



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË DHE
AUDITIMIN FINANCIAR TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL

Korrik 2023

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4
3. KONKLuzion I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	15
II. HYRJA	18
1. Titulli.....	19
2. Marrësi	19
3. Objektivat dhe qëllimi.....	19
4. Identifikimi i çështjes.....	19
5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.....	20
6. Përgjegjësitë e audituesve	20
7. Kriteret e vlerësimit.....	20
8. Standardet e auditimit.....	21
9. Metodatat e auditimit.	21
10. Dokumentimi i auditimit.....	22
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT	22
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	22
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	22
2.1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	22
2.2. Auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës.	45
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	55
2.4 Auditimi mbi dhënie e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese për mbrojtjen e bimëve.	134
2.5 Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2021-2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.	149
2.6. Auditimi i procedurave të prokurimit publik.	169
2.7. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit dhe vlerësimi i auditit të brendshëm.	299
2.8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.....	317
2.9 Çështje të ndryshme të dala gjatë auditimit.	349
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	354
V. ANEKSE	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi ka për mision konceptimin dhe implementimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, peshkimit dhe akuakulturës, përafrimin e legjislacionit dhe krijimin e një baze të konsoliduar ligjore brenda fushës së përgjegjesisë.

MBZHR funksionon në përputhje me legjislacionin përkatës Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr.9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 109, datë 31.07.2018, i ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përmbushje të misionit.

Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit por edhe nga fondet e BE-së.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi Kushtetues i kontrollit të fondeve buxhetore ka për qëllim që nga studimi i vlerësimit të riskut në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të MBZHR për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të auditojë nëse këto fonde janë përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike.

KLSH në periudhën nga data 11.01.2023 deri me datë 26.05.2023, kreu auditimin në subjektin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën e aktivitetit nga data 01.04.2021 deri ne 31.12.2022, duke u përqendruar në kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim të një vlerësimi të përgjithshëm të përputhshmërisë së aktiviteteve të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale. Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e konkluzioneve të auditimit.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit dhe të mungesës së përdorimit me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si intervistime, raporte dhe informacione, verifikime etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve publike, transparencës, përgjegjesisë dhe llogaridhënies.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e

rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJEVE	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>Nga auditimi u konstatua një nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga MBZHR, të lëna nga KLSH sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr. 528/7 Prot, datë 04.02.2022, ku nga 21 rekomandime, rezultoi se janë zbatuar 5 prej tyre ose 23,8% e totalit, zbatuar pjesërisht 2 ose 9,5 % e totalit, në proces – 6 rekomandime ose sa 28,57% e totalit dhe të pa zbatuara 8 rekomandime ose niveli i pa zbatueshmërisë është 38,09 %, veprime që sjellin mos përmirësim të performancës së MBZHR në kryerjen e detyrave funksionale dhe janë në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ne zbatim të nenit 15, shkronja “j”, neni 30.</p>	316-347	E lartë	<p>MBZHR të marrë masa që në të ardhmen të monitorojë me përgjegjësi dhe në kohë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, për përmirësimin e treguesve dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit ashtu edhe të burimeve njerëzore.</p>
2	<p>Lidhur me shkresën e ardhur në KLSH me nr. 19. Prot, datë 05.01.2023, nga shoqëria “Tenki 01” në lidhje me MBZHR, mbi zbatimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë me objekt:</p> <p>1-Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, për Lagunën e Patokut të datës 26.3.2015, për vlerësimin e bërë në kundërshtim me kriteret ligjore.</p> <p>2-Shfuqizimin e vendimit të ministrit për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, të datës 16.04.2015, grupi i auditimit të KLSH-së auditori veprimtarinë dhe përputhshmërinë e Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR si dhe DSHPA në varësi të saj, nga ku u konstatua se: MBZHR ka lidhur kontrata për aktivitet peshkimi me 5 subjekte fizike, dhe 8 subjekte juridike që prej vitit 2012 deri me vitin 2020 për një sipërfaqe prej 10,140 ha. Nga këto, deri më 31.12.2022, një kontratë është shfuqizuar dhe një është në proces gjyqësor. Nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit është vënë në dispozicion baza e të dhënave të kontratave të lidhura për peshkim në laguna i cili nuk përputhet me të dhënat e aparatit të MBZHR, ku rezultoi se janë lidhur 21 kontrata për peshkimin artizanal në laguna. Këto kontrata janë të regjistruara në regjistër të veçantë në administrim nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit por nuk janë pjesë e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR, si kontrata të lidhura me palë MBZHR, duke bërë që këto kontrata të lidhura me palë të tjera të krijojnë risk në mos raportim të problematikave që mund të lidhen me to si detyrë e një drejtorie në varësi të aparatit të MBZHR.</p> <p>Nuk janë hartuar plane veprimi vjetore në lidhje me monitorimin e kontratave të lidhura në laguna si dhe nuk ka një raport vjetor në lidhje me monitorimin e këtij sektori, apo raportim nga</p>	347-352	E lartë	<p>2.1 Të merren masa nga Titullari i institucionit që në të ardhmen të monitorohen me përgjegjësi dhe në kohë veprimtaria e kryer nga Institucionet e varësisë si dhe Drejtoritë në MBZHR, konkretisht për Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR, të hartohet regjistri i kontratave si pjesë integrale e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR.</p> <p>2.2 Të hartohen plane monitorimi vjetorë dhe mujorë nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA) dhe të miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm në MBZHR.</p> <p>2.3 Të raportohet në mënyrë periodike dhe vjetore mbi shfrytëzimin e lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre, për menaxhimin me eficiencë dhe efektivitet të të ardhurave që këto të fundit gjenerojnë në buxhetin e shtetit.</p>

	<p>DPSHA në MBZHR në lidhje me këtë monitorim. Gjatë auditimit u konstatuan raporte monitorimi të veçanta për monitorimin e vetëm 2 (dy) kontratave nga 21 të lidhura ose 10% të tyre, duke konstatuar in eficiency të Sektorit të Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA). Mungesa e planeve vjetore të monitorimit bie në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës e cila ka detyrë të hartojë objektivat, strategjitë dhe politikat specifike të peshkimit detar, në ujëra të brendshme dhe akuakulturë si dhe politika menaxhuese të lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre por edhe në kundërshtim me nenin 26, të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar ku DSHPA është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e planeve të zbatimit të peshkimit dhe akuakulturës”.</p> <p>U konstatua se as DPSHA dhe as MBZHR nuk verifikon numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, sipas plan biznesit të dakordësuar në kontratë, në kundërshtim me Udhëzimin e ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akua kulturën tokësore dhe ujore”, të ndryshuar, pika 7 ku është e përcaktuar qartë që struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DPSHA kontrollojnë dhe verifikojnë numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, në përputhje me nivelin e punësimit të deklaruar në plan biznes”. Nga sa më sipër si rezultat i mungesës së monitorimit periodik të kontratave të lidhura ndërmjet MBZHR-së dhe subjekteve, planeve konkretë të veprimit, kjo Drejtori rezultoi jo efiçente.</p>			
3	<p>Gjatë auditimit konstatohet se nga 51 kontrata që janë aktualisht të lidhura, 38 prej tyre ose 75% kanë detyrime në pagimin e qirasë në shumën totale 64,679,949 lekë, detyrim i cili për datën 31.12.2020 rezulton me një shumë totale prej 68,903,834 lekësh, ndërsa për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 paraqitet në shumën 29,043,882 lekë (në vitet në auditim janë bërë likuidime të detyrimeve të mbartura të qirasë).</p> <p>Për mungesë të realizimit të planit të investimit MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur gjoba në shumën 427,044,994 lekë, kryesisht gjatë auditimit në terren. Nga 51 kontratat ende në zbatim konstatohet se 83% e detyrimit për mos realizim të investimit i korrespondon 3 (tre) shoqërive, “B. A.I. ShPK” me 66% të detyrimit kundrejt detyrimit total, “P. I.” ShPK me 11% të detyrimit dhe shoqëria “F. A.” ShPK me 6% të detyrimit kundrejt detyrimit total që subjektet të cilët përdorin tokat bujqësore kanë ndaj MBZHR.</p> <p>Nga shumat e mësipërme për mos pagim qiraje dhe penalitet për vonesën në pagim në shumën totale 64,679,949 lekë më datë 31.12.2022, për gjoba të mosrealizimit të investimit në shumën totale 427,044,994 lekë, konstatohet se vlera</p>	54-133	E lartë	<p>MBZHR të marrë masat e menjëhershme në raportimin e duhur financiar të listës së debitorëve në lidhje me tokat bujqësore, duke bërë regjistrimin në pasqyrat financiare si dhe regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.</p>

	<p>totale 491,724,943 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të kontratave të tokave bujqësore në përdorim, të cilat nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të aparatit të MBZHR, Llogaria 411 “Klientë e llogari të ndryshme” dhe llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” rezultojnë në vlerën 0 lekë për vitin 2022, dhe krahasuar me vitin paraardhës nuk kanë pësuar ndryshime. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8/ 2018, Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 7/c. Megjithëse kundrejt MBZHR rezultojnë subjekte debitore me detyrimin për të likuiduar qiranë sipas kontratave të lidhura nga MBZHR në shumën 491,724,943 lekë deri në fund të vitit 2022, këto nuk janë pasqyruar në llogarinë 411/468 “Debitorë të ndryshëm”, duke denaturuar pasqyrat financiare me këtë shumë.</p>			
4	<p>Gjatë auditimit të kontratave të qirasë u përzgjidhën 21 kontrata kundrejt 51 kontratave në total. Përgjatë periudhës nën auditim, është lidhur vetëm 1 kontratë e re, ndërsa 20 kontratat e tjera janë lidhur në periudhat përpara viteve nën auditim, të cilat janë audituar duke marrë në konsideratë detyrimet progresive të mbartura në vite. Nga auditimi i dosjeve të kontratave të qiradhënies, edhe për vitet 2021 dhe 2022 u konstatua një vlerë e ndryshme e investimeve kapitale të parashikuara në Plan Biznes nga vlera e parashikuar në Shtojcën 2 të Kontratës së Qirasë, për 8 (tetë) subjektet më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shoq “P. I.t” ShPK; vlera e investimit e përcaktuar në plan biznes është vlera 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët). - Shoqëria “B.A. I.” ShPK; vlera e investimit sipas plan biznesit të paraqitur në konkurim është 2,863,542,500 lekë, ndërsa sipas shtojcës 2 të kontratës vlera e investimit është 2,128,000,000 lekë, ose 735,542,500 lekë më pak. - Shoqëria “K. D.” ShPK; vlera e investimit sipas plan biznesit të paraqitur në konkurim është përcaktuar 141,500,000 lekë dhe sipas shtojcës 2 të kontratës 137,100,000 lekë, ose 4,400,000 lekë më pak. - Shoqëria “B. N. F.” shpk; vlera e investimit sipas shtojcës 2 të kontratës është përcaktuar 33,740,000 lekë por ka mospërputhje dhe paqartësi në plan biznes, (në disa pjesë përshkruhet se vlera e investimit është 887,000 Euro ose 124,650,110 lekë dhe në disa pjesë vlera e investimit rezulton 607,000 Euro ose 85,301,710 lekë). - Shoqëria “B.P.” ShPK; vlera e investimit është 79,390,000 Lekë sipas planit të biznesit por sipas tabelave përmbledhëse rezulton 49,520,000 lekë (ka mospërputhje të shumta midis zërave të investimit, vlera të investimit dhe afateve të realizimit të investimeve) dhe 35,800,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës. - Person fizik L.Z.; vlera e investimit në planin e biznesit është përcaktuar 66,340,000 lekë (ka probleme në planin e biznesit ku janë futur shpenzime të tjera që nuk kanë vlerë për llogaritjen e investimeve) dhe 36,640,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës, ose 29,700,000 	54-133	E lartë	<p>4.1 Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e kontratave me problematikë në mospërputhjen e vlerës së investimit në plan biznes krahasuar kjo me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë. Në vijim të mundësohet dakordësia për amendim kontrate midis palëve me qëllim përputhshmërinë e investimit real me atë të parashikuar në kontratë sipas investimeve të kryera në terren dhe përshtatjen e afatit të qiradhënies sipas plan biznesit të ri.</p>

	<p>lekë më pak.</p> <p>- Person fizik P. C., "K.C."; Vlera e investimeve, sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim është 154,286,259 lekë, ndërsa vlera e investimeve sipas shtojcës 2 të kontratës është 120,900,000 lekë dhe (ose 33,386,259 lekë më pak).</p> <p>- Shoqëria "A. I.G." ShPK; vlera e investimit sipas planit fillestar të biznesit paraqitur në procedurat e ankandit është 482,178,240 lekë ndërsa sipas shtojcës 2 të kontratës së amenduar është 254,627,468 lekë, ose 227,550,772 lekë më pak.</p> <p>MBZHR rezulton të mos ketë ngritur në vazhdimësi një grup pune për vlerësimin dhe identifikimin e kontratave që kanë problematikë të mospërputhjes së vlerës së investimit të parashikuar në plan biznes me atë të lidhur në kontratë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8318, dt.01.04.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar; Neni 15, dhe VKM nr.460, datë 22.5.2013 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", i ndryshuar, Pikat 8 dhe 9.</p>			
5	<p>Nga auditimi u konstatua se nga ana e subjekteve të mëposhtëm, nuk janë dorëzuar garancitë e kontratave për periudhën objekt auditimi, kjo në kundërshtim me kontratën sipas nenit 8 "Sigurimi i garancisë së kontratës "pasi sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe duhet të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate "për kontratat e subjekteve si më poshtë:</p> <p>- "P. I." ShPK, - "B. N.F." ShPK, - L.Z. - P. C. - Sh. "M." ShPK. - "A.P." ShPK, - E.B. - "R. S." ShPK, - "A.B. F." shp.k, - "F. Al." shp.k, - "H.P.V." SHPK</p>	54-133	E lartë	5.1 MBZHR, të marrë masa të menjëhershme për njoftimin periodik për arkëtimin e garancive vjetore për të gjithë subjektet që nuk kanë mbaruar ende investimin, me qëllim parandalimin e risqeve që lidhen me mos respektimin e detyrimeve kontraktuale në kryerjen e investimeve sipas plan bizneseve të miratuara.
6	<p>Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore në lidhje me arkëtimin në kohë të qirasë rezulton se në 10 nga 21, ose 48% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë paguar në kohë detyrimin për qiranë duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si dhe shtim të detyrimeve të prapambetura në lidhje me kamatëvonesat e llogaritura në vlerën totale 55,830 mijë lekë, veprime në kundërshtim me VKM Nr.373, datë 20.6.2018 "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit"; Kontratat e qirasë, si dhe detyrimet kontraktuale sipas çdo kontrate.</p> <p>Gjatë auditimit u konstatua se 7 subjektet e mëposhtëm nuk kanë likuiduar apo paguar me vonesë qiratë në lidhje me kontratat e tokave bujqësore, si më poshtë:</p>	54-133	E lartë	<p>MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 55,830 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos pagesa në afat e detyrimit vjetor të qirave duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:</p> <p>- Shoqëria "P. I." ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863)</p> <p>- Shoqëria "A.I. G." ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë</p>

	<p>- Shoqëria "P. I." ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863) detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave;</p> <p>- Shoqëria "A.I. G." ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave;</p> <p>- Shoqëria "B.N. F." ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesave;</p> <p>- Shoqëria "R. S." ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesave;</p> <p>- Shoqëria "S. G." ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesave;</p> <p>- E.B., person fizik; K. C.; A. B. dhe F.A. dhe Kantina D. kanë në total 462 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesave.</p>			<p>- Shoqëria "B. N.F." ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë</p> <p>- Shoqëria "R.S." ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesave;</p> <p>- Shoqëria "S. G." ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë</p> <p>- E. B., person fizik; Kantina C.; A.B.t dhe F. A. dhe Kantina D. kanë në total 462 mijë lekë.</p> <p>-MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.</p>
7	<p>Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore në lidhje me realizimin e investimeve kapitale rezulton se në 12 nga 21, ose 57% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë kryer investime në terren për të cilat në dosjet e kontratave të audituara nuk ka dokumente justifikuese (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë 57% e kontratave nuk provon realizimin e investimit. Gjatë auditimit u konstatua se në 12 kontratat e qirasë nuk janë kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe nuk kanë kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para, referuar neni 6 pika 5, a dhe b të kontratës ku shprehet se "a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe.</p> <p>Gjatë auditimit u konstatua se 11 subjektet e mëposhtëm nuk kanë realizuar investimet e parashikuara në plan biznes për të cilat vlera e gjobës për mosrealizim të investimit paraqiten në vlerën totale 426,029 mijë lekë, si më poshtë:</p> <p>- Shoqëria "P. I." ShPK. në vlerën 45,465mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "Kantina D." ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "B. A. I." ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë</p> <p>- Shoqëria "K. Ç." ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "B. N. F." ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "A. I. G." ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "B.P." ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë;</p> <p>- Person fizik L. Z., në vlerën 5,147 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "A. P." ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "A. & CO" ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "F.A." ShPK në vlerën 25,650 mijë</p>	54-133	E lartë	<p>MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 426,029 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor në mos kryerjen e investimeve duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:</p> <p>- Shoqëria "P. I." ShPK. në vlerën 45,465 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "Kantina D." ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "B. A. I." ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë</p> <p>- Shoqëria "Kantina Ç." ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "B. N.F." ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "A. I. G." ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "B. P." ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë;</p> <p>- Person fizik L.Z., në vlerën 5,147 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "A. P." ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "A.. & CO" ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "F. A." ShPK në vlerën 25,650 mijë lekë;</p> <p>- Shoqëria "M." ShPK në vlerën 931 mijë lekë.</p> <p>-MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.</p>

	lekë; - Shoqëria "M." ShPK në vlerën 931 mijë lekë.			
8	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit: "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike", (2022), me objekt "Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim" me vlerë totale të fondit limit 866,303,595 lekë pa TVSH, është konstatuar vendosja e kriterëve përjashtues të cilat kanë sjellë pasojë përdorimin me efekt negativ të fondeve publike në vlerën 30,247,440 lekë pa TVSh e fondit të prokuruar, respektivisht:</p> <p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit Loti 7, me objekt: "Mbrotjtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier", me fond limit 93,972,048 lekë pa TVSh u konstatua se në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit ka vlerësuar në mënyrë të ngurtë kriterin 6 të "Kapacitetit teknik", ku nga NJP kërkohet që <i>paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, vetëm sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh."</i></p> <p>AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Grupi i auditimit e vlerëson këtë kriter përjashtues pasi të gjithë këta operatorë, nga historiku i prokurimeve në MBZHR, të s' kualifikuar për arsyen e sipërcituar nga KVO mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh." për profesionet "Teknik Ndërtimi", "Karpentier" dhe "Saldator", janë fitues në procedura të të njëjtit tip dhe kanë pasur kapacitetet teknike të mjaftueshme dhe të njëjtë për periudhën 2017-2021, ndërkohë në vitin 2022 të njëjtët OE vlerësohen me kapacitete teknike të pamjaftueshme ose e thënë ndryshe me teknikë jo të trajnuar dhe të pajisur me certifikatën tip të cilat sipas KVO duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh."</p> <p>Nga verifikimet e kryera në lidhje me subjektin "Qendra e trajnimeve të avancuara-QTA" i cili është certifikuar nga MFE me shkresën nr. 17089/2, datë 01.12.2021 me lëndë: "Për ndryshim në Licencën e formimit profesional dhe shtim të listës së kurseve të formimit profesional përkatësisht:</p> <p>Instalues i sistemeve ngrohëse; Saldator; Hidraulik; Pllaka shtrues; Karpentier; Murator-suvatues etj., rezulton që është vetëm ky subjekt privat i certifikuar nga MFE ose e thënë ndryshe ka "ekskluzivitetin" e dhënies së këtyre certifikatave të cilat janë kurse jo më shumë se 85-90 orë mësimore që "zëvendësojnë" shkollat e arsimit profesional që kanë një kohëzgjatje prej 3-vjet. (Verifikuar në certifikatat e lëshuara të marra nga sistemi elektronik i prokurimeve). Duke parë rëndësinë e ofertave ekonomike më</p>	167-298	E lartë	<p>1- AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s' kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, i cili nuk ndryshon thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e kualifikuar në këtë rast si ofertë të vlefshme me qëllim menaxhimin me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve të buxhetit të shtetit.</p>

<p>të mira ekonomikisht, në lidhje me kurset e specialistëve, nga KVO nuk duhej mbajtur qëndrim ”strikt”, në vlerësimin e ofertave, pasi nuk do të cenohej aspak realizimi i kontratës me sukses. Referuar ligjit mbi prokurimin publik, Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.</p> <p>MBZHR, nuk ka siguruar të ulë shpenzimet procedurale. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mosveprimit të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në disfavor të buxhetit të shtetit, përkatësisht: Nga s ‘kualifikimi i OE “Sh.07”, ShPK, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në disfavor në vlerën 22,880,970 lekë pa TVSH = (74,398,800 – 51,517,830), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.</p> <p>2- Nga auditimi i procedurës së prokurimit Loti 17, me objekt: "Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgj", me fond limit 57,139,289 lekë pa TVSh u konstatua se në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit ka vlerësuar në mënyrë të ngurtë kriterin 6 të “Kapacitetit teknik”, ku nga NJP kërkohet që <i>paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, vetëm sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”.</i> Gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht mangësive, përpara se të kryente s ‘kualifikimin, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e nenit 53 pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, sipas të cilit: <i>“autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”</i>., veprimet e KVO-së ndikojnë negativisht në mirë përdorimin e fondeve publike dhe për pasojë kryerjen e punimeve me një vlerë me të lartë ekonomike. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mos veprimit të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në dis favor të buxhetit të shtetit, përkatësisht: Nga s ‘kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “H.” ShPK me NUIS J.....B me ofertë ekonomike 64,293,759.60 lekë, veprimet e</p>			
---	--	--	--

	<p>KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë më tepër në vlerën 172,080 lekë pa TVSH = (66,465,840 – 64,293,760), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.</p> <p>Nga s 'kualifikimi i OE Operatori Ekonomik "U." ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 59,271,450 lekë pa tvsh, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në disfavor në vlerën 7,194,390 lekë pa TVSH = (66,465,840 – 59,271,450), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim. Në alternativë, sa më sipër KVO-ja, midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë, referuar nenit 2 të ligjit nr. 162/2020 prot., "Për prokurimin publik", me qëllim rritjen e efijencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirë përdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është "Oferta më e ulët" për të bërë të mundur shmangien e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike në vlerën 30,247,440 lekë si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.</p>			
9	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine", është shpallur fitues BOE S. (me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4), të përfaqësuar këta nga OE SALILLARI sipas prokurës së posaçme me nr. 5782 rep., 2175 kol., datë 26.09.2020 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me vlerë 288,523,171.95 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</p> <p>Nga inspektimi në terren i punimeve të realizuara për këtë kontratë por në lidhje me punimet për ndërtimin e stallës së lopëve, rezultoi se ky investim, në 5 mujorin e parë të vitit 2023 është krejtësisht jo efektiv dhe i pa vënë në përdorim nga ana e Ministrisë dhe QTTB, duke mos përmbushur objektivin për të cilin është ndërtuar dhe për pasojë përdorimin pa efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt në masën prej 67,633,707 lekë me TVSH. Gjithashtu investimi nuk rezultoi të ishte i sigurt nga vjedhjet, tjetërsimi si dhe nga përdorimit i paautorizuar pasi nuk janë siguruar vendqëndrimet dhe rojet përkatëse në të paktën 2 pozicione, këto të domosdoshme nisur edhe nga shtrirja e investimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi".</p>	167-298	E lartë	<p>Nga ana e MBZHR të merren të gjitha masat e nevojshme për vënien në përdorim të investimit të bërë për pjesën e stallës së lopëve pasi aktualisht mos përdorimi e bën këtë shpenzim të jetë krejtësisht jo efektiv duke shkaktuar kështu edhe një përdorimin pa efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet në masën prej 67,633,707 lekë me TVSH. Gjithashtu, MBZHR dhe QTTB të marrin masat e nevojshme për sigurimin nga vjedhjet, tjetërsimin si dhe nga përdorimet e paautorizuara të këtij aset.</p>
10	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë", rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE R&T (me nr. licence NZ.3091/19) me të cilin është lidhur kontrata</p>	167-298	E lartë	<p>Nga ana e MBZHR të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorim/ndjekje kontrate dhe atyre të marrjes në dorëzim me qëllim shmangien e rasteve të mospërputhshmërisë mes</p>

	<p>me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK z. sipas shkresës me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me vlerë 186,053,560 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</p> <p>Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përdorur pa efektivitet eficiency dhe ekonomicitet fondet në shumën prej 745,000 lekë pa TVSH e argumentuar kjo si më poshtë.</p> <p><i>Zëri F.V. Punime artistik me metal inoksidabël, rrrathë me diametër 5 m dhe figurë 3 m të lartë</i></p> <p>Sipas përshkrimit në preventiv ky detaj duhet të ishte realizuar me dimensione 5 m diametri dhe 3 m i lartë figura kur në fakt nga verifikimi në terren i kryer ky zë është realizuar me konfiguracion me dimensione 3.8 m dhe 2.4 m, ose përkatësisht 1.2 m dhe 0.6 m më pak. Pra, vlera prej 745,000 lekë pa TVSH nuk është kryer sipas kërkesave të projektit.</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6477/8 prot., datë 22.11.2021, Urdhri nr. 653, datë 03.12.2019 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës” si dhe Urdhri nr. 265/1 prot., datë 13.01.2022 “Për ngritjen e komisionit për kolaudimin e punimeve”.</p>			<p>zërave të preventivave dhe atyre të kryer në fakt, duke shmangur kështu edhe përdorimet pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve si është ai i shumës prej 745,000 lekë pa TVSH i shkaktuar prej mos respektimit të detajeve të projektit</p>
11	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine”, është shpallur fitues BOE S. (me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4), të përfaqësuar këta nga OE S. sipas prokurës së posaçme me nr. 5782 rep., 2175 kol., datë 26.09.2020 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me vlerë 288,523,171.95 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</p> <p>Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 6,461,698 lekë pa TVSH për 6 zëra punimesh.</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011,</p>	167-298	E lartë	<p>Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 6,461,698 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE S.(me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4) për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me objekt ‘Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine’.</p>

	<p>Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6942/6 prot., datë 23.10.2020, Urdhrin nr. 532, datë 31.12.2020 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës”.</p>			
12	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi objektiv dhe mbrojtje lumore, i ndarë me lote”, “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë) nën objekti “Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”, është shpallur fitues BOE B. & B. & B. & NG S. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 3273/25 prot, datë 31.08.2020 me vlerë 51,972,606 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</p> <p>Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfutur tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 956,402 lekë pa TVSH e argumentuar kjo si më poshtë.</p> <p>Sipas dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje rezulton se punimet e gërmimit nuk janë kryer me ekskavator me kapacitet 0.25 m³, siç parashikon zëri në preventiv por janë kryer me ekskavator me kapacitet kove 1 m³, kapacitet i cili rezulton një çmim më të ulët nga ai i zërit 3.97/b Gërmim dhe me ekskavator zinxhir 0.25 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shkarkim në tokë si rrjedhojë e një rendimenti më të lartë të kësaj kove me të paktën 50 %. Për rrjedhojë, për këtë zë duhet të ishte bërë korrigjimi i zërit në preventiv dhe në situacionin përfundimtar duke ndryshuar rendimentin nga 0.08 o.p makineri/m³ në 0.06 o.p makineri/m³. Mos kryerja e këtij veprimi ka bërë që të përfitohen tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlere prej 956,402 lekë pa TVSH ((900 lekë/m³ – 199 lekë/m³) x 1364.34 m³).</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 si dhe Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 3137/18 prot., datë 31.08.2021.</p>	167-298		<p>Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 956,402 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE B. & B. & B. & NG S. për punime jo në përputhje me preventivin në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3273/25 prot., datë 31.08.2020 me objekt “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë) nën objekti “Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”.</p>
13	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në</p>	167-298		<p>Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke</p>

<p>përfundim të procedurës së prokurimit me objekt <i>“Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”</i>, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE R. (me nr. licence NZ.3091/19) me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me vlerë 186,053,560 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</p> <p>Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 172,718 lekë pa TVSH e argumentuar kjo si më poshtë.</p> <p><i>Zëri Transport mbetjesh deri 7 km</i></p> <p>Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 1380 m³. Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar analizës së zërit të punës <i>Prishje mure tulle pa pastrim</i>, me nr. analize 2.426, rezulton se ky zë ka të parashikuar edhe volumin e punës për transportin e materialit. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër volumi prej 285 m³ për transportin e mbetjeve nga prishja e mureve të tullës, ose vlera prej 105,450 lekë pa TVSH.</p> <p><i>Zëri Shtrese betoni C-12/15</i></p> <p>Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 181.6 m³ nga të cilat sasia prej 32.75 m³ për plintat sipas librezës së masave. Në fakt, referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje rezulton se shtresa e betonit nuk është realizuar me shtesa prej 20 cm në çdo krah të plintave, pra nuk është realizuar me të njëjtën gjerësi të shtresës me çakëll por është realizuar me gjerësi sipas asaj të plintit. Për rrjedhojë rezulton se janë përfituar tepër volumi prej 8.515 m³ (32.75 x 26 %), ose vlera prej 67,268 lekë pa TVSH.</p> <p>Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6477/8 prot., datë 22.11.2021, Urdhri nr. 653, datë 03.12.2019 <i>“Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës”</i> si dhe Urdhri nr. 265/1 prot., datë 13.01.2022 <i>“Për ngritjen e komisionit për kolaudimin e punimeve”</i>.</p>			<p>ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 172,718 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE R. për punime të likuiduara por të pakryera në fakt në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me objekt <i>“Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”</i>.</p>
---	--	--	---

3. KONKLUZION I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (i modifikuar)¹.

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, pasqyrë mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura si dhe vlerësimi i saktësisë së pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e modifikuar/kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit më 31 dhjetor 2022, referuar ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. justifikon dhënien e një “Opinionit të modifikuar/kualifikuar”.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-700; 701; 705). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të auditimit. Ne jemi të pavarur nga MBZHR, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit për vitin 2022 (në masën 0,7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar) në vlerën 254,727 mijë lekë për shpenzimet, për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të mesëm.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në saktësinë e informacionit kontabël në MBZHR. Për këto arsye kemi dhënë “Opinion të modifikuar/kualifikuar”, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

a. Gjatë auditimit konstatohet se nga 51 kontrata për tokat bujqësore të lidhura në MBZHR, deri në dhjetor 2022, 38 prej tyre ose 75% kanë detyrime në mos pagimin e qirasë në shumën totale 64,680 mijë lekë.

b. Për mungesë të realizimit të planit të investimit nga subjektet qiramarrës, MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur penaltete në përputhje me detyrimet kontraktuale në shumën 427,045 mijë lekë. Pra shuma prej 491,725 mijë lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të

¹- Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, miratuar me vendim nr. 246, datë 29.12.2022, kapitulli 7.3.5 “Opinionet mbi auditimin financiar”, pika 4.2, “Opinion i Modifikuar me rezervë”, jepet në ato raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe datë përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

kontratave të tokave bujqësore në përdorim, (e përbërë nga shumat për mos pagim qiraje dhe penaltitet për vonesën në pagim në vlerën 64,680 mijë lekë deri më datë 31.12.2022 si dhe penaltitete të mos realizimit të investimit në shumën totale 427,045 mijë lekë), të cilat nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të aparatit të MBZHR. Llogaria 411 “Klientë e llogari të ndryshme” dhe llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” rezultojnë në vlerën 0 lekë për vitin 2022, e pandryshueshme nga vitet paraardhës.

- Mungesë regjistrimi në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare për periudhën 2021-2022, të tokave bujqësore që MBZHR administron, (në sipërfaqe totale 19,033.95 ha), duke cenuar transparencën dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave pasurore në administrim të MBZHR.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e “Kudrit rregullator/sipas rastit” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Titullari i Institucionit, Sekretari i Përgjithshëm (në cilësinë e Nëpunësit Autorizues), janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH, është që të shprehë një opinion për Pasqyrat Financiare Vjetore në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesit të KLSH, lidhet me ofrimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën e audituesit. Në gjithashtu: Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomali materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën e auditimit të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedurën e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

b. Opinion për auditimin e përputhshmërisë (I modifikuar/Kualifikuar²).

Mbështetur në ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në auditim përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës. “Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MBZHR, janë

²-Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (vendim nr, 245, datë 29.12.2022. fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinonet e pakualifikuara: “Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.

evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga MBZHR dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e opinionit të kualifikuar mbështetur në konstatimet në vijim:

- Mungesa e një plani vjetor për monitorimin e kontratave dhe një regjistri të miratuar për kontratat e qirasë.

- Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR, për periudhën 2013 -2022 ka lidhur 54 kontrata qiradhënie toke bujqësore, nga të cilat 45 kontrata janë aktive deri në fund të periudhës së auditimit dhe vlerësohen sipas parashikimeve kontraktuale, 3 (tre) kontrata janë zgjidhur, 3 (tre) kontrata janë në proces gjyqësor, për 1 (një) kontratë është kërkuar zgjidhja vullnetare nga subjekti dhe për 2 (dy) kontrata ka përfunduar procesi gjyqësor. Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore u përzgjedhën për auditim 21 prej tyre.

- Mos arkëtim i detyrimeve vjetore të qirave të tokave bujqësore në administrim të MBZHR nga kontraktorët në vlerën 64,680 mijë lekë për periudhën në auditim. (për 51 kontratat e lidhura).

Për 10 nga 21 dosjet e përzgjedhura për auditim, ose 48% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë paguar në kohë detyrimin për qiranë.

- Të ardhura të munguara nga mos arkëtimi në kohë i qirave vjetore për tokat bujqësore në vlerën totale 55,830 mijë lekë, nga strukturat përgjegjëse në MBZHR.

- Mos realizim i investimeve të parashikuara në plan biznes nga ana e 12 subjekteve qiramarrëse të përzgjedhura për auditim në zbatimin e detyrimeve kontraktuale nga të dy palët MBZHR dhe qiramarrës, e cila ka gjeneruar gjopa në vlera të konsiderueshme pa shpresë arkëtimi në shumën 426,029 mijë lekë, nga të cilat 82.7% e vlerës u përket vetëm 3 subjekteve kontraktues.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike”, (2022), me objekt “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim” me vlerë totale të fondit limit 866,303,595 lekë pa TVSH, është konstatuar vendosja e kritereve përjashtues nga AK të cilat kanë sjellë pasojë përdorimin pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 30,247,440 lekë pa TVSh e fondit të prokuruar.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine”, si dhe nga verifikimi në terren i zbatimit të kontratës në lidhje me punimet për ndërtimin e stallës së lopëve, rezultoi se ky investim, në 5 mujorin e parë të vitit 2023 është krejtësisht jo efektiv dhe i pa vënë ende në përdorim nga ana e Ministrisë dhe QTTB Fushë Krujë, duke mos përmbushur objektivin për të cilin është ndërtuar dhe duke sjellë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt në masën prej 67,633,707 lekë me TVSH.

- Nga auditimi në lidhje me zbatimin e kontratës të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”, rezultoi se nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave janë përdorur pa efektivitet efikasitet dhe ekonomicitet fondet në shumën prej 745,000 lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit.

- Dëm ekonomik në vlerën 7,591 mijë lekë pa TVSH, për 3 (tre) procedurat e prokurimit me objekt 1- “Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine”.

2- “Rehabilitimi objektesh dhe mbrojtje lumore, i ndarë me lote”, “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë)” nën objekti “Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”.

3- “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”.

Nga verifikimi në terren i zbatimit të kontratave rezultoi se nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave kjo shumë është përfutur më tepër nga ana e sipërmarrësve si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt për disa zëra punimesh.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MBZHR, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetore të saj, për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues të personave me liri të kufizuar. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1175/1prot., datë 11.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri në datë 26.05.2023, në subjektin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (*këtu e më poshtë MBZHR*) u krye auditimi “Mbi auditimin e përputhshmërisë dhe financiar” për periudhën nga 01.04.2021 deri në 31.12.2022 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. E.Ll., (Përgjegjës Grupi)
2. M. H., Auditues
3. I.I., Auditues
4. G.G., Auditues
5. S. K., auditues
6. J. H., auditues

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve, përputhshmërinë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Drejtorive të MBZHR e cila ka për mision konceptimin dhe implementimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, peshkimit dhe akua kulturës, për afrimin e legjislacionit dhe krijimin e një baze

të konsoliduar ligjore brenda fushës së përgjegjësisë, auditimi i procedurave të prokurimit publik, menaxhimi financiar dhe kontrolli, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt konstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren (MBZHR) me datë 05.05.2022 me përfaqësues të strukturave drejtuese, persona të cilësuar me përgjegjësi në aktet e mbajtura, si dhe grupit të auditimit. Takimi përmbyllës në terren është mbajtur sipas protokollit përkatës (Dokumenti standard 13) parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin nr.107 datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar.

1. Titulli

Raport mbi auditimin e përputhshmërisë dhe financiar në subjektin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për periudhën nga data 01.04.2021 deri më 31.12.2022.

2. Marrësi

Ky Raport i adresohet Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësuar nga znj. F.K..

3. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivat specifike të auditimit janë, dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.

Qëllimi i auditimit është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara në çdo aspekt material janë në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së MBZHR-së.

4. Identifikimi i çështjes.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, misioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e veprimtarisë si vijon:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral;
- Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural në koherencë të plotë me kërkesat e BE-së;
- Mbrojtja e shëndeti i kafshëve, bimëve, dhe garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që mund të vijnë nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve;
- Mbledhjen dhe përpunimin e informacionit bujqësor;
- Menaxhimin dhe administrimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore;
- Ofrimin e asistencës dhe informacionit për fermerët;
- Menaxhimin e sistemit të kullimit dhe koordinimin e veprimeve për administrimin e sistemit të ujitjes.

Aktiviteti i përgjithshëm i MBZHR drejtohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorë të Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Përgjegjës Sektori, ku zhvillohen veprimtaritë në bazë të rregullores miratuar me Urdhër të Ministrit “Për organizimin dhe funksionimin e MBZHR”, në të cilat përfshihen objekti i punës, struktura dhe detyrat funksionale të çdo punonjësi.

Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në Programin e Auditimit nr. 1175/1 prot, datë 11.01.2023, i ndryshuar.

-vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimi financiar dhe kontrollit, në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar sipas komponentëve.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/MBZHR-së dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojnë e kryejnë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit;

-Nëse shpenzimet janë planifikuar mbi bazën e nevojave në nivel institucioni nëse janë realizuar në përputhje me planin e miratuar nga ministri i MBZHR-së;

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore në -zhvillimin e një strategjie të përshtatshme për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, të bimëve, dhe garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që mund të vijnë nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve;

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për menaxhimin dhe administrimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore dhe monitorimin e kontratave të lidhura për to.

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore në zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, procedurat për qarkullimin e dokumentacionit etj.

- Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore në procedurat e prokurimeve duke filluar nga planifikimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për likuidimin në kohë të pagesave dhe auditimin e brendshëm.

-Nëse janë identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre etj.

7. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

-Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016.
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Ligji 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik.”
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”.
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike.
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.
- VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.”
- Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022, për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.**
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe çdo bazë ligjore me të cilën është operuar për periudhën 2021-2022 si dhe aktet juridike për funksionimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

8. Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

- ISSAI 100 (*Parime parimet themelore të auditimit të sektorit publik*), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) që zbatohen nga anëtarët e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve/IFAC;
- Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*"; etj.;
- Praktikat më të mira të fushës.

9. Metodatat e auditimit.

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të MBZHR, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

c. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*- duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

d. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

e. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

10. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e MBZHR-së, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij raporti.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi ka për mision konceptimin dhe implementimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, peshkimit dhe akuakulturës, përafrimin e legjislacionit dhe krijimin e një baze të konsoliduar ligjore brenda fushës së përgjegjësisë.

MBZHR funksionon në përputhje me legjislacionin përkatës Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr.9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 109, datë 31.07.2018, i ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përmbushje të misionit.

Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi Kushtetues i kontrollit të fondeve buxhetore ka për qëllim që nga studimi i vlerësimit të riskut në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të MBZHR për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Të auditojë nëse këto fonde janë përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

Në zbatim të pikës/ drejtimit 1 “Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Programet Buxhetore Afatmesëm(PBA) 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;*

2) *Projektbuxheti për vitin 2022 dhe vitin 2023, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit*

gjatë vitit ushtrimor 2021, 2022;

3) *Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit 2021, 2022;*

4) *Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.*

Auditimi u krye për 9-mujorin e vitit 2021 dhe vitin 2022, në zbatim të:

- Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Me Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”,
- Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar,
- VKM nr. 523 datë 25.07.2019 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2020-2022”
- VKM nr.577, datë 22.07.2020 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2021-2023”
- VKM nr.190. date 03.03.2021 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2022-2044"
- VKM nr. 440 datë 22.7.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtarë të shpenzimeve të programit buxhetor Afatmesëm 2022-2024”
- Udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”,
- Udhëzimit nr. 8, datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024”,
- Udhëzimit nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 - 2025”,
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 3.3.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 -2024”
- Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”,
- Udhëzimin plotësues nr. 1, datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”,
- Udhëzimit të MF nr. 36 datë 17.12.2019 “Për përgjegjësitë e përdoruesve në sistemin informatik të menaxhimit financiar për modulën e përgatitjes së buxhetit, modulën e menaxhimit të investimeve publike dhe modulën e monitorimit të buxhetit dhe portofolit të projekteve”
- etj.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka për mision zbatimin e programit të qeverisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, i ndërthurur me sektorë të tjerë si turizmi, infrastruktura dhe shërbimet, për nxitjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, nëpërmjet uljes së kostos dhe rritjes së konkurrueshmërisë, menaxhimit të qëndrueshëm të tokës dhe të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmytja, përmirësimin e sigurisë ushqimore në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Aparatit të Ministrisë dhe nëpërmjet saj institucioneve të varësisë i planifikohen nga buxheti i shtetit për çdo vit fonde buxhetore.

MBZHR ka në përbërje të buxhetit të saj shtatë programe:

- Programin nr. 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”;
- Programin nr. 04220
- Programin nr. 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”;
- Programin nr. 04250 “Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market”;
- Programin nr. 04860 “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”
- Programin nr. 05470 “Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore”
- Programin nr. 04230 “Mbështetje për Peshkimin”

Njësi të varësisë të MBZHR për vitin 2021 dhe 2022 janë gjithsej 24 (njëzetë e katër) njësi dhe konkretisht:

- Autoriteti kontraktor i ushqimit Tiranë dhe 12 DRAKU Rajonale
- Agjensia e zhvillimit bujqësor rural

- Drejtoria e shërbimeve të peshkimit dhe Akuakulturës
- Agjencia Kombëtare e Duhan cigareve
- Enti shtetëror i farërave dhe fidanëve“Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”;
- Aparati i MBZHRAU
- Instituti i sigurisë ushqimore dhe veterinarisë
- QTTB Fushë krupë
- QTTB Vlorë
- QTTB Shkodër
- QTTB Korçë
- QTTB Lushnjë
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Durrës, Korçë dhe Lezhë
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, Vlorë, Shkodër, Elbasan
- AREB Korçë, Lushnjë, Tiranë, Shkodër

Llogaritja e materialiteti për subjektin nën auditim:

Artikujt	Në mijë lekë	
	Buxheti 2021	Buxheti 2022
Paga (600-601)	2,302,239	2,303,989
Korente të Tjera (602-606)	3,012,000	4,503,285
Kapitale (230-232) Të Brendshme	3,500,000	2,765,844
Kapitale (230-232) Të Huaja	4,166,093	3,163,250
Totali	12,980,332	12,736,368
Materialiteti 2%	259,607	254,727

Materialiteti 2% i buxheteve fillestare për vitet nën auditim paraqitet në vlerën 259,607 mijë lekë për vitin 2021 dhe 254,727 mijë lekë për vitin 2022.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Për vitin 2022

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vendimmarrjet mbi procedurat e miratimit të PBA, projektbuxhetit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit janë kryer nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik ngritur në përputhje me Pikën 8/b, Nenit 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Për planifikimin e PBA dhe projekt buxhetit të vitit 2021 Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur sipas Urdhrit të Ministrit me nr. 64/ 1292 prot, datë 05.02.2021 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik”. Grupi i Menaxhimit Strategjik me Kryetar titullarin e MBZHR, është i përbërë nga 8 anëtarë, 1 anëtar pa të drejtë vote nga drejtoria e auditimit të brendshëm, 1 koordinator (Sekretarin e përgjithshëm të MBZHR) dhe sekretar nëpunësin zbatues. Me Urdhrin e Ministrit nr. 84/ prot 1589 “Për ngritjen e Ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore” janë caktuar drejtuesit dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit të shtatë programeve që administrojnë MBZHR. Në institucionin e MBZHR caktimi i drejtuesit të EMP-së është bërë në përputhje me përcaktimet e pikës 2.5.1/a të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, ku përcaktohet se: “1. Në varësi të organizimit të njësisë së qeverisjes qendrore drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të programit buxhetor është b) Në njësitë e qeverisjes qendrore që zbatojnë më shumë se një program buxhetor, drejtues programi si rregull konsiderohet drejtuesi i nivelit më të lartë në varësi direkte nga nëpunësi autorizues.

Grupit për menaxhimin strategjik ka marrë vendime për kërkesa shtesë bazuar në tavanet e miratuara për fazën e parë dhe të dytë të PBA-së 2022-2024, me VKM-në nr. 119, datë

3.3.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitorë të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024” dhe VKM nr. 440, datë 22.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përgatitorë të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024”, pas shqyrtimit të punës përgatitore nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore. Kërkesat shtesë janë bërë pjesë e relacionit bashkëlidhur PBA 2022-2024.

Nëpunësi zbatues ka përgatitur dokumentin përfundimtar të buxhetit konform Pikës 2/a dhe 3/a, Nenit 12 të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Ky dokument është miratuar nga Nëpunësi autorizues dhe është dërguar MFE konform Pikës 4/d, Nenit 9 të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për me menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se, është hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit si dhe aktivitetet e programit, ku çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore.

Nga grupi i auditimit u bënë objekt auditimi përgatitja e PBA-ve të periudhës 2022-2024 dhe 2023-2025 të cilat u audituan në drejtim të analizës së përlogaritjes dhe detajimit të fondeve buxhetore sipas viteve, transferimeve, rialokimeve dhe monitorimit të buxhetit gjatë viteve ushtrimore të audituara. PBA 2021-2023 nuk është audituar, pasi nuk i përket periudhës së këtij auditimi.

Planifikimi buxhetor i vitit 2022-2024

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, MBZHR ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2020-2022”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve.

Me shkresën nr. 2057/1 prot., datë 30.04.2021, MBZHR dërgon në MFE “Mbi projekt Buxhetin Afatmesëm 2022 – 2024 për MBZHR” (faza e parë/ strategjike), dhe me shkresën nr. 5611/2, datë 01.09.2021 “Mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2022 - 2024” janë dërguar kërkesat buxhetore të fazës së dytë/ teknike. Programimi i shpenzimeve është kryer sipas prioriteteve strategjike të MBZHR bazuar në Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor.

Planifikimi buxhetor sipas PBA 2022-2024, faza strategjike dhe teknike krahasuar me buxhetin e vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.: 1.1 “Planifikimi buxhetor afatmesëm 2022- 2024”

Në mijë lekë

Planifikimi Artikujt	Faza strategjike për v. 2022		Dif 2022-2021	PBA 2022 – 2024 Faza teknike		
	Buxheti 2021	2022		2022	2023	2024
Paga (600-601)	2,302,239	2,323,989	21,750	2,303,989	2,303,989	2,323,989
Korente të Tjera (602-606)	3,012,000	3,356,285	344,285	3,089,285	2,883,011	2,732,886
Kapitale (230-232) Të Brendshme	3,500,000	2,453,844	(1,046,156)	2,453,844	2,882,272	3,532,272
Kapitale (230-232) Të Huaja	4,166,093	2,924,946	(1,241,147)	2,924,946	3,124,946	3,624,946
Totali	12,980,332	11,059,064	(1,921,268)	10,772,064	11,194,218	12,214,093

Burimi: MBZHR, Përpunuar nga grupi auditimit

Planifikimi buxhetor strategjik në shumën totale 11,059,064 mijë lekë paraqitet për llogarinë 600 “paga” në shumën 1,982,400 mijë lekë, për llogarinë 601 në shumën 341,589 mijë lekë, për llogarinë 602 në shumën 1,579,365 mijë lekë, për llogarinë 605 “transfera të jashtme” në

shumën 21,600 mijë lekë, llogarinë 606 “transfera për familjet e individët” në shumën 1,755,320 mijë lekë, llogarinë 230 “aktive të trupëzuara” në shumën 30,000 mijë lekë dhe llogarinë 231 “aktive të trupëzuara” në shumën 5,348,790 mijë lekë.

Planifikimi buxhetor faza e dytë paraqitet për llogarinë 600 “paga” në shumën 1,972,400 mijë, për llogarinë 601 në shumën 331,589 mijë lekë, për llogarinë 602 në shumën 1,312,365 mijë lekë, për llogarinë 605 “transfera të jashtme” në shumën 21,600 mijë lekë, llogarinë 606 “transfera për familjet e individët” në shumën 1,755,320 mijë lekë, llogarinë 230 “aktive të trupëzuara” në shumën 35,000 mijë lekë dhe llogarinë 231 “aktive të trupëzuara” në shumën 5,343,790 mijë lekë.

Kërkesat shitesë mbi tavanet e miratuara që MBZHR ka paraqitur në MFE nëpërmjet relacionit të PBA 2022-2024 për fazën e parë/ strategjike dhe fazën e dytë/ teknike janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr: 1.2 “Kërkesat shitesë sipas PBA 2022 – 2024 për vitin 2022”

Në mln lekë

Emërtimi i programit/projektet	Kërkesat shitesë faza e parë	Kërkesat shitesë faza e dytë
1- Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes	650	650
Investime të Brendshme Ujitje, Kullim e Mbrojtje nga Përmbytja	650	650
2- Zhvillimi Rural	4,903	5,568
Skema Kombëtare	3,038	3,037
Skema e Naftës	8	158
Investime të Huaja për IPARD II	584	939
Investime të Brendshme për Bashkëfinancim IPARD II	1,273	1,434
3- Mbështetje për Peshkimin	370	370
Skema e Mbështetjes për Peshkimin	370	370
4- Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	10	10
Pajisje Kompjuterike/Laboratorike për Sistemin GIS.	10	10
TOTALI	5,933	6,598

Burimi: MBZHR, Përpunuar nga grupi auditimit

Parashikimi i PBA-së 2022-2024 për artikujt buxhetorë është bazuar në prioritetet e sektorit të bujqësisë, të cilat për periudhën afatmesme 2022-2024, kanë qenë si më poshtë:

- ✓ Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- ✓ Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;
- ✓ Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;
- ✓ Mbështetje për agroindustrinë;
- ✓ Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- ✓ Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve;
- ✓ Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- ✓ Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Gjatë auditimit të kërkesave buxhetore të PBA 2022-2024 planifikuar nga MBZHR konstatohet se kërkesat për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” janë bazuar në financimin për pagat e punonjësve të aparatit të MBZHR-së, për trajnimet e nëpunësve, për përmirësimin e strukturës funksionale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kapaciteteve

menaxhuese dhe implementuese në institucion, në funksion të hartimit dhe monitorimit të politikave.

Kapacitetet menaxhuese dhe implementuese në Institucion dhe mirefunksionale për hartimin dhe monitorimin e politikave në numër rezulton i pandryshuar nga një vit më parë, por me një shpenzim të ulur në vlerën 5,300 mijë lekë përgjatë fazës së parë dhe të ulur ende me vlerën 20,000 mijë lekë përgjatë fazës së dytë të planifikimit buxhetor.

Tabela nr. 1.3: “Kërkesat buxhetore të programit “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” gjatë fazave të përgatitjes së PBA 2022-2024 sipas artikuljeve”

Në mijë lekë

Totali shpenzimeve të Programit "Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi"	Buxheti viti 2021	Faza strategjike 2022-2024				Diferenca 2022 faza II-I	Faza teknike 2022-2024		
		Viti 2022	Diferenca 2022-2021	Viti 2023	Viti 2024		Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
	318,000	377,600	59,600	372,800	384,000	-20,000	357,600	357,800	384,000
600 - Paga	179,200	214,200	35,000	214,200	214,200	0	214,200	214,200	214,200
601 - Sigurime Shoqërore	30,800	35,800	5,000	35,800	35,800	0	35,800	35,800	35,800
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	70,580	65,280	-5,300	60,480	71,680	-20,000	45,280	45,480	71,680
605 - Transferata Korente të Huaja	35,000	21,600	-13,400	21,600	21,600	0	21,600	21,600	21,600
606 - Trans për Buxh. Fam. & Individ	2,420	720	-1,700	720	720	0	720	720	720
231 - Kapitale të Trupëzuara	0	40,000	40,000	40,000	40,000	0	40,000	40,000	40,000

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2023

Grupi i Menaxhimit Strategjik përgjatë vitit 2022 është ndryshuar sipas Urdhrit të Ministrit me nr. 628/ 8180/1 prot, datë 15.12.2021 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” për periudhën dhjetor 2021- dhjetor 2022 dhe sipas Urdhrit të Ministrit me nr. 373/ 4229/1 prot, datë 15.08.2022 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik” për periudhën dhjetor 2022-dhjetor 2023, i cili ka shfuqizuar urdhrin e mëparshëm. Me Urdhrin e Ministrit nr. 629/ prot 8180/2, datë 15.12.2021 dhe Urdhrin e Ministrit nr. 372/ prot 4229, datë 15.08.2022 “Për ngritjen e Ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore” janë caktuar drejtuesit dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit të shtatë programeve që administrojnë MBZHR për periudhat dhjetor 2021 - dhjetor 2022 dhe dhjetor 2022 - dhjetor 2023, ku urdhri i dytë ka shfuqizuar të parin.

Planifikimi i fondeve sipas PBA 2023-2025 të hartuar nga MBZHR, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2022), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Planifikimi buxhetor i vitit 2023-2025,

Kërkesat buxhetore të PBA për vitin 2023-2025 të fazës strategjike i janë dërguar MFE me shkresën nr. 1493/26, datë 28.04.2022 “Mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023 – 2025 për MBZHR”, ndërsa për fazën teknike janë dërguar me shkresën nr. 4113/3, datë 31.08.2022 “Mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023 – 2025 për MBZHR, faza teknike”.

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2023-2025, nuk paraqiten të ndryshuara nga periudha afatmesme e mëparshme 2022-2024.

Planifikimi i kërkesave buxhetore afatmesme të PBA 2023-2025 kundrejt buxhetit të vitit 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1.4” Kërkesat buxhetore sipas PBA 2023 – 2025 për dy fazat për MBZHR”

Në mijë lekë

Planifikimi PBA 2023-2025	Buxheti	Faza strategjike për v. 2023	Diferenca Faza I-Buxhet 2022	PBA 2023 – 2025 Faza teknike		
				2023	2024	2025
Artikujt	2022	2023		2023	2024	2025
Paga (600-601)	2,303,989	2,303,989	-	2,303,989	2,303,989	2,303,989
Korrente të Tjera (602-606)	4,503,285	4,470,011	33,274	4,470,011	4,601,011	4,621,011
Kapitale (230-232) Të Brendshme	2,765,844	3,079,272	313,428	3,079,272	2,827,272	2,931,863
Kapitale (230-232) Të Huaja	3,163,250	3,360,260	197,010	2,860,260	1,698,731	2,198,731
Jashtë-buxhetore	-	-	-	-	-	-
Totali	12,736,368	13,213,532	477,164	12,713,532	11,431,003	12,055,594

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi i auditimit

Konstatohet se planifikimi buxhetor për artikujt buxhetor 602-606 “Korrente e të tjera” paraqitet në vlerën 4,470,011 lekë, me një rënie prej 33,274 mijë lekë më pak se një vit më parë dhe ka qëndruar i tillë edhe për fazën teknike të planifikimit. Artikujt 230-232 “Kapitale të brendshme” paraqiten në shumën 3,079,272 mijë lekë ose 313,428 mijë lekë më shumë se një vit më parë, këto paraqiten të pandryshuara gjatë fazës së dytë të planifikimit. Artikujt 230-232 “Kapitale të huaja” paraqiten në shumën 3,360,260 mijë lekë, ose 197,010 mijë lekë më shumë se një vit më parë, të cilat janë pakësuar me 500,000 mijë lekë gjatë fazës së dytë. Përgjatë fazës strategjike konstatohet se shpenzimet për paga dhe sigurime nuk kanë pësuar ndryshime nga një vit më parë.

Tabela nr: 1.5 “Kërkesat shtesë sipas PBA 2023 – 2025 për vitin 2023”

Në mln lekë

Emërtimi i programit/projektet	Kërkesat shtesë faza e parë	Kërkesat shtesë faza e dytë
1- Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes	350	516
Shpenzime korrente	150	200
Investime të Brendshme	200	316
2- Zhvillimi Rural	4,115	3,929
Skema Kombëtare	2,890	2,523
Investime të Huaja (IPARD, EDELE)	1,057	887
Investime të Brendshme (kosto lokale, IPARD, RFCG)	168	519
3- Siguria ushqimore	-	1,548
Shpenzime korrente	-	347
Investime të Brendshme	-	944
Investime të huaja	-	257
3- Mbështetje për Peshkimin	42	281
Shpenzime personeli	31	-
Shpenzime korrente	11	82
Investime të Brendshme	-	76
Investime të huaja	-	123
4- Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	10.5	10
Shpenzime korrente	0.5	-
Investime të brendshme	10	10
5- Këshillimi dhe informacioni bujqësor	68	-
Shpenzime korrente	18	-
Investime të brendshme	50	-
6- Planifikim Menaxhim Administrim	90	-
Shpenzime personeli	10	-
Shpenzime korrente	80	-
TOTALI	6,048.5	6,286

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi i auditimit

Ndryshe nga një vit më parë, MBZHR ka përgatitur kërkesa shtesë për programin “Planifikim, Menaxhim dhe administrim” në shumën 90 mln lekë gjatë fazës së parë të planifikimit buxhetor të PBA 2023-2025.

Transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore vitin 2021, si dhe plani përfundimtar i buxhetit për vitin 2021

Viti 2021

Detajimi i limitit mujor të fondeve të MBZHR është bërë mbështetur në ligjin nr. 137, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar”.

Buxheti përfundimtar i MBZHR është ndryshuar në bazë të 71 shkresave bazuar në kërkesa të MBZHR për rialokime, detajimit të përdorimit të fondit të veçantë dhe në bazë të Akteve normative për buxhetin e vitit 2021.

Për të 7 programet e kësaj ministrie situata në lidhje me ndryshimet në planifikim për vitin 2021, përfshirë këtu buxhetin fillestar, dhe buxhetin me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1.6: “Diferencat midis buxhetit fillestar dhe përfundimtar 2021” Në mijë lekë

Programi	Buxheti Fillestar 2021	Buxheti i Rishikuar 2021	Diferencat
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	327,000	310,550	-16,450
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	2,134,099	1,653,528	-480,571
Mbështetje për Peshkimin	1,047,970	671,820	-376,150
Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes	3,893,232	3,624,917	-268,315
Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	4,986,031	6,503,126	1,517,095
Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	572,000	588,900	16,900
Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	20,000	19,350	-650
Totali	12,980,332	13,372,191	391,859

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi auditimit

Diferencat lidhen me ndryshimet si rezultat i detajimit të Fondit të veçantë prej 7.7 milionë lekë , në zbatimin e Aktit Normativ nr.26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar në një vlerë prej 176 milionë lekë si dhe në zbatimin e Aktit Normativ nr.34, datë 16.12.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar në një vlerë prej rreth 208.15 milionë lekë.

Tabela nr. 1.7: “Rialokimet e programit “Planifikim, Menaxhim, Administrimi për vitin 2021”:

Në mijë lekë

Llogari ekonomike	600	601	602	605	606	231
Plani Fillestar	214,200	35,800	46,280	20,000	720	10,000
Plani Përfundimtar	155,979	26,000	81,030	35,421	2,120	10,000
Fakti 12 mujor	155,956	26,000	72,373	35,413	1,802	9,200
Shkresa e MFE nr. 1381/37 prot. dt. 22.02.2021 (Detajimi i Fondit te Veçante)			-		1,000	-
Shkresa e MFE nr. 6951/1 prot. dt. 22.04.2021 (Transferim fondi për mbulim te telefonisë celulare)			(700)		700	-
Shkresa e MFE nr. 7639/1 prot. dt. 07.05.2021	(35,000)	(5,000)	25,000	15,000	-	-
Shkresa e MFE nr. 11547/1prot. dt. 1.07.2021 (Rialokim Fond i Veçante)			-		(300)	-
Shkresa e MFE nr. 11616/44 prot. dt. 12.07.2021 (AKTI NORMATIV Nr. 26, date 12,07,2021)	(4,800)	(4,300)	-		-	-
Shkresa MFE Nr. 18223/1 prot. date 27,10,2021	(3,000)		3,000		-	-

Shkresa e MFE nr. 21918/24 prot. date 14,12,2021 (AKTI NORMATIV Nr. 34, date 03,12,2021)	(15,421)	(500)	7,450	421	-	-
---	----------	-------	-------	-----	---	---

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi auditimit

Viti 2022

Ndërsa buxheti fillestar vjetor i vitit 2021 paraqitet në vlerën 12 miliardë e 980 milionë lekë dhe buxheti përfundimtar vjetor në vlerën 13 miliardë e 372 milionë lekë, buxheti fillestar vjetor 2022 paraqitet në vlerën 12 miliardë e 736 milion lekë dhe plani përfundimtar vjetor 2022 paraqitet në vlerën 13 miliard e 600 milion lekë ose me një diferencë totale prej 863,785 mijë lekë më shumë. Buxhetet përfundimtare të viteve 2022 -2021 rezultojnë me një rritje në vlerën 227,963 mijë lekë në vitin 2022.

Tabela nr. 1.8: “Buxheti fillestar dhe përfundimtar për vitin 2022”

Në mijë lekë

Emërtimi i programit	Buxheti fillestar 2022	Buxheti përfundimtar 2022	Diferencat
Planifikim Menaxhim Administrimi	332,600	340,224	7,624
Siguria Ushqimore	2,281,197	1,721,365	-559,832
Mbështetje për peshkimin	702,282	272,090	-430,192
Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes	1,681,091	1,854,494	173,403
Zhvillimi Rural	7,085,199	8,770,143	1,684,944
Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	634,000	623,838	-10,162
Menaxhimi Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	20,000	18,000	-2,000
TOTALI	12,736,369	13,600,154	863,785

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi auditimit

Buxheti përfundimtar i MBZHR është ndryshuar në bazë të 109 shkresave dërguar nga MFE, si rezultat i kërkesave të MBZHR për rialokime, Akteve normative për buxhetin e vitit 2022 dhe për përdorimin e fondit të veçantë.

Gjatë auditimit konstatohet se ndërsa buxheti përfundimtar i programeve buxhetore: “Siguria ushqimore”, “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, “Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore” dhe “Mbështetja për peshkimin” janë pakësuar, programet “Zhvillimi rural”, “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes” dhe “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” janë shtuar respektivisht në shumën 1,684,944 mijë, 173,403 mijë lekë dhe 7,624 mijë lekë. Buxheti përfundimtar 2022 është shtuar në shumën 863,785 mijë lekë kundrejt buxhetit fillestar të vitit 2022.

Tabela nr. 1.9 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim plani i ndryshuar dhe shkresat e rialokimeve viti 2022”

Në mijë lekë

Llogari ekonomike	600	601	602	605	606	231
Plani Fillestar	214,200	35,800	45,280	21,600	720	15,000
Plani Përfundimtar	157,695	25,805	115,378	32,850	3,996	4,500
Fakti 12 mujor	157,671	25,789	115,022	32,687	3,795	4,457
Shkresa e MFE nr. 2207/1 prot. dt. 9.02.2022	-	-	-	-	1,100	-
Shkresa e MFE nr. 2191/1 prot. dt. 9.02.2022	-	-	-906	-	906	-
Shkresa e MFE nr. 4085/1 prot. dt. 2.03.2022	-29,000	-3,000	32,000	-	-	-
Shkresa e MFE nr. 4934/153 prot. dt. 14.04.2022 Akti Normativ	-5,355	-895	-9,056	-	-	-
Shkresa e MFE nr. 4934/151 prot. dt. 14.04.2022 Akti Normativ	-	-	-	-	-	-10,000
Shkresa e MFE nr. 7902/1 prot. dt. 09.05.2022	-9,250	-3,000	-	12,250	-	-
Shkresa e MFE nr. 13405/1 prot. dt. 08.08.2022	-	-	-	-	-	-
Shkresa e MFE nr. 14405/34 prot. dt. 11.08.2022 Akti Normativ	-	-	16,060	-	-	-
Shkresa e MFE nr. 18578/1 prot. dt. 12.10.2022	-12,000	-2,800	14,800	-	-	-
Shkresa e MFE nr. 20999/5 prot. dt. 25.11.2022	-900	-300	2,200	-1,000	-	-

Shkresa e MFE nr. 22351/60 prot. dt. 14.12.2022 Akti Normativ	-	-	15,000	-	-	-
Shkresa e MFE nr. 22351/85 prot. dt. 16.12.2022 Akti Normativ	-	-	-	-	-	-500
Shkresa e MFE nr. 106/1 prot. dt. 06.1.2023 VKM Nr. 898, datë 29.12.2022	-	-	-	-	1,270	-

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi auditimit

Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2021

Auditimi i planifikimit të fondeve sipas programeve nën menaxhim të MBZHR për vitin 2021, konkretisht PBA 2021-2023 në fazat strategjike dhe teknike, duke iu referuar periudhës objekt auditimi prej 01.04.2021 deri më 31.12.2022, nuk është kryer përgjatë këtij auditimi duke qenë objekt i periudhës së mëparshme të audituar. MBZHR ka dërguar në MFE raportet e monitorimit për 4 – mujin 2021 me shkresën nr. 4143, datë 28.05.2021 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 4 –muji për vitin 2021”, 8 – mujin 2021 me shkresën nr. 4146/1, datë 30.09.2021 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 8 –muji për vitin 2021” dhe 12 – mujin 2021 me shkresën nr. 1358/7, datë 28.02.2022 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 12 –muji për vitin 2021” brenda afatit të parashikuar konform udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” dhe udhëzimit plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021.

Në vijim është audituar realizimi progresiv buxhetor për vitin 2021, për të cilin në tabelën e mëposhtme është përmbledhur realizimi sipas programeve.

Tabela nr 1.10: “Shpenzimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sipas programeve buxhetore dhe sipas artikujve ekonomikë”

Në mijë lekë

Programet		Shpenzimet e Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të Ujërave					
		(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti 12-mujor Plani i Periudhes Janar- dhjetor/ progresiv	(6) Fakti i Periudhes 12-mujore 2021
Titulli	Emertimi						
01110	Planifikim Menaxhim Administrimi	301,561	395,000	327,000	310,550	310,550	300,743
04220	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1,375,680	2,134,099	2,134,099	1,653,528	1,653,528	1,580,035
04230	Mbështetje për Peshkimin	206,518	997,970	1,047,970	671,820	671,820	601,442
04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes	4,226,761	3,083,232	3,893,232	3,624,917	3,624,917	3,410,509.0
04250	Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë dhe Agroindustrinë	3,491,252	4,304,781	4,986,031	6,503,126	6,503,126	6,387,175
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	426,731	576,000	572,000	588,900	588,900	560,410
05470	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	12,103	27,000	20,000	19,350	19,350	9,020
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë		10,040,606	11,518,082	12,980,332	13,372,191	13,372,191	12,849,334
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit		1,025			0	30,858	30,858
Totali		10,041,631	11,518,082	12,980,332	13,372,191	13,403,049	12,880,192

Burimi: MBZHR, përpunuar nga grupi i auditimit

Buxheti vjetor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural fillestar u rishikua në rritje në shumën 391,859 mijë lekë ose +3% gjatë vitit 2021 nëpërmjet 2 Akteve Normative për rishikimin e buxhetit. Realizimi faktik 2021 ishte 12.8 miliardë lekë, ose 99% e buxhetit fillestar dhe 96% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 97.9% dhe i investimeve 94.8% e planit të rishikuar.

1. Programi 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrimi”

Produktet e parashikuara të programit “Planifikim Menaxhim Administrimi” janë realizuar si vijon:

Produkti: 90501AA Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara Fondi i planifikuar për këtë produkt është realizuar në masën 100%, ndërsa numri i punonjësve në masën 83%, për shkak të mosrealizimit të numrit të punonjësve sipas planit.

Produkti: 90501AB Institucion në mirëfunksion. Është kryer likuidimi sipas dokumentacionit përkatës, përveç blerjes së karburantit (benzinë), pasi nuk u lidh minikontrata sipas Marrëveshjes Kuadër, meqenëse institucioni kishte gjendje.

Produkti: 90501AC Personel i trajnuar. Gjatë vitit 2021 ky produkt është realizuar pjesërisht për shkak të situatës së pandemisë. Gjithashtu, gjatë këtij viti, personeli i MBZHR-së ka ndjekur edhe trajnimet online pranë ASPA-s apo institucioneve të tjera, të cilat nuk janë me pagesë. Nga fondi i këtij kodi janë përdorur pagesa për shpenzime operative për kodin "Institucion në mirëfunksion" për arsye të mungesës së fondeve në fund të vitit.

Produkti: 90501AD Pagesë për kuotat ndërkombëtare të realizuara. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve MBZHR ka detyrime për përmbushjen e 12 kuotave financiare për pjesëmarrjet ku ajo aderon.

Produkti: Kodi 90501AE Institucione të audituara. Referuar planit të auditimeve, për vitin 2021 janë planifikuar për auditim 18 institucione. Në fund të vitit 2021 ky produkt është realizuar në masën 100%.

Produkti: Kodi 18AI901 Blerje pajisje Kompjuterike për Aparatin e MBZHR. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt në vlerën 10,000 mijë lekë, në përfundim të vitit 2021 janë realizuar në vlerën 9,200 mijë lekë. Është lidhur kontrata me operatorin ekonomik dhe produkti është dorëzuar në MBZHR.

2. Programi 04220, “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit 2021, për këtë program, që përfaqëson 12.3 % të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie. Për vitin 2021 kanë qenë në proces aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë dhe fitosanitare, programi i monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalve, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar RUDA, luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes të Bimëve (AKVMB), Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) me 12 Drejtoritë Rajonale të AKU.

Programi buxhetor Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit në total është realizuar në masën 96%.

Produktet e përfituara për vitin 2021 parashikuar në PBA-në e vitit 2021, janë realizuar si më poshtë:

- 90502AA “Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmuara”: Janë vaksinuar gjithsej 530,582 krerë kafshë gjedhë dhe të imta. Në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet veterinarë të Drejtorive Rajonale të AKVMB (blerja e bazës materiale, certifikatat që lëshohen në thertore, baza materiale për sistemin RUDA, blerja e dezinfektantëve, dërgimi i mostrave në ISUV dhe dëmshpërblimi i 788 kafshëve të ngordhura ose të eliminuara).
- 90502AB “Kafshë të shëndetshme dhe të kontrolluara”: Ky zë është realizuar në masën 98%. Përveç kontrolleve të realizuara në fermat e kafshëve të gjalla si dhe kontrolle në farmacitë veterinarë dhe depot farmaceutike, janë realizuar kontrolle dhe në pulari për shkak të shpërthimit të gripit të shpendëve, në total janë realizuar 8,331 kontrolle në terren dhe 246,837 gjurmime në fermat e gjedhit. Janë realizuar dhe shpenzimet paga + sigurime (600+601), shpenzime korrente (602) dhe kapitale të pa trupëzuara (606) nga AKVMB.
- 90502AD “Analiza të kryera në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivalente”: Ky zë është realizuar në masën 99% ku përfshihen (enë materiale laboratorike 2020, akull i thatë, servil kolaudime, standarde dhe materiale reference, kite, reagent, lims, analiza konfirmatore, teste proficence dhe reagent 2021). Janë realizuar 45.487 analiza nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, kampione të dërguara nga veterinerët zyrtar dhe inspektorët e AKU-së. Janë paguar detyrimet e kontratave të lidhura në vitin 2020 dhe të zbatuara në vitin 2021. Janë realizuar

dhe shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (600+601), shpenzimet për mallra dhe shërbime (602), investimet e brendshme dhe kapitale të pa trupëzuara (606).

- 90502AE “Emergenca veterinarë dhe emergjenca për sigurinë ushqimore”: Ky zë është realizuar në masën 94%. Janë kryer kontrole në të gjitha pularitë në territorin e Republikës të Shqipërisë për shkak të shpërthimit të gripit të shpendëve. Janë alokuar fonde për institucionet e vartësisë AKVMB, ISUV dhe AKU për blerjen e kiteve, reagentëve laboratorik.
- 90502AG “Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore”: Ky zë është realizuar në masën 98%. Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) kanë realizuar për vitin 2021 në të gjithë territorin e vendit 103.065 inspektime.
- 90502AH “Kontrolli dhe mbrojtja nga parazitët në fushën e bujqësisë”: Ky zë është realizuar në masën 100%. Me fondin prej 26.4 milion lekë janë luftuar 450 hektar gështenjë kundër parazit grerëz Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae).
- 90502AI “Funksionimi i Autoritetit Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve”: Ky zë është realizuar në masën 93%. AKVMB për vitin 2021 ka realizuar 560 kontrole në të gjithë territorin e vendit.

3. Programi 04240, “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit 2021, për këtë program, që përfaqëson **26.6 përqind** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie. **Nga investimet e brendshme në total 1,688 milion lekë**, rreth **1,015** milion lekë janë përdorur për objektet e ujitjes, mbrojtjes nga përmbytja dhe hidrovore në administrim të DUK-ve, studim e projektim dhe TVSH dhe KL për Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore, ndërsa 673 milion lekë për objektet e ujitjes dhe digat, që i përkasin bashkive.

Me 1,015 milion lekë, janë rehabilituar 31 objekte, nga të cilat 8 objekte i përkasin ujitjes, 17 mbrojtjes nga përmbytja dhe 6 hidrovoreve. Nga këto 31 objekte, 12 janë në vazhdim dhe përfundojnë në vitin 2022.

Përsa i përket objekteve të bashkive, me vlerën 673 milion lekë, nga 31 objekte nuk është arritur të realizoheshin punimet e parashikuara për vitin 2021, në 6 objekte, me vlerë 106 milion lekë, për të cilat duhet të mundësohet financimi gjatë vitit 2022, për përfundimin e tyre. Realizimi financiar për investimin e brendshëm është rreth 89 %.

Investimi i huaj rreth 985 milion lekë, i përket Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të Bankës Botërore, i cili ka mbyllur aktivitetin e tij, sipas afatit të parashikuar në muajin maj të vitit 2021, me përfundimin e rehabilitimit të skemës së fundit ujitëse, me burim ujqor rezervuarin e Janjarit, që përmirëson ujitjen në rreth 4500 ha në bashkinë Konispol. Realizimi financiar për financimin e huaj është rreth 100 %.

4- Programi 04250, “Zhvillimi Rural”

Në programin buxhetor të vitit 2021, “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut” realizimi i shpenzimeve të 12- mujorit të vitit 2021, për këtë program, që përfaqëson rreth **49.7 përqind** të totalit të buxhetit fakt të MBZHR. Nisur nga realizimi faktik i fondeve rreth 98.2% të totalit vjetor të planifikuar, si dhe treguesve të performancës, programi rezulton i plotësuar.

Ecuria e disa produkteve kryesore:

Masat mbështetëse. Ka përfunduar procesi i aplikimit, vlerësimit dhe disbursimit të fondeve për aplikimet. Kanë aplikuar dhe janë kualifikuar në fazën fillestare rreth 12,157 aplikantë nga të cilët kanë përfituar 6,758 persona, me rreth 18% përfituese femra. Numri më i lartë i përfituesve ka qenë masa e blegtorisë, ndjekur nga mbjellja e bimëve aromatiko-mjekësore, zëvendësimi i plasmasit termik për serat, etj.

Skema e subvencionimit me naftë për bujqësinë. Kemi pasur rreth 21,502 aplikime në total nga të cilat kanë përfituar rreth 19,225 aplikues me rreth 4.1 milion litra naftë.

Përfitues nga programi IPARD II. Janë vlerësuar dhe disbursuar fonde për 166 kontrata nga të cilat 43 femra.

Përfitues nga projektet e tjera të huaja. Ecuria ka qenë kënaqshme në disa prej tyre, sipas planit të aktiviteteve, ndërsa në disa të tjerë nuk ka pasur disbursime por ka vijuar puna. Protokollit Italian nuk ka pasur realizim për arsye të mbylljes së njësisë në dhjetor 2020.

5. Programi 04860, “Këshillimi dhe Informacioni bujqësor”.

Realizimi i shpenzimeve të 12- mujorit të vitit 2021, për këtë program përfaqëson rreth **4,4 përqind** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie. Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektorët përkatës.

6. Programi 05470, “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”.

Realizimi i shpenzimeve të 12- mujorit të vitit 2021, për këtë program përfaqëson rreth **0.07 %** të totalit të buxhetit të kësaj ministrie. Për vitin 2021, Krijimi i Sistemit të Informacionit për Tokën (LIS) dhe Integrimi në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) u shtri në qarkun Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër në 5 njësitë administrative/bashkiFrashër, Lekas, Vithkuq, Voskopojë, Qendër. Për vitin 2021 plotësimi i Regjistratit Dixhital të Tokës Bujqësore u realizua në njësitë administrative Shupenzë, Arras, Kala e Dodës, Zall Dardhë. Krijimi i programit WEB-GIS për të dhënat e tokës. Ky objektiv nuk u realizua për shkak të mos kryerjes së procedurës nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

7. Programi 04230, “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit të vitit 2021 për këtë program, përfaqëson **4.7%** të realizimit të kësaj ministrie dhe gjatë periudhës raportuese janë kryer një sërë aktivitete në drejtim të plotësimit të objektivave të programit, ku më kryesoret janë: Menaxhimi i porteve Shëngjin, Vlorë, Sarandë e Durrës dhe të tre ekonomive Zvezdë, Lin e Butrint, realizuar në shumën 97,473 mijë lekë; Janë kryer 2174 kontrole e inspektime në zbatim të Ligjit të Peshkimit Nr.64/2012 dhe të Rregulloreve përkatëse për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve peshkore, realizuar në shumën 12,263 mijë lekë; Ka përfunduar ndërtimi i tregut të tregtimit të peshkut në Shëngjin, ndërsa është në proces zbatimi ndërtimi i tregut të Vlorës realizuar në shumën 46,862 mijë lekë; Sistemi i VMS-së realizuar në shumën 169,144 mijë lekë. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar. Instaluar sistemi dhe kryer pagesa.

Viti 2022

Raportet e monitorimit të buxhetit janë dërguar në MFE sipas afateve të parashikuara ligjore. MBZHR ka dërguar në MFE raportet e monitorimit për 4 – mujorin 2022 me shkresën nr. 1358/8, datë 30.05.2022 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 4 –mujo për vitin 2022”, 8 – mujorin 2022 me shkresën nr. 4939/1, datë 30.09.2021 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 8 – mujo për vitin 2022” dhe 12 – mujorin 2022 me shkresën nr. 1355, datë 28.02.2023 “Monitorimi i realizimit të buxhetit 12 –mujo për vitin 2022”.

Realizimi i buxhetit të MBZHR për vitin 2022 krahasuar me alokimin fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1.11: ‘Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2022’

Në mijë lekë

Programet		Shpenzimet e Ministrisë Bujqësive, Zhvillimit Rural						(7)=(6)-(5) Diferencia
		(1) Fakti Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar	(5) Plani i Periudhes	(6) Fakti i Periudhes	
Nr.	Emërtimi							

				Viti 2022	Viti 2022	Janar-Dhjetor / progresiv	12-mujore 2022	
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	300,743	357,600	332,600	340,224	340,224	339,421	-803
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1,580,035	2,158,892	2,281,197	1,721,365	1,733,867	1,723,460	-10,407
3	Mbështetje për Peshkimin	601,442	865,282	702,282	272,090	272,090	268,409	-3,681
4	Menaxhimi i Infrastruktures se Kullimit dhe Ujitjes	3,410,509	1,481,091	1,681,091	1,854,494	1,854,494	1,821,384	-33,110
5	Zhvillimi Rural duke Mbeshtetur Bujqesine, Blegtorine dhe Agroindustrine	6,387,175	5,255,199	7,085,199	8,770,143	8,770,143	8,787,407	17,264
6	Keshillimi dhe Informaioni Bujqesor	560,410	634,000	634,000	623,838	623,838	616,423	-7,415
7	Menaxhimi i Qendrueshem i Tokes Bujqesore	9,020	20,000	20,000	18,000	18,000	17,681	-319
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë		12,849,334	10,772,064	12,736,369	13,600,154	13,612,656	13,574,185	-38,471
Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë limitit		30,858			17,686	17,079	17,079	
Totali		12,880,192	10,772,064	12,736,369	13,617,840	13,629,735	13,591,264	

Burimi: MBZHR, Përpunuar nga grupi auditimit

Buxheti vjetor 2022 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural fillestar u rishikua në rritje në shumën 863,785 mijë lekë ose +6.7% gjatë vitit 2022 nëpërmjet Akteve Normative për rishikimin e buxhetit. Realizimi faktik 2021 ishte 13.6 miliardë lekë, ose 99% e buxhetit fillestar dhe 99% e buxhetit të rishikuar.

1. Programi 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrimi”

Në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrimi”, që përfaqëson **2.5%** të realizimit të ministrisë përfshihet financimi për pagat e punonjësve të aparatit të MBZHR-së, për trajnimet e nëpunësve, për përmirësimin e strukturës funksionale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese në institucion, në funksion të hartimit dhe monitorimit të politikave. Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti: 90501AA Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara. Ky produkt i parashikuar në vlerën 186,590 mijë lekë, i rishikuar, për periudhën 12-mujore 2022 është realizuar në vlerën 186,550 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për këtë produkt është realizuar në masën 100%, ndërsa numri i punonjësve në masën 76%, për shkak të vakancave.

Produkti: 90501AB Institucion në mirëfunksion i parashikuar në vlerën 107,284 mijë lekë, i rishikuar, për periudhën vjetore është realizuar në vlerën 106,729 mijë lekë.

Produkti: 90501AC Personel i trajnuar, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve së burimeve njerëzore të afta për implementimin e politikave ekzistuese, si dhe të mirëtrajnuara për t’ju përshtatur proceseve integruese ishin planifikuar për t’u realizuar 161 trajnime në drejtim të arritjes së standarteve të sigurisë ushqimore, zhvillimit rural, ujitjes dhe kullimit, peshkimit, etj. Ky tregues është realizuar në masën 86%.

Produkti: 90501AD Pagesë për kuotat ndërkombëtare të realizuara. Në kuadër të marrëveshjeve me disa organizata ndërkombëtare MBZHR ka kryer detyrimet për përmbushjen e 12 kuotave financiare për pjesëmarrjet ku ajo aderon.

Produkti: Kodi 90501AE Institucione të audituara. Referuar planit të auditimeve, për vitin 2022 janë planifikuar për auditim 16 institucione. Për periudhën vjetore ky produkt është realizuar në masën 88%, pasi janë audituar 14 institucione.

Produkti: Kodi 18A1901 Rikonstruksion i sallës së konferencave në katin e tretë në MBZHR. Procedura për rikonstruksionin e sallës së konferencave të katit të tretë është kryer gjatë muajit korrik 2022. Fillimi i punimeve është realizuar gjatë muajit gusht 2022 dhe kanë përfunduar punimet në muajin shtator 2022. Është kryer likuidimi total për operatorin ekonomik dhe mbikëqyrjen e punimeve.

2. Programi 04220, “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”

Realizimi i shpenzimeve vjetore për vitin 2022, për këtë program, përfaqësojnë **12.7%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie.

Për vitin 2022 janë realizuar aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë dhe fitosanitare, programi i monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalve, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar RUDA, luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes të Bimëve (AKVMB), Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) me 12 Drejtoritë Rajonale të AKU.

Produktet e përfituara për vitin 2022 parashikuar në PBA-në e vitit 2022, janë realizuar si më poshtë:

- 90502AA “Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmua”: Ky zë është realizuar në masën 94%. Vaksinimi është një proces në zbatim të strategjisë së miratuar dhe kryhet me vaksinë të blerë që mbulohet nga buxheti i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Janë vaksinuar gjithsej 362,916 krerë gjedhë dhe të imta dhe janë gjurmuar 30,871 krerë gjedhë kundër brucelozës dhe tuberkulozit. Në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet veterinarë të Drejtorive Rajonale të AKVMB (blerja e bazës materiale, certifikatat që lëshohen në thertore, baza materiale për sistemin RUDA, blerja e dezinfektantëve, dërgimi i mostrave në ISUV dhe dëmshpërblimi i 325 kafshëve të ngordhura ose të eliminuara).
- 90502AB “Kafshë të shëndetshme dhe të kontrolluara”: Ky zë është realizuar në masën 99%. Përveç kontrolleve të realizuara në fermat e kafshëve të gjalla si dhe kontrolle në farmacitë veterinarë dhe depot farmaceutike, janë realizuar kontrolle dhe në pulari për shkak të shpërthimit të gripit të shpendëve, në total janë realizuar 33.140 kontrolle në terren. Janë realizuar dhe shpenzimet paga + sigurime (600+601), shpenzime korrente (602) dhe kapitale të pa trupëzuara (606) nga AKVMB.
- 90502AC “Matrikuj të blera për kafshët”: Ky zë është realizuar në masën 97%. Me rishikimin e buxhetit bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë sipas Aktit Normativ, fondi i matrikujve u pakësua me 26 milion lekë. Në bashkëpunim me AKSHI-n po punohet për përmirësimin e sistemit RUDA dhe ku është projektuar që matrikujt të jenë elektronik. Referuar gjendjes së matrikujve që kishin gjendje Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, është vendosur që mos të kryhet blerja e matrikujve të planifikuara për vitin 2022 dhe u përdorën matrikujt që ishin gjendje nëpër qarqe dhe fondi i mbetur u përdor për nevoja të Programit dhe Ministrisë.
- 90502AD “Analiza të kryera në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivalve”: Ky zë është realizuar në masën 99.7%. Janë realizuar 37.266 analiza nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, kampione të dërguara nga veterinerët zyrtar, inspektorët e AKU dhe operatorët e biznesit të cilët eksportojnë drejt vendeve të Open Ballkan. Janë akredituar 430 teste laboratorike si dhe janë realizuar dhe shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (600+601), shpenzimet për mallra dhe shërbime (602), investimet e brendshme dhe transfertat për familjet dhe individët (606).
- 90502AE “Emergjencia veterinarë dhe emergjenca për sigurinë ushqimore”: Ky zë është realizuar në masën 97%. Janë alokuar fonde për përbalimin e situatës të krijuar nga gripi i shpendëve (Influenca Aviare) dhe për dëmshpërblimin e kafshëve të ngordhura/eliminuar, realizuar në kodin 90502AA.
- 90502AG “Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore”: Ky zë është realizuar në masën 99.7%. Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) kanë realizuar për vitin 2022 në të gjithë territorin e vendit 101,479 inspektime. Janë realizuar dhe shpenzimet paga + sigurime (600+601), shpenzime korrente (602) dhe kapitale të pa trupëzuara (606).

- 90502AH “Kontrolli dhe mbrojtja nga parazitët në fushën e bujqësisë”: Ky zë është realizuar në masën 99.9%. Me fondin prej 33 milion lekë janë luftuar 550 hektar gështenjë kundër parazitit grerëz Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae).
- 90502AI “Funksionimi i Autoritetit Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve”: Ky zë është realizuar në masën 96.9%. AKVMB ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Drejtoria e Përgjithshme e AKVMB, për vitin 2022 ka kryer 495 inspektime dhe mbikëqyrje në terren.

3. Programi 04240, “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”

Realizimi i shpenzimeve vjetore për vitin 2022, për këtë program, përfaqësojnë **13.4 %** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie.

Për vitin 2022, financimet në totali fakt 1821 milion lekë (nga të cilat investime 1142 milion lekë dhe shpenzime 679 milion lekë), të realizuara kundrejt planit, në masën 98%. Me investimin 1142 milion lekë, janë financuar 43 objekte (përfshi dhe rialokimet e bëra gjatë muajit dhjetor 2022, për 10 objekte të bashkive në vazhdim), nga të cilat, 28 kanë përfunduar brenda vitit, ndërsa 15, janë objekte në vazhdim dhe përfundojnë në vitin 2023, konkretisht si më poshtë:

Në ujitje

Janë financuar 15 objekte me vlerë 223 milion lekë, nga të cilët 13 kanë përfunduar, ndërsa 2 përfundojnë në vitin 2023. Nëpërmjet këtyre investimeve është mundësuar rehabilitimi i kanaleve kryesor ujitës, për përmirësimin e ujitjes në rreth 10,000 ha, duke garantuar furnizimin me ujë të kanaleve sekondar në administrim të bashkive Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë dhe Vau i Dejës. Është mundësuar funksionimi i qëndrueshëm i kanalit ujitës Peqin-Kavajë, për të garantuar furnizimin me ujë në rreth 110 000 ha, kryesisht në zonat intensive bujqësore, në Shkodër, Lezhë, Rogozhinë, Peqin, Kavajë, Lushnje, Divjakë, Fier etj.

Në mbrojtje nga përmytja

Janë financuar 24 objekte, me vlerë 595 milion lekë, nga të cilët 13 kanë përfunduar, ndërsa 11 përfundojnë në vitin 2023 për të mundësuar rehabilitimin/ndërtimin e rreth 15 km argjinatura për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara.

Në hidrovore

- Janë financuar 4 hidrovore, me vlerë 253 milion lekë, nga të cilët 2 kanë përfunduar, ndërsa 2 përfundojnë në vitin 2023.
- Në 2 hidrovore Balldre në Lezhë dhe Drojë në Kurbin, kanë përfunduar punimet, që kanë të bëjnë me rikonstruksionin e godinave të këtyre hidrovoreve.
- Për rikonstruksionin e plotë të hidrovorit të Karavastas, që kullon rreth 7000 ha në bashkitë Divjakë e Lushnje dhe hidrovorit të Akërnisë në Vlorë, që kullon 4600 ha (ku dhe po ndërtohet Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës), punimet do të përfundojnë gjatë vitit 2023.

Me shpenzimet operative rreth 426 milion lekë është mundësuar:

- Mirëmbajtja/përmirësimi i kullimit në rreth 50 000 ha (si proces ciklik i mirëmbajtjes vjetore), nëpërmjet lëvizjes së rreth 1.8 milion m³ dhera (në rreth 250 km kanale kryesor);
- Përmirësimi i ujitjes në rreth 25 000 ha dhe venia në funksion i veprave të marrjes së ujit për skemat kryesore të ujitjes;
- Janë kryer remontet vjetore të hidrovoreve si dhe mbajtja në funksionim të plotë të 27 hidrovoreve, sidomos gjatë periudhave me reshje shiu.

4- Programi 04250, “Zhvillimi Rural”

Realizimi i shpenzimeve vjetore për vitin 2022, të programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut”, përfaqëson **64.7%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie.

Programi buxhetor “Zhvillimi Rural në mbështetje të Bujqësisë Blegtorisë, Agroindustrisë dhe Marketingut”, për vitin 2022, pas disa ndryshimeve të kryera gjatë kësaj periudhe, kishte në dispozicion gjithsej **8,770 milion lekë**, nga të cilat:

- Shpenzime korrente 5,550 milion lekë, dhe
- Shpenzime kapitale 3,220 milion lekë

ose rreth 64.4% të buxhetit total të Ministrisë.

Ndryshimet thelbësore kanë konsistuar në alokimin e fondeve shtesë në financimin e skemave mbështetëse për bujqësinë. Po ashtu, ndryshime ka pasur dhe përsa i përket rialokimit të fondeve brenda programit, për AZHBR-në dhe projektet e huaja.

Ecuria e disa produkteve kryesore:

Masat mbështetëse. Gjatë vitit 2022, pati një rritje të ndjeshme të fondeve për masat e mbështetjes, që arriti në rreth 5.1 miliardë lekë në total, nga të cilat 3.2 miliard lekë për skemat kombëtare. Fondi prej 1.2 miliard lekë ju shtua skemës për kultivimin e grurit, si dhe mbështetjen me 40 lekë/litër të karburantit në anijet e peshkimit.

Gjatë vitit 2022, kanë aplikuar gjithsej në masat kombëtare rreth 19,708 fermerë, nga të cilët pas procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, u disbursuan 13,925 përfitues, ose rreth 71% e tyre. Aplikimi dhe disbursimi më i madh i fondeve ishte tek masa e blegtorisë me rreth 44% përfitues, ndjekur nga masa për kultivimin e grurit me rreth 28.3% dhe mbështetja për bletarinë me rreth 19.3% të totalit të përfituesve.

Qarqet me numrin më të lartë të përfituesve kanë qenë: Fieri me rreth 18.6%, Korça me 15.4%, Vlora me 13.4%, Gjirokastra me 9%, etj. Po kështu numri më i lartë i aplikimeve në masën e mbështetjes për blegtorinë ka qenë në qarkun e Vlorës, ndjekur nga qarku Korçës dhe Gjirokastrës, ndërkohë që në masën e mbështetjes për grurin, numri më i lartë ka qenë në qarkun e Fierit, Korçës, Elbasanit dhe Tiranës. Në masën e mbështetjes me inpute për kultimin e perimeve në sera, numri më i lartë i përfituesve ka qenë në qarkun e Fierit dhe Beratit.

Skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë. Për vitin 2022, ka pasur rreth 49,654 aplikime në total, nga të cilat janë vlerësuar, shqyrtuar dhe disbursuar rreth 34,731 aplikues, të cilët tërhoqën një sasi prej 8.3 milion litra naftë. Fondi për këtë masë të mbështetjes u shtua gjatë vitit me 500 milion lekë, duke arritur në 1,9 miliard lekë me një realizim prej 100%.

Produkte shqiptare të promovuara. Gjatë vitit 2022, është mbështetur pjesëmarrja e Shqipërisë, bizneseve dhe produkteve bujqësore, në tre panaire ndërkombëtare, Fruit Logistica në Gjermani (kryer dhe pagesa për pjesëmarrje për vitin 2023), Agro Belgrade në Serbi, si dhe Terra Madre Salone del Gusto në Itali. Një pjesë e fondit të planifikuar ka kaluar për pagesën e detyrimit ligjor ndërkombëtar të procesit të arbitrazhit.

Mostra të degustuara të duhanit. Aktivitetet për realizimin e këtij produkti ndiqen nga Agjencia Kombëtare për Duhan Cigaren (AKDC). Gjatë vitit 2022, AKDC ka vijuar punën me realizimin e kontrollit të duhaneve dhe produkteve të tij sipas kërkesave të Komunitetit Europian në mbështetje të qëllimit të OBSH për ruajtjen e shëndetit të konsumatorit, me rreth 328 mostra të degustuara me një realizim 100%. Nga AKDC është kryer dhe blerja e pajisjeve, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës.

Vrojtime statistikore për bujqësinë dhe agroindustrinë të kryera. Gjatë vitit 2022, në bashkëpunim, me INSTAT dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, janë realizuar në masën 100%, sipas afatit, aktivitetet statistikore, si më poshtë:

- Vrojtimi Vjetor Bujqësor (VVB) 2021 (realizuar 100% dhe dorëzuar databaza e pastruar në INSTAT, Maj 2022);
- Vrojtimi i Sipërfaqeve të Mbjella (VSM) 2022 (realizuar 100% dhe dorëzuar databaza e pastruar në INSTAT, Korrik 2022);
- Vrojtimi i 6 mujorit të I-rë, të Subjekteve të Agroindustrisë 2022 (realizuar 100%, Shtator 2022);

- Vrojtimi i 6 mujorit të II-të të Subjekteve të Agroindustrisë 2022 (realizuar 100%, afati i përfundimit, Mars 2023).

Fara dhe fidanë të certifikuara, testuara dhe analizuara. Aktivitetet për realizimin e këtij produkti ndiqen nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF). në zbatim të Ligjit Nr.10416 datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".

Njësi vreshti dhe ullishte të regjistruara. Gjatë vitit 2022, nga QTTB-Fushë Krujë, janë regjistruar rreth 350 njësi vreshti dhe rreth 10,036 njësi ulli. Konkretisht realizimi i fondit ka qenë në masën 97%.

Ruajtja e racave autoktone në buaj dhe bagëti të imta. Ky fond i planifikuar për ruajtjen e racave në zhdukje sipas legjislacionit përkatës, për vitin 2022, nuk u realizua pasi sipas memos së datës 17.11.2022, nuk u miratua nga Sekretari i Përgjithshëm për këtë qëllim, por për kryerjen e një pagese emergjente të një detyrimi gjyqësor ndërkombëtar.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimeve për EOM, TGJM dhe STG. Ky produkt është realizuar nga Komisioni për Skemat e Cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore (KSC), i ngritur me urdhër ministri, në zbatim të Ligjit, Nr. 8/2019 "Për skemat e Cilësisë së produkteve Bujqësore dhe Ushqimore".

Popullim të dhënash për regjistrin e fermës. Ky fond nuk është përdorur në këtë aktivitet pasi u angazhuan direkt ekspertët e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor. Fondi u la i lirë dhe u përdor në pagesën për detyrimin gjyqësor ndërkombëtar.

Përfitues nga programi IPARD II. Gjatë vitit 2022, janë paguar 111 investime të plota/të përfunduara dhe janë kryer 84 pagesa paraprake, me një total disbursimi prej 19.1 mln euro, prej të cilave 14.4 mln euro nga BE dhe 4.7 mln euro nga buxheti shtetit. Në këta përfitues rreth 17 % kanë qenë gra (33 kontrata). AZHBR ka arritur të përthithë fondin e alokuar për vitin 2022, nën IPARD. Po ashtu gjatë 2022, është miratuar programi IPARD III dhe MBZHR është në procesin e akreditimit të masave të reja.

Protokolli Italian: Nuk ka pasur realizim për arsye të mbylljes së njësisë së projektit. Fondet e planifikuara si financim i huaj, në këtë produkt për tre projektet janë raportuar me realizim sipas raportimit të donatorit për komponentin e menaxhuar nga pala italiane. Fondet e përdorura për TVSH dhe Kosto Lokale përkatësisht nga projekti ASSI dhe ARDA, janë shpenzuar për zhdoganim malli në kuadër të projektit, "Intenerare të gjelbërta për blegtorinë shqiptare", me vlerë fature 778,316 lekë dhe 22,500 lekë. Sipas urdhrit nr. 428 dt 26.9.2022, kaluar pagesa për transferimin e fondeve të bashkëfinancimit për rimbursim TVSH në kuadër të projektit, me urdhër nr.458 datë 12.10.2022, ku është kryer pagesa për shpenzimet doganore për paisjet për bateri dhe panele diellore në kuadër të projektit IDELE të cilat janë dërguar në QTTB Korçë. Po ashtu janë akomoduar kërkesa brenda programit buxhetor dhe është paguar vlera për urdhrin e shpenzimit nr.270, datë 13.6.2022. Të gjitha konfirmimet për këto pagesa janë dhënë nga Drejtoria e Jetësimit të Projekteve dhe Statistikave, pa kaluar në EMP.

BERZH: Sipas kontratës janë disbursuar fondet në vlerën e planifikuar në buxhetin e vitit 2022. Gjatë vitit nga ky fond garancie, sipas konfirmimit të Sektorit të Projekteve IPA dhe Donatorëve të Tjerë, nuk ka pasur zhvillim.

Projekti GIZ, "Zhvillimi i Qëndrueshëm në Zonat Rurale në Shqipëri": Gjatë vitit 2022, nga ky projekt janë kryer aktivitetet e planifikuara, si më poshtë:

- Mbështetje në hartimin e strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 – 2027, si dhe planit të veprimit;
- Krijimi i databazës së cmimeve të referencës duke lehtësuar procesin e verifikimit dhe vlerësimit të aplikimeve;
- Mbështetje e sektorit të agroturizmit (trajtime, promovim, studim i thelluar i zhvillimit të sektorit);
- Përmirësimi i produkteve të zinxhirit të vlerës për fruta - perime; bimë medicinale dhe blegtori (të imta), produktet tradicionale, etj. Paketa specifike që përfshijnë ngritje kapacitetesh, certifikime, marketim, promovim, etj;

- Mbështetje e zhvillimit të inovacionit në bujqësi;
- Mbeshtetje për pjesëmarrjen në panairë ndërkombëtare të kompanive me kapacitete eksportuese;
- Zhvillimi i instrumentit CoSolve, për bizneset e vogla bujqësore dhe fermerët e vegjël në mënyrë që të rikuperohen nga efektet e COVID 19;
- Mbështetje për zhvillimin e luftës biologjike (biological pest control).

Projekti Food4Healthy: MBZHR dhe dy QTTB-të Korçë dhe Vlorë janë përfituesit direkt të projektit. Gjatë vitit 2022, referuar planit të zbatimit të projektit janë:

- Kontraktuar 6 ekspertiza për MBZHR-në, nga ekspertiza të jashtme;
- Ka përfunduar ndërtimi për laboratorin në QTTB Korçë, i cili ka synim transformimin e produkteve lokale në mënyra konkurruese dhe koherente për tregjet ndërkombëtare dhe konkretisht perpunimin dhe tharjen e mollëve, kumbullave dhe qershive;
- Ka përfunduar ndërtimi për laboratorin e transformimit të produkteve të peshkut në mënyra konkurruese dhe koherente për tregjet ndërkombëtare, në QTTB Vlorë;
- Në proces blerja e linjave të përpunimit, pas konsultimeve me grupet e fermerëve.

Projekti HELP; Në kuadër të këtij projekti kane përfituar për vitin 2022, fshatrat e Tiranës;

a)74 ferma te vogla dhe biznese te vogla ne formen e pajisjeve/makinerive bujqesore me vlere deri ne 2000 euro. b)100 te rinj dhe te reja me kurse te formimit professional. c) 81 individe trajnime biznesi.

Projekte investimesh të brendshme. Në investimet e brendshme janë përfshirë investimet direkte për institucionet e varësisë, si dhe bashkëfinancimi për projektet e huaja që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural nën këtë program.

Pothuajse për të gjitha projektet e investimeve të brendshme janë kryer procedurat tenderuese, janë lidhur kontratat, ka filluar zbatimi, me disbursim të fondeve 100%. Kështu janë marrë pajisjet:

- elektronike për AZHBR-në dhe Agropikat;
- e laboratorit për ESHFF-në;
- multifunksionale për AKDC-në;
- për kadastrat e QTTB-së Fushë Krujë.

Për “**Sistemin e aplikimit online për skemat IPARD**”, procedurat janë kryer nga AKSHI, është lidhur kontrata dhe ka filluar nga zbatimi. Është disbursuar fondi sipas kontratës.

Procedurat për “**Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare**”, nuk u mbyllën dot gjatë vitit 2022, kështu që fondet e parashikuara në këtë zë, u transferuan.

5. Programi 04860, “Këshillimi dhe Informacioni bujqësor”.

Realizimi i shpenzimeve vjetore për vitin 2022, për këtë program përfaqëson rreth **4,5%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie.

Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Agjencive Rajonale te Ekstensionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektorët përkatës.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti 90506AA: Paketa dhe karta teknologjike të prodhuara nga 5 QTTB-të, që ju vihen në dispozicion fermerëve dhe agrobizneseve dhe aplikohen prej tyre. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, në përfundim të vitit 2022, janë realizuar në masën 96% krahasuar me planin vjetor të rishikuar të shpenzimeve. Për vitin 2022, janë planifikuar dhe janë realizuar 16 teknologji/paketa teknologjike (elementë të përmirësuar).

Produkti 90506AB: Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore funksionale: Shpenzimet për këtë produkt gjatë vitit 2022 janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet për këtë produkt i dedikohen përmbushjes së detyrave funksionale të QTTB-ve që realizohen të ndara në financimin e Projekteve dhe Financimin Institucional.

Produkti 90506AC: Gra të informuara dhe trajnuara nga shërbimi këshillimor publik.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për vitin 2022 kanë realizuar 12 ditë trajnimi të dedikuara për 350 gra fermere, me synim zbutjen e parabarazisë dhe integrimin gjinor.

Produkti 90506AD: Fermerë të asistuar nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor për aplikimet në skemat kombëtare dhe IPARD.

Përgjatë fushatës promovuese dhe periudhës së aplikimit për skemën përkatëse, janë asistuar fermerë 69,354 aplikantë nga 30 mijë të planifikuar. Janë realizuar në masën 100% shpenzimet për këtë produkt.

Produkti 90506AE: Fermerë të kontaktuar dhe ofruar shërbime ekstensionit. Aktivitetet që shërbejnë për realizimin janë: 19 kërkime në nivel ferme që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit, në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; trajnime nga QTTB-të, Universiteti Bujqësor dhe Projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar. Nga 150 ditë trajnimi për specialistët e shërbimit këshillimor të planifikuar, në përfundim të vitit 2022, janë realizuar 178 ditë trajnimi. Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor kanë qenë të angazhuar në informimin e komunitetit të fermerëve dhe agrobizneseve në lidhje me mundësinë e përfitimit nga Skemat Kombëtare të Mbështetjes 2022 si dhe në asistimin dhe zbatimin e Skemës së naftës për bujqësinë në vitin 2022 sikurse edhe zbatimin e skemës së grurit, duke mbështetur dhe ndihmuar drejtpërdrejt rreth 69,354 aplikantë. Janë realizuar në masën 100% shpenzimet për këtë produkt.

Produkti 19AF601: “Projektet e zbatimit për modernizimin e kërimit dhe vlerësimit teknologjik në sektorin e bujqësisë si dhe në sektorin e blegtorisë për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë”. Janë realizuar plotësisht punimet për këtë objekt investimi. Është disbursuar 100% vlera e përcaktuar për vitin 2022.

Produkti M050292: “Serrë e ndërtuar në bazën Eksperimentale të QTTB Lushnjë faza e II-të”. Është realizuar 100% objekti I investimit dhe është disbursuar 100% vlera e prokuruar.

Produkti M050419: “Pajisje laboratorike të blera nga QTTB Fushë Krujë”. Pajisjet laboratorike të planifikuar për t’u blerë nga QTTB Fushë Krujë janë reduktuar me Aktin Normativ të muajit Prill.

Produkti 18AL 603 “Pajisje laboratorike të blera nga QTTB Fushë Krujë”. Është realizuar blerja e pajisjes laboratorike.

Produkti 18AL522: “Serrë e fidanëve me nebulizim në QTTB Vlorë e mbuluar”. Janë realizuar plotësisht punimet për këtë objekt investimi dhe është disbursuar 100% vlera e prokuruar.

Produkti M050720 “Serrë e fidanëve me nebulizim në QTTB Vlorë e Supervizuar”. Është realizuar supervizimi i objektit.

Produkti M051556 “Serrë e fidanëve me nebulizim në QTTB Vlorë e kolauduar”. Është realizuar kolaudimi i objektit.

Produkti M050694: “Rikonstruksion magazinash në QTTB Korçë”. Është realizuar objekti i investimit dhe është disbursuar 100% vlera e prokuruar.

Produkti M050714 “Rikonstruksioni i Magazinës qendër në QTTB Korçë i supervizuar”. Është realizuar supervizimi i objektit.

Produkti M051505 “Rikonstruksioni i Magazinës qendër në QTTB Korçë i kolauduar”. Është realizuar kolaudimi i objektit.

Produkti M050778: “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Tiranë”. Pajisjet kompjuterike të planifikuar për tu blerë nga AREB Tiranë janë reduktuar me Aktin Normativ të muajit prill.

Produkti 18AL405: “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Shkodër”. Është realizuar blerja e 23 pajisjeve kompjuterike dhe është disbursuar vlera në muajin shtator.

Produkti 18AL406: “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Lushnje”. Është realizuar blerja e 17 pajisjeve kompjuterike.

Produkti 18AL404: “Pajisje kompjuterike të blera nga AREB Korçë”. Është realizuar blerja e 17 pajisjeve kompjuterike.

Shërbimi i Ekstensionit

Gjatë vitit 2022, Strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në 4 Agjensitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, kanë zhvilluar aktivitete ekstensionit si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panaiere, tavolina të rrumbullakëta etj. Nga strukturat e Shërbimit Këshillimor morën informacion gjithsej 74,000 fermerë dhe agrobiznese, nga 73,000 fermerë dhe agrobiznese të synuara.

Gjatë vitit 2022, u realizuan 178 ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë ose 3,382 ditë/ekstensionistë të trajnuar nga 150 ditë trajnimi të planifikuara, si dhe 1,423 ditë trajnime me fermerë, me pjesëmarrjen e 9,924 fermerëve të interesuar, kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike etj. Janë realizuar 1,507 demonstrime me pjesëmarrjen e rreth 9,265 fermerëve, 295 ditë fushe me pjesëmarrjen e 2,544 fermerëve, janë shpërndarë për të interesuarit 25,500 copë fletëpalosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, marketingut, etj. Janë realizuar 76 kronika dhe emisione televizive në TV lokale.

6. Programi 05470, “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”.

Realizimi i shpenzimeve vjetore për vitin 2022, për këtë program përfaqëson rreth **0,1%** të totalit të buxhetit të kësaj ministrie.

Në kuadër të programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore” i cili synon të krijojë Sistemin e Informacionit për Tokën (LIS) në rreth 8,000 ha tokë bujqësore, në njësitë administrative Ballaban dhe Sukë të qarkut Gjirokastrë, Rrajcë të qarkut Elbasan dhe Qendër të qarkut Shkodër, për vitin 2022 janë realizuar detyrat e mëposhtme:

1. Inventarizimi dhe klasifikimi i tokave bujqësore sipas përshtatshmërisë së saj.
2. Mbledhja e informacionit për përdorimin/mbulesë tokësore për vitin që është kryer regjistrimi fillestar dhe 2022 si dhe analizimi i dinamikës së ndryshimeve në përdorimin e tokës bazuar te parcela.
3. Studimi agro-ekologjik i zonave në studim.
4. Dixhitalizimi i pjesshëm i regjistrit të tokës bujqësore për njësitë administrative Derjan, Strum, Shëngjin dhe Zall-Herr.
5. Krijimi i programit ËEB-GIS për të dhënat e tokës

Tabela nr. 1.12: “Të dhënat financiare për programin Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore për vitin 2022”

Nr.	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	Plani 2022	Shpenzuar 12 mujori 2022
1	Krijimi Lis/GIS	7,346,000	7,026,967
2	Dixhitalizim RTB	288,000	288,000
Shuma		7,634,000	7,314,967

7. Programi 04230, “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve vjetore për vitin 2022 për këtë program përfaqëson **2%** të realizimit të kësaj ministrie.

Produktet e përfituara gjatë 2022 të parashikuar për PBA-në e vitit 2022, janë realizuar si më poshtë:

Produkti 90503AA: Infrastruktura portuale e mirëmanaxhuar, realizuar në shumën 105,408 mijë lekë kundrejt planit 106,040 mijë lekë. Buxheti për këtë produkt Menaxhimi i porteve është një proces në vazhdimësi për të katër portet e peshkimit: në Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë dhe të tre ekonomive Zvezdë, Lin e Butrint.

Produkti 90503AB: Kontrollat e inspektoratit të peshkimit në subjektet e peshkimit, realizuar në shumën 11,637 mijë lekë kundrejt planit 12,000 mijë lekë. Gjatë vitit 2022 janë kryer 2000 kontrole dhe inspektime të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit si në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturë. Prioritet ka qenë inspektimi në vijën bregdetare për parandalimin e evidentimin e gjuetisë së paligjshme. Gjithashtu janë kryer kontrole e inspektime në det, në ujërat e brendshme, në pikat e tregimit dhe magazinimit të produkteve peshkore, etj.

Produkti 90503AC: Sistemi i vrojtimit-monitorimit e survejimit në anijet e peshkimit, realizuar në shumën 5,593 mijë lekë kundrejt planit 5,600 mijë lekë. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Produkti 90503AD: Raporte të kryera për një monitorim sa më të saktë të aktiviteteve të lidhur me peshkimin, akuakulturën dhe molusqet, realizuar në shumën 4,998 mijë lekë kundrejt planit 5,000 mijë lekë.

Produkti 90503AF: Ripopullim me rasate për pasurim të resurseve peshkore realizuar në shumën 7,369 mijë lekë kundrejt planit 7,400 mijë lekë. Realizuar duke bërë të mundur hedhjen e rasateve të peshkut duke bërë ripopullim me rezervave peshkore në liqenin e Ohrit dhe të Prespës.

Produkti 18AJ601: Ndërtimi i tregut të peshkut Vlorë, realizuar në shumën 37,472 mijë lekë kundrejt planit 37,638 mijë lekë, për të cilën është përfunduar investimi dhe realizuar pagesa.

Produkti 18AJ603: Shtim kapacitete ankoruese Porti i Peshkimit Durrës (Bankine) LOTI I, projekti I parashikuar për 2 vitet 2022-2023, realizuar në shumën 68,495 mijë lekë kundrejt planit 68,496 mijë lekë. Janë realizuar 90% e punimeve për vitin e parë 2022, marrja në dorëzim e projektit do të bëhet në vitin 2023.

Produkti 19AI005: Shtim kapacitetesh në Ekonominë e Rritjes së Rasateve të Krapit Zvezde, Korçe (Furnizim me ujë, Instalim i impjantit të riprodhimit) LOTI I, realizuar në shumën 6,737 mijë lekë, kundrejt planit 7,516 mijë lekë, duke bërë të mundur rritjen e numrit të rasateve të hedhura në liqenin e Prespës.

Produkti 19AI006: Përcaktimin e Zonave Prioritare për zhvillimin e akuakulturës së ujërave të brendshme në Republikën e Shqipërisë, realizuar në shumën 1,312 mijë lekë, kundrejt planit 1,400 mijë lekë. Është paguar 30% e kontratës, pjesa tjetër është shtrirë për vitin 2023, në të cilin është parashikuar edhe dorëzimi i projektit.

Produkti 21AC703: Blerje pajisje për qendrën e midhjes, markatat e peshkut dhe ekonomitë e rasateve, realizuar në shumën 854 mijë lekë, kundrejt planit 1,000 mijë lekë, për të cilën janë marrë në dorëzim pajisjet si: Peshore elektronike, trasbaleta dhe pajisje për moslejimin e insekteve për të vënë në funksionim Merkatën e Vlorës.

Produkti 21AC706: Blerje motora për mjetet lundruese, realizuar në shumën 4,188 mijë lekë, kundrejt planit 4,500 mijë lekë, duke marrë në dorëzim 4 motora për mjetet lundruese.

Produkti 21AC707: Blerje trajlera dhe pajisje teknologjike orientuese për mjetet lundruese, realizuar në shumën 3,070 mijë lekë, kundrejt planit 3,500 mijë lekë, duke marrë në dorëzim 3 trajlera dhe 2 GPS (pajisje teknologjike orientuese) për mjetet lundruese.

Produkti M051020: Studime Projektive, realizuar në shumën 936 mijë lekë, kundrejt planit 1,000 mijë lekë, për Studim Projektimi për hartimin e projektit mbi Mirëmbajtjen e Inkubatorit të rritjeve të rasatave të Koranit në Ekonominë Lin.

Produkti M051212: Blerje pajisje informatike për DSHPA realizuar në shumën 1,151 mijë lekë, kundrejt planit 1,500 mijë lekë, duke marrë në dorëzim 6 kompjutera, 10 printera, 2 UPS dhe 1 fotokopje, për DSHPA.

Produkti M051213: Blerje orendi zyre për DSHPA realizuar në shumën 309 mijë lekë, kundrejt planit 500 mijë lekë.

Produkti M051219: Blerje Automjeteve realizuar në shumën 8,880 mijë lekë, kundrejt planit 9,000 mijë lekë duke marrë në dorëzim 2 automjete për Sektorin e Inspektimit në DPSHA.

Parashikimi dhe realizimi i te ardhurave për vitin 2021

Përveç fondeve buxhetore MBZHR në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë me Ministrin e Financave, nr.1 datë 24.10.2006, “ Për përdorimin e të ardhurave dytësore,“ i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 8 datë 08.05.2007, i përbashkët me Ministrinë e Financave, “Mbi tarifatat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave“.

Parashikimi i të ardhurave për sistemin e MBZHR-së është kryer për çdo program buxhetor në anekset e pasqyrave të Projekt Buxheteve të vitit 2021, me klasifikimet përkatëse sipas burimit të krijimit të tyre. Parashikimi është bërë kryesisht duke u bazuar në eksperiencën e krijimit të tyre nga vitet buxhetore paraardhëse. Konkretisht sipas Shtojcës 1/A “Pasqyra shtesë për buxhetin vjetor” është bërë planifikimi i të ardhurave të veta për secin program të MBZHR në PBA 2022-2024 dhe PBA2023-2025.

Realizimi i tyre kundrejt parashikimit vjetor, klasifikimi i realizimit të tyre, për pjesën që i takojnë institucionit dhe derdhjes së tyre në buxhetin e shtetit, si dhe përdorimi i tyre kundrejt limitit të përcaktuar, paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr. 1.13: “Planifikimi dhe realizimi të ardhurave dytësore 2021”

Në mijë lekë

Programet Buxhetore	Planifikimi (PBA) 2021	Realizimi i te ardhurave 2021			Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit	Përdorimi	
		Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet		Plan limit	Fakt
Të ardhura nga qirate	43,583	35,505	138	35,367	81%	-	-
Të ardhura nga licenca/dhënie lejesh	107,120	53,749	-	53,749	50%	-	-
Të ardhura nga gjoba/urdhër-zhdëmtime	66,822	43,011	-	43,011	64%	-	-
Të ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	9,247	22	7	16	0%	-	-
Të ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	112,374	52,537	26,330	26,207	47%	31,150	23,289
Të tjera	36,865	88,854	4	88,850	241%	-	-
Totali	376,011	273,677	26,478	247,199	73%	31,150	23,289

Burimi: MBZHR

Gjatë auditimit u konstatua se planifikimi i të ardhurave përgjatë PBA është optimist, kundrejt një realizimi të të ardhurave për vitin 2021 me 73% të tij dhe në shumën totale 247,199 mijë lekë.

Tabela nr. 1.14: “Planifikimi dhe realizimi të ardhurave dytësore 2022”

Në mijë lekë

Programet Buxhetore	Planifikimi (PBA) 2022	Realizimi i te ardhurave 2022			Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit	Përdorimi	
		Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet		Gjithsej	Institucioni
Të ardhura nga qirate	46,631	40,646	-	40,646	87%	-	-
Të ardhura nga licenca/dhënie lejesh	77,247	26,749	-	26,749	35%	-	-
Të ardhura nga gjoba/urdhër-zhdëmtime	41,763	56,466	-	56,466	135%	-	-
Të ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	14,300	5,964	-	5,964	42%	-	-
Të ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	85,552	53,390	32,948	20,442	62%	35,377	29,040
Të tjera	71,535	94,488	-	94,488	132%	-	-

Totali	337,128	277,702	32,948	244,755	82%	35,377	29,040
---------------	----------------	----------------	---------------	----------------	------------	---------------	---------------

Burimi: MBZHR

Gjatë auditimit u konstatua se planifikimi i të ardhurave përgjatë PBA 2022-2024 megjithëse paraqitet përsëri optimist kundrejt realizimit, rezulton me një planifikimi të të ardhurave me shumën (38,883) mijë lekë më pak kundrejt një viti më parë. Realizimi të të ardhurave për vitin 2022 paraqitet në shumën totale 244,755 mijë lekë ose 82% e vlerës së planifikuar.

2.2 . Auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës.

Auditimi i këtij drejtimi të programit u bazua në shqyrtimin e dokumentacionit si më poshtë:

- Struktura organike, baza e të dhënave/data baza mbi personelin.
- Baza e të dhënave/Data baza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji Nr.152/2013“*Për Nëpunësin Civil*” i ndryshuar;
- VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”;
- VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” i ndryshuar,
- Urdhri i Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*”;
- Urdhri Nr.162, datë 14.12.2020 “*Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.150, datë 05.11.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”*;
- Urdhri i Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*”;
- Urdhri Nr.39, datë 22.01.2021 i Ministrit “*Për miratimin e strukturës së MBZHR-së*”.
- Urdhri i Kryeministrit Nr.5151, datë 28.10.2015 “*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil*”.
- Rregullore e brendshme, miratuar nga ministri nr.4276 prot., datë 2.6.2021.

Auditimi u fokusua në respektimin e strukturës organike si dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimin e tyre.

a. Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin:

Struktura organike e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) për periudhën objekt audimi (01.04.2021 deri me datë 30.06.2022) ka funksionuar në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020. Me Urdhrin Nr.39, datë 22.01.2021 Ministri ka miratuar strukturën e MBZHR në zbatim të Urdhrit Nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020.

Nga auditimi:

Për vitin 2021, numri total i punonjësve në strukturë është **174** (plani) ndërsa numri faktik/nr. Mesatar i punonjësve rezulton **142** (fakti) deri në Dhjetor 2021. Nga Janari 2022 deri në Qershor 2022 numri faktik/mesatar i punonjësve është **140** (fakti) pasi në datë 01.07.2022 ka hyrë në fuqi struktura e re miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*”.

Me hyrjen në fuqi të Urdhrit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 “*Për disa ndryshime në urdhrin nr.150 të kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”*”, nuk ka ndryshim të numrit total të punonjësve në strukturë, por ka ndryshim vetëm në emërtimin e disa sektorëve.

Me Urdhrin e Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 struktura organike e cila hyn në fuqi në Korrik 2022 bëhet me numër total të punonjësve **180** (plani) ndërsa numri faktik/nr. mesatar i punonjësve është **131** (fakti) deri në **Dhjetor 2022**. Në zbatim të Urdhrit Nr.88, datë 20.05.2022 ka dalë Urdhri Nr.318, datë 04.07.2022 i Ministrit të MBZHR-së “*Për miratimin e strukturës së MBZHR-së*”.

Referuar të dhënave të marra nga MBZHR (*Spektori i burimeve njerëzore*) për vitin 2021 periudha 01.04.2021-31.12.2021, numri mesatar i vendeve të lira/vakante është **32** vetëm për institucionin e MBZHR-së, ndërsa për strukturat e varësisë me punonjës civil numri mesatar i vendeve të lira/vakante paraqitet në Tabelën Nr.1 dhe për punonjësit që janë me Kod Pune paraqitet në Tabelën Nr.2, (*bashkëlidhur këtij akti*).

Për vitin 2022, (periudha *Janar-qershor 2022*) numri mesatar i vendeve të lira/vakante është **34**, vetëm për institucionin e MBZHR-së dhe nga Korriku-Dhjetor 2022 (*pasi në korrik kemi hryjen në fuqi të strukturës së re*) numri mesatar i vendeve të lira/vakante është **49**, ndërsa për strukturat e varësisë me punonjës civil, numri mesatar i vendeve të lira/vakante paraqitet në Tabelën Nr.2.1 dhe për punonjësit që janë me Kod Pune paraqitet në Tabelën Nr.2.2, tek seksioni “Anekse” .

Për periudhën 22.01.2021-04.07.2022, vende të lira/vakante sipas pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil në total janë 31.22 dhe të ndarë sipas kategorisë paraqiten:

Kategoria Staf politik & të tjerë	6.22
Kategoria e nivelit të mesëm drejtues:	3.67
Kategoria e nivelit të ulët drejtues:	4.89
Kategoria e nivelit ekzekutiv:	16.44
Totali	31.22

Në mënyrë analitike paraqiten në Tabelën Nr.2.3 tek seksioni “Anekse”.

Për periudhën 04.07.2022-31.12.2022, vende të lira/vakante sipas pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil në total janë 41.17 dhe të ndarë sipas kategorisë paraqiten:

Kategoria Staf politik & të tjerë	6.92
Kategoria e nivelit të mesëm drejtues:	7.58
Kategoria e nivelit të ulët drejtues:	4.83
Kategoria e nivelit ekzekutiv:	21.83
Totali	41.17

Në mënyrë analitike të dhënat në Tabelën nr.2.4. tek seksioni “Anekse” .

Planifikimi i rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.

Në zbatim të nenit 18, të Ligjit Nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Për vitin **2021**, nga MBZHR, me shkresën nr.10643/1 prot., datë 18.12.2020 prot., është kthyer përgjigje shkresës Nr.6336/1 prot., datë 27.11.2020 të Departamentit të Administratës Publike (DAP) “*Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2021*”, brenda afatit 21.12.2020 përcaktuar në këtë shkresë, përmes së cilës njoftohet se nuk përcillet informacion në lidhje me planifikimin e vendeve vakant për vitin 2021, për shkak të ristrukturimit të MBZHR (aparati), Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar (*Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër*).

Për vitin **2022**, nga MBZHR, me shkresën nr. 168 prot., datë 11.01.2022 “*Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2022 për MBZHR dhe institucionet e varësisë*”, është dërguar në DAP plani i nevojave për rekrutim për vitin 2022.

Plani është dërguar në rrugë elektronike nga Spektori i Burimeve Njerëzore datë 28.12.2021 brenda afatit të parashikuar në shkresën Nr.7096/1 prot., datë 20.12.2021 të DAP-it, ndërsa në rrugë zyrtare është dërguar datë 11.01.2022, në përputhje me VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, pika 4, ku citohet:

“Çdo institucion i administratës shtetërore përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm.”

Referuar këtij plani për vitin 2022, nevojat për rekrutim në shërbimin civil janë për **25** (njëzetepesë) vende, por me ndryshimin e strukturës dhe plani i nevojave për rekrutim ka pësuar ndryshime.

Ndryshimet në planin e nevojave për rekrutim nuk janë dërguar në DAP, pasi VKM Nr.108, datë 26.2.2014, pika 4, parashikon vetëm detyrimin për dërgimin e planit në fund të vitit për vitin e ardhshëm, si dhe pika 7, parashikon detyrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të ministrive, që brenda muajit nëntor, të dërgojë në Departamentin e Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për pranim për të gjithë sistemin përkatës, dhe nuk parashikon detyrimin për dërgimin e ndryshimeve në planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil që mund të ndodhin gjatë vitit, në rast të ndryshimit të strukturës organike, ku mund të ketë shtesa pozicionesh apo pakësime të tyre.

Në respekt të strukturës miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 (*hyrë në fuqi në korrik*), numri total i punonjësve rritet **180** (plani), duke pësuar ndryshime në këtë mënyrë dhe plani i rekrutimeve në shërbimin civil paraqitet në varësi të ndryshimeve strukturore në dy periudha si më poshtë:

-Janar-Korrik 2022 plani i rekrutimeve në shërbimin civil është **25** (njëzetepesë) vende (plani) nga të cilat janë realizuar **11** (njëmbëdhjetë) procedura rekrutimi dhe **5** (pesë) pozicione janë suprimuar si pasojë e ristrukturimit.

-Korrik-Dhjetor 2022 plani i rekrutimeve në shërbimin civil bëhet **46** (dyzetegjashtë) vende nga të cilat realizuar **16** (gjashtëmbëdhjetë) dhe janë në proces rekrutimi nga DAP-i **21**(njëzetënjë) vende.

Titulli i gjetjes	Pozicioni ”drejtor” në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, vend i lirë/vakant.
Situata	Nga MBZHR janë dërguar nevojat për rekrutim në DAP, ku për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm është bërë kërkesë për plotësimin e vendeve të lira/vakante në pozicionin “specialist” për vitin 2022, ndërsa për pozicionin “drejtor” nuk është dërguar në DAP planifikimi për rekrutime. Ky planifikim përfshin vetëm për 2(dy) vende në pozicionin “specialistë”. Me ndryshimet në strukturë të ndodhura gjatë vitit 2022 rezulton se, nga Gushti 2022-31.12.2022, drejtoria funksionon me 3 specialistë, pa drejtor, ku 1 (një) specialist është i komanduar drejtor. <i>Për sa sipër është kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse përfaqësuar nga znj. A. Sh. për propozimin e vendeve të lira/vakante konkretisht për pozicionin “drejtor” në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MBZHR të cilat duhet të ishin miratuar nga ish Sekretari i Përgjithshëm përfaqësuar nga z. O.M. dhe t’i dërgoheshin DAP-it, në përputhje me VKM Nr.108, datë 26.2.2014, pika 4 dhe pika 7.</i> Me observacionin e bërë me shkresën Nr.211/18, datë 15.05.2023, protokolluar në KLSH nr. 1175/7, datë 22.05.2023, nga MBZHR në lidhje me konstatimin e KLSH është dërguar në DAP plani rekrutimeve për vitin 2023, ku është përfshirë dhe pozicioni për vendin e lirë/vakant “drejtor” në DAB.
Kriteri	VKM Nr.108, datë 26.2.2014, pika 4 dhe pika 7.
Ndikimi/Efekti	Funksionimi i Drejtorisë së AB jo me eficiencë dhe efektivitet të plotë.
Shkaku	Mos plotësimi i vendit të lirë/vakant në pozicionin ”drejtor” drejtorie AB.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	1.Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri në bashkëpunim me DAP-in, për plotësimin e vendit vakant/të lirë në pozicionin ”drejtor” drejtorie AB.
Afati zbatimit:	Brenda vitit 2023

Sektori i Burimeve Njerëzore në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, pika 3, 5 dhe 8, Kreu II, bën shpalljet për plotësimin e vendeve të lira/vakante për punonjës në shërbimin civil në sistemin e HRMIS (*Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*) dhe më pas në sistemin on line të rekrutimit, në platformën administrata.al.

Për vitin **2021**, meqenëse nuk ka pasur planifikim të nevojave për rekrutim për shkak të ristrukturimit, janë bërë njoftimet në DAP për shpallje të pozicioneve të lira/vakant në shërbimin civil si më poshtë për:

☞ 4 (katër) raste me shkresën Nr.2870/2 prot., datë 09.09.2021 shpallje vendi të lirë/vakant në pozicionin “drejtor” drejtorie. Me shkresën Nr.5022/1 prot., datë 16.09.2021 DAP-i është përgjigjur se do vijojë me shpalljen e vendeve vakante të kërkuara në faqen zyrtare.

Theksojmë se njoftimet në DAP janë bërë pasi është ezauruar më parë korrespondenca me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) për shtyrje afati për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për 4 (katër) vende të shpallura vakante.

Me shkresën Nr. 2870 prot., datë 09.04.2021 të ish ministrit të MBZHR-së znj. M. E., është njoftuar KMSHC për 4 (katër) raste për shtyrje afati për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, pasi plotësojnë moshën për pension. Nga këta për 2 (dy) raste kërkohet të shtyhet afati deri në 1(një) vit dhe në 2 (dy) raste të tjera deri në 6 muaj.

Pretendimi i ngritur nga MBZHR për shtyrje afati është ekzistenca e nevojës emergjente për realizimin e disa proceseve lidhur me implementimin e Programit IPARD III për periudhën 2021-2027 për Shqipërinë dhe personat në këtë pozicion kanë detyra në proces.

KMSHC në përgjigje me shkresën Nr.461/1 prot., datë 13.04.2021 çmon se kërkesa e paraqitur për shtyrje afati për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nga MBZHR, është e bazuar dhe e arsyeshme dhe duhet të vijojë pa ndërprerje deri në përfundimin e procesit të rekrutimit.

Numri i punonjësve që kanë mbushur moshën për pension në këtë periudhë (2021) është **4** (katër). Nga këta:

-2 (dy) punonjës civil kanë dalë në pension,

-1(një) punonjës (Sh. Z.) ka vazhduar marrëdhëniet e punës deri në datë 04.10.2021, (mosha për pension datë 25.06.2021) pas miratimit të kërkesës nga KMSHC për shtyrjen e afatit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Për vitin 2021, rekrutimet për nëpunës civil dhe procedurat e tyre janë kryer nga DAP-i, ku fitues janë 6 (gjashhtë), për pozicionet e shpallura vakant nga Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Përveç punonjësve në strukturë të miratuar, në referim të urdhërave të Kryeministrit Nr.150, datë 09.11.2020 dhe Nr. 88, datë 20.05.2022, rezulton se janë lidhur kontrata pune me afat 1 vjeçar për:

-student të ekselencës 1(një), me nr.1218 prot., datë 03.02.2021, bazuar në VKM-në nr.586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, kontratë e cila ka përfunduar.

-akte emërimi për 20 (njëzet) punonjës (aparati) të punësuar në zbatim të VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore” e ndryshuar, ku plani është 22 (njëzetedy) vetëm për aparatën MBZHR dhe realizimi është 20 (njëzet), numri mesatar faktik 20.

Titulli i gjetjes	Punonjësit (20) e emëruar në zbatim të VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar, janë pa kontratë pune.
Situata	Për vitin 2021, punonjësit 20 (njëzet) të cilët janë emëruar në zbatim të VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar, nuk janë lidhur kontrata pune megjithëse kjo del qartë dhe nga emërtimi i aktit/VKM (<i>përcaktimin</i>

	<p><i>e punonjësve me kontratë të përkohshme ...</i>), por marrëdhënia e punës është rregulluar nëpërmjet Urdhrit të ministrit për emërimin në detyrë, duke vepruar jo në përputhje me VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar, pika 6. Nga MBZHR janë ndjekur standarde të ndryshme në lidhje me kontraktimin e përkohshëm të punonjësve, pasi për studentët e ekselencës të emëruar në përputhje me VKM-në nr.586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” e ndryshuar.</p> <p>Rekrutimi i punonjësve me shërbim civil është bërë bazuar në strukturën e miratuar me urdhërat respektivë të Kryeministrit dhe VKM-në respektive për “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme, në njësitë e qeverisjes qendrore”, në një kohë që struktura në disa raste nuk është plotësuar, pasi ka vende të lira/vakante, dhe nga ana tjetër kemi kontraktimin e punonjësve sipas VKM-së së sipërcituar (Nr.1151) në pozicionin “specialist” (7) që janë me shërbim civil, e cila tregon planifikim jo të studiuar të nevojave për rekrutimin e punonjësve.</p>
Kriteri	VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Punonjës (njëzet) pa kontratë për vitin 2021.
Shkaku	Mos zbatimi i VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	1.Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, për punonjësit e kontraktuar përkohësisht në zbatim të akteve nënligjore që nxjerr Këshilli i Ministrave (VKM) rast pas rasti për vitin respektiv, të lidhen kontrata pune krahas akteve të emërimit në detyrë.
Afati zbatimit:	<i>Rast pas rasti</i>

Për vitin **2022**, janë bërë njoftimet në DAP për vendet e lira/vakante si më poshtë për:

☞ 1(një) rast me shkresën Nr.4841/2 prot., datë 20.09.2022 për “*përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil*” në pozicionin “drejtor” drejtorie për shkak se ka ndërruar jetë;

☞ 3(tre) raste me shkresën Nr. 5174 prot., datë 11.10.2022 për shpallje vendi të lirë/vakant në pozicionin “specialist” .

☞ 7(shtatë) raste me shkresën Nr.5239 prot., datë 14.10.2022 për shpallje vendi të lirë/vakant në pozicioni: **4** “specialist”, **1** “drejtor” dhe **2** “përgjegjës sektori”.

☞ Për 2 (dy) vende të lira/vakante, që rezultojnë nga plotësimi i moshës për pension për *1 (një) vend në pozicionin “përgjegjës sektori” në Sektorin e Programimit në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të IPARD dhe 1(një) vend në pozicionin “specialist”*), në Drejtorinë e Auditimit në cilësinë e anëtarit të Njësisë për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në MBZHR nuk janë bërë njoftimet në DAP, jo në përputhje me VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 i ndryshuar “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, kreu II, pika 3 dhe 5, ku citohet se:

“Bazuar në planin vjetor të pranimit, njësia përgjegjëse shpall procedurën e konkurrimit për çdo pozicion, duke bërë të njohur edhe planin e zhvillimit të procedurës për secilin pozicion, jo më vonë se një muaj pas miratimit të këtij plani nga organet përgjegjëse....”.

“Për institucionet e administratës shtetërore, shpallja e procedurës së konkurrimit për secilin pozicion publikohet, në faqen zyrtare të DAP-it e portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe qëndron e publikuar, të paktën, deri në përfundimin e procedurës”.

Shënim: Në lidhje me këtë konstatim të KLSH është bërë observacion me shkresën Nr. 211/18, datë 15.05.2023, protokolluar në KLSH nr. 1175/7, datë 22.05.2023 trajtuar më poshtë i cili është marrë në konsideratë duke pasqyruar ndryshimet në këtë raport.

Nga Sektori i Burimeve Njerëzore/MBZHR këto 2 (dy) vende/pozicione, janë deklaruar “vend i lirë/vakant” që me dërgimin e planit të nevojave për rekrutim për vitin 2022, në përputhje me VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, pika 3, por nuk është bërë shpallja për vend të lirë/vakant sipas mënyrës së parashikuar nga ligji cituar më sipër.

MBZHR për këto punonjës, të cilët kanë mbushur moshën për pension i është drejtuar me kërkesë KMSHC-së për “shtyrje afati për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil”, por kërkesa nuk është marrë në konsideratë nga ajo.

Konkretisht:

Me shkresën Nr. 5125 prot., datë 10.10.2022 është kërkuar pranë KMSHC-së për 2 (dy) raste “shtyrje afati për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil”:

-1 (një) rast në pozicionin “përgjegjës sektori”, për shkak se përgjigjet direkt për vazhdimësinë e përhithjes së fondeve nga BE në kuadër të implementimit të programit IPARD III për periudhën 2021-2027;

-1 (një) rast në pozicionin “specialist” dhe në cilësinë e anëtarit të Njësisë për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në MBZHR si dhe pikë kontakti në raportimin periodik pranë ministrisë së drejtësisë për zbatimin e Strategjisë Anti korrupsion.

Në përgjigje, KMSHC me shkresën Nr.683/1 prot., datë 19.10.2022 bën të ditur MBZHR-së dhe DPA-it se:

“...në rastin konkret, institucioni kërkon të shtyhet afati i daljes në pension të nëpunësve në fjalë, kërkesë e cila nuk gjen rregullim ligjor në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi legjislacioni nuk ka parashikuar mundësinë e vazhdimit të marrëdhënies në shërbimin civil pas arritjes së moshës për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë....Komisioneri vlerëson se është Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse në institucionet shtetërore, institucioni që vlerëson emergjencën e rasteve dhe më tej merr masat për plotësimin e këtyre pozicioneve me një nga mënyrat e parashikuara nga ligji....pozicioni i punës duhet të rezultojë i lirë në Regjistrin Qendror të Personelit, në të kundërt DAP, nuk mund të vijojë më tej me procedurat për të plotësuar pozicionin e punës në fjalë. Gjithashtu njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, duhet të dërgojë pranë Komisionerit informacion në lidhje me masat e marra për plotësimin e këtyre pozicioneve. Komisioneri do të vazhdojë të ndjekë ecurinë e këtij rasti, me qëllim që të mos pengohet ecuria normale”.

Në vitin 2022, për këto 2(dy) vende janë bërë shpalljet si vende të lira/vakante pasi kanë dalë në pension me mbarimin e procedurës së punës për të cilën është kërkuar shtyrje afati për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Për vitin 2022, numri i punonjësve që kanë mbushur moshën për pension është **6** (gjashtë).

Rekrutimet dhe procedurat e tyre janë kryer nga DAP-i. për nëpunës civil ku janë 9 (nëntë) fitues, për pozicionet e shpallura vakant në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Nga MBZHR përveç punonjësve të rekrutuar në shërbimin civil përmes DAP-it dhe miratuar në strukturë sipas udhërave respektivë të Kryeministrit, për vitin 2022 janë lidhur dhe kontrata pune me afat 1(njëvjeçar) si më poshtë:

-1(një)kontratë pune Nr.607/2 prot., datë 28.01.2022 bazuar në VKM-në nr.395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike” të ndryshuar e cila ka përfunduar.

-1(një) kontratë pune Nr.2292/2 prot., datë 22.04.2022 bazuar në VKM-së nr.586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” e ndryshuar e cila është në fuqi.

-**25** (njëzetepesë) akte emërimi në zbatim të VKM Nr.35, datë 19.01.2022 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore” e ndryshuar, ku numri i punonjësve për MBZHR (aparati) është **27** (njëzeteshtatë) plani për periudhën Janar-Dhjetor 2022, realizuar 23 (njëzetetre) numri mesatar faktik dhe

31(tridhjetënjë) plani, për periudhën Korrik-Dhjetor 2022, realizuar 26 (njëzetegjashtë) numri mesatar faktik.

Titulli i gjetjes	Punonjësit (25) e kontraktuar në zbatim të VKM Nr. 35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, janë pa kontratë pune.
Situata	<p>1. Për (25) punonjësit të cilët janë emëruar në zbatim të VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, nuk janë lidhur kontrata pune megjithëse kjo del qartë dhe nga emërtimi i aktit/VKM (<i>përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme ...</i>), por marrëdhënia e punës është rregulluar nëpërmjet Urdhrit të ministrit për emërimin në detyrë, duke vepruar jo në përputhje me VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar. Nga MBZHR janë ndjekur standarde të ndryshme në lidhje me kontraktimin e përkohshëm të punonjësve, pasi për studentët e ekselencës të emëruar në përputhje me VKM-së nr.586, datë 30.8.2019 “<i>Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore</i>” e ndryshuar janë lidhur kontrata pune.</p> <p>2. Në 1(një) rast akti i emërimit nuk është bërë në përputhje me VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar. Konkretisht, me Urdhrin Nr.79, datë 21.02.2022, protokolluar Nr. 1140/1, datë 21.02.2022, është emëruar në detyrë në pozicionin “specialist” (<i>kategoria IV-a</i>) z.A.B. me kontratë të përkohshme, për periudhën 01.01.2022 deri më datë 24.02.2022, marrëdhëniet e punës dhe ato financiare i fillojnë me datë 01.01.2022. Megjithëse në aktin e emërimit është përcaktuar se emërohet me “<i>kontratë të përkohshme</i>” në fakt nuk është lidhur asnjë kontratë, veprim ky jo në përputhje me VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, pika 4. Nga ana tjetër VKM-ja nuk sjell efekte prapavepruese për punonjësit me të cilët lidhet kontratë e përkohshme, pasi në pikën 9 është përcaktuar qartë se “<i>Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij</i>”, ndërkohë që VKM ka dalë me datë 19.01.2022 dhe në këto kushte efektet financiare për z. A. B. nuk duhet të fillojnë me datë 01.01.2022 sic është shprehur në aktin e emërimit në detyrë/Urdhri Nr.79, datë 21.02.2022, por pas botimit të VKM-së në fletoren zyrtare (19.01.2022), pasi nuk figuron që të ketë qënë punonjës i kontraktuar në vitin paraardhës në MBZHR në mënyrë që efektet financiare të fillojnë nga 01 Janari 2022.</p> <p>Rekrutimi i punonjësve me shërbim civil është bërë bazuar në strukturën e miratuar me urdhërat respektivë të Kryeministrit dhe VKM-në respektive për “<i>Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme, në njësitë e qeverisjes qendrore</i>”, në një kohë që struktura, në disa raste nuk është plotësuar, pasi ka vende të lira/vakante, dhe nga ana tjetër kemi kontraktimin e punonjësve sipas VKM-së së sipërcituar (Nr.35) në pozicionin “specialist” (7)+(4) që janë me shërbim civil, e cila tregon planifikim jo të studiuar të nevojave për rekrutimin e punonjësve.</p>
Kriteri	VKM Nr. 35, datë 19.01.2022 e ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Punonjës (njëzetepesë) pa kontratë për vitin 2022.
Shkaku	Mos zbatimi i VKM Nr. 35, datë 19.01.2022 e ndryshuar.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	1. Të merren masa nga strukturat drejtuese që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, për punonjësit e kontraktuar përkohësisht në zbatim të akteve nënligjore që nxjerr Këshilli i Ministrave (VKM) rast pas rasti për vitin respektiv, të lidhen kontrata pune krahas akteve të emërimit në detyrë.

	2. Të merren masa nga strukturat drejtuese, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, aktet e emërimit në detyrë të punonjësve të kontraktuar përkohësisht në zbatim të VKM-ve respektive të nxirren në afat, me qëllim që vonesat në nxjerrjen e akteve të mos sjellin pasoja financiare në buxhet nga përfitimi i pagës në kushtet e fuqisë prapavepruese të aktit nënligjor kur një gjë e tillë nuk përfitohet nga nxjerrja me vonesë e aktit administrativ.
Afati zbatimit:	<i>Rast pas rasti</i>

b. Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu II, pika 1, Sektori i Burimeve Njerëzore/MBZHR-së ka krijuar “bazën e të dhënave gjyqësore” për gjyqe fituesit e larguar nga puna e si pjesë përbërëse e Regjistrisë Qendrore të Personelit.

Baza e të dhënave gjyqësore përfshin: informacionin mbi numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, palët ndërgjyqës objektin, dispozitivin e vendimit, aktin e largimit ose lirimit të nëpunësit nga shërbimi civil, fakte dhe rrethana të lidhura, në lidhje me pozicionin e punës, pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë etj.

Nga auditimi:

“Baza e të dhënave gjyqësore” nga kjo njësi është përditësuar rast pas rasti deri në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për gjyqe fituesit.

Për vitin 2021 deri në Qershor 2022, raportimi dhe përditësimi i të dhënave bëhej nga Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore pranë Drejtorisë së mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve”. Me hyrjen në fuqi (Korrik 2022) të strukturës miratuar me Urdhrit të Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”, raportimi dhe përditësimi bëhet nga Sektori i Çështjeve Juridike dhe Administrative, pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme.

Zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pranë çdo institucioni/njësie publike, në zbatim të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu IV, pika 1, krijohet Komisioni i Posaçëm i cili në zbatim të pikës 3, kryen këto detyra;

a-shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqësor fitues.

b- shqyrtimin e rasteve kur Urdhritet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitorë.

c- shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqe fituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

Për vitin 2021, në funksion të zbatimit të Urdhrit të sipërcituar Nr.5151, datë 28.10.2015 nga MBZHR është kryer procedura e rikthimit në punë për 1 gjyqësor fitues, emërimi i të cilit është bërë me datë 18.3.2021.

Për vitin 2022, është kryer procedura e rikthimit në punë për 3 gjyqësor fitues, nga të cilët:

-1(një) punonjës, emëruar në detyrë me aktin Nr. 4883/2, datë 19.08.2022 ku është refuzuar prej tij emërimi dhe me Vendimin Nr.88, datë 07.10.2022 të Komisionit të Posaçëm pranë MBZHR-së, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

-2 (dy) punonjës dhe pse kanë dalë aktet e emërimit dhe janë bërë shpalljet publike në faqen zyrtare të MBZHR-së dhe në njësitë bashkiake përkatëse, nuk i janë përgjigjur njoftimit dhe si

rezultat i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Konkretisht për znj. M. M. ndërprerë marrëdhëniet e punës me shkresën nr. 3619/31, datë 31.10.2022 dhe z. B.A., me shkresën nr.4073, datë 01.08.2022 drejtuar DAP-it.

Për punonjësit e larguar gjyqë fitues nga MBZHR është bërë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për detyrimet që rrjedhin prej tyre. Sektori i Financës dhe i Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar është i angazhuar me ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore, bazuar në Rregulloren e Brendshme Nr.4276 prot., datë 02.06.2021, Kap. III, pika 1, germa “h” dhe pika 2, germa “i” dhe “n”.

Për periudhën objekt auditimi (01.04.2021 deri me 31.12.2022) shpenzimet për likuidimin që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për gjyqë fituesit e larguar nga puna përfshirë dhe tarifën përmbartimore në rastet kur është aplikuar një e tillë, paraqitet në Tabelën Nr.2.5.

Tabela Nr.2.5 Shpenzimet që rrjedhin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore (Në lekë)

Viti	Përshkrimi	Vlera e likuiduar bazuar në vendimet gjyqësore	Vlera e likuiduar për shërbimin përmbartimor	Shpenzime gjyqësore	TOTALI
2021	Pagesë për vendime gjyqësore	5,452,252	22,000	3,300	5,477,552
2022	Pagesë për vendime gjyqësore	12,314,456	744,237	63,000	13,121,693

Burimi: Drejtoria e Buxhetimit dhe menaxhimit financiar/Sektori Financës

Nga të dhënat e tabelës për vitin 2021, nga MBZHR është likuiduar në total vlera **5,477,552** lekë për gjyqë fituesit e larguar nga puna, në të cilën përfshihen shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e kryera për shërbimin përmbartimor. Konstatohet për këtë periudhë se pagesa për shërbimin përmbartimor ka ardhur duke u zvogëluar (22,000 lekë), pra vetëm për 1 (një) rast është kryer ekzekutim i detyruar me përmbartim, pasi vendimet gjyqësore janë ekzekutuar vullnetarisht nga MBZHR.

Për vitin 2022, është likuiduar në total vlera **13,121,693** lekë në të cilën përfshihen shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e kryera për shërbimin përmbartimor.

Për vitin 2022, pagesa për shërbimin përmbartimor ka ardhur duke u rritur (744,237 lekë) krahasuar me vitin paraardhës (22,000 lekë) dhe pse vetëm për 3(tre) raste, pasi vendimet gjyqësore nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga MBZHR, duke sjellë kosto të shtuar në buxhetin e MBZHR.

Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 510, germa “a” dhe 511, germa “a” shprehet në mënyrë eksplicite se:

“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm”.

“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin”.

Në kushte të tilla MBZHR, menjëherë pas njoftimit të formës së prerë të vendimit, i kërkon gjyqë fituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, me qëllim ekzekutimin vullnetar të detyrimit si dhe shmangien e kostove shtesë të tarifave për shërbimin përmbartimor.

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë, Nr.1, datë 04.06.2014 *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”* pika 5:

“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet

sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe **grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar**".

Në respekt të këtij detyrimi ligjor MBZHR me publikimin on line në faqen zyrtare të saj, të grafikut të shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, fillon likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqë fituesin, pasi në zbatim të pikës 2:

"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre".

Për vitin 2021, shpenzimet e kryera për vendimet gjyqësore deri me 31.12.2021 janë në vlerën **31,051,358** lekë për 4 persona.

Për vitin 2022, shpenzimet e kryera për vendimet gjyqësore deri me 31.12.2022 janë në vlerën **38,514,201** lekë likuiduar 5 persona nga të cilët 2 janë likuiduar përfundimisht.

(Tabela Nr.2.6 dhe Nr.2.7 tek seksioni "Aneks").

Nga Sektori i Buxhetit janë kryer kontabilizimet për të gjitha detyrimet që lindin nga gjyqë fituesit e larguar nga puna për vitin 2021-2022.

Përveç Sektorit të Financës dhe Buxhetit, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, bazuar në Rregulloren e Brendshme Nr. 4276 prot., datë 02.06.2021, pika 3, germa "dh", "h" dhe "j" evidenton dhe monitoron ndjekjen e proceseve gjyqësore, verifikon dokumentacionin nga ana juridike për lëshimin e autorizimeve për likuidimin e vendimeve gjyqësore, mban korrespondencën me përmbaruesin lidhur me lëshimin e autorizimeve për likuidimin e vendimeve gjyqësore.

Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore i dërgon Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ecurinë e proceseve gjyqësore duke bashkëpunuar mbi bazën e të dhënave të qarta dhe të sakta.

Për vitin 2021, nuk ka gjurmë bashkëpunimi në rrugë zyrtare (shkresore) mes Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar pasi nuk disponohet data/bazë të dhënash që të jetë dërguar pranë kësaj drejtorie, në përputhje me Rregulloren e Brendshme Nr. 4276 prot., datë 02.06.2021, pika 3.

Për vitin 2022, me shkresën Nr. 377 prot., datë 18.01.2023 është dërguar për njohje në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar statusi i proceseve gjyqësore Kjo mënyrë bashkëpunimi mes këtyre sektorëve, bëhet me qëllim informimin në vazhdimësi të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të gjyqësorit, me qëllim që të merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që mund të sjellin probabilitet për lindjen e një detyrimi. Për këtë qëllim është i domosdoshëm ky bashkëpunim me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit dhe një parashikim të besueshëm mbi vlerën e detyrimeve, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përmbartimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 61, Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 "Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme" kapitull III pika 34, si dhe VKM nr.50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit".

Konkluzion:

Nga auditimi mbi strukturën dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore u konstatua:

☞ për periudhën object auditimi 01.04.2021 deri në 31.12.2023 struktura organike rezulton të jetë e pa plotësuar;

☞ nevojat për rekrutim në pozicionin “drejtor” i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nuk janë dërguar në DAP me planin e rekrutimeve të vitit 2022 duke u përmirësuar pas auditimit kjo situatë dhe dërguar me planin e rekrutimeve për vitin 2023;

☞ për (20) punonjësit e emëruar në vitin 2021 në zbatim të VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar si dhe (25) punonjësit e emëruar për vitin 2022 në zbatim të VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, nuk janë lidhur kontrata pune por vetëm akte të emërimit në detyrë;

☞ për vitin 2022, në 1(një) rast, emërimi në detyrë nuk është bërë në përputhje me VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, pasi marrëdhëniet e punës dhe ato financiare i kanë filluar para hyrjes në fuqi të VKM, duke sjell si pasojë efektet financiare negative në llogaritjen e pagës;

☞ për vitin 2021, nuk ka gjurmë bashkëpunimi në rrugë zyrtare (shkresore) mes Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar pasi nuk disponohet data /bazë të dhënash që të jetë dërguar pranë kësaj drejtorie, në përputhje me Rregulloren e Brendshme Nr. 4276 prot., datë 02.06.2021, pika 3.

Në lidhje me sa më sipër subjekti nuk ka sjellë observacion në fazën e RPA, rrjedhimisht qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

2.3/a Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet, bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë. (Likuidimi i tvsh-së nga MBZHR lidhur me projektet e huaja për zhvillimin rural).

Nga ditari i bankës janë përzgjedhur për tu audituar urdhër shpenzimet e muajit dhjetor 2021, janar 2022, dhjetor 2022, si dhe një përzgjedhje e tyre sipas kriterit të vlerave më të mëdha përgjatë viteve 2021 - 2022. Urdhër shpenzimet pas datës 29 dhjetor janë audituar në lidhje me përputhshmërinë me Udhëzimin e MFE nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ”.

Gjatë auditimit u konstatua se megjithëse urdhër shpenzime të muajit dhjetor, pas datës 29.12.2021 deri më datë 31.12.2021 dhe prej datës 29.12.2022 deri më datë 30.12.2022 të cilat i përkasin ditarëve të bankës për vitet respektive, përfaqësojnë pagesa jo të këtyre viteve, por të vitit pasardhës pasi janë miratuar nga NA elektronikisht në vitin pasardhës.

Udhëzimin e MFE nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ”, Pika 17: “*Pas miratimit në SIFQ nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë brenda pesë ditëve pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si më sipër paraqitet në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) bashkë me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë. Nëpunësi i thesarit kryen kontrollin dokumenter në prani të përfaqësuesit të njësisë dhe bën të vlefshëm përfundimisht transaksionin në librin e kontabilitetit të SIFQ”.*

Konstatim nr. 1:

1. Gjatë auditimit u konstatua se kryesisht urdhër shpenzimet pas datës 29 dhjetor janë proceduar për pagesë nga dega e thesarit në muajin Janar të vitit pasardhës përveç urdhër shpenzimit me nr. 658/ sekuencial 2101258, datë 31.12.2021 me objekt “Punime, rikonstruksion i godinës së QTTB Fushë Krujë dhe ndërtim godine” me vlerë 9,735,907, i cili sipas printimit konstatohet se është firmosur elektronikisht nga NA dhe nga dega e thesarit më datë 31.12.2021. Sipas specifikave të udhëzimit të MFE me nr. 25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021” Pika 19 “*bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, NA të NJQP do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve deri më 29.12.2021, për të vijuar në muajin Janar të vitit 2022... përveç rasteve për të cilat është miratuar afat specifik nga ministri përgjegjës i financave. Struktura e Thesarit në degë kryen*

kontrollat sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda datës 29.12.2021. *Dokumentacioni i paraqitur në thesar pas datës 29.12.2021 do të procesohet për pagesë në muajin janar 2022*”.

2. Nëpunësi Autorizues i Njësisë së Qerverisjes së Përgjithshme ka miratuar në SIFQ urdhër shpenzimin me referencat përkatëse. Nënshkrimi/miratimi i urdhër shpenzimit nga Nëpunësi Autorizues përbën njëkohësisht vërtetimin për shpenzimin e kryer për sistemin e thesarit. Kohëzgjatja e miratimi nga NA dhe nga dega e thesarit është brenda afatit 5 ditor.

Gjatë auditimit u konstatua se nga auditimi i urdhër shpenzimeve pas datës 29.12 të viteve nën auditim, për vitin 2021 nuk është bërë regjistrimi në ditarin e bankës për 11 nga 62, ose 18% urdhër shpenzime sipas radhës së regjistrimit apo numrit sekuencial të gjeneruar nga SIFQ, për vitin 2022 nuk është ruajtur kjo radhë për 15 nga 54 ose 28% urdhër shpenzimeve, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ”, Pika 20 “Me regjistrimin në SIFQ të dokumenteve të mësipërme, bëhet bllokimi i fondeve buxhetore (regjistrohet angazhimi) për shpenzim. Struktura e zbatimit të buxhetit në varësi të Nëpunësit Zbatues vendos mbi dokument numrin elektronik sekuencial të vendosur nga sistemi, i cili duhet respektuar nga njëzia e qeverisjes së përgjithshme në urdhrin për shpenzim/pagesë”.

Gjatë auditimit u konstatua se urdhër shpenzimet e mësipërme nuk ruajnë të njëjtën radhë ekzekutimi, sipas rregullit hyrja e parë dalja e parë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Pika 8: “Pagesat nga fondet publike kryhen në bazë të rregjistrimit kronologjik të urdhërave të shpenzimit të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë, sipas parimit hyrje e parë-dalje e parë”. Konstatohet se me urdhër shpenzimin nr. 1 datë 05.01.2022 dhe nr sekuencial 2200002 është likuiduar paga e personelit të muajit dhjetor 2021, por që i përket ditarit të bankës së vitit 2023, ndërsa me nr sekuencial 2200015 deri më nr. 2200156 i përkasin urdhër shpenzimeve të vitit 2021 nga nr. 660 deri më nr. 713 regjistruar në ditarin e bankës për vitin 2021. Megjithëse në ditarin e bankës urdhër shpenzimet mbajnë datën prej 29 – 31 dhjetor, miratimi i tyre nga NA mban datat prej 31 dhjetor deri më 25 Janar 2022 (për pagesat e vitit 2021). Për vitin 2022 për urdhër shpenzimet e datave prej 27 dhjetor deri më 30.12.2022 konstatohet se miratimi elektronik nga NA është bërë më datat 29 dhjetor deri më 24 Janar 2023 (për pagesat e vitit 2022). Miratimi nga NA i urdhër shpenzimeve të mësipërme në janar të vitit 2023 konfirmon faktin se këto pagesa i përkasin vitit 2023 dhe përbëjnë shpenzime të konstatuara të vitit të mëparshëm. Sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2021 konstatohet se faturat e papaguara të muajit dhjetor 2021 kapin vlerën 412,772,237 lekë, ndërsa faturat e palikuiduara të muajit dhjetor 2022 kapin vlerën 30,264,626 lekë.

Në tabelën e Aneksit nr. 3 janë përmbledhur urdhrat e shpenzimeve të regjistruara në ditarin e bankës prej datës 29.12.2021 deri më 31.12.2021, si dhe në tabelën nr 3/a.1 dhe nr. 3/a. 2 të Aneksit nr. 3 të auditimit, prej datës 29.12.2022 deri më 31.12.2022 të renditura sipas numrit sekuencial të regjistrimit në SIFQ.

Titulli i gjetjes nr. 1	Miratim i shpenzimeve duke mos ruajtur radhën e ditarin të bankës
Situata	<p>1. Gjatë auditimit u konstatua se nga auditimi i urdhër shpenzimeve pas datës 29.12 të viteve nën auditim, për vitin 2021 nuk është bërë regjistrimi në ditarin e bankës për 11 nga 62, ose 18% urdhër shpenzime sipas radhës së regjistrimit apo numrit sekuencial të gjeneruar nga SIFQ, për vitin 2022 nuk është ruajtur kjo radhë për 15 nga 54 ose 28% urdhër shpenzimeve.</p> <p>2. Gjatë auditimit u konstatua se urdhër shpenzimet e mësipërme nuk ruajnë të njëjtën radhë ekzekutimi, sipas rregullit hyrja e parë dalja e parë.</p> <p>3. Gjatë auditimit u konstatua se kryesisht urdhër shpenzimet pas datës 29 dhjetor janë firmosur elektronikisht nga NA dhe proceduar për pagesë nga</p>

	dega e thesarit në muajin Janar të vitit pasardhës përveç urdhër shpenzimit me nr. 658/ sekuencial 2101258, datë 31.12.2021 me objekt “Punime, rikonstruksion i godinës së QTTB Fushë Krujë dhe ndërtim godine” me vlerë 9,735,907, i cili sipas printimit konstatohet se është firmosur elektronikisht nga NA dhe nga dega e thesarit më datë 31.12.2021.
Kriteri	Udhëzimin e MFE nr. 9/1, datë 20.03.2018 “Për procedurat e zbatimit të buxhetit për NJQP që përdorin Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ”, Pika 20; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Pika 8; udhëzimit të MFE me nr. 25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021” Pika 19.
Ndikimi/Efekti	Mospërputhje e ditarit të bankës me regjistrimin në SIFQ
Shkaku	Mungesa e ruajtjes së radhës kronologjike të urdhër shpenzimeve
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	MBZHR të marrë masat që në likuidime/ urdhër shpenzime të ruajë të njëjtën radhë kronologjike me numrin elektronik sekuencial të vendosur nga Sistemi Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në funksion të respektimit dhe reflektimit të saktë të tyre në ditarin e bankës.

Konstatim nr. 2:

Gjatë auditimit përgjatë dy viteve 2021 dhe 2022 konstatohet se investimi dhe mirëmbajtja e sistemeve informatike si më poshtë:

Për vitin 2021: Sistemi i shpërndarjes dhe monitorimit të karburantit dhe mirëmbajtje e sistemit, Sistemi VMS dhe mirëmbajtje e sistemit, mirëmbajtja e sistemit Ruda;

Për vitin 2022: Mirëmbajtja e sistemit VMS dhe mirëmbajtja e sistemit të monitorimit të karburantit;

janë likuiduar nga MBZHR dhe jo nga AKSHI, në kundërshtim me Udhëzimi plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” . Pika 23/b, dhe Udhëzimi plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Pika 28/b: “Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” AKSHI është institucioni i vetëm përgjegjës për kryerjen e procedurave të prokurimit, tenderimit dhe lidhjes së kontratës për të gjitha sistemet e Teknologjisë së Informacionit. Për këtë procedura do të ndiqet është si vijon b. *Për shpenzimet korrente dhe kapitale kontrata lidhet në emër të titullarit të AKSHI-t, me përfitues të mallit dhe /ose shërbimit, AKSHI-in, pasi fondet përkatëse për vitin 2021 për mirëmbajtjen e sistemeve të IT të njëjësive të qeverisjes qendrore si dhe fondet e investimeve për përmirësimin e sistemeve të IT, kushteve të AKSHI-it dhe për Sistemet qeveritare janë të miratuara në buxhetin e AKSHI-it. Këto kontrata depozitohen nga ana e AKSHI-it në degën e thesarit për tu regjistruar në SIFQ”.*

Përgjatë vitit 2022 konstatohet se mirëmbajtja e sistemit VMS me 11 (njëmbëdhjetë) urdhër shpenzime të datës 23.12.2022, janë miratuar elektronikisht nga MBZHR më datë 28.12.2022, dhe janë likuiduar nga dega e thesarit në fillim të muajit janar 2023. Mirëmbajtja e sistemit të monitorimit të shpërndarjes së karburantit megjithë faturimeve sipas muajve të ofrimit të shërbimit, urdhër shpenzimet e regjistruara në ditarin e bankës mbajnë datën 30.12.2022, të cilët elektronikisht janë miratuar nga NA më datat 18.01.2023 dhe 24.01.2023 si dhe janë likuiduar nga thesari më datë 18 dhe 24.01.2023.

Gjatë auditimit të urdhër shpenzimeve u konstatua se MBZHR është në proces gjyqësor në gjykatën e arbitrazhit ndërkombëtar kundër investitorit italian Valeria Italia në lidhje me ndërmarrjen A.-G. *shpk.*, e krijuar në vitin 1992 midis investitorëve italian të V. I. dhe ish NB Gosë, Kavajë. Kjo ndërmarrje ka ushtruar aktivitetin në 582 ha tokë bujqësore, si dhe komplekse blegtorale.

Në zbatim të VKM nr. 62, datë 21.2.1994, Komuna Gosë ia shpërndau këtë sipërfaqe toke bujqësore, familjarëve të ish NB Gosë, (sipërfaqe toke e mbjellë), ndërsa në komplekset blegtorale filluan ndërtimet e kundraligjshme nga këto të fundit. Investitorët italian kanë bërë ankesa të vazhdueshme në institucionet më të larta të Republikës së Shqipërisë, duke kërkuar kompesim financiar me mbi 10 miliard lireta. Kjo çështje deri në fund të periudhës së auditimit vazhdon të mbetet në gjyq ndërkombëtar në të cilën MBZHR përfaqësohet nga Avokatura e Shtetit.

Sipas shkresës nr. 2235/27, datë 7.11.2018 të Avokaturës së shtetit MBZHR është vënë në dijeni të dërgimit të kontratës së nënshkruar nga Avokatura e Shtetit si përfaqësuese e MBZHR me studion “Ö. S.” (si palë e kontraktuar për mbrojtjen e palës shqiptare), për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar me paditës shoqëria “V.” srl, ish ndërmarje e përbashkët e bujqësisë. Ndërmjet studios ligjore “O. S.” LLP dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është nënshkruar **kontrata e përfaqësimit e datës 6.11.2018**, nëpërmjet së cilës O. është angazhuar dhe vijon të mbetet e tillë, për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar **PCA Case No. 2018-49 e iniciuar prej palës kërkuese V. I. S.r.l.**

Sipas njoftimeve nga Avokatura e Shtetit, me propozim të palës mbrojtese, nga avokatët e **O. S. LLP**, është shprehur nevoja dhe njëkohësisht është kërkuar miratimi për fillimin e procedurës së kontraktimit të ekspertit për palën shqiptare, për realizimin e raporteve përkatëse të ekspertimit financiar dhe bujqësor, nga ku pas dakordësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është lidhur një kontratë me firmën e ekspertëve “HKA G. L.”.

Me shkresën Nr. 1122/10 prot., datë 8.4.2022 “Kthim përgjigje” ministria ka shprehur dakordësinë për vijimin e kësaj procedure. Në datën 23.6.2022, midis palëve kontraktore Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit), HKA G. L. dhe O. S.LLP është nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të kontraktuar në kuadër të çështjes së arbitrazhit PCA Case No.2018-49 Valeria Italia S.R.L kundër Republikës së Shqipërisë, në vijim të VKM-së Nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”.

Midis palëve kontraktore MBZHR (përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit), HKA G. L.dhe O.S.LLP është nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimeve të konsulencës, ne vleren **385 mijë paund**.

Në rast se vendimi do të rezultojë i disfavourshëm për palën shqiptare, përveç vlerës së shpenzimeve administrative përkatëse të cilat do të kërkohen të detyrueshme në përfundim të shqyrtimit më tej të çështjes në themel (Merits of the Case), shteti shqiptar rrezikon (në rast të një vendimi përseri të disfavourshëm në themel) një vlerë e cila, nëse do të perlllogaritet për kohën përkatëse mund të arrijë shumë prej rreth **8,000,000 Euro**.

Në datën 23.6.2022, midis palëve kontraktore Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit), HKA G. L. dhe O. S. LLP është nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të kontraktuar në kuadër të çështjes së arbitrazhit PCA Case No.2018-49 V.I. S.R.L kundër Republikës së Shqipërisë, në vijim të VKM-së Nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”.

Me shkresën Nr. 700/34 prot., datë 4.8.2022 “Mbi realizimin e parashikimeve buxhetore për likuidimin e ekspertit të kontraktuar, në kuadër të çështjes së PCA Case No. 2018-49 V.I.Srl kundër Republikës së Shqipërisë” të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, protokolluar me tonën Nr. 1122/14, datë 5.8.2022, na është vendosur në dispozicion kontrata origjinale e nënshkruar me firmën e ekspertëve HKA G. L., për ofrimin e shërbimeve të konsulencës, ne vleren **385 mijë paund**

Përsa i përket shpenzimeve ndër vite të kësaj çështjeje:

Prej vitit 2018 të nisjes së procesit gjyqësor ndërkombëtar deri në fund të periudhës së auditimit, MBZHR ka kryer likuidimin total **prej 1,179,500 euro**, për kontrata të lidhura nga

Avokatura e shtetit në përputhje me VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, si më poshtë:

1. Bazuar totalit të detyrimit në kontratën PCA Case 2018-49 V. SRL e datës 6.11.2018, pika 4.1, është € 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë euro), nga të cilat deri tani janë likuduar €650,000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë euro).

Likuidimet për këtë detyrim kanë filluar që prej vitit 2018 me:

- Urdhër Shpenzimin nr. 596 datë 19.12.2018, për faturën nr. 20440 datë 22.11.2018, me vlerë €200,000 (dyqind mijë euro).
- Likuidimi i rradhës është kryer me Urdhër Shpenzimin nr. 108 datë 10.3.2022, për faturën nr.20839 datë 1.3.2022, me vlerë €250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), duke vijuar kështu deri në janar 2023 me likuidimin e faturës me vlerë €200,000 (dyqind mijë euro).

Detyrimi sipas kontratës mbetet ende €100,000 (njëqind mijë euro).

2. Gjithashtu, janë kryer **shpenzime të tjera** si më poshtë:

- Pagesa e kostove fillestare të arbitrazhit me vlerën €19,500 (nëntmbëdhjetë e pesëqind euro), për vitin 2019 me urdhër shpenzimin nr. 43 datë 5.2.2019,
- Pagesë për mbulimin e shpenzimeve administrative të Gjykatës PCA me vlerë €69,000 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë euro), për vitin 2020 me urdhër shpenzimin nr. 707 datë 22.12.2020, si dhe pagesa për vitin 2021 me vlerën €81,000 (tetëdhjetë e një mijë euro) me Urdhër Shpenzimin nr. 82 datë 4.3.2021.
- Pagesë për mbulimin e kostove administrative për fazën vijuese të procedimit me vlerë €150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë euro), me Urdhër Shpenzimin nr. 547 datë 22.11.2021.

3. **Pagesa e ekspertit** të kontraktuar në kuadër të çështjes PCA CASE 2018-49 V.srl. me Urdhër Shpenzimin nr. 484 datë 20.9.2022 për vlerën €210,000 (dyqind e dhjetë mijë euro).

Konstatim nr. 3:

Gjatë auditimit të urdhër shpenzimeve u konstatua se MBZHR është në proces gjyqësor në gjykatën e arbitrazhit ndërkombëtar kundër investitorit italian V. I. në lidhje me ndërmarrjen A.-G. *shpk.*, e krijuar në vitin 1992 midis investitorëve italian të V. I. dhe ish NB Gosë, Kavajë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MBZHR në lidhje me këtë çështje u konstatua se nga Avokatura e shtetit si përfaqësuese e MBZHR në përputhje me VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës, janë lidhur dy kontrata në kuadër të kësaj çështjeje, me O. S. LLP dërguar nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2235/27, datë 7.11.2018 “Kontrata e përfaqësimit e datës 6.11.2018” me detyrim total €750,000, si dhe me shkresën nr. 1122/14, datë 5.8.2022, “Kontrata e nënshkruar me firmën e ekspertëve HKA G. L.”, për ofrimin e shërbimeve të konsulencës, në vlerën 385,000 paund. Prej vitit 2018 të nisjes së procesit gjyqësor ndërkombëtar deri në fund të periudhës së auditimit, MBZHR ka kryer likuidimin total **prej 1,179,500 euro**, nga të cilat shpenzimet administrative ka kapur vlerën €319,500, shpenzimi kundrejt O. S. ka kapur vlerën €650,000, dhe shpenzimi kundrejt HKA G. L. ka kapur vlerën €210,000.

Ky proces gjyqësor e ka vënë MBZHR në vështirësi financiare për likuidim, pjesërisht prej mosplanifikimit të kërkesave buxhetore konform kontratës së parë të lidhur prej vitit 2018 dhe pjesërisht prej detyrimit të panjohur e të vënë në dijeni nga Avokatura e Shtetit përsa i përket kostove administrative të procesit dhe kontratës së re të lidhur me ekspertin në vitin 2022.

Për likuidimet e detyrimeve të mësipërme përgjatë vitit 2022 u konstatua përdorimi i fondeve të lira nga programet e tjera buxhetore. Kështu konstatohet se:

1. Me urdhër shpenzimin nr. 770, datë 29.12.2022 është bërë likuidim pjesor i faturës nr. 21342, datë 12.09.2022 O. S. në vlerën 88,675 euro ose 10,397,593 lekë me objekt “Pagesë për përfaqësimin ligjor në çështjen e arbitrazhit Valeria srl” duke përdorur fonde buxhetore të

programit 01110 në shumën 7,035,000 lekë, të programit 04220 në shumën 1,675,000 lekë, të programit 04250 në shumën 1,665,000 lekë *bazuar në urdhrin e SP me nr. 539, datë 21.11.2022* “Për ekzekutimin e disa pagesave të pakryera për mungesë fondesh”.

2. Me urdhër shpenzimin nr. 484, datë 20.09.2022 me objekt “Pagesë e ekspertit të kontraktuar për çështjen e arbitrazhit V.srl” me vlerë 28,132,119 lekë është likuiduar konsulenti HKA G. Fondet e përdorura për këtë likuidim i përkasin programeve 04220 në shumën totale 24,700,000 lekë (kode 90502AC dhe 90502AE), programit 04250 në shumën totale 3,398,000 lekë (kodet 90505AF dhe 90505AJ), ndërsa komisioni bankar i likuiduar nga programi 01110 në shumën 34,119 lekë. Likuidimi i këtij urdhër shpenzimi është bazuar në urdhrin e Ministrit nr. 406, datë 15.09.2022 “Për pagesën e ekspertit të kontraktuar në kuadër të çështjes PCA Case 2018-49 V.srl”. Sipas memos bashkëlidhur konstatohet se shpenzimet korrente të programit 01110 nuk kanë qenë të mjaftueshme, si dhe nuk është mundësuar rritja edhe me aktin normativ. Nga planifikimi buxhetor për vitin 2022-2024 në fazën e dytë është kërkuar rialokim në zërin shpenzime korrente të programit 01110 në shumën 20 milion lekë, prej programeve të tjera në funksion të likuidimit të detyrimeve gjyqësore.

3. Me urdhër shpenzimin nr. 658, datë 23.11.2022 është likuiduar shërbimi i avokatisë O. S. për shumën 11,721,710 lekë, përdorur nga programet 05470(kod 90507AA) në shumën 10,366,000 lekë, nga programi 04250 (kod 90505AM dhe 90505AK) në shumën totale 1,344,000 lekë, programi 01110 për komisionin bankar në shumën 11,710 lekë, bazuar në urdhrin e SP me nr. 539, datë 21.11.2022 “Për ekzekutimin e disa pagesave të pakryera për mungesë fondesh”.

Megjithëse likuidimi i detyrimeve të mësipërme ka kërkuar respektim të afateve të caktuar nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë mosrespektim të dispozitave ligjore në lidhje me disiplinën buxhetore, si: Ligji 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 44 “Rishpërndarja e fondeve buxhetore” “Të drejtat dhe limitet për rishpërndarjen e fondeve të shpërndara dhe të detajuara më parë, kur buxheti miratohet në nivel programi nga Kuvendi, sipas nenit 30 të këtij ligji janë si më poshtë: Për njësitë e qeverisjes qendrore: a) *rishpërndarjet e fondeve ndërmjet programeve, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes qendrore dhe për njësi të ndryshme të qeverisjes qendrore, miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe nuk tejkalojnë 10 për qind të totalit të programit të miratuar*”; dhe Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Pika 72. Nëpunësi autorizues gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesave mbështetet nga nëpunësi zbatues. Nëpunësi zbatues kontrollon nëse kërkesa për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh është në përputhje me buxhetin e miratuar, përmbledh kërkesat e drejtuesve të programeve dhe i paraqet tek nëpunësi autorizues i cili:

a) *Miratoni rishpërndarjet e fondeve brenda të njëjtë program, kapitull dhe artikull të shpenzimeve korrente, midis njësive të ndryshme shpenzuese në vartësi të njësive qendrore që mbulon. Fondet bëhen të vlefshëm për zbatim vetëm pasi rregjistrohen në SIFQ nga struktura përgjegjëse për buxhetin;*

Pika 73. Mbështetur në kërkesën për rishpërndarje fondesh dhe analizën e paraqitur tek Nëpunësi i Parë Autorizues:

a) *Rishpërndarjet e fondeve nga një program në tjetrin, brenda të njëjtës njësi të qeverisjes qendrore, apo midis programeve të njësive të ndryshme të qeverisjes qendrore, bëhen vetëm me miratim të Këshillit të Ministrave dhe nuk tejkalojnë 10% të shumës totale të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve totale kapitale të programit të miratuar. Transferimet, në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, kryhen në përputhje me procedurat për rishpërndarjen e fondeve.*

Nëpunësi i Parë Autorizues, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë përgjegjëse për Financat, njofton zyrtarisht njësinë qendrore për miratimin e kërkesës si dhe strukturën përgjegjëse të thesarit në degë, e cila nuk është konstatuar në urdhër shpenzimin përkatës.

Titulli i gjetjes nr. 2	Procesi ndërkombëtar i arbitrazhit ka sjellë vështirësi financiare, si pasojë e mungesën në planifikim
Situata	<p>Gjatë auditimit të urdhër shpenzimeve u konstatua se MBZHR është në proces gjyqësor në gjykatën e arbitrazhit ndërkombëtar kundër investitorit italian V. I. në lidhje me ndërmarrjen A.-G.shpk., e krijuar në vitin 1992 midis investitorëve italian të Valeria Italia dhe ish NB Gosë, Kavajë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MBZHR në lidhje me këtë çështje u konstatua se nga Avokatura e shtetit si përfaqësuese e MBZHR në përputhje me VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës, ka lidhur dy kontrata, me O. S. LLP dërguar nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2235/27, datë 7.11.2018 “Kontrata e përfaqësimit e datës 6.11.2018” me detyrim total 750,000 euro, si dhe me HKA G. L. për ofrimin e shërbimeve të konsulencës “Kontrata e nënshkruar me firmën e ekspertëve HKA G. L.”, dërguar me shkresën nr. 1122/14, datë 5.8.2022, në vlerën 385,000 paund.</p> <p>Prej vitit 2018 të nisjes së procesit gjyqësor ndërkombëtar deri në fund të periudhës së auditimit, MBZHR ka kryer likuidimin total prej 1,179,500 euro, nga të cilat shpenzimet administrative në vlerën €319,500, shpenzimi kundrejt O. S. në vlerën €650,000 , dhe shpenzimi kundrejt HKA G.L. në vlerën €210,000.</p> <p>Ky proces gjyqësor e ka vënë MBZHR në vështirësi financiare për likuidim, pjesërisht prej mosplanifikimit të kërkesave buxhetore konform kontratës së parë të lidhur prej vitit 2018 dhe pjesërisht prej detyrimit të panjohur e të vënë në dijeni nga Avokatura e Shtetit përsa i përket kostove administrative të procesit dhe kontratës së re të lidhur me ekspertin në vitin 2022.</p> <p>Për likuidimet e detyrimeve të mësipërme përgjatë vitit 2022 u konstatua përdorimi i fondeve të lira nga programet e tjera buxhetore. Kështu konstatohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Me urdhër shpenzimin nr. 770, datë 29.12.2022 është bërë likuidim pjesor i faturës nr. 21342, datë 12.09.2022 O. S. në vlerën 88,675 euro ose 10,397,593 lekë me objekt “Pagesë për përfaqësimin ligjor në çështjen e arbitrazhit V. srl” duke përdorur fonde buxhetore të programit “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” në shumën 1,675,000 lekë, të programit “Zhvillimi Rural” në shumën 1,665,000 lekë bazuar në urdhrin e SP me nr. 539, datë 21.11.2022 “Për ekzekutimin e disa pagesave të pakryera për mungesë fondesh”. 2. Me urdhër shpenzimin nr. 484, datë 20.09.2022 me objekt “Pagesë e ekspertit të kontraktuar për çështjen e arbitrazhit V. srl” me vlerë 28,132,119 lekë është likuiduar konsulenti HKA G. Fondet e përdorura për këtë likuidim i përkasin programeve “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” në shumën totale 24,700,000 lekë (kode 90502AC dhe 90502AE), programit “Zhvillimi Rural” në shumën totale 3,398,000 lekë (kodet 90505AF dhe 90505AJ). Likuidimi i këtij urdhër shpenzimi është bazuar në urdhrin e Ministrit nr. 406, datë 15.09.2022 “Për pagesën e ekspertit të kontraktuar në kuadër të çështjes PCA Case 2018-49 V. srl”. Sipas memos bashkëlidhur konstatohet se shpenzimet korrente të programit “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” nuk kanë qenë të mjaftueshme, si dhe nuk është mundur rritja edhe me aktin normativ. Nga planifikimi buxhetor për vitin 2022-2024 në fazën e

	<p>dytë është kërkuar rialokim në zërin shpenzime korrente të programit “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në shumën 20 milion lekë, prej programeve të tjera në funksion të likuidimit të detyrimeve gjyqësore.</p> <p>3. Me urdhër shpenzimin nr. 658, datë 23.11.2022 është likuiduar shërbimi i avokatisë O. S. për shumën 11,721,710 lekë, përdorur nga programet “Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore” (kod 90507AA) në shumën 10,366,000 lekë, nga programi “Zhvillimi Rural” (kod 90505AM dhe 90505AK) në shumën totale 1,344,000 lekë, bazuar në urdhrin e SP me nr. 539, datë 21.11.2022 “Për ekzekutimin e disa pagesave të pakryera për mungesë fondesh”.</p> <p>Megjithëse likuidimi i detyrimeve të mësipërme ka kërkuar respektim të afateve të caktuar nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë mosrespektim të dispozitave ligjore në lidhje me disiplinën buxhetore duke lejuar përdorim të fondeve të lira të programeve të tjera për një produkt të programit, “Planifikim, menaxhim, administrim”. Përdorimi i fondeve të lira të programeve të tjera në funksion të realizimit të shpenzimit korrent për programin “Planifikim, menaxhim, administrim” megjithëse praktikisht nuk është bërë me rialokim, pasi janë përdorur në programet respektive, ai faktikisht përfaqëson një rialokim, pasi përfaqëson përdorim të fondeve të një programi për një program tjetër, duke çenuar “veprimtarinë e programeve buxhetore”, e cila sipas dispozitës bazë ligjore, përfaqëson tërësinë e veprimtarive, që kryhen në kuadër të një programi, për realizimin e një produkti. Realizimi i mësipërm i fondeve ka çenuar produktet përkatëse të secilit program dhe përdorimi i tyre për produkte të tjera të pa miratuara ka lejuar shpenzime të cilat duhet të kryhen vetëm me miratim nga VKM.</p>
Kriteri	Ligji 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 44; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Pika 73.
Ndikimi/Efekt	Përdorim i fondeve jashtë klasifikimit të miratuar buxhetor.
Shkaku	Planifikim jo i plotë në lidhje me procesin e arbitrazhit.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR të marrë masa në planifikimin e duhur buxhetor në lidhje me procesin e arbitrazhit, si dhe të mos përdorë fonde të lira për realizimin e produkteve jashtë programit pa miratimin e duhur ligjor.

Projektet me financim të huaj në lidhje me likuidimin e TVSH

Gjatë auditimit u konstatua se për 9 prej projekteve me financim të huaj që MBZHR administron planifikohet dhe likuidohet tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH). Për vitin 2021 dhe 2022 është bërë përmbledhja në Tabela nr. 3/a.3 të Aneksit të auditimit, të fondeve të planifikuara dhe realizuara në lidhje me TVSH.

Gjatë auditimit u konstatua se fondet e planifikuara për tvsh e këtyre projekteve për vitin 2021 kapin vlerën 212,445,730 lekë dhe janë realizuar në vlerën 208,891,432 lekë, ose 3,554,298 më pak. Për vitin 2022 planifikimi për tvsh e projekteve me financim të huaj kap vlerën 30,026,600 lekë dhe është realizuar në shumën 26,208,848 lekë, ose 3,817,752 lekë më pak.

Për sa më sipër nuk u paraqitën observacione nga subjekti i audituar në fazën e Raportit Përfundimtar, rrjedhimisht qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me atë në projekt raportin e auditimit.

2.3/b. Në zbatim të pikës II/3.b “Auditimi mbi inventarizimin, administrimin e pronës shtetërore të tokës bujqësore, dhënia me qira dhe monitorimi i kontratave” të programit të auditimit Nr. 1175/1 datë 11.01.2023”, auditimi u fokusua në:

- Procedurat e dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, kontratat e lidhura për vitin 2021-2022;
- Monitorimin e kontratave (në verifikimin e kryerjes së investimeve të munguara si dhe të ardhurave të pa arkëtuara të qirave për tokat bujqësore).

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji Nr. 8318, dt.01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar;
- VKM Nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, e ndryshuar;
- VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” (ndryshuar me VKM nr. 487, datë 17.6.2020);
- VKM nr. 45/ 2014;
- VKM nr. 995/2015;
- VKM nr.142/2016, si dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë.

I. Administrimi i pronës shtetërore të tokës bujqësore, dhënia me qira dhe monitorimi i kontratave.

Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.150, datë 09.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” i ndryshuar me Urdhrin nr.162 datë 14.12.2020 të Kryeministrit “Për ndryshime në Urdhrin nr. 150, datë 19.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, është ngritur nga MBZHR struktura me Urdhrin nr.39 datë 22.01.2021, me nr. 835/1 prot, datë 22.01.2021 “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” gjithashtu bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.88, datë 20.05.2022 është ngritur struktura në MBZHR me shkresën nr. 1830/264, datë 04.07.2022 në të cilën rezulton se Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve në MBZHR është struktura përgjegjëse e qiradhënësit në ministri e ngarkuar për të kryer administrimin, monitorimin, zbatimin e kontratave të qirasë. Kjo drejtori është e përbërë nga 2 sektorë:

Sektori i Prokurimeve.

Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave.

Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave është struktura përgjegjëse e qiradhënësit në ministri e ngarkuar për të kryer administrimin, monitorimin, zbatimin e kontratave të qirasë.

Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave përbëhet nga: Zj. M.K., Përgjegjëse e sektorit, Z. E.Q., Specialist dhe Z. A. Z., Specialist.

Detyrat e këtij sektori janë:

- *Monitoron realizimin dhe zbatimin e kontratave të qirasë së tokës bujqësore të cilat janë lidhur nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Kontratave e Koncesioneve në përputhje me parashikimet e kontratës, Planit të Biznesit dhe legjislacionit në fuqi;*
- *Shqyrton dhe trajton brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, kërkesat e paraqitura për të marrë me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit dhe në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;*
- *Siguron realizimin e procedurës së konkurrimit në rastet e dhënies me koncension/partneritet publik privat/tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira;*

- Siguron zbatimin në kohë dhe në mënyrë profesionale të të gjitha procedurave ligjore për konkurimet publike sipas legjislacionit në fuqi;
- Kryen analizën financiare të plan bizneseve sipas legjislacionit në fuqi, për të vlerësuar impaktin e investimit të propozuar në fushën e bujqësisë dhe/ose blegtorisë dhe agroturizëm;
- Ndjek korespondencat dhe trajton kërkesat që kanë lidhje me privatizimin e objekteve të ish ndërmarrjeve bujqësore.

Kjo strukturë nuk ka funksionuar asnjëherë me staf të plotë me burime njerëzore për shkak të mos rekrutimit të punonjësve nga ana e DAP si dhe punonjësit e paket e këtij sektori, përtej kryerjes së detyrave funksionale, janë përfshirë rast pas rasti nga titullari i institucionit MBZHR (Ministri), duke marrë pjesë edhe në:

- Grupet e vlerësimit në terren, të tokës bujqësore që jepet me qira, me detyrë, verifikimin e gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës bujqësore, verifikimin e gjendjes së infrastrukturës ujëtare dhe kulluese të saj, distancën nga tregjet, nivelin e industrisë agro përpunuese, si dhe shkallën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës;
- Grupet e përlllogaritjes së vlerës së çmimit të qirasë vjetore për tokën që jepet me qira, me detyrë, përcaktimin e shkallës së bonitetit të tokës me qëllim përcaktimin e qirasë fillestare minimale, mbi vlerën e të cilës shtohen (në %) dhe komponentë të tjerë.

Kështu, vendosja në grupe të ndryshme të punonjësve të sektorit, për propozimin, miratimin, monitorimin, në të njëjtën kohë, nuk është në përputhshmëri, sipas kërkesave që dikton Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Konstatim nr. 1

Në auditimin e mëparshëm të KLSH sipas programit të Auditimit nr.528/1 prot datë 14.05.2021 i ndryshuar me shkresën nr.528/2 prot datë 25.05.2021, KLSH ka lënë si rekomandim që MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. Ky rekomandim jo vetëm që nuk është realizuar por konstatohet se ky sektor bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.88, datë 20.05.2022 ka ngritur strukturën në MBZHR me shkresën nr. 1830/264, datë 04.07.2022 në të cilën rezulton se Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve, Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave në MBZHR është zvogëluar në numër (një përgjegjës dhe 2 specialistë), duke ndikuar në mos përmirësimin e performancës së punës të këtij sektori me gjithë problematikat e konstatuara ndër vite në monitorimin e tokave bujqësore.

Në administrim të MBZHR, fondi i tokës bujqësore për qiradhënie është 19 033.⁹⁵ ha, kaluar me aktet nënligjore si më poshtë:

- VKM nr.45, datë 29.01.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 18,076 Ha.
- VKM nr.995, datë 9.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim Komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 4.4.2012, nr.417, datë 8.6.2011 dhe nr.534, datë 1.5.2008” ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 926,55 Ha.
- VKM nr.142, datë 24.2.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi të shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër” ka

kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 31,4 Ha, pasuria nr.2/17, Zona Kadastrale 3811.

Vendimet e Këshillit të Ministrave shoqërohen me listën e ngastrave të tokës bujqësore dhe të dhënat teknike të pozicionimit të tyre, me përjashtim të VKM nr. 45, datë 29.01.2014.

MBZHR ka në fuqi gjithsej 51 kontrata të lidhura për dhënien e tokës me qira të 2518.9212 ha tokë bujqësore dhe 617.68 ha në administrim të AIDA-s, për zhvillimin e investimeve strategjike të programuara, nga të cilat 40 kontrata të lidhura në periudhën 2013-2019 sipas VKM nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar, dhe 12 kontrata për periudhën 2019-2021, me VKM-së nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

Gjithsej 3.136 ha e 6 012 m² ose 17 % e tokës në administrim të MBZHR. Aktualisht sipërfaqe të lirë e disponueshme në përgjegjësi dhe administrim të MBZHR, për t’u dhënë me qira është 15 897 ha e 3 488 m², ose 83% e sipërfaqes gjithsej. Nga kjo sipërfaqe janë dhënë me qira nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2013-2021 sipërfaqja prej 2519 ha e 7366 m². Për periudhën 2021-2022 është dhënë me qira sipërfaqja prej 107.6105 ha. Sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për t’u dhënë me qira është 15,896 ha e 5, 334 m², duke konstatuar se gjendja juridike është e pa regjistruar pranë AKSH, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta. Për vitin 2021, lidhur me fondin e tokës bujqësore, disponibël shtetërore, objekt i VKM nr. 45, datë 29.01.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, Sektori i Administrimit të Tokës, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar informacion mbi statusin aktua/juridik të këtyre ngastrave/toke bujqësore në administrim të MBZHR nga Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në 12 qarqet.

MBZHR, për periudhën 2013 -2022 ka lidhur 54 kontrata qiradhënie toke bujqësore, nga të cilat 45 kontrata janë aktive dhe vlerësohen sipas parashikimeve kontraktuale, 3 (tre) kontrata janë zgjidhur, 3 (tre) kontrata janë në proces gjyqësor, për 1 (një) kontratë është kërkuar zgjidhja vullnetare nga subjekti dhe për 2 (dy) kontrata ka përfunduar procesi gjyqësor.

Kontratat e zgjidhura janë konkretisht: N. Ll., Person Fizik, Kontrata Nr. 1635 Prot., Nr. 582 Rep., Nr. 354 Kol., datë 28.2.2017, (Njoftuar me shkresën Nr. 9632/4 prot., datë 19.12.2019); N. Ll., Person Fizik, Kontrata Nr. 3507 Prot., Nr. 799 Rep., Nr. 257/1 Kol., datë 22.4.2015, (Njoftuar me shkresën Nr. 9632/5 prot., datë 19.12.2019) dhe A. M., Person Fizik (Zgjidhur me “Marrëveshje” Nr. 2534 Rep., Nr. 336 Kol., datë 5.8.2021);

Tre kontratat që janë në proces gjyqësor janë: Shoqëria "A. L. I. A." ShPK; Shoqëria "A. P. E." ShPK dhe Shoqëria "A.U. 95" ShPK

Kontrata për të cilën është kërkuar zgjidhja vullnetare nga subjekti është Shoqëria "D. F." ShPK (nuk është zgjidhur ende). Kontratat për të cilat ka përfunduar procesi gjyqësor janë Shoqëria "M." Shbb dhe Shoqëria "A. X." Shbb. Për shoqërinë "M." Shbb, (Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila me Vendimin Nr. 222, datë 10.6.2022, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit Nr. 302, datë 16.5.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, i cili konsiston “Konstatimin pjesërisht të pavlefshme të kontratës Nr. 752 prot., datë 27.1.2015 për dhënien me qira të tokës bujqësore të lidhur midis palës së paditur MBZHRAU dhe personit të tretë Shoqëria e Bashkimit Bujqësor “A. X.” lidhur me parcelat e ndodhura në Zonën Kadastrale nr. 3846 me nr. kadastral 10; nr. 48; nr. 70; nr. 72; nr. 73; nr. 74; nr. 75; nr. 81; nr. 84 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme për këtë pjesë”. Për shoqërinë "A. X." Shbb, (Gjykatën Administrative të Apelit, e cila me Vendimin me Nr. 579, datë 6.12.2022 ka vendosur: “Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 458, datë 23.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër” i cili konsiston “Gjykatën Administrative të

Shkallës së Parë Gjyrokastër, e cila pas shqyrtimit gjyqësor me Vendimin me Nr. 458, datë 23.12.2020 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, shfuqizimin e Urdhrit Nr. 411, datë 12.10.2020, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë me Nr. 4410 prot., Nr. 1306 Rep., Nr. 1046 Kol., datë 7.6.2016 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit”.

Nga informacioni i ardhur nga DAMT ky sektor ka evidentuar problematikat. Me shkresën nr. 6993 prot, datë 13.10.2021, dërguar të 12 Drejtorive të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në qarqe, ju është kërkuar ri konfirmim për ngastrat tokë bujqësore, disponibël shtetërore objekt i VKM së sipërcituar si dhe sipërfaqe e pa përfshira në këtë vendim. Referuar të dhënave të ardhura nga DAMT për fondin e tokave disponibël shtetërore objekt qiradhënie nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), fillimisht me memon sqaruese të datës 10.5.2021 dhe memon me datë 13.12.2021, iu është paraqitur Titullarit të MBZHR problematikat e veçanta, të evidentuara në 12 qarqet, në territoret e ish ndërmarrjeve bujqësore, si dhe problematikat që lidhen me regjistrimin e fondit të tokës në administrim të MBZHR. Këto problematika kanë të bëjnë me:

- procesin e kthimit e kompensimit të ish pronarëve;
- në sipërfaqen tokë disponibël shtetërore janë objekt investimeve strategjike /kanë kaluar MTM;
- zaptime të paligjshme nga fermerët;
- fragmentarizimi i skajshëm i tokës bujqësore në pronësi private dhe në pronësi shtetërore;
- okupimet nga ndërtime in formale;
- gabimet e ndryshme që janë bërë gjatë raportimit të fondit të tokës, janë përfshirë sipërfaqe të tokave me zë kadastral jo tokë bujqësore.

Konstatim nr. 2

Fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël, i dhënë në bazë të VKM-së nr. 45/2014, nuk është shoqëruar me një kopje të listës së inventarit për pasuritë, të njehsuar me origjinalin, si pjesë e kësaj VKM. Nga MBZHR me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019, i është kërkuar Këshillit të Ministrave por nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë. Në kushtet kur lista e inventarit të ngastrave që do të jepen me qira ka munguar dhe vijon të mungojë, duke dalë e paqartë se si strukturat përgjegjëse për administrimin e tokave bujqësore në MBZHR, bëjnë shpalljen publike dhe përditësimin e saj, sikundër dikton VKM nr. 373 datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit “i ndryshuar. MBZHR duhet të saktësojë sip e tokës që ka në administrim dhe në varësi të rezultatit të vlerësojë nevojën për amendimet e kontratës. Kjo situatë është e mbartur në vite në Ministrinë e Bujqësisë dhe nga struktura përgjegjëse e saj, nuk është ndërmarrë asnjë masë për regjistrimin e sipërfaqes në pronësi.

Nga auditimi, në lidhje me monitorimin e kontratave nga Sektori Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se ky sektor ka monitoruar:

- për vitin 2019, 8 kontrata, nga 40 kontrata në fuqi, ose 20% e kontratave.
- për vitin 2020, 6 kontrata nga 50 kontrata në fuqi, ose 12% të kontratave.
- për vitin 2021, 10 kontrata nga 51 kontrata gjithsej, ose 19.6 % të kontratave.
- për periudhën Janar-Mars të vitit 2022, 3 kontrata nga 51 gjithsej, ose 0.4 % e kontratave, në vijim për vitin 2022 nga struktura përgjegjëse janë monitoruar edhe 11 kontrata ose 21.15% e kontratave. Për periudhën objekt auditimi nga struktura përgjegjëse nuk u vendos në dispozicion plani i punës i miratuar nga Titullari për monitorimin e këtyre kontratave në vazhdim.

Konstatim nr. 3

MBZHR nuk disponon një plan vjetor për monitorimin e kontratave dhe nuk ka të miratuar një regjistër për kontratat e qirasë, forma dhe përmbajtja e të cilit miratohen me udhëzimin e ministrit. Monitorimi i kontratave ka filluar në vitin 2018 nga struktura përgjegjëse në ministri,

nga kontrolli i dosjeve të cilat u audituan nuk u gjenden procesverbale të viteve të mëparshme për monitorimin e kontratave kjo në kundërshtim me VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, Kreu VII, pikat 4/5; “Për këtë qëllim, struktura përgjegjëse mban regjistrin e kontratave të qirasë, forma dhe përmbajtja e të cilit miratohen me udhëzimin e ministrit. Për çdo kontratë të lidhur, në fund të vitit struktura përgjegjëse harton raport të hollësishëm për respektimin e kushteve të secilës kontratë dhe ia paraqet ministrit brenda datës 20 janar”.

Gjatë auditimit mbi ecurinë e realizimit të procedurave për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, në administrim të MBZHR-së, rezulton se për vitin 2021-2022 është lidhur vetëm 1 (një) kontratë për dhënien me qira të tokës bujqësore.

II. Procedura e dhënies me qira të sipërfaqes 107,610.5 ha, fshati Çlirim, Bashkia Kolonjë.

Nga auditimi u konstatua se subjekti ka sjellë kërkesën dt. 28.09.2020, protokolluar me nr. 9011, dt. 13.10.2020, për marrjen me qira të tokës bujqësore, pranë strukturës përkatëse në Ministri, në të cilën përcaktohet vend ndodhja, zona kadastrale, numri i pasurisë, sipërfaqja etj. Identitetin dhe dokumentin e regjistrimit si subjekt tregtar;

Vërtetimin për aftësinë financiare, jo më pak se 20% të vlerës totale të investimit;

Planin e biznesit për aktivitetin që ushtrohet. Projektin e investimit në infrastrukturë;

Raportin e vlerësimit për ndikimin e në mjedis, e përgatitur nga specialistë mjedisi;

Vetë deklarim dt. 09.10.2020 që nuk ka detyrim financiar, ndjekje penale, detyrime ndaj qiradhënësit;

Kartelën e pasurisë së paluajtshme që tregon gjendjen juridike të pronës.

Nga Struktura Përgjegjëse është bërë vlerësimi i kërkesës ku rezulton se:

Kërkesa e paraqitur është në përputhje me përcaktimet e VKM nr. 373/2018, pikës 3, pika IV.

Njoftimi për fillimin e procesit të qiradhënies është shpallur publikisht, në respektim të VKM nr.373/2018, i ndryshuar, pikës 4.1, pika IV, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të datës 26.10.2020, në gazetën zyrtare me tirazh të madh “Telegraf” datë 21.10.2020.

Nuk ka pasur pezullim të procedurës për çështje paraprake të ndonjë pale për interes të ligjshëm, pretendime pronësie të sipërfaqes së shpallur për dhënien me qira.

Nga Struktura Përgjegjëse e Qiradhënësit janë kryer verifikimet si më poshtë brenda 30 (tridhjetë) ditëve:

1. Mbi kategorinë e resursit dhe bonitetin e tokës bujqësore, objekt qiradhënieje.

Nga MBZHR është kërkuar informacion në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, me shkresën nr. 9328 prot., datë 20.10.2020, bashkëngjitur shkresës kopje e fragmentit të hartës kadastrale për pasuritë për të cilat kërkohet informacion.

Nga DAMT e Këshillit të Qarkut Korçë, është marrë informacioni i kërkuar, me shkresën nr. 638/1 prot., datë 26.10.2020, numër hyrës në MBZHR nr. 9328/1 prot., datë 29.10.2020 ku rezulton se të gjitha parcelat janë kategoria “arë”, nga të cilat: 4 boniteti VII, 4 boniteti VI, 8 boniteti V.

2. Për investime strategjike të pasurive.

Nga MBZHR është kërkuar informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me shkresën nr. 9330 prot., datë 20.10.2020. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronës publike, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 19742/1 prot., datë 28.10.2020, numër hyrës në MBZHR nr. 9330/1 prot., datë 29.10.2020, se pasuritë nuk rezultojnë të jenë objekt trajtimi sipas VKM nr. 54/2014 për dhënien me qira ose enfiteozë, apo pjesë e kapitalit të ndonjë shoqërie ose ndërmarrjeje shtetërore, si dhe nuk ka projekt për zhvillimin e tyre si zona ekonomike.

Nga AIDA/Drejtoria e Investimeve, është marrë informacioni me shkresën nr. 251/1 prot., datë 30.10.2020, me numër hyrës në MBZHR nr. 9330/2 prot., datë 3.11.2020, se asnjë investim mbi pronën objekt kërkesë nuk është trajtuar sipas procedurave të investimeve strategjike.

3. Nëse pasuria bën pjesë në zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, park kombëtar apo zona të mbrojtura, toka bujqësore, objekt qiradhënie.

Nga MBZHR është kërkuar informacion me shkresën nr. 9327 prot, dt. 20.10.2020 në ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin. Në rast se toka bujqësore përfshihet në zonë të mbrojtura, merret mendimi, nga agjencia përgjegjëse e zonave të mbrojtura për përputhshmërinë e aktivitetit për të cilin paraqitet kërkesa, me kuadrin ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura;

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, është marrë informacioni me shkresën nr. 6978/1 prot., datë 30.10.2020, me numër hyrës në MBZHR nr. 9772 prot., datë 3.11.2020, se pas shqyrtimit dhe verifikimit të hartave treguese, pasuritë nuk përfshihen në “Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit” referuar Vendimit të Këshillit Kombëtar Turizmit nr. 1, datë 26.7.2018 “Për shpalljen 17 Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit në territorin e RSH”, nuk bëjnë pjesë në rrjetin e Zonave të Mbrojtura.

4. Verifikimi i përcaktimeve të detyrueshme për zbatim që rrjedhin nga dokumentet kombëtare dhe vendore të planifikimit për pasuritë, objekt qiradhënieje.

Në Bashkinë Kolonjë, në territorin e së cilës ndodhet toka bujqësore, objekt qiradhënieje, me shkresën nr. 9326 prot., datë 20.10.2020, është marrë informacion nr. 5334 prot., datë 5.11.2020, hyrës në MBZHR nr. 9326/1 prot., datë 9.11.2020, se në referim të Planit të Përgjithshëm Vendor miratuar Vendimi nr. 2, datë 17.5.2019 Këshilli Kombëtar i Territorit, pasuritë objekt qiraje përcaktuar në kategorinë “Tokë bujqësore” dhe zhvillimin e tyre në drejtim të bujqësisë.

5. Verifikimi i përcaktimeve të detyrueshme për zbatim që rrjedhin nga dokumentet kombëtare dhe vendore të planifikimit për pasuritë, objekt qiradhënieje, në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;

Nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit me shkresën nr. 9326 prot., datë 20.10.2020, është marrë informacioni me shkresën nr. 1183/1 prot., datë 28.10.2020, me numër hyrës në MBZHR nr. 9329/1 prot., datë 29.10.2020.

6. MBZHR i ka drejtuar kërkesë Drejtorisë Vendore të ASHK Kolonjë për regjistrimi e pasurive në përgjegjësi administrimi me shkresën nr. 9318/1 prot., datë 9.11.2020, për regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme të pasurive objekt kontrate, në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së.

Pas verifikimit të kërkesave të sipërme nga MBZHR ka filluar procedura e dhënies me qira në të cilën është shpallur kualifikimi i ofertës së rregullt me Vendimin nr. 1996/3 prot., datë 16.3.2021 dhe njoftuar fituesi me shkresën nr. 2115/1 prot., datë 17.3.2021.

Nga MBZHR është bërë miratimi i fituesit dhe lidhja e kontratës me aktet si më poshtë:

1. Raport i miratuar nga ministri në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Qiradhënës me nr. 1996/4 prot., datë 2.4.2021, një përmbledhje e procedurës së ndjekur dhe propozimi i miratimit fitues, të ofertuesit “H. P. V.”, nga Bordi i Qiradhënies së TB.

2. Njoftimi i Fituesit me Formularin nr. 2115/2 prot., datë 7.4.2021, për “H.P.V.”, e cila ka ofruar çmimin vjetor të qirasë 880 000 lekë, sigurimi kontratës 392 750 lekë.

3. Garancia e Kontratës me Formularin me Nr. Serial 5371, Nr. 005371, datë 16.4.2021 nga Kompania e Sigurimit “S. I.” sha, në vlerën 392 750 lekë, me vlefshmëri 16.4.2021 deri më 15.4.2022, sipas Aneksit C të Kontratës Tip të Qirasë.

Në respektim të nenit 6 “Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit”, shkronja “a” të Kontratës së Qirasë nr. 3052 prot., nr.1381 Rep, nr.151 Kol, datë 19.4.2021, është bërë dorëzimi i tokës bujqësore Qiramarrësit.

Për këtë qëllim, me Urdhrin e Ministrit Nr. 179, datë 29.4.2021, është ngritur grupi i punës për dorëzimin e tokës bujqësore në pronësi të shtetit qiramarrësit shoqëria “H. P. V.” ShPK. Me

procesverbalin Nr.3233/1 prot, dt.14.05.2021 është kryer dorëzimi i tokës qiramarrësit i cili nuk ka paraqitur pretendime.

Procedura është komfort vendimit nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” (ndryshuar me VKM nr. 487, datë 17.6.2020).

III. Auditimi mbi ecurinë e monitorimit të kontratave tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, monitorimi i kontratave në administrim të MBZHR.

Në VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, përcaktohet se:

1. Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar.

2. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të kontratave të qirasë realizohet nga struktura përgjegjëse, e cila bashkëpunon me strukturat e tjera teknike pranë qiradhënësit.

3. Struktura përgjegjëse ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë.

4. Për këtë qëllim, ajo mban regjistrin e kontratave të qirasë, forma dhe përmbajtja e të cilit miratohen me udhëzimin e ministrit.

5. Për çdo kontratë të lidhur, në fund të vitit struktura përgjegjëse harton raport të hollësishëm për respektimin e kushteve të secilës kontratë dhe ia paraqet ministrit brenda datës 20 janar.

6. Për përmbushjen e detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura nga ish drejtoritë e bujqësisë ngarkohen agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor, në juridiksionin e të cilave gjendet toka bujqësore, objekt i këtyre kontratave.

Konstatim nr. 4

Nga auditimi për disa kontratave me objekt për dhënie me qira të tokave bujqësore për periudhën në auditimin vitet 2021 deri më 31.12.2022 gjatë procesit të realizimit dhe monitorimit u konstatua se:

- Proces verbalet e monitorimit në disa raste janë të pa protokolluara (proces verbali dt. 15.11.2018 për subjektin T.-A. ShPK.) në disa raste këto proces verbale nuk janë nënshkruar nga ana e qiramarrësit (subjekti E. B. person fizik; subjekti “R. S.” ShPK.).

- Raportet mbi realizimin e investimeve të subjekteve janë të pa protokolluara (subjekti P. C.); Në disa dosje këto raporte nuk gjenden.

Në lidhje me detyrimet dhe penalitetet e konstatuara për kontratat e lidhura janë dërguar nga MZHBR në vitin 2023 shkresat e mëposhtme të cilat i korrespondojnë detyrimit total 168,284,496 lekë. (Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Nga tabela shkresat e dërguara 6 (gjashtë) subjekteve nuk janë trajtuar në material pasi nuk kanë qenë të përzgjedhura. Konkretisht nuk janë trajtuar në material kontratat e lidhura me subjektet si më poshtë:

A. M.

A. F.H.

G. F.

N. Ll.

L. A.

A. L.A.

Konstatim nr. 5

Nga verifikimi i realizimit të investimeve kapitale rezulton që në shumicën e kontratave qiramarrësit megjithëse kanë kryer investime në terren nuk mund të mbështesin këto investime me dokumente justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë shumica e kontratave nuk provon realizimin e investimit nuk kanë kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe nuk kanë kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para, referuar neni 6 pika 5, a dhe b të kontratës ku shprehet se “a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe. Nuk kanë realizuar investimet e parashikuara në plan biznes subjektet si më poshtë:

- Shoqëria “P. I.” ShPK.
- Shoqëria “K. D.” ShPK.
- Shoqëria “B. A. I.” ShPK.
- Shoqëria “B. N. F.” ShPK.
- Shoqëria “B. P.” ShPK.
- Shoqëria “A. I. G.” ShPK
- Person fizik L. Z.
- E. B., Person Fizik.
- Shoqëria “A. P.” ShPK.
- Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “M.” ShPK.
- Shoqëria “R.S.” ShPK.
- Shoqëria “A. B.F.” ShPK.
- Shoqëria “F. A.” ShPK.

Konstatim nr.6

Nga auditimi i dosjeve rezulton vlerë e ndryshme e investimeve kapitale të parashikuara në Plan Biznes nga vlera e parashikuar në Kontratën e Qirasë, Shtojca 2; si në kontratat e lidhura me subjektet më poshtë:

- Shoqëria “P. I.” ShPK; Vlera e investimit e përcaktuar në plan biznes është vlera 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët). Total investimi i parashikuar në plan biznesin e vitit 2017 është 34,156,800 lekë.
- Shoqëria “B.A. I.” ShPK; Sipas shtojcës 2 të kontratës vlera e investimit është 2,128,000,000 lekë ndërsa sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim vlera e investimit është 22,207,375 Euro.
- Shoqëria “K. D.” ShPK; Vlera e investimit është përcaktuar 137,100,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës dhe 141,500,000 lekë sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim.
- Shoqëria “B.N. F.” ShPK; Vlera e investimit është përcaktuar 33,740,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës por ka mospërputhje dhe paqartësi në plan biznes, (në disa pjesë përshkruhet se vlera e investimit është 887,000 Euro dhe në disa pjesë vlera e investimit rezulton 607,000 Euro).
- Shoqëria “B. P.” ShPK; Vlera e investimit është 79,390,000 Lekë sipas planit të biznesit por sipas tabelave përmbledhëse rezulton 49,520,000 lekë (ka mospërputhje të shumta midis zërave të investimit, vlera të investimit dhe afateve të realizimit të investimeve) dhe 35,800,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës.
- Person fizik L. Z.; Vlera e investimit është përcaktuar 66,340,000 lekë në planin e biznesit (ka probleme në planin e biznesit ku janë futur shpenzime të tjera që nuk kanë vlerë për llogaritjen e investimeve) dhe 36,640,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës.
- Person fizik P. C., “K. C.”; Vlera e investimeve, sipas shtojcës 2 të kontratës është

120,900,000 lekë dhe sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim vlera e investimeve është 154,286,259 lekë (ose 33,386,259 lekë më e ulët).
- Shoqëria “A. I. G.” ShPK; Vlera e investimit sipas shtojcës 2 të kontratës është 482,178,240 lekë para amendimit dhe 254,627,468 lekë në planin e ri të biznesit pas amendimit.

Konstatim nr.7

Lidhur me garancitë e kontratës nga ana e subjekteve nuk janë dorëzuar garancitë e kontratave për periudhën objekt auditimi vitin 2021/22 kjo në kundërshtim me kontratën sipas nenit 8 “Sigurimi i garancisë së kontratës“ ku parashikohet: “*Sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate “për kontratat e subjekteve si më poshtë:*

- “P. I.” ShPK,
- “B. N.F.” ShPK,
- L. Z.
- P. C.
- ShBB “M.” ShPK.
- “A. P.” ShPK,
- E.B.
- “R. S.” ShPK.
- “A. B. F.” ShPK,,
- “F.A.” ShPK,
- “H.P.V.” SHPK

Konstatim nr. 8

- Në disa kontrata megjithëse janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit ka probleme me zaptimin e tyre nga palë të treta pa tagra pronësie dhe për pasojë nuk ka ecuri të këtyre kontratave.

-Në kontratën nr.4040 prot, Nr.793 Rep, nr.473 Kol, datë 12.5.2015, **shoqëria “B. N. F.” ShPK.**, qiramarrësi nuk ka kryer investimet sipas plan biznesit të parashikuara, pasi sipërfaqja prej 5 ha është e zaptuar nga fermerë të ndryshëm dhe nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi. Gjithashtu një pjesë e sipërfaqes, e cila ndodhet pranë një Reparti Ushtarak nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi, pasi nuk lejohet nga struktura e repartit me pretendimin se është zonë ushtarake. Subjekti pretenduar se rreth 28.84 ha tokë është e zaptuar.

-Kontrata e qirasë Nr. 748/1 Prot., Nr. 3051 Rep., Nr. 613 Kol., datë 22.9.2020, lidhur me qiramarrësin **subjektin “F. A.” ShPK.** Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës pasqyruar në procesverbalin me nr. 748/4 prot., datë 26.10.2020 i mbajtur për procesin e dorëzimit, në të cilin u dorëzuar të lira dhe pa problematika të gjitha sipërfaqet e trajtuara me qira, përveç pasurisë nr. 448/1, Vol 5, faqe 41 me sipërfaqe 6804 m², e cila sipas hartës treguese të regjistrimit lëshuar nga DVASHK Lushnje, ka rezultuar e zaptuar.

-Shoqëria **“P.I.” ShPK.** Në proces-verbalin e mbajtur në datë 05.06.2014 nga grupi i punës dhe përfaqësuesi i shoqërisë është dorëzuar një pjesë e sipërfaqes së trajtuar me qira tek qiramarrësi (është kryer piketimi) sipërfaqe prej 80 ha dhe pjesa tjetër prej 61.92 ha nuk është dorëzuar për shkak të pretendimeve të banorëve të zonës.

- Shoqëria **“B.A.” ShPK.** dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr.7075 prot, nr.6075 rep. nr.2615 kol, datë 7.10.2014, për të cilën në zbatim të Urdhrit nr.509 datë 30.10.2014 “Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë “B. A. I.” ShPK”, është ngritur grupi i punës i cili ka proçeduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se : “Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në

kufijte e pronave te tyre per periudhen para vitit 1946, por nuk disponojne asnje dokumentacion pronesie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtime pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 7.10.2014 “Për dhënien me qira të tokës bujqësor në pronësi të shtetit”.

Një pjesë e sipërfaqes së marrë me qira është e zaptuar nga të tretë. Në këto sipërfaqe janë ndërtuar shtëpi banimi. Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m 2 qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vend ndodhjes së saj.

- Shoqëria Kantina “Ç.” dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ngritje vreshti për kultivimin rrushi dhe prodhim vere me vlerë qiraje 321,565 lekë në vit. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës), është ngritur grupi i punës “Për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P. Ç.” ShPK, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit, citohet se “qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës”, fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi.

Investimi i parashikuar në planin e biznesi për 5 vitet e para është në vlerën 154,286,259 lekë, ndërsa nga auditimi i dosjes fizike nuk u konstatua asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realizimin e investimit të vitit të pestë kryer në masën prej 70%.

-Subjekti “T. A.” ShPK. në Kontratën nr. 6801/3 prot, Nr. 1719 Rep, Nr. 674 Kol, datë 18.11.2016. Rezulton se subjekti i ka ndërtuar dy stalla dhe në ndërtim ishte stalla e tretë me kapacitet prej 900 krerësh, por këto stalla nuk janë ngritur në sipërfaqen e marrë me qira, me argumentimin se nuk i është dorëzuar sipërfaqja në përdorim nga qiramarrësi.

Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 21 prej 51 kontratave të lidhura nga viti 2013 deri në fillim të 2021 për auditim, në lidhje me fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës në të cilat u konstatuan problematika. Pra në total janë audituar 21 kontrata ose 40 % nga 51 kontrata të cilat kanë objektin e dhënies me qira të tokës bujqësore.

- Në disa prej kontratave vlera e qirasë nuk është paguar në kohën e caktuar në kontratë dhe si rrjedhojë janë krijuar penalitete si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor.

- Investimet nuk janë kryer sipas planit të biznesit, nuk janë siguruar kontratat dhe gjithashtu toka nuk është përdorur sipas objektit të kontratës. Për disa kontrata ka filluar investimi i parashikuar me vonesë kjo si rezultat i mosrealizimit të dorëzimit të tokës nga struktura përgjegjëse e qiradhënësit.

-Në disa kontrata qiramarrësi ka kërkuar amendim kontrate, por pa paraqitur dokumentacionin e duhur (plan biznesin për kulturat që kërkojnë ndryshim) si dhe në disa kontrata nuk ka amendim të tyre në zbatim të kërimit të subjekteve.

- Sipas Kontratës së Qirasë Tip, në parashikimet e Nenit 7 “Sanksione” janë jashtë çdo logjike ekonomike, për arsye se kamatëvonesat për mospagimin e vlerës së qirasë vjetore janë pambarim pa përcaktuar një tavan për ndërprerjen e tyre.

- Asnjë qiramarrës nuk ka dhënë informacion për numrin e punonjësve të siguruar të parashikuar në Plan Biznes.

- Në disa kontrata qiraje janë dhënë me qira dhe pasuri mbi të cilat janë varrezat e zonës, ka ndërtime të ligjshme në të cilat nuk mund të zbatohen parashikimet e kontratës dhe të planit të biznesit.

- Disa prej tokave bujqësore të trajtuara me qira nuk janë të përfshira në Vendimet e Këshillit të Ministrave që kalojnë në administrim të MBZHR si pasuri shtetërore dhe nuk mund të

dorëzohen tek qiramarrësi dhe as nuk mund të regjistrohen ne ZVRPP prandaj dhe disa kontrata rezultojnë të paregjistruara, rrethana të cilat do të trajtohen më poshtë së bashku me problematikat e tjera të evidentuara. *(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raportit auditimi.)*

Nga auditimi u konstatua se, disa prej kontratave vlera e qirasë nuk është paguar në kohë dhe si rrjedhojë janë krijuar penalitete, qiramarrësit nuk kanë realizuar investimet e parashikuara në plan biznes, si pasojë nuk janë plotësuar detyrimet kontraktore, të cilat po i paraqesim më poshtë të trajtuara së bashku me problematikat e tjera të evidentuara.

1- Kontrata e qirasë Nr. 3620/1 prot., nr. 4774 Rep, nr. 1234 Kol, datë 6.9.2013, lidhur me qiramarrësin subjektin “P. I.” ShPK.

Nga auditimi i dosjes së subjektit rezulton se objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 141.92 ha, Zona Kadastrale nr. 1610, e përbërë nga pasuritë me nr. 250; nr. 251; nr. 252; nr. 258; nr. 259; nr. 260; nr. 261; nr. 270; nr. 271 dhe nr. 272, të cilat ndodhen në fshatin Grabian, Bashkia Divjakë, qarku Fier, për tu mbjellë me luleshtrydhe, fasule, rukola dhe oriz. Afati i kontratës është 60 (gjashtëdhjetë) vjet, dhe vlera e qirasë është parashikuar në shumën 2,873,880 lekë/total/vit, (shtuar kultura e orizit me Shtojcën Nr. 4307 prot., Nr. 1228 Rep., Nr. 298 Kol., datë 29.5.2017 “*Ndryshim i kontratës për dhënie me qira të tokës bujqësore me Nr. 3620/1 prot., datë 6.9.2013*”), amenduar duke përcaktuar të paguhet vetëm për 80 ha të dorëzuar në përdorim të Qiramarrësit në vlerë 1,620,000 lekë. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për mbjelljen e luleshtrydhe, fasule, rukola dhe oriz. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet parapagim në momentin e nënshkrimit të kontratës, por jo më vonë se 10 Shtator 2013; pagesat e tjera me datën 6 Shtator të çdo viti pasardhës. ***Vlera e investimit e përcaktuar në plan biznes është vlera 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët). Total investimi i parashikuar në plan biznesin e vitit 2017 është 34,156,800 lekë.***

Grupi i audituesve nga verifikimet në bazë të dosjes fizike, konstatoi se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali, *nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit*, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe *nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para*, referuar neni 6 pika 5, a dhe b ku shprehet se “*a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;*

b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3.

1.Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës u konstatua se me urdhër të titullarit Ministrit të Bujqësisë nr.2914 prot datë 24.04.2014 është ngritur grupi i punës “Për kalimin e tokës në përdorim në favor të subjektit “P.I.” ShPK. Me proces-verbal të mbajtur me datë 05.06.2014 nga grupi i punës dhe përfaqësuesi i shoqërisë është dorëzuar një pjesë e sipërfaqes së trajtuar me qira tek qiramarrësi (është kryer piketimi) sipërfaqe prej 80 ha dhe pjesa tjetër prej 61.92 ha nuk është dorëzuar për shkak të pretendimeve të banorëve të zonës.

Ky fakt tregon se toka bujqësore është dorëzuar nga Ministria e Bujqësisë, ***rreth 1 vit më vonë***, në mos plotësim të detyrimit kontraktor neni 3 nga MBZHR në cilësinë e Qiradhënësit dhe në mos përputhshmëri me bazën ligjore dhe nën ligjore mbi të cilën është miratuar kontrata në fjalë si pasojë e mos ngritjes nga titullari MBZHR, grupit të punës për dorëzimin e tokës bujqësore.

Në bazë të Shtojcës me nr.4307 Prot, nr.1225 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017, qiramarrësi ka ndryshuar Nenin 1, pika 2 të kontratës së qirasë, si edhe Nenin 2, shkronja d, ku është shtuar si aktivitete kultura bujqësore e orizit që do të mbillet në tokë, përveç luleshtrydhes, fasules dhe rukulës që ishte parashikuar fillimisht. Për këtë të fundit subjekti ka paraqitur edhe Planin e Biznesit të vitit 2017, të miratuar për mbjelljen dhe kultivimin e orizit. Nga auditimi,

në lidhje mbi monitorimin i kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se është ngritur grupi i punës me urdhër të ministrit të Ministrisë së Bujqësisë nr.97 datë 04.02.2019 “Për verifikimin e realizimit të programit të investimeve kapitale të kontratës së qirasë”. Në bazë të proces-verbali mbajtur me datë 08.02.2019 nga grupi i punës me anëtarë A. B., M. K., M.S., H.M. dhe E. T. si dhe firmosur nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë "P. I." shprehen se “parcelat me numër pasurie 270, 271, 272, 259, 258 dhe një pjesë e vogël (në formë trekëndëshi) e parcelës me numër pasurie 250, ishin në përdorim nga qiramarrësi. Pjesa tjetër e pasurisë me nr 250 ishte e mbjellë me tërfill nga të tretë. Parcela me numër pasurie 272 është e lirë më shumë se gjysma, në të cilën ishte ndërtuar një vend për rojet, zyrë me konstruksion metalik për tharjen e orizit. Po në këtë parcelë qiramarrësi ka shtrirë rrjetin elektrik, shtylla betoni rreth 8 të tillë, nga të cilat tre ishin lidhur me rrjetin dhe në njërin prej saj është montuar transformatori dhe pesë te tjera të palidhura. Në parcelat si më sipër ishin pastruar kanalet dhe ka mbetje të kashtës së kulturës së orizit. Ishin ngritur dhe oxhaqe për mbjelljen e orizit.”

2. Lidhur me shlyerjen e qirasë rezulton se: Në kontratën e qirasë, neni 1 “Objekti i kontratës”, pika 2, paragrafi i dytë, parashikon: “Palët bien dakord që vlera e shpërblimit vjetor për marrjen me qira të Pasurisë të jetë 20,250 (njëzet mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë/ha/vit”, pika 3 “Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo më vonë se 10 shtator 2013, ndërsa për periudhën vijuese me datë 6 shtator të çdo viti pasardhës”.

Neni 2 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit” shkronja “a” parashikon se: “Qiramarrësi ka për detyrim që të shlyejë në kohë dhe në mënyrë korrekte çmimin e qirasë të përcaktuar në nenin 1 më lart” dhe shkronja “b” parashikon se: “Qiramarrësi ka për detyrim të dorëzojë pranë qiradhënësit kopje të dokumentit bankar që vërteton pagesën e çmimit të qirasë”.

Me shtojcën Nr. 4307 prot., Nr. 1228 Rep., Nr. 298 Kol., datë 29.5.2017, “Ndryshim i kontratës për dhënien me qira të tokës bujqësore me Nr. 3620/1 prot., datë 6.9.2013”, neni 1 parashikon se: “Palët bien dakord të ndryshojnë pikën 2 të nenit 1, “Objekti i kontratës”, si vijon: “Palët bien dakord që vlera e shpërblimit vjetor për marrjen me qira të pasurisë të jetë 20,250 (njëzet mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë/ha/vit” dhe “Çmimi i qirasë paguhet në proporcion me sipërfaqen e pasurisë së dorëzuar tek qiramarrësi sipas pikës 1 të këtij neni. Dorëzimi i sipërfaqeve të tokës vërtetohet me procesverbal të nënshkruar nga palët”. MBZHR ka përllogaritur kamatëvonesat.

-Viti i parë i qirasë përfshin afatin kohor prej datës 6 shtator 2013 deri më datë 6 shtator 2014 (llogaritjet janë kryer nga data 5.6.2014 deri në datën 6.9.2014)

Që nga momenti i marrjes në dorëzim të tokës bujqësore, me sipërfaqe prej 80 ha (në datën 5.6.2014), deri në datën 6 shtator 2014 (datë kur paguhet dhe qiraja për vitin 2014) gjithsej janë 93 ditë.

Qiraja totale $20,250 \text{ lekë/ha} \times 80 \text{ ha} = 1,620,000 \text{ lekë}$.

Qira totale $1,620,000 \text{ lekë} / 365 \text{ ditë} = 4,438.36 \text{ qira ditore}$.

$93 \text{ ditë} \times 4,438.36 \text{ lekë (qira ditore)} = 412,767.12 \text{ lekë qira për vitin 2013-2014}$.

Subjekti ka paguar në datën (9.9.2013) shumën prej 2,873,880 lekë – $412,767.12 \text{ lekë} = 2,461,112.88 \text{ lekë}$, tepricë.

-Viti i dytë i qiramarrjes, viti 2014 (nga data 7 shtator 2014 deri 6 shtator 2015).

Nga 2,461,112.88 lekë, tepricë e vitit 2013 – $1,620,000 \text{ lekë/pagesa për } 80 \text{ ha} = 841,112.88 \text{ lekë}$ tepricë në vitin 2014.

-Viti i tretë i qirasë, vitin 2015 (nga data 7 shtator 2015 deri 6 shtator 2016)

Nga 841,112.88 (lekë tepricë) – $1,620,000 \text{ lekë/pagesa për } 80 \text{ ha} = -778,887.12 \text{ lekë}$ të paguara për vitin 2015.

$1 \text{ ditë vonesë} \times 0.5 \% \text{ e detyrimit vjetor të qirasë së mbetur pa paguar prej } (778,887.12 \text{ lekë}) = 3,894.44 \text{ lekë}$ kamatëvonesa ditore.

$3,894.44 \text{ lekë (kamatë ditore pjesore)} \times 732 \text{ ditë (nga data } 7.9.2015 \text{ deri në datën } 8.9.2017) = 2,850,726.87 \text{ lekë}$, kamatëvonesë.

Në datën 8.9.2017 është kryer nga subjekti pagesa prej 1,723,883 lekë, (principali i vitit 2017, në vlerën 1,620,000 lekë dhe kamatëvonesa) duke rezultuar një tepricë prej 87,683 lekë.

Principal i mbetur pa paguar i vitit 2015 (778,887.12 lekë) – 87,683 lekë = 691,204.12 lekë.

1 ditë vonesë \times 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë së mbetur pa paguar prej (691,204.12 lekë) = 3,456.02 lekë kamatëvonesa ditore.

3,456.02 lekë \times 367 ditë (nga data 8.9.2017 deri në datën 10.9.2018) = 1,268,359.57 lekë, kamatë vonesë.

Në datën 10.9.2018 është kryer nga subjekti pagesa prej 1,721,250 lekë, (principali i vitit 2018, në vlerën 1,620,000 lekë dhe kamatëvonesa) duke rezultuar një tepricë prej 68,850 lekë.

Principal i mbetur pa paguar (691,204.12 lekë) – 68,850 lekë (tepricë nga viti 2018) = 622,354.12 lekë.

1 ditë vonesë \times 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë së mbetur pa paguar prej (622,354.12 lekë) = 3,111.77 lekë kamatëvonesa ditore.

3,111.77 lekë \times 1561 ditë (nga data 10.9.2018 deri në datën 19.12.2022) = 4,857,473.93 lekë, kamatë vonesë.

-Për vitin 2015 subjekti rezulton debitor në vlerën totale prej 9,598,914.49 lekë, e përbërë nga zërat si më poshtë:

1. Principal i pa paguar = 622,354.12 lekë
2. Kamatë vonesë pjesore = 2,850,726.87 lekë
3. Kamatë vonesë pjesore = 1,268,359.57 lekë
4. Kamatë vonesë pjesore = 4,857,473.93 lekë

-Viti i katërt i qirasë, viti 2016 (nga data 7 shtator 2016 deri 6 shtator 2017)

Në vitin 2016, konkretisht në datën 22 shtator 2016 nga subjekti është kryer pagesa në vlerën 862,684 lekë, e cila është më e vogël se detyrimi i qirasë prej 1,620,000 lekë, të parashikuar në kontratën e nënshkruar midis palëve.

862,684 lekë, të paguara në vitin 2016 – 1,620,000 lekë, pagesa që duhej kryer për vitin 2016 = (-757,316) lekë debi e pa paguar për qiranë e vitit 2016.

Pagesa pjesore prej 862,684 lekë është kryer në datën 22 shtator 2016 ose (16 ditë me vonesë) pasi sipas parashikimeve të kontratës duhej të ishte paguar në datën 6 shtator 2016.

16 ditë \times 0.5 % të detyrimit vjetor të qirasë (8,100.00 lekë) = 129,600 lekë kamatëvonesa.

Për principalin e mbetur pa paguar prej 757,316 lekë, kamata ditore pjesore do të jetë “1 ditë vonesë \times 0.5 % e detyrimit vjetor pjesor të qirasë së mbetur pa paguar prej (757,316 lekë) = 3,786,58 lekë kamatëvonesa ditore”.

3,786.58 lekë \times 2279 ditë (nga data 22.9.2016 deri në datën 19.12.2022) = 8,629,615.82 lekë, kamatë vonesë.

Për vitin 2016 subjekti rezulton debitor në vlerën totale prej 9,516,531.82 lekë, e përbërë nga zërat si më poshtë:

1. Principal i pa paguar = 757,316 lekë
2. Kamatë vonesë totale = 129,600 lekë
3. Kamatë vonesë pjesore = 8,629,615.82 lekë

-Viti i pestë i qirasë, viti 2017 (nga data 7 shtator 2017 deri 6 shtator 2018)

Në vitin 2017, konkretisht në datën 8.9.2017 nga subjekti është paguar shuma në vlerën 1,723,883 lekë. Sipas parashikimeve të kontratës qiraja duhet të ishte paguar në datën 6 shtator 2017, pra 2 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 7 “Sanksione”, pika 1 e kontratës, llogariten si vijon:

2 ditë vonesë \times 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 16,200 lekë kamatëvonesa ditore.

1,620,000 lekë detyrim vjetor + 16,200 lekë kamatëvonesa = 1,636,200 lekë/total.

Subjekti ka paguar 1,723,883 lekë – 1,636,200 lekë (principal dhe kamatëvonesa) = 87,683 lekë tepricë të paguara për vitin 2017 (të cilat janë transferuar tek principali i pa paguar i vitit 2015).

-Viti i gjashtë i qirasë, viti 2018 (nga data 7 shtator 2018 deri 6 shtator 2019).

Në vitin 2018, konkretisht në datën 10.9.2018, subjekti ka paguar shumën në vlerën 1,721,250 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer në datën 10 shtator 2018 dhe jo në datën 6 shtator 2018, ose 4 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 7 “Sanksione”, pika 1 e kontratës, llogariten si vijon:
4 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore (0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë) = 32,400 lekë kamatëvonesa totale.

1,620,000 lekë detyrim vjetor + 32,400 lekë kamatëvonesa = 1,652,400 lekë/total.

Subjekti ka paguar 1,721,250 lekë – 1,652,400 lekë (principal dhe kamatëvonesa) = 68,850 lekë teprice të paguara për vitin 2018 (të cilat janë transferuar tek principal i pa paguar i vitit 2015).

-Viti i shtatë i qirasë, viti 2019 (nga data 7 shtator 2019 deri 6 shtator 2020).

Në vitin 2019, konkretisht në datën 7.10.2019, subjekti ka paguar shumën në vlerën 1,620,000 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer më 7 tetor 2019 dhe jo më 6 shtator 2019, ose 31 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 7 “Sanksione”, pika 1 e kontratës, llogariten si vijon:

31 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore (0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë) = 251,100 lekë, kamatëvonesa totale të papaguara për vitin 2019.

-Viti i tetë i qirasë, viti 2020 (nga data 7 shtator 2020 deri 6 shtator 2021)

Në vitin 2020, konkretisht në datën 5.10.2020, subjekti ka paguar shumën në vlerën 1,620,000 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer më 5 tetor 2020 dhe jo më 6 shtator 2020, ose 29 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 7 “Sanksione”, pika 1 e kontratës, llogariten si vijon:

29 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore (0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë) = 234,900 lekë, kamatëvonesa totale të papaguara për vitin 2020.

-Viti i nëntë i qirasë, viti 2021 (nga data 7 shtator 2021 deri 6 shtator 2022)

Në vitin 2021, pagesa e qirasë duhet të ishte paguar në datën 6 shtator 2021, por rezulton të mos jetë paguar ende nga subjekti. Referuar datës (19.12.2022 që është kryer llogaritja), subjekti rezulton 469 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

469 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore = 3,798,900 lekë, kamatëvonesa totale

Për vitin 2021 subjekti rezulton debitor në vlerën totale prej 5,418,900 lekë, e përbërë nga zërat si më poshtë:

1. Principal i pa paguar = 1,620,000 lekë

2. Kamatë vonesë totale = 3,798,900 lekë

-Viti i dhjetë i qirasë, viti 2022 (nga data 7 shtator 2022 deri 6 shtator 2023)

Në vitin 2022, pagesa e qirasë duhet të ishte paguar në datën 6 shtator 2022, por rezulton të mos jetë paguar nga subjekti. Subjekti rezulton 104 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

104 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore = 842,400 lekë, kamatëvonesa totale

Për vitin 2022 subjekti rezulton debitor në vlerën totale prej 2,462,400 lekë, e përbërë nga zërat si më poshtë:

1. Principal i pa paguar = 1,620,000 lekë

2. Kamatë vonesë totale = 842,400 lekë

-Vlera totale e qirasë së pashlyer ndër vite është **4,619,670.12 lekë** (622,354.12+757,316+1,620,000+1,620,000).

-Vlera totale e kamatëvonesave të pashlyer është **22,863,076.19 lekë** (8,976,560.37+8,759,215.82+251,100+234,900+3,798,900+842,400). Me shkresën nr. 4545 prot, datë 02.09.2022 MBZHR e ka kërkuar pagesën e këtyre kamatëvonesave por rezulton e pa paguar dhe në periudhën e auditimit.

Për periudhën e auditimit nga MBZHR nuk janë kryer monitorime për të kontrolluar përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga qiramarrësi. Gjithashtu nuk janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës, qëndrim që përbën shkelje të

nenit 3/1/b të kontratës së qirasë në të cilin parashikohet: “Të ushtrojë kontrolle periodike mbi pasurinë, për të verifikuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi tokën bujqësore, ato të kësaj kontrate si dhe kriteret dhe elementet e përcaktuara në ofertën prej tij pranë autoritetit qiramarrës për marrjen me qira të pasurisë”.

3.Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar garancia e kontratës për periudhën e auditimit 2021/2022, në kundërshtim me nenin 8 të kontratës së qirasë.

4.Subjekti “Pragma Investment” ShPK, për periudhën e auditimit, nuk ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues.

-MBZHR në kundërshtim me Vendim nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” (ndryshuar me VKM nr. 487, datë 17.6.2020) nuk ka ndjekur procedurat përkatëse lidhur me mos përmbushjen e detyrimit për investimin nga qiramarrësi, mospërdorimin e tokës sipas objektit, mospagimin e shumave të qirasë dhe kamatëvonesave përkatëse.

5. Lidhur me realizimin e investimit subjekti nuk ka realizuar investimet e parashikuara në 2 plan bizneset: (*kultivimin e prodhimit të luleshtrydheve, fasule dhe rukola, pas amendimit të kontratës është shtuar prodhimi i orizit*), edhe pse në proces verbalin e dorëzimit të tokës datë 5.6.2014, nga grupi i punës i ngritur me Urdhër Ministri nr. 190, datë 24.4.2013, ka deklaruar se dorëzimi jo i plotë i sipërfaqes së tokës nuk e pengon në realizimin e investimeve sipas planit të biznesit të parashikuar (referuar planit të biznesit të parë dhe planit të biznesit të dytë). Referuar planit të biznesit të ri nuk ka fatura që justifikojnë investimin. Subjekti nuk është njoftuar për detyrimet e konstatuara nga KLSH nga mos pagesa e qirasë vjetore dhe penaltete për mosrealizim të investimeve. Nga auditimi u konstatua se, për realizimin e investimit me vlerë prej 351,036,645 lekë sipas Kontratës Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013 në Planin e biznesit të vitit 2013, në dosje nuk u gjendet dokumentacioni justifikues, për vlerën e investimit të parashikuar në kontratë janë paraqitur disa fatura dhe për këtë arsye janë analizuar për rrjedhojë do të vendoset penalteti i parashikuar në mos plotësim të detyrimit kontraktor i parashikuar në masën 2% sipas nenit 7 pika 3.

Referuar Kontratës së Qirasë, neni 6 “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, parashikon se: “Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3, parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.

Plani i biznesit i vitit 2013 parashikonte investime në vlerën prej 351,036,455 lekë ndërsa plani i biznesit të vitit 2017 parashikonte investime në vlerën 34,156,800 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raport).

Bazuar në parashikimet kontraktore të sipërcituara gjoba për mos realizimin e investimeve të programuara do të llogaritet nga data 30 qershor 2014 sipas procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes prej 80 hektarësh në datën 5.6.2014. Referuar sa më sipër penaltetet që MZHBR ka përlllogaritur janë si vijon:

Gjoba për vitin e parë të investimit 2014-2015:

Vlera e investimit të parashikuar në planin e biznesit për vitin e parë (investime): 236,854,808 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (33,286,628.87) lekë.

Vlera e investimit të parrealizuar për periudhën 2014/2015: 236,854,808 lekë – 33,286,628.87 lekë (Realizim) = 203,568,179.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 203,568,179.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2015) = 4,071,363.58 lekë.

Gjoha për vitin e dytë të investimit 2015-2016:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e dytë (investime): 0 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15 dhe 2015/16) = 203,568,179.13 lekë + 0 lekë = 203,568,179.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 203,568,179.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2016) = 4,071,363.58 lekë.

Gjoha për vitin e tretë të investimit 2016-2017:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e tretë (investime): 0 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (13,104,998) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15, 2015/16 dhe 2016/17) = 203,568,179.13 lekë – 13,104,998 lekë = 190,463,181.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 190,463,181.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2017) = 3,809,263.62 lekë.

Gjoha për vitin e katërt të investimit 2017-2018:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e katërt sipas plan biznesit të parë është 114,181,647 lekë dhe sipas plan biznesit të amenduar në vitin 2017 vlera e investimeve të parashikuara është 15,785,920 lekë. Në total subjekti ka planifikuar investime në vlerën 129,967,567 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15, 2015/16, 2016/17 dhe 2017/18) = 203,568,179.13 lekë – 13,104,998 lekë + 129,967,567 lekë = 320,430,748.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 320,430,748.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2018) = 6,408,614.96 lekë.

Gjoha për vitin e pestë të investimit 2018-2019:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e pestë (investime): 18,370,880 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15, 2015/16, 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19) = 203,568,179.13 lekë – 13,104,998 lekë + 129,967,567 lekë + 18,370,880 lekë = 338,801,628.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 338,801,628.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2019) = 6,776,032.56 lekë.

Gjoha për vitin e gjashtë të investimit 2019-2020:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e gjashtë (investime): 0 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15, 2015/16, 2016/17, 2017/18, 2018/19 dhe 2019/20) = 203,568,179.13 lekë – 13,104,998 lekë + 129,967,567 lekë + 18,370,880 lekë + 0 lekë = 338,801,628.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 338,801,628.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2020) = 6,776,032.56 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2020-2021:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e shtatë (investime): 0 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15, 2015/16, 2016/17, 2017/18, 2018/19, 2019/20 dhe 2020/21) = 203,568,179.13 lekë – 13,104,998 lekë + 129,967,567 lekë + 18,370,880 lekë + 0 lekë = 338,801,628.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 338,801,628.13 lekë (vlera investimeve të përealizuara deri 30.6.2021) = 6,776,032.56 lekë.

Gjoha për vitin e tetë të investimit 2021-2022:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin e tetë (investime): 0 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15, 2015/16, 2016/17, 2017/18, 2018/19, 2019/20, 2020/21 dhe 2021/22) = 203,568,179.13 lekë – 13,104,998 lekë + 129,967,567 lekë + 18,370,880 lekë + 0 lekë = 338,801,628.13 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 338,801,628.13 lekë (vlera investimeve të perealizuara deri 30.6.2022) = 6,776,032.56 lekë.

-MBZHR ka përlllogaritur vlerën e penalitetit me shkresën 4545 prot, dt. 02.09.2022 deri në datë 31.08.2022. Grupi i auditimit ka përlllogaritur penalitetin deri në fund të periudhës së auditimit në shumën 45,464,736 lekë. (*Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti*).

Konstatim

Grupi i auditimit, pas verifikimit të dokumentacionit të dosjes, arrin në këto përfundime:

- Si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:
- Vlera 27,482,746.31 lekë (4,619,670.12 + 22,863,076.19) detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave
- Vlera 45,464,736 lekë penalitet për mosrealizimin e investimit.
- Vlera prej 72,947,482.31 lekë përbën detyrimin total të subjektit “P.” ShPK. për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

- Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimin e kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se MBZHR nuk ka kërkuar prishjen e kontratës dhe nuk ka sekuestruar garancinë. Qëndrimi i MBZHR bie në kundërshtim me dispozitat e mëposhtme:

a) VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pika VII/1 “Monitorimi i Kontratave”, ku parashikohet: “*Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar*”.

b) Nenin 6 të kontratës së qirasë “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, ku parashikohet se: “*Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3*”.

c) Nenin 7 të kontratës së qirasë “Sanksione”, pika 3, ku parashikohet se: “*Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë*”.

d) Nenin 8 të kontratës së qirasë nenit “Sigurimi i garancisë së kontratës” ku parashikohet se: “*Sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate*”.

2- Kontrata e Qirasë Nr. 7075 prot., Nr. 6075 Rep., Nr. 2815 Kol., datë 7.10.2014, ndryshuar me Shtojcën V, Nr. 6403/1 prot., Nr. 6594 Rep., Nr. 3931 Kol., datë 25.8.2016, lidhur me qiramarrësin subjektin “B.A. I.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 82.6960 ha, në Zonën Kadastrale nr. 1042, e përbërë prej ngastrave me numër pasurie 334/1; nr. 329/1; nr. 331; nr. 332; nr. 333/4; nr. 14; nr. 337; nr. 11; nr. 9/21; nr. 21; nr. 22; nr. 27/6; nr. 10/1; nr. 10/2; nr. 10/3; nr. 10/4; nr. 335/1; nr. 335/2; nr. 336; nr. 10/5 dhe nr. 15, ndryshuar me Shtojcën V, Nr. 6403/1 prot., Nr. 6594 Rep., Nr. 3931 Kol., datë 25.8.2016, ndodhur në Bashkinë Fushë Krujë,

qarku Durrës, me objekt kultivimin e domates në serra, kultivimin e drufrutorëve si dhe ndërtimin e një fabrike/njësie përpunimi dhe ambiente shërbimi, për një afat 90 vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 1,496,798 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për kultivimin e domates në serra, kultivimin e drufrutorëve si dhe ndërtimin e një fabrike/njësie përpunimi dhe ambiente shërbimi. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 14 Tetor 2014; pagesat e tjera brenda datës 7 Tetor të vitit përkatës. ***Sipas shtojcës 2 të kontratës vlera e investimit është 2,128,000,000 lekë ndërsa sipas planit të biznesit të paraqitur në konkurrim vlera e investimit është 22,207,375 Euro.*** (Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti.)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 1 % të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 21,280,000 lekë. Në zbatim të Urdhrit nr.509 datë 30.10.2014 “Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë “B. A. I.” ShPK”, është ngritur grupi i punës i cili ka proceduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.10.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se: “Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufijtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Një pjesë e sipërfaqes së marrë me qira është e zaptuar nga të tretë. Në këto sipërfaqe janë ndërtuar shtëpi banimi. Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m² qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vend ndodhjes së saj. Kontrata është e regjistruar në ASHK.

1.Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton se në zbatim të nenit 1/3 të kontratës, për vitin 2022/23 duhet të paguhej në datën 7 tetor 2022 por është paguar në datën 2 nëntor 2022 ose 26 ditë me vonese. Në Kontratën e Qirasë, neni 1 “Objekti i kontratës”, pika 2, paragrafi i dytë, parashikohet se: “Palët bien dakord që vlera e shpërblimit vjetor për marrjen me qira të pasurisë të jetë 18,100 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind) lek/ha/vit ose 1,496,798 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lek/totali/vit (“Çmimi i qirasë” ose “Qiraja”)” pika 3, parashikohet se: “Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 14 Tetor 2014, ndërsa për periudhën vijuese më datë 7 Tetor të çdo viti pasardhës”.

MBZHR në bazë të nenit 7/1 të kontratës, nuk ka përlllogaritur ndaj subjektit kamatëvonesa 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonese, në vlerën 194,583.74 lekë (1,496,798 * 0.5% *26 ditë). Kjo kamatëvonesë nuk është paguar.

2.U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Lidhur me këtë komponent rezulton se vlera e investimit është përcaktuar 22,407,375 Euro. Për periudhën objekt auditimi (2021-2022) nuk ka monitorim të kontratës nga ana e qiradhënësit. Verifikimi i fundit në terren nga MBZHR lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit është kryer në datën 13.02.2019, pasqyruar në procesverbalin Nr. 214/1 prot, datë 15.2.2019, nga Struktura Përgjegjëse për monitorimin: M.K., M. S., H. M., Z. Ç. (AREB Tiranë), rezultoi se e gjithë sipërfaqja e tokës ishte e rrethuar me rrjet teli dhe bandiera betoni. Nga tërësia e akteve të dosjes rezulton se nuk është kryer investimi sipas planit të biznesit.

Në Kontratën e Qirasë, neni 6 “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, parashikon se: “Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a)Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b)Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të

investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3, parashikon se: “*Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.* Për shkak të mosrealizimit të investimit subjekti detyrohet të paguajë gjobën si më poshtë:

Gjoha për vitin e parë të investimit 2014-2015:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2014-2015): 2,200,000 Euro dhe 29,032,500 lekë.

Vlera e vitit të parë konvertuar në lekë (kursi datës 7.10.2015) 1 Euro = 139.42 Lekë = 306,724,000 lekë (sera) + 29,032,500 lekë (pemëtore) = 335,756,500 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2014/15): 0 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për vitin (2014/15): 335,756,500 lekë – 0 lekë = 335,756,500 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2014/15) = 2 % * 335,756,500 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 6,715,130 lekë.

Gjoha për vitin e dytë të investimit 2015-2016:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2015-2016): 2,200,000 Euro.

Vlera e vitit të dytë konvertuar në lekë (kursi datës 7.10.2016) 1 Euro = 137.23 Lekë = 301,906,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2015/16): 0 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15 dhe 2015/16) = 335,756,500 lekë + 301,906,000 lekë = 637,662,500 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2015/16) = 2 % * 637,662,500 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 12,753,250 lekë.

Gjoha për vitin e tretë të investimit 2016-2017:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2016-2017): 2,200,000 Euro.

Vlera e vitit të tretë konvertuar në lekë (kursi datës 6.10.2017) 1 Euro = 133.81 Lekë = 294,382,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2016/17): 0 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për periudhën (2016/17): 294,382,000 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15; 2015/16 dhe 2016/17) = 335,756,500 lekë + 301,906,000 lekë + 294,382,000 lekë = 932,044,500 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2016/17) = 2 % * 932,044,500 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 18,640,890 lekë.

Gjoha për vitin e katërt të investimit 2017-2018:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2017-2018): 4,400,000 Euro.

Vlera e vitit të katërt konvertuar në lekë (kursi datës 8.10.2018) 1 Euro = 125.52 Lekë = 552,288,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2017/18): 8,916,295.48 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për periudhën (2017/18): 552,288,000 lekë - 8,916,295.48 lekë = 543,371,704.52 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15; 2015/16; 2016/17 dhe 2017/18) = 335,756,500 lekë + 301,906,000 lekë + 294,382,000 lekë + 543,371,704.52 lekë = 1,475,416,204.52 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2017/18) = 2 % * 1,475,416,204.52 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 29,508,324.09 lekë.

Gjoha për vitin e pestë të investimit 2018-2019:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2018-2019): 6,600,000 Euro.

Vlera e vitit të pestë konvertuar në lekë (kursi datës 7.10.2019) 1 Euro = 122.54 Lekë = 808,764,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2018/19): 41,839,839.05 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për periudhën (2017/18): 808,764,000 lekë - 41,839,839.05 lekë = 766,924,160.95 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15; 2015/16; 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19) = 335,756,500 lekë + 301,906,000 lekë + 294,382,000 lekë + 543,371,704.52 lekë + 766,924,160.95 lekë = 2,242,340,365.47 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2018/19) = 2 % * 2,242,340,365.47 lekë (vlera investimeve të përealizuara) = 44,846,807.31 lekë.

Gjoha për vitin e gjashtë të investimit 2019-2020:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2019-2020): 4,400,000 Euro (sera) dhe 200,000 Euro (ambiente për grumbullim dhe përpunim) = 4,600,000 Euro në total.

Vlera e vitit të gjashtë konvertuar në lekë (kursi datës 7.10.2020) 1 Euro = 124.01 Lekë = 570,446,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2019/20): 2,939,024.20 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për periudhën (2019/20): 570,446,000 lekë - 2,939,024.20 lekë = 567,506,975.80 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2014/15; 2015/16; 2016/17; 2017/18; 2018/19 dhe 2019/20) = 335,756,500 lekë + 301,906,000 lekë + 294,382,000 lekë + 543,371,704.52 lekë + 766,924,160.95 lekë + 567,506,975.80 lekë = 2,809,847,341.27 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2019/20) = 2 % * 2,809,847,341.27 lekë (vlera investimeve të përealizuara) = 56,196,946.83 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2020-2021:

Vlera totale e investimit të parashikuar në plan biznes: 22,407,375 Euro ose 2,863,542,500 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar sipas plan biznesit nga periudha (2014-2020): 2,809,847,341.27 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2020/21): 2,860 lekë.

Vlera totale e investimit të përealizuar: 2,809,847,341.27 lekë - 2,860 lekë = 2,809,844,481.27 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2020/21) = 2% * 2,809,844,481.27 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 56,196,889.63 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2021-2022:

Vlera totale e investimit të parashikuar në plan biznes: 22,407,375 Euro ose 2,863,542,500 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar sipas plan biznesit nga periudha (2014-2020): 2,809,844,481.27 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2021/22): 0 lekë.

Vlera totale e investimit të përealizuar: 2,809,844,481.27 lekë - 0 lekë = 2,809,844,481.27 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2021/22) = 2% * 2,809,844,481.27 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 56,196,889.63 lekë. (Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti).

-MBZHR nuk ka ndjekur procedurat përkatëse lidhur me përbushjen e detyrimit për investimin pasi nuk ka përlogaritur penalitetin për mosrealizimin e investimit, nuk ka realizuar njoftimin për përbushjen e detyrimit dhe as zgjidhjen e kontratës.

3.Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezultoi se nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Gjatë monitorimit në terren në datën 13.2.2019, rezultoi se subjekti ka mbjellë në tokat e marra me qira drurë frutorë dhe perime në sera, duke respektuar parashikimet e përcaktuara në kontratë dhe plan biznes. Qiramarrësi ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit.

4. Nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2021/22. Letër Garancia ka Nr. 15560/3 datë 21.1.2021 dhe është i vlefshëm deri në datën 21 Janar 2022. MBZHR me

shkresën Nr. 6496 prot., datë 21.12.2022 në zbatim të nenit 5 “Garancia e Kontratës“ i ka kërkuar subjektit rinovimin e formularit të garancisë së kontratës: *Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar një kopje e garancisë së kontratës për vitin e 2022/23.*

5.Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, protokolluar në MBZHR me Nr. 375 prot., datë 17.1.2020, shkresa me Nr. 209 prot., datë 13.1.2020, shkresa me Nr. 692/1 prot., datë 25.1.2021, shkresa me Nr. 69 prot., datë 7.1.2022, dhe shkresa me Nr. 216 prot., datë 12.1.2023, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. MBZHR, në zbatim të nenit 7, shkronja ‘c’ ka dërguar njoftim me anë të shkresës me Nr. 6496 prot., datë 21.12.2022, për të cilën ka sjellë informacion në MBZHR.

Konstatim

Grupi i auditimit, pas verifikimit të dokumentacionit të dosjes, arrin në këto përfundime:

- Si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

-Vlera prej 281,055,127.48 lekë përbën penalitet për shkak të mosrealizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

-Vlera prej 194,583.74 lekë përbën kamatëvonesë për pagesën e qirasë.

-Vlera prej 281,249,711.22 lekë (281,055,127.48 + 194,583.74) përbën detyrimin total të subjektit “B. A. I.” ShPK. për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

- Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimin e kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se MBZHR nuk ka vendosur penalitet për mosrealizimin e investimit, nuk ka kërkuar prishjen e kontratës dhe nuk ka sekuestruar garancinë. Qëndrimi i MBZHR bie në kundërshtim me dispozitat e mëposhtme:

a) VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pika VII/1 “Monitorimi i Kontratave”, ku parashikohet: “*Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar*”.

b) Nenin 6 të kontratës së qirasë “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, ku parashikohet se: “*Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3*”.

c) Nenin 7 të kontratës së qirasë “Sanksione”, pika 3, ku parashikohet se: “*Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë*”.

d) Nenin 8 të kontratës së qirasë nenit “Sigurimi i garancisë së kontratës” ku parashikohet se: “*Sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate*”.

3- Kontrata nr. 6801/3 prot, Nr. 1719 Rep, Nr. 674 Kol, datë 18.11.2016 lidhur me subjektin “T.A.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 45.8 ha, ndodhur në Zona Kadastrale nr. 2443, parcelat me nr. Pasurie 304/1; nr. 304/2; nr. 304/3; nr. 304/4; nr. 401; nr. 410 dhe nr. 411, Fshati Hadaj, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për ngritjen e kompleksit të gjedhit, kultivimi i bimëve foragjere dhe sigurimi i bazës ushqimore për kompleksion e gjedhit, për një afat 90 (nëntëdhjetë) vjet. Vlera e qirasë është

parashikuar në shumën 563,340 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet) lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për ngritjen e kompleksit të gjedhit, kultivimi i bimëve foragjere dhe sigurimi i bazës ushqimore për kompleksin e gjedhit. Afati i pagesës së qirasë: Paguesa e parë kryhet parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 5 Dhjetor 2016; pagesat e tjera me datën 18 Nëntor të çdo viti pasardhës. Vlera e investimit është përcaktuar 166,700,000 lekë.

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale brenda një jave nga dorëzimi i Pasurisë nga Qiradhënësi. Vlera maksimale e garancisë 3,334,000 lekë. Kontrata është regjistruar në ASHK. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës në përdorim të qiramarrësit në datë 15.11.2018. **Dorëzimi i tokës është kryer me vonesë sepse kontrata është lidhur që me dt.18.11.2016.** Nga ana e MBZHR nuk janë kryer monitorime pas vitit 2018. I vetmi monitorim është ai i kryer në datë 15.11.2018, ky procesverbal i monitorimit është i pa protokolluar.

1. Lidhur me pagimin e qirasë ky subjekt rezulton debitor për principal dhe kamatëvonesa për vitet 2016; 2017; 2021. Referuar shkresës 15.11.2021, shuma totale e detyrimit është në vlerën 645,024.3 lekë. Gjatë auditimit sipas strukturës përgjegjëse në MBZHR këto vlera janë paguar nga ana e qiramarrësit në dt. 11.12.2020 dhe dt. 11.11.2021. **Subjekti nuk rezulton debitor në lidhje me pagesën e detyrimeve në lidhje me qiratë vjetore.**

2. U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit, lidhur me këtë komponent rezulton: Vlera e investimit është përcaktuar 166,700,000 lekë.

Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit):

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Rezulton se subjekti i ka ndërtuar dy stalla dhe në ndërtim ishte stalla e tretë me kapacitet prej 300 krerësh, por këto stalla nuk janë ngritur në sipërfaqen e marrë me qira, me argumentimin se nuk i është dorëzuar sipërfaqja në përdorim nga qiramarrësi.

Nga SBPMK sqarohet se: Në ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” në kohën e nënshkrimit të kontratës **nuk ka qenë e parashikuar dhe lejuar ndërtimi i objekteve në funksion të aktiviteteve bujqësore apo blegtorale.**

Gjithashtu në Vendimin Nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, nuk ka qenë e parashikuar zhvillimi i aktivitetit blegtoral në tokën bujqësore në pronësi të shtetit të marrë me qira.

Këto mungesa parashikimesh kanë sjellë pengesë të qiramarrësit që të pajiset me leje përkatëse, referuar Vendimit Nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar dhe akteve të tjera në fuqi, për ndërtimin e stallave të parashikuara. Subjekti në momentin e nënshkrimit të kontratës së qirasë ka bërë porosinë e gjedhëve të parashikuara (për të cilat disponon dhe ka paraqitur fatura blerjeje) dhe në kushtet e pamundësisë së ndërtimit të këtyre stallave jo për fajin e tij, por për mungesë parashikimi në legjislacionin në fuqi të kohës për qiramarrjen e tokës bujqësore në pronësi të shtetit, është detyruar të gjejë një zgjidhje alternative duke blerë një sipërfaqe toke dhe ndërtuar stallat e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit blegtoral.

Me konstatimin e këtyre problematikave në këto qiramarrje (sqarojmë se këtë problematikë e kanë dhe disa subjekte të tjera) u propozua nga MBZHR ndryshimi i Ligjit Nr. 8318, datë 1.4.1998, konkretisht me Ligjin Nr. 65/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i cili në Nenin 2, parashikon se:

Pas nenit 16 shtohen nenet 16/1 dhe 16/2 me përmbajtje, si vijon, Nenin 16/1:

Në rastet kur në tokat bujqësore në administrim të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, objekt i qiradhënies, qiramarrësi kërkon të ndërtojë objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale apo objekte në funksion të agroturizmit, për të cilat kërkohet

leje ndërtimi dhe kategoria e resursit ndryshon nga “tokë bujqësore” në “truall”, qiradhënësi mund të japë miratimin, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

Ndërtimi i objekteve të parashikuara në kërkesë të jetë në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet e planifikimit të territorit;

Sipërfaqja ndërtimore të shërbejë vetëm për objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, të tokës bujqësore, objekt i qiradhënies ose për ngritjen e objekteve ndërtimore në funksion të agroturizmit.

Nuk lejohet në asnjë rast ndryshimi i destinacionit të objektit të ndërtuar sipas këtij ligji.

1. Për sipërfaqen ndërtimore “truall”, të miratuar sipas pikës 1 të këtij neni, aplikohet i njëjti çmim i qiradhënies si për tokën bujqësore.

Sa më sipër për subjektin “T.-A.” ShPK, ka qenë e pa mundur të procedonte me përmbushjen e investimeve të planifikuara në planin e biznesit, pasi Ligji Nr. 65/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe Kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, është shpallur me Dekretin me Nr. 10897, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, ose rreth 2 vite më vonë nga nënshkrimi i kontratës së qiradhënies midis MBZHR dhe subjektit “T.-A.” ShPK.

Për shkak të dinamikës së biznesit, pamundësisë për të ndërtuar në tokën e marrë me qira dhe nevojës për të ndërtuar objektet (pasi lopët ishin blerë) subjekti i ka ndërtuar ato në një ambient dhe sot ferma përbëhet nga rreth 900 krerë gjedhë, duke rritur prodhimin e produkteve blegtorale cilësore vendase.

Në vijim të kësaj nga subjekti është kërkuar me shkresën protokolluar në MBZHR me nr. 5050 prot., datë 07.07.2021 amendimi i kontratës së qirasë, e cila ende nuk është miratuar.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3, parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjorbë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”. Referuar neneve të mësipërme dhe planit të biznesit, pjesë përbërëse e saj, qiramarrësi duhet të fillonte përmbushjen e tyre, sipas sasive dhe afateve. Subjekti qiramarrës rezultoi se ka kryer investim, por jo në tokën e dhënë nga MBZHR. Nga procesverbali i monitorimit kryer në datën 06.04.2023, dhe protokolluar me Nr. 2071/2 Prot., datë 10.04.2023 në fshatin Hadaj, Bashkia Fier, qarku Fier, nga Struktura Përgjegjëse e Monitorimit, përfaqësuar nga M. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave, z. E. Q. dhe znj. M.A., specialistë në këtë sektor, citohet se.....se një pjesë e sipërfaqes së tokës ishte mbjellë me foragjere të cilat do të shërbenin ushqim për lopët, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes së tokës ishte (pluguar dhe po përgatitej për tu mbjellë me foragjere të stinës). Rrugët që të çojnë në parcela ishin të pastruara, shtruar me çakull dhe stabilizant. Kanalet kulluese (të çdo niveli) ishin të pastruara dhe të veshura me beton për të tërhequr ujrë. Ishin ndërtuar disa ura lidhëse nëpër parcela midis kanaleve. Ishte shtrirë sistemi i ujitjes (tuba, bryla, fasheta, pompa, etj). Subjekti ka blerë të gjitha makineritë dhe pajisjet e parashikuara dhe ishte ngritur në park me makineri dhe pajisje bujqësore (traktor, plug, frezë, kultivator, bot për shpërndarjen e plehut, kamion për transport, eskavator, rimorkio, impiant mjelje, makineri të ndryshme bujqësore, pompa uji, etj).

Sipas plan biznesit të miratuar në procedurën konkurruese subjekti “T.-A.” ka parashikuar investime në vlerën totale prej 166,700,000 lekë të shpërndarë nëpër vite. (Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti).

Vitin e parë (2016/17) subjekti ka parashikuar investime në zërat si më poshtë:

Traktor

Plugje

Rimorkio

Kamion transporti

Sistemim sipërfaqësor

Pastrim kanale kulluese
Instalimi i rrjetit të ujitjes

Totali i investimeve të parashikuar 9,050,000 lekë

Referuar vitit të parë të investimit (2016/2017) subjekti ka paraqitur në MBZHR fatura me punime të kryera në vlerën 48,158,147.69 lekë. (paraqitur në aneksin bashkëlidhur këtij raporti në pikën 2.3/b.)

Në vitin e dytë (2017/2018) të investimit janë parashikuar investime si më poshtë:

Traktor
Plugje
Freza
Kultivatorë
Traktopompa spërkatëve
Rimorkio
Impjant mjelje për 300 krerë,
Rrugë të brendshme
Sistemim sipërfaqësor
Instalimi i rrjetit të ujitjes
Pompa
Ndërtim stalle për 300 krerë,
Blerje meshqerra
Ndërtim mjedisi për bazë ushqimore
Ndërtim pleherishte e impjante përpunimi për plehërat

Totali i investimeve të parashikuar 124,650,000 lekë

Sipas faturave të paraqitura nga subjekti rezulton se janë blerë makineri & pajisje dhe kryer investime në vlerën 81,859,161.58 lekë, sipas tabelës paraqitur në aneksin bashkëlidhur këtij PRA në pikën 2.3/b.

Në vitin e tretë (2018/2019) të investimit janë parashikuar investime si më poshtë:

Impjant mjelje për 300 krerë
Rrugë të brendshme
Ndërtim mjedisi për bazë ushqimore
Ndërtim pleherishte e impiante përpunimi për plehërat

Totali i investimeve të parashikuara 33,000,000 lekë

Sipas faturave të paraqitura nga subjekti rezulton se janë kryer investime në vlerën 51,695,329.16 lekë..(paraqitur në aneksin bashkëlidhur këtij projekt raporti në pikën 2.3/b.)
(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi).

Për sa më sipër:

Subjekti nuk rezulton debitor në pagesën e qirasë vjetore të tokës së marrë me qira;

- Subjekti ka treguar se ka pasur dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të realizuar investimin e planifikuar;
- Ligji Nr. 65/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8318, Datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, është miratuar rreth 2 vite më vonë nga nënshkrimi i kontratës së qiradhënies Nr. 6801/3 prot., Nr. 1717 Rep., Nr. 874 Kol., datë 18.11.2016, midis MBZHR dhe subjektit “T.-A.” ShPK;

4- Kontrata nr. 2658 Prot., datë 27/3/2015 e lidhur me qiramarrësin subjektin “B.F.” ShPK., ndryshuar me Amendimin me Nr. 11093 prot., Nr. 4394 Rep., Nr. 906 Kol., datë 16.12.2020.

Objekti i kontratës është dhënia me qira e sipërfaqes 123.58 ha, vendndodhja, pasuritë nr. 120, 123, 124, 130, 131, 132, 134, 135, 136, 137, 151, Zona Kadastrale 1430, fshati Çukë, qarku Vlorë. Kontrata është amenduar me Nr.11093 Prot., Nr. 4394 Rep., Nr. 906 Kol., datë 16/12/2020, ka ndryshuar aktiviteti. Kohëzgjatja: 60 (gjashtëdhjetë) vjet. Aktiviteti: Krijimin e veprimtarisë blegtorale, që përfshin ndërtimin e stallave, hangarëve, baxhos për përpunimin e qumështit dhe të nënprodukteve të tij, ndërtimin e sillozëve dhe vendgrumbullimeve të silazhit të përpunuar, ambiente për gropën e plehut organik. Infrastrukturë mbështetëse që përfshin ndërtimin e zyrave për administratën, mensës dhe dhomës së punëtorëve. Mbarështimin e shpendëve, që përfshin ngritjen e ambienteve për rritjen e pulave. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 4,325,300 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për mbjelljen e bimëve foragjere (ushqim për pularinë dhe fermën blegtorale) dhe infrastrukturës grumbulluese, përpunuese dhe ambalazhuese në funksion të fermës blegtorale. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 10 prill 2015; pagesat e tjera brenda datës 27 mars të vitit përkatës. Vlera e investimit është përcaktuar 413,562,509 lekë.

Nga MBZHR është kryer monitorimi pasqyruar në procesverbalin datë 6.12.2022, protokolluar me Nr. 6203/2 datë 23.12.2022, nga Struktura Përgjegjëse për monitorim e përbëra nga M. K., E. Q. dhe A. Z. Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 1 % të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 4,135,625 lekë. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës. Kontrata është regjistruar në ASHK.

1.Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton se subjekti rezulton se ka paguar në kohë vlerën e qirasë vjetore.

2.Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton se Qiramarrësi ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit. Nga MZHBR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Sipas Procesverbalit të monitorimit të mbajtur në datën 5.2.2019, dhe Procesverbalit të monitorimit të kryer në datën 6.12.2022, protokolluar me Nr. 6203/2 datë 23.12.2022, rezultoi se në terren janë mbjellë bimë foragjere (ushqim për pularinë dhe fermën blegtorale) dhe ndërtuar infrastrukturë grumbulluese, përpunuese dhe ambalazhuese në funksion të fermës blegtorale, duke respektuar parashikimet e përcaktuara në kontratë dhe plan biznes.

Subjekti “B.F.” ShPK., me shkresën Nr. 6089 prot., datë 30.11.2022 të protokolluar në MBZHR, ka kërkuar amendimin e kontratës dhe përshtatjen e plan biznesit me kontekstin e ri ekonomik, të krijuar pas pandemisë Covid-19, mungesës së punonjësve të kualifikuar, etj.

3.MBZHR me shkresën Nr. 8525/1 prot., datë 21.9.2018 dhe me shkresën Nr. 6696 prot., datë 30.12.2022, në zbatim të nenit 5 “Garancia e kontratës“ pika 1, i ka kërkuar subjektit rinovimin e formularit të garancisë së kontratës. Formulari i Garancisë së Kontratës ka Nr. 89 datë 8.2.2023 dhe është i vlefshëm deri në datën 8.2.2024.

4.Për realizimin e investimit Nga MBZHR janë kryer dy verifikime në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit. Sipas procesverbalit të monitorimit të mbajtur në datën 5.2.2019 nga Struktura Përgjegjëse për monitorim e përbëra nga znj. M. K. dhe znj. H. M., rezultoi se subjekti kishte punuar rreth 117 ha tokë, kishte nisur blerjen e makineri dhe pajisjeve, nisjen e punimeve në infrastrukturë, etj. Nga Procesverbali i monitorimit të kryer në datën 6.12.2022, protokolluar me Nr. 6203/2 datë 23.12.2022, nga Struktura Përgjegjëse për monitorim e përbëra nga znj. M. K., z. E. Q. dhe z. A.Z., rezultoi se ishin ndërtuar dy stalla për lopët, ishte ndërtuar linja e stallave dhe mjeljes së lopëve, ishte ndërtuar baxhoja për përpunimin e qumështit, ndërtimi i hangarit të mjeteve bujqësore, godina e administratës, ishin ndërtuar 4 sillosa, një kapanon pularie, ishte mbjellë toka bujqësore me misër, etj. Gjatë periudhës (Qershor 2020 deri në periudhën Shtator 2022) subjekti ka realizuar 115,316,503 lekë.

5. Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. MZHBR, në zbatim njoftim me anë të

shkresës me Nr. 8425 prot., datë 29.12.2021 dhe Nr. 6696 prot., datë 30.12.2022, të nenit 5, pika 4, ka dërguar për përmbushjen e raportimit periodik. Referuar Shkresës Nr. 6696 prot., datë 30.12.2022, subjekti nuk ka përcjellë informacionin e kërkuar.

5- Kontrata e Qirasë nr. 5841 prot., nr. 1594 Rep., nr. 453/5 Kol., datë 15.7.2015 me palë qiramarrëse shoqëria “K.D.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore në pronësi të shtetit, me sipërfaqe prej 25.33 ha, në Zonën Kadastrale 2925, pasuria nr. 643/59 ndodhur në fshatin Përrenjas, Bashkia Përrenjas, qarku Elbasan, me qëllim kultivimin, prodhimin dhe përpunimin e rrushit, për një afat 90 (nëntëdhjetë) vjet. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 702,908 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për kultivimin, prodhimin dhe përpunimin e rrushit. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 28 korrik 2015; pagesat e tjera me datën 14 Korrik të çdo viti pasardhës. Ka një mospërputhje në vlerën e investimit. **Vlera e investimit është përcaktuar 137,100,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës dhe 141,500,000 lekë sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim.** Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale brenda një jave nga dorëzimi i Pasurisë nga Qiradhënësi. Vlera maksimale e garancisë 2,742,000 lekë. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës me datë 4.8.2015. Kontrata është regjistruar në ASHK. Për periudhën objekt auditimi në dosje nuk rezultoi që MBZHR të ketë kryer monitorim të subjektit. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës me datë 4.8.2015.

Në dosje gjendet procesverbali i monitorimit të kontratës nr. 146 prot, date 11.02.2019 i mbajtur nga struktura përgjegjëse për monitorim e përbërë nga: H.M.; M.K.; M. S.. Ky procesverbal është nënshkruar dhe nga ana e subjektit, shoqërisë “K. D.” ShPK. Në dosje ndodhet dhe shkresa “Raporti mbi realizimin e investimeve të subjektit shoqëria “K.D.” SHPK e cila është e pa protokolluar dhe pa datë.

1. Në lidhje me qiranë në nenin 7 “Sanksione” të Kontratës së Qirasë, parashikohet se “*Qiramarrësi, paguan gjorbë në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë*”. Referuar shkresës nr. 3790 prot, dt. 13.07.2022 të përlllogaritur nga MBZHR totali i kamatëvonesave është si më poshtë:

-Totali kamatave për vitin 2016 = 13 ditë * 3,514.54 lekë(kamatë ditore) = 45,689 lekë

-Totali kamatave për vitin 2017 = 230 ditë * 3,514.54 lekë(kamatë ditore) = 808,344.2 lekë

-Totali kamatave për vitin 2018 = 4 ditë * 3,514.54 lekë(kamatë ditore) = 14,058.16 lekë

-Totali kamatave për vitin 2020 = 80 ditë * 3,514.54 lekë(kamatë ditore) = 281,163.2 lekë

Duke qenë se janë paguar 1,124,661 lekë kamatëvonesa ndër vite ato do të zbriten nga totali i kamatëvonesave: 1,149,254.6 (kamatëvonesa total) - 1,124,661 (kamatëvonesa të paguara)= 24,593.6 lekë kamatëvonesa të papaguara nga subjekti “K. D.” ShPK.

2.Subjekti “K.D.” ShPK., ka realizuar pjesërisht dhe jo brenda afateve të parashikuara investimin e programuar në plan biznes. Me dorëzimin e sipërfaqes së dhënë me qira qiramarrësi referuar parashikimeve të kontratës dhe planit të biznesit, pjesë përbërëse e saj, duhet të fillonte përmbushjen e tyre, sipas sasive dhe afateve. Subjekti qiramarrës nuk ka kryer asnjë investim në sipërfaqen e marrë me qira, si dhe në dosje nuk gjenden dokumente justifikues (fatura) dorëzuar në MBZHR apo dokument tjetër provues për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Në planin e biznesit bashkëlidhur kontratës parashikohen investime në shumën prej 137,100,000 lekë. Investimi ishte parashikuar të kryhej brenda 4 viteve nga nënshkrimi i kontratës dhe duhet të ishte realizuar deri më datë 15.07.2019.

3. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit është kryer sigurimi i kontratës, Formulari i Sigurimit të Kontratës me Numër Serie & fature: 59124473, datë 6.8.2018, lëshuar nga kompania e sigurimit “A.” sha me afat vlefshmërie deri në zbatimin e plotë të kontratës së qirasë.

4. Qiramarrësi ka kërkuar amendimin e kontratës së qirasë me shkresat: Datë 27.5.2019, protokolluar në MBZHR me Nr. 4609 prot., datë 10.6.2019, ka kërkuar ngritjen e një magazine bujqësorë për magazinimin, ruajtjen seleksionimin e prodhimit (rrushit); Nr. 5 prot., datë 3.9.2020, protokolluar në MBZHR me Nr. 7020 prot., datë 4.9.2020 shtimin e objektit me aktivitetin e agro turizmit, kërkesë e cila është shqyrtuar dhe refuzuar; Nr. 12 prot., datë 26.4.2021, protokolluar në MBZHR me Nr. 3305 prot., datë 30.4.2021 shtimin e një strukture dykatëshe me papafingo me ambiente ndihmëse në funksion të strukturës akomoduese, kërkesa të cilat nuk janë shqyrtuar. Qiramarrësi ka bërë kërkesa të vazhdueshme për amendim kontrate por nuk ka marrë përgjigje dhe vetëm në një rast është informuar me memo titullari.

5. Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti ka depozituar raporte periodike mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, me shkresat me datë 1.3.2018, protokolluar në MBZHR me Nr. 2308 prot., datë 2.3.2018; datë 10.9.2018, protokolluar në MBZHR me Nr. 8478/1 prot., datë 12.9.2018; datë 7.1.2019, protokolluar në MBZHR me Nr. 146 prot., datë 8.1.2019; Nr. 1 prot., datë 9.1.2020, protokolluar në MBZHR me Nr. 10063/1 prot., datë 19.1.2020; Nr. 2 prot., datë 21.1.2021, protokolluar në MBZHR me Nr. 905 prot., datë 25.1.2021; Nr, 30 prot., datë 6.1.2022. MZHBRR, në zbatim të nenit 5, pika 4 ka dërguar njoftim me anë të shkresave me Nr. 8478 prot., datë 31.8.2018; Nr. 11691 prot., datë 26.12.2018, Nr. 10063 prot., datë 30.12.2019; Nr. 8347 prot., datë 24.12.2021; Nr. 30/1 prot., datë 25.03.2022, Nr. 6694 prot., datë 30.12.2022, për përmbushjen e raportimit periodik. Në Kontratën e Qirasë, në nenin 6 *“Zgjidhja e kontratës”*, pika 5, shkronjat *“a”* dhe *“b”*, parashikohet se: *“a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet se Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3”*.

Në Kontratën e Qirasë, Neni 7 *“Sanksione”*, pika 3 parashikon se: *“Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”*. MBZHR nuk ka përllogaritur penalitetet sipas neneve të mësipërme. Subjekti duhet paguajë gjobë në vlerat në vijim:

Gjoba për vitin e parë të investimit 2015 - 2016:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2015/16 (investime): 30,250,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për periudhën 2015/16: 30,250,000 lekë – 0 (Realizim) = 30,250,000 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 30,250,000 lekë (vlera investimeve të porealizuara deri 2016) = 605,000 lekë.

Gjoba për vitin e dytë të investimit 2016 - 2017:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2016/17 (investime): 57,650,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2016/17: 5,262,900.45 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për periudhën (2016-2017): 57,650,000 lekë – 5,262,900.45 lekë = 52,387,099.55 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16 dhe 2016/17) = 30,250,000 lekë + 52,387,099.55 lekë = 82,637,099.55 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 82,637,099.55 lekë (vlera e investimeve të porealizuara deri 2017) = 1,652,741.99 lekë.

Gjoba për vitin e tretë të investimit 2017 - 2018:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2017/18 (investime): 32,600,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2017/18: 5,229,560 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për vitin (2017-2018): 32,600,000 lekë – 5,229,560 lekë = 27,370,440 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16; 2016/17 dhe 2017/18) = 30,250,000 lekë + 52,387,099.55 lekë + 27,370,440 lekë = 110,007,539.55 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 110,007,539.79 lekë (vlera e investimeve të përealizuara deri 2018) = 2,200,150.79 lekë.

Gjoha për vitin e katërt të investimit 2018 - 2019:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2018/19 (investime): 16,600,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2018/19: 7,933,153.53 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për vitin (2018-2019): 16,600,000 lekë – 7,933,153.53 lekë = 8,666,846.48 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16; 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19) = 30,250,000 lekë + 52,387,099.55 lekë + 27,370,440 lekë + 8,666,846.48 lekë = 118,674,386.03 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 118,674,386.03 lekë (vlera e investimeve të përealizuara deri 2019) = 2,373,487.72 lekë.

Gjoha për vitin e pestë të investimit 2019 - 2020:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 137,100,000 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar në vitin 2019/2020 (duke zbritur të gjitha faturat deri 2018/19): 118,674,386.03 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2019-2020: 13,724,216 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar në total: 118,674,386.03 lekë – 13,724,216 lekë = 104,950,170.03 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 104,950,170.03 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 2,099,003.40 lekë.

Gjoha për vitin e gjashtë të investimit 2020 - 2021:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 137,100,000 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar në vitin 2020/2021 (duke zbritur të gjitha faturat deri 2019/20): 104,950,170.03 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2020-2021: 882,560 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar në total: 104,950,170.03 lekë – 882,560 lekë = 104,067,610.03 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 104,067,610.03 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 2,081,352.20 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2021 - 2022:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 137,100,000 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar në vitin 2021/2022 (duke zbritur të gjitha faturat deri 2020/21): 104,067,610.03 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2021-2022: 7,759,962 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar në total: 104,067,610.03 lekë – 7,759,962 lekë = 96,307,648.03 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 96,307,648.03 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 1,926,152.96 lekë.

Sa më lart subjekti duhet të paguajë gjobë totale në vlerën 12,937,889.06 lekë. MBZHR nuk ka përlogaritur penalitete e mësipërme ndaj qiramarrësit. Gjatë kohës së kryerjes së auditimit nga ana e MBZHR subjektit i është dërguar shkresë për penalitetet lidhur me mosrealizimin e investimeve. Gjithashtu ky institucion nuk ka realizuar zgjidhjen e kontratës detyrim që rrjedh nga e njëjta dispozitë kontraktore.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 12,937,889.06 lekë përbën penalitetet për shkak të mosrealizimit të investimeve sipas planit të biznesit.
- Vlera prej 24,593.6 lekë përbën kamatëvonesa të papaguara.
- Vlerat totale e detyrimit të subjektin “K. D.” ShPK. është 12,962,482.66 lekë.

- Për këtë MBZHR, referuar parashikimeve të kontratës së qirasë, konkretisht Nenit 6, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, në të cilin shprehet se “a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet se Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3 dhe Nenit 7, pika 3, ku parashikohet se “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”, ka llogaritur gjobën dhe penalitetet dhe ka njoftuar subjektin me shkresën me Nr. 1322 prot., datë 27.02.2023 “Mbi përmbushjen e detyrimeve të kontratës së qirasë”.

Po në këtë shkresë i është bërë me dije se në rast se, subjekti nuk i përmbush këto detyrime, atëherë MBZHR do të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për vjeljen e këtyre detyrimeve si dhe do të vazhdojë me zbatimin e kushteve të parashikuara në Kontratë. (Bashkëngjitur shkresa nr. 1322 prot., datë 27.2.2023 “Mbi përmbushjen e detyrimeve të kontratës së qirasë” dhe Raportin mbi realizimin e investimeve të kryera nga subjekti.)

6- Kontrata e qirasë Nr. 4040 Prot., Nr. 793 Rep., Nr. 473 Kol., datë 12.05.2015, me palë qiramarrëse subjektin “B.N.F.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 49.8402 ha, e përbërë prej ngastrave me numra pasurie: 53/ 5; nr. 54/ 2; nr. 55/ 1; dhe nr. 129/ 2, Zona Kadastrale nr. 2511, me vend ndodhje Komuna Papër, qarku Elbasan, me qëllim ngritjen dhe kultivimin e bllokut me shegë, për një afat 30 (tridhjetë) vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 652,907 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për ngritjen dhe kultivimin e bllokut me shegë. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 25 Maj 2015; pagesat e tjera në datën 11 Maj të çdo viti pasardhës. **Vlera e investimit është përcaktuar 33,740,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës por ka mospërputhje dhe paqartësi në plan biznes, (në disa pjesë përshkruhet se vlera e investimit është 887,000 Euro dhe në disa pjesë vlera e investimit rezulton 607,000 Euro).**

Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit, bashkëlidhur amendimit të kontratës së qirasë):

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale brenda një javë nga dorëzimi i Pasurisë nga Qiradhënësi. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës me anë të procesverbalit nr. 2700/2 prot datë 24.11.2015. Kontrata nuk është regjistruar në ASHK. Qiramarrësi nuk ka kryer investimet sipas plan biznesit të parashikuara, pasi sipërfaqja prej 5 ha është e zaptuar nga fermerë të ndryshëm dhe nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi. Gjithashtu një pjesë e sipërfaqes, e cila ndodhet pranë një Reparti Ushtarak nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi, pasi nuk lejohet nga struktura e repartit me pretendimin se është zonë ushtarake. Subjekti pretenduar se rreth 28.84 ha tokë është e zaptuar.

1. Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton se subjekti është debitor sepse nuk ka paguar që nga viti 2016 e në vazhdim kamatëvonesat. (Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Pagesat e qirasë dhe kamatëvonesave janë kryer në datat:

Datë 18.05.2015 vlerën 652,907 lekë;

Datë 10.10.2017 vlerën 1,305,814 lekë;

Datë 4.12.2018 vlerën 674,800 lekë kamatëvonesë;

Datë 7.3.2019 vlerën 652,907 lekë;

Datë 3.10.2020 vlerën 100,000 lekë;

Në nenin 7 “Sanksione” pika 1, të Kontratës së Qirasë, parashikohet se: “*Qiramarrësi, paguan gjorbë në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë*”. Në zbatim të parashikimeve të sipërcituara rezulton si vijon:

-Kamatëvonesat për vitin 2016

Për vitin 2016 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2016. Pagesa është kryer në datën 10.10.2017 pra 517 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vitin 2016 = 517 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 1,687,764.60 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2017.

Për vitin 2017 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2017. Pagesa është kryer në datën 10.10.2017 pra 152 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vitin 2017 = 152 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 496,209.32 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2018.

Për vitin 2018 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2018. Pagesa është kryer në datën 7.3.2019 pra 300 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vitin 2018 = 300 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 979,360.50 lekë.

Duke qenë se është paguar në datën 4.12.2018, vlera prej 674,800 lekë kamatëvonesa mbetet pa paguar në shumën 304,560.50 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2019

Për vitin 2019 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2019. Pagesa nuk është kryer akoma deri në datën 31.12.2022.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vitin 2019 = 1330 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 4,341,831.55 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2020

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2020. Një pjesë prej 100,000 lekësh është paguar më datën 3.10.2020, pjesa tjetër prej 552,907 lekësh nuk është paguar deri në datë 31.12.2022. Pra kemi 145 dite vonesë për vlerën e plotë të qirasë dhe 871 dite për vlerën e mbetur prej 552,907 lekë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vlerën e plotë = 145 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 473,357.58 lekë.

1 ditë vonesë = (principal i mbetur) * 0.5% = 552,907 * 0.5% = 2,764.54 lekë.

Totali kamatave për vlerën e mbetur = 819 ditë * 2,764.54 lekë (kamatë ditore) = 2,264,154.17 lekë.

Totali kamatave për vitin 2020 = 473,357.58 + 2,264,154.17 = 2,737,511.74 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2021

Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2021. Pagesa nuk është kryer akoma deri sot datë 31.12.2022, pra deri tani jeni 599 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vitin 2021 = 599 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 1,955,456.47 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2022

Për vitin 2022 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 11.5.2022. Pagesa nuk është kryer akoma deri sot datë 31.12.2022, pra deri tani jeni 234 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 652,907 * 0.5% = 3,264.54 lekë.

Totali kamatave për vitin 2021 = 234 ditë * 3,264.54 lekë (kamatë ditore) = 763,901.19 lekë.

-Aktualisht ky subjekt rezulton debitor në shumën 14,798,863.38 lekë [2,511,628 (qira e pashlyer) + 12,287,235.38 (kamatëvonesa)].

2. Nga grupi i auditimit u verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit:

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Në Kontratën e Qirasë, neni 6 “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, parashikon se: “Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3, parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.

Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me realizimin e investimeve. Gjatë monitorimit në terren me datë 10.1.2018 ka rezultuar se 5 ha tokë janë zënë nga fshatarët, por janë lënë në mirëkuptim nga ana e shoqërisë, sipërfaqe prej 20 ha është mbjellë me kulturën e shegës, e llojit “Wandefull”.

Gjoha për vitin e parë të investimit 2015-2016:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2015-2016): 473,000 Euro.

Vlera e vitit të parë konvertuar në lekë (kursi datës 12.5.2015) 1 Euro = 140.75 Lekë = 66,574,750 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2015/16): 3,111,075 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për vitin (2015/16): 66,574,750 lekë – 3,111,075 lekë = 63,463,675 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2015/16) = 2 % * 63,463,675 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 1,269,273.50 lekë.

Gjoha për vitin e dytë të investimit 2016-2017:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2016-2017): 45,000 Euro.

Vlera e vitit të dytë konvertuar në lekë (kursi datës 12.5.2016) 1 Euro = 138.52 Lekë = 6,233,400 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2016/17): 1,518,000 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për vitin (2016/17): 6,233,400 lekë – 1,518,000 lekë = 4,715,400 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16 dhe 2016/17) = 63,463,675 lekë + 4,715,400 lekë = 68,179,075 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2016/17) = 2 % * 68,179,075 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 1,363,581.50 lekë.

Gjoha për vitin e tretë të investimit 2017-2018:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2017-2018): 75,000 Euro.

Vlera e vitit të tretë konvertuar në lekë (kursi datës 12.5.2017) 1 Euro = 134.24 Lekë = 10,068,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2017/18): 240,000 lekë.

Vlera e investimit të porealizuar për periudhën (2017/18): 10,068,000 lekë – 240,000 lekë = 9,828,000 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16; 2016/17 dhe 2017/18) = 63,463,675 lekë + 4,715,400 lekë + 9,828,000 lekë = 78,007,075 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2017/18) = 2 % * 78,007,075 lekë (vlera investimeve të porealizuara) = 1,560,141.50 lekë.

Gjoha për vitin e katërt të investimit 2018-2019:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin (2018-2019): 14,000 Euro.

Vlera e vitit të katër konvertuar në lekë (kursi datës 12.5.2018) 1 Euro = 126.94 Lekë = 1,777,160 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën (2018/19): 18,641,820 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për periudhën : 0 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16; 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19) = 63,463,675 lekë + 4,715,400 lekë + 9,828,000 + 1,777,160 lekë – 18,641,820 lekë = 61,142,415 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2018/19) = 2 % * 61,142,415 lekë (vlera investimeve të përealizuara) = 1,222,848.30 lekë.

Gjoha për vitin e pestë të investimit 2019-2020:

Vlera totale e investimit të parashikuar në plan biznes: 607,000 Euro ose 84,653,310 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar sipas plan biznesit nga periudha (2015-2019): 61,142,415 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2019/20): 0 lekë.

Vlera totale e investimit të përealizuar: 61,142,415 lekë – 0 lekë = 61,142,415 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2019/20) = 2% * 61,142,415 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 1,222,848.30 lekë.

Gjoha për vitin e gjashtë të investimit 2020-2021:

Vlera totale e investimit të parashikuar në plan biznes: 607,000 Euro ose 84,653,310 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar sipas plan biznesit nga periudha (2015-2020): 61,142,415 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2020/21): 0 lekë.

Vlera totale e investimit të përealizuar: 61,142,415 lekë – 0 lekë = 61,142,415 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2020/21) = 2% * 61,142,415 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 1,222,848.30 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2021-2022:

Vlera totale e investimit të parashikuar në plan biznes: 607,000 Euro ose 84,653,310 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar sipas plan biznesit nga periudha (2015-2021): 61,142,415 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2021/22): 0 lekë.

Vlera totale e investimit të përealizuar: 61,142,415 lekë – 0 lekë = 61,142,415 lekë.

Vlera e gjobës për vitin (2021/22) = 2% * 61,142,415 lekë (vlera e investimeve të përealizuara) = 1,222,848.30 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

3. Nga MZHBR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Subjekti në sipërfaqen prej 20 ha kishte mbjellë shegë, e llojit “Wandefull”, e moshës tre vjeçare, mbjellë me fidanë 16 muajsh. Sipërfaqja prej 10 ha ishte e mbjellë me kulturën e fikut (këtë kulturë qiramarrësi e ka mbjellë për provë), i cili është në vitin e gjashtë. Qiramarrësi nuk e ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit, ka ndryshuar kulturën pa miratimin e Qiradhënësit, 10 ha i ka mbjellë me kulturën e fikut.

4.Lidhur me garancinë e kontratës: Nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për periudhën 2016 - 2017 me afat vlefshmërie deri më datë 10.1.2017 dhe 2017 - 2018 me afat vlefshmërie deri më datë 17.1.2018. Me shkresat me Nr. 8526/1 prot., datë 21.9.2018 dhe Nr. 6146 prot., datë 2.9.2021, por subjekti nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës së qirasë.

5.Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton: Subjekti ka depozituar raporte periodike mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. MZHBR, në zbatim të nenit 5, pika 4 ka dërguar njoftim me anë të shkresave me Nr. 8526 prot., datë 3.9.2018; Nr. 11694 prot., datë 26.12.2018, Nr. 10050 prot., datë 30.12.2019; Nr. 683 prot., datë 19.1.2021, Nr. 8428 prot., datë 29.12.2021, Nr. 6531 prot., datë 22.12.2022, për përmbushjen e raportimit periodik. Subjekti Qiramarrës ka dërguar informacion me shkresat: Nr.1 prot., datë 8.1.2022, protokolluar në MBZHR me Nr. 343 prot., datë 17.1.2022.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 9,084,389.70 lekë përbën penalitetet për shkak të mos realizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

- Subjekti rezulton debitor në shumën 14,798,863.38 lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa.

Vlera prej 23,883,253.08 lekë përbën detyrimin total të subjektit “B.N. F.” ShPK. për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

-Gjatë periudhës së auditimit MBZHR nuk ka ndjekur në kohë procedurat përkatëse lidhur me shlyerjen e qirasë dhe kamatëvonesave, me përmbushjen e detyrimit për investim, nuk ka përllogaritur penalitetin për mosrealizimin e investimit, nuk ka realizuar njoftimin për përmbushjen e detyrimit dhe as zgjidhjen e kontratës. Gjatë kohës së kryerjes së auditimit nga ana e MBZHR subjektit i është dërguar shkresë me **nr. 1647 prot., datë 13.3.2023, lënda “Mbi përmbushjen e detyrimeve të kontratës së qirasë”** për penalitetet lidhur me mos realizimin e investimeve. Nga auditimi u konstatua se MBZHR nuk ka ndjekur në afatet e parashikuara procedurat përkatëse lidhur me shlyerjen e qirasë dhe kamatëvonesave, me përmbushjen e detyrimit për investim, nuk ka përllogaritur penalitetin për mosrealizimin e investimit, nuk ka realizuar njoftimin për përmbushjen e detyrimit dhe as zgjidhjen e kontratës, veprime në kundërshtim me VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pika VII/1 “Monitorimi i Kontratave”, ku parashikohet: *“Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar”*. Gjithashtu MBZHR ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, pika 5 dhe nenin 7, pika 3 të kontratës.

7- Kontrata e Qirasë Nr.293 Prot., datë 14.1.2015 lidhur me qiramarrësin subjektin “B.P.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 12.8249 ha, pasuritë nr. 228/1; nr. 228/2; nr. 228/3; nr. 228/4; nr. 228/5; nr. 228/6; nr. 228/7; nr. 228/8; nr. 228/9; nr. 228/10; nr. 228/11; nr. 228/12; nr. 228/13; Zona Kadastrale nr. 1582, fshati Zhamë Sektor, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier, kohëzgjatja: 90 (nëntëdhjetë) vjet. Aktiviteti: kultivimi dhe përpunimi i shegës. Vlera e qirasë vjetore: 352,685 lekë/total/vit. Afati i pagesës së qirasë, brenda datës 12 Janar të çdo viti. (vonesa në pagesë 0.5% e detyrimit vjetor për çdo ditë vonesë, neni 7 “Sanksione” i kontratës.). Pagesa e parë jo më vonë se 19 Janar 2015. **Vlera e investimit është 79,390,000 Lekë sipas planit të biznesit por sipas tabelave përmbledhëse rezulton 49,520,000 lekë (ka mospërputhje të shumta midis zërave të investimit, vlera të investimit dhe afateve të realizimit të investimeve) dhe 35,800,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës.** Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit): 4 vjet. Vlera e garancisë: 2% e investimeve kapitale. Dorëzimi i tokës nga qiradhënësi është kryer në datë 12.5.2015, kontrata është regjistruar në ASHK.

1.Subjekti ka paguar vlerën e qirasë vjetore në datat sipas tabelës më poshtë:

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Subjekti mbas llogaritjeve të kamatëvonesave dhe rakordimit me vlerat e paguara të kamatëvonesave ka vlerën prej 82,881.45 lekë detyrime të papaguara. Subjekti është njoftuar për të paguar kamatëvonesat dhe në dt. 20.01.2022 i ka paguar. Subjekti nuk është debitor. Pagesa e garancisë mban datën 7.9.2015 e vlefshme deri në përfundimin e investimit. Në dosje ndodhet procesverbali nr. 11072/1 prot., datë 17.12.2018 i mbajtur për monitorimin e kontratës. Për periudhën objekt auditimi nuk ka monitorime.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti.)

2. Në planin e biznesit bashkëlidhur kontratës parashikohen investime në shumën prej 49,520,000 lekë. Investimi ishte parashikuar të kryhej brenda 4 viteve nga nënshkrimi i kontratës, dhe duhet të ishte realizuar deri më datë 14.1.2019 por nuk është realizuar.

Në Kontratën e Qirasë në nenin 6 “Zgjidhja e kontratës”, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, parashikohet se: “a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet se Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3 parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.

Vlera e investimit të parashikuar në planin e biznesit është shuma prej 49,520,000 lekë. Bazuar në parashikimet sipas dispozitave më sipër gjoba sipas parashikimit të investimeve në vite (2015-2022) duhet të ishte llogaritet nga ana e MBZHR. Kjo shume nuk i është përlllogaritur nga MBZHR-ja. Grupi i auditimit përlllogariti penalitetet si vijon:

Gjoba për vitin e parë të investimit 2015-2016:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2015/16 (investime): 23,680,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për periudhën 2015/16: 23,680,000 lekë – 0 (Realizim) = 23,680,000 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 23,680,000 lekë (vlera investimeve të perealizuara deri 2016) = 473,600 lekë.

Gjoba për vitin e dytë të investimit 2016-2017:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2016/17 (investime): 2,080,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2016/17: 0 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për periudhën (2016-2017): 2,080,000 lekë – 0 lekë = 2,080,000 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16 dhe 2016/17) = 23,680,000 lekë + 2,080,000 lekë = 25,760,000 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 25,760,000 lekë (vlera e investimeve të perealizuara deri 2017) = 515,200 lekë.

Gjoba për vitin e tretë të investimit 2017-2018:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2017/18 (investime): 9,480,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2017/18: 6,320,663 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për vitin (2017-2018): 9,480,000 lekë – 6,320,663 lekë = 3,159,337 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16; 2016/17 dhe 2017/18) = 23,680,000 lekë + 2,080,000 lekë + 3,159,337 lekë = 28,919,337 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 28,919,337 lekë (vlera e investimeve të perealizuara deri 2018) = 578,386.74 lekë.

Gjoba për vitin e katërt të investimit 2018-2019:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2018/19 (investime): 14,280,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2018/19: 963,920 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për vitin (2018-2019): 14,280,000 lekë – 963,920 lekë = 13,316,080 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2015/16; 2016/17; 2017/18 dhe 2018/19) = 23,680,000 lekë + 2,080,000 lekë + 3,159,337 lekë + 13,316,080 lekë = 42,235,417 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 42,235,417 lekë (vlera e investimeve të perealizuara deri 2019) = 844,708.34 lekë.

Gjoba për vitin e pestë të investimit 2019-2020:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 49,520,000 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar deri në vitin 2019/2020 (duke zbritur të gjitha faturat deri 2018/19): 42,235,417 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2019-2020: 3,708,599 lekë.

Vlera e investimit të përcaktuar në total: 42,235,417 lekë – 3,708,599 lekë = 38,526,819 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 38,526,819 lekë (vlera e investimeve të përcaktuara) = 770,536.37 lekë.

Gjoha për vitin e gjashtë të investimit 2020-2021:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 49,520,000 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar deri në vitin 2020/2021 (duke zbritur të gjitha faturat deri 2019/20): 38,526,819 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2020-2021: 0 lekë.

Vlera e investimit të përcaktuar në total: 38,526,819 lekë – 0 lekë = 38,526,819 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 38,526,819 lekë (vlera e investimeve të përcaktuara) = 770,536.37 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2021-2022:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 49,520,000 lekë.

Vlera e investimit të mbetur pa realizuar deri në vitin 2021/2022 (duke zbritur të gjitha faturat deri 2020/21): 38,526,819 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2021-2022: 459,725 lekë.

Vlera e investimit të përcaktuar në total: 38,526,819 lekë – 459,725 lekë = 38,067,094 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 38,067,094 lekë (vlera e investimeve të përcaktuara) = 761,341.87 lekë.

Vlera totale e penaliteteve për mos përmbushje të investimeve është **4,714,309.33 lekë**.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

3. Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton sa vijon: Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Gjatë monitorimit në terren në datën 13.12.2018, rezultoi se subjekti nuk ka dorëzuar fatura lidhur me mbjelljen e tokës sipas nenit 2 të kontratës (kultivimi i shegëve). Në mungesë të dokumentacionit justifikues për kultivimin e shegëve qiramarrësi nuk e ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 4,714,309.33 lekë përbën penalitet për shkak të mos realizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

-Vlerat totale e detyrimit të subjektin “Bio Product” ShPK është 4,714,309.33 lekë.

-Gjatë periudhës së auditimit MBZHR nuk ka ndjekur procedurat përkatëse në afatet e duhura me përmbushjen e detyrimit për investim, përllogaritjen e penaliteteve për mosrealizimin e investimit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pika VII/1 “Monitorimi i Kontratave”.

8- Kontrata e Qirasë Nr. nr.5673 prot, nr. 2807 rep, nr. 990 kol, datë 21.7.2016 lidhur me subjektin “L. Z.” person fizik.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 22.09 ha, ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 1217, e përbërë prej ngastrave me nr: 542; dhe nr: 545, fshati Bilçë, Njësia Administrative Velabisht, Bashkia Berat, qarku Berat, me qëllim kultivimin dhe prodhimin e ullirit, për një afat 90 vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 198,810 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për kultivimin dhe prodhimin e ullirit. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 4 Gusht 2016; pagesat e tjera brenda datës 21 Korrik të vitit përkatës. **Vlera e investimit është përcaktuar 66,340,000 lekë në planin e biznesit (ka probleme në planin e**

biznesit ku janë futur shpenzime të tjera që nuk kanë vlerë për llogaritjen e investimeve) dhe 36,640,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2 % të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 732,800 lekë (rezulton se ka një pasaktësi në vlerën e investimit të parashikuar në plan biznes e cila është përcaktuar 66,340,000 lekë ndërsa në shtojcën nr. 2 bashkëngjitur kontratës investimi paraqitet me vlerën 36,640,000 lekë). Për shkak se plani i biznesit përfaqëson dokumentin bazë të investimit shuma e përcaktuar 66,340,000 lekë do të konsiderohet si vlerë investimi. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës me anë të procesverbalit me Nr. 9765/2 prot., datë 25.10.2018.

1. Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton:

Subjekti e ka paguar qiranë e vitit të parë brenda afateve. Për vitin 2017 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 21.7.2017. Pagesa është kryer në datën 24.7.2017, me 3 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 198,810 * 0.5 % = 994.05 lekë.

Totali kamatave për vitin 2017 = 3 ditë * 994.05 lekë (kamatë ditore) = **2,982.15 lekë.**

Për vitin 2018 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 21.7.2018. Pagesa është kryer në datën 2.8.2018, me 12 ditë me vonesë. Subjekti ka paguar në datën 2.8.2018 vlerën prej 8,946 lekë ngelen dhe 3 ditë kamatëvonesa për tu paguar.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 198,810 * 0.5 % = 994.05 lekë.

Totali kamatave për vitin 2018 = 3 ditë * 994.05 lekë (kamatë ditore) = **2,982.60 lekë.**

Për vitin 2019 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 21.7.2019. Pagesa është kryer në datën 6.8.2019, me 16 ditë me vonesë. Subjekti ka paguar në datën 6.8.2019 vlerën prej 2,982 lekë ngelen dhe 13 ditë kamatëvonesa për tu paguar.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 198,810 * 0.5 % = 994.05 lekë.

Totali kamatave për vitin 2019 = 13 ditë * 994.05 lekë (kamatë ditore) = **12,922.80 lekë.**

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 21.7.2020. Pagesa është kryer në datën 15.9.2020, me 56 ditë me vonesë. Subjekti ka paguar në datën 15.9.2020 vlerën prej 14,910 lekë ngelen dhe 41 ditë kamatëvonesa për tu paguar.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 198,810 * 0.5 % = 994.05 lekë.

Totali kamatave për vitin 2020 = 41 ditë * 994.05 lekë (kamatë ditore) = **40,756.80 lekë.**

Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 21.7.2021. Pagesa është kryer në datën 26.7.2021, me 5 ditë me vonesë. Subjekti ka paguar në datën 26.7.2021 vlerën prej 40,756 lekë duke shlyer dhe një pjesë të detyrimit të prapambetur nga vitet e kaluara.

Për vitin 2022 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 21.7.2022. Pagesa është kryer në datën 22.7.2022, me 1 ditë me vonesë. Subjekti ka paguar në datën 22.7.2022 vlerën prej 23,859 lekë duke shlyer dhe detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara. Subjekti aktualisht rezulton debitor në **vlerën 994.05 lekë.**

2. U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Lidhur me këtë komponent rezulton se realizimi i investimit referuar parashikimeve të plan biznesit dhe vlerave të faturave të dorëzuara është rreth 11.59 %. Në dosje gjendet shkresa “Raport mbi realizimin e investimeve” e cila është pa datë dhe pa numër protokolli. Regjistrimi i kontratës në ASHK është kryer.

Në planin e biznesit bashkëlidhur Kontratës parashikohen investime në shumën prej 66,340,000 lekë. Investimi për kryerjen e mbjelljeve dhe punimeve të tjera ishte parashikuar të kryhej brenda 3 viteve nga nënshkrimi i kontratës dhe shpenzimet për shërbimet kulturore ishin parashikuar për 6 vjet, të cilat së bashku duhet të ishte realizuar deri më datë 21.7.2022. Vlera e investimit të parashikuar në planin e biznesit është shuma prej 66,340,000 lekë.

Në Kontratën e Qirasë në nenin 6 “Zgjidhja e kontratës”, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, parashikohet se: “a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet se Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të

parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë neni 7 “Sanksione”, pika 3 parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Vlera e gjobës do të jetë 2% e vlerës së investimeve kapitale të perealizuara për çdo vit vonesë. Sipas planit të biznesit pjesë përbërëse e Kontratës, investimi duhet të ishte realizuar deri në datë 21.7.2022. Subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion financiar, fatura apo dokumentacion justifikues për realizimin e investimeve në MBZHR. Nuk janë kryer investime sipas planit të biznesit në makineri, pajisje, infrastrukturë, ndërtime, parashikuar në shtojcën 2 të kontratës. Nuk ka realizuar punësimin sipas planit të biznesit. Në zbatim të nenit 7 të Kontratës së Qirasë MBZHR duhet të kishte përllogaritur penalitetet si më poshtë:

Gjoha për vitin e parë të investimit 2016-2017:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2016/17 (investime): 12,640,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (338,000) lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për periudhën 2016/17: 12,640,000 lekë – 338,000 (Realizim) = 12,302,000 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 12,302,000 lekë (vlera investimeve të perealizuara deri 2017) = 246,040 lekë.

Gjoha për vitin e dytë të investimit 2017-2018:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2017/18 (investime): 23,900,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2017/18: 165,000 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për periudhën (2017-2018): 23,900,000 lekë – 165,000 lekë = 23,735,000 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17 dhe 2017/18) = 12,302,000 lekë + 23,735,000 lekë = 36,037,000 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 36,037,000 lekë (vlera e investimeve të perealizuara deri 2018) = 720,740 lekë.

Gjoha për vitin e tretë të investimit 2018-2019:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2018/19 (investime): 11,800,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2018/19: 2,411,800 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për vitin (2018-2019): 11,800,000 lekë – 2,411,800 lekë = 9,388,200 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17; 2017/18 dhe 2018/19) = 12,302,000 lekë + 23,735,000 lekë + 9,388,200 lekë = 45,425,200 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 45,425,200 lekë (vlera e investimeve të perealizuara deri 2019) = 908,504 lekë.

Gjoha për vitin e katërt të investimit 2019-2020:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2019/20 (investime): 6,900,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2019/20: 3,319,935 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për vitin (2019-2020): 6,900,000 lekë – 3,319,935 lekë = 3,580,065 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17; 2017/18; 2018/19 dhe 2019/20) = 12,302,000 lekë + 23,735,000 lekë + 9,388,200 lekë + 3,580,065 lekë = 49,005,265 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 49,005,265 lekë (vlera e investimeve të perealizuara deri 2020) = 980,105.30 lekë.

Gjoha për vitin e pestë të investimit 2020-2021:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes për vitin 2020/21 (investime): 7,400,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2020/21: 469,775 lekë.

Vlera e investimit të perealizuar për vitin (2020-2021): 7,400,000 lekë – 469,775 lekë = 6,930,225 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17; 2017/18; 2018/19; 2019/20 dhe 2020/21) = 12,302,000 lekë + 23,735,000 lekë + 9,388,200 lekë + 3,580,065 lekë + 6,930,225 lekë = 55,935,490 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 55,935,490 lekë (vlera e investimeve të përealizuara deri 2021) = 1,118,709.80 lekë.

Gjoha për vitin e shtatë të investimit 2021-2022:

Vlera e investimit total të planifikuar në plan biznes: 3,700,000 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për periudhën 2021/22: 986,700 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për vitin (2021-2022): 3,700,000 lekë – 986,700 lekë = 2,713,300 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17; 2017/18; 2018/19; 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22) = 12,302,000 lekë + 23,735,000 lekë + 9,388,200 lekë + 3,580,065 lekë + 6,930,225 lekë + 2,713,300 lekë = 58,648,790 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 58,648,790 lekë (vlera e investimeve të përealizuara deri 2022) = 1,172,975.80 lekë.

Gjoha totale për mosrealizimin e investimit është në vlerën 5,147,075 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti).

3. Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton sa vijon: Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Gjatë monitorimit në terren në datën 25.10.2018, rezultoi se subjekti ka mbjellë në tokat e marra me qira ullinj, duke respektuar parashikimet e përcaktuara në kontratë dhe plan biznes. Qiramarrësi ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe investuar pjesërisht sipas parashikimeve të planit të biznesit.

4. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit nuk është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2022/23. MBZHR me shkresën Nr. 8495/2 prot., datë 21.9.2018, me shkresën në zbatim të nenit 5 “Garancia e Kontratës” i ka kërkuar subjektit rinovimin e formularit të garancisë së kontratës. Për vitet 2017-2022 nuk janë dorëzuar garancitë e kontratës. Në dosje nuk ka dokumentacion për sigurimin e kontratës për investimet. Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar kopje e garancisë së kontratës për vitin e 2022/23.

5 .Sa i takon informacionit periodik MBZHR, në zbatim të nenit 7, shkronja ‘c’ ka dërguar njoftim me anë të shkresës me Nr. 8495 prot., datë 31.8.2018, Nr. 10059 prot., datë 30.12.2019, Nr. 686 prot., datë 19.1.2021, Nr. 8418 prot., datë 29.12.2021 dhe Nr. 6523 prot., datë 22.12.2022 për të cilat subjekti në periudha të ndryshme ka kthyer përgjigje me informacionin bashkëlidhur. Rezulton se subjekti ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, protokolluar në MBZHR me Nr. 8495/1 prot., datë 17.9.2018, shkresa Nr. 248 prot., datë 14.1.2020, shkresa me Nr. 686/1 prot., datë 17.2.2021, shkresa me Nr. 114 prot., datë 10.1.2022 dhe shkresa me Nr. 157 prot., datë 10.1.2023, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 5,147,075 lekë përbën penalitetet për shkak të mos realizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

- Vlera prej 994.05 lekë përbën kamatëvonesa të papaguara.

-Vlerat totale e detyrimit të subjektin “L. Z.” person fizik është 5,148,069.05 lekë.

-Gjatë periudhës së auditimit MBZHR ka ndjekur procedurat përkatëse lidhur me shlyerjen e kamatëvonesave, por nuk ka ndjekur në afatet e duhura vendosjen e penaliteteve për përbushjen e detyrimit për investim. Gjatë kohës së kryerjes së auditimit nga ana e MBZHR subjektit i është dërguar shkresë për penalitetet lidhur me mos realizimin e investimeve. Për këto arsye MBZHR ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të

tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pika VII/1 “Monitorimi i Kontratave”, ku parashikohet: *“Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar”*. Gjithashtu MBZHR ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, pika 5, nenin 7, pika 3 dhe nenin 8 të kontratës.

9- Kontrata e qirasë nr. 1001 Prot, nr. 396 Rep, nr. 369 Kol, datë 5.2.2016 lidhur me qiramarrësin subjektin “K. C.”. Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sip 36.335 ha, Pasuritë nr. 617; 618; 623; 624/1; 624/2; 625; 626; Zona Kadastrale 2570 të cilat ndodhen në fshatin Malinat, Njësia Administrative Vërtop, Bashkia Berat dhe pasurinë nr. 1736; Zona Kadastrale 1004 në fshatin Agim, Njësia Administrative Poshnje Bashkia Ura Vajgurore. Kohëzgjatja: 60 (gjashtëdhjetë) vjet. Aktiviteti: Kultivim rrushi për prodhim vere. Vlera e qirasë vjetore: 321,565 lekë/total/vit. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë në momentin e lidhjes së kontratës por jo më vonë se 22 Shkurt 2016. Pagesat tjera deri në datë 5 Shkurt të vitit përkatës.(vonesa në pagesë 0.5% e detyrimit vjetor për çdo ditë vonesë, neni 7 “Sanksione” i kontratës). *Përsa i përket vlerës së investimit ka një mospërputhje të vlerës së investimeve, pasi sipas shtojcës 2 të kontratës është 120,900,000 lekë dhe sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim vlera e investimeve është 154,286,259 lekë (ose 33,386,259 lekë më e ulët).*

Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit): Investimi i planifikuar nga subjekti zgjat 4 vjet, sipas tabelës (*Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.*)

Vlera e garancisë: 2% e investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 3,085,725 lekë sipas planit të biznesit.

1. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës), është ngritur grupi i punës “Për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit “K.C.”, Z. P. Ç. Nga ana e qiradhënësit është realizuar me vonesë dorëzimi i tokës në dt 25.10.2018, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit, citohet se *“qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës”,* fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi. Për periudhën objekt auditimi nuk ka monitorim në terren. Në dosje gjendet një monitorim në dt. 26.10.2018 ku është konstatuar se subjekti ka kryer investimet por ai nuk ka paraqitur asnjëherë dokumentet justifikuese të investimeve në mënyrë që të bëhet krahasimi i investimit të kryer me vlerat e parashikuara sipas planit të biznesit. Subjekti është njoftuar në mënyrë të vazhdueshme që të paraqesin dokumentacionin justifikues të investimeve por nuk i është përgjigjur kërkesave të MBZHR.

2. Qiramarrësi nuk ka raportuar asnjëherë mbi ecurinë e plotë apo të pjesshme të investimeve sipas nenit 5 pika 4 e kontratës, pavarësisht se nga ana e MBZHR i është kërkuar raportimi çdo vit.

3. Regjistrimi i kontratës në ASHK nuk është realizuar. Subjekti nuk ka paraqitur pranë MBZHR kopje të dokumentacionit të regjistrimit të kontratës së qirasë në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, siç kërkohet nga neni 2 dhe shtojca 4 e kontratës së qirasë.

4. Pagesa e garancisë së kontratës për periudhën objekt auditimi nuk është bërë nga ana e qiramarrësit.

5. Sa i takon qirasë pas llogaritjes të kamatëvonesave dhe pagesave që ka kryer subjekti rezulton:

Kamatëvonesat për vitin 2017:

Për vitin 2017 qiraja vjetore duhet të ishte paguar deri me datë 5.2.2017, por është kryer më datë 24.5.2017 pra 108 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 321,565 * 0.5% = 1,607.825 lekë.

Totali i kamatave për vitin 2017 = 108 ditë * 1,607.825 lekë (kamatë ditore) = **173,645.1 lekë**.

Kamatëvonesat për vitin 2018:

Për vitin 2018 qiraja vjetore duhet të ishte paguar deri me datë 5.2.2018, por është kryer më datë 23.5.2018 pra 107 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 321,565 * 0.5% = 1,607.825 lekë.

Totali i kamatave për vitin 2018 = 107 ditë * 1,607.825 lekë (kamatë ditore) = 172,037.3 lekë.

Në dosje u evidentua se, duke qenë se janë paguar 157,566 lekë kamatëvonesa, mbeten për tu shlyer edhe **14,471.3 lekë** kamatëvonesa papaguar për vitin 2018. MZHBR në lidhje mbi llogaritjen e pagesave të principalit të qirasë ka nxjerrë dhe penalitetet.

-Në total subjekti ka 188,116.4 lekë kamatëvonesa papaguar për vitet 2017-2018.

6. U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Në planin e biznesit bashkëlidhur kontratës parashikohen investime në shumën prej 154,286,259 lekë. Investimi ishte parashikuar të kryhej brenda 4 viteve nga nënshkrimi i kontratës dhe duhet të ishte realizuar deri më datë 5.2.2020.

Në dosje gjendet "Raport mbi realizimin e investimeve të subjektit "K. C.". Raporti nuk ka datë dhe nuk është protokolluar. Në shkresë përshkruhet se subjekti ka paraqitur fatura në vlerën totale 34,887,820.47 lekë.

Me anë të shkresave Nr. 8494 prot., datë 31.8.2018, Nr. 11681 prot., datë 26.12.2018, Nr. 10072 prot., datë 30.12.2019, Nr. 694 prot., datë 19.1.2021, Nr. 756/3 prot., datë 22.4.2022 MBZHR ka kërkuar informacion për realizimin e investimeve si dhe paraqitjen e dokumenteve justifikues (fatura, stacione, etj). Subjekti nuk i është përgjigjur asnjëherë në mënyrë shkresore kërkesave të vazhdueshme të MBZHR por janë paraqitur disa fatura të cilat janë analizuar. (Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti).

Në Kontratën e Qirasë në nenin 6 "Zgjidhja e kontratës", pika 5, shkronjat "a" dhe "b", parashikohet se "a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet se Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3".

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 "Sanksione", pika 3 parashikon se "Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë".

Vlera e investimit të parashikuar në planin e biznesit është shuma prej 154,286,260 lekë. Në zbatim të parashikimit si më sipër shoqëria detyrohet të paguajë gjobën si më poshtë:

Vlera e gjobës do të jetë 2% e vlerës së investimeve kapitale të porealizuara për çdo vit vonesë. Sipas planit të biznesit pjesë përbërëse e Kontratës, investimi duhet të ishte realizuar deri në datë 5.2.2020. MBZHR nuk ka përlllogaritur penalitetet. Këto penalitete duhet të ishin vendosur si vijon:

Gjoba për vitin e parë të investimit 2016 - 2017:

Vlera e investimit të parashikuar deri 2016/17 (investime + qira): 25,421,565 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave është (0) lekë.

Pagesa e qirasë: 321,565 lekë.

Vlera e investimit të porealizuara deri 2016/17: 25,421,565 lekë – qiraja vjetore 321,565 lekë = 25,100,000 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 25,100,000 lekë (vlera investimeve të porealizuara deri 2017) = 502,000 lekë.

Gjoba për vitin e dytë të investimit 2017 - 2018:

Vlera e investimit të parashikuar 2017/18 (investime + qira): 73,621,565 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin 2017/18: 2,394,707 lekë.

Pagesa e qirasë: 321,565 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për vitin (2017 - 2018): 73,621,565 lekë – 2,394,707 lekë – 321,565 lekë = 70,905,293 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17 dhe 2017/18) = 25,100,000 lekë + 70,905,293 lekë = 96,005,293 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 96,005,293 lekë (vlera e investimeve të përealizuara deri 2018) = 1,920,105.86 lekë.

Gjoha për vitin e tretë të investimit 2018 - 2019:

Vlera e investimit të parashikuar deri 2018/19 (investime + qira): 37,821,565 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin 2018/19: 2,592,999 lekë.

Pagesa e qirasë: 321,565 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për vitin (2018 - 2019): 37,821,565 lekë – 2,592,999 lekë – 321,565 lekë = 34,907,001 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17; 2017/18 dhe 2018/19) = 25,100,000 lekë + 70,905,293 lekë + 34,907,001 lekë = 130,912,294 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 130,912,294 lekë (vlera e investimeve të përealizuara deri 2019) = 2,618,245.88 lekë.

Gjoha për vitin e katërt të investimit 2019 - 2020:

Vlera e investimit të parashikuar për vitin 2019/20 (investime + qira): 17,421,565 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave: 0 lekë.

Pagesa e qirasë: 321,565 lekë.

Vlera e investimit të përealizuar për vitin (2019 - 2020): 17,421,565 lekë – 321,565 lekë = 17,100,000 lekë.

Total mos realizimi i investimeve viti (2016/17; 2017/18; 2018/19 dhe 2019/20) = 25,100,000 lekë + 70,905,293 lekë + 34,907,001 lekë + 17,100,000 lekë = 148,012,294 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 148,012,294 (vlera e investimeve të përealizuara deri 2020) = 2,960,245.88 lekë.

Gjoha për vitin e pestë të investimit 2020 - 2021:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes (investime + qira): 154,286,260 lekë.

Vlera e përealizuar deri në vitin 2021 (total fatura të llogaritura): 149,298,554 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2020/21): 9,564,139.91 lekë.

Vlera e investimit total të përealizuar deri në vitin 2021: 149,298,554 lekë – 9,564,139.91 lekë = 139,734,414.09 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 139,734,414.09 lekë (vlera e investimeve totale të përealizuara deri 2021) = 2,794,688.28 lekë.

Gjoha për vitin e gjashtë të investimit 2021 - 2022:

Vlera e investimit të parashikuar në plan biznes (investime + qira): 154,286,260 lekë.

Vlera e përealizuar deri në vitin 2022 (total fatura të llogaritura): 139,734,414.09 lekë.

Vlera e realizimit sipas faturave për vitin (2021/22): 20,335,974.56 lekë.

Vlera e investimit total të përealizuar deri në vitin 2022: 139,734,414.09 lekë – 20,335,974.56 lekë = 119,398,439.53 lekë.

Vlera e gjobës = 2% * 119,398,439.53 lekë (vlera e investimeve totale të përealizuara deri 2022) = 2,387,968.79 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Penaliteti për mosrealizimin e investimeve për vitet 2016-2022 është në vlerën 13,183,254.69 lekë.

MBZHR me shkresën nr. 132/1 prot, datë 27.02.2023 ka njoftuar subjektin për penalitetin për mos realizimin e investimeve sipas afateve të parashikuara në kontratë. Në këtë shkresë nga MBZHR është përlllogaritur dhe viti 2022/2023 i cili maturohet 5.2.2016, prandaj ka dhe diferencë me shumën totale të përlllogaritur më sipër.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 13,183,254.69 lekë përbën penalitet për shkak të mosrealizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

- Subjekti ka 188,116.4 lekë kamatëvonesa pa paguar për vitet 2017-2018.

-Vlera prej 13,371,370.61 lekë përbën detyrimin total të subjektit “K. C.”, P. C.për shkak të mos përbushjes së detyrimeve kontraktore.

-MBZHR ka ndjekur procedurat përkatëse lidhur me kamatëvonesat, përbushjen e detyrimit për investimin pasi ka përlloritur penalitetin për mosrealizimin e investimit, dhe dërguar me shkresë me nr. 638. Prot, datë 27.01.2023.

10- Kontrata e qirasë Nr. 855 Prot., Nr. 323 Rep., Nr. 110 Kol., datë 2.2.2016, ndryshuar me Amendimin kontrate me Nr. 325/2 Prot., Nr. 139 Kol., Nr. 1116 Rep., datë 7.4.2021 me palë qiramarrëse subjektin “S.G.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 19.39 ha., e përbërë prej ngastrave me numra pasurie 2; nr. 3 dhe nr. 4, Zona Kadastrale nr. 2890, me vend ndodhje në zonën e ish-NUB-it, Bashkia Patos, Qarku Fier, me qëllim kultivimin, prodhimin dhe tregtimin e kulturës së ullirit, ambiente në funksion të këtij aktiviteti si dhe serrë për fidanë ulliri, për një afat 90 (nëntëdhjetë) vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 465,360 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për kultivimin, prodhimin dhe tregtimin e kulturës së ullirit, ambiente në funksion të këtij aktiviteti si dhe serrë për fidanë ulliri. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 16 Shkurt 2016; pagesat e tjera me datën 2 Shkurt të çdo viti pasardhës. Vlera e investimit është përcaktuar 66,260,394 lekë. Afati për përbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit, bashkëlidhur amendimit të kontratës së qirasë):

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti auditimi.)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale brenda një javë nga dorëzimi i pasurisë nga qiradhënësi. Vlera maksimale e garancisë 1,325,208 lekë. Nga ana e qiradhënësit është **realizuar dorëzimi i tokës me datë 21.11.2018** dhe kontrata është regjistruar në ASHK.

1.Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton se subjekti ka kryer pagesat në datat:

-Datë 10.2.2016 vlerën 465,360 lekë;

-Datë 10.10.2017 vlerën 465,360 lekë;

-Datë 29.12.2018 vlerën 465,360 lekë;

-Datë 24.9.2019 vlerën 465,360 lekë;

-Datë 5.2.2020 vlerën 465,360 lekë;

-Datë 2.2.2021 vlerën 465,360 lekë;

-Datë 2.2.2022 vlerën 465,360 lekë.

Në nenin 7 “Sanksione” të Kontratës së Qirasë, parashikohet se: *“Qiramarrësi, paguan gjobë në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë”*. Në zbatim të parashikimeve të sipërcituara MBZHR ka përlloritur kamatëvonesat nga ku rezulton si vijon:

Kamatëvonesat për vitin 2017

Për vitin 2017 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 2.2.2017, por është kryer në datën 10.10.2017, 250 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 465,360 * 0.5% = 2,326.8 lekë.

Totali kamatave për vitin 2017 = 250 ditë * 2,326.8 lekë (kamatë ditore) = 581,700 lekë.

Kamatëvonesat për vitin 2018

Për vitin 2018 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 2.2.2018, por është kryer në datën 28.12.2018, 329 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 465,360 * 0.5% = 2,326.8 lekë

Totali kamatave për vitin 2018 = 329 ditë * 2,326.8 lekë (kamatë ditore) = 765,517.2 lekë

Kamatëvonesat për vitin 2019

Për vitin 2019 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 2.2.2019, por është kryer në datën 24.9.2019, 234 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 465,360 * 0.5% = 2,326.8 lekë

Totali kamatave për vitin 2019 = 234 ditë * 2,326.8 lekë (kamatë ditore) = 544,471.2 lekë

Kamatëvonesat për vitin 2020

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 2.2.2020. Pagesa është kryer në datën 5.2.2020, 3 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 465,360 * 0.5% = 2,326.8 lekë

Totali kamatave për vitin 2020 = 3 ditë * 2,326.8 lekë (kamatë ditore) = 6,980.4 lekë

Subjekti “S. G.” ShPK. duhet të paguajë vlerën për kamatëvonesat e qirasë **1,898,668.8 lekë.**

Aktualisht ky subjekt rezulton debitor. Për këtë debi subjekti me shkresën protokolluar në MBZHR me Nr. 689/2 prot., datë 8.2.2021 ka paraqitur ankim duke e argumentuar se vlerën e kamatëvonesës ta përfshijnë në vlerën e qirasë vjetore të paguar nga subjekti në vitin 2017 kohë në të cilën nuk ka marrë në dorëzim në përdorim tokën e dhënë me qira nga Ministria.

2. Gjatë auditimit lidhur me realizimin e investimit rezulton se vlera e investimit të parashikuar në planin e biznesit është shuma prej 89,464,336 lekë. Nga kjo vlerë rreth 80,804,336 lekë janë parashikuar për investime dhe vlera prej 8,660,000 lekë janë parashikuar si shpenzime gjatë periudhës së rritjes së plantacionit me ullinj.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Sipas “Akt Verifikimit” me Nr. 427/1 prot, datë 1.12.2017 grupi i Auditit ngritur me Urdhrin e MBZHR, Nr. 484, datë 9.11.2017 ka rezultuar se: Qiramarrësi ka investuar për ndërtimin e rrugës, dispononte ambiente serash, Mjete transporti dhe makineri bujqësore. Kishte përgatitur tokën për mbjellje, kishte shtrirë sistemin e ujitjes , etj.

Edhe pse dorëzimi i tokës është kryer me procesverbal me Nr. 10810/1 prot., datë 23.11.2018 rezulton se subjekti ka kryer punime që në vitin 2017, kështu që llogaritë do të nisin që nga viti 2017.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Subjekti ka realizuar parashikimet dhe planin e biznesit dhe planin e paraqitur. Me Amendimin e Kontratës Nr. 325/2 prot., Nr. 1116 Rep., Nr. 139 Kol., datë 7.4.2021 subjekti ka amenduar kontratën duke përditësuar dhe planin e investimeve të planifikuara për tu zhvilluar. Për periudhën 2021-2023 subjekti ka parashikuar investime si më poshtë:

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

3. Subjekti “S.G.” ShPK. nuk ka raportuar lidhur me përdorimin e tokës sipas kontratës dhe në kushtet kur nga MBZHR nuk janë kryer monitorime, nuk provohet përdorimi i tokës sipas objektit. Sipas procesverbalit të monitorimit të mbajtur në datën 13.02.2019 ka rezultuar se subjekti ka hapur rreth katër km rrugë për të shkuar mjetet në token e marrë me qira. Është shpyllëzuar, pastruar, sistemuar dhe punuar e gjithë sipërfaqja. Kishte përgatitur tokën për mbjellje, kishte shtrirë sistemin e ujitjes , etj.

4. Nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për periudhën 2021 – 2022, Formulari për Sigurimin e Kontratës me Nr. 0019527/2021, datë 8.4.2021, lëshuar nga kompania e sigurimit “I.” sha, me afat vlefshmërie deri më datë 6.4.2022.

Për periudhën 06.04.2022 e në vazhdim subjekti nuk ka siguruar kontratën. Nga MBZHR nuk i është dërguar shkresë për sigurimin e garancisë. Në nenin 5 të kontratës parashikohet se: *“Qiramarrësi duhet të paraqesë pranë qiradhënësit një garanci bankare prej 2% e investimeve kapitale të parashikuara brenda një jave nga dorëzimi i pasurisë nga qiradhënësi. “Garancia bankare mund të lëshohet për një afat kohor 1 vjeçar dhe do të rinovohet deri në përfundim të investimeve kapitale. Garancia e kontratës do të reduktohet proporcionalisht vit pas viti në raport me investimin e realizuar në vitin pasardhës”.*

Konstatim

-Grupi i auditimit, pas verifikimit të dokumentacionit të dosjes, arrin në këto përfundime:
- Subjekti "S. G." ShPK. duhet të paguajë vlerën për kamatëvonesat e qirasë 1,898,668.8 lekë.

11- Kontrata e Qirasë Nr. 1824 Prot., Nr. 1269 Rep., Nr. 287 Kol., datë 3.3.2016 lidhur me subjektin "A.I. G." ShPK.

Nga auditimi i dosjes së subjektit rezulton se objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 87 ha, pasuritë nr. 151/1; nr. 151/1; nr. 152/1; nr. 153/1; nr. 153/6; nr. 154/1; nr. 157/1; nr. 155/1; nr. 155/5; nr. 156/1; nr. 158/1, nr. 159/1; nr. 160/1, Zona Kadastrale nr. 2085 të cilat ndodhen në fshatin Karavasta, njësia administrative Rremas, bashkia Divjakë, Qarku Fier. Kontrata është amenduar me Nr. 3101 prot., Nr. 1388 Rep., Nr. 237 Kol., datë 4.5.2020, ndryshim kulture dhe plan biznesi, kohëzgjatja: 90 vjet aktiviteti: kultivimi i shegës dhe goji berry. Vlera e qirasë vjetore: 730,800 lekë/total/vit. afati i pagesës së qirasë: pagesa e parë në momentin e lidhjes së kontratës por jo më vonë se 17 Mars 2016. Pagesat tjera deri në datë 3 Mars të vitit përkatës. (vonesa në pagesë 0.5% e detyrimit vjetor për çdo ditë vonesë, neni 7 "Sanksione" i kontratës). **Vlera e investimit: 482,178,240 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës para amendimit dhe 254,627,468 lekë plani i ri i biznesit pas amendimit.** Afati për përmbushjen e investimit i ndarë sipas periudhës: nuk ka një tabelë ndarëse në vite të investimit, pasi i gjithë investimi i programuar duhet të përfundonte gjatë vitit 2017-2018. Vlera e garancisë: 1% e investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 2,546,274.68 lekë sipas planit të ri të biznesit.

Në mënyrë të përmbledhur në planin e biznesit janë parashikuar investime si: mbjellje shegë dhe goji berry, mbjellje ullinj, ndërtim rrugësh dhe kanale, mjete transporti, mobilim zyresh, investime në energji elektrike etj. **I gjithë investimi i programuar ka përfunduar deri në vitin 2018.**

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 1 % të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 2,546,274.68 lekë. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës. Grupi i Punës me anë të Urdhrit nr. 496 datë 15.11.2018, protokolluar me Nr. 10417/1 prot., datë 15.11.2018 "Për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit "A. I.G." ShPK. Kjo sipërfaqe është dorëzuar me procesverbal për dorëzimin e tokës bujqësore protokolluar me Nr. 10417/2 prot., datë 20.11.2018.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti).

1. Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, lidhur me qiranë e tokës ka konstatuar se:

-Për vitin 2016 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 17.3.2016 pagesa është kryer në datën 1.4.2016, pra 15 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 730,800 * 0.5% = 3,654 lekë

Totali kamatave për vitin 2016 = 15 ditë * 3,654 lekë (kamatë ditore) = **54,810 lekë.**

-Për vitin 2017 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 3.3.2017, pagesa nuk është kryer akoma deri në datë 31.12.2022. Deri në këtë datë janë 2129 ditë vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 730,800 * 0.5% = 3,654 lekë.

Totali kamatave për vitin 2017 = 2129 ditë * 3,654 lekë (kamatë ditore) = **7,779,366 lekë.**

Totali Kamatëvonesa dhe qira për vitin 2017 = 730,800 lekë (qira vjetore) + 7,779,366 lekë (kamatëvonesa) = **8,510,166 lekë.**

-Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 3.3.2020 pagesa është kryer në datën 4.3.2020, pra 1 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 730,800 * 0.5% = 3,654 lekë.

Totali kamatave për vitin 2021 = 1 ditë * 3,654 lekë (kamatë ditore) = 3,654 lekë

Kjo kamatëvonesë rezulton të jetë paguar 4.2.2021.

-Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 3.3.2021 pagesa është kryer në datën 4.3.2021, pra 1 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 730,800 * 0.5% = 3,654 lekë.

Totali kamatave për vitin 2021 = 1 ditë * 3,654 lekë (kamatë ditore) = 3,654 lekë.

-Për vitin 2022 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 3.3.2022, pagesa është kryer në datën 1.7.2022, pra 120 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 730,800 * 0.5% = 3,654 lekë

Totali kamatave për vitin 2022 = 120 ditë * 3,654 lekë (kamatë ditore) = 438,480 lekë.

-Aktualisht (deri në datën 31.12.2022) ky subjekt rezulton debitor për principal të pa paguar dhe kamata në vlerën 9,007,110 lekë.

-Subjekti është njoftuar nga MBZHR për të kryer pagesat e qirasë vjetore dhe kamatëvonesave të akumuluar me anë të shkresave Nr. 2041 prot., datë 1.3.2019, shkresën Nr. 1993 prot., datë 3.3.2021 dhe shkresës me Nr. 3402 prot., datë 22.6.2022.

2.U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Lidhur me këtë komponent rezulton se vlera e investimit është përcaktuar 254,627,468 lekë. Subjekti e ka realizuar investimin dhe ka paraqitur faturat.

3.Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton se nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Gjatë dorëzimit të tokës në terren në datën 20.11.2018, rezultoi se subjekti ka mbjellë në tokat e marra me qira shegë, goji berry, etj., duke mos respektuar parashikimet e përcaktuara në kontratë dhe plan biznes. Qiramarrësi nuk ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit.

4.Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit nuk është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2022/23. MBZHR me shkresën Nr. 8481/2 prot., datë 21.9.2018 në zbatim të nenit 5 "Garancia e kontratës" i ka kërkuar subjektit rinovimin e formularit të garancisë së kontratës: Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar një kopje e garancisë së kontratës.

5.Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, protokolluar në MBZHR me Nr. 685/1 prot., datë 28.1.2021, Nr. 168 prot., 10.1.2020, Nr. 232/2 prot., datë 5.3.2020, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. MZHBR, në zbatim të nenit 5, pika '4' ka dërguar njoftim me anë të shkresave me Nr. 10061 prot., datë 30.12.2019, Nr. 232/1 prot., datë 20.1.2020, Nr. 8438 prot., datë 29.12.2021, Nr. 685 prot., datë 19.1.2021, Nr. 6534 prot., datë 22.12.2022, për të cilat me shkresat Nr. 685/1 prot., datë 28.1.2021, Nr. 168 prot., 10.1.2020, Nr. 232/2 prot., datë 5.3.2020 ka sjellë informacion.

Konstatim

Vlera prej 9,007,110 lekë (për principal dhe kamata të pa paguar) përbën detyrimin total të subjektit "A. I. G." ShPK. për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

12- Kontrata e qirasë Nr. 4410 prot., Nr. 1306 Rep., Nr. 1046 Kol., datë 7.6.2016, lidhur me qiramarrësin Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor "M." ShPK.

Nga auditimi i dosjes së subjektit rezulton se objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 71.74 ha, e përbërë prej ngastrave me numra pasurie 48; nr. 49; nr. 54; nr. 55; nr. 56; nr. 91; nr. 92; nr. 93/1; nr. 94/4 dhe nr. 95/3, Zona Kadastrale nr. 3701, e cila ndodhet në fshatin Valare, Njësia Administrative Lunxhëri, Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, me qëllim kultivimin dhe prodhimin e lajthisë, arrës dhe shegës, për një afat 90 (nëntëdhjetë) vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 1,255,450 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për mbjelljen e arrave, ullirit dhe fidanishte me arra. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet parapagim në momentin e nënshkrimit të kontratës, por jo më vonë se 21 Qershor 2016; pagesat e tjera me datën 7 Qershor të çdo viti pasardhës. Vlera e investimit është përcaktuar 233,145,000 lekë. Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale brenda një jave nga dorëzimi i Pasurisë nga Qiradhënësi. Vlera maksimale e garancisë 2,766,000 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

1. Grupi i auditimit lidhur me qiranë e tokës ka konstatuar se nga ana e qiradhënësit është realizuar me vonesë dorëzimi i tokës me datë 22.1.2019. Kontrata e qirasë është lidhur në datë

7.6.2016, Nga procesverbali i monitorimit dt.24.01.2019 dhe aktet e dosjes së kontratës së qirasë, rezulton se qiramarrësi nuk ka paguar qiranë për vitet 2019 dhe 2020. Në nenin 1, pika 3 të kontratës së qirasë parashikohet: *“Pagesa e qirasë për vitin e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo më vonë se 21 qershori 2016, ndërsa për periudhën vijuese në datë 7 qershor të çdo viti pasardhës”*. Në këto kushte nga qiramarrësi nuk është përmbushur detyrimi për pagimin e qirasë për vitet e mësipërme. Në nenin 7/1 të kontratës parashikohet: *“Qiramarrësi paguan gjobë në vlerën 0,5 % të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë”*. Bazuar në këtë dispozitë ndaj qiramarrësit duhet të aplikohet sanksioni i mësipërm.

-Kamatëvonesat për vitin 2019: Për vitin 2019 qiraja vjetore duhet të ishte paguar në datën e pagesës së qirasë sipas kontratës, konkretisht dt.07.06.2019. Pagesa e qirasë vjetore nuk është kryer në datën 13.10.2020 kur është dërguar njoftimi për zgjidhjen e kontratës.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 1,255,450 * 0.5 % = 6,277.25 lekë, kamatëvonesë ditore

Numri i ditëve vonesë: 07.06.2019 (data e shlyerjes së qirasë) - 13.10.2020 (data e zgjidhjes së kontratës) = 494 ditë.

Totali kamatave për vitin 2019= 494 ditë * 6,277.25 lekë (kamatë ditore) = 3,100,961.5 lekë, vlere e cila mbartet dhe në periudhën e auditimit.

-Kamatëvonesat për vitin 2020: Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar në datën e pagesës së qirasë sipas kontratës, konkretisht dt.07.06.2020. Pagesa e qirasë vjetore nuk është kryer në datën 13.10.2020 kur është dërguar njoftimi për zgjidhjen e kontratës.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 1,255,450 * 0.5 % = 6,277.25 lekë, kamatëvonesë ditore

Numri i ditëve vonesë: 07.06.2020 (data e shlyerjes së qirasë) - 13.10.2020 (data e zgjidhjes së kontratës) = 128 ditë.

Totali kamatave për vitin 2020= 128 ditë * 6,277.25 lekë (kamatë ditore) = 803,488 lekë, vlere e cila mbartet dhe në periudhën e auditimit.

-Vlera totale e qirasë dhe kamatëvonesës së papaguar nga qiramarrësi për vitet 2019 dhe 2020 është 6,415,350 lekë [1,255,450 (principal 2019) + 1,255,450 (principal 2020) + 3,100,961.5 + 803,488].

2. Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit. Sipas procesverbalit të monitorimit me Nr. 225/2 prot., datë 24.1.2019, nga monitorimi i kryer në terren me datë 23.1.2019 rezultoi se nga momenti i nënshkrimit të kontratës e deri në fund të vitit 2020 (kur ka filluar procedura për zgjidhjen e njëanshme të kontratës) nga subjekti nuk është realizuar asnjë investim i parashikuar.

Lidhur me këtë komponent rezulton se për vitin 2019 nuk është realizuar investimi në vlerën 46,550,000 lekë, (qiramarrësit i është dorëzuar toka me vonesë në datë 22.1.2019 për këtë arsye ky vit konsiderohet si vit i parë i investimit) duke shkelur detyrimin e nenit 2/d të kontratës. Në bazë të nenit 7/3 të kontratës qiramarrësi duhet të paguajë një penalitet në formën e kushtit penal gjobor për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë. MBZHR ka përlllogaritur penalitetin në vlerën 931,000 lekë (46,550,000 * 2%). Ky detyrim është mbartur deri në periudhën objekt auditimi.

3. Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton sa vijon: Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Subjekti as në momentin e dorëzimit në përdorim të tokës datë 23.1.2019 dhe as më vonë deri në vitin 2020 ku ka filluar proceduar për zgjidhjen e njëanshme të kontratës nuk ka kryer asnjë investim apo mbjellje në sipërfaqen e marrë me qira. Rezulton se qiramarrësi nuk e ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit.

4.Lidhur me garancinë e kontratës Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar garancia e kontratës qysh nga momenti i nënshkrimit të kontratës. MBZHR me shkresën Nr. 8480/1 prot., datë 21.9.2018 në zbatim të nenit 5 “Garancia e kontratës“ i ka kërkuar subjektit të paraqesë sigurimin e kontratës për vitin 2018 – 2019. Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar ende garancia e kontratës.

5.Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti nuk ka depozituar raporte periodike mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit.

-MBZHR në zbatim të parashikimeve si më sipër me shkresën Nr. 4448 prot., datë 17.6.2020 ka njoftuar qiramarrësin të kryejë pagesën e detyrimit të qirasë, kamatëvonesave dhe vlerën e gjobës për mosrealizimin e investimeve të parashikuara për t'u kryer vitin e parë të qirasë, për një afat 90 ditë, i cili fillon nga data e marrjes së njoftimit. Gjithashtu i është bërë me dije se në rast të mos pagesës brenda këtij afati Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të procedonte me zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme për mos përmbushje të detyrimeve të saj. Nga qiramarrësi megjithë njoftimet e bëra nga Ministria nuk u përmbushën këto detyrime, duke sjellë dhe fillimin nga Ministria të procedurës për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirasë. Me Urdhrin me Nr. 411, datë 12.10.2020, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë me Nr. 4410 prot., Nr. 1306 Rep., Nr. 1046 Kol., datë 7.6.2016 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit", është zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontrata e qirasë, urdhër i cili i është njoftuar qiramarrësit. Zgjidhja e kontratës është bazuar në parashikimet e nenit 6 "Zgjidhja e kontratës", në të cilin citohet se: "Në rastin kur Qiramarrësi nuk ka zbatuar detyrimet e kësaj kontrate të përcaktuar në nenin 2 pika (a) dhe (c) dhe (d), përveç rastit kur sipas germës (e) qiramarrësi shkarkohet nga këto detyrime atëherë Qiradhënësi i kërkon me shkrim Qiramarrësit përmbushjen e këtij detyrimi brenda 90 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se, Qiramarrësi nuk e përmbush detyrimin brenda këtij afati, atëherë Qiradhënësi njofton Qiramarrësin për zgjidhjen e kontratës si dhe përcakton datën nga e cila kontrata konsiderohet e zgjidhur, duke i dërguar njoftim me shkrim 180 ditë përpara datës së përcaktuar për zgjidhje".

Qiramarrësi nuk ka qenë dakord për këtë zgjidhje dhe e ka kundërshtuar duke kërkuar shfuqizimin e këtij urdhri në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, e cila pas shqyrtimit gjyqësor me Vendimin me Nr. 458, datë 23.12.2020 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, shfuqizimin e Urdhrit Nr. 411, datë 12.10.2020, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë me Nr. 4410 prot., Nr. 1306 Rep., Nr. 1046 Kol., datë 7.6.2016 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim MBZHR në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila me Vendimin me Nr. 579, datë 6.12.2022 ka vendosur: "Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 458, datë 23.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër".

-Në VKM nr.373 datë 20.06.2018 "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit" i ndryshuar, pika VII/1 "Monitorimi i Kontratave", parashikohet: "Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", të ndryshuar".

Në përfundim, lidhur me kontratën e mësipërme rezulton:

-Megenëse vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër ka marrë formë të prerë, dhe urdhri i Ministrit për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirasë është shfuqizuar, Qiramarrësi Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor "M." duhet të fillojë përmbushjen e detyrimeve kontraktore, pagesën e vlerës së qirasë vjetore për vitet 2019, 2020 dhe kamatëvonesat për këto vite, gjithsej në vlerë detyrimi 6,415,350 lekë.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

-Vlerën e detyrimi 6,415,350 lekë për pagesën e vlerës së qirasë vjetore dhe kamatëvonesat për vitet 2019, 2020.

-Qiramarrësi duhet të paguajë dhe shumë prej 931,000 lekë penalitet për mosrealizimin e investimeve për vitin e parë të Kontratës së Qirasë. Në njoftimin për këto detyrime duhet që Qiramarrësi të njoftohet dhe për fillimin e realizimit të investimeve sipas sasive, vlerave dhe afateve të parashikuara në Plan Biznesin e paraqitur në konkurrimin për këtë qiramarrje.

-Vlera prej 7,346,350 lekë përbën detyrimin total të subjekti qiramarrësin Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor "M." ShPK. për shkak të mos përbushjes së detyrimeve kontraktore. -Nga MBZHR duhet të ndiqen procedurat përkatëse për vjeljen e detyrimeve të mësipërme dhe përbushjen e detyrimeve kontraktore.

13- Kontrata e Qirasë Nr. 5130 prot., nr. 1387 Rep., Nr. 562/1 Kol., datë 03.07.2017, lidhur me qiramarrësin, subjektin "A. P." ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 13.3 ha, në Zonën Kadastrale nr. 2999, e përbërë nga ngastra me numër pasurie 74, ndodhur në me vendndodhje në fshatin Plug, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier, me qëllim prodhimin e fidanëve, prodhimin, tregtimin e fruta perimeve në fushë dhe në ambiente të mbrojtura dhe përpunimin e tyre, për një afat 90 vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumë 260,000 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për prodhimin e fidanëve, prodhimin, tregtimin e fruta perimeve në fushë dhe në ambiente të mbrojtura dhe përpunimin e tyre. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 17 Korrik 2017; pagesat e tjera brenda datës 3 Korrik të vitit përkatës. Vlera e investimit është përcaktuar 418,581,000 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 1 % të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 4,185,810 lekë. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës me anë të procesverbalit të mbajtur në datën 11.8.2017.

1.Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton:

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 3.7.2020. Pagesa është kryer në datën 21.7.2020, me 18 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 260,000 * 0.5% = 1,300 lekë

Totali kamatave për vitin 2020 = 18 ditë * 1,300 lekë(kamatë ditore) = 23,400 lekë

Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më dt. 3.7.2021. Pagesa është kryer në datën 20.10.2021, me 109 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 260,000 * 0.5% = 1,300 lekë

Totali kamatave për vitin 2020 = 109 ditë * 1,300 lekë(kamatë ditore) = 141,700 lekë

Totali i kamatëvonesave për vitet 2020 dhe 2021= 23,400 (kamata 2020)+ 141,700 (kamata 2021) = 165,100 lekë. Këto kamatëvonesa janë paguar në datën 28.2.2022 në vlerën 153,000 lekë dhe në datën 29.6.2022 në vlerën 11,700 lekë. Ky subjekt nuk është debitor për qiranë.

2.U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Lidhur me këtë komponent rezulton: Vlera e investimit është përcaktuar 418,581,000.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Subjekti nuk ka paraqitur asnjë faturë investimi dhe nuk ka kryer investime në terren. Nga MBZHR për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer verifikime në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit, qëndrim që përbën shkelje të nenit 3/1/b të kontratës së qirasë. Në dosje ndodhet procesverbali i monitorimit datë 16.11.2018 i mbajtur në terren nga Struktura Përgjegjëse për monitorimin: znj. M.K. dhe z. K. G. (AREB Lushnjë), nga ku rezultoi se sipërfaqja e tokës ishte pastruar dhe pluguar. Sipas këtij procesverbali nuk ishte kryer asnjë investim tjetër në tokë apo në infrastrukturë. Realizimi i investimit referuar parashikimeve të plan biznesit dhe vlerave të faturave nuk është realizuar.

Në Kontratën e Qirasë, neni 6 "Zgjidhja e Kontratës", pika 5, parashikon se: "Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që

Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”;

b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3, parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.

Në zbatim të parashikimeve si më sipër subjekti detyrohet të paguajë penaltetet si më poshtë:

-Për vitin 2017 - 2018 janë parashikuar investime në vlerën prej 28,006,000 lekë. Investime të realizuara 0 lekë. Vlera e gjobës për vitin 2017 - 2018 = 2% * 28,006,000 lekë (vlera e investimeve të porealizuara) * 5 (vitet vonesë) = 2,800,600 lekë.

-Për vitin 2018 - 2019 janë parashikuar investime në vlerën prej 81,600,000 lekë. Investime të realizuara 0 lekë. Vlera e gjobës për vitin 2018 - 2019 = 2% * 81,600,000 lekë (vlera e investimeve të porealizuara) * 4 (vitet vonesë) = 6,528,000 lekë.

-Për vitin 2019 - 2020 janë parashikuar investime në vlerën prej 59,400,000 lekë. Investime të realizuara 0 lekë. Vlera e gjobës për vitin 2019 - 2020 = 2% * 59,400,000 lekë (vlera e investimeve të porealizuara) * 3 (vitet vonesë) = 3,564,000 lekë.

-Për vitin 2020 - 2021 janë parashikuar investime në vlerën prej 56,000,000 lekë. Investime të realizuara 0 lekë. Vlera e gjobës për vitin 2010 - 2021 = 2% * 56,000,000 lekë (vlera e investimeve të porealizuara) * 2 (vitet vonesë) = 2,240,000 lekë.

-Për vitin 2021 - 2022 janë parashikuar investime në vlerën prej 96,500,000 lekë. Investime të realizuara 0 lekë. Vlera e gjobës për vitin 2010 - 2021 = 2% * 96,500,000 lekë (vlera e investimeve të porealizuara) * 1 (vitet vonesë) = 1,930,000 lekë.

- Në total vlera e gjobës sipas viteve për mosrealizimin e investimeve të parashikuara është në shumën 17,062,600 lekë.

3.Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit nuk është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2021/22 dhe për vitin 2022/23. MBZHR me shkresën Nr. 7209 prot., datë 25.10.2021 në zbatim të nenit 5 “Garancia e Kontratës“ pika 1, i ka kërkuar subjektit rinovimin e formularit të garancisë së kontratës. Me shkresën Nr. 4435 prot., datë 29.8.2022 i është ri kërkuar subjektit rinovimi i formularit të garancisë së kontratës. Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar një kopje e garancisë së kontratës për vitin e 2022/23.

4.Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti nuk ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit. MBZHR, në zbatim të nenit 5, pika ‘4’ ka kërkuar informacion mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e qirasë, me anë të shkresës me Nr. 8376 prot., datë 28.12.2021, dhe shkresës Nr. 4435/1 prot., datë 29.8.2022, dhe subjekti ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në MBZHR me Nr. 4435/2 prot., datë 19.9.2022. Gjithashtu me shkresën Nr. 6498 prot., datë 21.12.2022 i është kërkuar informacion mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e qirasë.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 17,062,600 lekë përbën penaltetet për shkak të mosrealizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

-Vlerat totale e detyrimit të shoqërisë “A. P.” ShPK. është 17,062,600 lekë.

- MBZHR ka ndjekur procedurat përkatëse jo në afatet e parashikuara sipas kontratës përkatëse (me nenin 6, pika 5 dhe nenin 7, pika 3 të kontratës), lidhur me përmbushjen e detyrimit për investimin duke përlogaritur penaltetin për mosrealizimin e investimit dhe dërguar shkresën me nr. 1181. Prot, datë20.02.2023. Gjatë kohës së kryerjes së auditimit nga ana e MBZHR subjektit i është dërguar shkresë nr. 1181 prot, dt.20.02.2023, për penaltetet lidhur me mosrealizimin e investimeve.

14- Kontrata Nr: 2117 Rep., Nr. 972 Kol., Nr. 6194 prot., datë 21.8.2017, lidhur me qiramarrësin “C. C.” ShPK. Amenduar me kontratën Nr. 9437 prot., datë 22.10.2020

Objekt i kontratës është dhënie me qira e sipërfaqes 12 ha. Kontrata është amenduar dy herë me Nr. 2876/2 prot., datë 4.5.2020, ku është zëvendësuar qiramarrësi nga A.T. në shoqërinë “C. C.” ShPK. si dhe është korrigjuar numri i pasurisë. Amenduar me kontratën Nr. 9437 prot., datë 22.10.2020, ku ka ndryshuar afati nga 30 (tridhjetë) vjet në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet si dhe është shtuar aktiviteti për veprimtari pritëse në funksion të aktivitetit bujqësor (agro turizëm). Vlera e qirasë vjetore: 96,000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/total/vit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 4 Shtator 2017, ndërsa për periudhën vijuese deri me datën 21 Gusht të çdo viti pasardhës. Subjekti i ka kryer pagesat e qirasë. Vlera e investimit është 49,829,658 Lekë.

Struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave e përbërë nga M. K. dhe E. Q. ka kryer monitorimin e subjektit “C.C.” ShPK. të pasqyruar në procesverbalin Nr. 5265/1 prot, dt. 17.10.2022. Në dosje nuk ka monitorime të tjera të kryera gjatë viteve të mëparshme.

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë është 996,593.16 lekë.

1. Nga verifikimi në terren sipas procesverbalit të grupit të monitorimit rezulton se në zbatim të nenit 2 të kontratës “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit” subjekti ka kryer punimet e parashikuara në plan biznes por në dosje gjenden fatura nga të cilat rezulton se investimet kanë filluar në muajin gusht të vitit 2021. Në këto kushte investimi i parashikuar në planin e biznesit për katër vitet e para 2017-2021 nuk është realizuar në vitet e planifikuara sipas plan biznesit.

Në Kontratën e Qirasë, neni 6 “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, parashikon se: “Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3”.

Në Kontratën e Qirasë Neni 7 “Sanksione”, pika 3, parashikon se: “Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”. Në planin e biznesit të miratuar nga ana e MBZHR vlera e investimeve se si do të realizohen këto investime nuk është e specifikuar dhe e ndarë në vite. Ndërkohë që në kontratën e lidhur midis palëve në nenin 7 pika 3 parashikohet gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë. MBZHR nuk ka përllogaritur penalitete. Në planin e biznesit realizimi i investimit nuk është përcaktuar i ndarë në vite dhe nuk është përllogaritur penalteti ndaj subjektit.

2. Subjektit ka dorëzuar garancinë e kontratës për vitin e parë në datë 01.11.2021, me nr.062419, në vlerën 996,593 lekë pranë Sigal. Për vitin 2022 është kryer sigurimi i garancisë së kontratës.

3. Lidhur me qiranë ky subjekt nuk rezulton debitor.

15- Kontrata e qirasë Nr. 4527 Prot., Nr. 1174 Rep., Nr. 481/1 Kol., datë 6.6.2017, me palë qiramarrëse subjektin E. B., Person Fizik.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 7 ha, ngastra me numër 189 ose 201/13 sipas ZVRPP Gjirokastër, Zona Kadastrale nr. 8541, me vendndodhje në zonën Bashkia Gjirokastër, Qarku Gjirokastër, me qëllim kultivimin dhe prodhimin e kivit, ambiente ruajtje dhe dhomë frigoriferike, për një afat 30 (tridhjetë) vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 126,000 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për kultivimin dhe prodhimin e kivit, ambiente ruajtje dhe dhomë frigoriferike. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë kryhet parapagim në momentin e lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 19

Qershor 2017, pagesat e tjera me datën 6 Qershor të çdo viti pasardhës. ***Vlera e investimit ec përcaktuar në Shtojcën 2 është 29,360,800 lekë, e cila nuk përputhet dhe me vlerën totale të plan biznesit shuma 25,989,750 lekë.*** Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale brenda një jave nga dorëzimi i Pasurisë nga Qiradhënësi. Vlera maksimale e garancisë 587,216 lekë. Kontrata nuk është regjistruar DVASHK Gjirokastër. MBZHR ka monitoruar qiramarrësin për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe sipas procesverbalit të mbajtur në subjekt me dt. 17.11.2022, protokolluar me nr. 5873/2, dt. 22.11.2022, ka rezultuar se subjekti ka kryer rrethimin e sipërfaqes së tokës (shtylla betoni dhe tel), ngritjen e sistemit të ujitjes me pika dhe mbjelljen sipërfaqes së tokës me lajthi (të moshës rreth 2 vjeçare). Subjekti ka planifikuar të kryejë në vitin 2017 investime në ndërtimin e plantacionit me kivi, konkretisht (pastrimin e parcelës, kryerjen e plehërimit, plugimit, frezimit, transportin e plehut kimik dhe organik, kryerjen e piketimeve, hapjen e gropave, blerjen e fidanëve, mbjelljen e fidanëve, lidhjen e fidanëve, vendosjen e sistemit ujitës, etj. Në vitin 2018 subjekti ka planifikuar të ndërtojë hangarin e mekanikës bujqësore dhe veglave të punës. Në vitin 2023 ka planifikuar ndërtimin e magazinës dhe ndërtimin e dhomës frigoriferike.

1.Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton se qiramarrësi e ka paguar qiranë e tokës edhe pse tokën nuk e ka marrë në dorëzim. MBZHR ka llogaritur dhe kamatëvonesat për vitet si më poshtë: Në nenin 7 “Sanksione” të Kontratës së Qirasë, parashikohet se: *“Qiramarrësi, paguan gjobë në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë”*. Kamatëvonesat për vitin 2020

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 6.6.2020, është kryer në datën 8.6.2021, pra 367 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 126,000 * 0.5% = 630 lekë.

Totali kamatave për vitin 2020 = 367 ditë * 630 lekë (kamatë ditore) = 231,210 lekë.

Kamatëvonesat për vitin 2021:

Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datë 6.6.2021, është kryer në datën 8.6.2021, pra 2 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5% = 126,000 * 0.5% = 630 lekë .

Totali kamatave për vitin 2021 = 2 ditë * 630 lekë (kamatë ditore) = 1,260 lekë.

-Totali I kamatëvonesave është në vlerën 232,470 lekë.

2.U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit lidhur me këtë komponent rezulton: Vlera e investimit është përcaktuar 29,360,800 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me realizimin e investimeve. Nga procesverbali i monitorimit i kryer në terren me datë 22.01.2019 nga Struktura Përgjegjëse për monitorim Mimoza Kita dhe Hava Memko rezulton se qiramarrësit nuk i është dorëzuar me procesverbal sipërfaqja e dhënë me qira sipas kontratës së qirasë Nr. 4527 Prot., Nr. 1174 Rep., Nr. 481/1 Kol., datë 6.6.2017, me palë MBZHR dhe qiramarrës subjekti E.B. Bazuar në këtë procesverbal nuk është bërë saktësimi i sipërfaqes pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme Gjirokastër duke qenë se pretendohet se sipërfaqja nuk është 7 ha si në kontratën e nënshkruar nga palët. Gjithashtu në këtë sipërfaqe rezulton se një pjesë e saj ka pësuar gërryerje nga lumi që kalon pranë tokës me pasojë zvogëlimin e sipërfaqes. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastër e ka informuar MBZHR me shkresën nr. 22.05.2017 nga DAMT Gjirokastër rezulton se në ZVRPPGJ kjo sipërfaqe rezulton 7 ha, ndërsa në terren pas gërryerjes që ka pësuar nga ujërat e lumit është rreth 3.46 ha. MBZHR është në kundërshtim me nenin 1 të kontratës në të cilën parashikohet se: *Objekt i kësaj kontrate është marrja me qira e pasurisë nga ana e Qiramarrësit. Dorëzimi i pasurisë do të kryhet nëpërmjet një procesverbali të nënshkruar nga palët.* Gjithashtu MBZHR është në kundërshtim me nenin 3 pika 1/a në të cilin

parashikohet se: “*Qiradhënësi i dorëzon qiramarrësit pasurinë, objekt i kontratës si dhe të lejojë përdorimin e qetë të pasurisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës*”.

Nga procesverbali i monitorimit i kryer në terren me datë 17.11.2022 rezulton se subjekti ka kryer rrethimin e sipërfaqes së tokës (shtylla betoni dhe tel), ngritjen e sistemit të ujitjes me pika dhe mbjelljen sipërfaqes së tokës me lajthi (të moshës rreth 2 vjeçare). Subjekti nuk ka kryer investimin sipas planit të biznesit.

3. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për periudhën 2021 – 2022, Policë Sigurimi e Kontratës me Nr. 0013129, datë 8.6.2021, lëshuar nga kompania e sigurimit “A.” sha, me afat vlefshmërie deri më datë 7.6.2022. Nuk i është dërguar shkresë për garancinë, subjektit për sigurimin e kontratës së qirasë. Nuk ka sigurim kontratë për këtë periudhë.

4. Në dosje ndodhet procesverbali i monitorimit nr. 5873/2, dt. 22.11.2022, në zbatim të nenit 8 të kontratës “Sigurimi i garancisë së Kontratës”, subjekti ka kryer ngurtësimin e fondeve me anë të “Garanci kontrate” dt. 08.06.2021 e vlefshme deri në dt. 07.06.2022. Aktualisht subjekti rezulton të mos ketë kryer rinovimin e garancisë.

Konstatim

-Nuk është kryer dorëzimi i tokës nga MBZHR dhe si pasojë nuk është realizuar investimi nga subjekti rrjedhimisht grupi i auditimit bën me përgjegjësi MBZHR për mos zbatim të detyrimeve kontraktuale parashikuar për dy vitet e para.

-Nuk përputhet sipërfaqja e tokës në kontratë (7 ha) me sipërfaqen e tokës në terren (4.36 ha).

-Nuk është kryer regjistrimi i pasurive në administrim të MBZHR.

-Vlera 232,470 lekë përbën detyrim të pashlyer për kamatëvonesat mbi pagesat e qirasë.

16- Kontrata e qirasë nr. 9099 prot, dt. 14.10.2020, nr. 3381 rep, e nr. 686 kol, dt. 14.10.2020 lidhur me qiramarrësin “W.al” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sip 10.22 ha, Pasuria nr.163, Zona Kadastrale 1559, fshati Drobonik, Njësia Administrative Velabisht, Bashkia Berat, qarku Berat. Afati i kontratës: 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet. Vlera e qirasë: Shuma 62,000 (gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë/total/vit. Afati i pagesës së qirasë është përcaktuar brenda datës 15 Tetor të çdo viti.(vonesa në pagesë 0.05% e detyrimit vjetor për çdo ditë vonesë, neni 14 “Sanksione” i kontratës.). Pagesa e parë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës. Vlera e investimit: 41,297,997 lekë. Grupi i punës ka mbajtur procesverbalin nr. 9401/1 prot., datë 29.10.2020 për dorëzimin e tokës qiramarrësit në zbatim të urdhrit nr. 439, dt. 21.10.2020, protokolluar me nr. 9401, dt. 21.10.2020. Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit): *(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)*

1. Lidhur me qiranë vjetore, bazuar në procesverbalin e monitorimit rezulton se është kryer parapagimi i vlerës së qirasë vjetore brenda 30 ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës me mandatin dt 02.11.2020 për pagimin e qirasë për vitin 2020/2021, në përputhje me kontratën e qirasë.

2. Nga MBZHR është kryer verifikimi në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit. Sipas procesverbalit të monitorimit të mbajtur nga Struktura Përgjegjëse për monitorimin: znj. M. K., z. E. Q., z. A.Z. dhe z. I. M. (përfaqësues i subjektit), në terren në datën 19.10.2022, rezultoi se subjekti janë kryer punimet parapërgatitore (hapja dhe sistemimi i rrugës kryesore, pastrimi i shkurreve dhe barishteve, zhvendosje dherash, plugim, frezim ,etj. Janë hapur kanalet kulluese të ujit, është ndërtuar një depo uji, etj.

3. Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton se nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Gjatë monitorimit në terren në datën 19.10.2022, rezultoi se subjekti ka investuar në tokat e marra me qira, duke respektuar parashikimet e përcaktuara në kontratë dhe

plan biznes. Qiramarrësi ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe investuar sipas parashikimeve të planit të biznesit.

4. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit është paraqitur “*Sigurimi i garancisë së kontratës*” në vlerën 825,600 lekë, nga kompania “S.” U. G.A., me numër serie 064848 datë 26.8.2022, i cili është i vlefshëm deri në datën 26.8.2023.

5. Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se MZHBR, në zbatim të nenit 7, shkronja ‘c’ ka kërkuar informacion mbi përmbushjen e detyrimeve kontraktore me anë të shkresës me Nr. 8441 prot., datë 29.12.2021, Nr. 6744 prot., datë 30.12.2022 për të cilat subjekti me anë të shkresës protokolluar në MBZHR me Nr. 11506 prot., datë 29.12.2020, Nr. 5514/3 prot., datë 28.12.2021, Nr. 4639 prot., datë 9.9.2022 dhe shkresës me Nr. 1603 prot., datë 10.3.2023 ka kthyer përgjigje duke bashkangjitur informacion mbi ecurinë e investimit.

17- Kontrata e Qirasë Nr. 311 prot., Nr. 178 Rep., Nr. 32/4 Kol., datë 15.1.2020, lidhur me qiramarrësin shoqëria “R.S.” ShPK.

Nga auditimi i dosjes së subjektit rezulton se objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 91.7552 ha, pasuritë numër 143, nr. 144, nr. 360, nr. 364, nr. 365, nr. 369 dhe nr. 390, Zona Kadastrale nr. 3358, të cilat ndodhen në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, për mbjellje arrorësh dhe shegë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 780,000 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për mbjelljen e arrorëve dhe shegëve. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës. *Vlera e investimit është përcaktuar 193,540,320 lekë sipas planit të biznesit por sipas tabelës së paraqitur në plan biznes rezulton 201,796,320 lekë*. Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit).

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 3,870,806.4 lekë. Sipas Urdhrit të Ministrit Nr. 20 datë 17.1.2020 është ngritur grupi i punës për dorëzimin e tokës në përdorim, dorëzim i cili është realizuar me Proces-Verbalin Nr. 311/2 prot, datë 22.1.2020.

1. Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, lidhur me qiranë e tokës ka konstatuar se subjekti e ka paguar qiranë e vitit të parë me 229 ditë vonesë. Është përlllogaritur kamatëvonesa 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë, si më poshtë:

-Kamatëvonesat për vitin 2020: Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës (ose në datën 15.1.2020). Pagesa e qirasë vjetore është kryer në datën 31.8.2020 ose 229 ditë me vonesë, të cilat në zbatim të nenit 1 dhe nenit 7, pika 1, të kontratës, llogariten si vijon:

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 780,000 * 0.5 % = 3,900 lekë, kamatëvonesë ditore

Totali kamatave për vitin 2020 = 229 ditë (nga data 15.1.2020 deri 31.8.2020) * 3,900 lekë (kamatë ditore) = 893,100 lekë, vlerë e cila mbartet dhe në periudhën e auditimit.

-Kamatëvonesat për vitin 2021: Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar brenda tremujorit të parë të vitit përkatës (ose brenda datës 15.4.2021), por rezulton të jetë paguar në mënyrë pjesore (500,000 lekë) në datën 13.10.2021, ose 181 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1 dhe nenit 7, pika 1, të kontratës, llogariten si vijon:

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 780,000 * 0.5 % = 3,900 lekë, kamatëvonesë ditore

Kamatëvonesa për vitin 2021 = 181 ditë (nga data 15.4.2021 deri 13.10.2021) * 3,900 lekë (kamatë ditore) = 705,900 lekë.

-Qiraja pjesore e mbetur pa paguar prej 280,000 lekë është kryer si pagesë në datën 4.3.2022 ose 142 ditë me vonesë nga data (13.10.2021 deri në datën 4.3.2022).

1 ditë vonesë = (principal i mbetur i papaguar) * 0.5 % = 280,000 * 0.5 % = 1,400 lekë, kamatëvonesë ditore pjesore.

Kamatëvonesa mbi vlerën e mbetur prej 280,000 = 142 ditë (nga data 14.10.2021 deri 4.3.2022) * 1,400 lekë (kamatë ditore pjesore) = 198,800 lekë.

-Kamatëvonesat për vitin 2022: Qiraja vjetore duhet të ishte paguar brenda tremujorit të parë të vitit përkatës (ose brenda datës 15.4.2022). Pagesa e qirasë vjetore është kryer në datën 22.7.2022 ose 98 ditë me vonesë, të cilat në zbatim të nenit 1 dhe nenit 7, pika 1, të kontratës, llogariten si vijon:

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 780,000 * 0.5 % = 3,900 lekë, kamatëvonesë ditore

Kamatëvonesa për vitin 2022 = 98 ditë (nga data 15.4.2022 deri 22.7.2022) * 3,900 lekë (kamatë ditore) = 382,200 lekë.

-Aktualisht ky subjekt rezulton debitor për kamatëvonesë në vlerën 2,180,000 lekë. Nga ana e MBZHR i është dërguar shkresa për pagesën e qirasë të vitit 2022/23 me Nr. 2051 prot., datë 6.4.2022, shkresa Nr. 676/1 prot., datë 8.4.2021 dhe shkresa Nr. 5211 prot., datë 13.7.2021.

2. U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Lidhur me këtë komponent rezulton se vlera e investimit është përcaktuar 193,540,320 lekë. Me Marrëveshje Sigurie nr. 684/2 Prot., datë 12.5.2021 është shtyrë afati i realizimit të investimeve të parashikuara në plan biznes, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshje. Investimi për vitin e parë të planifikuar fillon pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Nga MBZHR është kryer verifikimi në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit. Subjekti është verifikuar në datën 26.1.2021 dhe është mbajtur Procesverbali me Nr. 405/1 prot., datë 27.1.2021 nga Struktura Përgjegjëse për monitorimin: nj. M.K. dhe z. E.Q.

Për vitin e parë të investimeve 2021/2022, referuar shkresës të dërguar nga qiramarrësi në MBZHR me Nr. 4474 prot., datë 31.8.2022 rezulton se është realizuar nga subjekti qiramarrës investimi në vlerën 7,162,020 lekë. Me marrëveshjen siguroese nr. 684/2 prot, dt. 12.05.2021 është shtyrë afati i realizimit të investimeve të parashikuara në planin e biznesit (për shkak të pandemisë). Investimi në vitin e parë fillon nga dt. 12.05.2021. Neni 3 “Të ndryshme” i marrëveshjen siguroese nr. 684/2 prot, dt. 12.05.2021 parashikon se: *Në rast se në përfundim të vitit të parë, i cili sipas nenit të kësaj marrëveshje fillon në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, konstatohet se qiramarrësi nuk ka realizuar investimet e parashikuara për vitin e parë sipas plan-biznesit, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë.*

Për vitin e 2021-2022 nuk është realizuar investimi në vlerën 21,376,000 lekë, duke vepruar në kundërshtim me planin e biznesit. Në bazë të nenit 7/3 të kontratës parashikohet se: *“Qiramarrësi duhet të paguajë një penaltitet në formën e kushtit penal për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 0.5% të vlerës së investimit të pakryer për çdo vit vonesë.*

-Subjekti nuk ka realizuar të gjithë investimin sipas planit të biznesit në vlerën 14,213,980 Lekë (21,376,000 -7,162,020).

-Penaliteti që duhet të paguajë subjekti është 71,069.9 Lekë (14,213,980* 0.5%)

-Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimin i kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se MBZHR nuk ka vendosur penaltitet për mosrealizimin e investimit, nuk ka kërkuar prishjen e kontratës dhe nuk ka sekuestruar garancinë.

3. Grupi i auditimit lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës konstatoi se për periudhën objekt auditimi nga MBZHR nuk janë kryer verifikime në terren. Në dosje gjendet procesverbali nr. 405/1, datë 27.01.2021 mbajtur nga Struktura përgjegjëse për monitorimin e përbërë nga M. K.; E. Q. dhe është firmosur nga qiramarrësi, shoqëria “R.S.” ShPK. Shkresa “Raport mbi realizimin e investimeve” është e pa protokolluar dhe pa datën në të cilin është hartuar.

4. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2021/22. “Garanci Kontrate” nga kompania “A.” me Numër Serie 062601 i vlefshëm deri në datën 10.5.2022. Nuk është kryer sigurimi për vitin 2022/23.

5. Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, protokolluar në MBZHR me Nr. 4474 prot., datë 31.8.2022, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues. MZHBR, në zbatim të nenit 5, pika ‘4’ ka dërguar njoftim me anë të shkresës

me Nr. 6685 prot., datë 30.12.2022, shkresës nr. 676 prot., datë 19.1.2021 dhe Nr. 8410 prot., datë 29.12.2021.

Konstatim

-Grupi i auditimit pas verifikimit të dokumentacionit të dosjes arrin në këto përfundime:
-Si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- a) Vlera prej 71,069.9 lekë përbën penalitet për shkak të mosrealizimit të investimeve sipas planit të biznesit.
- b) Vlera prej 2,180,000 lekë përbën kamatëvonesave për vitet 2020;2021;2022 lidhur me qiranë.
- c) Vlera prej 2,251,070 lekë përbën detyrimin total të subjektit “R.S.” ShPK. për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimin e kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se MBZHR nuk ka vendosur penalitet për mosrealizimin e investimit, nuk ka kërkuar prishjen e kontratës dhe nuk ka sekuestruar garancinë. Qëndrimi i MBZHR bie në kundërshtim me dispozitat e mëposhtme:

a. VKM nr. 373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, pika VII/1 “Monitorimi i Kontratave”, ku parashikohet: *“Qiradhënësi është përgjegjës për ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura në përputhje me këtë vendim, si dhe kontratat në proces, të lidhura sipas vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të ndryshuar”.*

b. Nenin 6 të kontratës së qirasë “Zgjidhja e Kontratës”, pika 5, ku parashikohet se: *“Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë: a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, sipas nenit 7, pika 3”.*

c. Nenin 7 të kontratës së qirasë “Sanksione”, pika 3, ku parashikohet se: *“Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë”.*

d. Nenin 8 të kontratës së qirasë nenit “Sigurimi i garancisë së kontratës” ku parashikohet se: *“Sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate”.*

18- Kontrata e Qirasë nr. 293 prot, dt. 14.01.2015, Nr. 317 prot., Nr. 180 Rep., Nr. 33/4 Kol., datë 15.1.2020, lidhur me qiramarrësin subjektin shoqëria “A. B. F.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe prej 29.42 ha, të përbërë nga pasuritë nr; 84/1, volumi 3, faqe 245, me sipërfaqe 13.68 ha, nr; 84/3, volumi 3, faqe 247, sipërfaqe 8.68 ha dhe nr; 84/8, volumi 4, faqe 2, sipërfaqe 7.06 ha, në Zonën kadastrale nr. 3301, fshati Seman i Ri, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, me qëllim kultivimin e lajthisë, shegës dhe kivit për një afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 780,000 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për mbjelljen e lajthi, shegë, bajame dhe arra. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e qirasë 500,140 lekë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, pagesat e tjera brenda tremujorit të parë të vitit përkatës. Me shkresën Nr. 528/7 Prot., datë 4.2.2022, protokolluar në MBZHR me Nr. 843 Prot., datë 8.2.2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dërguar Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditin e kryer në MBZHR, me objekt “Auditim financiar dhe përputhshmërie”. Nga auditimi i Kontratës së Qirasë Nr. 317

prot., Nr. 180 Rep., Nr. 33/2 Kol., datë 15.1.2020, me palë Qiradhënës Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Qiramarrës shoqëria "A.B.F." ShPK, ka rezultuar si më poshtë:

Në Kontratën e Qirasë, neni 1 "*Objekti, afati dhe vlera e kontratës*", pika 3, paragrafi i dytë, parashikohet se: "*Palët bien dakord që vlera e qirasë vjetore për marrjen me qira të Pasurisë të jetë 17,000 (shtatëmbëdhjetë mijë) lek/ha/vit ose 500,140 (pesëqind mijë e njëqind e dyzet) lek/totali/vit vlera e qirasë vjetore për gjithë sipërfaqen prej 29,42 ha që do të merret me qira, ("Çmimi i Qirasë),... Vlera e qirasë së tokës objekt i kësaj kontrate, parapaguhet nga ana e qiramarrësit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tre mujorit të parë të vitit përkatës". Në lidhje me këtë parashikim në Raportin Përfundimtar të KLSH-së është lënë rekomandimi që Neni 1 "*Objekti, afati dhe vlera e kontratës*", pika 3, paragrafi i dytë, të amendohet dhe çmimi fillestar i qirasë duhet të jetë 532,986.00 lekë, për të cilën është dakordësuar me subjektin amendimi i kontratës së qirasë sa i takon vlerës së qirasë vjetore. Vlera e investimit është përcaktuar 83,747,600 lekë.*

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi me vonesë i tokës në datë 12.11.2020 e lirë dhe pa pretendime. Kontrata në ASHK është regjistruar gjithashtu dhe sipërfaqja për të gjitha pasuritë në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së. Në dosje gjendet "Raport mbi realizimin e investimeve të subjektit" i cili është pa datë dhe i pa protokolluar.

1. Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton:

Në nenin 7 "*Sanksione*" të kontratës së qirasë, pika 1, parashikohet se: "*Qiramarrësi, paguan kamatëvonesë në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë*". Në zbatim të parashikimeve të sipërcituara rezulton si vijon:

Kamatëvonesat për vitin 2020

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar më datën 15.1.2020. Pagesa është kryer në datën 29.1.2020 pra 14 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 500,140 * 0.5 % = 2,500.70 lekë

Totali kamatave për vitin 2020 = 14 ditë * 2,500.70 lekë (kamatë ditore) = 35,009.80 lekë.

Kamatëvonesat për vitin 2021

Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar deri më datën 15.4.2021. Pagesa është kryer në datën 8.6.2021 pra 54 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 500,140 * 0.5 % = 2,500.70 lekë

Totali kamatave për vitin 2021 = 54 ditë * 2,500.70 lekë (kamatë ditore) = 135,037.80 lekë.

Kamatëvonesat për vitin 2022

Për vitin 2022 qiraja vjetore duhet të ishte paguar deri më datën 15.4.2022. Pagesa është kryer në datën 19.4.2022 pra 4 ditë me vonesë.

1 ditë vonesë = (principal) * 0.5 % = 500,140 * 0.5 % = 2,500.70 lekë

Totali kamatave për vitin 2022 = 4 ditë * 2,500.70 lekë (kamatë ditore) = 10,002.80 lekë.

Në total për tre vitet e qirasë të paguara nga subjekti janë akumuluar kamatëvonesa në vlerën 180,050.40 lekë. Subjekti në datën 24.12.2021 ka paguar kamatëvonesa në vlerën 170,048 lekë.

Aktualisht rezultoni debitor në kamatëvonesa në **vlerën 10,002.40 lekë**.

2. U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Nga MBZHR për vitin 2022 nuk është kryer verifikimi në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit. Për vitin e parë të investimeve 2021/2022 është realizuar nga subjekti qiramarrës investimi në vlerën 0 (zero) lekë, jo në zbatim të planit të biznesit. Me dorëzimin e sipërfaqes së dhënë me qira qiramarrësi referuar parashikimeve të kontratës dhe planit të biznesit, pjesë përbërëse e saj, duhet të fillonte përmbushjen e tyre, sipas sasive dhe afateve. Subjekti qiramarrës nuk ka kryer asnjë investim në sipërfaqen e marrë me qira dhe pse

kanë përfunduar dy vite të kontratës së qirasë, si dhe në dosje nuk gjenden dokumente justifikues (fatura) dorëzuar në MBZHR apo dokument tjetër provues për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

-Për vitin 2020-2021 nuk është realizuar investimi në vlerën 8,960,000 lekë. Në Kontratën e Qirasë, neni 1 “Objekti, afati dhe vlera e kontratës”, pika 2, parashikohet se: “Dorëzimi i pasurisë do të kryhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, nëpërmjet një inventari të nënshkruar nga Qiradhënësi së bashku me përfaqësuesin e Drejtorisë së Administrimit dhe mBrojtejs së tokës, pranë Këshillit të Qarkut Fier, ku gjendet toka bujqësore dhe Qiramarrësi”..... Neni 3 “Të drejta dhe detyrime të Qiradhënësit”, paragrafi i parë, shkronja “a”, parashikon se: “Qiradhënësi ka për detyrë t’i dorëzojë Qiramarrësit Pasurinë, objekt i kësaj kontrate, si dhe të lejojë përdorimin e qetë të Pasurisë nga Qiramarrësi gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës”.

Bazuar në parashikimet si më lart, brenda afatit është ngritur Grupi i Punës me Urdhrin Nr. 19, datë 17.1.2020, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për dorëzimin e tokës qiramarrësit, i cili pas lirimit të tokës nga zaptimet (një pjesë e sipërfaqes) me datë 12.11.2020 ka proceduar me dorëzimin në përdorim Qiramarrësit të tokës së dhënë me qira në këtë kontratë qiraje, me procesverbalin nr. 6710/5 prot., datë 12.11.2020, dorëzim i cili ka rezultuar pa problematika dhe sipërfaqja pa vese e të meta.

Nga momenti i dorëzimit fillon dhe afati për realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit pjesë përbërëse e kontratës së qirasë (fundi i vitit 2020).

Në Kontratën e Qirasë, neni 3 “Të drejta dhe detyrime të qiradhënësit”, pika1, shkronja “b”, parashikohet se: “Qiradhënësi ka për detyrë të ushtrojë kontrolle periodike mbi Pasurinë, për të verifikuar nëse Qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe ato të parashikuara në kontratë”..... Neni 4 “Plani i investimeve”, parashikohet se: “Investimet që do të realizohen nga Qiramarrësi, janë në përputhje me planin e biznesit të aktivitetit, pjesë përbërëse e kësaj kontratë”.

Referuar parashikimit të sipërcituar është njoftuar Qiramarrësi për procesin e monitorimit dhe është kryer verifikimi në terren në datë 05.01.2023, ku nga verifikimi në terren rezultoi se Qiramarrësi në pasuritë e marra me qira me nr. 84/1; nr. 84/3 dhe nr. 84/8, nuk kishte kryer asnjë punim dhe toka ishte djerrë dhe e pa mbjellë. Struktura përgjegjëse pas monitorimit në terren të kësaj kontrate ka mbajtur procesverbalin e monitorimit me Nr. 899/2 prot., datë 7.2.2023.

Në Kontratën e Qirasë, Neni 6 “Zgjidhja e kontratës”, pika 3, pika 10, parashikohet se: “Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi, si më poshtë:

a) Nëse në përfundim të vitit të parë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar vlerën e investimeve kapitale të parashikuara në Planin e Biznesit për këtë vit, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;

b) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20 % e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;

c) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar 70 % të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3.

Në kushtet ku subjekti nuk ka kryer asnjë investim në sipërfaqen e marrë me qira dhe pse kanë përfunduar dy vite të kontratës së qirasë, duke marrë si datë fillimi ditën e dorëzimit në përdorim të sipërfaqes qiramarrësit, si dhe kur nga subjekti nuk është dorëzuar në MBZHR asnjë faturë apo dokument tjetër provues për përmbushjen e detyrimeve kontraktore, nga MBZHR me shkresën me Nr. 1361/2 prot., datë 13.3.2023 është njoftuar subjekti se nga MBZHR do të fillojë procesi për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 10,002.40 lekë përbën kamatëvonesave lidhur me qiranë.

-MBZHR ka ndjekur procedurat përkatëse lidhur me përmbushjen e detyrimit për investimin pasi ka dërguar shkresën Nr. 1362/2 prot., datë 13.3.2023, Lënda “Njoftim për përmbushjen e detyrimeve kontraktore dhe Procesverbali me Nr. 899/2 prot., datë 7.2.2023 për monitorimin në terren.

19- Kontrata e qirasë Nr. 748/1 Prot., Nr. 3051 Rep., Nr. 613 Kol., datë 22.9.2020, lidhur me qiramarrësin subjektin “F. A.” ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 304.4794 ha, e përbërë nga pasuritë nr. 4/1; nr. 5/1; nr. 14/1; nr. 14/3; nr. 15/1; nr. 15/3; nr. 16/1; nr. 17/1; nr. 18/1; nr. 19/1; nr. 20/1; nr. 20/3; nr. 21/1; nr. 22/1; nr. 23/1; nr. 24/1; nr. 24/4; nr. 25/1; nr. 61/4; nr. 62/1; nr. 67/1; nr. 67/4; nr. 67/8; nr. 67/9; nr. 68/1; nr. 68/4; nr. 68/7; nr. 68/8; nr. 69/1; nr. 70/1; nr. 71/1; nr. 72/1; nr. 72/8; nr. 72/9; nr. 79/1; nr. 79/4; nr. 81/1; nr. 82/1; nr. 84/1; nr. 447/1; nr. 448/1; nr. 449/1; nr. 449/8; nr. 450/1dhe nr. 450/3, Zona Kadastrale nr. 2085, e cila ndodhet në Karavasta e Re, Njësia Administrative Rremas, Bashkia Divjakë, Qarku Fier, me qëllim kultivimin e perimëvë të ndryshme në fushë të hapur, serrë eksperimentale 0.5 ha dhe infrastrukturë përpunuese dhe mbështetëse në funksion të aktivitetit bujqësor, për një afat 99 vjeçar.

Në zbatim të rekomandimit të KLSH të përcaktuar në Raportin Përfundimtar dërguar me shkresën Nr. 528/7 prot., datë 4.2.2022, MBZHR-së dhe subjekti “F.A.” ShPK, kanë nënshkruar me shkresën nr. 4931 prot, dt. 27.09.2022 procesverbalin mbi amendimin e Kontratës së Qirasë, sa i takon vlerës së qirasë vjetore të përcaktuar në këtë kontratë, e cila nga shuma 3,000,035.53 (tre milion e tridhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e tre) lekë duhet të jetë në shumën 3,163,948.47 (tre milion njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë pikë dyzet e shtatë) lekë/total/vit. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë parapagim deri në 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës; pagesat e tjera brenda datës 20 gusht të çdo viti. Vlera e investimit është përcaktuar 932,660,229 lekë.

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 392,750 lekë.

Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës pasqyruar në procesverbalin me nr. 748/4 prot., datë 26.10.2020 i mbajtur për procesin e dorëzimit, në të cilin u dorëzuar të lira dhe pa problematika të gjitha sipërfaqet e trajtuara me qira, përveç pasurisë nr. 448/1, Vol 5, faqe 41 me sipërfaqe 6804 m², e cila sipas hartës treguese të regjistrimit lëshuar nga DVASHK Lushnje, ka rezultuar e zaptuar. Për këtë zaptim subjekti ka deklaruar se mospërdorimi i kësaj sipërfaqe nuk e pengon në realizimin e parashikimeve të Planit të Biznesit të paraqitur në konkurrim dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë. Kontrata e qirasë është regjistruar në ASHK.

1.Lidhur me qiranë e tokës nga verifikimi i dosjes së kontratës së mësipërme rezulton si më poshtë: *(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)*

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se qiramarrësi ka paguar kamatëvonesa:

Shuma 139,501 lekë në datë 27.1.2022;

Shuma 250,503 lekë në datë 25.11.2022.

Në nenin 14 “Sanksionet/Penalitetet”, të Kontratës së Qirasë, parashikohet se: “Në rast se Qiramarrësi është në mosrespektim të afateve të pagesës siç përcaktohet në nenin 3, paguan kamatëvonesë në vlerën 0.05% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera e qirasë së një viti”.

Në zbatim të parashikimeve të sipërcituara ka rezultuar si vijon:

Kamatëvonesat për vitin 2020

Për vitin 2020 qiraja vjetore duhet të ishte paguar me deri me datë 22.10.2020, por pagesa është kryer në datën 4.11.2020, pra 13 ditë me vonesë. Sa më sipër rezulton:

1 ditë vonesë = (principal) * 0.05% = 3,000,035.53 * 0.05% = 1,500.02 lekë;

Kamatëvonesa për vitin 2020 = 13 ditë * 1,500.02 lekë (kamatë ditore) = 19,500.23 lekë.

Kamatëvonesat për vitin 2021

Për vitin 2021 qiraja vjetore duhet të ishte paguar me deri me datë 20.8.2021, por pagesa është kryer në datën 27.1.2022, pra 160 ditë me vonesë. Sa më sipër rezulton:

1 ditë vonesë = (principal) * 0.05% = 3,000,035.53 * 0.05% = 1,500.02 lekë;

Kamatëvonesa për vitin 2021 = 160 ditë * 1,500.02 lekë (kamatë ditore) = 240,002.84 lekë.

Kamatëvonesat për vitin 2022

Në bazë të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit ardhur në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën Nr. 843/3 prot., datë 2.3.2022 dhe proces-verbalit Nr. 4931 prot., datë 27.9.2022, vlera e qirasë për vitin 2022 ka ndryshuar nga 3,000,035.53 lekë në 3,163,948.47 lekë.

Për vitin 2022 qiraja vjetore duhet të ishte paguar me deri me datë 20.8.2022, por pagesa është kryer në datën 25.11.2022, në shumën prej 3000,035.53 dhe në datë 9.1.2023 për diferencën e shtuar të qirasë, pra me 97 ditë vonesë për qiranë në total dhe 45 ditë vonesë për diferencën. Sa më sipër rezulton:

1 ditë vonesë = (principal) * 0.05% = 3,163,948.47 * 0.05% = 1,582 lekë.

Kamatëvonesa për vitin 2022 = 97 ditë * 1,582 lekë (kamatë ditore) = 153,454 lekë.

1 ditë vonesë për diferencën = 163,912.94 * 0.05% = 82 lekë.

Kamatëvonesa për diferencën e papaguar viti 2022 = 82 lekë (kamatë ditore) * 45 ditë = 3,690 lekë. Total viti 2022 kamatëvonesa = 153,454 + 3690 lekë = 157,144 lekë.

Duke qenë se subjekti ka paguar 390,004 lekë kamatë vonesa, kjo zbritet nga totali si më poshtë:

19,500.23 (kamata 2020) + 240,002.84 (kamata 2021) + 157,144 (kamata 2022) – 390,004 (kamata të paguara) = 26,643 lekë (kamata të papaguara). **Subjekti rezulton debitor për vlerën 26,643 lekë kamatëvonesa.**

2.U verifikua dosja lidhur me realizimin e investimit sipas kontratës së qirasë. Lidhur me këtë komponent rezulton: Vlera e investimit është përcaktuar 19,637,500 lekë. Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit): *(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)*

Me shkresën datë 29.3.2021, protokolluar në MBZHR me Nr. 2567 prot., datë 30.3.2021 ka kërkuar shtyrjen e afatit për realizimin e investimeve për një vit, kërkesë e cila me shkresën me Nr. 2567/1 prot., datë 11.5.2021 ka miratuar përmbushjen e detyrimit, realizimin e investimeve të parashikuara për vitin “0” dhe “I” në shumën 257,626,220 lekë, brenda vitit pasardhës, duke filluar ky afat nga data 26.10.2021, datë në të cilin përfundon afati i vitit të parë të investimit.

Nga MBZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit. Sipas procesverbalit të monitorimit Nr. 1498/3 prot., datë 14.11.2022 të mbajtur për procesin e monitorimit të kryer në datën 10.11.2022 rezultoi se subjekti në një sipërfaqe prej rreth 1 ha, subjekti kishte kryer mbjelljen e parcelës me lakër dhe ishin kryer të gjitha punimet e nevojshme si (pastrimi i shkurreve dhe barishteve, zhvendosja e dherave dhe pastrimi i sipërfaqes së tokës, plugimi, frezimi dhe plehërimi i sipërfaqes së projektuar për tu mbjellë me perime). Ishte vendosur sistemi i ujitjes me pika, ishin shtrirë tubat ujitëse në të gjithë parcelën e mbjellë dhe në cep të tokës ishte hapur një rezervuar i vogël uji. Referuar pasurive të marra me qira nga subjekti “F. A.” ShPK, nuk ishte kryer asnjë punim dhe toka ishte djerrë dhe e pa mbjellë. Subjekti ka pasur problematika me zaptimin e disa ha tokë.

Për vitin e parë të investimeve 2021/2022 është realizuar nga subjekti qiramarrës investimi në vlerën 1,125,020 lekë, në zbatim të planit të biznesit. *(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)*

Me shkresën me Nr. 298 prot., datë 5.11.2022, protokolluar në MBZHR me Nr. 6551 prot., datë 23.12.2022 ka kërkuar përsëri shtyrjen e afatit të realizimit të investimeve të parashikuara

për vitin "0" dhe "I" të Kontratës së Qirasë, periudha tetor 2021 - 2022, me pretendimin se sipërfaqja e marrë me qira dhe uji që vjen nga Emisari pranë saj, i cili ishte parashikuar të përdorej për vaditje, janë më përmbajtje të lartë kripe dhe për këtë keni implementuar një projekt pilot duke mbjellë një sipërfaqe prej 1 ha dhe jeni në pritje të rezultateve të këtij projekti. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga MBZHR. Në Kontratën e Qirasë, Neni 10 "Zgjidhja e kontratës", pika 1, shkronja "b", parashikohet se: "Kontrata zgjidhet para mbarimit të afatit kur qiramarrësi nuk ka realizuar investimet kapitale sipas parashikimeve në Planin e Biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në këtë rast qiradhënësi njofton qiramarrësin për përmbushjen e këtij detyrimi brenda vitit pasardhës dhe pagimin e penaliteteve sipas nenit 14. Në rast se pas përfundimit të afatit si më lart, qiramarrësi vazhdon të jetë në mosrespektim të këtij detyrimi, qiradhënësi e njofton për zgjidhjen e njëanshme të kontratës".

Në nenin 14 "Sanksionet/Penalitetet", i kontratës së qirasë, pika 3, parashikohet se: "Në rast se Qiramarrësi është me vonesë me realizimin e investimeve kapitale të parashikuara në Planin e Biznesit, detyrohet të paguajë në formën e kushtit penal në masën 10% të vlerës së investimit të pakryer në vit".

Në zbatim të parashikimeve si më sipër subjekti detyrohet të paguajë penalitetet si më poshtë:

- Vlera e investimit të parashikuar (viti 0+I) është shuma prej 257,626,228 lekë;
- Vlera e investimit të realizuar sipas faturave të paraqitura nga subjekti për periudhën 2020 - 2022 është shuma prej 1,125,019.9 lekë;
- Vlera e investimeve të përcaktuara $257,626,228 - 1,125,019.9 = 256,501,208.1$ lekë
- Vlera e penalitetit do të jetë 10% e vlerës së investimit të pakryer në vit:
- Vlera e penalitetit 25,650,120.81 lekë ($10\% * 256,501,208.1$).

Sa më lart bazuar në Nenin 10 "Zgjidhja e kontratës", pika 1, shkronja "b", duhet të njoftohet subjekti të përmbushë realizimin e investimeve të parashikuara për t'u realizuar në vitin "0" dhe "I" në Planin e Biznesit, pjesë përbërëse e kontratës së qirasë, brenda vitit 2023. Gjithashtu subjekti duhet të paguajë penalitet në vlerën **25,650,120.81 lekë** (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e njëzet pikë tetëdhjetë e një) lekë si detyrime që rrjedhin nga kontrata e qirasë, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

3.Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton se nga MZHBR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës. Rezulton se qiramarrësi nuk e ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit.

4. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2020/2021. Formulari i Garancisë së Kontratës ka Nr. 4925/0012836, datë 8.9.2020, lëshuar nga kompania e sigurimit "S." sha dhe është i vlefshëm deri në datën 8.9.2021.

MBZHR me shkresat Nr. 4515 prot., datë 1.9.2021, Nr. 6046/1 prot., datë 24.11.2022, në zbatim të nenit 8 "Sigurimi i garancisë së kontratës" i ka kërkuar subjektit rinovimin e formularit të garancisë së kontratës: Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar ende garancia e kontratës për vitin e 2022/23.

5.Sa i takon informacionit periodik nga qiramarrësi rezulton se subjekti ka depozituar raportin periodik mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në kontratë dhe në planin e biznesit, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues, me shkresat datë 5.3.2022, protokolluar në MBZHR me Nr. 1498 prot., datë 7.3.2022 dhe me Nr. 242 prot., datë 30.11.2022, protokolluar me Nr. 6046/3 prot., datë 30.11.2022. MZHBR, në zbatim të nenit 7, shkronja 'c' ka dërguar njoftim me anë të shkresave me Nr. 8436 prot., datë 29.12.2021, Nr. 6046 prot., datë 24.11.2022, Nr. 6745 prot., datë 30.12.2022 për përmbushjen e raportimit periodik.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 25,650,120.81 lekë përbën penalitet për shkak të mos realizimit të investimeve sipas planit të biznesit.
- Vlera prej 26,643 lekë përbën kamatëvonesa për shkak të qirasë.

-Vlerat totale e detyrimit të subjektin "F. A." ShPK. është 25,676,763.81 lekë.

MBZHR ka ndjekur procedurat përkatëse lidhur me përmbushjen e detyrimit për investimin pasi ka përlloritur penalitetin për mosrealizimin e investimit, dhe ka realizuar njoftimin për përmbushjen e detyrimit me shkresë nr. 1113. Prot, datë 16.02.2023.

20- Kontrata e qirasë Nr. 1897 prot., Nr 944 Rep., Nr. 190 Kol., datë 26.02.2021, lidhur me qiramarrësin subjektin "A.W. & C." ShPK.

Objekt i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sipërfaqe 49.7957 ha, Zona Kadastrale nr. 1843, e përbërë prej ngastrave me numër pasurie 159; nr. 160; nr. 171; nr. 180; nr. 178/5; nr. 179; nr. 181; nr. 182, me vendndodhje në fshatin Gramsh, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, me qëllim ngritjen e vreshtave me rrush dhe infrastrukturës mbështetëse përpunuese, për një afat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjeçar. Vlera e qirasë është parashikuar në shumën 1,100,000 lekë/total/vit. Sipërfaqja e tokës do të përdoret për ngritjen e vreshtave me rrush dhe infrastrukturës mbështetëse përpunuese. Afati i pagesës së qirasë: Pagesa e parë deri në 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës; pagesat e tjera brenda datës 15 mars të vitit përkatës. Vlera e investimit është përcaktuar 151,775,000 lekë. Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 3,035,500 lekë. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës me datë 25.3.2021 pa pretendime. Është regjistruar sipërfaqja (pasuritë) në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së dhe kontrata në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë. MBZHR ka kryer monitorimin e kontratës me procesverbalin nr. 2374/1, dt. 27.04.2022 i përbërë nga M. K.; A. Z. Sipas këtij procesverbali plani i investimeve rezulton si më poshtë:

(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti)

1. Nga MBZHR është kryer verifikimi në terren lidhur me realizimin e investimeve sipas planit të biznesit, subjekti nuk ka realizuar parashikimet e planit të biznesit sa i takon investimeve të parashikuara për vitin e parë të kontratës. Për vitin e parë të investimeve 2021/2022 është realizuar nga subjekti qiramarrës investimi në vlerën 800,000 lekë. Vlera e investimeve të pakryera për vitin 26.2.2021 - 26.2.2022 është shuma **14,377,500 lekë** (15,177,500 - 800,000). Në kontratën e qirasë, Neni 14/3, "Sanksionet/Penalitetet", parashikohet se: "Në rast se Qiramarrësi është me vonesë me realizimin e investimeve kapitale të parashikuara në Planin e Biznesit, detyrohet të paguajë në formën e kushtit penal në masën 10% të vlerës së investimit të pakryer në vit".

Ndaj subjektit "A.W & C." ShPK. është caktuar penaliteti në vlerën **1,437,750 lekë** (14,377,500 * 10%). Kjo gjohë i është njoftuar subjektit me shkresën me Nr. 4917 prot, datë 26.9.2022 por nuk rezulton të jetë paguar. Sipas nenit 10, pika 1/b, të kontratës së qirasë, "Zgjidhja e Kontratës", parashikohet se: "Kontrata zgjidhet para mbarimit të afatit kur Qiramarrësi nuk ka realizuar investimet kapitale sipas parashikimeve në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate. Në këtë rast Qiradhënësi njofton Qiramarrësin për përmbushjen e këtij detyrimi brenda vitit pasardhës dhe pagimin e penaliteteve sipas nenit 14. Në rast se pas përfundimit të afatit si më lart, Qiramarrësi vazhdon të jetë në mosrespektim të këtij detyrimi, Qiradhënësi e njofton për zgjidhjen e njëanshme të kontratës". Nga MZHR pas kalimit të afatit ligjor duhet të ndiqen hapat ligjore për vjeljen e detyrimit.

2. Lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës nga dokumentacioni i dosjes rezulton sa vijon: Nga MZHR janë kryer verifikime në terren lidhur me përdorimin e tokës sipas objektit të kontratës, nga ku rezulton se qiramarrësi nuk e ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit.

3. Lidhur me garancinë e kontratës MBZHR me shkresën Nr. 4918 prot., datë 26.9.2022 në zbatim të nenit 8 "Sigurimi i garancisë së kontratës" i ka kërkuar subjektit paraqitjen e formularit të garancisë së kontratës. Nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për vitin 26.02.2022- 26.02.2023.

Konstatim

Në përfundim, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktore subjekti ka detyrimet në vijim:

- Vlera prej 1,437,750 lekë përbën penalitet për shkak të mos realizimit të investimeve sipas planit të biznesit.

-Vlerat totale e detyrimit të subjektit “A.W & C.” ShPK. është 1,437,750 lekë.

21- Kontrata e qirasë Nr. 3052 prot., nr.1381 Rep, nr.151 Kol, 19.4.2021, lidhur me Shoqërinë “H.P. V.” SHPK.

Objekti i kontratës është dhënia me qira e tokës bujqësore me sip 107,6150 ha, në pasurinë nr. 2, nr.4, nr.5, nr.6, nr.7, nr.8, nr.24, nr.29, nr.31, nr.33, nr.36, nr.38, nr.40, nr.48, nr.54, nr.60, zona kadastrale nr. 1412, të cilat ndodhen në fshatin Çlirim, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë. Afati i kontratës është përcaktuar 10 (dhjetë) vjet. Vlera e qirasë shuma 880,000 (tetëqind e tetëdhjetë mijë) lekë në vit. Me urdhrin nr. 179, dt. 29.04.2021, protokolluar me nr. 3233, dt 29.04.2021, është bërë dorëzimi i tokës qiramarrësit.

Vlera e investimit është përcaktuar 19,637,500 lekë. Afati për përmbushjen e investimit (i ndarë sipas periudhës, me %, sipas p. Biznesit): *(Detajuar në tabelën e Aneksit 3/b bashkëlidhur këtij raporti).*

Vlera e garancisë është përcaktuar në masën 2% të investimeve kapitale. Vlera maksimale e garancisë 392,750 lekë. Kontrata është regjistruar në ASHK.

1. Në lidhje me qiranë sipas procesverbalit të monitorimit të mbajtur në datën 30.11.2022 rezulton se subjekti e ka paguar qiranë e vitit të parë me 43 ditë vonesë. Qira vjetore 880,000 lekë * 0.05 (kamatëvonesë) % = 440 lekë kamatë ditore. Ditë në vonesë 43 * 440 lekë (kamata ditore) = 18,920 lekë. Kjo kamatëvonesë është paguar në datën 8.4.2022. Aktualisht ky subjekt nuk rezulton debitor.

2. Për vitin e parë të investimeve 2021/2022 është realizuar nga subjekti qiramarrës investimi në vlerën 2,519,200 lekë, në zbatim të planit të biznesit. Qiramarrësi ka përdorur tokën sipas objektit të kontratës dhe planit të biznesit.

3. Lidhur me garancinë e kontratës nga ana e subjektit është dorëzuar garancia e kontratës për vitin e 2021/22 në shumën 392,750 lekë. Formulari i Garancisë së Kontratës ka Nr. 005371 datë 16.4.2021 dhe është i vlefshëm deri në datën 15.4.2022. Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar ende garancia e kontratës për vitin 2022/23 kjo në kundërshtim me kontratën sipas nenit 8 “Sigurimi i garancisë së kontratës“ ku parashikohet: *“Sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate”.*

Përmbledhja e mësipërme e kontratave të lidhura nga MBZHR për administrimin e tokave bujqësore është paraqitur në Tabelën nr. 1 të Aneksit nr. 3 të këtij Raporti auditimi.

Sa më sipër arrihet në konkluzion

Gjatë auditimit konstatohet se nga 51 kontrata që janë aktualisht të lidhura, 38 prej tyre ose 75% kanë detyrime në pagimin e qirasë, i cili mbartur prej datës 31.12.2020 rezulton me një shumë totale prej 68,903,834 lekësh, ndërsa për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 konstatohet se shuma e detyrimit për pagim të qirasë si dhe kamatëvonesë në pagimin e qirasë rezulton 29,043,882 lekë. Përgjatë viteve 2021- 2022 janë likuiduar pagesa të vonuara të mbartura mbi qiratë, si rezultat detyrimi i qirasë në fund të vitit 2022 nuk rezulton si shumë e detyrimit në fund vit 2020 me fund vit 2022.

Për mungesë të realizimit të planit të investimit MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur gjoba në shumën 427,044,994 lekë. Këto gjoba janë vendosur gjatë auditimit në terren përgjatë konstatimit të grupit të auditimit. Nga 51 kontratat ende në zbatim konstatohet se 83% e detyrimit për mosrealizim të investimit i korrespondon 3 (tre) shoqërive, “B. A. I. ShPK” me 66% të detyrimit kundrejt detyrimit total, “P.I.” ShPK me 11% të detyrimit dhe shoqëria “F. A.” ShPK me 6% të detyrimit kundrejt detyrimit total që subjektet të cilat përdorin tokat bujqësore kanë ndaj MBZHR.

Nga shumat e mësipërme për mospagim qiraje dhe penalitet për vonesën në pagim në shumën totale 64,979,949 lekë më datë 31.12.2022, për gjoba të mosrealizimit të investimit në shumën totale 427,044,994 lekë, konstatohet se vlera totale 491,724,943 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të kontratave të tokave bujqësore në përdorim.

Titulli i gjetjes nr. 1	Shkurtimi i strukturës së Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave.
Situata	<p>Në auditimin e mëparshëm të KLSH sipas programit të Auditimit nr.528/1 prot datë 14.05.2021, i ndryshuar me shkresën nr.528/2 prot datë 25.05.2021, KLSH ka rekomanduar që MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. Ky rekomandim jo vetëm që nuk është realizuar, por konstatohet se ky sektor bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.88, datë 20.05.2022 ka ngritur strukturën në MBZHR me shkresën nr. 1830/264, datë 04.07.2022 në të cilën rezultojnë se Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteve, Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave në MBZHR është zvogëluar në numër (një përgjegjes dhe 2 specialistë), duke ndikuar në mos përmirësimin e performancës së punës të këtij sektori me gjithë problematikat e konstatuara ndër vite në monitorimin e tokave bujqësore. Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave rezultojnë me ngarkesë të lartë, referuar numrit të kontratave për monitorim dhe detyrave të tjera që lidhen me administrimin e tokës bujqësore pronë e MBZHR-së si dhe problematikave të konstatuara nga ky auditim. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse, Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën”, i ndryshuar.</p> <p>Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njerëzore si dhe vendosja e punonjësve të pakët nga ana e titullarit të MBZHR, në disa procese pune në të njëjtën kohë, për vlerësimin e tokës në terren, përlllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë vjetore, për hartimin e kontratës së qirasë si dhe monitorimin e tyre, nuk ka bërë të mundur të kemi efektivitet të plotë të monitorimit të ecursisë së kontratave të qirasë të tokave bujqësore.</p>
Kriteri	Rekomandim i mëparshëm i KLSH dërguar MBZHR me shkresën nr.528/2 prot datë 25.05.2021. VKM nr.373 datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” kreu VII “Monitorimi i kontratave”, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Mungesë e monitorimit të kontratave të tokave bujqësore.
Shkaku	Zvogëlimi i strukturës së sektorit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga

	pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. MBZHR të marrë masa mbi shtimin në strukturën e sektorit të Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave me një specialist në funksion të mbarëvajtjes së punës në lidhje me monitorimin e kontratave.
--	---

Titulli i gjetjes nr. 2	Fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël nuk shoqërohet me listën e inventarit për pasuritë të cilat jepen me qira.
Situata	<p>Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR ka në administrim të saj fondin e tokës bujqësore për qiradhënie prej 19,033.95 ha, kaluar me aktet e nënligjore si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 45, datë 29.01.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 18,076 Ha. - VKM nr. 995, datë 9.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha. - VKM nr. 142, datë 24.2.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të sipërfaqes së tokës bujqësore” ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 31,4 Ha. <p>Nga vendimet e mësipërme është konstatuar se fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël, i dhënë në bazë të VKM-së nr. 45/2014, “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” nuk është shoqëruar me një kopje të listës së inventarit për pasuritë, të njehsuar me origjinalin, si pjesë e kësaj VKM. Nga MBZHR me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019, i është kërkuar Këshillit të Ministrave, por nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë. Në kushtet kur lista e inventarit të ngastrave që do të jepen me qira ka munguar dhe vijon të mungojë deri në fund të auditimit, del e paqartë se si strukturat përgjegjëse për administrimin e tokave bujqësore në MBZHR, bëjnë shpalljen publike dhe përditësimin e saj. Mungesa e listës së pasurive të VKM nr. 45/2014 konfirmon faktin që MBZHR nuk ka të saktësuar sipërfaqen e tokës që ka në administrim, pasi mungesa e një liste inventari të tokave bujqësore është e mbartur që prej fillimit të dhënies në përdorim të tokave bujqësore deri në fund të periudhës në auditim, në drejtim të së cilës struktura përgjegjëse në MBZHR nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për regjistrimin e sipërfaqes në pronësi. Në vijim MBZHR nuk ka në dispozicion një regjistër të ngastrave të tokës bujqësore të cilat janë në administrim të saj, në kundërshtim të me Kreun II “Objekti i qiradhënies”, të VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, duke</p>

	krijuar riskun e pasaktësive në lidhjen e kontratave të qirasë. Nga sipërfaqja e tokës në administrim të MBZHR, për periudhën 2013-2021 është dhënë me qira sipërfaqja prej 2,519 ha e 7,366 m ² . Për periudhën 2021-2022 është dhënë me qira sipërfaqja prej 107.61 ha. <i>Sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për t'u dhënë me qira është 15,896 ha e 3,488 m², ose 83% e sipërfaqes gjithsej.</i>
Kriteri	VKM-së nr. 45/2014, “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “ <i>Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit</i> ” e ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasaktësi në dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.
Shkaku	Mungesa e listës së inventarit për pasuritë të cilat jepen me qira.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	1. Nga ana e MBZHR të merren masa, për evidentimin e gjithë fondit të tokës bujqësore që ka në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me institucionet dhe organet kompetente shtetërore, si Këshillin e Ministrave dhe Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe. 2. Në vijim MBZHR të marrë masa për hartimin e një regjistri të plotë dhe të saktë të tokës bujqësore, forma dhe përmbajtja e të cilit të miratohen me udhëzimin e ministrit.

Titulli i gjetjes nr. 3	Mungesa e një plani vjetor për monitorimin e kontratave dhe një regjistri të miratuar për kontratat e qirasë.
Situata	1. Gjatë auditimit u konstatua se <i>MBZHR, për periudhën 2013 -2022 ka lidhur 54 kontrata qiradhënie toke bujqësore, nga të cilat 45 kontrata janë aktive deri në fund të periudhës së auditimit dhe vlerësohen sipas parashikimeve kontraktuale, 3 (tre) kontrata janë zgjidhur, 3 (tre) kontrata janë në proces gjyqësor, për 1 (një) kontratë është kërkuar zgjidhja vullnetare nga subjekti dhe për 2 (dy) kontrata ka përfunduar procesi gjyqësor.</i> Nga kontratat aktive vetëm 1 kontratë është lidhur për periudhën nën auditim, konkretisht në vitin 2021. Në lidhje me këto kontrata megjithëse MBZHR ka një regjistër të tyre, ai nuk është i miratuar si nga forma dhe përmbajtja me udhëzim të Ministrit, në kundërshtim me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “ <i>Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit</i> ” e ndryshuar, Kreu VII, pika 4; “ <i>Për këtë qëllim, struktura përgjegjëse mban regjistrin e kontratave të qirasë, forma dhe përmbajtja e të cilit miratohen me udhëzimin e ministrit.</i> ” 2. Nga 45 kontratat aktive u përzgjedhën për auditim 21 kontrata, ose 47% e tyre. Nga auditimi, në lidhje me monitorimin e kontratave nga Sektori Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se ky sektor ka monitoruar: - Për vitin 2019, 8 kontrata, nga 40 kontrata në fuqi, ose 20% e kontratave.

	<p>- Për vitin 2020, 6 kontrata nga 50 kontrata në fuqi, ose 12% të kontratave.</p> <p>- Për vitin 2021, 10 kontrata nga 51 kontrata gjithsej, ose 19,6 % të kontratave.</p> <p>- Për vitin 2022, 14 kontrata nga 51 gjithsej (3 kontrata në proces gjyqësor), ose 27 % e kontratave.</p> <p>Gjatë auditimit të kontratave të qiradhënies së tokave bujqësore u konstatua se MBZHR nuk disponon një plan vjetor për monitorimin e kontratave, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve, nuk u gjendën raporte për çdo vit për monitorimin e kontratave, kjo në kundërshtim me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, Kreu VII, pika 5; “...Për çdo kontratë të lidhur, në fund të vitit struktura përgjegjëse harton raport të hollësishëm për respektimin e kushteve të secilës kontratë dhe ia paraqet ministrit brenda datës 20 janar”. Gjithashtu për monitorimet e kryera nga sektori u konstatua se nuk kishte të dhëna të hollësishme për kontratat e monitoruara në lidhje me gjendjen faktike të investimeve të kryera dhe kulturave të mbjella duke e justifikuar me dokumentet përkatëse, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjeve, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit.</p>
Kriteri	VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, Kreu VII, pikat 4/5, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 16.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e plotësisë në monitorimin e kontratave dhe evidentimi i një regjistrit të plotë dhe të miratuar të kontratave të qirasë.
Shkaku	Mungesë e një plani vjetor për monitorimin e kontratave të tokave bujqësore dhe mungesa e një regjistri të miratuar për kontratat e qirasë.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. MBZHR të marrë masat e nevojshme për miratimin e regjistrit për kontratat e qirasë, në të cilin të mirë përcaktohet forma, përmbajtja si dhe të evidentohet në një kolonë të veçantë monitorimi i secilës kontratë në fund të çdo viti ushtrimor. 2. MBZHR të marrë masat në hartimin e një plani vjetor në fillim të çdo viti për monitorimin e kontratave. MBZHR të hartojë një raport tip për ndjekjen dhe monitorimin e kontratave, ku të pasqyrohet dokumentacioni që duhet të plotësohet gjatë monitorimit, për të justifikuar investimet kapitale të kryera si dhe për shpenzimet për përmirësimin e tokës.
Titulli i gjetjes nr. 4	Struktura përgjegjëse nuk ka protokolluar dosjet e kontratave të qirasë dhe procesverbalet e monitorimit në disa raste janë të pa protokolluara.
Situata	<p>Nga auditimi i 21 kontratave me objekt për dhënie me qira të tokave bujqësore për periudhën në auditim gjatë procesit të realizimit dhe monitorimit u konstatua se:</p> <p>- Dosjet e kontratave të dhëna me qira janë të pa protokolluara, pa fletë inventari në të cilin të evidentohet dokumentacioni pjesë e dosjes, duke krijuar riskun e mungesës, humbjes apo ruajtjes së radhës kronologjike të tyre.</p> <p>Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 24 dhe 44 i Ligjit</p>

	nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar.
Kriteri	Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar, Neni 24 dhe 44
Ndikimi/Efekti	Mangësi në dokumentimin dhe arkivimin e kontratave të qirasë.
Shkaku	Mungesa e zbatimit të dispozitës ligjore për arkivimin.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR të marrë masat për protokollimin e të gjitha procesverbaleve të monitorimit të kontratave të qirasë dhe procesverbalet të nënshkruhen dhe nga ana e qiramarrësit.

Titulli i gjetjes nr. 5	Mos realizim i investimeve të parashikuara në plan biznes nga ana e subjekteve qiramarrëse.
Situata	<p>Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore në lidhje me realizimin e investimeve kapitale rezulton se në 12 nga 21, ose 57% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë kryer investime në terren për të cilat në dosjet e kontratave të audituara nuk ka dokumente justifikuese (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë 57% e kontratave nuk provon realizimin e investimit. Gjatë auditimit u konstatua se në 12 kontratat e qirasë nuk janë kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe nuk kanë kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para, referuar neni 6 pika 5, a dhe b të kontratës ku shprehet se “a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe.</p> <p>Gjatë auditimit u konstatua se 11 subjektet e mëposhtëm nuk kanë realizuar investimet e parashikuara në plan biznes për të cilat <i>vlera e gjobës për mosrealizim të investimit</i> paraqiten në vlerën totale 426,029 mijë lekë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shoqëria “P. I.” ShPK. në vlerën 45,465mijë lekë; - Shoqëria “K.D.” ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë; - Shoqëria “B. A. I.” ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë - Shoqëria “K.Ç.” ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë; - Shoqëria “B.N. F.” ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë; - Shoqëria “A. I. G.” ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë; - Shoqëria “B.P.” ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë; - Person fizik L. Z., në vlerën 5,147 mijë lekë; - Shoqëria “A.P.” ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë; - Shoqëria “A.W & C.” ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë; - Shoqëria “F.A.” ShPK në vlerën 25,650 mijë lekë; - Shoqëria “M.” ShPK në vlerën 931 mijë lekë.
Kriteri	Ligji Nr. 8318, dt.01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar; VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; Kontratat e qirasë.
Ndikimi/Efekti	Mungesë në realizimin e investimeve dhe në ecurinë e suksesshme të

	kontratave në vlerën totale 399,886 mijë lekë.
Shkaku	Qiramarrësit nuk mund të mbështesin investime në terren me dokumente justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh).
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të 12 kontratave të mësipërme në funksion të arkëtimit të penalteteve të vendosura në zbatim të detyrimeve kontraktuale. Në rastet kur MBZHR has pamundësi në arkëtim, të vlerësojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës.

Titulli i gjetjes nr. 6	Të ardhura të munguara nga mos arkëtimi në kohë i qirave vjetore për tokat bujqësore.
Situata	<p>Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore në lidhje me arkëtimin në kohë të qirasë rezulton se në 10 nga 21, ose 48% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë paguar në kohë detyrimin për qiranë duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si dhe shtim të detyrimeve të prapambetura në lidhje me kamatëvonesat e llogaritura në vlerën totale 55,830 mijë lekë.</p> <p>Gjatë auditimit u konstatua se 7 subjektet e mëposhtëm nuk kanë likuiduar apo paguar me vonesë qiratë në lidhje me kontratat e tokave bujqësore, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shoqëria “P. I.” ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863) detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave; - Shoqëria “A. I. G.” ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave; - Shoqëria “B.N.F.” ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa; - Shoqëria “R. S.” ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa; - Shoqëria “S. G.” ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa; - E. B., person fizik; Kantina C.; A.B. dhe F. A. dhe Kantina D. kanë në total 462 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa.
Kriteri	Ligji Nr. 8318, dt.01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar; VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; Kontratat e qirasë.
Ndikimi/Efekti	Të ardhura të munguara në arkëtimin në kohë të qirave vjetore në vlerën totale 55,830 mijë lekë.
Shkaku	Moszbatim i afatit kohor nga subjektet si dhe vonesë në kryerjen e procedurave nga Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR të marrë masa për arkëtimin e menjëhershëm të detyrimeve në respektim të afateve, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

Titulli i gjetjes nr. 7	Mospërputhje midis vlerës së investimit parashikuar në plan biznes e fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të
--------------------------------	--

	paraqitur në kontratën e qirasë.
Situata	<p>Gjatë auditimit të kontratave të qirasë u përzgjedhën 21 kontrata kundrejt 51 kontratave në total. Përgjatë periudhës nën auditim, është lidhur vetëm 1 kontratë e re, ndërsa 20 kontratat e tjera janë lidhur në periudhat përpara viteve nën auditim, të cilat janë audituar duke marrë në konsideratë detyrimet progresive të mbartura në vite. Nga auditimi i dosjeve të kontratave të qiradhënies, edhe për vitet 2021 dhe 2022 u konstatua një vlerë e ndryshme e investimeve kapitale të parashikuara në Plan Biznes nga vlera e parashikuar në Shtojcën 2 të Kontratës së Qirasë, për 8 (tetë) subjektet më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shoq “P. I.” ShPK; vlera e investimit e përcaktuar në plan biznes është vlera 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët). - Shoqëria “B. A. I.” ShPK; vlera e investimit sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim është 2,863,542,500 lekë, ndërsa sipas shtojcës 2 të kontratës vlera e investimit është 2,128,000,000 lekë, ose 735,542,500 lekë më pak. - Shoqëria “K. D.” ShPK; vlera e investimit sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim është përcaktuar 141,500,000 lekë dhe sipas shtojcës 2 të kontratës 137,100,000 lekë, ose 4,400,000 lekë më pak. - Shoqëria “B. N. F.” ShPK; vlera e investimit sipas shtojcës 2 të kontratës është përcaktuar 33,740,000 lekë por ka mospërputhje dhe paqartësi në plan biznes, (në disa pjesë përshkruhet se vlera e investimit është 887,000 Euro ose 124,650,110 lekë dhe në disa pjesë vlera e investimit rezulton 607,000 Euro ose 85,301,710 lekë). - Shoqëria “B. P.” ShPK; vlera e investimit është 79,390,000 Lekë sipas planit të biznesit por sipas tabelave përmbledhëse rezulton 49,520,000 lekë (ka mospërputhje të shumta midis zërave të investimit, vlera të investimit dhe afateve të realizimit të investimeve) dhe 35,800,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës. - Person fizik L. Z.; vlera e investimit në planin e biznesit është përcaktuar 66,340,000 lekë (ka probleme në planin e biznesit ku janë futur shpenzime të tjera që nuk kanë vlerë për llogaritjen e investimeve) dhe 36,640,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës, ose 29,700,000 lekë më pak. - Person fizik P. C., “K. C.”; Vlera e investimeve, sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim është 154,286,259 lekë, ndërsa vlera e investimeve sipas shtojcës 2 të kontratës është 120,900,000 lekë dhe (ose 33,386,259 lekë më pak). - Shoqëria “A. I. G.” ShPK; vlera e investimit sipas planit fillestar të biznesit paraqitur në procedurat e ankandit është 482,178,240 lekë ndërsa sipas shtojcës 2 të kontratës së amenduar është 254,627,468 lekë, ose 227,550,772 lekë më pak. <p>MBZHR rezulton të mos ketë ngritur në vazhdimësi një grup pune për vlerësimin dhe identifikimin e kontratave që kanë problematikë të mospërputhjes së vlerës së investimit të parashikuar në plan biznes me atë të lidhur në kontratë.</p>
Kriteri	<p>Ligji Nr. 8318, dt.01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar; Neni 15.</p> <p>VKM nr.460, datë 22.5.2013“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”,</p>

	ndryshuar me VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” (ndryshuar me VKM nr. 487, datë 17.6.2020), Pikat 8 dhe 9.
Ndikimi/Efekti	Ky fakt çënon procesin e dhënies me qira, gjatë të cilit është pretenduar nga subjekti, për vlerë më të madhe të investimit si dhe lidhja e këtyre kontratave është në kundërshtim me bazën nënligjore të aplikuar të kohës.
Shkaku	Mospërputhje midis vlerës së investimit në kontratë dhe planin e biznesit.
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e kontratave me problematikë në mospërputhjen e vlerës së investimit në plan biznes krahasuar kjo me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë. Në vijim të mundësohet dakordësia për amendim kontrate midis palëve me qëllim përputhshmërinë e investimit real me atë të parashikuar në kontratë sipas investimeve të kryera në terren dhe përshtatjen e afatit të qiradhënies sipas plan biznesit të ri.

Titulli i gjetjes nr. 8	Problematikë në dorëzimin e ngastrave të tokës bujqësore
Situata	<p>Gjatë auditimit të kontratave të dhënies më qira u konstatua se megjithëse janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit, janë hasur probleme ndër vite me zaptimin e tyre nga palë të tretë pa tagra pronësie dhe për pasojë nuk ka një shfrytëzim të plotë të ngastrave të tokës të dhënë me qira. Kjo problematikë është konstatuar në dosjet e kontratave me subjektet më poshtë:</p> <p>-Në kontratën nr.4040 prot, Nr.793 Rep, nr.473 Kol, datë 12.5.2015, shoqëria “B.N. F.” ShPK., në të cilën qiramarrësi nuk ka kryer investimet sipas plan biznesit të parashikuara, pasi sipërfaqja prej 5 ha është e zaptuar nga fermerë të ndryshëm dhe nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi. Gjithashtu një pjesë rreth 28.84 ha e sipërfaqes, e cila ndodhet pranë një Reparti Ushtarak nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi, pasi nuk lejohet nga struktura e repartit me pretendimin se është zonë ushtarake.</p> <p>-Kontrata e qirasë Nr. 748/1 Prot., Nr. 3051 Rep., Nr. 613 Kol., datë 22.9.2020, lidhur me qiramarrësin subjektin “F. A.” ShPK. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës pasqyruar në procesverbalin me nr. 748/4 prot., datë 26.10.2020 i mbajtur për procesin e dorëzimit, në të cilin u dorëzuan pa problematikë të gjitha sipërfaqet e trajtuara me qira, përveç pasurisë nr. 448/1, Vol 5, faqe 41 me sipërfaqe 6,804 m², e cila sipas hartës treguese të regjistrimit lëshuar nga DVASHK Lushnje, ka rezultuar e zaptuar.</p> <p>-Shoq “P. I.” ShPK. Në proces-verbalin e mbajtur në datë 05.06.2014 nga grupi i punës dhe përfaqësuesi i shoqërisë është dorëzuar një pjesë e sipërfaqes së trajtuar me qira tek qiramarrësi (është kryer piketimi) sipërfaqe prej 80 ha dhe pjesa tjetër prej 61.92 ha nuk është dorëzuar për shkak të pretendimeve të banorëve të zonës.</p> <p>-Subjekti “B. A.” ShPK. dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr.7075 prot, nr.6075 rep. nr.2615 kol, datë 7.10.2014. Në zbatim të Urdhrit nr.509 datë 30.10.2014</p>

	<p>“Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë “B. A. I.” ShPK”, është ngritur grupi i punës i cili ka proceduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se: “Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufijtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtimet pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 7.10.2014 “Për dhënien me qira të tokës bujqësor në pronësi të shtetit”.</p> <p>Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m² qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vend ndodhjes së saj.</p> <p>- Subjekti Kantina “Ç.” ShPK me Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër e Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës), është ngritur grupi i punës “Për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P. Ç.” ShPK, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit, citohet se “qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës”, fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi.</p> <p>-Subjekti “T. A.” ShPK. në Kontratën nr. 6801/3 prot, Nr. 1719 Rep, Nr. 674 Kol, datë 18.11.2016. Rezulton se subjekti i ka ndërtuar dy stalla dhe në ndërtim ishte stalla e tretë me kapacitet prej 300 krerësh, por këto stalla nuk janë ngritur në sipërfaqen e marrë me qira, me argumentimin se nuk i është dorëzuar sipërfaqja në përdorim nga qiramarrësi.</p>
Kriteri	Kontratat e qirasë
Ndikimi/Efekt	Mospërputhje e ngastrave të tokës dhënë me qira dhe sipërfaqen e shfrytëzueshme nga ana e qiramarrësve.
Shkaku	Zaptimet ndër vite
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	<p>Nga titullari i MBZHR të merren masa për vlerësimin dhe mundësimin e amendimit të kontratave të mësipërme midis palëve, në të cilat të vendoset sipërfaqja e saktë në përdorim.</p> <p>MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbivendosje të sipërfaqeve bujqësore, me qëllim realizimin me sukses të kontratave. Për të gjitha rastet, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qira tokë bujqësore, pa realizuar procesin e identifikimit dhe verifikimit të mungesës së mbivendosjeve nga palë të treta.</p>

Titulli i gjetjes nr. 9	Mangësi në lidhje me dorëzimin e garancisë së kontratave sipas planit vjetor të investimeve.
Situata	Lidhur me garancitë e kontratës nga ana e subjekteve nuk janë dorëzuar garancitë e kontratave për periudhën objekt auditimi vitin 2021/22 kjo në kundërshtim me kontratën sipas nenit 8 “Sigurimi i garancisë së kontratës“ ku parashikohet: “ <i>Sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate “për kontratat e subjekteve si më poshtë:</i> - “P. I.” ShPK, - “B. N. F.” ShPK, - L. Z. - P. C. - ShBB “M.” ShPK. - “A.P.” ShPK, - E. B. - “R. S.” ShPK, - “A. B. F.” shp.k, - “F. A.” shp.k, - “H. P.V.” SHPK
Kriteri	Nenit 8 “Sigurimi i garancisë së kontratës”
Ndikimi/Efekti	Risk në mbarëvajtjen e investimit të parashikuar në kontratë
Shkaku	Mos kryerja e detyrave funksionale nga sektori përkatës
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR, të marrë masa të menjëhershme për njoftimin periodik për arkëtimin e garancive vjetore për të gjithë subjektet që nuk kanë mbaruar ende investimin, me qëllim parandalimin e risqeve që lidhen me mos respektimin e detyrimeve kontraktuale në kryerjen e investimeve sipas plan bizneseve të miratuara.

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 6, datë 08.05.2023, dhe janë trajtuar observacionet rast pas rasti në drejtimin përkatës.

2.4 Auditimi mbi dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese për mbrojtjen e bimëve.

Në zbatim të pikës 4, “*Auditimi mbi dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese*”, të programit të auditimit Nr. 1175/1 datë 11.01.2023”, auditimi u fokusua në:

- Procedurat e regjistrimit të PMB-ve, dhënien e certifikatave dhe regjistrimin e produkteve plehëruese për mbrojtjen e bimëve nga Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB).

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e Bimëve” i ndryshuar;

- Vendim nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar;

- Urdhër nr. 174, datë 4.5.2020 “Për miratimin e të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve”;

-Urdhër nr. 72, datë 2/03/2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar;

-Udhëzim nr. 9, dt. 12.07.2010 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, dt. 08.05.2007 “Mbi tarifatat e të ardhurave detyësore, të aplikueshme nga institucionet vartësë të ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

I.Të Përgjithshme

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave orientuese, mbështetëse dhe nxitëse për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë. Ajo përcakton politikatat dhe zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët dhe agrobizneset bazuar në politikatat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre; harton dhe zbaton politikatat për sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë; harton dhe zbaton politikatat për shëndetin e kafshëve e të bimëve, si dhe për garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej tyre. Për periudhën në auditim 2021-2022, struktura e përgjithshme e MBZHR ka ndryshuar sipas urdhrave të mëposhtëm:

Në zbatim të rregullores të brendshme të miratuara nga titullari i MBZHR me urdhrin nr.4276 prot datë 02.06.2021 “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural përfshihen:

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Drejtoria e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve.

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është drejtoria e cila kryen procedurat për dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese. Kjo Drejtori përbëhet nga 5 sektorë:

Spektori i Ushqimit me Origjinë Jo shtazore;

Spektori i Ushqimit me Origjinë Shtazore dhe Ushqimit për Kafshë;


Spektori i Epidemiologjisë dhe Identifikim Regjistrimit të Kafshëve;

Spektori i Shëndetit të Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ;

Spektori i Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve.

Më poshtë paraqitet organigrama në lidhje me drejtorinë dhe sektorët që kanë detyrë funksionale dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese:

Figura 1 - Organigrama e pjesshme e MBZHR



Spektori i cili merret me produktet plehëruese është **Spektori i Shëndetit të Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ**. Qëllimi i këtij sektori është:

-Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive për mbrojtjen e bimëve nga parazitët, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për organizmat e modifikuar gjenetikiisht (OMGJ). Me ndryshimet që ka pësuar struktura në 1 Korrik 2022 përshkrimet e vendit të punës nuk kanë ndryshuar, janë të njëjta me ato të parashikuara në rregulloren e vitit 2021. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e këtij sektori janë:

Bashkëpunon në hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ duke e përafuar me atë të BE- së;

Harton procedurat, standardet dhe formatet tip që do të përdoren për të garantuar unifikimin e tyre në shkallë vendi përgjatë gjithë aktiviteteve që kryhen në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ;

2. Jep kontribut në mirëfeksionimin e punës në mënyrë që të jenë të përputhura me kërkesat për standardizimin e shërbimeve në ndihmë të Sektorit të Shëndetit të Bimëve dhe OMGJ;
 3. Kryen procedurat për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe monitoron zbatimin gjatë importit, transportit, ruajtjes, shitjes dhe përdorimit të tyre;
 4. Harton listën e PMB-ve të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe hedhjen e saj në faqen zyrtare të ministrisë;
 5. Kryen procedurat për miratimin e lëndëve vepruese, të përbërësve të tjerë në përmbajtje të PMB-ve, të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve, si dhe përditësimin e tyre, në përputhje me legjislacionin e BE-Së;
- Bashkëpunon me aplikantët dhe Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për problemet e regjistrimit të PMB-ve, AKU- në si dhe institucione të tjera.
7. Monitoron kontrollin e parazitëve si një domosdoshmëri për forcimin e masave parandaluese të futjes së parazitëve karantinorë në territorin e vendit tonë si dhe të masave të çrrënjësjes së tyre në rast shfaqje;
 8. Harton dhe monitoron rregullat për importin, eksportin dhe kalimin transit në territorin e Republikës së Shqipërisë të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera;
 9. Harton listën e PP-ve të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe hedhjen e saj në faqen zyrtare të ministrisë;
 10. Ndjek procedurën e regjistrimit të Produkteve Plehëruese nëpërmjet sistemit e-Albania;

Me organiken e re pas Korrikut 2022 drejtorja e mësipërme ka ndryshuar dhe është Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit e cila ka në varësi sektorin për PP, dhe ka në përbërje të saj këto drejtori:

Drejtorja e Politikave Veterinare;

Drejtorja e Politikave të Sigurisë Ushqimore;

Drejtorja e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farave, Fidanëve dhe Plehrave;

Drejtorja e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Drejtorja e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farave, Fidanëve dhe Plehrave është drejtorja e cila merret me procedurat për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) dhe përbëhet nga 2 sektorë:

- Sektori i Farërave, Fidanëve dhe Produkteve plehëruese: Përbërja e këtij sektori aktualisht është: Përgjegjës sektori + 2 specialistë, (një vend është vakant).

- Sektori i Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjet: Përbërja e këtij sektori aktualisht është: Përgjegjës sektori + 2 specialistë.

MZHBR nuk ka hartuar një rregullore të re në zbatim të strukturës së miratuar por ka në fuqi Rregulloren Nr. 4276 prot, dt. 02.06.2021 “Për funksionimin e Brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të gjitha procedurat, që lidhen me regjistrimin e PMB-ve, lëndëve vepruese, si dhe të shtuesve e të bashkëvepruesve kryhen pranë strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve (SPMB), si autoriteti përgjegjës (Sektori i Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjet). Në periudhën Prill 2021 – Korrik 2022, SPMB në ministri ka qenë Drejtorja e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në cilën ka qenë Sektori Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ që mbulonte PMB-të. Të gjitha PMB-të, që importohen dhe vendosen në treg dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë vetëm të regjistruara. Në Republikën së Shqipërisë pranohen për regjistrim vetëm PMB-të që janë të regjistruara në një nga vendet e Bashkimit Evropian.

Regjistrimi i PMB-ve kryhet nga Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB), i ngritur në ministri. Komisioni është organ kolegjal teknik, i përhershëm, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të PMB-ve. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë vijon:

Zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;

Dy përfaqësues nga ministria;

Një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

Një përfaqësues nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). Pas amendimit të Vendimit nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar (ISUV) është zëvendësuar me një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB).

Sekretar i komisionit të regjistrimit të PMB-ve është specialisti që mbulon PMB-të pranë strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve (SPMB) i caktuar me Urdhër të Ministrit.

II. Procedura e regjistrimit të PMB-ve

Kërkesa për regjistrimin e PMB-së kryhet nga Kërkuesi në sistemin on-line (*e-Albania*) dhe përmban:

të dhënat teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-së, në gjuhën shqipe ose angleze, sipas urdhrimit të ministrit nr. 174, datë 4.5.2020;

të dhënat që provojnë se PMB-ja është e regjistruar nga kërkuesi në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose kërkuesi ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të regjistrimit nga subjekti, që e ka regjistruar në një nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilat janë: certifikata e regjistrimit ose vërtetimi i lëshuar nga institucionet zyrtare kompetente, numri i regjistrimit, sipas adresës elektronike të shtetit që e ka regjistruar PMB-në, dhe etiketa përkatëse;

Etiketën e cila duhet të jetë e përkthyer edhe në gjuhën shqipe;

Dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”. MSDS-ja të jetë e përkthyer edhe në gjuhën shqipe”.

Brenda 20 (njëzet) ditëve nga kërkesa në portal e-Albania, sekretari i komisionit ka shqyrtuar dokumentacionin nëse është në rregull, menjëherë pas pranimit, janë dërguar me e-mail zyrtar tek ISUV-i, të dhënat teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-së.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) kryen vlerësimin e dokumentacionit dhe e dërgon mendimin me shkrim tek SPMB-ja brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes së emailit.

Sekretari përgatit materialin përmbledhës për mbledhjen e radhës së KRPMB-së brenda 10 ditëve, nga ardhja e mendimeve të ISUV-it dhe ja dërgon Komisionit pas caktimit të mbledhjes së radhës.

Komisioni shqyrton dokumentacionin dhe vendos për miratimin ose jo të kërkesës për regjistrim.

Pas përfundimit të mbledhjes së Komisionit, sekretari përgatit dokumentin e regjistrimit për çdo PMB të miratuar. Kryetari i komisionit njofton kërkuesin për regjistrimin ose jo të PMB-së.

Në zbatim të Vendimit Nr. 335, dt. 06.06.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e Bimëve” janë ngritur urdhrat “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” si më poshtë:

Urdhër nr. 357, dt. 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, protokolluar me nr. 8233/1, dt. 31.08.2018;

Urdhër nr. 223, dt. 05.06.2020 për një ndryshim në urdhrin nr. 357, dt. 31.08.2018, “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” i ndryshuar, protokolluar me nr. 4057 prot, dt. 05.06.2020;

Urdhër nr. 225, dt. 05.06.2020 “Për caktimin e sekretarit të komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” protokolluar me nr. 4059, dt. 05.06.2020;

Urdhër nr. 111, dt. 04.03.2021 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 357, dt. 31.08.2018, “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar protokolluar me nr. 2008, dt. 04.03.2021;

Urdhër nr. 526, dt. 22.10.2021 për një ndryshim në urdhrin nr. 357, dt. 31.08.2018, “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” protokolluar me nr. 7164/1, dt. 22.10.2021;

Urdhër nr. 614, dt. 30.12.2022 “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” protokolluar me nr. 6688/1, dt. 30.12.2022;

Për periudhën objekt auditimi Prill 2021- Dhjetor 2022 Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB) ka zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) mbledhje nga të cilat 6 mbledhje në vitin 2021 dhe 6 në vitin 2022. U kontrolluan dosjet fizike për procedurën e dhënies së certifikatave të regjistrimit. Nuk ka pasur ankimime nga kërkuesit (aplikantët) as me email, as me shkresë zyrtare dhe as në sistemin e bashkëqeverisjes lidhur me këtë problem.

Për vitin 2021 sipas procesverbaleve të mbajtura në datat 28.04.2021; 21.05.2021; 05.11.2021; Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB) bazuar në Ligjin Nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”; Vendimin nr. 335, date 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”; Urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.03.2017 “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, janë zhvilluar mbledhjet, duke shqyrtuar dosjet e paraqitura për regjistrim, reregjistrimin, modifikim të PMB-ve.

Pas kryerjes së aplikimit nga kërkuesi në sistemin On-line sekretari i komisionit ka shqyrtuar aplikimet me dokumentacionin përkatës për një afat kohor prej 20 ditësh. Pas kryerjes së shqyrtimit të dokumentacionit të ardhur nga aplikanti, të dhënat teknike të produktit i dërgohen ISUVIT me email i cili pas kryerjes së vlerësimit (afati 20 ditë). ISUVI i dërgon me shkresë MBZHR-së mendimin për këto produkte. Sekretari i komisionit përgatit dokumentacionin për mbledhjen e radhës dhe njofton kryetarin e Komisionit. Kryetari i komisionit cakton datën për mbledhjen e radhës. Në mbledhje shqyrtohet dokumentacioni dhe merren vendimet sipas rastit. Pas përfundimit të mbledhjes dhe firmosjes së procesverbalit përfundimtarë sekretari i komisionit bën zbardhjen e dokumentacionit të regjistrimit sipas dosjes së paraqitur të produktit dhe vendimit të komisionit.

Konkretisht për produktet e regjistruara në dosjet e audituara janë dokumentet si vijojnë:

- Mandati i pagesës për produktin e regjistruar i cili i dërgohet kërkuesit për të kryer pagesën;
- Certifikata e regjistrimit me rubrikat sipas përcaktimeve të VKM 355 dt. 06.06.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e Bimëve” të cilat përmbajnë procedurën (regjistrim; ri regjistrim; modifikim)
- Klasifikimin e produktit;
- Emrin tregtar të produktit;
- Kërkuesin; Prodhuesin;
- Lëndën vepruese të produktit;
- Formulimin e produktit;
- Pamjen fizike të produktit;
- Vlefshmërinë e certifikatës.

Certifikatës së miratuar nga komisioni i bashkëlidhet Etiketa e miratuar e produktit përkatës me rubrikat si më poshtë:

- Emrin tregtar të produktit;
- Përmbajtjen dhe formulimin;
- deklaratat e rrezikut dhe parandaluese, piktogramat përkatëse;
- Informacion në rast helmimi;
- Përdorimi;
- Ndikimi në mjedis si dhe karencat dhe kushtet e magazinimit;
- Dokumentacioni i regjistrimit (certifikata dhe etiketa) i dërgohet aplikantit pasi të kryejë pagesën përkatëse sipas rastit.

Për rastet e mosmiratimit kërkuesi njoftohet për vendimin e marrë nga komisioni dhe për arsyet e mosmiratimit.

Gjatë auditimit u verifikuan dosjet fizike dhe procedura e ndjekur në sistemin on-line ku rezultoi se në mbledhjen e **dt. 28.04.2021** janë miratuar regjistrimet e PMB-ve, si më poshtë vijon:

M. A. 10/1,25 SC, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti D. S.p.A., me nr. 11515 Prot, datë 29.12.2020; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlershmëri deri me 14.09.2027; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me nr. 2275 Prot, datë 16.3.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 2275/1 Prot, datë 14.4.2021.

1. B.®, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti D.S.p.A., me nr. 11343 Prot, datë 23.12.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Spanjë, me vlershmëri deri me 31.8.2021; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me nr. 2275 Prot, datë 16.3.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 2275/1 Prot, datë 14.4.2021.

2. S., me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti D.S.p.A., me nr. 11254 Prot, datë 21.12.2020; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Slloveni, me vlershmëri deri me 31.12.2021; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me nr. 2275 Prot, datë 16.3.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 2275/1 Prot, datë 14.4.2021.

3. Z., me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti D. S.p.A., me nr. 10379 Prot, datë 24.11.2020; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Spanjë, me vlershmëri deri me 28.2.2034; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me nr. 2275 Prot, datë 16.3.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 2275/1 Prot, datë 14.4.2021.

Në këtë mbledhje nuk është miratuar regjistrimi i PMB-së; **F. 70 DF**, sepse vlerësimi i ISUV është negativ (Nuk është paraqitur dokumentacioni teknik në përputhje me Urdhrin nr. 174, datë 04.05.2020 “Për Miratimin e të Dhënave teknike të Dosjes së Regjistrimit të PMB-ve”. Për këtë produkt janë paraqitur vetëm metoda analitike dhe asnjë seksion tjetër teknik”).

Në mbledhjen e **dt. 21.05.2021**, janë miratuar regjistrimet e PMB-ve, si më poshtë vijon:

1. B. MX 44 G, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti S. Crop Protection AG, me nr. MBZHR-2021-9057627-AT Prot (*e-Albania*), datë 14.4.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlershmëri deri me 31.03.2031; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me email, datë 14.4.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 387 Prot, datë 29.4.2021.

2. D. G. 960 EC, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti S. Crop Protection AG, me nr. MBZHR-2021-9156614-CP Prot (*e-Albania*), datë 9.4.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlershmëri deri me 03.02.2025; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me email, datë 9.4.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 387 Prot, datë 29.4.2021.

3. D. 60/30 DC, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti S. Crop Protection AG, me nr. MBZHR-2021-2672384-FF Prot (*e-Albania*), datë 7.4.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlershmëri deri me 31.12.2021; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me email, datë 7.4.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 387 Prot, datë 29.4.2021.

4. M. 300 SL, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti P. Sp. Z O.O., me nr. MBZHR-2021-5347498-UK Prot (*e-Albania*), datë 9.4.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlershmëri deri me 31.10.2021; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me email, datë 9.4.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 387 Prot, datë 29.4.2021.

5. G., me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti B. S.L., me nr. MBZHR-2021-8929029-GP Prot (*e-Albania*), datë 19.4.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Spanjë, me vlershmëri deri me 11.02.2021; - Dërguar për

vlerësim te ISUV, me email, datë 19.4.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 3421 Prot, datë 10.05.2021.

6. S. 2.5 EC, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti K.&N.E. S.A., me nr. MBZHR-2021-5340727-RL Prot (e-Albania), datë 27.4.2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 31.10.2021; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me e mail, datë 27.4.2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 3421 Prot, datë 10.05.2021.

Në mbledhjen e **dt. 05.11.2021**, janë miratuar regjistrimet e PMB-ve, si më poshtë vijon

1. A. 250 SC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi P. Sp. z o.o. Poloni, me nr. MBZHR-2021-4809214-OD prot (e-Albania), datë 28-07-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 29 korrik 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 5999 prot, datë 24 gusht 2021.

2. A. 350 SE, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi I. Sp. z o.o. Poloni, me nr. MBZHR-2021-2718243-Dë prot (e-Albania), datë 01-07-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 maj 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me e mail, datë 2 korrik 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 5999 prot, datë 24 gusht 2021.

3. K. 80 ëG, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi P. Sp. z o.o. Poloni, me nr. MBZHR-2021-3939091-AM prot (e-Albania), datë 05-07-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 korrik 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 6 korrik 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 5341 prot, datë 19 gusht 2021. Për këtë produkt komision ka lënë shënim që të hiqet nga etiketa piktograma GHS06.

4. K. 510 SL, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi I. Sp. z o.o. Poloni, me nr. MBZHR-2021-9688070-ZN prot (e-Albania), datë 24-08-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 korrik 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 24 korrik 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 6889 prot, datë 8 tetor 2021.

5. L. 80 ëG, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi I.Sp. z o.o. Poloni, me nr. MBZHR-2021-1011267-XY prot (e-Albania), datë 24-08-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 korrik 2023; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 24 gusht 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 6307 prot, datë 13 shtator 2021. Për këtë produkt komision la shënim që të hiqet nga etiketa piktograma GHS06.

6. N., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi P. Sp. z o.o. Poloni, me nr. MBZHR-2021-3373497-JM prot (e-Albania), datë 23-08-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 23 gusht 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 6889 prot, datë 8 tetor 2021.

7. S. 0.5 GR, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi Sh. Ch. E. SL, me nr. MBZHR-2021-6579614-UH prot (e-Albania), datë 23-08-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 24 gusht 2021; - Vlerësimi i ardhur *pozitiv* nga ISUV, me shkresën nr. 6307 prot, datë 13 shtator 2021.

Në këtë mbledhje janë miratuar ri regjistrim; modifikim për PMB-të:

P., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi I. A., SA, Spanjë, me nr. MBZHR-2021-7070271-FI prot (e-Albania), datë 05-10-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 korrik 2036. Të pasqyrohen në dokumentet e regjistrimit (etiketë), të gjitha mendimet e dhëna nga anëtarët e Komisionit.

L. 5G, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti I. Ch. Srl, me nr. MBZHR-2021-7593379-ZU prot (*e-Albania*), datë 2.12.2021; - akti i bashkimit.

Për vitin 2022 sipas procesverbaleve dt. **07.03.2022; 15.08.2022; 15.09.2022; 25.02.2022**, bazuar në Ligjin Nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; dhe Vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” të ndryshuar; Urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.03.2017 “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar., komisioni ka shqyrtuar dosjet e paraqitura për regjistrim, ri regjistrimin, modifikim të PMB-ve. Në këto mbledhjen janë miratuar regjistrimin e PMB-ve, me dokumentacionin përkatës si më poshtë vijon:

1. B. 4 OD, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *R. A.E. L.*, me nr. MBZHR-2022-5658204-EN, prot (*e-Albania*), data e pranimit 22 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në Shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2023; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 22 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 1965 prot, datë 1 prill 2022. Sipas Vendim nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve i ndryshuar, Kreu V, pika 3, parashikohet se: “*Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) kryen vlerësimin e dokumentacionit dhe e dërgon mendimin me shkrim tek SPMB-ja brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes*”. ISUVI nuk e ka respektuar afatin ligjorë (19 ditë vonesë).

2. M., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *P.-P. P.*, me nr. MBZHR- MBZHR-2022-8961039-PE, prot (*e-Albania*), data e pranimit 22 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Spanjë, me vlefshmëri deri me 31 janar 2023; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 25 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 1965 prot, datë 1 prill 2022. Sipas Vendim nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve i ndryshuar, Kreu V, pika 3, parashikohet se: “*Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) kryen vlerësimin e dokumentacionit dhe e dërgon mendimin me shkrim tek SPMB-ja brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes*”. ISUVI nuk e ka respektuar afatin ligjorë (16 ditë vonesë).

3.C.® C D.® me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *UPL E. Ltd*, me nr. MBZHR-2022-2092994-GE, prot (*e-Albania*), data e pranimit 7 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 15 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 1869 prot, datë 29 mars 2022. (16 ditë vonesë)

4. C.® U. D.®, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *UPL E. Ltd*, me nr. MBZHR-2022-2967431-AD, prot (*e-Albania*), data e pranimit 7 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 15 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 1869 prot, datë 29 mars 2022. (16 ditë vonesë)

5. S. 544 SC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *A. L. S.*, me nr. MBZHR-2022-7028227-HQ, prot (*e-Albania*), data e pranimit 7 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 gusht 2024; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 15 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 1869 prot, datë 29 mars 2022. (16 ditë vonesë)

6. O.70 SG, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *R. A. Co Ltd*, me nr. MBZHR-2022-3914529-UN, prot (*e-Albania*), data e pranimit 16 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2024; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me email, datë 17 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 1929 prot, datë 31 mars 2022. (24 ditë vonesë)

7. L., me këto dokumente:- kërkesa nga kërkuesi *E.o H.S.*, me nr. MBZHR-2022-2561436-YG, prot (e-Albania), data e pranimit 30 mars 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 30 prill 2025.

Në mbledhje nuk janë miratuar regjistrimin e PMB-ve si më poshtë, sepse nga ISUVI ka ardhur vlerësim negativ:

1. P. 250 EC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *I. Sp. z o.o.*, me nr. MBZHR-2022-6744805-FG, prot (e-Albania), data e pranimit 22 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2023; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *e-mail*, datë 22 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur **negativ** nga ISUV, me shkresën nr. 1965 prot, datë 1 prill 2022.

2. D. 500 SC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *I.Sp. z o.o.*, me nr. MBZHR-2022-5364127-SZ, prot (e-Albania), data e pranimit 22 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 maj 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *e-mail*, datë 22 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 1965 prot, datë 1 prill 2022.

3. A. 200 SE, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *I. Sp. z o.o.*, me nr. MBZHR-2022-3281730-JE, prot (e-Albania), data e pranimit 22 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 28 shkurt 2034; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *e-mail*, datë 22 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 1965 prot, datë 1 prill 2022.

4. N. P.[®], me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *N. Ch. E. GmbH*, me nr. MBZHR-2022-9822364-AO, prot (e-Albania), data e pranimit 7 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 maj 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *e-mail*, datë 15 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 1869 prot, datë 29 mars 2022.

5. Z. V.[®], me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *N. Ch.E. GmbH.*, me nr. MBZHR-2022-3323711-AR, prot (e-Albania), data e pranimit 7 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 3 mars 2028; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *e-mail*, datë 15 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 1869 prot, datë 29 mars 2022.

6. B. 450 SC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *I. Sp. z o. o.*, me nr. MBZHR-2022-4717047-UY, prot (e-Albania), data e pranimit 16 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 30 tetor 2023; - Dërguar për vlerësim në ISUV, me *e-mail*, datë 17 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 1929 prot, datë 31 mars 2022.

7. S. 250ëG, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *C.a*, me nr. MBZHR-2022-2976266-HI, prot (e-Albania), data e pranimit 2 shkurt 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 30 qershor 2025; - Dërguar për vlerësim në ISUV, me *e-mail*, datë 2 shkurt 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 1396 prot, datë 2 mars 2022.

8. D. 250 EC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *I. Sp. z o.o.*, me nr. MBZHR-2022-3084255-KN, prot (e-Albania), data e pranimit 30 mars 2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 30 qershor 2023; - Dërguar për vlerësim në ISUV, me *e-mail*, datë 30 mars 2022; - Vlerësimi i ardhur negativ nga ISUV, me shkresën nr. 2400 prot, datë 26 prill 2022.

9. N. P., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi *N. Ch. E.*; - me nr. gjurmueshmërie MBZHR-2022-1255667-NT; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në Shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 maj 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 18 gusht 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 4557 prot., datë 6 shtator 2022.

10. S., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi B. C.- me nr. gjurmueshmërie MBZHR-2022-4249853-RS; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në Shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 16 shtator 2027; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 23 gusht 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 4557 prot., datë 6 shtator 2022.

11. S.-D, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi A. L. B. SPRL; - me nr. gjurmueshmërie MBZHR-2022-2620209-GX; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në Shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2023; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 23 gusht 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 4557 prot., datë 6 shtator 2022.

12. CH., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi Ch. S.P.A., me nr. MBZHR-2021-9489551-JX prot (*e-Albania*), datë 22-11-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në Shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 22 nëntor 2021; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 685 prot, datë 2 shkurt 2022.

13. E., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi B. AG, me nr. MBZHR-2021-8756378-RD prot (*e-Albania*), datë 25-11-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Slloveni, me vlefshmëri deri me 31 maj 2022; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 25 nëntor 2021; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 8367 prot, datë 28 dhjetor 2021.

14. H. S., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi B. AG, me nr. MBZHR-2021-4034955-FM prot (*e-Albania*), datë 25-11-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Slloveni, me vlefshmëri deri me 30 qershor 2025; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 25 nëntor 2021; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 685 prot, datë 2 shkurt 2022. Për këtë produkt komision ka lënë shënim që të hiqet nga etiketa piktograma GHS06.

15. SH.P. 100 Eë, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi E.H. SAC., me nr. MBZHR-2022-1158623-BD prot (*e-Albania*), datë 21-01-2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 31 tetor 2023; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 21 janar 2022; - Vlerësimi i ardhur **pozitiv** nga ISUV, me shkresën nr. 884 prot, datë 9 shkurt 2022.

16. M., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi B. AG, me nr. MBZHR-2021-3897067-EI prot (*e-Albania*), datë 6-01-2022; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Itali, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2027.

Në këto mbledhje janë miratuar modifikimet e PMB-ve, si më poshtë vijon:

D. MAX, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti D. S.p.A, me nr. MBZHR-2022-3087032-TB, prot (*e-Albania*), data e pranimit 15 mars 2022; me dokumentacionin provues kërkesa, certifikata e regjistrimit me etiketën e miratuar në Itali.

P., me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi A. L., me nr. MBZHR-2022-4677934-XJ, prot (*e-Albania*), data e pranimit 21 shkurt 2022; me dokumentacionin provues: deklarata konfidenciale nga Klasifikimi: Konfidencial, për shtim të linjës së prodhimit.

2. **M. 20 SG**, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi N. Ch.E.; - me nr. gjurmueshmërie MBZHR-2022-8134057-VR; - dokumentacionin provues kërkesa; draft etiketa; pjesë seksioni nga të dhënat teknike të dosjes "GAP". Komisioni vendosi të mos miratojë modifikimin e kërkuar, pasi dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk u konsiderua provues.

Në këto mbledhje nuk janë miratuar regjistrimin e PMB-së, si më poshtë vijon:

1. D. 250 EC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi I. Sp. z o.o., me nr. MBZHR-2021-1320092-YT prot (*e-Albania*), datë 13-10-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Poloni, me vlefshmëri deri me 31 dhjetor 2021; - Dërguar për vlerësim te ISUV, me *email*, datë 14 tetor 2021; - Vlerësimi i ardhur **negativ** nga ISUV, me shkresën nr. 7607 prot, datë 12 nëntor 2021.

2.O.120 SC, me këto dokumente: - kërkesa nga kërkuesi C. A., me nr. MBZHR-2021-9828884-AV prot (*e-Albania*), datë 29-12-2021; - dokumentacioni me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS) në shqip; - certifikatë regjistrimi në Greqi, me vlefshmëri deri me 29 dhjetor 2021; - Dërguar për vlerësim të ISUV, me email, datë 29 dhjetor 2021; - Vlerësimi i ardhur *negativ* nga ISUV, me shkresën nr. 884 prot, datë 9 shkurt 2022. ***Për këtë produkt komisioni vendosi të shtyjë vendimmarrjen, pasi kërkohet një diskutim me ISUV-in dhe më pas zhvillimi i mbledhjes për këtë produkt.***

Në mbledhje janë miratuar modifikimet e PMB-së, si më poshtë vijon:

1. D. 480 S., me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti G. Ch. L., me nr. MBZHR-2021-8914145-CY prot (*e-Albania*), datë 21 janar 2022; me dokumentacionin provues kërkesa, certifikata e regjistrimit, deklarata e pranimit për prodhim dhe deklarata e identitetit.
2. O. 80 D., me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti U. E. Ltd, me nr. MBZHR-2021-7304186-FE prot (*e-Albania*), datë 21 janar 2022; me dokumentacionin provues kërkesa, certifikata e regjistrimit në Greqi, deklarata për aplikantin dhe linja e prodhimit.
3. C. 36 SL, me këto dokumente: - kërkesa nga aplikanti N. SAS, me nr. MBZHR-2022-2699985-YU prot (*e-Albania*), datë 16 shkurt 2022; me dokumentacionin provues kërkesa dhe certifikata e regjistrimit në Slloveni.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin:

Referuar Vendim nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, në të gjitha dosjet e audituara ndodhen mandat-pagesat sipas Udhëzimit nr. 9, dt. 12.07.2010, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, dt. 08.05.2007 “Mbi tarifën e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”. Gjithashtu në dosje gjenden procesverbali dhe relacioni i mbledhjeve pëkatëse, në zbatim të Urdhër nr. 72, datë 2/03/2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar, Urdhër nr. 174, datë 4.5.2020 “Për miratimin e të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve”.

- *Regjistrimi i PP-ve, dhënia e certifikatave të regjistrimit për mbrojtjen e bimëve nga Komisioni i Regjistrimit të (KRPP).*

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligjin nr. 17/2020 “Për produktet Plehëruese”;
- VKM Nr. 332, dt. 18.05.2022 “Për përcaktimin e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese”.
- Urdhri i Ministrit, nr. 141, dt 26.03.2020, “Për miratimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të komisionit të produkteve plehëruese”.
- Urdhri i ministrit nr. 141/1 datë 26.3.2020 “Procedura e hollësishme e regjistrimit të produkteve plehëruese”.
- Urdhri i ministrit nr. 142 datë 26.3.2020 “Për miratimin e përmbajtjes të të dhënave teknike të produkteve plehëruese”.
- Urdhri i ministri nr. 145, datë 26.3.2020 “Për Miratimin e klasifikimit të hollësishëm të produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim”.
- Rregullore Nr. 4276 prot, dt. 02.06.2021 “Për funksionimin e Brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

Ligjin nr. 17/2020 “Për produktet Plehëruese” përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, informimin, reklamimin dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me produktet plehëruese, si dhe organizimin e funksionimit e strukturave përkatëse.

Ky ligj zbatohet për: a) produktet plehëruese që regjistrohen, prodhohen, eksportohen, tregtohen, importohen dhe përdoren në Republikën e Shqipërisë; b) personat fizikë e juridikë

që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, si dhe të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet, vlerësimin e ndikimit në mjedis, lejet e mjedisit e kimikatet. Në zbatim të rregullores së brendshme të miratuara nga titullari i MBZHR me Urdhrin nr.4276 prot datë 02.06.2021 “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural përfshihen:

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.


Drejtoria e konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve.

Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është drejtoria e cila kryen procedurat për dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese. Kjo Drejtori përbëhet nga 5 sektorë:

- Sektori i Ushqimit me Origjinë Jo shtazore;
- Sektori i Ushqimit me Origjinë Shtazore dhe Ushqimit për Kafshë;
- Sektori i Epidemiologjisë dhe Identifikim Regjistrimit të Kafshëve;
- Sektori i Shëndetit të Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ;
- Sektori i Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve.

Më poshtë paraqitet organigrama në lidhje me drejtorinë dhe sektorët që kanë detyrë funksionale dhënien e licencave, autorizimeve dhe lejet për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, importin, eksportin që lidhen me produktet plehëruese:

Figura 1 - Organigrama e pjesshme e MBZHR



Sektori i cili merret me produktet plehëruese është Sektori i Shëndetit të Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ. Qëllimi i këtij sektori është:

-Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive për mbrojtjen e bimëve nga parazitët, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve si dhe hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për organizmat e modifikuar gjenetikut (OMGJ). Me ndryshimet që ka pësuar struktura në 1 Korrik 2022 përshkrimet e vendit të punës nuk kanë ndryshuar, janë të njëjta me ato të parashikuara në rregulloren e vitit 2021. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e këtij sektori janë:

Bashkëpunon në hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ duke e përafuar me atë të BE- së;

Harton procedurat, standardet dhe formatet tip që do të përdoren për të garantuar unifikimin e tyre në shkallë vendi përgjatë gjithë aktiviteteve që kryhen në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ;

2. Jep kontribut në mirëfunksionimin e punës në mënyrë që të jenë të përputhura me kërkesat për standardizimin e shërbimeve në ndihmë të Sektorit të Shëndetit të Bimëve dhe OMGJ;
3. Kryen procedurat për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe monitoron zbatimin gjatë importit, transportit, ruajtjes, shitjes dhe përdorimit të tyre;
4. Harton listën e PMB-ve të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe hedhjen e saj në faqen zyrtare të ministrisë;
5. Kryen procedurat për miratimin e lëndëve vepruese, të përbërësve të tjerë në përmbajtje të PMB-ve, të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-ve, si dhe përditësimin e tyre, në përputhje me legjislacionin e BE-Së;

Bashkëpunon me aplikantët dhe Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për problemet e regjistrimit të PMB-ve, AKU- në si dhe institucione të tjera.

7. Monitoron kontrollin e parazitëve si një domosdoshmëri për forcimin e masave parandaluese të futjes së parazitëve karantinorë në territorin e vendit tonë si dhe të masave të çrrënjësjes së tyre në rast shfaqje;
8. Harton dhe monitoron rregullat për importin, eksportin dhe kalimin transit në territorin e Republikës së Shqipërisë të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera;
9. Harton listën e PP-ve të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe hedhjen e saj në faqen zyrtare të ministrisë;
10. Ndjek procedurën e regjistrimit të Produkteve Plehëruese nëpërmjet sistemit e-Albania, etj.

Me organiken e re pas Korrikut 2022 drejtorja e mësipërme ka ndryshuar dhe është Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit e cila përbëhet nga:

Drejtorja e Politikave Veterinare;

Drejtorja e Politikave të Sigurisë Ushqimore;

Drejtorja e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farave, Fidanëve dhe Plehrave;

Drejtorja e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Drejtorja e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farave, Fidanëve dhe Plehrave është drejtorja e cila merret me procedurat për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe përbëhet nga 2 sektorë:

-Sektori i Farëve, Fidanëve Produkteve plehëruese (PP) dhe OMGJ: Përbërja e këtij sektori aktualisht është: Përgjegjës sektori + 2 specialistë, (një vend është vakant).

-Sektori i Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjet: Përbërja e këtij sektori aktualisht është: Përgjegjës sektori + 2 specialistë.

MZHBR nuk ka hartuar një rregullore të re në zbatim të strukturës së miratuar por ka në fuqi Rregulloren Nr. 4276 prot, dt. 02.06.2021 “Për funksionimin e Brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese ka funksionuar në zbatim të urdhrave si më poshtë:

Urdhër nr. 143, dt. 26.03.2020 “Për caktimin e sekretarit të komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese”, protokolluar me nr. 2571/5, dt. 26.03.2020;

Urdhër nr. 144, dt. 26.03.2020 “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese”, protokolluar me nr. 2571/6, dt. 26.03.2020;

Urdhër nr. 223, dt. 05.06.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 357, dt. 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve”, i ndryshuar, protokolluar me nr. 4057 prot, dt. 05.06.2020;

Urdhër nr. 225, dt.05.06.2020 “Për caktimin e sekretarit të komisionit të regjistrimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve”, protokolluar me nr. 4059 prot, dt. 05.06.2020;

Urdhër nr. 144/1, dt. 05.06.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 144, dt.26.03.2020 “Për ngritjen e komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese”, protokolluar me nr. 2571/9, dt.05.06.2020;

Urdhër nr. 226, dt.05.06.2020 “Për caktimin e sekretarit të komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese”, protokolluar me nr. 4060 prot, dt. 05.06.2020;

Komisioni i regjistrimit të produkteve plehëruese është organ kolegjal teknik i përhershëm dhe vendimmarrës. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

a) zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;

b) dy përfaqësues nga SPPP-ja në ministri;

c) një përfaqësues nga laboratorit i referencës;

ç) një përfaqësues nga Agjencitë Përgjegjëse për Këshillimin Bujqësor;

d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;

dh) një përfaqësues nga shoqatat e fermerëve.

Sekretar i komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese është specialisti që mbulon produktet plehëruese pranë SPPP-së në ministri, i caktuar me urdhër të ministrit. Referuar Vendimi nr. 332, dt. 18.05.2022 “Për përcaktimin e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese” është AKU institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese. Në Republikën e Shqipërisë lejohet vetëm përdorimi i produkteve plehëruese të regjistruara. Produktet plehëruese duhet të përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet që jepen në etiketë. Përdorimi i produkteve plehëruese duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve, të konsumatorëve, të kafshëve dhe të mjedisit. Të gjitha produktet plehëruese që prodhohen, importohen e tregtohen për t’u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit. Një produkt plehërues mund të regjistrohet, nëse përmbush kërkesat, si më poshtë:

- a) produkti plehërues të jetë i miratuar, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji;
- b) lënda ushqyese garanton siguri, cilësi dhe efektshmëri;
- c) ekzistojnë metodat e analizave dhe të testimeve;
- ç) nuk ndikon negativisht në shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe në mjedis;
- d) përmbush të gjitha kërkesat për ambalazhimin, etiketimin dhe magazinimin, sipas dispozitave të këtij ligji;
- dh) përmbush kufijtë e tolerancës.

Referuar dokumentacionit të ardhur nga kërkesat e aplikuesve për regjistrimin e produktit plehërues dosjet e vëna në dispozicion përmbajnë të dhënat si më poshtë:

- a) kërkesën e aplikantit për regjistrimin e produktit plehërues në gjuhën shqipe;
- b) të dhënat teknike të produktit plehërues në gjuhën shqipe ose angleze;
- c) etiketën, të përkthyer dhe në gjuhën shqipe;
- ç) dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS). MSDS të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat specifike, përmbajtjen e formatin e përcaktuar nga legjislacioni përkatës në fuqi për kimikatet;
- d) mostrën e produktit plehërues që kërkon të regjistrojë e cila dërgohet në (QTTB).

Aplikimi për regjistrim, sipas shkronjave “a” dhe “ç”, të këtij neni, kryhet në sistemin *online*, ndërsa mostra, sipas shkronjës “d”, të këtij neni, depozitohet te laboratorit i referencës.

Pas pranimit, ky dokumentacion dërgohet nga SPPP-ja te laboratorit i referencës, për të kryer vlerësimin e të dhënave të produktit plehërues, të cilin e pasqyron në sistemin *online* brenda 5 ditëve.

Procedura e regjistrimit të produktit plehërues përfundon brenda 20 ditëve nga aplikimi.

Përmbajtja e të dhënave teknike të produkteve plehëruese miratohet me urdhër të ministrit.

Procedura e hollësishme e regjistrimit të produkteve plehëruese miratohet me rregullore të ministrit.

Dosjet e audituara për regjistrimin e Produktit Plehërues përmbanin;

Aplikimin e bërë nga aplikanti në sistemin e- Albania;

Shkresat për pranimin dhe dërgimin për vlerësim QTTB Fushë-Krujë për vlerësim teknik;

Mendimin e ardhur me email të skanuar nga QTTB-ja;

Njoftimi i komisionit për mbledhjen e radhës bashkëngjitur me mendimet e QTTB-së;

Dërgimi i dosjes së produktit plehërues në proces regjistrimi vënë në dispozicion nga sekretari i komisionit të gjithë anëtarëve;

Procesverbali i mbledhjes;

Certifikata e regjistrimit dhe etiketa;

Mandatin e pagesës.

Hapat që janë ndjekur për procedurën e regjistrimit të një produkti plehërues janë si vijon;

Aplikimi për regjistrimin e produkteve plehëruese kryhet on line në e-Albania ndërsa mostra depozitohet te laboratorit i referencës nga aplikanti.

Pas dërgimit të aplikimit, dokumentacioni dërgohet nga SPPP-ja te laboratorit i referencës për të kryer vlerësimin e të dhënave të produktit plehërues. Dokumentacioni i dërguar nëpërmjet aplikimit dërgohet nga SPPP-ja te laboratorit i referencës, për të kryer vlerësimin e të dhënave të produktit plehërues të cilin e pasqyron në sistemin on line brenda 5 ditëve. Nëse dokumentacioni i dërguar është i rregullt, aplikimi pranohet dhe merret në shqyrtim nga komisioni. Nëse aplikimi ka parregullsi në dokumentacion, aplikanti njoftohet për dërgimin e dokumenteve të sakta. Pas pranimit të aplikimit kryhet vlerësimi i të dhënave të produktit plehërues. Nëse vendoset që ky produkt të regjistrohet aplikantit i dërgohet fatura për kryerjen e pagesës në bankë. Subjekti ka ngarkuar on line mandatpagesën e marrë nga banka në portal. Pasi verifikohet kryerja e pagesës nga zyra përkatëse në MBZHR, aplikantit i dërgohet certifikata e regjistrimit elektronikisht dhe gjithashtu kjo certifikatë i dërgohet dhe me vulë të njome me postë, nëpërmjet zyrës së protokollit. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 20 ditë.

Aplikimet të ardhura nga e-Albania trajtohen nëpërmjet AMS (Sistemi i menaxhimit të aplikimeve) sipas kërkesave të aplikuesve.

Kthimi i përgjigjeve përfundimtare tek aplikanti është bërë nëpërmjet Sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik (SQDNE) dhe përgjigjja merret me email në sistemin e-albania. E gjithë procedura realizohet në rrugë elektronike përveç mostrës së produktit plehërues e cila dërgohet fizikisht nga aplikanti siç edhe është shpjeguar në procedurën e aplikimit.

Për periudhën Prill 2021- Dhjetor 2022 Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese ka zhvilluar 51 mbledhje. Në këto mbledhje janë regjistruar në total 807 Produkte Plehëruese. Mosmiratime në total 61 Produkte Plehëruese për të cilat janë marrë vendimet përkatëse të mosmiratimit me arsyetimin se QTTB Fushë Krujë nuk është shprehur dakord, pasi nuk është dërguar mostra e produktit plehërues. Dosjet e audituara për regjistrimin e Produktit Plehërues përmbanin dokumentacionin sipas Ligjit nr. 17/2020 “Për produktet Plehëruese”.

U kontrolluan (4) katër dosje për vitin 2021. Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **14.04.2021**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), bazuar në: Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 6 (gjashtë) Produkte Plehëruese.

Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **26.05.2021**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 8 (tetë) Produkte Plehëruese.

Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **9.9.2021**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 7 (shtatë) Produkte Plehëruese.

Të mos miratojë Produktet Plehëruese, si më poshtë pasi vlerësimi i ardhur nga QTTB Fushë Krujë është negativ sepse në dokumentacion janë deklaruar vlerat e ndotësve shumë herë më të larta se limitet e miratuara për metalet e rënda, ndërsa për PP FUCOVITA, certifikata e analizës është pa firme dhe vule.

Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **14.10.2021**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 27 (njëzet e shtatë) Produkte Plehëruese, si më poshtë vijon:

U kontrolluan (4) katër dosje për vitin 2022. Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **27.9.2022**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkzionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 30 (tridhjetë) Produkte Plehëruese.

Në këtë mbledhje nuk janë miratuar 4 (katër) Produkte Plehëruese, duke u referuar shkresës së ardhur nga QTTB-ja Fushë Krujë me Nr. Prot. 485, datë 19.9.2022 pasi nuk kanë dërguar mostrat e produkteve plehëruese të poshtë cituara. Proces verbali është nënshkruar nga pjesëtarët prezentë.

Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **10.10.2022**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), bazuar në: Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkzionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 9 (nëntë) Produkte Plehëruese.

Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **11.11.2022**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), bazuar në: Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkzionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 9 (nëntë) Produkte Plehëruese.

Referuar shkresës së ardhur nga QTTB-ja Fushë Krujë me Nr. Prot. 601, datë 8.11.2022 nuk janë miratuar 4 (katër) Produkte Plehëruese,

Tek këto 3 produkte plehëruese të dhënat teknike mungojnë. Certifikata e këtyre produkteve nuk kanë firmë dhe vulë origjinale nga kompania prodhuese.

Bazuar në proces verbalin e mbajtur në datë **29.12.2022**, Komisioni i Regjistrimit të Produkteve Plehëruese (KRPP), bazuar në: Ligjin nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”; Urdhrin e Ministrit, nr. 141, datë 26.3.2020, “Për miratimin e Rregullores së Funkzionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese”, (KRPP) ka vendosur të miratojë 28 (njëzet e tetë) Produkte Plehëruese.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se: Regjistrimi i PP-ve, dhënia e certifikatave të regjistrimit për mbrojtjen e bimëve nga Komisioni i Regjistrimit të (KRPP) për dosjet e audituara sa më sipër janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 17/2020 “Për produktet Plehëruese” dhe VKM Nr. 332, dt. 18.05.2022 “Për përcaktimin e institucionit përgjegjës për mbikëqytjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese”.

2.5 Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2021-2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

-Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

-Plotësia e pasqyrave financiare, për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

-Inventarizimi i pronës.

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;

5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto.
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

a. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar komfort dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare, mbi vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe mbi kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), komfort udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë përditësuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga MBZHR, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF janë shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore, por konstatohet se shënimet shpjeguese nuk janë komfort Aneksit nr. 2, Pasqyra nr. 5 “*Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare vjetore*”, Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimi e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*”.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2021 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1924, datë 30.03.2022 “*Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor*”.

- për vitin 2022 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1063/5, datë 27.03.2023 “*Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor*” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmosur rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit.

b. Plotësia e pasqyrave financiare, për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

VITI 2021, pasqyrat financiare

Auditimi i llogarive të performancës financiare

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer komfort dispozitave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Performancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2021 paraqiten si më poshtë vijon:

- i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 1,092 milionë lekë
 - ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 1,072 milionë lekë
 - iii. Rezultati i ushtrimit (Ilog.85) = 20 milionë lekë
- Totali ii + iii = 1,092 milionë lekë

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ në kolonën nr. 100 të pasqyrës së “*Pozicionit Financiar*” (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132, të Formatit nr. 2 “*Pasqyra e Performancës*”.

Për vitin 2021, llogaria 63 “*Ndryshimit të gjendjes së inventarit*” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiarë Vjetore, (diferenca midis tepicës më 31.12.2021 me 31.12.2020, përkatësisht 84,173 mijë – 64,483 mijë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 “*Ndryshim i gjendjeve të inventarit*” në Pasqyrën nr. 2 “*Performanca financiare e institucionit*” prej 19,690 mijë lekë.

Të ardhurat përbëhen nga grantet korrente në vlerën 1,062,538,303 lekë dhe të ardhurat jo tatimore, si rezultat i të ardhurave sekondare në vlerën 29,873,400 lekë. Nga rakordimi midis MBZHR dhe Degës së Thesarit për muajin dhjetor 2021 konstatohet se të ardhurat sekondare të MBZHR progresive për vitin 2021 kapin vlerën 58,145,149.16 lekë, ku 27,894,020 lekë janë të ardhurat nga licencat, 26,347,824.59 janë të ardhurat nga qiratë e tokave bujqësore, të ardhurat nga mallrat e shërbimet në shumën 1,402,660.57 lekë, të ardhurat nga kamatëvonesat me shumën 1,550,432 lekë, të ardhura nga qiraja e ndërtesës në shumën 727,800 lekë dhe të ardhura nga shitja e matrikujve në shumën 222,412 lekë e cila përkon me pjesën që institucioni e përdor si rritje të autorizuar dhe pjesa tjetër në shumën 57,922,737.16 lekë janë derdhur në buxhet. Grantet korrente për vitin 2021 janë rritur kundrejt vitit 2020 për mbështetjen e fermerëve me karburant.

Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar komfort dispozitave ligjore në fuqi. Pasqyra e Aktiv Pasit është pasqyruar në Aneksin 3/a të Raportit të auditimit.

Sipas pasqyrave financiare vjetore në Aktivin e Bilancit Kontabël rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 93% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 7% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

- Llogaria 512 “Mjete monetare në bankë” në vlerën në vlerën 441,840 lekë përfaqëson mjetet monetare të MBZHR në bankë, ku në krahasim me vitin 2020 nuk ka pësuar ndryshim. Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Llogaria 512, “Mjete monetare në bankë” vepron kryesisht për institucionet që zbatojnë projekte të huaja. Mjetet monetare në bankën e nivelit të dytë për përfaqësinë e MBZHR në Bruksel, nuk janë të regjistruara në këtë llogari për faktin, se ndodhen në llogarinë bankare të MEPJ.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49: përdoret nga njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466). Pasqyrimi në vlerën në vlerën 176,689,588 lekë përfaqëson të ardhura të trashëguara, si dhe gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) për garanci punimesh në shumën 63,091,456 lekë.

Sipas Pikës nr. 50 të Udhëzimit, Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në llogaritë vjetore të vitit 2021 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2021 reflekton me ulje prej vitit 2020 në vlerën 4,808,896 lekë. Sipas akt rakordimit me thesarin konstatohet se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” të hyrat rezultojnë në shumën 7,760,048 lekë, e cila përputhet me të dhënat analitike të kësaj llogarie, të cilat nuk janë të detajuara në shënimet shpjeguese, por janë marrë nga sektori i financës në MBZHR, ndërsa daljet e kësaj llogarie sipas akt rakordimit me thesarin rezultojnë në shumën 23,309,724 lekë, ndërsa sipas llogarisë analitike në shumën 32,536,439 lekë, ose *me një diferencë prej 9,226,715 lekë*. Kjo shumë sipas urdhër shpenzimeve nr. 633, 634, 635 datë 24.12.2021 përkojnë me likuidimin e garancive të ofertës për të cilat kanë qenë fonde të ngurtësuar në sistemin e Thesarit për sigurim oferte për projektet C0100 Loti I “Rehabilitimi i hidrovorit të Karavastasë”, C0737 Loti II “Mbrojtje nga përmbytja lumi Osum, Berat”, C2722 dhe C0183 Loti III “Mbrojtja lumore e zonës perëndimore qyteti Librazhd”, përkatësisht në shumën 5,531,787 lekë, 1,094,928 lekë, 1,466,667 lekë dhe 1,133,333 lekë. *Shuma prej 1,466,667 lekë për operatorin Meteo ShPK mbetet ende e pa likuiduar, por nuk është regjistruar në llogarinë 401 Furnitorë*. Në lidhje me fondet e ngurtësuar është dërguar nga MBZHR kërkesa me nr. 6757/3, datë 17.12.2021 drejtuar degës së thesarit “Rritje e autorizuar” në shumën 9,226,715 lekë me qëllim çlirimin e këtyre shumave të ngurtësuar në llogarinë 466 operatorëve pjesëmarrës në tender.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2021, rezulton në vlerën 84,173,639 lekë. Në krahasim me vitin 2020 është rritur në vlerën 19,690,602 lekë, nga shtimi i zërit “Materiale” në vlerën prej 19,515,871 lekë dhe shtimi i zërit “Inventar i Imët” në vlerën 174,731 lekë. Diferenca 19,690,602 lekë përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.

Llogari të arkëtueshme:

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 27,418,431 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MBZHR ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2021 që paguhet në muajin Janar 2022, përkatësisht për pagat në vlerën 10,609,306 lekë, për tatim taksa në vlerën 1,179,368 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 3,694,195 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 466,791 lekë, si dhe kreditorë të ndryshëm në vlerën 28,414,200 lekë (që përfaqëson shpenzime të konstatuara në 2021), të cilat paguhet në Janar të vitit 2022. Kjo

llogari ka si kundër parti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 436 dhe 467. Llogaria 4342 përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Në shënime shpjeguese shprehet se “kjo llogari pasqyron detyrimet që do të likuidohen vitin tjetër për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, sigurimi si dhe tatimi mbi të ardhurave nga punësimi” të cilat do të përbënin shumën 15,949,660 lekë, me një diferencë prej 11,468,771 më pak se regjistrimi i bërë në llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor”. Shuma 11,468,771 lekë përfaqëson detyrim të prapambetur sipas rakordimit me llogarinë 602 për “Blerje mallra e shërbime”.

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 42,758,222 lekë, e cila përfaqëson detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve, të cilat i ka ndarë sipas natyrës së tyre.

Sipas shënimeve shpjeguese të MBZHR kjo llogari përfshin shumën 42,758,222 lekë të fondit të transferuar në llogari të Misionit për përfaqësuesit e MBZHR në Bruksel, nga i cili nuk është disbursuar.

Sipas udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, të ndryshuar, Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfshihet në grupin e llogarive rregulluese, përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), ndërkohë që sipas informacionit të marrë në MBZHR transferta e fundit e bërë kundrejt llogarisë bankare të Misionit, e cila menaxhohet nga Ministria e Jashtme, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur me MBZHR, mban vlerën €194,930. Sipas MBZHR llogaria dhe transferta në fjalë është bërë për likuidimin e pagesave të personelit përfaqësues të MBZHR në Bruksel, i cili sipas organikës së ministrisë rezulton me vende plotësisht vakante për gjithë periudhën e auditimit, vitin 2021-2022. Nga MBZHR nuk disponohet një ekstrakt bankar i kësaj llogarie. Në llogarinë 512 “Mjete monetare në bankë” nuk është regjistruar shuma e kësaj transferte pasi këto mjete nuk ndodhen në një llogari bankare të MBZHR, por të MEPJ. Auditimi i urdhër shpenzimit përkatës nuk është audituar pasi nuk i përket periudhës nën auditim.

Llogaria 401-408 “Furnitorë” rezulton në shumën 25,812,793 lekë dhe përfaqëson detyrimet e prapambetura për Aparatin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fund të vitit 2021, e detajuar si më poshtë:

- 14,344,022 lekë janë për mosrealizim punimesh në objektin Rehabilitim i V-2 Dropull, Gjirokastrë.
- 8,800,000 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (AKSHI), nga mungesa e raportit të monitorimit.
- 167,760 lekë të likuidatorit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore, znj. A.N., pasi mungon vendimi i çregjistrimit në gjykatë.
- 826,692 lekë të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, pasi mungon praktika.
- dhe diferenca prej 157,112 lekë janë publikime në gazetë për dhënie toke me qira që u mungon praktika.

Aktivet afatgjata

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata” në vlerën neto prej 4,591 milionë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 3.5 milion dhe “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 2,070 milion lekë.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 3,504,000 lekë, e pandryshuar nga viti 2020. Nga auditimi u konstatua se kjo vlerë ka të bëjë me studim projektimin e “Godinës së MBZHR” e njohur në kontabilitet që në 2020.

Vlera e pandryshuar prej vitit të mëparshëm ushtrimor evidenton faktin se kjo llogari nuk i është nënshtruar amortizimit, duke qenë një aktiv afatgjatë jo material, në kundërshtim me Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Pjesa III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Pika 36, “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon: Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”

- Llogaria 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme” paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 0 lekë.

Gjatë auditimit konstatohet se MBZHR është autoriteti kontraktor në 3 (tre) kontrata koncesionare “Për shfrytëzimin e burimit ujor Sasaj, Bunec” me vlerë 503.7 milionë lekë dhe “Për dhënien me koncesion të sipërfaqes deri në 1000 ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevindh dhe Gosë, Kavajë me vlerë 1.9 miliardë lekë sipas raportimit të MFE në adresën elektronike <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Raporti-Vjetor-i-Permbledhur-2021.pdf> dhe për “Hydrocentralin e Gjançit”, në rrethin e Korçës informacion i marrë nga Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave.

Konstatim nr. 4:

1. Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR është autoriteti përgjegjës për kontratat 3 (tre) koncesionare si më poshtë:

a-Me Kontratën e Konkensionit datë 7.1.2009, me palë konkensionare Autoriteti: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Konkensionari shoqëria “A.1” sha, është dhënë me konkension sipërfaqja deri 1000 ha (jo më pak se 700 ha), në Komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevindh dhe Gosë, Kavajë, me qëllim kultivimin e Ullirit, për një afat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet. Kjo kontratë është miratuar me Ligjin nr. 10082, datë 23.2.2009 “Për miratimin e kontratës së konkensionit të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) për kultivimin e ullirit, në një sipërfaqe deri në 1000 ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevindh dhe Gosë, Kavajë, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si Autoritet Kontraktues dhe “A. 1” sha, Tiranë.

b-Me Vendimin Nr. 625, datë 11.9.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Marrëveshjes së Konkensionit të formës "ROT" ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Shoqërisë “S.” ShPK për Hydrocentralin e Gjançit” shoqëria “S.” ShPK ka marrë me koncesion hydrocentralin e Gjançit, në rrethin e Korçës së bashku me transformatorin ngritës 6/35 kV deri të thika e tij nga ana e zbarave 35 kV, në përputhje me formën “ROT” me asetet sipas Aneksit 1 pjesë përbërëse e marrëveshjes së konkensionit. Ky koncesion është me kohëzgjatje 30 (vjet) afat i cili fillon nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së konkensionit

c-Me Kontratën e Konkensionit nr. 8618, datë 14.08.2014 Ministria e Mjedisit me cilësinë e Autoritetit Kontraktor, si autoriteti që ka administruar këto burime ujore, i ka dhënë me koncesion Shoqërisë “B. E. O.” shpk (Konkensionari) përdorimin e ujit të burimit “Sasaj, Bunec” Lukovë, Sarandë. Forma e Kontratës së Konkensionit është shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit (BOT) për një afat 20 vjet. Me VKM nr.775, datë 04.12.2019, është përcaktuar MBZHR, si i vetmi Autoritet Kontraktues përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate koncesionare.

Këto kontrata koncesionare monitorohen nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave në MBZHR, sektor i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në MBZHR.

Kontratat koncesionare të mësipërme nuk rezultojnë të regjistruara në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 31/b. ***Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistr të veçantë për*** secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe **kontratat e konkensionit** dhe enfiteozes,

me të dhënat si vijon: b. *Për kontratat e koncesionit dhe enfiteozës - Objekti i koncesionit, afati në vite, kushti bazë i pagesës, fillimi i pagesës, arkëtuar deri në vitin xxxx, viti aktual (planifikuar, derdhur), parashikimi për vitin e ardhshëm, akti që ka miratuar kontratën koncesionare apo të enfiteozës.*

Titulli i gjetjes nr. 3	Mungesë e pasqyrimin të kontratave koncesionare në regjistrin e aktiveve.
Situata	<p>1.Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR është autoriteti përgjegjës për kontratat 3 (tre) koncesionare si më poshtë:</p> <p>a-Me Kontratën e Koncesionit datë 7.1.2009, miratuar me Ligjin nr. 10082, datë 23.2.2009 “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” për kultivimin e ullirit, në një sipërfaqe deri në 1000 ha, në komonat Synej, Luz i Vogël, Kryeviidh dhe Gosë, Kavajë, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si Autoritet Kontraktues dhe “A.1” sha, Tiranë.</p> <p>b-Me Vendimin Nr. 625, datë 11.9.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit të formës "ROT" ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Shoqërisë “S.” shpk për Hydrocentralin e Gjançit”.</p> <p>c-Me Kontratën e Koncesionit nr. 8618, datë 14.08.2014 dhe me VKM nr. 775, datë 04.12.2019, MBZHR është Autoritet Kontraktues përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës koncesionare me Shoqërinë “B. . O.” shpk (Koncesionari) për përdorimin e ujit të burimit “Sasaj, Bunec” Lukovë, Sarandë.</p> <p>Këto kontrata koncesionare monitorohen nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave në MBZHR, sektor i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse në MBZHR. Kontratat koncesionare të mësipërme nuk rezultojnë të regjistruara në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR, duke krijuar riskun e humbjes së gjurmës së auditimit.</p>
Kriteri	Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 31/b.
Ndikimi/Efekti	Risku i humbjes së gjurmës së auditimit
Shkaku	Mos përfshirja e regjistrin të koncesioneve në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	MBZHR të marrë masat në pasqyrimin në regjistrin e aktiveve të kontratave koncesionare për të cilat ajo është autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit.

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet edhe për vitin 2021 në vlerën 0 lekë, megjithëse MBZHR ka në administrim toka bujqësore.

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 113,131,922 lekë, përbërë nga:

Objekti	Vlera fillestare	Viti i vënies në shfrytëzim	Vlera e mbetur 31.12.2021
Ndërtesa e vjetër MBUK	109,757,093	1939	21,600,887
Ndërtesa e re MBUK	124, 578,000	2003	87,263,823
Rikonstruksion ndërtesa	4,728,215	2019	4,267,214

Krahasuar me vitin e mëparshëm ka pësuar ndryshime në një ulje prej 5,954,312 lekë si rezultat i amortizimit të vitit ushtrimor 2021.

- Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në vlerën 3,440,003 lekë. Gjatë vitit 2021 ky zë ka pësuar ulje në vlerën bruto në shumën 181,053 lekë nga llogaritja e amortizimit vjetor.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto prej 19,674,990 lekë, ku sipas regjistrorit të aktiveve përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të MBZHR, dhe në ndryshimi nga viti paraardhës rezulton me një pakësim 4,918,748 lekë, si rezultat i amortizimit vjetor.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në vlerën neto prej 44,606,347 lekë me në rritje prej 30,462,239 prej vitit të mëparshëm. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat:

- shtesë nga transferime kapitale pa pagesë nga DSHPA dhe Banka Botërore në shumën prej 46,105,672 lekë.
- shtesë me pagesë nga blerja e pajisjeve të zyrës, si kompjutera, skanera, etj. në shumën 8,517,360 lekë.
- si dhe pakësimin në shumën 24,160,793 lekë nga llogaritja e amortizimit vjetor.

- Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” paraqitet në shumën 15,632,932 lekë dhe me ulje prej 5,210,977 lekë kundrejt një viti më parë, si rezultat i amortizimit vjetor pasi ende nuk është zhvilluar procesi i asgjësimit të tyre.

- Llogaria 28 “Caktime të aktiveve afatgjata” paraqitet në shumën 1,873,544,829 lekë, rritur në shumën 1,240,212,383 lekë prej vitit 2021 nga investimet në veprat ujore dhe kullimit të vitit 2020 në shumën 683,223,160 lekë, shtesat pa pagesë kapitalizim i llogarisë 231 në shumën 687.541.060 lekë, sistemi VMS për peshkimin në shumën 169,143,613, vepra ujore në shumën 302,432,202 lekë, Shtesë pa pagesë kapitalizim merkato e peshkut Shëngjin në shumën 34,632,845 lekë, etj.

Sipas formatit 7/b të pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” konstatohet se është reflektuar saktë pakësimi i kësaj llogarie në shumën 58,405,598 lekë për transferimin kapital të merkatos së peshkut Shëngjin.

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet në shumën 2,217,739,000 lekë, rritur në shumën 63,000,000 lekë kundrejt një viti më parë, si rezultat i shtimit të fondit të garancisë së BERZH.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” (me koston historike) është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2021 me vlerën bruto prej 2,383,897,829 leke dhe në formatin 7/b me vlerën e tyre neto prej 2,073,535,023 lekë, shumë kjo e njëjtë dhe e rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1, llogaria 20 & 21 të pozicionit financiar në zërin “Aktive afatgjata” (rreshti nr. 43 dhe 47 i bilancit).

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2021, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 246,866,241 lekë.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 10,609,306 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2021, që paguhen në janar të vitit 2022.

- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,179,368 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2021, të cilat paguhen në Janar të vitit 2022.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 3,694,195 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 466,791 të muajit Dhjetor 2021, të cilat paguhen në muajin Janar 2022.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën prej 176,689,588 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur për punime si dhe të ardhura të papërdorura të kapitullit 6 të llogarisë 602.

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 28,414,200 lekë, përfaqëson detyrimet e prapambetura për shpenzime, për të cilat nuk është konstatuar debitimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”.

Sipas shënimeve shpjeguese konstatohet se në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta) janë pasqyruar detyrimet e muajit dhjetorit 2021 që do të paguhet në janar 2022, për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Sipas shënimeve shpjeguese, por dhe pasqyrimin në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohet se këto zëra janë në shumën totale prej 15,949,660 lekë, ndërkohë që llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” rezulton në fund të vitit 2021 në shumën 27,418,431 lekë, pa një shpjegim për vlerën 11,468,771 lekë. Nga kryqëzimi i të dhënave me llogarinë analitike 602 “Blerje mallra e shërbime” shuma 11,468,771 lekë është regjistruar si shpenzim i konstatuar i periudhës me emërtimin “detyrime të prapambetura”.

Pas kërkesës së grupit të auditimit kundrejt detajimit të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” drejtuar sektorit të financës në MBZHR, na u vu në dispozicion detajimi i mëposhtëm, i cili nuk pasqyrohet në shënime shpjeguese:

Tabela nr. 5.3: “Përbërja analitike e Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2021”

Në lekë

Nr.	Pershkrimi	leke
1	Ministria e Jashtme (Paga për përfaqësuesit e Brukselit)	25,000,000
2	B. A.Gjyqfitues (kthim në vendin e punës)	1,885,680
3	A. O.Gjyqfitues (kthim në vendin e punës)	923,520
4	B.A.Gjyqfitues (kthim në vendin e punës)	605,000
	TOTALI	28,414,200

Burimi: MBZHR

Për Llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 28,414,200 lekë nuk ka shpjegim në shënime shpjeguese, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8/2018, i ndryshuar, Pika 19.

Aktiviteti neto/ fondet

Fondi neto në vlerën 4,676,012,516 lekë përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 264,407,531 lekë, nga teprica e llogarisë 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme” në shumën 2,173,667,843 lekë të cilat kanë të bëjnë me aktivet në proces vlerë për të cilën është debituar llogaria 23 “Investime, teprica e llogarisë 12 “Rezultati i mbartur” në shumën 65,700 lekë, teprica e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në shumën 19,690,602 lekë, llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të huaja” në vlerën 441,840 lekë dhe “Të tjera” në shumën 2,217,739,000 lekë”.

Konstatim nr. 5:

Llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 65,700 lekë e pandryshuar nga viti i mëparshëm ushtrimor 2020. Nga rakordimi midis zërave dhe pasqyrave krahasuese 2021-2020 duhej të paraqitej për vlerën (41,717,893) lekë. Në fillim të vitit ushtrimor, nga MBZHR duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm (2020) dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”. Veprime këto në mospërputhje me Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik” Pika 44... “ në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”. Sipas pasqyrës së performancës financiare të vitit 2021, konstatohet se rezultati i veprimtarisë ushtrimore për vitin 2020 ka rezultuar në shumën debitore (61,474,195), për vitin 2021 për shumën kreditore 19,690,602 lekë, dhe

gjendja e llogarisë 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” në shumën 65,700 lekë, duke sjellë se kjo llogari duhet të paraqitet në shumën (41,717,893) lekë.

Në lidhje me këtë konstatim nga MBZHR është dërguar observacioni me nr. 211/19, datë 15.05.2023 protokolluar në KLSH me nr. 1175/8, datë 22.05.2023 në përgjigje të Akt Konstatimit nr. 1, datë 08.05.2023, për të cilin është reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

Auditimi i pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë paraqet shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të institucionit, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Nga auditimi i zërave të pasqyrës rezulton se totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit në vlerën 95,732,646 lekë është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 1,093,109,577 lekë, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor në vlerën 90,681,588 lekë dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 1,088,058,519 lekë.

Rubrika II, e cila pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në vlerën 35,780,423 lekë, përbëhet nga zëra: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale në vlerën 888,847,866 lekë, nga te cilat 853,067,443 lekë janë për investimet e realizuar gjatë vitit ushtrimor 2021.

Rubrika III pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera në vlerën (136,387,666) lekë. Kjo rubrikë përbëhet nga zëra si: derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet në vlerën 57,922,737 lekë dhe Transferime ne buxhet të Fondeve të papërdorura (-) në vlerën 78,464,929 lekë.

Nga auditimi i zërave rezulton se Rubrika IV në vlerën (4,874,597) lekë, e cila përfaqëson rënien neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës, e cila është e barabartë me shumën algjebrike të rubrikave I, II dhe III.

Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur. Diferenca algjebrike e këtyre rubrikave është e barabartë me shumën e evidentuar në rubrikën IV.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit rakordon me “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre” të pasqyrës së pozicionit financiar në shumën 177,131,428 lekë.

Viti 2022, pasqyrat financiare

Pasqyrat financiare për vitin 2022 janë dërguar në MFE me shkresën nr. 1063/5, datë 27.03.2023 “Dërgohen pasqyrat financiare të vitit 2022”.

Auditimi i pasqyrës së performancës financiare

Nga auditimi i gjendjes së llogarive për vitin 2022 rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirm dispozitave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 469 milionë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 493 milionë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = -24.5 milionë lekë

Totali ii + iii = 469 milionë lekë

Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore“ në kolonën nr. 100 të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” (F1) rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132, të Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

Për vitin 2022, llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiarë Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2022 me 31.12.2021, përkatësisht mijë 59,667 mijë– 84,173 mijë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2 “Performanca financiare e institucionit” prej (24,507) mijë lekë.

Të ardhurat përbëhen nga grantet korrente në vlerën 453,016,556 lekë dhe të ardhurat jo tatimore, si rezultat i të ardhurave sekondare në vlerën 15,715,967 lekë. Grantet korrente të vitit 2022 rezultojnë të ulura me vlerën 623,679,180 lekë, për faktin se rimbursimi naftës për fermerët përgjatë vitit 2022 ndryshe nga një vit më parë, është kryer nga AZHBR.

Nga rakordimi midis MBZHR dhe Degës së Thesarit për vitin 2022 konstatohet se të ardhurat sekondare të MBZHR progresive për vitin 2022 kapin vlerën 57,320,169 lekë, ku 20,483,952 lekë janë të ardhurat nga licencat, 32,048,487 janë të ardhurat nga qiratë e tokave bujqësore, të ardhurat nga mallrat e shërbimet në shumën 1,618,765 lekë, të ardhurat nga kamatvonesat me shumën 1,339,706 lekë, të ardhura nga qiraja e ndërtesës në shumën 727,800 lekë dhe të ardhura nga dëmshpërblime të përfituara nga Instituti i Sigurimeve në shumën 1,001,459 lekë, gjobë për mosrealizim investimi në shumën 89,000 lekë si dhe të ardhura nga analizat kimike e biologjike në shumën 11,000 lekë. Nga të ardhurat rritja e autorizuar paraqitet në shumën 1,001,459 lekë dhe pjesa tjetër në shumën 56,318,710 lekë janë derdhur në buxhet. Të ardhurat sekondare në vlerën 15,715,967 lekë paraqesin të ardhurat që ka përdorur MBZHR në lidhje me matrikujt.

Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrave financiare vjetore në Aktivin e Bilancit Kontabël rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 94% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 6% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

- Llogaria 512 “Mjete monetare në bankë” në vlerën në vlerën 18,056,070 lekë përfaqëson gjendjen monetare në bankë, ku në krahasim me vitin 2021 ka pësuar rritje në shumën 17,614,230 lekë, si institucion që zbaton projekte të huaja.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” paraqitet në shumën 124,028,008 lekë dhe ka një pakësim në shumën 52,661,580 lekë kundrejt vitit 2021. Pasqyrimi në vlerën në vlerën 124,028,008 lekë përfaqëson të ardhura të trashëguara, për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466) për garanci punimesh në shumën 49,920,775 lekë, si dhe kapitulli 6 i llogarive 602/231 në shumën totale 74,107,232 lekë.

Sipas Pikës nr. 50 të Udhëzimit, Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Në llogaritë vjetore të vitit 2022 është bashkëlidhur akt rakordimi me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2022 reflekton me ulje prej vitit 2021 në vlerën 52,661,580 lekë. Sipas bilancit llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” përputhet në shumë me llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” respektivisht në nr rreshtor 6 dhe 81, ndërkohë sipas aktrakordimit me thesarin konstatohet se llogaria 466

“Kreditorë për mjete në ruajtje” të hyrat rezultojnë në shumën 15,297,249 lekë, e cila përputhet me të dhënat analitike të kësaj llogarie, të cilat nuk janë të detajuara në shënimet shpjeguese, por janë marrë nga sektori i financës në MBZHR, ndërsa daljet e kësaj llogarie sipas aktrakordimit me thesarin rezultojnë në shumën 53,244,321 lekë, duke bërë që gjendja në fund e llogarisë 466 “Mjete monetare në ruajtje” të rezultojë në shumën 49,920,775 lekë (gjendja fillestare e mbartur prej vitit 2021 duhet të rezultojë 87,867,847 lekë) regjistruar në kontabilitet me shumën 124,028,008 lekë, ose 74,107,233 lekë më shumë. Kjo shumë i korrespondon kapitullit 06 të llogarisë 602, pjesë e disponibiliteteve në thesar.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2022, rezulton në vlerën 59,667,048 lekë. Në krahasim me vitin 2021 është pakësuar në vlerën 24,506,591 lekë, nga pakësimi i zërit “Materiale” në vlerën prej 24,688,991 lekë dhe shtimi i zërit “Inventar i Imët” në vlerën 182,400 lekë. Diferenca 24,506,591 lekë përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.

Llogari të arkëtueshme:

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 15,155,726 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MBZHR ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022 që paguhet në muajin Janar 2023, përkatësisht për pagat në vlerën 10,049,872 lekë, për tatim taksa në vlerën 1,079,283 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 3,583,091 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 443,480 lekë, në këtë llogari nuk është përfshirë llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 31,386,460 lekë.

Llogaritë e marrëdhënies me shtetin: Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhet nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Përgjatë vitit 2022, ndryshe nga viti 2021, nuk është regjistruar në llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” shumën e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në shumën 31,386,460 lekë. Kjo shumë nga krahasimi shifror me relacionin shoqëruar të pasqyrave financiare të vitit 2022, rezulton të jetë e barabartë me vlerën e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, për *“fondin e transferuar në llogari të Misionit për përfaqësuesit e MBZHR në Bruksel, nga i cili nuk disbursuar pagesë gjatë viteve 2021 dhe 2022, pasi Sekretariati i MBZHR në Bruksel është vakant dhe vendimi gjyqësor i punonjësit A.K., i cili do të paguhet në vitin 2023”*.

Llogaria 401-408 “Furnitorë” rezulton në shumën 0 lekë, duke paraqitur faktin që MBZHR nuk ka furnitorë të palikuiduar.

Aktivet afatgjata

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata” në vlerën neto prej 3,686 milionë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 68,8 milion dhe “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 1,006.4 milion lekë.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 68,886,000 lekë, me një rritje prej 65,382,000 lekësh nga viti 2021, si rezultat i lëvizjeve brenda aktiveve si: mbajtja e sistemit të fizibilitetit të sistemit të naftës për fermerët e cila nuk u transferua në AZHBR, por u mbajt në Aparatin e MBZHR, dhe trajnimi i përdoruesve të MBZHR për këtë sistem. Sipas relacionit shpjegues të pasqyrave financiare, kjo llogari është shtuar prej pakësimit të llogarisë 28 “Caktime”.

Vlera e pandryshuar e llogarisë së mbartur prej vitit 2020 nuk i është nënshtruar amortizimit, duke qenë një aktiv afatgjatë jomaterial, në kundërshtim me Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, Pjesa III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen

dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Pika 36, “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon: Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.”

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet edhe për vitin 2022 në vlerën 0 lekë, të pandryshuar nga viti 2021.

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 110,902,944 lekë, e pakësuar prej një viti më parë si rezultat i llogaritjes së amortizimit vjetor.

- Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në vlerën 3,268,003 lekë. Gjatë vitit 2022 ky zë ka pësuar ulje në vlerën bruto në shumën 172,000 lekë nga llogaritja e amortizimit vjetor.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 15,739,992 lekë, ku sipas regjistrimit të aktiveve përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të MBZHR, dhe në ndryshimi nga viti paraardhës rezulton me një pakësim 3,934,998 lekë, si rezultat i amortizimit vjetor.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në vlerën neto prej 21,347,667 lekë me pakësim prej 23,258,680 lekë prej vitit të mëparshëm. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat:

- shtesë nga transferime kapitale pa pagesë nga GIZ në shumën prej 1,029,000 lekë
- shtesë me pagesë nga blerja e pajisjeve të sallës së mbledhjeve në shumën 2,262,376 lekë.
- pakësimit në shumën 460,905 lekë për dalje që janë bërë për DPSHA
- pakësimit në shumën 26,832,151 lekë nga llogaritja e amortizimit vjetor.

- Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” paraqitet në shumën 30,848,418 lekë dhe me rritje prej 15,215,486 lekë kundrejt një viti më parë. Konstatohet nga krahasimi me të dhënat e pasqyrës statistikore formati 7/b, se shuma prej 15,215,486 lekë përfaqëson pakësim të kësaj llogarie, e cila nuk është bërë zbritje vlerës së mbartur prej vitit 2021, vlera e paraqitur në pasqyrë përfaqëson koston historike të llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në shumën 30,848,418 lekë, pasi ende nuk është zhvilluar procesi i asgjësimit të tyre. Vlera e amortizimit të akumuluar të tyre sipas formatit 7/b rezulton zero, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8/2018, Pika 92, 93 “Vlera neto, për çdo element të kolonave, është e barabartë me koston historike minus amortizimin”.

Sipas relacionit shpjegues bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit 2022, kjo llogari është sistemuar për vlerën e amortizimit të llogaritur gabim në vitin 2021, në të cilën vlera e amortizimit e llogarisë 24 për vitin 2021, i është shtuar llogarisë 28 “Caktime” për VMS e vjetër të bërë transferim kapital nga DPSHA.

- Llogaria 28 “Caktime të aktiveve afatgjata” paraqitet në shumën 824,333,195 lekë, pakësuar në shumën 1,049,211,634 lekë prej vitit 2021. Në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare bëhet shpjegimi i përbërjes analitike si më poshtë:

- është bërë shtimi i llogarisë nga blerjet në shumën 173,648,446 lekë.

- shtim nga kapitalizimin i investimeve në proces të vitit 2021 me vlerën 210,772,915 lekë.

- pakësim i investimeve të përfunduara njësisive të varësisë në shumën 1,433,632,995 lekë, prej rezultateve të grupit të punës së ngritur me urdhrin e SP nr. 310, datë 29.06.2022 “Për transferimin e investimeve për “Rehabilitimin e objekteve dhe mbrojtjeve lumore në njësitë e varësisë”. Sipas rekomandimit të grupit të punës, ky transferim është i pjesshëm dhe pjesa e mbetur do të transferohet në vijim pas verifikimit në terren.

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet në shumën 2,293,446,000 lekë, rritur në shumën 75,707,000 lekë kundrejt një viti më parë, si rezultat i shtimit të fondit të garancisë së BERZH.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme,” (me koston historike) është e pasqyruar në mbyllje të ushtrimit me 31.12.2022 me vlerën bruto prej 2,383,897,829 leke dhe në formatin 7/b me vlerën e tyre neto prej

1,075,326,219 lekë, shumë kjo e njëjtë dhe e rakorduar me vlerën e referuar në formatin nr. 1, llogaria 20 & 21 të pozicionit financiar në zërin “Aktive afatgjata” (rreshti nr. 43 dhe 47 i bilancit).

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2022, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 170,570,194 lekë.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 10,049,872 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në janar të vitit 2023.
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 1,079,283 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në Janar të vitit 2023.
- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 3,583,091 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 443,480 të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin Janar 2023.
- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën prej 124,028,008 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur për punime si dhe të ardhura të papërdorura të kapitullit 6 të llogarisë 602.
- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 31,386,460 lekë, përfaqëson detyrimet e prapambetura për shpenzime, për të cilat nuk është konstatuar debitimi i llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”.

Pas kërkesës së grupit të auditimit kundrejt detajimit të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” drejtuar sektorit të financës në MBZHR, na u vu në dispozicion detajimi i mëposhtëm, i cili nuk pasqyrohet në shënimet shpjeguese:

Tabela nr. 5.4: “Përbërja analitike e Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2022”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	leke
1	Ministria e Jashtme (Paga për përfaqësuesit e Brukselit)	25,000,000
2	Aleksandër Klimi Gjqy fitues (kthim në vendin e punës)	6,386,460
	TOTALI	31,386,460

Burimi: MBZHR

Konstatim nr. 6:

Për Llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për të dy vitet në auditim, për vitin 2021 me vlerën 28,414,200 lekë dhe vitin 2022 me vlerën 31,386,460 lekë nuk ka shpjegim në shënimet shpjeguese, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8/2018, i ndryshuar me Pikën 19. Seksioni 3.7 “Rregullat për dhënie e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale” në pikën 85 shtohen pikat, si më poshtë vijon: *pasqyrën analitike të llogarive të pagueshme të NJQP sipas llojit të kreditorëve ku të jepet shifra e akumuluar e secilës llogari kontabël sipas Aneksit 2. Pasqyra 5 e rishikuar në këtë udhëzim.*

Në lidhje me këtë konstatim nga MBZHR është dërguar observacioni me nr. 211/19, datë 15.05.2023 protokolluar në KLSH me nr. 1175/8, datë 22.05.2023 në përgjigje të Akt Konstatimit nr. 1, datë 08.05.2023, për të cilin është reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

Aktivitet neto/ fondet

Fondi neto në vlerën 3,763,772,562 lekë përbëhet nga llogaritë 101 “Fondi bazë” në vlerën 335,166,663 lekë, nga teprica e llogarisë 105 “Teprica e Granteve kapitale te brendshme” në shumën 1,141,610,420 lekë të cilat kanë të bëjnë me aktivet në proces vlerë për të cilën është debituar llogaria 23 “Investime, teprica e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në shumën (24,506,591) lekë, llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të huaja” në vlerën 18,056,070 lekë dhe “Të tjera” në shumën 2,293,446,000 lekë”. Teprica e llogarisë 12 “Rezultati i mbartur” në shumën 65,700 lekë nuk është pasqyruar në llogarinë 12 për vitin 2021.

Konstatim nr. 7:

Llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” në vlerën 65,700 lekë, i pasqyrave financiare të vitit 2021, i pandryshuar nga viti ushtrimor 2020, nuk është mbartur në vitin 2022 si vit krahasues me vitin e mëparshëm. Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” rezulton në vlerën debitore 24,506,591 lekë, si rezultat i shpenzimeve të funksionimit më të larta se të ardhurat e periudhës ushtrimore për të cilën nuk ka të dhëna në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, veprim në mospërputhje me Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Pika 57... “Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa, si tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese”.

Në lidhje me këtë konstatim nga MBZHR është dërguar observacioni me nr. 211/19, datë 15.05.2023 protokolluar në KLSH me nr. 1175/8, datë 22.05.2023 në përgjigje të Akt Konstatimit nr. 1, datë 08.05.2023, për të cilin është reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë paraqet shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të institucionit, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Nga auditimi i zërave të pasqyrës rezulton se totali i flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e shfrytëzimit në vlerën 22,875,798 lekë është i barabartë me shumën e totalit të zërave: akordim fondesh buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 455,414,895 lekë, arkëtime e të hyra gjatë vitit ushtrimor në vlerën 90,278,648 lekë dhe pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 522,817,745 lekë.

Rubrika II, e cila pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e investimeve të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në vlerën 9,291,649 lekë, përbëhet nga zëra: akordim fondesh buxhetore për shpenzime kapitale në vlerën 488,911,459 lekë, nga te cilat 479,619,810 lekë janë për investimet e realizuar gjatë vitit ushtrimor 2022.

Rubrika III pasqyron flukset monetare që rrjedhin nga transfertat dhe transaksionet e tjera në vlerën (67,214,797) lekë. Kjo rubrikë përbëhet nga zëra si: derdhje e transferime të të ardhurave në buxhet në vlerën 56,318,710 lekë dhe Transferime ne buxhet të Fondeve të papërdorura (-) në vlerën 10,896,087 lekë.

Nga auditimi i zërave rezulton se Rubrika IV në vlerën (35,047,350) lekë, e cila përfaqëson rënien neto të mjeteve monetare në krahasim me vitin paraardhës, e cila është e barabartë me shumën algjebrike të rubrikave I, II dhe III.

Rubrika V dhe rubrika VI përfaqësojnë respektivisht gjendjen e mjeteve monetare në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor të mbyllur. Diferenca algjebrike e këtyre rubrikave është e barabartë me shumën e evidentuar në rubrikën IV.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit rakordon me “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre” të pasqyrës së pozicionit financiar në shumën 142,084,078 lekë.

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se MBZHR ka të dhëna të plota mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhura ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës... përveç konstatimeve në lidhje me to në këtë akt.

Konstatim nr. 8:

Nga të dhënat e marra prej Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave konstatohet se MBZHR në zbatim të legjislacionit në fuqi, administron tokat bujqësore ku nëpërmjet qiradhënies së tyre sigurohen të ardhura dytësore të derdhshme totalisht në buxhetin e shtetit. Nga kryqëzimi i të dhënave të mësipërme me regjistrin e aktiveve, si dhe librat e kontabilitetit konstatohet se edhe për vitet 2021, 2022 këto toka bujqësore që MBZHR administron, në sipërfaqe totale 19,033.95 ha, ashtu si në auditimin e mëparshëm, nuk janë të regjistruara në pasqyrat financiare dhe në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhura ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës... ”.

Në lidhje me këtë konstatim nga MBZHR është dërguar observacioni me nr. 211/19, datë 15.05.2023 protokolluar në KLSH me nr. 1175/8, datë 22.05.2023 në përgjigje të Akt Konstatimit nr. 1, datë 08.05.2023, për të cilin është reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

Titulli i gjetjes nr. 4	Mungesë e pasqyrimit të tokave bujqësore në pasqyrat financiare dhe regjistrin e aktiveve.
Situata	Nga të dhënat e marra prej Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave konstatohet se MBZHR në zbatim të legjislacionit në fuqi, administron tokat bujqësore ku nëpërmjet qiradhënies së tyre sigurohen të ardhura dytësore të derdhshme totalisht në buxhetin e shtetit. Nga kryqëzimi i të dhënave të mësipërme me regjistrin e aktiveve, si dhe librat e kontabilitetit konstatohet se edhe për vitet 2021, 2022 këto toka bujqësore që MBZHR administron, në sipërfaqe totale 19,033.95 ha, ashtu si në auditimin e mëparshëm, nuk janë të regjistruara në pasqyrat financiare duke cenuar transparencën dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave pasurore në administrim të MBZHR, si dhe në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.
Kriteri	Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Pjesa II, Pika 5 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Neni 26 dhe Neni 31.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrim i pasaktë i gjendjes pasurore në administrim të MBZHR
Shkaku	Mos regjistrim i tokave bujqësore në kadastër
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR të marrë masat në regjistrimin e menjëhershëm të tokave

bujqësore në Agjencinë e Kadastrës dhe më tej në pasqyrat financiare dhe regjistrin e aktiveve për të pasqyruar sa më saktë gjendjen e saj pasurore në administrim.

Gjatë auditimit u konstatua se me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR z. E.H. me nr. 510, prot 7026/1 datë 14.10.2021 “Për kryerjen e inventarit të përgjithshëm” është ngritur grupi i punës i përbërë nga 1 kryetar dhe 5 anëtarë për kryerjen e inventarizimit për vitin 2021 të aparatit të MBZHR me afat të kryerjes së këtij procesi prej datës 25.10.2021 deri më 25.11.2021. Inventarizimi sipas këtij urdhri do të kryhet për llogaritë ekonomike 07 “Inventari imët”, 212 “Ndërtesa”, 213 “Makineri, pajisje nga MADA”, 214 “ Investime teknike, kaldaja”, 215 “Makinat”, 218 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara”, 311 “Materiale konsumi”. *Inventarizimi i aktiveve nuk ka pasur si objektiv verifikimin fizik të aktiveve jo materiale si dhe aktiveve nën administrim të MBZHR, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 74 “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”, si dhe Pika 31/d “Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, me të dhënat si vijon: d. Për objektet e dhëna me qira – Sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik”. Një regjistër i kontratave të qirasë së lidhura nga MBZHR në lidhje me tokat bujqësore mbahet nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, regjistër i cili nuk është pjesë e regjistrit të aktiveve të MBZHR. Në vijim në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR nuk janë të regjistruara 54 kontrata qiraje për përdorimin e tokave bujqësore.*

Nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të Kontratave na u vu në dispozicion data baza e kontratave të lidhura nga MBZHR me subjekte fizike dhe juridike. Prej kësaj data baze konstatohet se MBZHR ka lidhur 54 kontrata, nga të cilat deri më datë 31.12.2022 ka ende të lidhura 44 prej tyre, ndërkohë që 4 kontrata janë zgjidhur dhe 6 prej tyre janë në proces gjyqësor. Sipas këtyre kontratave subjektet palë kanë detyrimin për likuidimin e qirasë të përdorimit të tokës bujqësore si dhe detyrimin për kryerjen e një plani investimi, të ndarë në vite, investim i cili në përfundim të kontratës i kalon shtetit. Për vonesë në pagim të qirasë si dhe mosrealizim të planit të investimit subjektet sipas kontratave mund të jenë subjekt i penaliteteve si dhe gjobave.

Konstatim nr. 9:

Gjatë auditimit konstatohet se nga 45 kontrata që janë aktualisht të lidhura dhe në zbatim, 34 prej tyre ose 77% kanë detyrime në pagimin e qirasë, i cili mbartur prej datës 31.12.2020 rezulton me një shumë totale prej 35,377,211 lekësh, nga të cilat 4,808,014 janë detyrim për mungesë pagese qiraje dhe 30,569,197 janë detyrim për penalitete të vonesës në pagim. Ndërsa për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 konstatohet se shuma e detyrimit është 27,374,429 lekë, ku detyrimi për pagimin e qirasë rezulton 5,959,944 lekë dhe penalteti për pagim me vonesë 22,609,030 lekë.

Për mungesë të realizimit të planit të investimit MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur gjoba në shumën 392,490,703 lekë. Këto gjoba janë vendosur gjatë auditimit në terren përgjatë konstatimit të grupit të auditimit. Nga 45 kontratat ende në zbatim konstatohet se 77% e detyrimit për mosrealizim të investimit i korrespondon 3 (tre) shoqërive, “B. A.I.ShPK” me 72% të detyrimit kundrejt detyrimit total, “F. A.” shpk me 7% të detyrimit dhe shoqëria “P. I.” shpk me 5% të detyrimit kundrejt detyrimit total që subjektet që përdorin tokat bujqësore kanë ndaj MBZHR. Nga 45 kontratat në zbatim, MBZHR nuk ka llogaritur ende gjobat e mosrealizimit të investimit për 5 (pesë) shoqëritë: “B. N. F. shpk”, “R.S. shpk”, “S.G.ShPK”, “A. F.” dhe “G. G. ShPK”.

Nga shumat e mësipërme për mospagim qiraje dhe penaltitet për vonesën në pagim në shumën totale 53,205,662 lekë më datë 31.12.2022, për gjoba të mosrealizimit të investimit në shumën totale 392,490,703 lekë, si dhe për 4 kontratat e zgjidhura ku 3 prej subjekteve palë janë debitorë në shumën totale 27,084,470 lekë, konstatohet se vlera totale **472,780,835** lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të kontratave të tokave bujqësore në përdorim, të cilat nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të aparatit të MBZHR, Llogaria 411 “Klientë e llogari të ndryshme” dhe llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” rezultojnë në vlerën 0 lekë për vitin 2022, dhe krahasuar me vitin paraardhës nuk kanë pësuar ndryshime. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8/ 2018, Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 7/c “Për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: *Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16/e administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë* si më poshtë: “Për konstatimin paraprak të të drejtave për tu arkëtuar debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/ 468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje – të ardhura për tu marrë” në analiza shtatë shifrorë sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar”.

Megjithëse kundrejt MBZHR rezultojnë subjekte debitorë me detyrimin për të likuiduar qiranë sipas kontratave të lidhura nga MBZHR në shumën **472,780,835** lekë deri në fund të vitit 2022, këto nuk janë pasqyruar në llogarinë 411/ 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke denaturuar pasqyrat financiare me këtë shumë. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8/ 2018, Pika 32. “Kërkesat për arkëtim mbi debitorët, si dhe detyrimet të paraqiten në pasqyrat financiare me vlerën e evidentuar në kohën e lindjes së të drejtës dhe detyrimit. Në zbatim të nenit 61 të ligjit të buxhetit, lidhur më njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet, në fund të periudhës raportuese duhet të paraqiten në kontabilitet, si më poshtë: - Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i prishëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Në lidhje me këtë konstatim nga MBZHR është dërguar observacioni me nr. 211/19, datë 15.05.2023 protokolluar në KLSH me nr. 1175/8, datë 22.05.2023 në përgjigje të Akt Konstatimit nr. 1, datë 08.05.2023, për të cilin është reflektuar dhe jemi shprehur në projekt raport. Në fazën e RPA nga subjekti nuk është paraqitur observacion.

Titulli i gjetjes nr. 5	Pasqyrim i debitorëve në pasqyrat financiare
Situata	<p>Gjatë auditimit konstatohet se nga 51 kontrata që janë aktualisht të lidhura, 38 prej tyre ose 75% kanë detyrime në pagimin e qirasë në shumën totale 64,679,949 lekë, detyrim i cili për datën 31.12.2020 rezulton me një shumë totale prej 68,903,834 lekësh, ndërsa për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 paraqitet në shumën 29,043,882 lekë (në vitet në auditim janë bërë likuidime të detyrimeve të mbartura të qirasë).</p> <p>Për mungesë të realizimit të planit të investimit MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur gjoba në shumën 427,044,994 lekë, të vendosura kryesisht gjatë auditimit në terren. Nga 51 kontratat ende në zbatim konstatohet se 83% e detyrimit për mosrealizim të investimit i korrespondon 3 (tre) shoqërive, “B.A.I.shpk” me 66% të detyrimit kundrejt detyrimit total, “P.I.” shpk me 11% të detyrimit dhe shoqëria</p>

	<p>“F.A.” shpk me 6% të detyrimit kundrejt detyrimit total që subjektet të cilët përdorin tokat bujqësore kanë ndaj MBZHR.</p> <p>Nga shumat e mësipërme për mospagim qiraje dhe penalitet për vonesën në pagim në shumën totale 64,679,949 lekë më datë 31.12.2022, për gjoba të mosrealizimit të investimit në shumën totale 427,044,994 lekë, konstatohet se vlera totale 491,724,943 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të kontratave të tokave bujqësore në përdorim, të cilat nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të aparatit të MBZHR, Llogaria 411 “Klientë e llogari të ndryshme” dhe llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” rezultojnë në vlerën 0 lekë për vitin 2022, dhe krahasuar me vitin paraardhës nuk kanë pësuar ndryshime. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8/ 2018, Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 7/c “Për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16/e administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë: “Për konstatimin paraprak të të drejtave për tu arkëtuar debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/ 468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje – të ardhura për tu marrë” në analiza shtatë shifrore sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar”.</p> <p>Megjithëse kundrejt MBZHR rezultojnë subjekte debitore me detyrimin për të likuiduar qiranë sipas kontratave të lidhura nga MBZHR në shumën 491,724,943 lekë deri në fund të vitit 2022, këto nuk janë pasqyruar në llogarinë 411/ 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke denatyruar pasqyrat financiare me këtë shumë.</p>
Kriteri	Udhëzimit nr. 8/ 2018, Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 7/c.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrim i denatyruar i pasqyrave financiare
Shkaku	Mos pasqyrim i debitorëve të tokave bujqësore
Rëndësia	E Lartë
Rekomandimi	MBZHR të marrë masat e menjëhershme në raportimin e duhur financiar të listës së debitorëve në lidhje me tokat bujqësore, duke bërë regjistrimin në pasqyrat financiare si dhe regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.

Për vitin 2021

Me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR z. E. H. me nr. 510, prot 7026/1 datë 14.10.2021 “Për kryerjen e inventarit të përgjithshëm” është ngritur grupi i punës i përbërë nga 1 kryetar dhe 5 anëtarë për kryerjen e inventarizimit për vitin 2021 të aparatit të MBZHR me afat të kryerjes së këtij procesi prej datës 25.10.2021 deri më 25.11.2021. Inventarizimi sipas këtij urdhri do të kryhet për llogaritë ekonomike 07 “Inventari imët”, 212 “Ndërtesa”, 213 “Makineri, pajisje nga M.”, 214 “Investime teknike, kaldaja”, 215 “Makinat”, 218 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara”, 311 “Materiale konsumi”. *Inventarizimi i aktiveve nuk ka pasur si objektiv verifikimin fizik të aktiveve jo materiale si dhe aktiveve nën administrim të MBZHR, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 74 “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një here në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”, si dhe Pika 31/d “Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, me të dhënat si*

vijon: d. Për objektet e dhëna me qira – Sipërfaqja e objektit në m2, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik”. Një regjistër i kontratave të qirasë së lidhura nga MBZHR në lidhje me tokat bujqësore mbahet nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, regjistër i cili nuk është pjesë e regjistrit të aktiveve të MBZHR, tokat bujqësore në përbërje të të cilit, si dhe kontratat e qirasë nuk kanë qenë objekt i procesit të inventarizimit për vitin 2021.

Me shkresën nr. 7026/2 datë 01.12.2021 komisioni i inventarizimit i ka dërguar Nëpunësit Autorizues të MBZHR, dhe vënë në dijeni Drejtorinë e buxhetimit dhe menaxhimit financiar “Mbi rezultatet e inventarizimit të aseteve për vitin 2021 për Aparatin e MBZHR”, nga ku bashkëlidhur ndodhet procesverbali i inventarizimit, firmosur nga anëtarët e komisionit mbi problematikat e inventarizimit, nga ku gjendja e magazinës rezultoi pa mungesa. Sipas këtij relacioni nuk konstatohet kryerja e procesit të inventarizimit për Klasën 3 “Inventari i imët”.

Megjithëse komisionit të inventarizimit arriti në përfundimin se nuk rezultuan mungesa fizike të aktiveve të MBZHR për vitin 2021, në përmbajtje të rezultateve të inventarizimit është konstatuar se ka diferenca midis regjistrimit në kontabilitet dhe gjendjes faktike midis llogarive si më poshtë:

1. Përgjatë vitit 2021 janë bërë blerje me pagesë dy sisteme elektronike sistemi VMS dhe sistemi i naftës për fermerët që sipas komisionit të inventarizimit janë instaluar tek AKSHI dhe do të kalojnë me transferim kapital. Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare për vitin 2021, konstatohet se nuk është bërë dalje pa pagesë e këtyre sistemeve.

2. Gjatë verifikimit fizik të automjeteve është konstatuar se nga 17 automjete në regjistrin e aktiveve, 3 prej tyre megjithëse janë ende të regjistruar në kontabilitetin e MBZHR, nuk janë në përdorim nga aparati. Automjeti Nissan Terrano (Blu) TR ...F është në përdorim nga AKU Elbasan; Mitsubishi Pajero TR ...F është në përdorim nga AKDC dhe Nissan AA LD është në përdorim nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë prej vitit 2021. Gjatë auditimit konstatohet se përfundimet e procesit të inventarizimit për vitin 2021 i janë vënë në dispozicion sektorit të financës.

Gjatë auditimit në lidhje me sa më sipër u konstatua se me urdhrin e ministrit me nr. 74, datë 28.01.2019 “Për transferim kapital automjeti” janë transferuar pa pagesë 3 (tre) automjete të cilat janë bërë hyrje në MBZHR me fletë hyrje nr. 03, datë 29.01.2019. Me urdhrin e ministrit me nr. 599, datë 05.11.2019 “Për transferim kapital automjetesh” është bërë hyrje në MBZHR një automjet nga AKU dhe dalje për në AKU i një automjeti tjetër, si dhe me urdhrin e ministrit me nr. 184, datë 07.05.2020 “Për transferim kapital mjete transporti “është bërë përsëri një shkëmbim tjetër automjetesh me AKU si transferim kapital.

- Automjeti Nissan Terrano (Blu) TR ...F konstatohet se është bërë dalje që prej vitit 2011 për në AKU (Drejtorinë Rajonale Shkodër) në bazë të urdhrin të Ministrit me nr. 195/ prot 2580, datë 07.06.2011 “Për mbajtje në ruajtje të disa auto veturave të përdorura” dhe është ende në regjistrin e aktiveve të MBZHR. Automjeti është marrë në dorëzim nga AKU, Drejtoria Rajonale Shkodër më datë 01.07.2011 dhe është ridërguar në Drejtorinë e përgjithshme të AKU më 07.11.2013 në bazë të urdhrin të drejtorit të përgjithshëm të AKU me nr. 806, datë 07.11.2013 “Për transferimin dhe mbajtjen në ruajtje të automjeteve të përdorura AKU-së”

- Gjatë auditimit u konstatua se automjeti Nissan Pathfinder me targë AA LD (nr. shasie VSKJVËR51U0497282) është bërë dalje prej magazinës së MBZHR me fletë dalje nr. 193/2, datë 12.04.2021 për në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve me vlerë 4,620,200 dhe amortizim në dalje me vlerë 2,334,560 lekë. Kjo fletë dalje është bazuar në Urdhrin e Ministrit Znj. M. K.... me nr. 157, datë 09.04.2021 “Për dhënie në përdorim auto vetura”. Në AKVMB është bërë hyrje në regjistrin e magazinës me nr. 1, datë 12.04.2021. Konstatohet se për automjetin Nissan me targë AALD është kryer mirëmbajtje dhe likuiduar urdhër shpenzimi nr. 666, datë 29.12.2021 në shumën 371,400 lekë, për të cilin procedura e prokurimit ka nisur në vitin 2020, përpara dhënies në përdorim.

- Automjeti Mitsubishi Pajero TR ...F (nr. shasie JMBONK9403J001855) në përdorim nga Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve Tiranë (AKDC) është bërë dalje prej magazinës së MBZHR me fletëdaljen nr. 4, datë 31.03.2016 në bazë të Urdhrit të Ministrit Z. E.P.me nr. 190, datë 29.03.2016 “Për dhënie në përdorim auto veturë”.

3. Konstatohet se është bërë shtesë pa pagesë nga Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës e VMS së vjetër, e cila nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare për vitin 2021, por është bërë sistemimi në vitin 2022.

Sipas relacionit të këtij komisioni në pikën nr. 9 të tij, komisioni i inventarizimit ka hartuar regjistrin e aktiveve të aparatit të përditësuar me hyrje daljet e vitit 2021 si dhe është llogaritur amortizimi vjetor. Veprimi i mësipërm nuk është detyrë e komisionit të inventarizimit, pasi ky komision e nis procesin e verifikimit mbi regjistrin e aktive të vënë në dispozicion nga sektori i financës në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 27 “Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit”.

Në relacionin e komisionit të inventarizimit nuk propozohet një listë tabelore e mallrave të identifikuar për vlerësim në numër dhe sasi, por propozohet mbi nxjerrjen nga përdorimi të disa materialeve që i përkasin llogarisë 311, llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje”.

Në magazinat e MBZHR aktualisht ndodhen aktive për nxjerrje jashtë përdorimit mbartur prej vitit 2020 me vlerë fillestare 30,848,418 lekë dhe vlerë të mbetur 15,632,932 lekë për të cilat ende nuk janë zhvilluar procedurat e asgjësimit.

Për vitin 2022

Me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR z. O. M. me nr. 525, datë 17.11.2022 “Për kryerjen e inventarit të përgjithshëm” është ngritur grupi i punës i përbërë nga 1 kryetar dhe 4 anëtarë për kryerjen e inventarizimit për vitin 2022 të aparatit të MBZHR me afat të kryerjes së këtij procesi prej datës 25.11.2021 deri më 25.12.2021. Inventarizimi sipas këtij urdhri do të kryhet për llogaritë ekonomike 07 “Inventari imët”, 212 “Ndërtesa”, 213 “Makineri, pajisje nga M.”, 214 “Investime teknike, kaldaja”, 215 “Makinat”, 218 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara”, 311 “Materiale konsumi”. Edhe për vitin 2022 *Inventarizimi i aktiveve nuk ka pasur si objektiv verifikimin fizik të aktiveve jo materiale si dhe aktiveve nën administrim të MBZHR*, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 74, si dhe Pika 31/d.

Me shkresën nr. 5913/1 datë 26.12.2021 komisioni i inventarizimit i ka dërguar Nëpunësit Autorizues të MBZHR, dhe vënë në dijeni Drejtorinë e buxhetimit dhe menaxhimit financiar “Mbi rezultatet e inventarizimit të asetëve për vitin 2022 për Aparatin e MBZHR”, nga ku bashkëlidhur ndodhet procesverbali i inventarizimit, firmosur nga anëtarët e komisionit mbi problematikat e inventarizimit, nga ku gjendja e magazinës rezultoi pa mungesa.

Në relacionin e komisionit të inventarizimit nuk propozohet një listë tabelore e mallrave të identifikuar për vlerësim në numër dhe sasi.

Në magazinat e MBZHR aktualisht ndodhen aktive për nxjerrje jashtë përdorimit mbartur prej vitit 2020 me vlerë fillestare 30,848,418 lekë dhe vlerë të mbetur 15,632,932 lekë për të cilat ende nuk janë zhvilluar procedurat e asgjësimit.

2.6. Auditimi i procedurave të prokurimit publik.

2.6.1 Auditimi i procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në shqyrtimin e dokumentacionit si më poshtë:

-Dosjet e prokurimit për periudhën 2019-2022

-Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE) në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit publik

-Praktikat e likuidimit të kryera nga Sektori i Financës.

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për prokurimin publik” dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime etj.)

-Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (VKM, udhëzime etj.)

MBZHR për vitet 2019-2022, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik ka ngritur Komisionin e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël si dhe Komisionin e sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar, me urdhrat respektivë të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK) bazuar në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, Ligjin Nr.162/2020 i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 neni 68, dhe Udhëzimin Nr.3, datë 18.06.2021.

Sipas viteve objekt auditimi, realizimi i procedurave të prokurimit “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” paraqitet në vijim:

Për **vitin 2019**, janë realizuar 55 procedura prokurimi “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” me vlerë totale të kontratave të realizuara **15,330,121** lekë me TVSH dhe fond limit 17,735,274 lekë pa TVSH.

Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen në Tabelën Nr.6.1, tek seksioni ”Anekse” .

Në procedurat e prokurimit “*blerje me vlerë të vogël*” me të dhënat në Tabelën Nr.6.2, tek seksioni “Anekse”, të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*), nuk u konstatua asgjë nga auditimi për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

Titulli i gjetjes	Dosjet e prokurimeve të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara për vitin 2019.
Situata	Nga auditimi i procedurave të prokurimit “ <i>blerje me vlerë të vogël</i> ” dhe “ <i>sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar</i> ” rezultoi se dosjet për vitin 2019, ishin të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara duke sjellë si pasojë pa rregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit.
Kriteri	Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar
Ndikimi/Efekti	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit.
Shkaku	Mos inventarizimi dhe mos arkivimi i dosjeve
Rëndësia	I ulët
Rekomandimi	1.Të merren masa nga njësia përgjegjëse për prokurimin në MBZHR për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit për vitin 2019 me qëllim sistemin arkivor të dokumentacionit.
Afati zbatimit:	Deri në 31.09.2023

Procedurat e prokurimit “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*) me të dhënat si më poshtë u konstatua në dosjet e audituara:

Titulli i gjetjes	-Realizimi i procedurave kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit.
Situata	-Në të gjitha rastet e audituara, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit, pasi praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë. -Në shumicën e rasteve të audituara, vihet re tërheqja e operatorëve

	ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ <i>ka ndryshuar çmimi</i> ” me të cilin kanë ofertuar, si pasojë kontrata lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë.
Kriteri	Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ” i ndryshuar neni 8, pika 1., Ligji Nr. 162/2020 “ <i>Për prokurimin publik</i> ” i ndryshuar nenin 4, pika 5.
Ndikimi/Efekti	-Blerje biletave të transportit ajror me kosto të lartë.
Shkaku	-Vonesa në fillimin e procedurës -Tërheqja e OE klasifikuar në vend të parë në momentin e lidhjes së kontratës.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	1. Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR në bashkëpunim me Drejtorinë e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në eventet jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin dhe konfirmimit nga Kryeministri për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në kryerjen e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.
Afati zbatimit:	<i>Deri në 31.09.2023</i>

“Blerje bileta avioni Tiranë- Boston (SHBA)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi Nr.239, datë 4.4.2019 data e tenderit 04.04.2019, fond limit 793,667 lekë pa TVSH, fituese oferta "O.E.", me vlerë 780,000 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të lartë*), pasi OE “A. T. and T.” i kualifikuar në vend të parë (*oferta 470,250 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 2 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel (Belgjike)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi, Nr.116, datë 8.2.2019 data e tenderit 08.02.2019, fond limit 546,539 lekë pa TVSH, fituese oferta "O.E.", me vlerë 417,000 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Për vitin 2020, janë realizuar 26 procedura prokurimi “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” me vlerë totale të kontratave të realizuara **7,924,458** lekë me TVSH dhe fond limit 9,008,527 lekë pa TVSH. Procedurat sipas llojit dhe realizimit jepen në Tabelën 6.3, tek seksioni “Aneksë”.

Në procedurat e prokurimit “*blerje me vlerë të vogël*” me të dhënat në Tabelën Nr.6.4, tek seksioni “Aneksë”, nuk u konstatua nga auditimi ndonjë gjë për t’u shënuar në zhvillimin e procedurës, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik përveç mos inventarizimit dhe mos arkivimit të dosjeve, jo në përputhje me Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar. Gjithashtu vihet re tërheqje e OE fitues në fazën e lidhjes së kontratës me pretendimin se “*është përlllogaritur gabim fondi limit*” me të cilin kanë ofertuar, e cila ka sjellë si pasojë kontrata të lidhet me OE të renditur më pas me vlerë më të lartë.

Në procedurat e prokurimit për vitin 2020 “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*) me të dhënat si më poshtë u konstatua:

Titulli i gjetjes	-Realizimi i procedurave kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit.
Situata	-Në të gjitha rastet e audituara, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit, pasi praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të

	lartë. -Në shumicën e rasteve të audituara, vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ <i>ka ndryshuar çmimi</i> ” me të cilin kanë ofertuar, si pasojë kontrata lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë. -Në shumicën e rasteve në Ftesën për ofertë, nuk vendoset si kriter paraqitja e certifikatës së akreditimit ose vërtetimi nga IATA, jo në përputhje me Udhëzimin APP Nr.4, datë 9.01.2018 “ <i>Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike</i> ” i ndryshuar, pika 6, duke ndjekur standard të dyfishtë në vendosjen e kriterëve nga AK/MBZHR.
Kriteri	Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ” i ndryshuar neni 8, pika 1.
Ndikimi/Efekti	-Blerje biletave të transportit ajror me kosto të lartë..
Shkaku	-Vonesa në fillimin e procedurës -Tërheqja e OE klasifikuar në vend të parë në momentin e lidhjes së kontratës.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	1. Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR në bashkëpunim me Drejtorinë e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në eventet jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin dhe konfirmimit nga Kryeministri për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në kryerjen e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.
Afati zbatimit:	<i>Deri në 31.09.2023</i>

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Gjeneve (Zvicër)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi, Nr.37, datë 23.01.2020 data e tenderit 23.01.2020, fond limit 46,833 lekë pa TVSH, fituese oferta "Sh. P.", me vlerë 40,790 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të lartë*), pasi OE “A. T. and T.” i kualifikuar në vend të parë (*oferta 39,000 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës. Ftesa për ofertë datë 23.01.2020 ka gabime në përcaktimin e itinerarit. Në seksionin B. “Specifikimet teknike”, pika 3, përcaktohet “*Kthimi Berlin datë 05.02.2020*” ndërkohë që, në përshkrimin e ofertës së publikuar kthimi është datë 05.02.2020, pra nuk kemi transit pasi bileta avionit është Tiranë-Gjenevë, kompetence e Komisionit (*E.M., E. M. dhe M. Q.*).

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Paris (France)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi, Nr.67, datë 11.02.2020 data e tenderit 11.02.2020, fond limit 82,630 lekë pa TVSH, fituese oferta "Sh.P.", me vlerë 79,490 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë të lartë*), pasi OE “O. T. & T.” i kualifikuar në vend të parë (*oferta 71,7000 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 7 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Budapest (Hungari)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi, Nr.119, datë 04.03.2020 data e tenderit 04.03.2020, fond limit 134,802 lekë pa TVSH, fituese oferta "O. E.", me vlerë 63,000 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE klasifikuar i dyti me ofertë më të lartë*), pasi OE “A.& L. T.-B. T. O.” i kualifikuar në vend të parë (*oferta 55,350 lekë*) është tërhequr nga lidhja e kontratës me pretendimin “*ka ndryshuar gjendja e vendeve*”, pjesëmarrës në tender 9 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Për vitin 2021, bazuar në të dhënat e regjistrit, janë realizuar 17 procedura prokurimi “*blerje me vlerë të vogël*” dhe “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror*”

ndërkombëtar” me vlerë totale të kontratave të realizuara 6,569,114 lekë me TVSH dhe fond limit 7,092,254 lekë pa TVSH. Procedurat sipas llojit paraqiten në Tabelën Nr.6.5, tek seksioni “Aneksë”.

Në procedurat e prokurimit “*blerje me vlerë të vogël*” të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*) me të dhënat në Tabelën Nr.6.6, tek seksioni “Aneksë”, nuk u konstatua nga auditimi ndonjë gjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik, përveç mos inventarizimit dhe mos arkivimit të dosjeve, jo në përputhje me Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar:

Në procedurat e prokurimit “*sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar*” të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*), u konstatua në të gjithë procedurat e audituara:

Titulli i gjetjes	-Realizimi i procedurave kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit.
Situata	-Në të gjitha rastet e audituara më poshtë, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit, pasi praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë nga Drejtoria e Kabinetit, jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. -Praktika për miratimin nga Kryeministri i pjesëmarrjes së ministrit në evente nuk i bashkëngjitet dokumentacionit për fillimin e procedurës së prokurimit, në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe i auditueshëm nga subjektet e njohura me ligj. Një veprim i tillë është përgjegjshmëri menaxheriale e dobët e kësaj strukture/Drejtorisë së Kabinetit, në menaxhimin e procesit të miratimit për pjesëmarrje në evente, në mënyrë që procedurat e prokurimit për sistemin dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror të mos fillojnë me vonesë (<i>kryesisht një ditë para udhëtimit</i>), veprim jo në përputhje me Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1, si dhe Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 4, pika 5.Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë. -Në shumicën e rasteve, vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ <i>ka ndryshuar çmimi</i> ” me të cilin kanë ofertuar e cila ka sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë.
Kriteri	Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1. Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 4, pika 5.
Ndikimi/Efekti	-Blerje biletave të transportit ajror me kosto të lartë.
Shkaku	-Vonesa në fillimin e procedurës -Tërheqja e OE klasifikuar në vend të parë në momentin e lidhjes së kontratës.
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	1. Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR në bashkëpunim me Drejtorinë e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në eventet jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin dhe konfirmimit nga Kryeministri për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në kryerjen e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.
Afati zbatimit:	<i>Deri në 31.09.2023</i>

“Blerje e bileta avioni Tiranë-Turqi-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi Nr.573, datë 09.11.2021, data e tenderit 09.11.2021, fitues oferta "A.T.and T.", me vlerë 187,880 lekë pa TVSH (oferta e kualifikuar në vend të tretë) pasi OE "G. T." i kualifikuar në vend të parë (oferta 133,715 lekë) dhe OE L. I. (oferta 186,960 lekë) klasifikuar në vend të dytë, janë tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 6 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

"Blerje bileta avioni Tiranë - Beograd (Serbi)–Podgoricë (Mali i Zi)-Tiranë (Shqipëri).

Urdhër Prokurimi Nr.20, datë 26.01.2022, data e tenderit 26.01.2022, fitues oferta "A.S.", me vlerë 169,400 lekë pa TVSH (oferta e kualifikuar në vend të dytë) pasi OE "A. T.-B.T.O." i kualifikuar në vend të parë (oferta 164,700 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 2 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Nga auditimi:

Me shkresën Nr. 531/1, datë 25.01.2022 të Drejtorit të Kabinetit (E. D.) në MBZHR është bërë kërkesë në Kryeministri për miratimin e pjesëmarrjes së ministrit në panairin ndërkombëtar "A.B. 2022" zhvilluar në Beograd-Serbi datë 27 Janar 2022.

Me shkresën Nr.519/1, datë 27.01.2022 të Kryeministrit (Kabineti) është miratuar kërkesa për pjesëmarrje e ministrit.

Memo nga Drejtori i Kabinetit (Znj. E. D.) ka dalë në datë 26.01.2022 ndërkohë që panairi zhvillohet datë 27 Janar 2022, për pasojë fillimi i procedurës së prokurimit bëhet 1 ditë para datës së udhëtimit, duke kryer blerje të biletës me kosto më të lartë.

Kronologjia e daljes së akteve administrative për fillimin e procedurës së prokurimit:

-Urdhri nga Sekretari i Përgjithshëm për dërgim jashtë shtetit Nr.23, datë 26.01.2022,

-Autorizimi nga Sekretari i Përgjithshëm për shërbim jashtë shtetit Nr. 531/6, datë 26.01.2022.

"Blerje e 3 (tre) biletave të transportit ajror ndërkombëtar (Tirane-Berlin-Tiranë)".

Urdhër Prokurimi Nr.3318/4, datë 21.06.2022, data e tenderit 22.06.2022, fituese oferta "O.E.T &T.LTD", me vlerë 432,500 lekë pa TVSH (lidhur kontrata me OE me ofertë më të lartë) pasi OE "A. T. and T." i kualifikuar në vend të parë (oferta 204,960 lekë) është tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 2 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Nga auditimi:

Me shkresën Nr. 336, datë 17.06.2022 të Drejtorit të Kabinetit (E. D.) është kërkuar nga Kryeministria miratimi i pjesëmarrjes së ministrit në Konferencën e Berlinit, bashkëlidhur ftesa nga organizatorët datë 16 Qershor 2022.

Me shkresën Nr. 3543/1, datë 21.06.2022 të Kryeministrit (Kabineti) është dërguar miratimi nga Kryeministri për pjesëmarrjen e ministrit të MBZHR në konferencën ministeriale që zhvillohet në datë 24 Qershor në Berlin, ka dalë datë 21.06.2022.

Memo nga Drejtori i Kabinetit për pjesëmarrje në event/konferencë ka dalë datë 21.06.2022.

Kronologjia e daljes së akteve administrative për fillimin e procedurës së prokurimit:

-Urdhri nga Sekretari i Përgjithshëm për dërgim jashtë shtetit Nr.289 datë 23.06.2022,

-Autorizimi nga Sekretari i Përgjithshëm për shërbim jashtë shtetit Nr.3318/6, datë 21.06.2022.

"Blerje 5 (pesë) bileta udhëtimi me avion ardhje, Beograd, Serbi – Tiranë".

Urdhër Prokurimi nr.4446, datë 30.08.2022, data e tenderit 30.08.2022, fituese oferta "A.S.", me vlerë 70,400 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

"Blerje 5 (pesë) bileta udhëtimi me avion vajtje - ardhje, Tiranë - Torino, Torino – Tiranë". Urdhër Prokurimi Nr.4842, datë 20.09.2022, data e tenderit 20.09.2022, fituese oferta "A. T. and T.", me vlerë 299,900 lekë pa TVSH, pjesëmarrës në tender 2 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Nga auditimi:

Me shkresën Nr.4342/1, datë 15.09.2022 të Drejtorisë së Kabinetit në MBZHR është përcjellë kërkesa për miratimin e pjesëmarrjes së ministrit në panairin që e zhvilluar në Torino-Itali në datat 22-26 Shtator 2022, bashkëlidhur ftesa e organizatorit datë 7 Shtator 2022.

“Blerje Bileta avioni me intinerar Tiranë-Paris, Francë- Londër, Angli-Tiranë për 4 (katër) persona”.

Urdhër Prokurimi Nr.86, datë 25.02.2022, data e tenderit 25.02.2022, fituese oferta “A. T.and T.”, me vlerë 192,000 lekë pa TVSH më të ulët, pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Nga auditimi:

Me shkresën Nr. 792/2, datë 18.03.2022 është përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MPEPJ) letra e ministrit datë 25.02.2022 francez të bujqësisë për ministrin e MBZHR për pjesëmarrje panairin e bujqësisë zhvilluar në Paris nga data 01-02.03.2022.

Me shkresën Nr. 1287, datë 24.02.2022 të Drejtorisë së Kabinetit në MBZHR është dërguar në Kryeministri kërkesa për miratimin e ministrit si pjesëmarrës në këtë event e cila është miratuar dhe dërguar në MBZHR me shkresën Nr.1213/1, datë 25.02.2022.

“Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi me avion vajtje - ardhje, Tiranë - Tel Aviv - Eilat, Eilat-Tel Aviv- Tiranë”.

Urdhër Prokurimi Nr.5217, datë 13.10.2022, data e tenderit 13.10.2022, fituese oferta "O. T. &T.", me vlerë 378,600 lekë pa TVSH, pasi OE “A. T.and T.”, me vlerë 363,000 lekë është tërhequr nga lidhja e kontratës, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të lartë) pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

“Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi me avion, vajtje - ardhje, Tiranë – Kansas, USA –Tiranë”.

Urdhër Prokurimi Nr.2920/4, datë 04.08.2022, data e tenderit 05.08.2022, fituese oferta "K. T.", me vlerë 378,600 lekë pa TVSH, pasi OE “A.T. and T.”, me vlerë 335,280 lekë është tërhequr nga lidhja e kontratës, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të lartë) pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës.

Nga auditimi:

Memo nga Drejtori i Kabinetit datë 25.07.2022, Urdhri dhe Autorizimi për dërgim jashtë të ish Sekretarit të Përgjithshëm datë 25.07.2022, ndërkohë që Urdhër Prokurimi ka dalë datë 04.08.2022 për udhëtimin që do kryhet në Kansas, USA datë 09.09.2022.

Titulli i gjetjes	-Vonesa në realizimin e procedurës së prokurimit
Situata	<p>–Vonesë në realizimin e procedurës së prokurimit, nga dalja e akteve administrative të sipërme për miratimin e pjesëmarrësve në event deri në daljen e urdhër prokurimit. Kjo sjell si pasojë blerje të biletave me kosto më të lartë e cila është përgjegjshmërisë menaxheriale e dobët sipas Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 4, pika 9, ku citohet se “përgjegjshmëria menaxheriale është detyrimi i menaxherëve të njëjësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera”, kompetencë e strukturave drejtuese të MBZHR-së.</p> <p>–Tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se “ka ndryshuar çmimi” me të cilin ka ofertuar. Kjo ka sjellë si pasojë që, kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë.</p>

Kriteri	Ligji Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1 dhe neni 4, pika 9.
Ndikimi/Efekti	Blerje e biletave me kosto më të lartë
Shkaku	Nxjerrja me vonesë e akteve administrative për pjesëmarrje në eventet e stafit shoqërues të ministrit.
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	1. Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR në bashkëpunim me Drejtorinë e Kabinetit të ministrit, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e stafit shoqërues të ministrit në eventet jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët për eventin dhe konfirmimit nga Kryeministri për pjesëmarrje të ministrit në event, me qëllim minimizimin e vonesave në kryerjen e procedurës së prokurimit dhe blerjes së biletave me kosto të lartë.
Afati zbatimit:	<i>Rast pas rasti</i>

Në lidhje me sa sipër nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit me emailin e datës 26.07.2023, ardhur në KLSH, citohet se:

Pretendimi i subjektit: “*Së pari, në shumicën e rasteve të audituara vihet re tërheqja e operatorëve ekonomikë fitues në fazën e lidhjes së kontratës.*”

Së dyti, në lidhje me konstatimin “*...mosarkivim i dosjeve në përputhje me ligjin “Për Arkivat”, sqarojmë se të gjitha aktet e protokolluara kanë kopjen e tyre në zyrën e protokollit sipas ligjit “Për Arkivat”.*”

Së treti, në lidhje me konstatimin “*...Në shumicën e rasteve në ftesën për ofertë, nuk vendoset si kriter paraqitja e certifikatës së akreditimit ose vërtetim nga IATA, ...*”, sqarojmë se në udhëzimin nr. 4, të APP-së është përcaktuar shprehimisht se: “*në raste specifike komisioni i sistemit dinamik vendos si kriter në ftesën për ofertë dokumentacionin përkatës provues si psh: certifikata akreditimi ose vërtetim nga IATA.*”

Së katërti, në lidhje me konstatimin për procedurën “*Blerja bileta avioni Tiranë - Gjenevë (Zvicër) –Tiranë*”, konkretisht: “*..Ftesa për ofertë, datë 23.01.2020, ka gabime në përcaktimin e intinerarit..., vlerësojmë konstatimin nga ana juaj të gabimit material që ka ndodhur gjatë përgatitjes së ftesës për ofertë. Sqarojmë se kjo gjë nuk ka sjellë pasojë në blerjen e biletës sipas nevojës së autoritetit kontraktor...”.*”

Qëndrimi i audituesve shtetërorë:

Në lidhje me pretendimet e subjektit i cili nuk sjell asnjë argument të ri ligjor për sa trajtuar dhe më parë në observacionet ndaj aktkonstatimit përkatës sqarojmë dhe njëherë:

Pretendimi 1. Në lidhje me pretendimin nr.1, observacioni juaj pranohet dhe është reflektuar në RPA.

Pretendimi 2. Në lidhje me pretendimin 2 sqarojmë se në përputhje me LPP kërkohet arkivimi i plotë i dosjes së prokurimit me inventarin shoqërues dhe jo arkivim i akteve të veçanta të procedurës së prokurimit, e cila është përgjegjësi e Njësisë së Prokurimit.

Pretendimi 3. Në lidhje me këtë pretendim sqarohet dhe njëherë se kjo mangësi i përket procedurave të zhvilluara për vitin 2020, ku mungesa e këtij kriteri është jo në përputhje me Udhëzimin APP Nr.4, datë 9.01.2018, pasi AK ndjek dy standarde në vendosjen e tij ku në ca raste e kërkon dhe në të tjera jo.

Pretendimi 4. Konstatimi i KLSH i pranuar dhe nga subjekti vë në dukje gabimet materiale dhe pse ato nuk janë të përsëritura dhe nuk sjellin pasoja, është detyrim i KLSH të konstatojë. Për rrjedhojë për sa sipër, observacioni **merret pjesërisht në konsideratë.**

Konkluzion:

☞ Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik “blerje me vlerë të vogël” me përzgjedhje mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) viti 2019-2022, nuk u konstatua ndonjë gjë për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik, përveç mos inventarizimit dhe mos arkivimit të dosjeve, jo në përputhje me Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar. Gjithashtu vihet re tërheqje e OE fitues në fazën e lidhjes së kontratës me pretendimin se “është përlllogaritur gabim fondi limit” me të cilin kanë ofertuar, e për pasojë kontrata lidhet me OE të renditur më pas me vlerë më të lartë,

☞ Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” viti 2019-2022 mbi bazë risku (referuar kontratës së lidhur me vlerë më të lartë) si gjetje e përbashkët u konstatua:

–Në të gjitha rastet e audituara trajtuar sa sipër, procedurat e prokurimit realizohen kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit. Për vitin 2021-2022, praktika e miratimit për pjesëmarrje në evente bëhet me vonesë nga Drejtoria e Kabinetit, jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët si dhe praktika për miratimin nga Kryeministri i pjesëmarrjes së ministrit në evente nuk i bashkëngjitet dokumentacionit për fillimin e procedurës prokurimit, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar nenin 4, pika 5 dhe Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, pika 1.Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, sjell si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë.

Në lidhje me këtë drejtim u shqyrtua dokumentacioni fizik dhe elektronik mbi procedurat e prokurimit të parashikuara dhe realizuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (këtu e më poshtë: MBZHR), për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, (ri auditim) si më poshtë:

- Shkresat dhe Urdhrat e titullarit të AK mbi caktimin e personave përgjegjës për prokurimet;
- Regjistrat e Parashikimit për periudhën objekt auditimi;
- Regjistrat e Realizimit për periudhën objekt auditimi;
- Të dhënat e Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) të APP-së, për MBZHR.

Personi Përgjegjës për Prokurimet

Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP) për vitin 2019, me anë të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm, znj. A. A. nr. 7, nr. 112 prot., datë 07.01.2019, është caktuar z. E. M.

Me urdhër nr 8, të Sekretarit të Përgjithshëm nr.132., prot, datë 07.01.2019, është krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. K., anëtare,
3. Znj. L. I., anëtare.

Me urdhër nr 8/1, të Sekretarit të Përgjithshëm, Enea Hoti, nr.132/1, prot, datë 21.03.2019, është ri krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. K., anëtare,
3. Znj. M. Q., anëtare

Me urdhër nr 389, të Sekretarit të Përgjithshëm nr.132/2, prot, datë 20.06.2019, është krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E. M., kryetar
2. Znj. M. K., anëtare,
3. Znj. L. I., anëtare.

Me urdhër nr 9, të Sekretarit të Përgjithshëm, znj. (A. A.), nr.133, prot, datë 07.01.2019, është krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E. M.,
2. Znj. M. Kita, anëtare,
3. Znj. M.Q., anëtare.

Me urdhër nr 601, të Sekretarit të Përgjithshëm, z. E. H., nr.133/2, prot, datë 06.11.2019, është ri krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E. M., kryetar
2. Znj. M. K., anëtare,
3. Z. E. M., anëtar

Me urdhër nr 624, të Sekretarit të Përgjithshëm, z. E. H., nr.133/3, prot, datë 15.11.2019, është ri krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E. M., kryetar
2. Z. E. M., anëtar
3. Znj. L. I., anëtare.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019 në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë zhvilluar në total 31 procedura prokurimi me vlerë totale 664,559,878 lekë të fondit limit dhe me vlerë kontrate 614,558,206 lekë, nga të cilat:

- 3 procedura të hapura me vlerë fondi limit 612,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 574,390,578 lekë,
- 19 procedura blerje të vogla me vlerë 10,129,340 lekë dhe vlerë kontrate 5.948.024 lekë,
- blerje biletash me vlerë 8,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 7.285.171 lekë,
- kërkesë për propozim 8 procedura me vlerë 34,470,538 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate 25,664,540 lekë.

Në procedurat e prokurimit pa përfshirë ato “*blerje me vlerë të vogël*”, të trajtuara më lart, me të dhënat e paraqitura tek seksioni “Aneksë”, nr. 2.6, bashkëlidhur këtij raporti auditimi, të cilat u përzgjodhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*), nuk u konstatuan shkelje nga auditimi për t’u shënuar, që të përbëjë mos përputhje me kriteret për prokurimin publik.

I. Mbi auditimin e procedurës së hapur me objekt “Organizim aktiviteti me temë “Shqipëria punon tokën” me fond limit në vlerën prej 20,000,000 lekë pa TVSh.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Organizim aktiviteti me temë “Shqipëria punon tokën”		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 512, me shkresë nr. 6889/4 prot datë 16.09.2019, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E. M. 2. O.G. 3. H.Xh. 	<p>3. Urdhër i brendshëm nr.501, me shkresë nr. 6889/1prot datë 10.09.2019 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, afatin e realizimit si dhe llogaritjen e fondit limit” me përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E. M. 2. O. G. 3. H. Xh. 	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 513 me shkresë nr. 6889/5 prot datë 16.09.2019, me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.T.kryetare 2. M.Q. anëtare 3. L. I.anëtare
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur”</p>		

5.Fondi Limit (pa TVSh) 19,695,170 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE“P.” ShPK oferta e paraqitur, me vlerë prej 17,946,669.4 lekë pa TVSh dhe 21,536,003.28 lekë me TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh), prej 1,748,500.6 lekë.
8. Data e hapjes së tenderit Data 23.10.2019, ora 09:00	9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike pjesëmarrës: 1. O.E “F. S.” P.F. me NUIS L.V, me ofertë ekonomike 19,565,890 lekë pa TVSh. (S’ kualifikuar) 2. O.E. “P.” ShPK me NUIS L.....A, me ofertë ekonomike 17,946,669.4 lekë pa TVSh, fitues 3. O.E. “Th. A.” ShPK me NUIS L.....S, me ofertë ekonomike 20,175,100 lekë pa TVSh, (oferta është më e madhe se fondi limit, është s kualifikuar.
11. Ankimime Pranë AK- nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Është lidhur kontrata nr.6889/11prot datë 12.11.2019	15.Zbatimi i Kontratës Monitorimi i kontratës është bërë në bazë të Urdhër nr.617 datë 12.11.2019 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt prokurimi “Organizim aktiviteti me temë “Shqipëria punon tokën”. Në bazë të PV nr.1 datë 13.11.2019, janë marrë në dorëzim mallrat, në mbështetje të Faturës tatimore nga operatori ekonomik “P. “ShPK nr. 61, datë 13.11.2019.	

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Organizim aktiviteti me temë "Shqipëria punon tokën”**.

Numri i referencës së procedurës: **REF-36052-09-16-2019**

Fondi limit: **19,695,170** (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës: **2 ditë.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët.**

-Në bazë të Memos e konceptuar nga znj. L. P. (drejtor kabineti) dhe aprovuar nga Sekretari i përgjithshëm në MBZHR, të datës 10.09.2019 është kërkuar miratimi pranë Ministrin në lidhje me organizimin e aktivitetit Edicioni III i Panairit “Shqipëria Punon Tokën”, i cili ka si qëllim, rritjen e gamës së gjerë të aktiviteteve për fermerët , bizneset, duke përfshirë organizimin dhe instalimin e fermave eksperimentale, kopshteve për fëmijët për mbjellje lulesh, farash dhe fidanësh, krijimin e një auditoriumi me panele informative, work shop, hapësira për biznese e huaja, hapësira për degustimin e produkteve tipike, hapësira rekreacioni, etj., duke i ekspozuar në Sheshin “Skënderbeu” në Tiranë me kohëzgjatje dy-ditore.

-Nga Titullari i AK, është miratuar Urdhër i brendshëm nr. 501, me shkresë nr.6889/1prot datë 10.09.2019 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, afatin e realizimit si dhe llogaritjen e fondit limit”, i cili më datë 13.09.2019 ka mbajtur proces-verbalin, ku janë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës të ndara si vijon (Prodhim, konceptim & design, pajisje, mjete, sisteme dhe staf), për të cilat është kërkuar ofertë në tre operatorë ekonomikë:

-Shoqëria “A. P.” ShPK me ofertë në vlerë 165,811 Euro pa TVSh

-Shoqëria “Th. A.” ShPK me ofertë në vlerë 166,625 Euro pa TVSh

-Shoqëria “O. C.” ShPK me ofertë në vlerë 155,874 Euro pa TVSh,

Mesatarizimi i vlerave duke i konvertuar me kursin e Euros në këtë datë është 19,695,170 lekë pa TVSh.

Gjithashtu, në bazë të Urdhrit të Ministrit të MBZHR nr. 501/1 datë 15.09.2019 me shkresë nr.6889/3 prot datë 15.09.2019 “Për kryerjen e aktivitetit kombëtar “Panairi-Shqipëria punon tokën”, është urdhëruar që kryerjen e shpenzimeve për organizimin e aktivitetit, në vlerën 25,000,000 lekë me TVSh, do të përballohen nga fondet e lira në shpenzimet operative të programit buxhetor 0422 “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”, planifikuar për “Luftimi i sëmundjeve në Bujqësi” në Aparatin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

-Nga titullari AK janë miratuar në bazë të urdhrave:

Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave, ku nga ana e njësisë së prokurimit sipas Proces-verbalit datë 16.09.2019 janë përgatitur dhe miratuar dokumentet e tenderit, si dhe është përcaktuar afati për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje më datë 17.10.2019 ora 9:00.

-Më datë 07.10.2019 në MBZHR, nga Sektori i Koordinimit pranë APP, ka paraqitur pretendimet për modifikimin e kriterëve kualifikuese në DST të vendosura nga Njësia e Prokurimit, si vijon:

Asistenca që APP i jep AK në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konkretisht, procedura me objekt “Për kryerjen e aktivitetit kombëtar “Panairi-Shqipëria punon tokën” me REF-36052-09-16-2019, me fond limit 19,695,170.00 lekë pa TVSh, duke rekomanduar:

a) Duke ju përmbajtur me rigozitet përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik dhe për fusha të tjera ku procedura shtrin ndikimin apo kuptimit të tyre, duhet të saktësojë/riformulojë kriteret në vijim, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues apo që mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO.

-Në pikën 3.2.3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar:

“Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2018 në të gjitha adresat ku OE ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së”.

Në lidhje me këtë kriter, për të pasur një informacion sa më koherent në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore, është sugjeruar që AK duhet të kërkojë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019, duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2019.

-Nisur sa më sipër, nga Titullari i AK është miratuar Urdhër nr. 512/1 datë 07.10.2019 me shkresë nr. 6889/7 prot. “Për pezullimin e procedurës së prokurimit për shqyrtimin e sugjerimeve të APP”, ku nga ana e Njesisë së prokurimit janë marrë në konsideratë, në bazë të procesverbalit datë 08.10.2019, duke i modifikuar si dhe duke e shtyrë datën e hapjes së ofertave më 23.10.2019 si më poshtë:

-Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit (nga data 23.10.2016 deri në ditën e hapjes 23.10.2019) për kontratë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2019 në të gjitha adresat ku OE ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së.

Janë s’ kualifikuar ofertuesit:

1. O.E “F. S.” P.F., për arsyet e mëposhtme:

a. Operatori Ekonomik “F. S.” P.F. nuk ka paraqitur vërtetim të shlyerjes së të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri;

b. Operatori Ekonomik “F. S.” P.F. nuk plotëson kriterin kualifikues për xhiro mesatare vjetore te tre viteve të fundit me vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet. Sipas

dokumentacionit të paraqitur në SPE figuron se O.E. ka realizuar mesatarisht xhiro në vlerën prej 4,734,463 lekë. Referuar DST, O.E. duhet të kishte realizuar xhiro mesatare te tre viteve te fundit ne vlerën prej 7,878,068 lekë;

c. Operatori Ekonomik “F.S.” P.F. nuk ka paraqitur bilancet e tre viteve të fundit (2016-2018);

d. Operatori Ekonomik “F.S.” P.F. nuk ka paraqitur dokumentacion për të faktuar se ka realizuar eksperiencë të ngjashme;

e. Operatori Ekonomik “F. S.” P.F. nuk ka paraqitur staf te punësuar sipas pikës 3.3.2 të Kapacitetit teknik, konkretisht:

i. Koordinator; Vajza/djem hostess; Fotograf; Videograf; Inxhinier IT/ekuivalent; Montator; a. Grafit; Shofer; Mirëmbajtës stalle (zooteknik/ekuivalent); Agronom/ekuivalent; Punonjës të thjeshtë;

f. Operatori Ekonomik “F.S.” P.F. nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se ka në pronësi/qira 4 (katër) kamionçina;

g. Operatori Ekonomik “F. S.” P.F. nuk ka paraqitur autorizim/kontratë furnizimi për zërat si më poshtë:

a. Traktor; Fidan, bime e ritur fidani, humus dhe vegla pune; Sistem fonie, ledëall dhe sistem ndricimi;

2. O.E. “Th. A.” ShPK, për arsyet e mëposhtme:

a. Operatori Ekonomik “Th. A.” ShPK ka paraqitur ofertën ekonomike mbi vlerën e fondit limit të prokuruar nga AK.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomik “P.” ShPK me ofertë të paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **17,946,669.4** (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet e gjashtë mikë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë katër) lekë pa TVSH dhe **21,536,003.28** (njëzet e një milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tre pikë njëzet e tetë) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **24.10.2019**.

Ankesa: Në lidhje me kriteret e kualifikimit si dhe me vlerësimin e ofertave nuk është paraqitur asnjë ankesë. Janë paraqitur sugjerime nga APP të cilat janë pranuar dhe në përputhje me aktet ligjore janë reflektuar në SPE nëpërmjet shtojcës përkatëse.

Në lidhje me zbatimin e kriterëve të DST nga OE fitues si dhe në procesin e vlerësimit të dosjeve të dorëzuara dhe OE të s’ kualifikuar nga KVO, nuk u konstatuan shkelje.

Nga titullari i AK me operatorin ekonomik është lidhur kontrata nr. 6889/11prot datë 12.11.2019, me kohë përfundimi 2 ditë, pasi aktiviteti do të zhvillohet më datë 16-17 Nëntor 2019. Monitorimi i kontratës është bërë në bazë të Urdhrit nr. 617 datë 12.11.2019 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt prokurimi “Organizim aktiviteti me temë “Shqipëria punon tokën”.

Zbatimi i likuiditetit të situacioneve jepet në tabelën bashkëlidhur këtij raporti në aneksin sipas drejtimit 6.

II. Për procedurën “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”, gusht 2019, nga verifikimi i dosjes fizike dhe elektronike në SPE, u konstatua:

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË TENDERIT

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”

<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 467, me nr. 6476 prot datë 19.08.2019, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E. M. 2. E.J. 3. L. I. 	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur- Punë”</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr.468 , me nr.6476/1 prot datë 19.08.2019, me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E. T., kryetar 2. M. Q., anëtar 3. K. J., anëtar
<p>4.Fondi Limit (pa TVSh) 161,478,671 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH,.</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratë është 158,290,523.80 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tre pikë tetë) lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 3,188,147.2 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë pikë dy) lekë pa TVSH.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 25.09.2019, ora 09:00</p>	<p>8.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2019- 2020-2021</p>	<p>9. Operoret Ekonomike pjesëmarrës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. O.E “R & T” ShPK. me NUIS J.....G, me ofertë ekonomike 158,290,523.8 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tre pikë tetë) lekë pa TVSH. 2. O.E. “I.” ShPK me NUIS J.....L, me ofertë ekonomike 133,137,774 (njëqind e tridhjetë e tre milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. 3. B.O.E. “C.” SH.P.K me NUIS J....E & “B....” ShPK me NUIS J.....D, me ofertë ekonomike 118,302,290 (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e treqind e dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH. 4. O.E. “E.- VL” ShPK me NUIS K....Ë, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 5. O.E. “S.....” ShPK me NUIS K....Ë, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 6. O.E. “S.....” ShPK me NUIS J.....Q, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
<p>10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - Në datë 27/08/2019 është paraqitur ankesë nga O.E. “Sh.90” ShPK;</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike</p>	<p>11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - Në datë 27/08/2019 AK ka kthyer përgjigje O.E. “Sh. 90” ShPK mos pranimin e ankesës pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore; Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike Në datë 12/11/2019 O.E. “I.” ShPK është njoftuar me vendimin e KSHA duke vendosur mos pranimin e ankesës;</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga KKP – nuk ka</p>
<p>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi</p>		
<p>13. Lidhja e kontratës me nr. 6476/10 datë 03.12.2019 dhe përfundon 24 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës /miratimi i fillimit të punimeve.</p>	<p>14. Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhrin nr. 653, me nr. 6476/12 prot datë 03.12.2019 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratë me përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. T.D.- kryetar; 2. E. J.-anëtar; 3. L.K.- anëtar. 	

-Dokumentacioni fizik dhe elektronik mbi procedurën e prokurimit Procedurë e Hapur të zhvilluar me objekt: “Ri konstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”, gusht 2019, me nr. REF-33827-08-19-2019, zhvilluar në MBZHR.

-Dokumentacioni i zbatimit të kësaj procedure.

Sipas urdhrorit të prokurimit me nr. 6476 datë 19.08.2019, Titullari i AK, z. E. H. ka miratuar njësinë e prokurimit të përbërë nga 3 anëtarë:

z. E. M., (Kryetar i NJP), E. J. dhe L. I., anëtarë.

-Me urdhër nr.468, nr. 6476/1. prot , datë 19.08.2019 Titullari i AK ka miratuar ngritjen e KVO për këtë procedurë me përbërje:

Znj. E.T., z. K.J.dhe znj. M. Q., anëtarë

Fondi limit: 161,350,789 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e treqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) **leke pa TVSh**, vënë në dispozicion nga buxheti i ndarë si më poshtë:

30,000,000 (tridhjetë milion) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga buxheti i vitit 2019 dhe; Viti 2020 – 2021 sipas PBA financimi: 131,350,789 (njëqind e tridhjetë e një milion e treqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i ndare si me poshtë:

- 66,666,666 (gjashtë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga buxheti i vitit 2020;

- 64,684,123 (gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga buxheti i vitit 2021;

Nr.	Emërtimi	Financim 2019 Pa TVSh	Financim 2020-2021 Pa TVSh	Totali Pa TVSh
1	Ri konstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë.	30,000,000	131,350,789	161,350,789

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Nr.	Emërtimi	Autoriteti Prokurues	Koha e fillimit	Koha e përfundimit	Autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës
1	Ri konstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë.	MBZHR	Me nënshkrimin e kontratës/ miratimi i fillimit të punimeve	24 muaj	MBZHR

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ka qenë data 19/09/2019, ora: 10:00.

Ankesa:

Në lidhje me kriteret e kualifikimit janë ndjekur hapat si më poshtë:

- Në datë 21.08.2019 janë paraqitur sugjerime nga APP të cilat janë pranuar dhe në përputhje me aktet ligjore janë reflektuar në SPE nëpërmjet shtojcës përkatëse;
- Në datë 27/08/2019 është paraqitur ankesë nga O.E. “Sh.90” ShPK;
- Në datë 27/08/2019 AK ka kthyer përgjigje O.E. “Sh.90” ShPK për mos pranimin e ankesës pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore;
- Në datë 9/9/2019 është vendosur heqja e pezullimit të procedurës duke qenë se O.E. “Sh.90” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë KPP;

Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike janë ndjekur hapat si më poshtë:

- Në datë 08/11/2019 është paraqitur ankesë nga O.E. “I.” ShPK;
- Në datë 08/11/2019 është vendosur pezullimi i procedurës si dhe ngritja e KSHA për shqyrtimin e ankesës përkatëse;

- iii. Në datë 12/11/2019 O.E. "I." ShPK është njoftuar me vendimin e KSHA duke vendosur mos pranimin e ankesës;
- iv. Në datë 25/11/2019 AK ka vendosur heqjen e pezullimit pasi janë ezauruar afatet e ankimit për në KPP. O.E. "I." ShPK nuk ka paraqitur ankesë pranë KPP në lidhje me arsyet e s kualifikimit të KVO-së.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët.**

Është kualifikuar fitues nga KVO Operatori Ekonomik "R." SHPK, me ofertë ekonomike 158,290,523.8 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tre pikë tetë) lekë pa TVSH.

Janë s' kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm për mos plotësim të kritereve sipas DST dhe konkretisht:

1) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "C." SH.P.K & "B." SHPK për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

a) Bashkimi i Operatorëve ekonomik ne formularin e ofertës ka paraqitur vlera prej 118,302,290 lekë pa TVSH dhe 141,962,747 me TVSH. Referuar preventivit te paraqitur në SPE rezultojnë këto zëra te ofertuar:

- Shuma për punime ndërtimi me vlere: 59,852,290 leke pa TVSH;
- Shuma për punime sistemimi me vlere: 15,606,655 leke pa TVSH;
- Shuma për punime artistike me vlere: 436,498 leke pa TVSH;
- Shuma 1-3 me vlerë 14,731,526 leke pa TVSH;
- Totali 1-5 me vlerë 3,779,163 leke pa TVSH;
- Pajisje mekanike shuma totale me vlere 9,108,932 leke pa TVSH;
- Punime elektrike shuma A-I me vlere 6,163,413 leke pa TVSH;
- Furnizim makineri dhe pajisje elektrike me vlere 6,136,189 leke pa TVSH;
- Fondi rezervë ne vlerën prej 5,028,477 leke pa TVSH;

Në manualin e përdorimit për vlerësimin e ofertave (miratuar nga APP) është përcaktuar se nga anëtarët e KVO ngarkohen ne SPE ne fazën e vlerësimit ofertat në vlerën pa TVSH. Nga verifikimi i preventivit me formularin e ofertës, rezulton një ndryshim në vlerën prej 2,540,853 lekë pa TVSH. Nga përlllogaritja e korrigjimit del se oferta është me gabime aritmetikore me vlere mbi normën e lejuar +/-2%. Ne zbatim te **VKM nr. 914, neni 66, pika 4)** nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Në rastin konkret oferta duhet të ishte paraqitur në shumën totale 120,843,143 leke pa TVSH.

b) Nuk kanë përzgjedhur anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik në Sistemin e Prokurimeve Elektronike sipas manualit nr. 01, datë 26.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

c) Operatori ekonomik "C." ShPK ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën me objekt "Rikonstruksion i poliklinikës se specialiteteve" me vlerë të situacionuar në shumën prej 69,426,611,7 leke pa TVSH. Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.1 të DST, ku citohet se:

"Ofertuesi duhet të dorëzojë punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës se përlllogaritur te kontratës qe prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit" ose kriterin 2.3.2 "Ofertuesi duhet të dorëzojë punë të ngjashme deri ne një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit. Për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës se përlllogaritur te kontratës qe prokurohet O.E. duhet te kishte dorëzuar kontrate ne vlerën prej 80,675,394.5 leke pa TVSH.

d) O.E. "C." ShPK nuk figuron të ketë ne licencën profesionale Inxhinier Struk turist sipas kërkesave te kualifikimit.

- e) O.E. "C." ShPK nuk figuron të ketë te punësuar Inxhinier Gjeolog sipas kërkesave të kualifikimit.
- f) O.E. "C." ShPK nuk figuron te ketë te punësuar "Arkitekt" sipas kërkesave të kualifikimit.
- g) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik nuk figuron të ketë te punësuar 1 (një) specialist IT/ekuivalent sipas kërkesave të kualifikimit.
- gj) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik "C." ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin "transport mbetjesh deri në 7 km". Në deklaratën noteriale nr. repertori 2085, nr. koleksioni 1513, operatori ekonomik "C." ka deklaruar nën përgjegjësi personale ligjore se punonjësit e mëposhtëm (pjesë e tyre edhe z. B.D.) janë te punësuar sipas kontratave përkatëse të paraqitura në këtë procedurë. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "C." ShPK ka paraqitur 8 shoferë nga të cilët z. B. D nuk figuron në LP për periudhën Janar 2019 – Korrik 2019 edhe pse kontrata është nënshkruar me datë 03.01.2019. Gjithashtu, operatori juaj ekonomik, në zbatim të VKM nr. 914 neni 74/3 duhet të kishte të punësuar me kontratë noteriale 10 shoferë, ndërkohë që ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 7 shoferë si dhe 1 shofer, z. B.D. i cili nuk rezulton të jetë i punësuar pranë shoqërisë C..
- h) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik "C." ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin "Punime lysterje". Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "C." ShPK ka paraqitur 3 bojaxhinj nga 5 të kërkuar. Në zbatim të VKM nr. 914 neni 74/3 duhet të kishte të punësuar me kontratë noteriale 5 bojaxhinj ndërkohë që ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 3 të tillë.
- i) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik "B." ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin "Punime muratore". Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "B." ShPK ka paraqitur 2 muratorë nga 5 të kërkuar ku sipas VKM nr. 914 neni 74/3 duhet të kishte të punësuar me kontratë noteriale 5 muratorë , ndërkohë që ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 2 të tillë.
- j) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik "B." ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin "2. Makineri dhe pajisje kondicionimi". Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "B." ShPK nuk ka paraqitur asnjë specialist të sistemeve të kondicionimit. Në zbatim të VKM nr. 914 neni 74/3 duhet të kishte të punësuar me kontratë noteriale 3 specialistë për sistemet e kondicionimit.
- k) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik "B." ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin "Punime suvatim - veshje". Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "B." ShPK ka paraqitur 2 specialistë për punime gipsi. Në zbatim të VKM nr. 914 neni 74/3 duhet të kishte të punësuar me kontratë noteriale 5 specialistë për punime gipsi, ndërkohë që ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 2 të tillë.
- l) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik "B." ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin "Kamera të brendshme". "Kamera të jashtme" si dhe "Njësia e regjistrimit të kamerave". Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik "B." ShPK nuk ka paraqitur asnjë specialist përkatës. Në zbatim të VKM nr. 914 neni 74/3 duhet të kishte të punësuar me kontratë noteriale 1 specialist për pajisje kamera. Ndërkohë operatori ekonomik "C." ShPK ka paraqitur si specialist kamerash z. A. M. Në deklaratën noteriale nr. repertori 2085, nr. koleksioni 1513, operatori ekonomik "C." ka deklaruar në përgjegjësi personale e ligjore se punonjësit e mëposhtëm (pjesë e tyre edhe z. A.M.) janë te punësuar sipas kontratave përkatëse të paraqitura në këtë procedurë. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se z. A. M. nuk figuron në LP për periudhën Janar 2019 – Korrik 2019 edhe pse kontrata është nënshkruar me datë 03.01.2019.
- m) O.E. "C." ShPK ka paraqitur si vinçier z. A.A. Në SPE rezulton të jetë paraqitur certifikatë trajnimi lëshuar me nr. AQS/T/S7992017 nga shoqëria AQSCERT lëshuar me 30/06/2017. Dokumentacioni i paraqitur nuk është dorëzuar komfort VKM nr. 808, datë 04.12.2003 "Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit".

Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “B.” ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin “2. Makineri dhe pajisje kondicionimi”. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “B.” ShPK nuk ka paraqitur autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, sipas kriterit kualifikues “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 e DST.

n) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “B.” ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin “central telefonik ” dhe “Aparate telefonike”. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “B.” ShPK nuk ka paraqitur autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, sipas kriterit kualifikues “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 e DST.

o) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “B.” ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin “Kamera të brendshme”, “Kamera të jashtme” si dhe “Njësia e regjistrimit të kamerave”. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “B.” ShPK nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, sipas kriterit kualifikues “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.11 e DST.

p) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “B.” ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin “F.V. bordura betoni”. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “B.” ShPK nuk ka paraqitur autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, sipas kriterit kualifikues “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 e DST.

q) Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Bahas” ShPK ka marrë përsipër 100 % për të realizuar zërin “Gjenerator silencioz.”. Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “B.” ShPK nuk ka paraqitur autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, sipas kriterit kualifikues “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 e DT.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese*”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar Operatorin Ekonomik.

2. Të s’ kualifikojë Operatorin Ekonomik “I.” SHPK për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konkretisht:

1. Operatori ekonomik në formularin e ofertës ka paraqitur vlerën prej 133,137,774 lekë pa TVSH dhe 170,235,829 me TVSH. Referuar preventivit rezultojnë vlerat si më poshtë:

- Shuma për punime mekanike me vlere: 28,211,050 leke pa TVSH;
- Shuma për punime elektrike me vlere: 8,476,400 leke pa TVSH;
- Shuma 1-3 me vlere 126,797,880 leke pa TVSH;
- Fondi rezervë 6,339,894 leke pa TVSH;
- Shuma punime 133,137,774 leke pa TVSH;
- TVSH 26,627,555 leke;
- Pajisje mekanike shuma totale me vlere 5,877,000 leke pa TVSH;
- Punime elektrike shuma totale me vlere 4,593,500 leke pa TVSH;

- Shuma pajisje 10,470,500 leke pa TVSH;
- Shuma totale me TVSH 170,235,829;

Në manualin e përdorimit për vlerësimin e ofertave (miratuar nga APP) është përcaktuar se anëtarët e KVO ngarkojnë ofertat ekonomike të operatorëve pjesëmarrës në SPE në fazën e vlerësimit të ofertave në vlerën pa TVSH. Nga verifikimi i preventivit me formularin e ofertës, rezultoi një ndryshim në vlerën prej 10,470,500 leke pa TVSH. Nga përlllogaritja e korrigjimit del se oferta është me gabime aritmetike me vlerë mbi normën e lejuar +/-2%. Në zbatim të VKM nr. 914, neni 66, pika 4) nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Në rastin konkret oferta duhet të ishte paraqitur në shumën totale 143,608,274 leke pa TVSH.

b) Operatori ekonomik "I." ShPK ka paraqitur si punë të ngjashme kontratat me objekt:

Kontratë datë 23.09.2016 me palë MMRS dhe B.O.E "I. "ShPK & "E.", ShPK & "E." ShPK & "B." ShPK me objekt "Ndërtim i bazës prodhuese, Faza e I-rë, shkolla Industriale "A. B.", Shkodër".

Për këtë kontratë O.E në SPE ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: Kontratën e nënshkruar midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik; Formular vlerësimi; Aktin e kolaudimit, Situacion përfundimtar të objektit; Fatura tatimore. Kontratë datë 24.10.2016 me palë MMRS dhe B.O.E "I."shpk & "E." ShPK me objekt "Rikonstruksion i ndërtesës së shkollës teknologjike "Hamdi Bushati, Shkodër". Për këtë kontratë O.E në SPE ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: Kontratën e nënshkruar midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik; Formular vlerësimi, Aktin e kolaudimit; Situacion përfundimtar të objektit; Fatura tatimore;

Kontratë datë 05.07.2017 me palë MMRS dhe B.O.E "I. "ShPK & "E." ShPK me objekt "Ndërtim i bazës prodhuese të shkollës "Arben Broci, Shkodër". Për këtë kontratë O.E në SPE ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratën e nënshkruar midis Autoritetit Kontraktor dhe operatorit ekonomik;
- Formular vlerësimi;
- Aktin e kolaudimit;
- Situacion përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore;

Për kontratat e mësipërme Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur kontratën e përkohshme të bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këto procedura sipas kriterit kualifikues të AK, në pikën 2.3.1 "Për kapacitetin teknik", për të verifikuar zërat konkretë që ai ka marrë përsipër për të kryer, me qëllim verifikimin e saktë të tyre (bazuar gjithashtu në vendim të KPP nr. 685/2019, datë 30.10.2019).

c) Operatori ekonomik "I." ShPK ka paraqitur si punë të ngjashme kontratat me objekt: Kontratë datë 30.11.2017 me palë Bashkia Vlorë dhe O.E. "I." ShPK me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo" me vlerë 58,309,005 leke pa TVSH;

Kontratë datë 14.12.2017 me palë MB dhe O.E. "I." ShPK me objekt "Rikonstruksion i objektit 2 katesh, ish biblioteka e KDS me destinacion Qendra e Ekselencës" me vlerë 45,394,666,7 leke pa TVSH;

Për kontratat e mësipërme Operatori Ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.1 "Ofertuesi duhet të dorëzojë punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit" ose kriterin 2.3.2 "Ofertuesi duhet të dorëzojë punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit. Për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet O.E. duhet të kishte dorëzuar kontratë në vlerën prej 80,675,394.5 leke pa TVSH.

2.1 Operatori ekonomik "I." ShPK ka paraqitur si punë të ngjashme kontratat me objekt:

a. “Punë e ngjashme pallati (pjesa e parë dhe pjesa e dytë);

b. “Pallati i ri, punë e ngjashme”;

2.1.1 Referuar SPE, për kontratën me objekt “Punë e ngjashme pallati (pjesa e parë dhe pjesa e dytë) operatori ekonomik ka paraqitur sipas faturave tatimore përkatëse.

Referuar kritereve të kualifikimit 2.3.1 “Për kapacitetin teknik” është kërkuar në dokumentet e tenderit Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës se përlogaritur te kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit (nga data **25.09.2016** deri ditën e hapjes së ofertave datë **25.09.2019**). Referuar situacioneve të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik rezulton se janë kryer punime brenda afateve të kërkuara nga AK në vlerën prej 68,699,789 lekë pa TVSH. Për sa më sipër kjo kontratë nuk plotëson kriterin 2.3.1 “Për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës se përlogaritur te kontratës që prokurohet O.E. duhet të kishte dorëzuar kontrate në vlerën prej 80,675,394.5 lekë pa TVSH.

Gjithashtu, bashkëlidhur faturave tatimore janë paraqitur edhe situacionet përkatëse. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se situacionet nuk janë paraqitur në formën e duhur ligjore. Konkretisht në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, pika 17 specifikohet që situacionet kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. Situacionet që janë paraqitur në SPE janë të nënshkruara vetëm nga Inxh. L. M e cila rezulton të jetë e punësuar si drejtuese teknike pranë shoqërisë “I.” ShPK.

Operatori ekonomik nuk disponon sipas kërkesave të kualifikimit 2.3.10 “Për kapacitetin teknik”, konkretisht te disponoje ne pronësi ose me qira “GPS”. Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se për dokumentin me emërtim “Inerti qira GPS” rezulton se në kontratën e nënshkruar me kompaninë “L. & C.” objekt qiraje është instrument “Total Station”.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese*”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar Operatorin Ekonomik.

3. Të s’ kualifikojë Operatorin ekonomik “E.- VL” ShPK, për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm “Ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” si dhe formulari i ofertës i pa plotësuar.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese*”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar Operatorin Ekonomik.

5. Të s’ kualifikojë Operatorin ekonomik “S.” ShPK, për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm dokumentin “Preventivin pjesa 3”, i cili është pjesa e tretë e preventivit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik.

6. Të skualifikojë Operatorin ekonomik “S.” ShPK, për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm “Vërtetim debie”.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 “*Operatorët*

ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar Operatorin Ekonomik.

Konkluzion: Në lidhje me operatorët e s' kualifikuar u verifikuan dokumentacioni në SPE si dhe dosjet fizike nga të cilat nuk u konstatuan shkelje të KVO, në verifikimin e kriterëve të pa plotësuar nga OE.

Grupi i auditimit shqyrtoi plotësimin e dokumentacionit e të kërkesave për kualifikim nga DST sipas NJP, në bazë të LPP neni 46/1 kriterëve në lidhje me **Operatorin Ekonomik “R & T” ShPK**, ku sipas ofertës së paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 158,290,523.80 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tre pikë tetë) lekë pa TVSH dhe 189,948,628.56 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë pikë pesëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **04.11.2019**.

Kohëzgjatja e kontratës: **24 muaj**.

Data e lidhjes së kontratës: 03.12.2019, Vlera e kontratës është 186,053,560.36 lekë.

Nga auditimi u konstatua:

Sipas verifikimit të dosjes elektronike në SPE, rezulton se:

Sipas kriterëve në Kapacitetin teknik 2.3, pika 4, nga NJP përcaktohet se:

Drejtues Teknik ne licencën e Shoqërisë të ketë në përbërje:

- 1) *Inxhinier Hidroteknik 1 (një)*
- 2) *Inxhinier Ndërtimi 1 (një)*
- 3) *Inxhinier Ndërtimi Strukturist 1 (një)*
- 4) *Inxhinier Topograf 1 (një)*
- 5) *Inxhinier Mjedisi 1 (një)*
- 6) *Inxhinier Mekanik 1 (një)*
- 7) *Inxhinier Elektrik 1 (një)*
- 8) *Gjeolog 1 (një)*

a) Për secilin prej pjesëtareve të stafit teknik ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale pune. b) Diplome përkatëse.

5- Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të Administratorit të shoqërisë Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, i pajisur me Diplomë dhe Kontratë pune. Drejtuesi teknik nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhës se realizimit te objektit.

Në lidhje me kriterin e përbërjes në licencën e shoqërisë ku kërkohet një inxhinier gjeolog, rezulton se shoqëria R. ka lidhur kontratë pune me z. K. O. në datë 16.02.2017 me një afat 3-vjeçar, gjë që mbaron në 16.02.2020, ndërkohë kohëzgjatja e punimeve sipas kontratës me AK është 24 muaj pra mbaron në 03.12.2021, rrjedhimisht për inxhinier gjeolog mbaron afati kontraktual.

E njëjta situatë paraqitet edhe me specialistin në profilin inxhinier hidro-teknik, me të cilin është lidhur kontrata në datë 16.02.2017 me një afat 3-vjeçar, afat ky që nuk përmbush detyrimin kontraktual të R. ShPK për përfundimin e kontratës në ndërtimin e Merkatos Vlorë e cila mbaron në 03.12.2021.

Në këtë rast KVO duhet të kishte kërkuar sqarime në lidhje me këto mos përputhje në mënyrë që të mos riskohet zbatimi me sukses i kontratës në përputhje me nenin 53. Shqyrtimi i ofertave/ pika 4. *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet*

dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.³

Në lidhje me zbatimin e kontratës sipas situacioneve të faturuara dhe urdhër shpenzimeve të kryera nga Sektori i Financës në MBZHR, rezulton kjo situatë e paraqitur në tabelën bashkëlidhur këtij raporti në aneksin sipas drejtimit 6.

Në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate sipas të dhënave të marra analitikisht nga financa si dhe urdhër shpenzimet konstatohet se zbatimi i kësaj kontrate ka një amendim kontrate me nr. 7812/3, datë 01.12.2021 ku citohet se:

Grafiku i Zbatimit :

Objektet e prokuruar nga ana e AK do të kryhet nga Kontraktuesi brenda 795 ditëve nga nënshkrimi i kontratës fillestare të punimeve.

Ndërkohë Lidhja e kontratës fillestare me nr. 6476/10 është kryer në datë 03.12.2019 dhe përfundonte 24 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës /miratimi i fillimit të punimeve, pra përfundimi i punimeve duhet të ishte data 03.12.2021. Me amendimin e kontratës është kryer shtimi prej 65 ditë për realizimit e plotë të saj.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 9, datë 26.05.2023.

Observacioni i MBZHR-së me shkresë 1175/21, datë 07.06.2023, sipas akt-konstatimit nr.9, datë 26.05.2023, nr. prot 211/21 prot, datë 26.05.2023. për të cilin është reflektuar dhe jemi shprehur në projekt raport.

Në fazën e RPA nga subjekti është paraqitur observacion nga ish anëtarët e NJP dhe ish-anëtarët e KVO-së, ne emailin e datës 26.07.2023.

Pretendimi i subjektit:.... Në lidhje me konstatimin "...Gjithashtu në stafin e specialistëve inxhinier nga shoqëria nuk ka deklaruar në përbërje të saj inxhinier topograf në kundërshtim me kriterin 2.3 të sipërcituar...", sqarojmë se për të plotësuar këtë kriter O.E ka paraqitur inxhinieren znj. S. A. (Foto). Lutemi verifikimin edhe një herë nga ana juaj të dokumentacionit të dorëzuar për plotesimin e kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Sqarojmë se kualifikimi inxhinier gjeodet është ekuivalent me inxhinier topograf. (Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin provues).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Observacioni juaj pranohet dhe është reflektuar në RPA.

III. Auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: Rehabilitim dhe mbrojtje lumore (e ndarë në 6 lote), REF-19871-04-26-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Rehabilitim dhe mbrojtje lumore (e ndarë në 6 lote)", REF-19871-04-26-2019		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019	3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike A. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 z. E. M. z. T. D. znj. L. I.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 289 me nr. 2704/6, datë 26.04.2019 z. A. M. – Kryetar znj. E. T.– Anëtare z. L.K. – Anëtar znj. M. Q. – Anëtare z. E. J.– Anëtar
2. Lloji i Procedurës "Procedurë e format elektronik		

³ Ndryshuar me ligjin nr. 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

<p>5. Fondi Limit (pa TVSh) 416,450,420 lekë</p> <p>Loti 1: 53,688,999 Loti 2: 30,919,951 Loti 3: 36,614,190 Loti 4: 64,361,249 Loti 5: 67,005,582 Loti 6: 163,860,449</p> <p>5.1 Afati Loti 1: 3 muaj Loti 2: 3 muaj Loti 3: 4 muaj Loti 4: 3 muaj Loti 5: 3 muaj Loti 6: 2 muaj</p>	<p>6. Oferta e kualifikuar e para 398,153,385 lekë</p> <p>Loti 1: 51,745,510 – N. 2014 & RR.G. Loti 2: 27,476,550 – V. K.& E.A. & LL. Loti 3: 35,876,467 – V. N. IS & N. Loti 4: 63,677,521 – H. Loti 5: 63,891,059 – M. & LL. Loti 6: 155,486,278 – B. N & A.K.</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 18,297,035 ekë (4.4 %)</p> <p>Loti 1: 1,943,489 (3.6 %) Loti 2: 3,443,401 (11.1 %) Loti 3: 737,723 (2.0 %) Loti 4: 683,728 (1.0 %) Loti 5: 3,114,523 (4.6 %) Loti 6: 8,374,171 (5.1 %)</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit 03.06.2019, ora 10:00</p>	<p>9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 2019 – 2020</p>	<p>10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)</p>
<p>11. Ankimime (Trajtuar rast pas rasti)</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës (Trajtuar rast pas rasti)</p>	<p>(Trajtuar rast pas rasti)</p>

Nga një analizë e të 6 loteve rezulton si më poshtë:

Loti 1: 3 pjesëmarrës, tërhequr 2, s' kualifikuar 0, fitues OE i renditur i treti;
Loti 2: 6 pjesëmarrës, tërhequr 4, s' kualifikuar 0, fitues OE i renditur i pesti;
Loti 3: 8 pjesëmarrës, tërhequr 4, s' kualifikuar 3, fitues OE i renditur i teti;
Loti 4: 9 pjesëmarrës, tërhequr 4, s' kualifikuar 4, fitues OE i renditur i nënti;
Loti 5: 5 pjesëmarrës, tërhequr 2, s' kualifikuar 2, fitues OE i renditur i pesti;
Loti 6: 4 pjesëmarrës, tërhequr 2, s' kualifikuar 1, fitues OE i renditur i katërti;

Loti 1 Argjinatura e lumit Drin, krahu i djathtë i rrjedhës Ishull Shëngjin me nr. REF-19879-04-26-2019

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : 'Argjinatura e lumit Drin, krahu i djathtë i rrjedhës Ishull Shëngjin' me nr. REF-19879-04-26-2019		
<p>1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019</p>	<p>3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike A.</p> <p>Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 z. E. M. z. T.D. znj. L. I.</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 289 me nr. 2704/6, datë 26.04.2019</p> <p>z. A.M.– Kryetar znj. E.T.– Anëtare z. L. K.– Anëtar znj. M. Q.– Anëtare z. E. J.– Anëtar</p>
<p>2. Lloji i Procedurës "Procedurë hapur" format elektronik</p>		
<p>5. Fondi Limit (pa TVSh) 53,688,999 5.1 Afati 3 muaj</p>	<p>6. Oferta e kualifikuar e para 51,745,510 – N. 2014 & RR. G. & N.</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,943,489 (3.6 %)</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit 03.06.2019, ora 10:00</p>	<p>9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 2019 – 2020</p>	<p>10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)</p>
<p>11. Ankimime (Trajtuar rast pas rasti)</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës (Trajtuar rast pas rasti)</p>	<p>S. 2F & A.-I.G. CO. – 38,777,676.⁰⁰ 2T & B. – 44,508,850.⁴⁰ N.2014 & RR. G. & N. – 51,745,510.⁰⁰</p>

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË NJP

Në lidhje me Lotin 1 rezulton se sipas procesverbalit të datës 26.04.2019 nga ana e NJP janë hartuar DT të procedurës. Pas njoftimit të kontratës sipas shkresës me nr. 2704/7 prot., datë 26.04.2019, rezulton se në lidhje me kriteret janë bërë sugjerime nga ana e APP sipas e-mailit të datës 08.05.2019 të ardhur në adresën e z. E.M.

Sipas shkresës nr. 2704/8 prot., datë 02.05.2019, nga ana e ish Titullarit të AK z. E. H. është pezulluar procedura e prokurimit për shkak të ankesave të bëra nga ana e OE. Në përbërje të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), janë caktuar anëtarët e KVO të kësaj procedure. Në përfundim të trajtimit të sugjerimeve të bëra nga ana e APP rezulton se nga ana e KSHA është bërë reflektimi pjesor i këtyre ndryshimeve duke paraqitur edhe shtojcën përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË KVO

Sipas shkresës me nr. – prot., datë 03.06.2019 është bërë hyrja në sistem për vlerësimin e ofertave nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE me vlera të ofertës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Statusi
1	S. 2F & A.-I.G. C.	38,777,676. ⁰⁰	Tërhequr
2	2T & B.	44,508,850. ⁴⁰	Tërhequr
3	N.2014 & RR. G. & N.	51,745,510. ⁰⁰	Fitues

Sipas dokumentacionit rezulton se nga ana e BOE S. 2F & A.-I. G.C. dhe BOE 2T & BE-IS janë paraqitur respektivisht sipas shkresave me nr. 4798 prot., datë 14.06.2019 dhe 4807 prot., datë 17.06.2019 kërkesat për tërheqje nga procedura e prokurimit duke bërë që BOE N. 2014 & RR.G. & N. me vlerën më të lartë të ofertuar të renditet si ofertues i pari dhe i vetmi i kësaj procedure prokurimi. Pas miratimit të Raportit Përmbledhës të Procedurës nga ana e Titullarit sipas shkresës nr. 2704/14 prot., datë 26.06.2019 dhe njoftimit të BOE fitues sipas shkresës nr. 2704/16 prot., datë 27.06.2019, është njoftuar Drejtoria të Kullimit Lezhë për lidhjen e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

Loti 2 Mbrojtje nga përmbytjet nga lumi Shkumbin në Shushicë (lagja Gogollaret).

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : 'Mbrojtje nga përmbytjet nga lumi Shkumbin në Shushicë (lagja Gogollaret)' me nr. REF-19882-04-26-2019		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 2. Lloji i Procedurës "Procedurë hapur" format elektronik	3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike G. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 z. E.M. z. T. D. znj. L. I.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 289 me nr. 2704/6, datë 26.04.2019 z. A. M. – Kryetar znj. E.T. – Anëtare z. L.K. – Anëtar znj. M.Q. – Anëtare z. E. J. – Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 30,919,951 5.1 Afati 3 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para 27,476,550 – V.K. & E.-A. & LL.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,443,401 Lekë (11.1 %)
8. Data e hapjes së tenderit 03.06.2019, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 2019 – 2020	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH) B 93 & R. C. – 24,067,740 2T & B. – 25,179,678 S.2F & A.-I. G. C. – 25,555,555 H. – 26,952,833 V.K. & E.-A. & LL. – 27,476,550 S. & U. B. – 29,326,176
11. Ankimime Po në lidhje me kriteret	12. Përgjigje Ankesës Po	

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË NJP

Në lidhje me Lotin 2 rezulton se sipas procesverbalit të datës 26.04.2019 nga ana e NJP janë hartuar DT të procedurës. Pas njoftimit të kontratës sipas shkresës me nr. 2704/7 prot., datë

26.04.2019, rezulton se në lidhje me kriteret janë bërë sugjerime nga ana e APP sipas e-mailit të datës 08.05.2019 të ardhur në adresën e z. E. M.

Sipas shkresës nr. 2704/8 prot., datë 02.05.2019, nga ana e ish Titullarit të AK z. E.H. është pezulluar procedura e prokurimit për shkak të ankesave të bëra nga ana e OE. Në përbërje të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), janë caktuar anëtarët e KVO të kësaj procedure. Në përfundim të trajtimit të sugjerimeve të bëra nga ana e APP rezulton se nga ana e KSHA është bërë reflektimi pjesor i këtyre ndryshimeve duke paraqitur edhe shtojcën përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË KVO

Sipas shkresës me nr. – prot., datë 03.06.2019 është bërë hyrja në sistem për vlerësimin e ofertave nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE me vlera të ofertës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Statusi
1	B-93 & R. C.	24,067,740	Tërhequr
2	2T & B.	25,179,678	Tërhequr
3	S. 2F & A.-I. G. C.	25,555,555	Tërhequr
4	H.	26,952,833	Tërhequr
5	V.K.& E.A.& LL.	27,476,550	Fitues
6	S. & U. B.	29,326,176	S' kualifikuar

Sipas dokumentacionit rezulton se nga 6 OE si më sipër, janë tërhequr nga procedura ende pa përfunduar vlerësimi i ofertave 4 operatorët e parë. Në vijim KVO ka s' kualifikuar BOE S.& U. B. Pas miratimit të Raportit Përmbledhës të Procedurës nga ana e Titullarit sipas shkresës nr. 2704/20 prot., datë 03.07.2019 dhe njoftimit të BOE fitues sipas shkresës nr. 2704/21 prot., datë 03.07.2019, është njoftuar Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë për lidhjen e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

Loti 3 Argjinatura mbrojtëse Zalli Sinës

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : 'Argjinatura mbrojtëse Zalli Sines' me nr. REF-19884-04-26-2019		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019	3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike T.S.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 289 me nr. 2704/6, datë 26.04.2019
2. Lloji i Procedurës "Procedurë hapur" format elektronik	Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 z. E. M. z. T. D. znj. L. I.	z. A.M.– Kryetar znj. E. T.– Anëtare z. L.K. – Anëtar znj. M. Q. – Anëtare z. E.J.– Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 36,614,190 5.1 Afati 3 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para 35,876,467 – V.N.I. & N.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 737,723 Lekë (2.0 %)
8. Data e hapjes së tenderit 03.06.2019, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 2019 – 2020	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)
11. Ankimime Po në lidhje me kriteret	12. Përgjigje Ankesës Po	B-93 & R.C.– 30,823,678 H. – 31,828,348 S. 2F A.-I. G. C. – 32,000,000 A. C.& K. I. – 32,393,330 BE – I. & 2. – 33,895,100 L.VII & A.M. – 33,922,240 E.-A.& V. K. & LL. – 34,039,175 V. N.I.S & N. – 35,876,467

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË NJP

Në lidhje me Lotin 3 rezulton se sipas procesverbalit të datës 26.04.2019 nga ana e NJP janë hartuar DT të procedurës. Pas njoftimit të kontratës sipas shkresës me nr. 2704/7 prot., datë

26.04.2019, rezulton se në lidhje me kriteret janë bërë sugjerime nga ana e APP sipas e-mailit të datës 08.05.2019 të ardhur në adresën e z. E. M.

Sipas shkresës nr. 2704/8 prot., datë 02.05.2019, nga ana e Titullarit të AK z. E.H. është pezulluar procedura e prokurimit për shkak të ankesave të bëra nga ana e OE. Në përbërje të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), janë caktuar anëtarët e KVO të kësaj procedure. Në përfundim të trajtimit të sugjerimeve të bëra nga ana e APP rezulton se nga ana e KSHA është bërë reflektimi pjesor i këtyre ndryshimeve duke paraqitur edhe shtojcën përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË KVO

Sipas shkresës me nr. – prot., datë 03.06.2019 është bërë hyrja në sistem për vlerësimin e ofertave nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë 8 OE me vlera të ofertës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Statusi
1	B-93 & R. C.	30,823,678	Tërhequr
2	H.	31,828,348	Tërhequr
3	S. 2F A.-I. G. C.	32,000,000	Tërhequr
4	A.C. & K.I.	32,393,330	S' kualifikuar
5	BE – I.& 2.	33,895,100	Tërhequr
6	L.VII & A.M.	33,922,240	S' kualifikuar
7	E.-A. & V .K & LL	34,039,175	S' kualifikuar
8	V. I.S & N.	35,876,467	Fitues

Sipas dokumentacionit rezulton se nga 8 OE si më sipër, janë tërhequr nga procedura ende pa përfunduar vlerësimi i ofertave 4 operatorë dhe janë s' kualifikuar 3 OE duke rezultuar fitues kështu BOE V. N. I.S & N. i cili është edhe ofertuesi me vlerën më të lartë ekonomike.

Pas miratimit të Raportit Përmbledhës të Procedurës nga ana e ish Titullarit sipas shkresës nr. 2704/22 prot., datë 10.07.2019 dhe njoftimit të BOE fitues sipas shkresës nr. 2704/23 prot., datë 10.07.2019, është njoftuar Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës për lidhjen e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

Loti 5 Mbrojtje nga Lumi Vjosë, në Kashisht

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : 'Mbrojtje nga Lumi Vjosë, në Kashisht' me nr. REF-19889-04-26-2019		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019	3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike V. A.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 289 me nr. 2704/6, datë 26.04.2019
2. Lloji i Procedurës "Procedurë hapur" format elektronik	Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 z. E.M. z. T.D. znj. L. I.	z. A. M. – Kryetar znj. E. T. – Anëtare z. L. K. – Anëtar znj. M. Q. – Anëtare z. E. J. – Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 67,005,582 5.1 Afati 3 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para 63,891,059 – M.& LL.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,114,523 Lekë (4.6 %)
8. Data e hapjes së tenderit 03.06.2019, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 2019 – 2020	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)
11. Ankimime Po në lidhje me kriteret	12. Përgjigje Ankesës Po	S. 2F & A.-I. G. C.. – 55,555,555. ⁰⁰ SH.– 57,995,963. ⁰⁰ A. C.& K.I.– 58,837,241. ⁹¹ GJ. – 60,259,763. ⁰⁰ M.& LL.– 63,891,059.⁰⁰

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË NJP

Në lidhje me Lotin 5 rezulton se sipas procesverbalit të datës 26.04.2019 nga ana e NJP janë hartuar DT të procedurës. Pas njoftimit të kontratës sipas shkresës me nr. 2704/7 prot., datë

26.04.2019, rezulton se në lidhje me kriteret janë bërë sugjerime nga ana e APP sipas e-mailit të datës 08.05.2019 të ardhur në adresën e z. E. M.

Sipas shkresës nr. 2704/8 prot., datë 02.05.2019, nga ana e ish Titullarit të AK z. E.H. është pezulluar procedura e prokurimit për shkak të ankesave të bëra nga ana e OE. Në përbërje të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), janë caktuar anëtarët e KVO të kësaj procedure. Në përfundim të trajtimit të sugjerimeve të bëra nga ana e APP rezulton se nga ana e KSHA është bërë reflektimi pjesor i këtyre ndryshimeve duke paraqitur edhe shtojcën përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

Në fakt konstatohet se disa prej kriterëve të vendosura janë të paargumentuara teknikisht. Konkretisht:

Kriteri 2.3:

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar, si më poshtë:

Auditues mjedisi - 1 (një)

Në lidhje me Audituesin Mjedisor të vendosur rezulton se kjo kërkesë (*e cila i referohet Certifikatës Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor*) është një dokument i cili lëshohet nga Ministria e linjës (Neni 24 i ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 *‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’*. Ky ekspert, sipas nenit 6 *Përkufizime*, pikës 18 të ligjit si më sipër, është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga Ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor. Në fakt, në nenin 1 *Qëllimi*, ky ligj ka cituar se:

‘Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

Pra, nga sa më sipër rezulton se procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, është një fazë e cila ezaurohet përpara miratimit të Projektit dhe pasi Projekti është miratuar, marrë në dorëzim dhe nuk duhet të vendoset si kriter për firmat sipërmarrëse që do të marrin pjesë në procedurë.

10. Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri:

Nr.	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbajtës minimalisht 15 ton	copë	15	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës minimalisht 3.5 ton	copë	4	Në pronësi ose me qira
3	Fadroma	copë	3	Në pronësi ose me qira
4	Ekskavator me krahë të gjatë mbi 18 m	copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Ekskavator	copë	8	Në pronësi ose me qira
6	Buldozer	copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Rrula	copë	3	Në pronësi ose me qira
8	Autovinç	copë	2	Në pronësi ose me qira
9	Autopompë betoni	copë	2	Në pronësi ose me qira
10	Auto betoniere	copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Autobot uji	copë	2	Në pronësi ose me qira
12	Karroca dore	copë	20	Në pronësi ose me qira
16	Tabela	copë	10	Në pronësi ose me qira
17	Autovinç me krah horizontal jo më pak se 50 m (shoqëruar me skede teknike dhe foto)	copë	2	Në pronësi ose me qira

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka një asnjë sqarim konkret për të argumentuar numrin e mjeteve të vendosura por vetëm një përkrahje të përgjithshme. Gjithashtu, rezultojnë tërësisht të paargumentuara mbi baza teknike kriteret të tilla si ato që lidhen me kërkesën për disponimin e përkatësisht 10 apo 4 kamionësh me kapacitete respektivisht mbi 15 ton dhe mbi 3.5 ton, 9 ekskavatorë, 3 rrula, etj.

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË KVO

Sipas shkresës me nr. – prot., datë 10.06.2019 është bërë hyrja në sistem për vlerësimin e ofertave nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë 5 OE me vlera të ofertës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Statusi
1	S. 2F & A.-I. G. C.	61,999,222. ⁰⁰	Tërhequr
2	SH.	57,995,963. ⁰⁰	Tërhequr
3	A. C. & K. I.	58,837,241. ⁹¹	S' kualifikuar
4	GJ.	60,259,763. ⁰⁰	S' kualifikuar
5	M. & LL.	63,891,059.00	Fitues

Sipas dokumentacionit rezulton se nga 5 OE si më sipër, janë tërhequr nga procedura ende pa përfunduar vlerësimi i ofertave 2 operatorë dhe janë s' kualifikuar 2 OE duke rezultuar fitues kështu BOE M. & LL.

Pas miratimit të Raportit Përmbledhës të Procedurës nga ana e ish Titullarit sipas shkresës nr. 2704/15 prot., datë 26.06.2019 dhe njoftimit të BOE fitues sipas shkresës nr. 2704/17 prot., datë 27.06.2019, është njoftuar Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier për lidhjen e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

Loti 6 Përroi i Zaranikës

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : 'Përroi i Zaranikës' me nr. REF-19891-04-26-2019		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 2. Lloji i Procedurës "Procedurë hapur" format elektronik	3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike T.S. Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 288 me nr. 2704/8 prot., datë 26.04.2019 z. E.M. z. T.D. znj. L. I.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 289 me nr. 2704/6, datë 26.04.2019 z. A.M. – Kryetar znj. E. T. – Anëtare z. L. K. – Anëtar znj. M.Q. – Anëtare z. E. J. – Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 163,860,449 5.1 Afati 2 muaj	6. Oferta e kualifikuar e para 155,486,278 – B.N & A.K.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 8,374,171 Lekë (5.1 %)
8. Data e hapjes së tenderit 03.06.2019, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit 2019 – 2020	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH) 2T & B.- I. – 126,190,663. ⁵⁰ V. H. & SH.– 131,969,253. ⁰⁰ V. I. & V. II. & AL A.– 151,409,696. ¹² B.N & A. K. – 155,486,278.⁰⁰
11. Ankimime <i>Po në lidhje me kriteret</i>	12. Përgjigje Ankesës <i>Po</i>	

Në lidhje me Lotin 6 rezulton se sipas procesverbalit të datës 26.04.2019 nga ana e NJP janë hartuar DT të procedurës. Pas njoftimit të kontratës sipas shkresës me nr. 2704/7 prot., datë 26.04.2019, rezulton se në lidhje me kriteret janë bërë sugjerime nga ana e APP sipas e-mailit të datës 08.05.2019 të ardhur në adresën e z. E. M.

Sipas shkresës nr. 2704/8 prot., datë 02.05.2019, nga ana e ish Titullarit të AK z. E.H. është pezulluar procedura e prokurimit për shkak të ankesave të bëra nga ana e OE. Në përbërje të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), janë caktuar anëtarët e KVO të kësaj procedure. Në përfundim të trajtimit të sugjerimeve të bëra nga ana e APP rezulton se nga ana e KSHA është bërë reflektimi pjesor i këtyre ndryshimeve duke paraqitur edhe shtojcën përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

AUDITIMI I AKTIVITETIT TË KVO

Sipas shkresës me nr. – prot., datë 03.06.2019 është bërë hyrja në sistem për vlerësimin e ofertave nga ku ka rezultuar se kanë marrë pjesë 4 OE me vlera të ofertës si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Statusi
1	2T & B.- I.	126,190,663. ⁵⁰	Tërhequr
2	V. H. & SH.	131,969,253. ⁰⁰	Tërhequr
3	V. I. & V. I. I. & A.A.	151,409,696. ¹²	S'kualifikuar
4	B.N & A. K.	155,486,278.⁰⁰	Kualifikuar

Pas kërkesës dhe miratimit përkatës për shtyrjen e aftit të vlerësimit të ofertave, me datë 26.09.2019 nga ana e KVO është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave sipas të cilit rezulton se nga 4 OE si më sipër, janë tërhequr nga procedura ende pa përfunduar vlerësimi i ofertave 2 operatorë dhe është s' kualifikuar 2 OE duke rezultuar fitues kështu B.N & A.K.

Në përfundim të vlerësimit të KVO nga ana e BOE V. I. & V. I.I. & A. A. janë ndjekur hapat e ankimit deri në KPP i cili, sipas shkresës së dërguar në AK me nr. 5753/2 prot., datë 23.08.2019, ka përcjellë Vendimin nr. 556/2019 sipas të cilit nuk është marrë në konsideratë ankesa e BOE V. I. & V. I.I. & AL A. për s' kualifikimit e duke lejuar kështu AK të vijojë procedurat.

Pas miratimit të Raportit Përmbledhës të Procedurës nga ana e ish Titullarit sipas shkresës nr. 2704/25 prot., datë 23.08.2019 është edhe njoftimi i BOE fitues sipas shkresës nr. 2704/26 prot., datë 23.08.2019. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në lidhje me këtë procedurë prokurimi është bërë kallëzim penal nga ana e subjektit C.N.në datë 23.09.2019 me nr. 7087 për veprën penale të *Shpërdorimit të Detyrës, Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*. Në përfundim të hetimeve, sipas vendimit me nr. 5080 regj. them., datë 13.11.2019, datë vendimi nr. 16.12.2019, është pushuar procedimi i regjistruar.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave për dy procedurat me objekt "Loti 3 Argjinatura mbrojtëse Zalli i Sinës" dhe "Loti 5 Mbrojtje nga Lumi Vjosë, në Kashisht" nga ana e anëtarëve të KVO është dërguar përmes postës elektronike observacioni i datës 26.07.2023. Në përfundim të shqyrtimit, Grupi i Auditimit merr në konsideratë observacionin pas saktësisht të metodologjisë së përdorur gjatë vlerësimit të ofertave, por pavarësisht kësaj, sqarojmë se në vijimësi duhet patur në konsideratë fakti se, praktikisht OE pjesëmarrës të një bashkimi operatorësh ekonomikë, kontribuojnë me mjete staf dhe kualifikime sipas pjesës së punimeve/furnizimeve/shërbimeve të marra përsipër në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit. Kjo do të thotë se kriteret nuk duhet të konsiderohen si të përmbushura nëse plotësohen nga kushdo OE, por vetëm nëse ato përmbushen nga ai OE, nga ana e të cilit dëshmohet disponimi i kualifikimit/stafit/mjetit etj. që duhet për realizimin e pjesë korresponduese të kontratës së punimeve/furnizimeve/shërbimeve.

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të vendosjes së kriterëve.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara për 5 nga 6 lotet e procedurës së prokurimit me objekt "Rehabilitim dhe mbrojtje lumore (e ndarë në 6 lote)", REF-19871-04-26-2019 , rezulton se disa prej kriterëve të vendosura janë të paargumentuara teknikisht. Konkretisht rezulton se nga ana e NJP janë kërkuar staf inxhinierik për të cilët nuk rezulton të ketë një sqarim në lidhje me diferencimin mes stafit të kërkuar si pjesë e listës së drejtuesve teknik dhe atyre të kërkuar si staf mbështetës. Gjithashtu, janë kërkuar inxhinierë të profileve të ndryshme pa bërë asnjë lloj analize teknike mbështetur në volume dhe në afate. Gjithashtu në lidhje me Audituesin Mjedisor të vendosur rezulton se kjo kërkesë (<i>e cila i referohet Certifikatës Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor</i>) është një dokument i cili lëshohet nga Ministria e linjës (Neni 24 i ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 ' <i>Për vlerësimin e ndikimit në mjedis</i> '). Ky ekspert, sipas nenit 6 <i>Përkufizime</i> , pikës 18 të ligjit si më sipër, është personi fizik, i cili

	<p>pajiset me certifikatën përkatëse nga Ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor. Në fakt, në nenin 1 <i>Qëllimi</i>, ky ligj ka cituar se:</p> <p><i>‘Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:</i></p> <p><i>a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;</i></p> <p>Pra, nga sa më sipër rezulton se procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, është një fazë e cila ezaurohet përpara miratimit të Projektit dhe pasi Projekti është miratuar, marrë në dorëzim dhe nuk duhet të vendoset si kriter për firmat sipërmarrëse që do të marrin pjesë në procedurë. Gjithashtu, për sa i takon mjeteve të kërkuara, rezulton se nuk ka asnjë sqarim konkret për të argumentuar numrin dhe kapacitetet e tyre por vetëm një përshkrim të përgjithshëm.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”:</p> <p>“Qëllimi i këtij ligji është:</p> <p>b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</p> <p>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;</p> <p>dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”</p> <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar:</p> <p>Neni 26, “Kontratat për punë publike”:</p> <p>“3) Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës;</p> <p>5) Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.</p> <p>Neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”:</p> <p>“3) Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.”</p>
Ndikimi:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me nevojat e shërbimit ndikon në konkurrencën e lirë e të ndershme si dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve të MBZHR.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të NJP si dhe mungesa e kontrolleve nga niveli drejtues i institucionit.
Rëndësia:	E mesme.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të merren masa për argumentimin e kriterëve të vendosura në procedurat e prokurimit si dhe përzgjedhjen e tyre në raport

	me nevojat e investimeve me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efiçencës dhe ekonomikitet.
--	---

Në lidhje me auditimin e procedurave për vitin 2020, u shqyrtua dokumentacioni fizik dhe elektronik mbi procedurat e prokurimit të parashikuara dhe realizuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (këtu e më poshtë: MBZHR), për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, (ri auditim) si më poshtë:

- Shkresat dhe Urdhrat e titullarit të AK mbi caktimin e personave përgjegjës për prokurimet;
- Regjistrat e Parashikimit për periudhën objekt auditimi;
- Regjistrat e Realizimit për periudhën objekt auditimi;
- Të dhënat e Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) të APP-së, për MBZHR.

Personi Përgjegjës për Prokurimet

Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP) për gjithë vitin kalendarik 2020, me anë të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm, nr. 1, nr. 91 prot., datë 08.01.2019, është caktuar z. E. M.

Me urdhër nr. 2, të Sekretarit të Përgjithshëm nr.92/ prot, datë 08.01.2020, është krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. Q.anëtare,
3. Znj. L. I., anëtare.

Me urdhër nr. 3, të Sekretarit të Përgjithshëm, nr.92/1, prot, datë 08.01.2020, është ri krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. Q., anëtare,
3. Znj. L. I., anëtare.

Me urdhër nr. 33, të Sekretarit të Përgjithshëm nr.92/2, prot, datë 22.01.2020, është krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. Q., anëtare,
3. Z. E.M., anëtar.

Me urdhër nr. 34, të Sekretarit të Përgjithshëm, nr.92/3, prot, datë 22.01.2020, është ri krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. Q., anëtare,
3. Z. E.M., anëtar

Me urdhër nr. 77, të Sekretarit të Përgjithshëm, nr.92/4, prot, datë 14.02.2020, është ri krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Z. E.M.
3. Znj. L. I., anëtare.

Me urdhër nr. 114, të Sekretarit të Përgjithshëm, E. H., nr.92/5, prot, datë 03.03.2020, është ri krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. znj. M. Q., anëtare,
3. Znj. L.I., anëtare.

Me urdhër nr. 115, të Sekretarit të Përgjithshëm, Enea Hoti, nr.92/6, prot, datë 03.03.2020, është ri krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar

2. znj. M. Q., anëtare,
3. Znj. L. I., anëtare.

Për vitin 2020 në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë zhvilluar në total 35 procedura me vlerë 1,443,331,822 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 1,304,667,138 lekë, nga të cilat:

- 9 procedura të hapura me vlerë 1,396,303,350 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 557,244,142 lekë.
- 12 procedura blerje të vogla me vlerë 7,550,000 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 5,043,641 lekë.
- 1 procedurë blerje biletash me vlerë 6,800,000 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 185,290 lekë.
- 3 procedura shërbim konsulence me vlerë 12,778,333 të fondit limit dhe vlerë kontrate 12,640,000 lekë.
- 7 procedura kërkesë për propozim me vlerë 19,600,139 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 17,282,364 lekë.

Në procedurat e prokurimit pa përfshirë ato “blerje me vlerë të vogël”, të trajtuara më lart, me të dhënat e paraqitura tek seksioni “Anekse”, nr. 2.6, bashkëlidhur këtij raporti, të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (vlera më e lartë e kontratës së lidhur), nuk u konstatua asgjë nga auditimi për t’u shënuar, që të përbëjë mospërputhje me kriteret për prokurimin publik.

I. Auditimi i Procedurës së hapur me objekt “Studim fizibiliteti me objekt “Fuqizimi prognozë-sinjalizimet në bujqësi nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative në kuadër të zhvillimit ekonomik rajonal” me fond limit në vlerës prej 68,000,000 lekë pa TVSh. (viti 2020).

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Studim fizibiliteti me objekt “Fuqizimi prognozë-sinjalizimet në bujqësi nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative në kuadër të zhvillimit ekonomik rajonal”		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 325, me nr. 6507/1 prot datë 19.08.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M. 2. O. G. 3. L. I. 4. E. V. 5.D. M. 	<p>3. Urdhër i brendshëm nr.479, me nr.10318 prot datë 23.11.2020 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, afatin e realizimit si dhe llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Studim fizibiliteti me objekt “Fuqizimi prognozë-sinjalizimet në bujqësi nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative në kuadër të zhvillimit ekonomik rajonal” me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M. 2. B.R. 3. L. I. 4. E.V. 5. D. M. 	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 484, me nr. 10318/2 prot datë 26.11.2020, me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M.kryetar 2. E.T., anëtar 3. L. G., anëtare 4. A.M. anëtar 5. M. Q.anëtare
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur - Shërbime”</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) 67,915,000 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) Lekë pa TVSh.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratë është 62,500,000 (gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSh dhe 75,000,000 (shtatëdhjetë e pesë milion) Lekë me TVSh.</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 5,415,000 (pesë milion e katërqind e pesëmbëdhjetë mije) lekë pa TVSh dhe 6,498,000 (gjashtë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lek me TVSh.</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 14.09.2020, ora 10:00</p>	<p>9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2020-2021</p>	<p>10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1.B.O.E. “A.- A. D. M.” ShPK & “I.” ShPK me ofertë 62,500,000 lekë pa TVSH 2. “Operatori Ekonomik “Gj. & CO” ShPK me ofertë 62,345,970 lekë pa TVSh.</p>
<p>11. Ankimime Pranë AK- nuk ka</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka</p>	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka</p>
<p>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi</p>		

<p>14. Lidhja e kontratës me nr. 6507/9 datë 07.10.2020 dhe përfundon 16 javë nga nënshkrimi i kontratës, pra më datë 27.01.2021.</p>	<p>15. Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhrin nr. 402, me nr. 6507/11 prot datë 07.10.2020 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratë me përbërje: 1. L.G. 2. A.M. 3. E. K. 4. A.Dh. 5. O.G. Sipas kontratës janë përcaktuar afatet për secilin raport të cilat janë dokumenter me procesverbale nga grupi punës si më poshtë: 1. Në datë 21.10.2020 Kontraktuesi dorëzoi raportin fillestar me nr. prot 6507/12. Komisioni në zbatim të urdhrin të titullarit verifikoi raportin e dorëzuar. Komisioni, pas analizimit të raportit në datë 26.10.2020 konfirmoi realizimin e raportit fillestar sipas përcaktimeve të kontratës dhe specifikimeve teknike/termave të referencës dhe e miraton atë, duke vendosur dërgimin e sugjerimeve kontraktuesit për ti përfshirë në fazat e tjera të realizimit të kontratës. 2. Në datë 01.12.2020 Kontraktuesi dorëzoi raportin afatmesëm me nr. prot 6507/14. Komisioni në zbatim të urdhrin të titullarit verifikoi raportin e dorëzuar. Komisioni, pas analizimit të raportit në datë 07.12.2020 konfirmoi realizimin e raportit afatmesëm sipas përcaktimeve të kontratës dhe specifikimeve teknike/termave të referencës dhe e miraton atë. 3. Në datë 23.12.2020 Kontraktuesi dorëzoi draft-raportin final me nr. 11359 prot. Komisioni në zbatim të urdhrin të titullarit verifikoi raportin e dorëzuar. Komisioni, pas analizimit të raportit në datë 28.12.2020 konfirmoi realizimin e draft-raportin final sipas përcaktimeve të kontratës dhe specifikimeve teknike/termave të referencës dhe e miraton atë. 4. Në datë 18.01.2021 Kontraktuesi dorëzoi raportin final me nr. 460 prot. Komisioni në zbatim të urdhrin të titullarit verifikoi raportin e dorëzuar. Komisioni, pas analizimit të raportit në datë 22.01.2020 konfirmoi realizimin e raportit final sipas përcaktimeve të kontratës dhe specifikimeve teknike/termave të referencës dhe e miraton atë. Shënim: Për të dyja temat për të cilat është kryer ky shërbim buxheti i shtetit ka alokuar fonde për implementimin e tyre në buxhetin 2021.</p>
--	--

Kjo procedurë është ndërmarrë për tu zhvilluar nga MBZHR, në cilësinë e AK, bazuar në strategjinë e zhvillimit bujqësor, në përmbushje të politikave të qeverisë shqiptare, për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore, krijimin e mundësive për zhvillimin e kapaciteteve rajonale të përdorimit të teknologjive të reja në bujqësi dhe shërbimet në luftën kundër dëmtuesve në bujqësi, informim i fermerëve nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve ndaj pemëve frutorë, arorë, vajorë etj.

- MBZHR, me urdhër të Titullarit të AK nr. 318, nr. prot.6507/1 datë 11.08.2020 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, afatin e realizimit dhe llogaritjen e fondit limit” dhe më pas me Urdhër prokurimi nr.325, nr. prot.6507/2 datë 19.08.2020, është përcaktuar lloji i procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur-shërbime”.

Burimi i financimit, për vitin 2020 janë vënë në dispozicion 46,666,666.7 lekë pa TVSh, për vitin 2021 sipas PBA 2021 -2022 janë vënë në dispozicion 21,248,333 lekë pa TVSh.

-Nga auditimi u konstatua se, në lidhje mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, duke u mbështetur mbi tipologjinë e objektit dhe qëllimin kryesor që ka të bëjë me studim fizibiliteti për sinjalizimin në bujqësi, nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative, nga AK duhej të kishte përdorur llojin e procedurës “Shërbim konsulentë” sipas nenit 37 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik “i ndryshuar, ku citohet se:

Neni 37 Shërbimet e konsulencës:

Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nën konsulence, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur.

-Gjithashtu, nëse AK, nëse do të përdorte “Shërbim Konsulentë”, gjatë përgatitjes së preventivit të kostos dhe buxhetit, që bazohet në vlerësimin që AK u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën konkretisht (kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe in puti fizik), kostoja duhej të ndahej në dy kategori, (i) tarifatat dhe (ii) rimbursimet. Gjithashtu,

përlllogaritja e fondit limit duhet argumentohet dhe dokumentohet, sipas përcaktimeve të nenit 59 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

-Nga auditimi u konstatua se, njësia e prokurimit më përbërje (E. M., O. G., L.I. dhe E.V.dhe D.M.), më datë 19.08.2020, kanë hartuar dokumentet e tenderit, të cilat janë njoftuar më datë 19.08.2020 në SPE në app.gov.al me nr.REF-69109-08-19-2020, të cilat më pas nga asistenca e APP i është rekomanduar se duhet të saktësojnë/riformulojnë kriteret në vijim, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues apo që mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO.

Konkretisht:

1. Në pikën 3.2.3, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar “Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2019 pranë bashkisë/ve që OE ushtron aktivitetin e tij”.

Në lidhje me këtë kriter, për të pasur një informacion sa më koherent në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore, është sugjeruar që AK duhet të kërkojë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Në procedurë, nga AK janë evidentuar edhe kriteret të veçanta, të cilat konsiderohen se, në mënyrë direkt ose indirekte, mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, e për rrjedhim vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik ose edhe ligjor të nevojës për vendosjen e tyre apo saktësim/plotësim, (3.3.2 të kapacitetit teknik përvoja pune eksperience në projekte të ngjashme 15 dhe 10 vjet ; kontratat e punës; zv/drejtues projekti dhe përvojë si ekspert GIS)

Sa më sipër, AK duhet të mbajë në konsideratë që, në zbatim të përcaktimeve të nenit 61 të vendimit 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, citohet se:

Çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjorisht si dhe kur nga AK konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i dokumenteve të tenderit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurim publik” i ndryshuar, AK nuk duhet të anulohet procedurën, por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion OE, në DST të publikuara në SPE.

Nisur nga këto kushte, AK, (njësia e prokurimit) më datë 04.09.2020 ka argumentuar dhe miratuar ndryshimin e DST nëpërmjet Shtojcës nr.1 si dhe titullari i AK me Urdhër nr. 351 datë 04.09.2020 me shkresë nr.6507/5 prot datë 04.09.2020, ka pezulluar procedurën me objekt “Studim fizibiliteti me objekt “Fuqizimi prognozë-sinjalizimet në bujqësi nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative në kuadër të zhvillimit ekonomik rajonal” për ngarkimin e Shtojcës nr.1 sipas sugjerimeve të APP.

-Nga auditimi, i paraqitjes së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, u konstatua se,

Pjesëmarrës në procedurë janë paraqitur këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara, si vijon:

(1). BOE “me përbërje shoqëria “A. – A. D.M.” ShPK me NUIS L.....A dhe shoqëria “I.” ShPK me NUIS K.....P me ofertë ekonomike 62,500,000 lekë pa TVSh.

(2). OE “GJ. & CO” ShPK me NUIS K....5U me ofertë ekonomike 62,345,970 lekë pa TVSh.

Në bazë të dokumentacionit të përcjellë në SPE, është s’ kualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori ekonomik “GJ.& CO” ShPK për arsyet si vijon:

-Referuar dokumentacionit të publikuar në SPE në pikën 3.3.1 “Për kapacitetin teknik”, është kërkuar: “Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit (duke përfshirë shërbime të realizuara nga data 21.09.2017 deri ditën e hapjes së ofertave datë 21.09.2020) për kontratë/kontrata në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerësimit të kontratës që prokurohet.”

Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezultoi se operatori ekonomik në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- a). Formular Vlerësimi lëshuar nga AKUKIM për objektin “Lot 4- “Studim projektim i furnizimit me ujë për zonat bregdetare.” me vlerë të realizuar 15,600,000 lekë me tvsh, datë fillimi 26.04.2019 dhe datë mbarimi 22.07.2020 shoqëruar me dokumentacion referencë punimesh, akt marrëveshje, amendim kontrate.
- b). Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Divjakë për objektin “Hartim i Planeve të Detajuara Vendore në Njësitë Administrative Divjakë, Grabian.” me vlerë të realizuar 1,972,440 lekë me TVSH, datë fillimi 26.03.2018 dhe datë mbarimi 25.06.2018 shoqëruar me dokumentacion akt marrëveshje, faturë tatimore shitje nr. 40 datë 18.06.2018.
- c). Formular Vlerësimi lëshuar nga Sha. Ujësijellës Kanalizime Tiranë për objektin “Hartim i projekt – preventivit të zbatimit për sot dhe për perspektivën 25 vjeçare” me vlerë të realizuar 19,299,996 lekë me TVSH, datë fillimi 29.10.2018 dhe datë mbarimi 28.01.2019 shoqëruar me dokumentacion akt marrëveshje, procesverbal mbi dorëzimin e projekt zbatimit, fatura tatimore shitje nr. 98 datë 28.12.2018 dhe nr. 5 datë 27.02.2019.
- d). Formular Vlerësimi lëshuar nga ARRSH për objektin “Studim projektim: Plotësimi i By Passit Shkodër si pjesë e korridorit” me vlerë të realizuar 106,200,000 lekë me TVSh, datë fillimi 06.03.2017 dhe datë mbarimi 05.07.2018 shoqëruar me dokumentacion vërtetim punimesh, akt marrëveshje, amendim kontrate, fatura tatimore shitje nr. 52 datë 05.09.2017 dhe nr. 42 datë 28.06.2018, situacion nr. 1 dhe nr. 2.
- e). Akt marrëveshje ndërmjet operatorit ekonomik dhe MIE me objekt “Hartimi i planeve të përgjithshme Vendore për bashkitë Fushë Arrëz – Has – Bulqizë” me vlerë të realizuar 37,473,117.6 lekë me TVSH, shoqëruar me dokumentacion akt marrëveshje, faturë tatimore shitje nr. 16 datë 18.04.2019, faturë tatimore shitje nr. 3 datë 04.02.2019, faturë tatimore shitje nr. 90 datë 24.12.2018 dhe faturë tatimore shitje nr. 70 datë 29.10.2018.
- f). Formular Vlerësimi lëshuar nga AKUKIM për objektin “Lot 2- “Studim projektim i furnizimit me ujë për zonat bregdetare” me vlerë të realizuar 24,360,000 lekë me tvsh, datë fillimi 19.07.2019 dhe datë mbarimi 22.07.2020 shoqëruar me dokumentacion referencë punimesh, akt marrëveshje, amendim kontrate.

Nga analizimi i shërbimeve të realizuara në kontratat e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “GJ. & CO” ShPK, pjesëmarrës *rezulton se ato janë me natyrë të ndryshme nga shërbimet që ka prokuruar Autoriteti Kontraktor. Lloji i natyrës së kontratave të paraqitura nga operatori ekonomik hyjnë te kontratat e konkurs projektimit ose shërbime konsulence në fushën e investimeve për punë publike, duke mos plotësuar kriterin në pikën 3.3.1 “Kapaciteti teknik” dhe jo për natyrën e veçantë të kësaj procedure.*

Kështu, në referim të legjislacionit për prokurimin publik, KVO ka s’ kualifikuar OE, “GJ.& CO” ShPK, në bazë të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, duke shpallur fitues BOE “A.– A. D. M.” ShPK dhe “I.” ShPK” me ofertë ekonomike 62,500,000 (gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSh.

-Nga auditimi u konstatua se, për këtë procedurë nuk janë paraqitur ankesa as mbi dokumentet e tenderit dhe as mbi vlerësimin e ofertave. Nuk u konstatuan shkelje në vlerësimin e ofertave nga KVO.

-Nga auditimi u konstatua se, është lidhur Kontratë shërbimi me shkresë nr.6507/9 prot datë **07.10.2020** midis MBZHR dhe BOE “A. – A. D. M.” ShPK dhe “I.” ShPK” si dhe për monitorimin e kësaj kontrate është caktuar grupi i punës me Urdhër nr.402 datë 07.10.2020 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr. 6507/9 prot, datë 07.10.2020”.

Likuidimi i kontratës paraqitet në tabelën në aneksin sipas drejtimit 6 të PA, bashkëlidhur këtij RA.

II-Auditimi i Procedurës së Hapur, me 5 lote me objekt: Rehabilitim objekteve dhe mbrojtje lumore, i ndarë në 5 lote zhvilluar në maj 2020, në MBZHR.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- i. Loti 1 - “Rehabilitim hidrovoresh” me nr. REF-57519-05-06-2020;

- ii. Loti 2 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastrë - Tepelenë)” me nr. REF-57521-05-06-2020;
- iii. Loti 3 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 2 (qarku Fier - Vlorë)” me nr. REF-57523-05-06-2020;
- iv. Loti 4 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë - Elbasan – Durrës - Berat)” me nr. REF-57526-05-06-2020;
- v. Loti 5 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Veri (qarku Lezhë – Shkodër - Dibër)” me nr. REF-57528-05-06-2020;

Fondi limit për 5 lotet: 986,011,139.4 (nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë katër) **leke pa TVSh.**

-Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit nr.78 datë 17.02.2020 të Ministrisë të MBZHR “Për realizimin e procedurave të prokurimit publik të objekteve në Programin “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”, do të realizohen nga MBZHR në cilësinë e AK, duke përfshirë që nga njoftimi i kontratës deri në ndjekjen dhe zbatimin e punimeve, për rrjedhojë të gjitha Drejtoritë Rajonale të Bordeve të Ujitjes dhe Kullimit duhet të dërgojnë dokumentacionin e plotë (në formë shkresore dhe elektronike) si projektet preventivat, termat referencës, specifikimet teknike dhe afatet teknike dhe afatet e realizimit të kontratave.

-MBZHR, në bazë të planifikimit të regjistrit të parashikimeve për vitin 2020, por në vijim të Njoftimit nr. 2254 prot datë 12.03.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit publik, për shkak të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme si pasojë e Pandemisë Covid-19, i ka kërkuar APP më datë 28.04.2020, në formë elektronike miratimin për publikimin në SPE të procedurave të prokurimit, me arsyetimin si vijon, “*Duke parë rëndësinë e investimeve në përmirësimin e bujqësisë si dhe kompleksitetin e punimeve ndërtimore (Punime ndërtimore me natyrë hidrike si mbrojtje lumore, kanale ujitës, hidrovore etj.), pezullimi pa afat i publikimit të procedurave të prokurimit mund të shkaktojë mos realizim të investimeve. Afatet e zbatimit të këtyre punimeve detyrimisht duhet të jenë gjatë një periudhe me nivel sa më të vogël të prezencës së ujit në objektet përkatëse. Periudha më e mirë për të vijuar me zbatimin e punimeve (duke qenë se kanë zëra si germime në prezencë uji, përmirësim të mbrojtjeve lumore etj) është stina e verës në të cilën ka mundësi të shirave si dhe prani të vogël të nivelit të ujit në objektet e investimit.”*

Në përgjigje të kërkesës, po në datë 28.04.2020 është marrë nga APP, në formë elektronike, dakordësimi i realizimit të procedurave tenderuese.

-Nga auditimi u konstatua se, procedura sipas Loteve të mësipërme është anuluar dy herë, për shkak se:

1. Anulimi me Urdhër Prokurimi nr.170 datë 30.04.2020, me njësi prokurimi me përbërje (E. M., T. D.dhe M. Q.) në bazë të sugjerimeve të APP me arsyetimin, konkretisht sugjerimi i APP me të drejtë është se “*Procedura e publikuar është e organizuar me lote dhe është përcaktuar datë e ndryshme e zhvillimit të çdo loti. APP ka vendosur mos publikimin e njoftimit të procedurës pasi sugjeron që data e zhvillimit të çdo loti duhet të jetë e njëjtë me datën e përgjithshme të procedurës, në momentin e shpalljes së saj.”*

Referuar sugjerimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, nga AK i MBZHR është vendosur anulimi i procedurës, në bazë të Njoftimit të Anulimit 05.05.2020.

2. Anulimi me Urdhër Prokurimi nr. 178 datë 05.05.2020 me njësi prokurimi me përbërje (E.M., T. D. dhe M. Q.) në bazë të sugjerimeve të APP me arsyetimin konkretisht, AK i MBZHR ka vendosur të zhvillojë procedurën e hapur me mjete elektronike (pune) me objekt “Rehabilitim objektiv dhe mbrojtje lumore, i ndarë me lote” dhe referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, neni 33, pika 4/c ka vendosur që afati i pritjes së ofertave në kontratat e punëve publike të jetë 28 ditë. APP ka vendosur mos publikimin e njoftimit të procedurës pasi sugjeron që afati i pritjes së ofertave në kontratat e punëve publike duhet të jetë 30 ditë.

Referuar sugjerimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, nga AK i MBZHR është vendosur anulimi i procedurës, në bazë të Njoftimit të Anulimit 06.05.2020.

-Nga auditimi u konstatua se, procedura ka ri filluar me Urdhër Prokurimi nr.180 datë 06.05.2020, ku në bazë të procesverbalit të Njesisë së prokurimit, janë hedhur në SPE me REF-57517-05-06-2020, dokumentet e tenderit.

-Më datë 11.05.2020 operatori ekonomik "4 A." ShPK ka paraqitur ankesa pranë AK duke kërkuar modifikimin e Dokumenteve të Tenderit të publikuara për të gjitha Lotet e kësaj procedure prokurimi. AK në bazë të parashikimeve ligjore me anë të urdhrat të Titullarit, ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e ankesave përkatëse si dhe ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave. Komisioni i shqyrtimit të ankesave pasi ka shqyrtuar ankesat e paraqitura ka vendosur mospranimin e ankesave duke lënë në fuqi kriteret përcaktuara në dokumentet e tenderit të publikuara. Në datë 14.05.2020 OE "4A." ShPK u njoftua për mos pranimin e ankesave të paraqitura.

-Më datë 20.05.2020 OE "4 A." ka paraqitur ankesë për procedurën e mësipërme pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), i cili ka vendosur të pranojë pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik, në bazë të vendimeve të KPP me nr.243/3/2020; 244/3/2020; 45/3/2020; 246/3/2020; 247/3/2020. Me anë të vendimeve të datës 15.07.2020 KPP ka vendosur të mos heqë pezullimin e procedurës, pasi gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë kryer të gjitha modifikimet në përputhje me vendimet e KPP-së.

Sa më sipër, Njësia e prokurimit me përbërje (E. M., T. D. dhe M.Q.), ka ri marrë në shqyrtim kriteret e vendosura duke përgatitur Shtojcën nr.2 "Mbi modifikimin dhe ndryshimin e dokumenteve të tenderit".

Më poshtë po paraqesim ndryshimet e DT, të vendosura nga KPP për AK e MBZHR si pasojë e ankesës së operatorit ekonomik "4 A.":

(1) Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë: "*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë"*

-Në nenin 12 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se "*Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim"*

-Në nenin 21 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se "*Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.*

Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës.

Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos: a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të 11 paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive".

-Në nenin 46, pika 1 germa "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jo diskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

-Nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon ti drejtohet interpretimit logjik të normës juridike. Në vetë frymën e lex specialist LPP, vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- Në Republikën e Shqipërisë, marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar i cili në nenin 12 të tij parashikohen se kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në respekt të parashikimeve të lex specialis, kontrata e punës, në cilësinë e një marrëveshjeje që rregullon marrëdhëniet mes punëdhënësit dhe punëmarrësit. Rregullimet e mëtejshme mbi mënyrën e hartimit dhe formës të kontratës së punës rregullohen nga neni 21 i lex specialist, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i cili inter allia parashikon se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë.” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në asnjë rast nuk parashikohet domosdoshmëria për efekt vlefshmërie e nënshkrimit të kontratës së punës noteriale, por mjaftohet që kjo e fundit të jetë e lidhur me shkrim.

Sa më sipër, KPP gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor se kontratat e punës duhen noteriale, është kufizuese dhe shkakton diskriminim të panevojshëm të operatorët ekonomik pjesëmarrës. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriteret e kualifikimit duke hequr detyrimin që kontratat e punës duhet të jenë domosdoshmërisht noteriale.

(2) Referuar, preventivit të punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen nga ana e operatorëve ekonomikë të autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP gjykon se është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, për sa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit.

Ndërsa, për sa i takon kërkesës të autoritetit kontraktor se autorizimet/ kontratat e bashkëpunimit duhet të paraqiten për çdo objekt, Komisioni gjykon se është një kërkesë e

ekzagjeruar dhe tërësisht e panevojshme, pasi është e mjaftueshme nga një kontratë e vetme për secilin produkt për të tre objektet që do të punohet.

(3) Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

-Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi disponueshmërinë në mënyrë kumulative të nëntë drejtuesve teknik me kualifikime e Inxhinier Gjeolog (1); Inxhinier Ndërtimi (2); Inxhinier Ndërtimi profil transport (1); Inxhinier Hidroteknik (3), duke parashtruar argumente se këta të fundit nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Referuar, preventivit të punimeve të parashikuar, grafikut të punimeve, si dhe Udhëzimin nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku parashikohet se “Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi; 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi; 2.2 Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve”.

KPP konstaton se në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit drejtohet drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit, të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Në këto kushte, bazuar në faktin që punimet do të kryhen njëkohësisht në disa objekte (kantiere ndërtimi) dhe në vende të ndryshme të territorit të Shqipërisë, Komisioni gjykon se kërkimi i autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e personave përgjegjës, për drejtimin e punimeve për çdo nën objekt është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore sektoriale në fuqi, pasi bazuar në këtë legjislacionin, është e detyrueshme prezenca me kohë të plotë në objekt e drejtuesve të punimeve referuar vlerës së kontratës që prokurohet, **por kërkesa që drejtuesit e punimeve për çdo kantier duhet duhet të jenë detyrimisht drejtues teknik është një kërkesë e ekzagjeruar dhe kufizon konkurrencën në mënyrë të panevojshme**, pasi referuar udhëzimit të sipërcituar, për drejtimin e punimeve në kantier jo domosdoshmërisht duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke mos kërkuar detyrimisht drejtuesin teknik për drejtimin e punimeve për çdo kantier. Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi shumëfishimin e inxhinierëve dhe drejtuesve teknik të të njëjtit profil në mënyrë të pa justifikuar, KPP gjykon se ky pretendim nuk qëndron, pasi në objektet ku janë kërkuar në cilësinë e drejtuesit teknik, inxhinierët pjesë e stafit, nuk janë kërkuar në të njëjtin profil.

- Lidhur me kundërshtimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi numrin e inxhinierëve të mjedisit dhe gjeolog të kërkuar kumulativisht si pjesë e stafit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë tre inxhinierë

gjeolog dhe tre inxhinierë mjedisi. Referuar preventivit të punimeve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, grafikut të punimeve, Komisioni gjykon se numri i inxhinierëve gjeolog dhe mjedisi, nuk është në përputhje me volumet e parashikuara në preventiv për tu kryer. Komisioni gjykon se numri i inxhinierëve të kërkuar është i ekzagjeruar dhe i pajustificuar nga autoriteti kontraktor, kjo bazuar në zërat e preventivit, si dhe në distancën e objekteve nga njëri-tjetri. Komisioni thekson se, prezenca e inxhinierëve gjeolog dhe të mjedisit rezident në çdo objekt, nuk është e nevojshme, referuar karakteristikave të punës që do të kryhen në këto objekte dhe në raport me profilin e këtyre inxhinierëve.

(4) Lidhur me kundërshtimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi numrin e manovratorëve, shoferëve, teknikëve të ndërtimit, saldatorëve dhe hekurkthyesve të kërkuar kumulativisht, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë dymbëdhjetë manovratorë, tridhjetë e pesë shoferë, dhjetë teknik ndërtimi, dymbëdhjetë saldatorë dhe dymbëdhjetë hekur thyes. Referuar preventivit të punimeve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, grafikut të punimeve, si dhe bazuar në parashikimet e Vendimit nr.42 të Këshillit të Ministrave datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi” ku përcaktohet se: “c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera. ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mos ndjekjen e zbatimit të këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik.”, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit, kërkimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e dhjetë teknikë ndërtimi, dymbëdhjetë saldatorë dhe dymbëdhjetë hekur thyes, parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, si edhe kohëzgjatjen maksimale të kohës së punës referuar Kodit të Punës, nuk është një kërkesë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme. K.P.P. thekson se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë stafin e duhur për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Në këto kushte, KPP e vlerëson të drejtë pretendimin e ankimuesit dhe se autoriteti kontraktor duhet ri përlllogarisë numrin e inxhinierëve gjeologë, inxhinierëve të mjedisit, teknikëve të ndërtimit, saldatorëve dhe hekur thyesve, duke i ulur ato në përputhje dhe proporcion me volumet e parashikuara në kontratën objekt prokurimi.

Ndërsa lidhur me numrin e manovratorëve dhe shoferëve të kërkuar, Komisioni gjykon se për sa kohë numri i mjeteve do të ulet në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, atëherë edhe numri i këtyre punonjësve duhet të ulet në mënyrë proporcionale me numrin e mjeteve.

Konkluzion: Sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se, kriteret e mësipërme të vendosura nga njësia e prokurimit vështirësojnë përgatitjen e dokumentacionit të dokumenteve të tenderit, pasi rrisin koston në kohë dhe në burime njerëzore, por mbi të gjitha sjellin kufizimin të konkurrencës së operatorët ekonomikë që janë të interesuar për të qenë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Loti 1- “Rehabilitim hidrovresh”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 180, me nr. 3273 prot datë 06.05.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit	3. Projektet e zbatimit, ku përfshihen specifikimet teknike, afati i realizimit si dhe	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me

<p>për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M. 2. T.D. 3. M.Q. 	<p>llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit janë hartuar nga projektuesit.</p>	<p>urdhri nr. 181, me nr. 3273/1 prot datë 06.05.2020, me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A.M.kryetar 2. E. M. anëtar 3. E.T. anëtare
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur, me mjete elektronike”</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) 183.997,684,4 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër presje katër) Lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa TVSh) B.O.E. “A. K.” ShPK & “H.” ShPK & “M. Ltd” ShPK me vlerë 177,630,064.55 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 6,367,619.85 lekë (gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose sa 96,5 % e fondit limit.</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 27.07.2020, ora 10:00</p>	<p>9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2020-2021</p>	<p>10. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. B.O.E. “A.K.” ShPK & “H.” ShPK & “M. L.” ShPK me ofertë ekonomike 177,630,064.55 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH kualifikuar pasi ka paraqitur ofertën ekonomike ne përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. 2. Operatori Ekonomik “K. C.” ShPK nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
<p>11. Ankimime Pranë AK- • Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. – Operatori Ekonomik ankimues “4 –A.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur; - Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mos pranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “D.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK – Operatori Ekonomik ankimues “4 –A.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “F. K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “K.C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p>	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP – Operatori Ankimues “4 – A.” sh.p.k paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni I Prokurimit Publik me anë të vendimi trn. 243/2020 vendosi pranimin e pjeshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni I Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 243/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.</p>

<p>11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “I.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “F.K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “F. K.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “K. C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor Brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, I ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “K.C.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “Gj.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.</p>	<p>- Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p>	
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>14. Lidhja e kontratës me nr. 3273/22 datë 31.08.2020 dhe përfundon sipas grafikëve të punimeve për secilin objekt.</p>	<p>15. Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhër nr. 353, me nr. 6507/11 prot datë 08.09.2020 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M. 2. T.D. 3. E.Xh. 4. B.Ç. 5. E. J. 6. F.D. 	

Kane marre pjesë

1 Bashkimin e Operatorëve Ekonomik “A. K.” SHPK & “Hastoçi” SHPK & “M. LTD” SHPK 177.639.064.55 leke

2. K. C. ShPK ka paraqitur vetëm vërtetim për pagese detyrimesh dhe si rrjedhim është s’ kualifikuar.

Fitues BOE “A. K.” SHPK 48.3%-- “H.” SHPK 21% “M. LTD” SHPK 30.7%

Në DST kërkohet:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

Kriteri 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: 1- Vlera mesatare e xhiros së realizuar gjatë tre viteve të fundit financiar (2016,2017,2018) të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-albania.

Konstatohet se nga shoqëria “A.K.” ShPK është paraqitur vërtetimi nga DRT për vitet 2017-2018-2019 në kundërshtim me kriterin 2.2 të vendosur nga NJP.

Vërtetim xhiroje për vitin 2016 e lëshuar me 26.10.2017.

E njëjta situatë është edhe me shoqërinë “M. L.” ShPK nga e cila është paraqitur vërtetim për xhiron e realizuar për periudhën 2017-2018-2019.

Gjithashtu shoqëria H. ShPK ka paraqitur vërtetim nga DRTM Tiranë për periudhën 2015-2016-2017 jo në përputhshmëri me kriterin e sipërcituar si dhe vërtetimi i paraqitur është shumë i hershëm pra është i datës 08.02.2018 (2 vjet përpara zhvillimit të procedurës), ndërkohë dorëzimi i dokumentacionit është në qershor 2020. Subjekti për çdo periudhë ka të drejtë dhe detyrim të marrë pranë DRT përkatëse vërtetimin për situatën koherente të tij e cila është vazhdimisht e ndryshueshme nga pikëpamja statistikore. Kjo gjë për analogji me vërtetimin që po kjo shoqëri ka paraqitur nga DRTM për shlyerjen e detyrimeve i cili mban datën 13.07.2020, pra sikurse është marrë ky vërtetim duhet të ishin marrë edhe vërtetimet e tjera sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit ***për të dhënë besueshmëri në paraqitjen e dokumentacionit.***

Nuk u konstatuan shkelje në verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të veçanta dhe të përgjithshme të NJP. Në lidhje me sa më lart KVO duhet të tregohet më e kujdesshme për verifikimin e dokumentacionit dhe kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.

Pretendimi i subjektit sipas observacionit të ardhur me emailin e datës 26.07.202, ndër të tjera citohet se.....: Në DST kërkohet:2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

Kriteri 2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: 1- Vlera mesatare e xhiros së realizuar gjatë tre viteve të fundit financiar (2016,2017,2018) të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-albania. Nuk u konstatuan shkelje në verifikimin e plotësimit të kriterëve të tjera të veçanta dhe të përgjithshme të NJP. Në lidhje me sa më lart KVO duhet të tregohet më e kujdesshme për verifikimin e dokumentacionit dhe kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave.”...

Nga auditimi i dosjes elektronike për BOE fitues, u konstatua se: BOE e përbërë nga: S. ShPK 21.55%-; B.-M ShPK 17.84%; E. ShPK 13.82%; M. ShPK 20.57%; A.-M.ShPK 10.86% ; E. ShPK 15.46%, kanë nënshkruar kontratë bashkëpunimi me nr 1441, datë 24.04.2020. a) Në DST “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar pika 1, citohet se “Vlera mesatare e xhiros të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiar (2016, 2017, 2018) të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit që prokurohet. Për këtë kërkohet vërtetimi i xhiros për vitet 2016-2017-2018 nga të gjithë ofertuesit e BOE. Rezulton se për shoqëritë “E. A.” ShPK, E. ShPK, B. N ShPK nuk është paraqitur vërtetim xhiroje për vitin 2016. b) Për Taksat vendore mungon vërtetimi i detyrimeve të paguara për shoqërinë E. ShPK. Për sa më sipër, duke qenë se BOE operatorët ofertues kanë paraqitur dokumentacion me devijime të vogla, KVO në mbështetje të nenit 53/Shqyrtimi i Ofertave” të LPP, pika 1, duhet të kërkonte sqarim për plotësimin e dokumentacionit i cili nuk paraqet risk në zbatimin me sukses të kontratës. Sqarojmë se vërtetimi i xhiros i paraqitur nga O.E ka qenë për 3 vite, konkretisht vitin 2017-2018-2019. Referuar xhiros së viteve të njëpasnjëshme dhe faktit se përmbushet kriteri i xhiros mesatare në përputhje me % që ka secili operator, komisioni i vlerësimit sic e keni konstatuar edhe ju mospërmbushjet e sipërcituara i ka konsideruar devijime të vogla dhe ka vijuar me kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Gjithashtu për vitet përkatëse të paraqitura bashkimi i operatorëve i plotëson dhe tejkalon kriteret e kualifikimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Për sa ju observoni, ndani të njëjtin mendim me grupin e auditimit dhe sikurse jemi shprehur në RPA, ky fakt është konsideruar devijime të

vogla që nuk cenpjnë zbatimin me sukse të kontratës, por thjesht është dashur sqarim në kohë me operatorët ekonomikë sipas LPP.

Zbatimi i kontratës dhe likuidimi i kontratës LOTI I, Kontrata 3273/22 dt. 31.08.2020, jepen në aneksin bashkëlidhur këtij raporti, drejtimi 6.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Loti 2- "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastrë-Tepelenë)" REF-57521-05-06-2020		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 180, me nr. 3273 prot datë 06.05.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 1. E.M. 2. T.D. 3. M.Q.</p>	<p>3. Projekti i zbatimit, ku përfshihen specifikimet teknike, afati i realizimit si dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit janë hartuar nga projektuesit</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 181, me nr. 3273/1 prot datë 06.05.2020, me përbërje: 1. A. M. kryetar 2. E. M.anëtar 3. E.T. anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e Hapur, me mjete elektronike"</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) 221.647.514 (dyqind e njëzet e një milion e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) Lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa TVSh) B.O.E. "A.- S." ShPK & "R." ShPK & "A.- S." ShPK me vlerë 206,073,514.41 (dyqind e gjashtë milion e shtatëdhjetë e tremijë e pesëqind e katërbëdhjetë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 15,573,999.59 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë nëntë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 27.07.2020, ora 10:00</p>	<p>9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2020-2021</p>	<p>10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. B.O.E. "A.- S." SHPK & "R." SHPK & "A.-S." SHPK me ofertë ekonomike 206,073,514.41 (dyqind e gjashtë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH, kualifikuar. 2. B.O.E. "A. I.G. C." SHPK & "2T" SHPK & "V." SHPK me ofertë ekonomike 206,131,657.73 (dyqind e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, S kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.. 3. B.O.E."A. C." SHPK& "A." SHPK& "E.C.C." SHPK me ofertë ekonomike. 127,626,966.51 (njëqind e njëzet e shtatë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e një), s' kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.. 4. O.E "K. C." SHPK nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.</p>
<p>11. Ankimime Pranë AK- • Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. - Operatori Ekonomik ankimues "4 -AM" ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK - Operatori Ekonomik ankimues "4 -A." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues "D." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë</p>	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP -Operatori Ankimues "4 -A." sh.p.k paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 244/2020 vendosi pranimin e pjesëshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së</p>

<p>Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur; - Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “D.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “I.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “F. K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “F.K.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “K. C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “K.C.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “Gj.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>• Operatori Ankimues “4 –A.” ShPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 244/2020 vendosi pranimin e pjesëshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 244/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të</p>	<p>Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “F.K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “K.C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p>	<p>publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 244/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.</p>
---	---	---

vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.		
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
14. Lidhja e kontratës me nr. 3273/20 datë 28.08.2020 dhe përfundon sipas grafikëve të punimeve për secilin objekt.	15.Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhri nr. 353, me nr. 6507/11 prot datë 08.09.2020 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratë me përbërje : 1. E.M. 2. T.D. 3. E. Xh. 4. B. Ç. 5. E. J. 6. F. D.	

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rehabilitim objektesh dhe mbrojtje lumore, i ndare me lote”,
“Loti 2 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastrë - Tepelenë)”
Fondi limit: 221,647,514 (dyqind e njëzet e një milion e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Loti 2 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastrë - Tepelenë)”						
N r.	Emërtimi	Autori teti Prokurues	Koha e fillimit	Koha e përfundimit (Muaj)	Autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës	Autoriteti përfitues
1	Mbrojtje nga lumi i Kardhiqit në Palokastër	MBZH R	Me nënshkrimin e kontratës	3	MBZHR	DUK Fier
2	Mbrojtje nga lumi Drinos, Palokastër, Gjirokastrë			2		DUK Fier
3	Rrëshqitja Lekël			2		DUK Fier
4	Rehabilitim i V-2 (Dropull)			3		DUK Fier

Janë s’ kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. B.O.E. “A. C.” SHPK& “E.c. c.” SHPK& “A.” sh.p. k, S’ kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
2. B.O.E. “A. I.G. C.” SHPK& “V.” SHPK& “2T” SHPK’ kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
3. O.E “K.C.” SHPK nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga verifikimi i dosjes në SPE mbi dorëzimin e dokumenteve sipas kriterëve për BOE e sipërcituara grupi i auditimit kreu verifikimin përkatës nga ku rezultoi që subjektet janë s’ kualifikuar nga KVO në zbatim, në bazë të LPP neni 46/1 “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese”.

Në lidhje me BOE fitues: A.- S.” SHPK me NUIS J.....Ë, “R&T” me NUIS J.....G SHPK & “A.-S.” SHPK me NUIS J.....Ë me ofertë ekonomike 206,073,514.41 lekë (dyqind e gjashtë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) lekë pa TVSH; nuk u konstatuan shkelje në plotësimin e kriterëve sipas DST. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.08.2020.

Ankesa:

Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

Operatori Ekonomik ankimues “4 –A.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur;

Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “D.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “I.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “F. K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “F.K.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “K. C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “K.C.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “Gj.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ankimues “4 –A.” ShPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 244/2020 vendosi pranimin e pjesëshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 244/5/2020 pranoi

ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Për këtë procedurë nuk janë paraqitur ankesa mbi vlerësimin e ofertave.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës”

2 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastrë - Tepelenë)”			
Emërtimi	Financim 2020 Pa TVSh	Financim 2021 Pa TVSh	Totali Pa TVSh
Mbrojtje nga lumi i Kardhiqit në Palokastër	44.402.812	0	44.402.812
Mbrojtje nga lumi Drinos, Palokastër, Gjirokastrë	12.263.728	0	12.263.728
Rrëshqitja Lekël	99,861,427	0	99,861,427
Rehabilitim i V-2 (Dropull)	24.419.831	40.699.717	65,119,548
Totali	180,947,797	40,699,717,50	221,647,514

Zbatimi i kontratës, nga ana e likuidimit të faturave, LOTI II, Kontrata 3273/20 dt 28.08.2020, jepet në aneksin sipas drejtimit 6 të RPA bashkëlidhur këtij raporti.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Loti 3- “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 2(qarku Fier-Vlorë)”		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 180, me nr. 3273 prot datë 06.05.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <p>1. E.M. 2. T.D. 3. M.Q.</p>	<p>3. Projekti i zbatimit, ku përfshihen specifikimet teknike, afati i realizimit si dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit janë hartuar nga projektuesit.</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 181, me nr. 3273/1 prot datë 06.05.2020, me përbërje:</p> <p>1. A.M.kryetar 2. E.M.anëtar 3. E.T. anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur, me mjete elektronike”</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) 162.143.277 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e dyzet e tremijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa TVSh) B.O.E. “N. S.” ShPK & “B. II” ShPK & “B.-I.” ShPK & “B.” ShPK me vlerë 142,601,830 (njëqind e dyzet e dy milion e gjashtëqind e njëmijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 19,541,447 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e një mijë e katërqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 27.07.2020, ora 10:00</p>	<p>9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2020-2021</p>	<p>10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës:</p> <p>1. B.O.E. “N. S.” SHPK & “B. II” SHPK & “B.-I.” SHPK& “B.” SHPK me ofertë ekonomike 142,601,830 (njëqind e dyzet e dy milion e gjashtëqind e njëmijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, kualifikuar pasi ka paraqitur ofertën ekonomike ne përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. .</p> <p>2. B.O.E.“4 AM” SHPK& “E. K.” SHPK me përbërje shoqëria “4 AM” SHPK me ofertë ekonomike 144,304,602.96 (njëqind e dyzet e katër milion e treqind e katërmijë e gjashtëqind e dy pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, S’ kualifikuar për shkak se nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</p> <p>3. B.O.E. “A. I.G. C.” SHPK & “2T” SHPK & “V.” SHPK me ofertë ekonomike 145,942,053.93 (njëqind e dyzet e pesë milion e nëntëqind e dyzet e dymijë e pesëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, S kualifikuar për shkak se nuk</p>

		<p>plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</p> <p>4. B.O.E. "F." SHPK & "Sh. 07" SHPK & "G. K. M" SHPK & "B." SHPK & "Vëllezërit H." SHPK me ofertë ekonomike 96,369,421 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë e katërqind e njëzet e një), përfunduar pa vendim përfundimtar, pasi me anë të shkresës nr.264/1 prot, datë 07.08.2020 me lëndë "Njoftim për tërheqje nga procedurat e prokurimit të organizuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "përkatësisht në objektin:</p> <p>Loti 3 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 2 (qarku Fier - Vlorë)" me nr. REF-57523-05-06-2020;</p> <p>Loti 4 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë - Elbasan - Durrës - Berat)" me nr. REF-57526-05-06-2020"...., anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik "Sh.07" ShPK ka paraqitur kërkesë për tu tërhequr nga pjesëmarrja në këtë procedurë. .</p> <p>5. O.E "K. C." SHPK me NUIS K.....Ë nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.</p>
<p>11. Ankimime Pranë AK-</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. - Operatori Ekonomik ankimes "4 -A." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur; - Operatori Ekonomik ankimes "D." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "D." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimes "I." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK</p> <ul style="list-style-type: none"> - Operatori Ekonomik ankimes "4 -A." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimes "D." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. - Operatori Ekonomik ankimes "I." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. <p>Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Operatori Ekonomik ankimes "F. K." ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimes "K. C." ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimes "G." ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. 	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP –</p> <ul style="list-style-type: none"> • Operatori Ankimes "4 -A." ShPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 245/2020 vendosi pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publikime anë të vendimit nr. 245/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit. • Për këtë procedurë nuk janë paraqitur ankesa mbi vlerësimin e ofertave.

<p>29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “I.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “F.K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “F.K.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “K.C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “K.C.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “G.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p>		
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>14. Lidhja e kontratës me nr. 3273/25 datë 31.08.2020 dhe përfundon sipas grafikëve të punimeve për secilin objekt.</p>	<p>15. Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhri nr. 353, me nr. 6507/11 prot datë 08.09.2020 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratë me përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M. 2. T. D. 3. E.Xh. 4. B.Ç. 5. E.J. 6. F.D. 	

Për: Bashkimin e Operatorëve ekonomik “N.S.” SHPK(21.05 %) & “B.” SHPK(30.37 %) & “B. II” SHPK(17.82 %) & “B.-I.” SHPK(30.76%).

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Loti 3 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 2 (qarku Fier - Vlorë)"						
N r.	Emërtimi	Autoriteti Prokurues	Koha fillimit	Koha e përfundimit (Muaj)	Autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës	Autoriteti përfutues
1	Ura mbi kufizuesin e majtë, zona Libofshë	MBZHR	Me nënshkrimin e kontratës	2	MBZHR	DUK Fier
2	Mbrojtje nga lumi i Vjosës, krahu i djathtë, Pishë Poro			2		DUK Fier
3	Mbrojtje nga gërryerjet e lumit Seman në krahuin e djathtë të rrjedhjes, zona Toshkëz dhe Zhelizhan.			3		DUK Fier
4	Mbrojtje nga lumi Vjosë në Hekal, Mallakastër			3		DUK Fier
5	Rehabilitim i kanalit ujitës Armen			3		DUK Fier

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. B.O.E. "N. S." SHPK & "B. II" SHPK & "B.-I." SHPK & "B.-" SHPK me përbërje shoqëria "N. S." SHPK me NUIS L.....O, shoqëria "B. II" SHPK me NUIS L.....O, shoqëria "B." SHPK me NUIS J.R dhe shoqëria "B.-I." SHPK me NUIS K.....A me ofertë ekonomike 142,601,830 (njëqind e dyzet e dy milion e gjashtëqind e njëmijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH; është identifikuar si oferta e suksesshme.

2. B.O.E. "4A." SHPK & "E. K." SHPK me përbërje shoqëria "4A." SHPK me NUIS K.....L dhe shoqëria "E. K." SHPK me NUIS K.....I, me ofertë ekonomike 144,304,602.96 (njëqind e dyzet e katër milion e treqind e katërmijë e gjashtëqind e dy pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH; s' kualifikuar bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomik nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese", Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar BOE.

3. B.O.E. "A. I. G. C." SHPK & "2T" SHPK & "V." SHPK me përbërje shoqëria "A. I.G.C." SHPK me NUIS K.....I, shoqëria "2T" SHPK me NUIS K.....M dhe shoqëria "V." SHPK me NUIS K.....L, me ofertë ekonomike 145,942,053.93 (njëqind e dyzet e pesë milion e nëntëqind e dyzet e dymijë e pesëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH; s' kualifikuar pasi bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomik nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese", Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar BOE.

4. B.O.E. "F." SHPK & "Sh.07" SHPK & "G.K. M" SHPK & "B." SHPK & "V. H." SHPK me ofertë ekonomike të pavlefshme; s' kualifikuar bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomik nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese", Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s' kualifikuar BOE si dhe kërkesë për tërheqje nga procedura për Lotin 3 dhe Lotin 4 të , "Sh. - 07", SHPK

5. O.E "K. C." SHPK me NUIS K.....Ë nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, s' kualifikuar. Në lidhje me BOE fitues dhe dosjen elektronike të tij në SPE nuk u konstatuan mos përputhshmëri në plotësimin e kriterëve të veçanta të vendosura nga NJP.

Zbatimi dhe likuidimi i kontratës, LOTI III, Kontrata 3273/25 datë 31.8.2020, jepet në aneksin bashkëlidhur këtij RPA sipas drejtimit 6 të programit të auditimit.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Loti 4- "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë-Elbasan-Durrës-Berat)"		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 180, me nr. 3273 prot datë 06.05.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 1. E. M. 2. T. D. 3. M. Q.</p>	<p>3. Projekti i zbatimit, ku përfshihen specifikimet teknike, afati i realizimit si dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit janë hartuar nga projektuesit.</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 181, me nr. 3273/1 prot datë 06.05.2020, me përbërje: 1. A.M.kryetar 2. E. M. anëtar 3. El. T.anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e Hapur, me mjete elektronike"</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) 238.020.303 (dyqind e tridhjetë e tetë milion e njëzet mijë e treqind e tre) Lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratës është 220,246,551.83 (Dyqind e njëzet milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 17,773,751.17 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë lekë pa TVSH ose sa 92,5 % e fondit limit.</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 27.07.2020, ora 10:00</p>	<p>9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2020-2021</p>	<p>10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. B.O.E "S." Sh.P.K & "E." Sh.P.K & "B.N" SHPK & "A.-M." SHPK & "M." SHPK & "E.-A." SHPK me ofertë ekonomike 220,246,551.83 lekë (Dyqind e njëzet milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH. 2. O.E "K. C." SH.P.K nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 3. B.O.E. "F." SH.P.K & "Sh. 07" SH.P.K & "V. H." SH.P.K & "B." SH.P.K & "K." SH.P.K & "G. K. M" me ofertë ekonomike SH.P.K 140,305,907 (njëqind e dyzet milion e treqind e pesë mijë e nëntëqind e shtatë). 4. O.E. "K-A." SHPK nuk ka paraqitur ofertë ekonomike për të gjitha objektet.</p>
<p>11. Ankimime a) Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit.</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës a) Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. - Operatori Ekonomik ankimues "4 -A." SHPK në</p>	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP • Operatori Ankimues "4 -A." SHPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 246/2020</p>

<p>- Operatori Ekonomik ankimes "4 - AM" ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit.;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "D." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Operatori Ankimes "D." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "I." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "F. K." ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "K. C." ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "K. C." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "Gj." ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "Gj." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p>	<p>datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit.;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "D." ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Operatori Ankimes "D." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "I." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "F.K." ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "K.C." ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "K.K." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>- Operatori Ekonomik ankimes "G." ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimes "G." ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p> <p>• Operatori Ankimes "4 -A." ShPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 246/2020 vendosi pranimin e pjesëshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 246/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.</p>	<p>vendosi pranimin e pjesëshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 246/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.</p>
<p>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi</p>		
<p>14. Lidhja e kontratës me nr. 3273/28 datë 03.09.2020 dhe përfundon ...</p>	<p>15. Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhri nr. 353, me nr. 6507/11 prot datë 08.09.2020 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratë me përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E. M. 2. T. D. 3. E. Xh. 4. B. Ç. 5. E.J. 6. F. D. 	

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. B.O.E “me përbërje shoqëria “S.” SHPK me NUIS J....M, shoqëria “E.” SHPK me NUIS K....P, shoqëria “B.N.” SHPK me NUIS K....O, shoqëria “A.-M.” SHPK me NUIS K....B, shoqëria “M.” SHPK me NUIS L....C dhe shoqëria “E.-A.” SHPK me NUIS K....H me ofertë ekonomike 220,246,551.83 lekë (Dyqind e njëzet milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH është kualifikuar dhe është identifikuar si oferta e suksesshme.

2. O.E “K. C.” SHPK me NUIS K....Ë nuk pa paraqitur ofertë ekonomike.

3. O.E. “K-A.” SHPK me NUIS L.....C, me ofertë ekonomike të pavlefshme është s’ kualifikuar për arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë sipas kërkesave për kualifikim të kërkuara për këtë procedurë.

4. B.O.E me përbërje shoqëria “F.” SHPK me NUIS K....C, shoqëria “Sh. 07” SHPK me NUIS K....Ë, shoqëria “V. H.” SHPK me NUIS K....C, shoqëria “B.” SHPK me NUIS J....B, shoqëria “K.” SHPK me NUIS J....H dhe shoqëria “G.K.M” SHPK me NUIS L....T me ofertë ekonomike të pavlefshme; anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Sh.07” ShPK ka paraqitur kërkesë për tu tërhequr nga pjesëmarrja në këtë procedurë.

Nga shqyrtimi i kërkesës pranë Autoritetit Kontraktor, me anë të së cilës anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Sh. 07” ShPK kërkon të tërhiqet nga procedura e prokurimit objekt vlerësimi, Komisioni vëren se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Duke qenë se kjo situatë nuk rregullohet nga Ligji “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i drejtohet ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1, parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Komisioni gjykon se, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Sh.07” ShPK është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt vlerësimi. Tërheqja e një anëtari të bashkimit të operatorëve ekonomikë çon në prishjen/zgjidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe si pasojë mos ekzistencë të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Prishja e bashkimit të operatorëve ekonomikë sjell mos shqyrtimin/vlerësimin e ofertës së këtij bashkimi nga Autoritetit Kontraktor. Heqja dorë nga pjesëmarrja në procedurë nga bashkimi i operatorëve ekonomik si rrjedhojë çon në përfundimin e vlerësimit pa një vendim përfundimtar duke e bërë ofertën e paraqitur të pavlefshme në kuptimin material.

Ankesa:

Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

Operatori Ekonomik ankimues “4 –A.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur;

Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “D.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u

shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “I.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “F. K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “F. K.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “K. C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “K. C.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “Gj.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Operatori Ankimues “4 –A.” ShPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 246/2020 vendosi pranimin e pjesëshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 246/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Për këtë procedure është paraqitur 1 (një) ankesë në lidhje me vlerësimin e ofertave.

Operatori Ekonomik ankimues “K-A.” ShPK në datë 14.08.2020 ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor me numër hyrës protokollit 6591, brenda afateve ligjore të ankimimit për vlerësimin e ofertave. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës me numër protokollit 6591/3 datë 18.08.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar Operatorin Ekonomik “K-A.” ShPK për mospranimin e ankesës së paraqitur.

Operatori Ekonomik “K-A.” ShPK nuk e ka ushtruar të drejtën e tij për ankimim pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga auditimi i dosjes elektronike për BOE fitues, u konstatua se:

BOE e përbërë nga

1. S. ShPK 21.55%-
2. B.-M ShPK 17.84%
3. –E.ShPK 13.82%-
4. M.ShPK 20.57%-
5. A.-M. ShPK 10.86%

6. E. ShPK 15.46%,

kanë nënshkruar kontratë bashkëpunimi me nr 1441, datë 24.04.2020.

a) Në DST “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar pika 1, citohet se “Vlera mesatare e xhiros të realizuar gjate tre viteve te fundit financiar (2016, 2017, 2018) te jetë jo me e vogël se 50% e fondit limit që prokurohet. Për këtë kërkohet vërtetimi i xhiros për vitet 2016-2017-2018 nga të gjithë ofertuesit e BOE. Rezulton se për shoqëritë “E. A.” ShPK, E.ShPK, B.N ShPK nuk është paraqitur vërtetim xhiroje për vitin 2016.

b) Për Taksat vendore mungon vërtetimi i detyrimeve të paguara për shoqërinë E. ShPK.

Për sa më sipër, duke qenë se BOE operatorët ofertues kanë paraqitur dokumentacion me devijime të vogla, KVO në mbështetje të nenit 53/Shqyrtimi i Ofertave” të LPP, pika 1, duhej të kërkonte sqarim për plotësimin e dokumentacionit i cili nuk paraqet risk në zbatimin me sukses të kontratës.

Zbatimi i kontratës, LOTI IV, likuidimi i kontratës sipas situacioneve me nr. 3273/28 dt. 03.09.2020, jepet në aneksin bashkëlidhur këtij raporti sipas drejtimit 6.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Loti 5- “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Veri (qarku Lezhë-Shkodër-Dibër)”		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 180, me nr. 3273 prot datë 06.05.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 1. E.M. 2. T.D. 3. M. Q.</p>	<p>3. Projekti i zbatimit, ku përfshihen specifikimet teknike, afati i realizimit si dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit janë hartuar nga projektuesit</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 181, me nr. 3273/1 prot datë 06.05.2020, me përbërje: 1. A. M.kryetar 2. E.M. anëtar 3. E.T.anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur, me mjete elektronike”</p>		
<p>5.Fondi Limit (pa TVSh) 180.202.361 (njëqind e tetëdhjetë milion e dyqind e dymijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) Lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratë është 167,978,978 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) Diferenca është 12,223,383 (dymbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e tre mije e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 27.07.2020, ora 10:00</p>	<p>9.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2020-2021</p>	<p>10. Operatoret Ekonomike pjesëmarrës: 1. B.O.E. “U.” SHPK & “GJ.K.” SH.A& “N.2014” SHPK & “A.” SHPK & “U. N.” SHPK me ofertë ekonomike 167,978,978 (njëqind e gjashtë shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë; 2. B.O.E. “N.” SHPK & “S.M.O. U.” SHPK & “S.M.O. V.” SHPK & “M./S” SHPK me ofertë ekonomike 120,108,320.76 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetë e treqind e njëzet pikë shtatëdhjetë e gjashtë). 3. O.E “K.C.” SHPK me NUIS K....Ë nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.</p>

<p>11. Ankimime Pranë AK- • Për këtë procedurë janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. - Operatori Ekonomik ankimues “4 –A.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur; - Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “D.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “I.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “F. K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK - Operatori Ekonomik ankimues “4 –A.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur; - Operatori Ekonomik ankimues “D.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “I.” ShPK në datë 11.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “F.K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 15.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “K. K.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimimit për dokumentet e tenderit. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. - Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur.</p>	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP • Operatori Ankimues “4 –A.” ShPK paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 247/2020 vendosi pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor në përputhje me vendimet e KPP-së publikoi shtojcat nr.1 dhe nr.2. Komisioni i Prokurimit Publikime anë të vendimit nr. 247/5/2020 pranoi ndryshimet e kryera dhe vendosi heqjen e pezullimit, si dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit. • Për këtë procedurë nuk janë paraqitur ankesa mbi vlerësimin e ofertave.</p>
--	---	--

<p>paraqitur. Operatori Ankimues “F. K.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “K.C.” ShPK në datë 13.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor brenda afateve ligjore të ankimit për dokumentet e tenderit. Ankesa e tij u shqyrtua në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor vendosi mospranimin e ankesës së paraqitur. Me anë të shkresës datë 14.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “K. C.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik; - Operatori Ekonomik ankimues “Gj.” ShPK në datë 15.05.2020 paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor jashtë afateve ligjore të ankimit dhe për këtë arsye ankesa e tij nuk u pranua. Me anë të shkresës datë 18.05.2020 Autoriteti Kontraktor ka njoftuar mospranimin e ankesës së paraqitur. Operatori Ankimues “Gj.” ShPK nuk paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik;</p>		
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>14. Lidhja e kontratës me nr. 3273/31 datë 03.09.2020 dhe përfundon ...</p>	<p>15.Zbatimi i Kontratës: 15.1 Në bazë të kontratës është ngritur me urdhri nr. 353, me nr. 6507/11 prot datë 08.09.2020 komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratë me përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E. M. 2. T.D. 3. E. Xh. 4. B. Ç. 5. E. J. 6. F. D. 	

Në Lotin 5 është shpallur si oferta më e suksesshme BOE i përbërë:

1. shoqëria “U.” SHPK me NUIS K....Q (e caktuar me prokurë si përfaqësuese e bashkimit të operatorëve ekonomikë) e cila do të realizojë 22.5 % të punimeve,
 2. shoqëria “GJ. K.” SH. A me NUIS J....U e cila do të realizojë 26.09 % të punimeve,
 3. shoqëria “N. 2014” SHPK me NUIS L...L e cila do të realizojë 24.53 % të punimeve,
 4. shoqëria “A...” SHPK me NUIS L...I e cila do të realizojë 12.36 % të punimeve,
 5. shoqëria “U. N.” SHPK me NUIS J.....O e cila do të realizojë 14.52 % të punimeve.
- me ofertë ekonomike 167,978,978 (njëqind e gjashtë shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë; ose e thënë ndryshe me një diferencë prej 12,223,383 (dymbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, pra 93,2 % e fondit limit.

- Janë s’ kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “K. C.” ShPK për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm vërtetim “Pagim detyrimesh”.

Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 46/1 “Operatorët

ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mospranimin e ofertës ekonomike duke s kualifikuar Operatorin Ekonomik.

B.O.E. “N.” SHPK& “S.M.O. U.” SHPK& “S.M.O. V.” SHPK& “M.” SHPK s’ kualifikuar nga KVO, për një mori kriteresh të paplotësuara nga BOE të cilat janë të rëndësishme dhe cenojnë zbatimin e kontratës. Në s kualifikimin e këtij BOE nuk u konstatuan shkelje nga KVO, trajtuar hollësisht në akt konstatimin nr. 10, datë 26.05.2023.

Për këtë procedurë nuk janë paraqitur ankesa mbi vlerësimin e ofertave.

Njoftimi i Klasifikimit të BOE fitues është bërë në datë 05.08.2020.

Në lidhje me BOE, e cila është shpallur nga KVO si oferta më e suksesshme, sipas dokumentacionit të dorëzuar në SPE, nuk janë konstatuar devijime apo mos plotësim të kriterëve të vendosura nga NJP.

Zbatimi dhe likuidimi i kontratës sipas situacioneve. LOTI V, Kontrata 3273/31 dt. 03.09.2020 jepet në aneksin bashkëlidhur këtij raporti sipas drejtimit 6.

Konkluzion: AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së. Për çdo procedurë prokurimi Autoriteti Kontraktor të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në mirë administrimin e fonde buxhetore. Gjithashtu, kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, si dhe në çdo rast, ato duhet të argumentohen teknikisht dhe të gjejnë mbështetje ligjore. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.10, datë 26.05.2023.

Titulli i Gjetjes 1:	Auditimi i procedurave publike për periudhën në auditim nga 01.01.2019 deri më 31.03.2020, në AK e MBZHR.
Situata 1 :	<p>Nga auditimi i disa prej procedurave të realizuara nga MBZHR, në cilësinë e AK, respektivisht: për periudhën 2019-2020, dhe konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedura me objekt prokurimi: Organizim aktiviteti me temë "Shqipëria punon tokën". 2. Procedura prokurimit e hapur me objekt “Studim fizibiliteti me objekt “Fuqizimi prognozë-sinjalizimet në bujqësi nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative në kuadër të zhvillimit ekonomik rajonal”, me fond limit në vlerën prej 68,000,000 lekë pa tvsh. 3. Procedura e hapur me objekt “Rehabilitim objektsh dhe mbrojtje lumore, e ndarë në 5 lote me fond limit në vlerën prej 986,011,139.4 lekë pa TVSh. <ol style="list-style-type: none"> i. Loti 1 - “Rehabilitim hidrovoresh” ii. Loti 2 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastrë - Tepelenë)” iii. Loti 3 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 2 (qarku Fier - Vlorë)” iv. Loti 4 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë - Elbasan – Durrës - Berat)”

	<p>v. Loti 5 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Veri (qarku Lezhë – Shkodër - Dibër)” .</p> <p><i>u konstatua se, kanë pasur mangësi, në vendosjen e afateve të realizimit të procedurës, në vendosjen e kriterëve në hartimin e kriterëve kualifikuese/dokumenteve të tenderit të vendosura sipas llojit, vecorive, natyrën dhe volumin e objektit, të cilat janë ankimuar nga OE dhe evidentuar nga APP, dhe mbas rekomandimeve të saj janë reflektuar nga Njësia e prokurimit. Grupi i auditimit, konstaton se, kriteret e vendosura nga njësitë e prokurimit, kanë sjellë vonesa në përgatitjen e dokumentacionit të dokumenteve të tenderit, pasi kanë rritur koston në kohë dhe në burime njerëzore, si dhe përbëjnë risk të mundshëm duke i vendosur në pozitë jo të barabartë operatorët ekonomikë që janë të interesuar për të qënë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit ka si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.</i></p> <p>Nga auditimi procedurave të mësipërme nuk ka pasur ankimime në lidhje mbi kualifikimet dhe s’ kualifikimet e operatorëve ekonomikë, por vetëm për vendosjen e kriterëve të cilat janë të asistuar nga APP.</p>
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nei 43,63,66 dhe 72 si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe çdo bazë ligjore që është në fuqi në lidhje me fushën e prokurimeve.
Ndikimi/Efekti:	Rrisin koston në kohë dhe në burime njerëzore, por mbi të gjitha sjellin kufizimin jo të drejtë të konkurrencës pasi i vendos në pozitë jo të barabartë operatorët ekonomikë që janë të interesuar për të qënë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Shkaku:	Mosrespektimi i bazës ligjore për prokurimet publike
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	-AK i MBZHR, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. -MBZHR (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Titulli i Gjetjes 2:	Sigurimi i gjurmës së auditimit për shmangien e risqeve të mundshme në zbatimin me sukses të kontratave për punë publike, për periudhën në auditim nga 01.01.2019 deri më 31.03.2020, në MBZHR.
Situata 1 :	Nga auditimi i disa prej procedurave të realizuara nga MBZHR, në cilësinë e AK, respektivisht: për periudhën 2019-2020, dhe konkretisht: 1. Për procedurën “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”, gusht 2019. 2. Procedura e hapur me objekt “Rehabilitim objektsh dhe mbrojtje lumore, e ndarë në 5 lote me fond limit në vlerën prej 986,011,139.4 lekë pa TVSh.

	i. Loti 4 - “Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë - Elbasan – Durrës - Berat)” <i>u konstatua se, operatorët ekonomikë ofertues dhe njëkohësisht të shpallur fitues kanë paraqitur dokumentacion me devijime të vogla, për të cilat KVO në mbështetje të nenit 53/Shqyrtimi i Ofertave” të LPP, pika 1, duhej të kërkonte sqarim për plotësimin e dokumentacionit për të siguruar gjurmë auditimi dhe për të shmangur risqet e mundshme në zbatimin me sukses të kontratave për punë publike.</i>
Kriteri:	Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 1, si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Shmangie e risqeve të mundshme në zbatimin me sukses të kontratave për punë publike.
Shkaku:	Mungesa e gjurmës së auditimit.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi	AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’ kualifikim apo kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit për vitin 2021:

Personi Përgjegjës për Prokurimet.

Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP) për gjithë vitin kalendarik 2021, me anë të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm, z. E. H., nr. 16, nr. 243/ prot., 12.01.2021, është caktuar z. E.M.

Me urdhër nr. 17, të Sekretarit të Përgjithshëm nr.244, prot, datë 12.01.2021, është krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E. M., kryetar
2. Znj. L. I., anëtare,
3. Znj. M. Q., anëtare.

Me urdhër nr. 18, të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 245. prot, datë 12.01.2021, është krijuar për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. Q., anëtare,
3. Znj. L. I., anëtare.

Me urdhër nr. 18/1, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. M. E., nr. 245/1, prot, datë 13.07.2021, është ri krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E. M., kryetar
2. Znj. M. Q., anëtare,
3. Znj. D.M., anëtare.

Me urdhër nr. 207, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nr. 244/1, prot, datë 24.05.2021, është ri krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E.M., kryetar
2. Znj. M. Q., anëtare,
3. Znj. D.M., anëtare.

Me urdhër nr. 207/1, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nr.244/2, prot, datë 13.12.2021, është ri krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E. M., kryetar
2. Znj. D. M., anëtare
3. Z. F. B., anëtar

Me urdhër nr. 393, të Ministrit të MBZHR, nr. 6607, prot, datë 27.09.2021, ka kryer delegimin e kompetencave të Titullarit të AK, për procedurat e prokurimit në MBZHR, Sekretarit të Përgjithshëm. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit. Urdhri nr. 74, datë 11.02.2021, shfuqizohet.

- Për vitin 2021, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë zhvilluar në total 24 procedura me vlerë 1,838,050,723 lekë të fondit limit dhe vlerë kontrate 1,607,457,312 lekë, nga të cilat:

- 10 procedura të hapura me vlerë 1,821,780,993 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 1,143,814,248 lekë.
- 11 procedura blerje të vogla me vlerë 6,100,000 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 4,395,220 lekë.
- 1 procedurë blerje biletash me vlerë 1,000,000 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 81,000 lekë.
- 3 procedura kërkesë për propozim me vlerë 9,169,730 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 1,105,000 lekë.

Në procedurat e prokurimit pa përfshirë ato “blerje me vlerë të vogël”, të trajtuara më lart, me të dhënat e paraqitura tek seksioni “Aneksë”, nr. 2.6, bashkëlidhur këtij projekt –raporti, të cilat u përzgjodhën mbi bazë risku (vlera më e lartë e kontratës së lidhur), në vijim:

I. Auditimi i procedurës me objekt ”Mbrojtjen e gështenjës nga parazitë grerëza “Galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae” me fond limit në vlerën prej 22,050,000 lekë pa TVSh.

I TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË TENDERIT

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mbrojtjen e gështenjës nga parazitë grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae” në Qarkun Shkodër, Masivi i Reçit”		
<p>1. Urdhër Prokurimi, me nr. 175, nr. 3104/6 prot datë 23.04.2021, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. E. M. 5. P. L. 6. D.M. <p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur, me mjete elektronike” REF-93899-04-23-2021</p>	<p>Urdhër i Brendshëm nr. 168, me nr. 3104 prot, “Për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, afatin e realizimit si dhe llogaritjen e e fondit limit për procedurën me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga parazitë grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae” në Qarkun Shkodër, Masivi i Reçit”, me perberje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. E.M. 2. P. L. 3. D. M. 	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin, me nr 176, me nr.3104/7 prot datë 23.04.2021, me përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A.M., Kryetar 2. E. M., Anëtar 3. Rr. K., Anëtar
<p>4.Fondi Limit (pa TVSh) 22,050,000 (njëzet e dy milion e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) 22,040,000 (njëzet e dy milion e dyzet mijë) lekë pa TVSH</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 10,000 (dhjetë mijë) lekë pa TVSH.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 12.05.2021 ora 10.00</p>	<p>8.Burimi Financimi nga Buxheti i Shtetit 2021</p>	<p>9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. O.E A.” ShPK me NUIS M.H nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. 2. O.E. “K. 04” ShPK me NUIS K.....B nuk ka paraqitur ofertë ekonomike; 3. O.E. “G.A.C” ShPK me NUIS L.....A me ofertë të pavlefshme. 4. O.E. “Gj.-I.” ShPK me NUIS L.....P me vlerë prej 22.040.000 (njëzet e dy milion e dyzet mijë) lekë pa TVSH.

10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S' ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S' ka	11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S' ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S' ka	12. Përgjigje - S' ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
13. Lidhja e kontratës është bërë Nr. 3104/15 prot datë 02.06.2022	14.Zbatimi i Kontratës: Sipas Urdhrit Nr. 3104/17 prot., datë 02.06.2021 për ngritjen e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt: “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae”.	

Me Urdhër Prokurimi me nr. 3104/6 prot datë 23.04.2021, titullari i AK, Ministri i MBZHR, znj. M.E., ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae” ka miratuar Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT me përbërje:

1. E. M. Personi përgjegjës
2. P.L..
3. D. M.

dhe nëpërmjet urdhrit me nr 176, me nr.3104/7 prot datë 23.04.2021, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje:

1. A. M., Kryetar
2. E. M., Anëtar
3. Rr. K., Anëtar

Në lidhje me përgatitjen e fondit limit në zbatim të njoftimit nr. 2502, datë 09.04.2021 të APP, njoftimit nr. .2109, datë 24.03.2021, LPP nr. 162, datë 23.12.2020, dhe nenit 59, pika 2 e VKM nr.285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, është kryer përllogaritja e vlerësimit të kontratës ku AK, i është referuar çmimeve të kontratave të mëparshme (kontrata 29.05.2020) e realizuar nga MBZHR me të njëjtin objekt si dhe në zbatim të VKM nr. 232, datë 14.04.2021 “Për caktimin e MBZHR-së si organ qendror blerës për realizimin e procedurës me objekt” Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae”. Gjithashtu në memon e datës 02.02.2021, nga ish- SP, z. E. H. drejtuar ministres znj. M.E., jep informacion dhe argumente në lidhje me projekt-vendimin për “Për caktimin e MBZHR-së si organ qendror blerës për realizimin e procedurës me objekt” Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae”. Ndër të tjera MBZHR ka nënshkruar kontratën me UBT me objekt”.

Studim për identifikimin e zonës së prekur dhe mbrojtjen e gështenjës nga paraziti në qarkun e Shkodrës”.

Nga studimi i realizuar u identifikuan zonat e prekura dhe u përcaktua se mënyra më efektive për mbrojtjen e gështenjës në vendin tonë është mbrojtja me metoda biologjike, konkretisht paraziti “Torymus Sinensis”. Sipas studimit të UBT-së strategjia e luftimit kalon në disa faza dhe ka një shtrirje kohore 4-5 vjet e më shumë. Për vitin 2020, MBZHR realizoi ndërhyrjen duke luftuar këtë dëmtues në zonën e Reçit (rreth 450 ha) në bashkinë Malësi e Madhe.

Në lidhje me procedurën e sipër cituar, është kryer njoftimi i fituesit për: Operatorin Ekonomik “Gj.-I.” Shpk, me adresë: Rruga “Revolucioni Komunist Austrohungarez”, numër pasurie 15/974, Zona Kadastrale 8593, Kati i Pare, 4001, Shkodër me fond limit: 22,050,000 (njëzet e dy milion e pesëdhjetëmijë) lekë pa TVSH.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- O.E A.” ShPK me NUIS M.....H nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
- O.E. “K. 04” ShPK me NUIS K.....B nuk ka paraqitur ofertë ekonomike;

- O.E. “G.A.C” ShPK me NUIS L....A me ofertë të pavlefshme.
- O.E. “Gj.-I.” ShPK me NUIS L....P me vlerë prej 22.040.000 (njëzet e dy milion e dyzet mijë) lekë pa TVSH.

Janë s’ kualifikuar nga KVO, ofertuesit e mëposhtëm me këto argumente:

- Të s’ kualifikojë Operatorin Ekonomik “K. 04” ShPK me NUIS K.....B për arsye se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm *ekstrakti i regjistrimit tregtar, vërtetim i xhiros për tre viteve të fundit dhe vërtetim për taksat vendore*. Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 92 pika 3 “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*”, Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mos pranimin e ofertës ekonomike duke s’ kualifikuar Operatorin Ekonomik.
- Të s’ kualifikojë Operatorin Ekonomik “A.” ShPK me NUIS M....H për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedure.
- Të s’ kualifikojë Operatorin Ekonomik “G.A.C” ShPK me NUIS L.....A për arsye se nuk plotëson kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit dhe specifikimet teknike.
- Së pari në dokumentet e tenderit, në pikën 2 është vendosur kriteri kualifikues “*Operatori ekonomik të paraqesë dokumentacion që konfirmon statusin ligjor/certifikatën e regjistrimit të prodhuesit ku të specifikohet se lejohet tregtimi i insekteve përkatëse në një nga vendet anëtare të BE.*”

Për të plotësuar këtë kriter OE ka paraqitur vërtetimin nr. 2157 rep, datë 10.05.2021 ku është përkthyer një dokument me informacion për shoqërinë prodhuese, si dhe një dokument me informacionin/specifikime rreth produktit. Dokumenti i paraqitur nuk vërteton statusin ligjor/certifikatën e regjistrimit të prodhuesit ku të specifikohet se lejohet tregtimi i insekteve përkatëse në një nga vendet anëtare të BE, ***pasi nuk është i firmosur dhe vulosur nga autoritet autorizuese te vendeve anëtare të BE-së.***

Së dyti: Në bazë të specifikimeve teknike është kërkuar që mbrojtja të realizohet me anë të metodës biologjike duke përdorur grerëzën parazitoidë “*Torymus Sinensis*”. Në dokumentet e tenderit, në pikën 3 është vendosur kriteri kualifikues “*Operatori ekonomik të paraqesë certifikatën ose çdo dokument ekuivalent të produktit ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike te insekteve përkatëse.*”

Operatori ekonomik “G.A.C” ShPK për të plotësuar këtë kriter ka paraqitur vërtetimin nr. 2157 rep, datë 10.05.2021 ku është përkthyer një dokument me informacion për shoqërinë prodhuese, si dhe një dokument/specifikime me informacion rreth produktit ACTARA.

Nga dokumentacioni i paraqitur rreth produktit në bazë të specifikimeve të paraqitura nga vetë O.E. në SPE rezulton se është produkt kimik insekticid, konkretisht një kokërr e cila shpërndahet në ujë. Specifikimet e produktit të paraqitur, bien në kundërshtim me metodën biologjike të kërkuar në specifikimet teknike të publikuara nga Autoritetit Kontraktor në dosjen e tenderit. Sipas LPP, operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Ndryshimi i kërkesave si dhe specifikimeve nuk mund të bëhet nga asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Është Autoriteti Kontraktor ai që përcakton nevojat për shërbime/mallra/punë dhe operatorët ekonomik ata që paraqesin ofertat në përputhje me këto kërkesa ligjore.

Për më tepër, dhe vetë Operatori Ekonomik në deklaratën e ngarkuar në SPE me titull “*Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike...*” konfirmon se i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në DT dhe e vërtetojnë këtë me dokumentet e certifikata të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë. Nga shqyrtimi i SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument apo certifikatë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara

nga AK në Dokumentet e Tenderit të publikuara në SPE. Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të **LPP neni 92 pika 3 dhe nenit 38 të këtij ligji**. Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos mos pranimin e ofertës ekonomike duke s' kualifikuar Operatorin Ekonomik.

Njoftimi i Klasifikimit nga KVO është kryer në 17.05.2021

Nuk ka pasur ankesa për dokumentet e tenderit.

Në lidhje me s kualifikimet e OE-kë nga KVO u konstatua se është vepruar në përputhje me LPP, neni 92 pika 3.

Nga verifikimi i dosjes fizike të OE fitues dhe zbatimit të kritereve të përcaktuara nga NJP, u konstatua se:

1. Në seksionin 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika e., nga NJP kërkohet ndër të tjera që:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

e-Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Nga vërtetimi i debisë i OSHEE-2021-1432200-JO date 28.04.2021 i dorëzuar në MBZHR citohet se:

Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) zj. A. P., vërtetohet se kërkuesi GJ.-I. SHPK, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, rezulton se nuk ka kontratë për energjinë elektrike dhe për rrjedhojë ka në total 0 lekë detyrime.

Operatori ekonomik GJ.-I. SHPK në Qendrën Kombëtare të Biznesit deklaroi një numër të konsiderueshëm adresash që ushtron aktivitetin e tij. Në asnjë prej këtyre adresave nuk ka kontratë për energjinë elektrike si dhe asnjë kontratë qiraje në të cilën të shprehet që energjinë elektrike e paguan qiradhënësi.

- Në proces-verbalin e mbajtur për miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me datë 23.04.2021 është kërkuar që shoqëria të disponojë (kontratë qiraje/hua përdorje apo në pronësi) 1 mjet transporti në të cilën duhet të paraqiten leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracioni si dhe foto të dallueshme të mjetit.

Midis shoqërisë "GJ.-I. SHPK" dhe shoqërisë "N." SHPK është nënshkruar para noterit kontrata nr Rep. 1445 nr kol 355 date 03.05.2021 me objekt dhënien me qira të një automjeti furgon frigorifer. Në këto dokumente mungon policia e sigurimit dhe akti i kolaudimit të mjetit. Për sa më sipër, duke qenë se operatori ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim, në bazë të LPP neni 92/ Shqyrtimi I ofertave, pika 3, ku citohet se:

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

KVO duhet të kishte kërkuar sqarim nga OE për plotësim të dokumentacionit, pasi rezulton që kjo procedurë është e kryer për herë të dytë nga MBZHR ku rezulton i njëjti fitues.

Procedura e prokurimit është zhvilluar në datë 12.05.2021 dhe më datë 12.05.2021 është shpallur fituesi.

Në datë 02.06.2021 me nr. 3104/18 Prot është nënshkruar Plan Zbatimi i kontratës nr 3104/15 datë 02.06.2021 midis MZHBR dhe "GJ.-I. SHPK" Në DST citohet se:

Kohëzgjatja dhe ekzekutimi i kontratës 40 ditë nga nënshkrimi i saj. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate pra në 02.06.2021.

Me datën 02.06.2021 ka dalë Urdhri i Titullarit me nr 233, për ngritjen e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, i cili përbëhej nga:

z. Xh. Z., dhe z. Gj.T.

Konstatohet se në dokumentet e procedurës në datë 16.06.2021, komisioni i krijuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës ka mbajtur Proces-Verbalin e realizimit të kontratës të

shërbimit me objekt” Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti Grerëza Galeformuese”. Komisioni shprehet se: “Shërbimi është realizuar në mbështetje të faturës tatimore qe subjekti ka dorëzuar” faturën me nr. 388, datë 16.06.2021, e cila në përshkrimin e saj ka të përcaktuar qartë shërbimin e kryer nga OE për çdo element dhe konkretisht:

1. Trajnimi i fermerëve – vlera 2,204,000 lekë
2. Blerja e insektit—vlera 12,122,000 lekë
3. Transporti i insektit dhe ruajtja- 1,102,000 lekë
4. Shpërndarja e insektit- + vlerësimi i ecurisë së trajtimit të gështenjës- 2,204,000 lekë
5. Ruajtja dhe monitorimi i ecurisë-4,408,000 lekë.

Vlera totale e faturës rezulton 26,448,000 lekë me TVSh.

Në Proces-verbal shkruhet ndër të tjera: “.....se u realizua me sukses trajnimi i fermerëve vendas në lidhje me luftimin e parazitëve”, e cila pasqyrohet në raportin përmbledhës të zbatimit të kontratës sjellë nga OE më 16.06.202, ku janë të detajuara me fotot përkatëse gjithë procesi i mbrojtjes së gështenjës dhe listat e fermerëve me nënshkrimet përkatëse që janë pjesë e këtij procesi.

Nuk u konstatuan shkelje në procesin e zbatimit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara sipas LPP 162/2020.

II. Të dhënat e përgjithshme të tenderit.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitim i veprave te programit ujitje-kullim Rajoni Jug”, i ndarë me lote, Loti 1 “Rehabilitim i Hidrovorit te Karavastasë”		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr.258, me nr.4664 prot datë 18.06.2021, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <p>7. E.M. 8. E.J. 9. D.M.</p>	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur- Punë me mjete elektronike me nr. REF-98545-06-18-2021</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr.259 , me nr.4664/1 prot datë 18.06.2021, me përbërje:</p> <p>1. A. M., kryetar 2. E.M., anëtar 3. E. T., anëtare</p>
<p>4. Fondi Limit (pa TVSh) 276,589,335 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH,.</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratë është 241,065,283 (dyqind e dyzet e një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 35,524,052 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose sa 87 % e vlerës së fondit limit.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 16.07.2021, ora 10:00</p>	<p>8. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2021- 2022-2023</p>	<p>9. Operoret Ekonomike pjesëmarrës: I.B.O.E. “Sh.” SH.P.K me NUIS K....N & “G.P.G C.” ShPK me NUIS J....V, me ofertë ekonomike 241,065,283 (dyqind e dyzet e një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.</p>
<p>10. Ankimime Pranë AK: Nuk janë paraqitur ankesa për këtë procedurë prokurimi</p>	<p>11. Përgjigje Ankesës Nuk janë paraqitur ankesa për këtë procedurë prokurimi</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga KKP – Nuk janë paraqitur ankesa për këtë procedurë prokurimi</p>
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>13. Lidhja e kontratës është bërë pranë D.U.K Fier, me kohëzgjatje 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.</p>	<p>14. Zbatimi i Kontratës: Pranë D.U.K Fier.</p>	

Loti 1 - “Rehabilitim i hidrovorit te Karavastasë”;

Punime ndërtimi; Punime ndërtimi inxhinierie përveç urave, tuneleve, boshteve dhe nën kalimeve; Punime argjinature.

Fondi limit: 434,231,744 (katërqind e tridhjetë e katër milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e katër) **lekë pa TVSh.**

Nr	Emërtimi	Financim viti 2021	Financim PBA vitet 2022-2023	Totali
1	Loti 1 - Rehabilitim i Hidrovorit të Karavastasë	57,466,843	219,122,492	276,589,335
2	Loti 2 - Rikonstrukcion i Argjinaturës së Selevetit, Vlorë	48,333,333	109,309,076	157,642,409
3	Totali	105,800,176	328,431,568	434,231,744

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

B.O.E. “Sh.. & G.P.G. C.” SHPK, me përbërje shoqëria “Sh.” SHPK me NUIS K.....N, shoqëria “G.P.G. C.” SHPK me NUIS J....V me vlerë 241,065,283 (dyqind e dyzet e një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Nuk ka operatorë ekonomikë/ofertues të s’ kualifikuar.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sh. & G.P.G. C.” SHPK, me ofertë me vlerë totale prej 241,065,283 (dyqind e dyzet e një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme dhe është firmosur nga Titullari i AK, znj. M. E., sipas formularit fitues.

Procedura e prokurimit është zhvilluar në bazë të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Baza ligjore 4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetë deklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).

Nga verifikimi i dosjes elektronike dhe fizike të BOE fitues në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk u konstatuan devijime dhe kriteret ishin në përputhje me ato të vendosura nga NJP.

Në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 277\4 datë 10.09.2021 lidhur ndërmjet BOE fitues dhe AK në rastin konkret DUK Fier si dhe sipas urdhër shpenzimeve të likuiduara marrë nga Sektori i buxhetit dhe financës në MBZHR rezulton se deri në datë 19.12.2022 është likuiduar vlera 244,522,823 lekë, (pasqyruar në tabelën e mëposhtme) ndërkohë që afati sipas kontratës me nr. 277/4 dt. 10.09.2021 është 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës pra deri në 10.09.2022. Ka amendime të kontratave të cilat nuk na u vunë në dispozicion pasi i menaxhon DUK Fier, e cila ka përgjegjësinë dhe detyrën për monitorimin dhe zbatimin e kontratës. Pavarësisht kësaj, Institucioni Qendror MBZHR dhe konkretisht Drejtoria e Administrimit të Tokës dhe Ujërave/ Sektori i Programeve dhe Administrimit të Ujitje-Kullimit që në përbërjen e tij ka 4 inxhinierë sipas detyrave funksionale ndër të tjera ka:

b. Harton PBA për Programin Buxhetor “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” dhe monitoron në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës realizimin e tij.

c. Monitoron aktivitetin e ujitjes dhe kullimit pranë Drejtorisë së ujitjes dhe Kullimit.

h. Ndjek dhe kontrollon funksionimin e stacioneve të pompimit për kullimin e hidrovoreve dhe funksionimin e parkut të makinerisë së rëndë për mirëmbajtjen e infrastrukturës së kullimit dhe mbrojtjen nga përmbytja.

Kjo drejtori duhet të disponojë informacion periodik mbi zbatimin e kontratës, arsyet e amendimeve, argumentimin e vonesave në kryerjen e punimeve nga BOE fitues pasi këto do të jenë fakte të cilat duhet t'i shërbejnë AK në dhënien e sigurisë që një OE ofron për zbatimin e kontratave publike dhe pjesëmarrjen në procedura të tjera të prokurimit publik, veprime në kundërshtim me nenin 107 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës pika 1, pika 3, pika 4, pika 7 dhe neni 108 të VKM nr 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Zbatimi i kontratës "Rehabilitimi i Hidrovorit të Karavastasë", kontrata 277\4 datë 10.09.2021 jepet në aneksin bashkëlidhur këtij raporti sipas drejtimit 6.

III. Mbi auditimin e procedurës së hapur mbi kufirin e lartë monetar me objekt “Blerje karburant për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë”, me fond limit në vlerën prej 2,000,000,000 lekë pa TVSh, realizuar në vitin 2021.

Shpjegim për vlerën e fondit limit në planifikim.

Bazuar në ligjin 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, miratuar në datë 6 nëntor 2020, në nenin 11, është përcaktuar se:

“Kriteret bazë, masa e përfitimit, mënyra e përdorimit të fondit prej 1.000 milionë lekësh, të përcaktuar në programin buxhetor 04250 “Zhvillimi Rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agro industrial dhe marketingun” në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë, si dhe financimi i ngritjes së sistemit të shpërndarjes dhe monitorimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Pra sa me sipër në detajimin fillestar të buxhetit dhe referuar shifrave të PBA 2021-2023, skema e naftës për fermerët ka nisur me 1 miliard lekë në dispozicion. Nën synimin që numri i fermerëve përfitues të ishte 70 mijë, në regjistrin e parashikimeve është parashikuar fondi limit 2 miliard përfshirë **vitin 2021 dhe 2022**, sipas parashikimeve të produktit “Skema e naftës për bujqësinë” dhe referuar tavaneve në dispozicion.

000/lekë

Produkti	Skema e Subvencionit të naftës për bujqësinë			
Njësia Matëse	Numër përfituesish			
	2021	2022	2023	2024
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	19000	17500	18000	18500
Kosto totale (në lekë)	1.000.000	792.190.000	700.000.000	500.000.000
Kosto për njësi (në lekë)	45,268	45.268	38.888.89	27.027.03

Burimi i të dhënave, MBZHR, përpunuar nga grupi i auditimit.

MBZHR ka realizuar Procedurën e hapur, mbi kufirin e lartë monetar me objekt “Blerje karburant për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë”, me fond limit në vlerën prej **2,000,000,000** lekë pa TVSh, me afat për kryerjen e shërbimit 12 muaj, duke lidhur Marrëveshje Kuadër.

-Burimi i Financimit, është miratuar me ligjin nr.137/2020 datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021, kjo sipas shkresës nr. 23724 datë 21.12.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi u konstatua se Qeveria Shqiptare, në mbështetje të sektorit të bujqësisë e cila ka nevojë për tu zhvilluar, pasi niveli i përdorimit të mekanikës bujqësore vazhdon të mbetet i ulët kur e krahasojmë edhe me vendet e rajonit, për këtë problem, sigurimi i naftës falas për fermerët shqiptarë, do të bëjë të mundur rritjen dhe zhvillimin e bujqësisë.

-Kështu në bazë të VKM nr.82 datë 14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara” për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime” i ndryshuar me VKM nr.889 datë 11.11.2020 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 82 datë 14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave

të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, ku i jep të drejtën MBZHR, të prokurojë karburantin për përdorim nga fermerët.

-Procedura e cila është mbi kufirin e lartë monetar sipas nenit 8 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 si dhe në bazë të nenit 5 “Publikimi i njoftimit të kontratës” pika 4 parashikon “Një përmbledhje e njoftimit të kontratës mbi kufirin e lartë monetar duhet të botohet edhe në të paktën një gazetë me shpërndarje të gjerë në Evropë”.

Për këtë AK e MBZHR, ka komunikuar me përfaqësuesit e “The Economist Group Business Representative” duke e publikuar për 42 ditë në Ekonomist on line, nga data 01.12.2020 deri në 11.01.2021.

- KVO e ngritur me Urdhër të titullarit të AK nr.484 datë 26.11.2020, si dhe në bazë të dokumentacionit ligjor financiar të paraqitur në app.gov.al me REF-80139-11-26-2020, ka shpallur fitues BOE “K.” ShPK dhe “K. Group” SH.A duke lidhur Marrëveshje Kuadër me shkresën me nr.827/2 prot datë 27.01.2021 .

-Procedura është realizuar në përputhshmëri me bazën ligjore të prokurimit publik Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë”.		
<p>1. Urdhër Prokurimi nr. 483, me nr. 10318/1 prot, datë 26.11.2020, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT. 1. E.M. 2. O. G. 3. L. I.</p>	<p>3. Urdhër i brendshëm nr. 479, me nr. 10318 prot datë 23.11.2020 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës, afatin e realizimit si dhe llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburant për përdorim nga fermerët në sektorin e bujqësisë” me përbërje : 1. E. M. 2. O. G. 3. L. I.</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 484, me nr. 10318/2 prot datë 26.11.2020, me përbërje: 1. A. M. kryetar 2. E. M. anëtar 3. L. G., anëtare 4. A.M. anëtar 5. E.K. anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur, mbi kufirin e lartë monetar”</p>		
<p>5. Fondi Limit (pa TVSh) 791,666,666.7 lekë.</p>	<p>6. Oferta fituese (pa tvsh) Vlera e pritshme e Marrëveshjes Kuadër është 791,666,666.7 (shtatëqind e nëntëdhjetë e një million e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e gjashtë pikë shtatë) Lekë pa TVSH dhe 950,000,000.04 (nëntëqind e pesëdhjetë million pike zero katër) Lekë me TVSH, me ofertë 17.4 % (shprehur në marzh fitimi)</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh).</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit Data 11.01.2021, ora 09:00</p>	<p>9. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit</p>	<p>10. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. B.O.E. “K.” ShPK & “K. G.” Sha me ofertë 17.4 % (shprehur në marzh fitimi). 2. “Operatori Ekonomik “E. – S.” ShPK nuk ka paraqitur ofertë. 3. Operatori Ekonomik “R. - ER” Sha nuk ka paraqitur ofertë.</p>
<p>11. Ankimime Pranë AK- nuk ka</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga AK –nuk ka</p>	<p>13. Përgjigje Ankesës nga KKP –nuk ka</p>
<p>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi</p>		
<p>14. Lidhja e marrëveshjes kuadër me nr. 827/2 datë 21.01.2021 me afat 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.</p>	<p>15. Zbatimi i marrëveshjes kuadër: 15.1 Në bazë të marrëveshjes kuadër është ngritur urdhri nr. 80, me nr. 827/4 prot datë 12.02.2021 për zbatimin, monitorimin dhe koordinimin e procesit që lidhet me skemën e mbështetjes së naftës për bujqësinë. 15.2 Në zbatim të marrëveshjes kuadër janë lidhur mini kontrata si vijon: - Mini kontrata nr. 1 me nr. 827/9 prot, datë 17.02.2021 me vlerë 2,161,003 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 2 me nr. 827/14 prot, datë 05.03.2021 me vlerë 1,905,770.96 lekë pa TVSh;</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> - Mini kontrata nr. 3 me nr. 827/19 prot, datë 25.03.2021 me vlerë 7,478,808.66 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 4 me nr. 827/24 prot, datë 02.04.2021 me vlerë 20,744,282.8 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 5 me nr. 827/29 prot, datë 08.04.2021 me vlerë 26,178,759.5 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 6 me nr. 827/34 prot, datë 14.04.2021 me vlerë 31,332,846.34 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 7 me nr. 827/39 prot, datë 16.04.2021 me vlerë 64,191,569.53 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 8 + amendament mini kontratë nr.8 me nr. 827/56 prot, datë 07.05.2021 me vlerë 83,310,651.64 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr, 9 + amendament mini kontrate nr. 9, me nr. 827/53 prot, datë 29.04.2021 me vlerë 85,507,662.36 lekë pa TVSh; - Mini kontrata nr. 10 me nr. 827/64 prot, datë 18.05.2021 me vlerë 90,363,073.17 lekë pa tvsh; - Mini kontrata nr. 11 me nr. 827/ prot, datë 02.06.2021 me vlerë 45,241,076.43 lekë pa tvsh; - Mini kontrata nr. 12 me nr. 827/ prot, datë 02.06.2021 me vlerë 45,241,076.43 lekë pa tvsh; - Mini kontrata nr. 13 me nr. 827/ prot, datë 02.06.2021 me vlerë 45,241,076.43 lekë pa tvsh; <p><i>*Shënim: Njësia e posaçme ka vendosur në dispozicion të Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve listat me aplikimet e miratuara të fermerëve. Në bazë të listave të miratuara nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve ka nënshkruar kontratat. Pas nënshkrimit të kontratës janë prodhuar kartat për fermerët përfitues dhe i janë dorëzuar Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, të cilat ia kanë shpërndarë fermerëve përfitues.</i></p>
--	---

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. O.E “E. – S.” ShPK me NUIS K.....K, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2. B.O.E. “K.” ShPK me NUIS J.....P & “K. G.” Sha me NUIS K.....V, me ofertë ekonomike 17.4 % (shprehur në marzh fitimi).
3. O.E. “R. - ER” Sha me NUIS L.....V, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Janë s kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

3. Operatori Ekonomik “E.– S.” ShPK, për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm vërtetim “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a” lëshuar më datë 22.07.2020.

4. Operatori Ekonomik “R. - ER” Sha, për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar për këtë procedurë. Nga ana e Operatorit ekonomik është paraqitur vetëm ekstrakt historik i shoqërisë shkarkuar nga sistemi më datë 07.08.2020.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “K.” ShPK & “K. G.” Sha** me ofertën e paraqitur me 17,4 % (shprehur në marzh fitimi), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Është kryer pagesa e sigurimit të kontratës në vlerën prej 95,000,000 (nëntëdhjetë e pesë milion) siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. **(13.01.2021)**

Ankesa: Në lidhje me kriteret e kualifikimit si dhe me vlerësimin e ofertave nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Për sa i përket procedurës së prokurimit nuk u konstatuan shkelje në përzgjedhjen e fituesit si dhe në plotësimin e Kritereve të Përgjithshme dhe të Veçanta të vendosura nga NJP.

Në lidhje me zbatimin e kontratës së lidhur sipas Urdhër Prokurimit me nr. 483, datë 26.11.2020, me nr. 827/9, datë 17.02.2021 dhe marrëveshjes kuadër me nr. 827/2, datë 27.01.2021, sipas nenit 1, ku citohet se:

1.2. AK do të kërkojë sasisë sipas nevojave që do të krijohen gjatë 12 muajve të zbatimit të marrëveshjes. Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e kërkesës tek operatori ekonomik, palë në marrëveshje duke specifikuar sasisë përkatëse.

Dhe nenit 6/Kushtet e pagesës, ku citohet se:

6.1 Pagesa do të bëhet veçmas për çdo anëtar të bashkimit të operatorëve ekonomikë sipas përqindjes që ka marrë përsipër të realizojë në kontratën e bashkëpunimit, konkretisht:

Anëtari “K.”, shpk, 80%,

Anëtari “K. G.”, SHA, 20%.

Në tabelën bashkëlidhur këtij raporti në aneksin sipas drejtimit 6 jepen realizimi i mini kontratave me gjithë elementët përkatës.

U konstatua se nga likuidimi i pagesave sipas faturave dhe urdhër shpenzimeve të detajuara kontrata është realizuar në vlerën 666,844,646 lekë pra sa 70,19 % e vlerës totale, nëse i referohemi vlerës totale të kontratës me TVSh e cila është 950,000,000.04 lekë. Gjithashtu u konstatua se nuk është zbatuar nga Sektori neni 6, pika 6.1 ku *Pagesa do të bëhet veçmas për çdo anëtar të bashkimit të operatorëve ekonomikë sipas përqindjes që ka marrë përsipër të realizojë në kontratën e bashkëpunimit, konkretisht:*

Anëtari "K.", shpk, 80%,

Anëtari "K.G.", SHA, 20%.

Nga verifikimi i urdhër shpenzimeve ndaj Kastrati shpk është kryer pagesa në vlerën 546,952,535 lekë ose sa 82 % e vlerës totale, ndërsa për "K.G.", SHA është kryer pagesa prej 119,892,111 lekë ose sa 18 % e vlerës totale të likuiduar. Pra ndaj K. G.", SHA, referuar kushteve të kontratës janë likuiduar 13,336,892.92 lekë më pak. Për sa më sipër u kërkua sqarim nga sektori i financës dhe buxhetit në MBZHR:

Blerje karburant për fermerët në sektorin e bujqësisë planifikuar në buxhet **950,000,000** lekë, fond i cili u pakësua me shkresën e MFE nr. 21918 datë 14.12.2021, akti normativ nr. 34 datë 03.12.2021 për **26,000,000** lekë.

Janë lidhur gjithsej 13 mini-kontrata. vlera e të cilave është **638,690,667** lekë dhe realizimi i tyre është **666,844,646** lekë ose realizuar në masën 97.5%.

Kontratat janë lidhur me dy operatorë ekonomik K. dhe K.G..

Operatori ekonomik Kastrati është planifikuar sipas kontratës me 80% të vlerës së saj dhe ka përfituar 80 % të pagesës së planifikuar, ndërsa operatori tjetër, K. G. është planifikuar 20% të kontratës dhe është realizuar në masën 17.54% të saj.

Të gjitha faturat janë lëshuar në emër të K. dhe për këtë fillimisht pagesat kaluan në emrin e këtij subjekti deri sa u përfituan 80 % të vlerës totale të kontratës.

Pas kësaj është kaluar me pagesën e operatorit tjetër që është K.G. e cila nuk u realizua në masën 20% por vetëm 17.54% pasi nuk u tërhoq e gjithë sasia e naftës së faturuar në emër të MBZHR- së nga fermerët, pasi sipas nenit nr.6, të kushteve të veçanta të kontratës, pika 6.3 citon se: "Pagesa për mallrat do të bëhet 30 ditë pas dorëzimit të raportit përkatës sipas sasive që çdo fermer ka tërhequr". Nuk u konstatuan mos përputhje në zbatimin e kontratës.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 11, datë 26.05.2023.

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit për vitin 2022:

Në zbatim të pikës 6 të *1175/1, prot., i ndryshuar, datë 11.01.2023*, u shqyrtua dokumentacioni fizik dhe elektronik mbi procedurat e prokurimit të parashikuara dhe realizuara nga Ministria e *Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, si më poshtë:

- Shkresat dhe Urdhret e titullarit të AK mbi caktimin e personave përgjegjës për prokurimet;
- Regjistrat e Parashikimit për periudhën objekt auditimi (2022);
- Regjistrat e Realizimit për periudhën objekt auditimi; (2022);
- Të dhënat e Sistemit të Prokurimeve Elektronike (SPE) të APP-së, për MBZHR.

Personi Përgjegjës për Prokurimet

Personi Përgjegjës për Prokurimet (PPP) për gjithë vitin kalendarik 2022, me anë të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm, z. O.M., nr. 4, nr. 83. prot., datë 07.01.2022, është caktuar z. E. M.

Me urdhër nr. 2, të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 81, prot, datë 07.01.2022, është krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E.S., kryetar
2. Z. E. M., anëtar,
3. Z. F.B., anëtar.

Me urdhër nr. 3, të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 82, prot, datë 07.01.2022, është krijuar komisioni për sistemin dinamik të biletave të transportit ndërkombëtar, i përbërë nga:

1. Z. E. S., kryetar
2. Z. E. M., anëtar,
3. Z. F. B., anëtar.

Me urdhër nr 218, të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 81/1. prot, datë 17.05.2022, është rikrijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël, i përbërë nga:

1. Z. E. S., kryetar
2. Z. E. M., anëtar,
3. Z. M. M., anëtar.

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al

Janë dërguar përkatësisht regjistrat e parashikimeve të prokurimit publik, dhe ndryshimet e tyre, drejtuar SP, dhe Degës së Thesarit, në zbatim të Ligjit nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Kreut I, nenit 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrat të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrat të realizimeve të procedurave të prokurimit publik dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, përkatësisht me nr. 505, datë 24.01.2022; nr. 505/1, datë 02.02.2022, nr. 505/5, datë 17.05.2022; 505/6, datë 17.05.2022; 505/7, datë 27.06.2022; 505/8, datë 27.06.2022; 505/9, datë 06.07.2022, 505/10, datë 06.07.2022;

505/11, datë 14.07.2022; 505/12, datë 14.07.2022; 505/13, datë 29.07.2022, 505/14, datë 29.07.2022; 505/15, datë 29.08.2022, 505/16, datë 29.08.2022; 505/17, datë 13.09.2022, 505/18, datë 13.09.2022; 505/19, datë 27.09.2022, 505/20, datë 27.09.2022, 505/21, datë 10.10.2022, 505/22, datë 10.10.2022.

Për vitin 2022, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë zhvilluar në total 33 procedura me vlerë 3,007,465,307 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 2,606,925,413 lekë, nga të cilat:

-16 procedura të hapura me vlerë 412,181,974 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 200,904,934 lekë.

-4 procedura Open INT me vlerë 2,576,333,333 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 16,982,448 lekë, nga të cilat 3 procedura janë me objekt: Blerje Karburant për rimbursimin e skemës së fermerëve me vlerë të fondit limit 1,708,333,333 lekë dhe vlerë realizimi 1,625,000,000 lekë.

-8 procedura të hapura e thjeshtë me vlerë 32,701,929 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 18,752,186 lekë.

-13 procedura blerje të vogla me vlerë 10,950,000 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 5,311,271 lekë

- 1 procedurë blerje biletash me vlerë 8,000,000 lekë të fondit limit, dhe vlerë kontrate 69,200 lekë

Në auditimin e dosjeve të përzgjedhura për auditim, janë konstatuar, trajtuar në vijim:

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt:

“Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae, zhvilluar në maj 2022.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae”		
<p>1. Urdhër Prokurimi , me nr. 1594/15 prot datë 17.05.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 10. E.M.Personi përgjegjës 11. V.B. 12. D. M.</p>	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur, Marrëveshje Kuadër 12 muaj, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara” REF-30022-05-19-2022</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin, me nr.2821/1 prot datë 20.05.2022, me përbërje: 1. E. S., Kryetar 2. G. H., Anëtar 3. S.P., Anëtar</p>
<p>4.Fondi Limit (pa TVSh) 27,427,512 (njëzet e shtatë milion e katërqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) 27,310,000 (njëzet e shtatë milion e treqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 117,512 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 06.06.2022 ora 10.00</p>	<p>8.Burimi Financimi nga Buxheti i Shtetit 2022</p>	<p>9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. “Gj.-I.” ShPK me NIPT: L.....P, me ofertë ekonomike 27 310 000 (njëzet e shtatë milion e treqind e dhjetë mijë) Lekë pa TVSH</p>
<p>10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S’ ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S’ ka</p>	<p>11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S’ ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S’ ka</p>	<p>12. Përgjigje - S’ ka</p>
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>13. Lidhja e kontratës është bërë Marrëveshje Kuadër Nr. 3159/2 prot datë 10.06.2022.</p>	<p>14. Zbatimi i Kontratës: Sipas Urdhrit Nr. 3159/4 prot., datë 13.06.2022 për ngritjen e komisionit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me objekt: “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae”</p>	

Me Urdhër Prokurimi me nr. 1594/15 prot datë 17.05.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae” ka miratuar Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT me përbërje:

4. E. M. Personi përgjegjës
5. V. B.
6. D.M.

dhe nëpërmjet urdhrin, me nr.2821/1 prot datë 20.05.2022, ka urdhëruar ngritjen e KVO me përbërje:

4. E. S., Kryetar
5. G. H., Anëtar
6. S.P., Anëtar

Në lidhje me procedurën e prokurimit: “Procedurë e Hapur, Marrëveshje Kuadër me afat 12 muaj me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae” me fond limit 27,427,512 (njëzet e shtatë milion e katërqind e njëzet e shtatë mijë e

pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe me Nr. REF-30022-05-19-2022, ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik Gj.-I.” SHPK me NIPT L.....P me ofertë ekonomike 27,310,000 lekë ose sa 99,57 % e fondit limit, i cili është identifikuar si oferta e suksesshme. Nuk ka operatorë ekonomikë të s’ kualifikuar. Njoftimi i klasifikimit është bërë në dt 07.06.2022.

Kjo procedurë është kryer mbështetur në nenin 52, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të nenit 64, pika 1/a dhe 2 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet se: *“Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.*

Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën bazuar në marrëveshjen kuadër vetëm në lidhje me kushtet, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.”

Kohëzgjatja: 12 muaj nga lidhja e marrëveshjes kuadër.

Kjo është një procedurë që zhvillohet për të tretin vit në MBZHR. Drejtori i Drejtorisë së Prokurimeve ka dërguar informacion SP dhe Ministrin të MBZHR-së në lidhje me projektvendimin “Për Caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si Organ Qendror Blerës, për Realizimin e Procedurës së Prokurimit, me Objekt ‘Mbrojtjen E Gështenjës Nga Paraziti Grerëza Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae). Në zbatim të VKM Nr. 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, ku është përcaktuar se ministrinë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre duhet të kërkojnë fillimisht sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucione publike të arsimit të lartë. MBZHR nënshkroi kontratë në datë 03.02.2020 me Universitetin Bujqësor të Tiranës me objekt “Studim për identifikimin e zonës së prekur dhe mbrojtjen e gështenjës nga parazitët në qarkun e Shkodrës”.

Nga studimi u identifikuan zonat e prekura dhe u përcaktua se mënyra më efektive për mbrojtje është metoda biologjike, konkretisht me parazitin “*Torymus Sinenis*”.

MBZHR në bashkëpunimin me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit propozuan një projektvendim i cili u miratua, konkretisht VKM Nr. 373, 06.05.2020 “Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si autoritet kontraktor për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mbrojtjen e gështenjës nga parazitët Grerëza Galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae”. Sipas studimit të UBT (faqja 11), strategjia e luftimit të këtij paraziti kalon në disa faza dhe ka një shtrirje kohore jo më pak se 4-5 vjet.

Për vitin 2020 dhe 2021, MBZHR realizoi ndërhyrjen duke luftuar këtë dëmtues në zonën e Masivit të Reçit (rreth 450 ha sipërfaqe të dëmtuar) në bashkinë e Malësisë së Madhe.

Për vitin 2022 është parashikuar fondi buxhetor “*Kontrolli dhe mbrojtja nga parazitët në fushën e bujqësisë*”, por është e nevojshme që të miratohet projektvendimi bashkëlidhur për caktimin e MBZHR-së si organ qendror blerës për realizimin e procedurës së prokurimit.

Theksojmë se projektvendimi është hartuar sipas praktikës së konsoliduar tashmë në vitin 2020 dhe 2021, komunikimeve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Departamentit Juridik në Kryeministri. Pas komunikimit me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit janë kërkuar ndryshimi i 2 prej pikave të projekt-vendimit të cilat grupi i punës në MBZHR i ka pasqyruar në memon drejtuar Ministrin të MBZHR-së.

Nga verifikimi i dosjes fizike të OE fitues (i cili është i njëjtë për të tre vitet) dhe zbatimit të kriterëve të përcaktuara nga NJP, u konstatua se:

1 Në seksionin Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit të DST pika (e) kërkohet që:

Operatori ekonomik duhet të ketë paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga vërtetimi i debisë OSHEE-2022-2596366-GG, datë 16.05.2022 i dorëzuar në MBZHR citohet se:

Bazuar në deklaratimet e deklaruësit (përfaqësuesit ligjor) zj. A.P., vërtetohet se kërkuesi GJ.-I. SHPK, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, rezulton se nuk ka kontratë për energjinë elektrike dhe për rrjedhojë ka në total 0 lekë detyrime.

Operatori ekonomik GJ.-I. SHPK në Qendrën Kombëtare të Biznesit deklaroi një numër të konsiderueshëm adresash që ushtron aktivitetin e tij. Në asnjë prej këtyre adresave nuk ka kontratë për energjinë elektrike si dhe asnjë kontratë qiraje në të cilën të shprehet që energjinë elektrike e paguan qiradhënësi.

KVO duhet të kishte kërkuar sqarim nga OE për plotësim të dokumentacionit, pasi rezulton që kjo procedurë është e kryer për herë të tretë nga MBZHR ku rezulton i njëjti fitues.

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 12, datë 26.05.2023.

Observacion i MBZHR në lidhje me akt-konstatimin nr. 12, datë 26.05.2023 të KLSH-së, për të cilin jemi shprehur dhe reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA, subjekti nuk ka paraqitur observacion.

Më datë 13.06.2022 me nr. 3159/6 prot është nënshkruar Mini kontrata nr. 1 midis MZHBR dhe “Gj.-I. SHPK” ku në nenin 8 “Hyrja në fuqi e Kontratës, kohëzgjatja dhe Ekzekutimi” citohet se: *Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate 13.06.2022. Afati i ekzekutimit 40 ditë nga nënshkrimi.*

Rezultoi nga dokumentet e procedurës se në datë 13.06.2022-14.06.2022 komisioni i krijuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me përbërje z. E.M., (p/prokurimi), Z. Rr. K., (specialist pranë DRVMB, Shkodër), z. A. S., (specialist pranë MTM), ka mbajtur Proces-Verbalin e realizimit të kontratës së shërbimit me objekt” Mbrojtjen e gështenjës nga parazitët Grerëza Galeformuese”.

Në Proces-verbal citohet se:

Që u realizua me sukses trajnimi i fermerëve vendas në lidhje me luftimin e parazitëve, gjë e cila pasqyrohet në raportin e monitorimit të OE, ku bashkëlidhur janë edhe listat me fermerët e trajnuar dhe që kanë asistuar në procesin e dezinfektimit së bashku me punonjësit e AREB-Shkodër.

Likuidimi i kontratës është kryer nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. 424, datë 19.08.2022, faturës fiskale të dorëzuar nga OE datë 24.06.2022, me vlerë totale 32,772,000 lekë. Në faturë ka specifikim të hollësishëm të artikujve, pra të shërbimeve të kryera:

6. Trajnimi i fermerëve – vlera 2,457,900 lekë
7. Blerja e insektit—vlera 18,843,900 lekë
8. Transporti I insektit dhe ruajtja- 1,638,600 lekë
9. Shpërndarja e insektit- + vlerësimi i ecurisë së trajtimit të gështenjës- 3,277,200 lekë
10. Ruajtja dhe monitorimi i ecurisë-6,554,400 lekë.

II. Auditimi i dokumentacionit fizik dhe elektronik mbi procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt Marrëveshje kuadër: “Mbikëqyrje rehabilitim i veprave të program ujitje –kullimit me lote, ndarë në 19 lote”, maj 2022, zhvilluar në MBZHR.

(1) Titullari i AK, ka miratuar Urdhrin nr. 2562, prot., datë 05.05.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit të kontratës me objekt “Mbikëqyrje punimesh rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”. Grupi i punës i përbërë (E. M., D. M. dhe T. D.) kanë paraqitur memon me nr.prot.2562/2, datë 18.05.2022, duke përcaktuar vlerën e fondit limit prej 19,314,733.54 (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e

katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSh, ndarë në 19 Lote.

Kjo vlerë është përlllogaritur në bazë të përgjigjeve që DUK-Rajonale dhe QTTB-Fushë-Krujë, për shkresën e MBZHR-së me nr.1194/2 prot datë 24.02.2022, në zbatim të Urdhrit nr 77, datë 21.02.2022 të Ministrit të MBZHR-së, si dhe VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime dhe planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, duke dërguar përcjellë dokumentacionin e plotë për projektet e programit “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”. ku në zbatim të pikës 3 të këtij Urdhri kanë kërkuar dërgimin në MBZHR të dokumentacionit të plotë për projektet e programit “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”. Në datën 22.04.2022 është publikuar nga AK procedura e prokurimit “rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, me nr REF - 23746-04-01-2022.

Me anë të Urdhrit të Prokurimit nr. 2562/3, prot., datë 18.05.2022, Urdhrit nr 77, datë 21.02.2022 të Ministrit të MBZHR-së, si dhe VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime dhe planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, Titullari i AK ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit “E hapur me mjete elektronike” me objekt: “Mbikëqyrje punimesh rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, ndarë në 19 lote, me fond limit 19,314,733.54 (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, si dhe ka përcaktuar Njësinë e Prokurimit, të përbërë nga:

1. Z. E. M., përgjegjës i sektorit të prokurimeve.
2. Znj. D. M., Specialiste
3. Z. T.D., inxhinier mjedisi, specialist

Me anë të Urdhrit nr. 2562/11, prot., datë 31.05.2022, Titullari i AK z. O. M., ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përbërë nga:

1. Z. E. S., Kryetar, aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme në MBZHR.
2. Z. G.H., anëtar me detyrë përgjegjës i sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme.
3. Z. M.M., me detyrë inxhinier specialist në sektorin e prokurimeve.

Në zbatim të Nenit 99, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 84, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ngritur me Urdhrit Nr. 2562/11 prot., datë 31.05.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor/Personit të Autorizuar, ka paraqitur Raportin Përmbledhës me nr. prot 2562/36, datë 13.07.2022, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt:

Më poshtë po paraqesim të dhënat kryesore të procedurës së prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mbikëqyrje rehabilitim i veprave të program ujitje –kullimit me lote, ndarë në 19 lote		
1. Urdhër Prokurimi nr. 2562/2. prot., datë 18.05.2022	2. Njësia e prokurimit E. M. T. D., inxhinier D. M.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 2562/11. prot., datë 31.05.2022 E. S. M. M. G.H.
8. Data e hapjes së ofertave 10.06.2022; ora: 10:00	9. Burimi i Financimit Buxhetit i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender Të cituar në tabelën në vijim për 19 lote
11. Ankimime JO	12. Përgjigje e ankesës nga AK JO	13. Përgjigje e ankesës nga KPP-PO
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
1. Lidhje e kontratës nr. 3937/1, datë 21.07.2022 me DUK Durrës.	2. Vlera e kontratës (me TVSh) Loti 2: 288,999.32 Loti 3: 1,976,290.44 Loti 4: 1,131,111.60	3. Likuiduar:

2. Lidhje e kontratës nr. 3934/1, datë 21.07.2022 me DUK Korçë	2. Vlera e kontratës (me TVSh) Loti 9: 1,843,797.96 Loti 10: 1,339,377.60 Loti 13: 1,511,584.97			
3. Lidhje e kontratës nr. 3938/1, datë 21.07.2022 me DUK Lezhë	2. Vlera e kontratës (me TVSh) Loti 14: 154,442.40 Loti 15: 160,688.40 Loti 16: 1,067,156.40 Loti 17: 1,524,573 Loti 18: 308,776.80			
3. Lidhje e kontratës nr. 3935/1, datë 21.07.2022 me DUK Fier	. Vlera e kontratës (me TVSh) Loti 5: 608,005.20 Loti 7: 2,165,781.24 Loti 8: 3,290,044.94			
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë Sipas listës.	18. Afati i kontratës në ditë 4 muaj nga nënshkrimi		19. Zgjatja e kontratës me ditë JO	
20. Mbikëqyrësi i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
21. Kolaudatori i punimeve N/A	Licencë N/A	Kontrata N/A	Likuiduar N/A	Pa likuiduar N/A
22. Procesverbal i marrjes në dorëzim DUK Rajonal	23. Grupi i marrjes në dorëzim Sipas DUK Rajonal			

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “Mbikëqyrje punimesh rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, 19 lote.

Fondi limit: 19,314,733.54 (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH, ndarë në 19 lote.

Nga auditimi u konstatua, se për Lote 1, 6, 11, 12 dhe 19, pas përfundimit të afateve të ankimimit, nuk është paraqitur asnjë ankesë në lidhje me vendimet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Më poshtë po paraqesim përshkrimin e shkurtër të Loteve të s’ kualifikuara:

Loti 1: Mbikëqyrje punimesh "*Rehabilitim pjesor në kanal in kryesor ujitës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe ri veshje kanali)*", me fond limit **418,443.25** Lekë pa TVSh, me numër REF-30409-05-23-2022. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë. Procedura është anuluar me njoftim nr. 2562/14, dt. 05.07.2022 me argumentimin bazuar në ligjin nr. 162/2020” Për prokurimin publik”, neni 98/pika 1, pasqyruar në raportin përmbledhës me nr. 2562/36, datë 13.07.2022 përgatitur nga KVO, duke pasqyruar arsyet e s’ kualifikimit. (Të paraqitura hollësisht në tabelë për secilin lot sipas aneksit bashkëlidhur këtij akt konstatimi.)

Loti 6: Mbikëqyrje punimesh "*Mbrojtja nga Lumi Vjosë në Bishan, krahu i majtë, bashkia Vlorë*", me fond limit 315,106.44 (treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtë pikë dyzet e katër) Lekë pa TVSh; REF-30447-05-23-2022, morën pjesë 7 operatorë ekonomikë, por procedura është anuluar me njoftim nr. 2562/13, datë 05.07.2022 me argumentimin bazuar në Ligjin nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, neni 98/pika 1, pasqyruar në raportin përmbledhës me nr. 2562/36, datë 13.07.2022 përgatitur nga KVO.

Operatorët e s’ kualifikuar janë renditur në vijim sipas arsyeve të paraqitura nga KVO, sipas raportit përmbledhës, ku kryesisht është pasi OE kanë paraqitur Ofertë ekonomike në vlerë më të ulët se vlera minimale e përlloritur bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. (Të paraqitura hollësisht në tabelë për secilin lot sipas aneksit bashkëlidhur këtij akt konstatimi.)

Loti 11: Mbikëqyrje punimesh "*Mbrojtja nga gërryerja e lumit Osum, bregu i majtë i tokës në fshatin Arrëz, bashkia Dimal*", REF-30458-05-23-2022, me fond limit **1,683,312.92** lekë pa TVSh, morën pjesë 11 operatorë ekonomikë, por procedura është anuluar me njoftim nr. 2562/15, datë 05.07.2022 me argumentimin bazuar në Ligjin nr. 162/2020 ”Për prokurimin

publik”, neni 98/pika 1, pasqyruar në raportin përmbledhës me nr. 2562/36, datë 13.07.2022 përgatitur nga KVO.

Operatorët e s’ kualifikuar janë renditur në vijim sipas arsyeve të paraqitura nga KVO sipas raportit përmbledhës. (Të paraqitura hollësisht në tabelë për secilin lot sipas aneksit bashkëlidhur këtij akt konstatimi.)

Loti 12 Mbikëqyrje punimesh "Mbrojtje nga përmytja nga lumi Devoll në Gegë, Bashkia Kuçovë", me fond limit 1,342,507.93 (një milion e treqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e shtatë pikë nëntëdhjetë e tre) Lekë pa TVSh; morën pjesë 9 operatorë ekonomikë, por procedura është anuluar me njoftim nr. 2562/16, datë 05.07.2022 me argumentimin bazuar në Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 98/pika 1, pasqyruar në raportin përmbledhës me nr. 2562/36, datë 13.07.2022 përgatitur nga KVO. Operatorët e s’ kualifikuar janë renditur në vijim sipas arsyeve të paraqitura nga KVO sipas raportit përmbledhës. (Të paraqitura hollësisht në tabelë për secilin lot sipas aneksit bashkëlidhur këtij akt konstatimi.)

Loti 19 Mbikëqyrje punimesh "Mbrojtje nga përmytja nga lumi Gjolës i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë-Krujë", REF-30414-05-23-2022, me fond limit 421,514.6 lekë pa TVSh, morën pjesë 7 operatorë ekonomikë, por procedura është anuluar me njoftim nr. 2562/17, datë 05.07.2022 me argumentimin bazuar në Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 98/pika 1, pasqyruar në raportin përmbledhës me nr. 2562/36, datë 13.07.2022 përgatitur nga KVO. Operatorët e s’ kualifikuar janë renditur në vijim sipas arsyeve të paraqitura nga KVO sipas raportit përmbledhës. (Të paraqitura hollësisht në tabelë për secilin lot sipas aneksit bashkëlidhur këtij akt konstatimi.)

Në lotet e s’ kualifikuara konstatohet një numër i lartë pjesëmarrje të cilët në 90% të s’ kualifikimeve rezultojnë se kanë paraqitur ofertë më të ulët se oferta minimale e përlllogaritur nga NJP, bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Mungon një raport nga NJP dhe KVO, ku të jenë analizuar shkaqet që çuan në dështimin e procedurës, në kundërshtim me Nenin 93 Sigurimi i konkurrencës, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku citohet se:

3. Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizojnë shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, nga njësisia e prokurimit.

Lotet e kualifikuara

Me anë të Raportit Përmbledhës me numër protokollit 2562/38 dhe datë 20.07.2022 dhe 2562/39, datë 20.07.2022 titullari i AK ka miratuar procedurën e hapur me objekt: Mbikëqyrje punimesh rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, ndarë në 19 Lote, me fond limit 19,314,733.54, në zbatim të Nenit 99, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik"; Nenit 84, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ngritur me Urdhrin Nr. 2562/11 prot., datë 31.05.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor/Personit të Autorizuar, me numër REF-30406-05-23-2022, për lotet 2,3,4,5,7,8,9,10,13,14,15,16,17,18.

• **Loti 2** Mbikëqyrje punimesh "Rehabilitim Argjinatura Perlat (Loti II)", me fond limit **250,095.57** (dyqind e pesëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 9 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s’ kualifikuar 8 dhe është kualifikuar OE.G B C.E.” SHPK, me NUIS L.....V, me ofertë ekonomike 240,832.77 (dyqind e dyzetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, me një diferencë prej 9262.8 lekë me fondin limit, është identifikuar si Oferta e suksesshme. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Për llogaritjen e fondit limit është ngritur grupi i punës i përbërë nga 3 anëtarë: E. M., T.D.dhe D. M.

Në bazë të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, dhe kolaudim”, llogaritet vlera e interpoluar, bazuar në nenin 39, germa 1) dhe m), grupi tarifor i cili është përzgjedhur referuar natyrës së punimeve të ndërtimit që konkretisht është “Grupi IV tarifor” dhe përllogaritja është kryer në vijim:

Sipas vlerës respektive dhe sipas nenit 38, tabela 10 me interpolim si më poshtë:

	A-Min	B-Max
K1 5,000,000	13%	14%
	C-Min	D-Max
K2: 10,000,000	13%	14%

Vlera e ndërtimit = 9,262,799 lekë pa TVSh

Vlera minimale e mbikëqyrjes= $20\% * 13\% * 9,262,799 = 240,832.77$ lekë pa TVSh

Vlera maksimale e mbikëqyrjes= $20\% * 14\% * 9,262,799 = 259,358.37$ lekë pa TVSh

Nga sa më sipër fondi limit përllogaritet si vlera mesatare e vlerës min dhe vlerës max:

$(240,832.77 + 259,358.37)/2 = 250,095.57$ lekë pa TVSh.

Në lidhje me sa më sipër kanë paraqitur oferta të njëjta edhe dy OE dhe konkretisht Operatori ekonomik “M. C.” SHPK, me NUIS K.....K, me ofertë ekonomike 240 832.77 (dyqind e dyzetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, i cili është s’ kualifikuar me argumentimin se: *Nuk plotëson pikë 2.3.2 “Kapaciteti Teknik” ku kërkohet një Inxhinier Ndërtimi dhe një Inxhinier Hidroteknik pasi OE ka paraqitur licencën profesionale MK.1503/5, ku ka të përfshirë vetëm një drejtues teknik me inicialet Gj. D.*

Si dhe BOE H.-E. C.” SHPK, me NUIS M....F dhe “I...” ShPK me NUIS L....M, me ofertë ekonomike 240,833 (dyqind e dyzetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH, është s’ kualifikuar pasi sipas KVO: Nuk plotëson pikën 2.3.3 “Kapaciteti Teknik”, pasi përfaqësuesi i BOE “H.-E. C.” nuk ka të përfshirë në licencën profesionale pikën NP-9 “Punime dhe mbrojtje lumore, sistemi hidraulike dhe bonifikime” e cila lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Nisur nga përqindja e kontratës së bashkëpunimit ku ky operator do të kryej 80 % të shërbimit të mbikëqyrjes, duhet të ishte i pajisur me pikën NP-9 pasi sipas zërave të preventivit dhe volumeve të mbikëqyrjes të zbatimit të punimeve që lidhen me këtë pikë të licencës, kjo pikë nuk mund të mbulohet nga anëtari tjetër i këtij BOE i cili ka 20 % të shërbimit.

Sa më sipër, s’ kualifikimi i tyre nga KVO është në përputhje me DST.

Loti 3 Mbikëqyrje punimesh "Rehabilitimi argjaturës se Tones, Segmenti Tarin - Perlat", me fond limit 1,724, 868 (një milion e shtatëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSh; kanë ofertuar 6 OE si më poshtë nga të cilët është zgjedhur fitues me njoftim nr 2562/31, datë 12.07.2022, I.D. – A., SHPK, me NUIS K.A, me ofertë ekonomike 1 646 908.70 (një milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tetë pikë shtatë) Lekë pa TVSH dhe me një diferencë prej 77,959.3 lekë me fondin limit.

- Janë s’ kualifikuar 4 operatorë nga KVO, pasi: Oferta ekonomike e paraqitur është me vlerë më të ulët se vlera minimale e përllogaritur bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. I.D. – A.” SHPK, me NUIS K.....A, me ofertë ekonomike 1 646 908.70 (një milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tetë pikë shtatë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Procedura e përllogaritjes së vlerës së fondit limit është e njëjtë për të gjitha lotet duke u bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, dhe kolaudim”.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

- *Loti 4 Mbikëqyrje punimesh "Argjaturë mbrojtëse nga lumi Shkumbin, (Gose-Ballaj ,6km, vijim i projektit)", me fond limit 981,590 (nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e*

nëntëdhjetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 8 operatorë ekonomike, nga të cilët janë s' kualifikuar 7 dhe është kualifikuar subjekti D. SHPK, me NUIS L.....H me ofertë ekonomike 942,593.77 (dyqind e dyzetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, me një diferencë prej 38,997 lekë me fondin limit, është identifikuar si Oferta e suksesshme. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

- **Loti 5:** Mbikëqyrje punimesh "*Vepra e marrjes së kanalit Ujitës Llakatund, Vlorë*", me fond limit **526,158.18** (pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tetëmbëdhjetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 12 operatorë ekonomike, nga të cilët janë s' kualifikuar 10 dhe është kualifikuar BOE "H.-E. C." SHPK, me NUIS M.....F dhe "I." SHPK me NUIS L.....M, me ofertë ekonomike 506,671 (pesëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 19,487.18 lekë me fondin limit, është identifikuar si Oferta e suksesshme. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Ndër 10 OE pjesëmarrës, 9 janë s' kualifikuar për të njëjtën arsye pra:

- Oferta ekonomike e paraqitur është me vlerë më të ulët se vlera minimale e përlllogaritur bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*".

- Ndërsa OE I. D. – A." SHPK, me NUIS K.....A, me ofertë ekonomike 506,670.84 (pesëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH është s' kualifikuar nga KVO me argumentin OE nuk plotëson pikën 2.3.2 të "*Kapacitetit Teknik*" ku kërkohet një Inxhinier Ndërtimi dhe një Hidroteknik. Bazuar në përcaktimet e DST për kriteret kumulative për kapacitetin teknik, OE në Formularin e Vetë deklaramit në këtë lot ka deklaruar Inxhinier Ndërtimi me iniciale N.N, i njëjti Inxhinier Ndërtimi i deklaruar dhe në Loti 3 Mbikëqyrje punimesh "*Rehabilitimi argjaturës së Tones, Segmenti Tarin - Perlat*" me nr. REF-30438-05-23-2022 për të cilin ky OE është renditur i pari.

Nga sa më sipër KVO refuzoi ofertën e paraqitur pa vazhduar më tej vlerësimin.

Data e lidhjes së kontratës është 01.08.2022. Zbatimi i kontratës do të kryhet nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier. Vlera totale përfundimtare e kontratës (*përfshirë Lotet, opsionet dhe nën kontraktimin*) është 608 005.01 lekë me TVSh. *Pra sa më sipër*, secila prej Loteve realizohet si procedurë e veçantë e për rrjedhojë secili OE tenderues duhet të paraqesë dokumentacion të saktë për secilin kriter, nisur nga këto kushte KVO e ka s' kualifikuar me të drejtë.

- **Loti 7:** Mbikëqyrje punimesh "*Mbrojtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier*", me fond limit 1,893,142 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e dy) Lekë pa TVSh; morën pjesë 11 operatorë ekonomike, nga të cilët janë s' kualifikuar 10 dhe është kualifikuar "GJ. & CO" SHPK, me NUIS K.....U, me ofertë ekonomike 1,804,817.70 (një milion e tetëqind e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 88,324.3 lekë me fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Për 10 Operatorët KVO ka kryer s' kualifikimin me të njëjtin argument:

Oferta ekonomike e paraqitur është me vlerë më të ulët se vlera minimale e përlllogaritur bazuar në VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016, "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*".

Ndërkohë në procesverbalin e datës 05.05.2022 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për përgatitjen e fondit limit, konstatohet që:

- a. Vlera minimale e mbikëqyrjes është 1,804,808.36 lekë pa TVSh
- b. Vlera maksimale e mbikëqyrjes është 1,981,475.81 lekë pa TVSh

Fondi limit është përlllogaritur si vlerë mesatare e këtyre dy vlerave dhe është: 1,893,142 lekë pa TVSh.

Rezulton se BOE "H.-E. C." SHPK, me NUIS M.....F dhe "I." ShPK me NUIS L.....M, me ofertë ekonomike 1,804,807 lekë si dhe OE "M." SHPK, me NUIS L.....K, me ofertë ekonomike 1,804,807.32 (një milion e tetëqind e katër mijë e tetëqind e shtatë pikë tridhjetë e dy) Lekë pa TVSH, janë s' kualifikuar për ofertë ekonomike me vlerën më të ulët se vlera minimale e fondit limit ku ndërkohë vlera e ofertës e paraqitur nga OE fitues është gjithashtu 1,804,817.7 lekë pra 17,7 lekë më shumë një shifër kjo e pa konsiderueshme për t' u marrë si kriter për s' kualifikim të dy operatorëve të tjerë të sipër cituar.

- **Loti 8:** Mbikëqyrje punimesh "*Rikonstruksioni i hidrovorit të Akërnisë, Vlorë*", me fond limit 2,878,477.34 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë e katër) Lekë pa TVSh; morën pjesë 8 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 7 dhe është kualifikuar A. MK" SHPK, me NUIS L.....Q, me ofertë ekonomike 2,741,704.12 (dy milion e shtatëqind e dyzetë e një mijë e shtatëqind e katër pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 136,773.22 lekë me fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin 2.6, bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Ndërkohë në procesverbalin e datës 05.05.2022 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për përgatitjen e fondit limit konstatohet që:

- a. Vlera minimale e mbikëqyrjes është **2,741,693.63** lekë pa TVSh
 - b. Vlera maksimale e mbikëqyrjes është **3,015,261.05** lekë pa TVSh
- Fondi limit është përlogaritur si vlerë mesatare e këtyre dy vlerave dhe është: 2,878,477.34 lekë pa TVSh.

Është s' kualifikuar BOE "H.-E. C." SHPK, me NUIS M.....F dhe "I." ShPK me NUIS L.....M, me ofertë ekonomike 2,741,696 (dy milion e shtatëqind e dyzetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH pra sa vlera minimale e mbikëqyrjes (3 lekë më shumë) të cilës i referohet KVO në procesin e kualifikimit me argumentet:

BOE nuk plotëson pikën 2.3.2 të "*Kapacitetit Teknik*" ku ndër të tjera kërkohet një Inxhinier Hidroteknik. Bazuar në përcaktimet e DST për kriteret kumulative për kapacitetin teknik, BOE ka vetëm një inxhinier Hidroteknik të përfshirë në licencën e OE "I." me initiale A.K, i cili është deklaruar në formularin e Vetë deklarimit të Lotit 5 Mbikëqyrje punimesh "*Vepra e marrjes së kanalit Ujitës Llakatund, Vlorë*" me nr. REF-30444-05-23-2022 për të cilin BOE është renditur i pari.

BOE nuk plotëson pikën 2.3.3 të "*Kapacitetit Teknik*" pasi OE "I." që ka marrë përsipër të kryej 20% të shërbimit të mbikëqyrjes nuk ka të përfshirë në licencën profesionale pikat: NP-11, NS-12, NS-14 dhe NS-18. Pra sa më sipër, secili prej Loteve realizohet si procedurë e veçantë e për rrjedhojë secili OE tenderues duhet të paraqesë dokumentacion të saktë për secilin kriter, nisur nga këto kushte KVO e ka s' kualifikuar me të drejtë.

- **Loti 9:** Mbikëqyrje punimesh "*Rehabilitim i kanalit ujitës krahu i djathtë rezervuari Gjanç*", me fond limit 1,608,103.73 (një milion e gjashtëqind e tetë mijë e njëqind e tre pikë shtatëdhjetë e tre) Lekë pa TVSh; morën pjesë 8 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 7 dhe është kualifikuar BOE "H. C." SHPK, me NUIS M.....P dhe "H. & S." me NUIS L.....B, me ofertë ekonomike 1,536,498.30 (një milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 71,605.43 lekë me fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Në procesverbalin e datës 05.05.2022 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për përgatitjen e fondit limit, konstatohet që:

- c. Vlera minimale e mbikëqyrjes është **1,536,481.26** lekë pa TVSh
- d. Vlera maksimale e mbikëqyrjes është **1,679,726.2** lekë pa TVSh

Fondi limit është përlogaritur si vlerë mesatare e këtyre dy vlerave dhe është: 1,608,103.73 lekë pa TVSh.

Të 8 OE janë s' kualifikuar nga KVO me të njëjtin argument:

Për ofertë ekonomike të paraqitur me vlerë më të ulët se vlera minimale e fondit limit.

Sipas nenit 1, pika 2, ku citohet se:

Në rastin kur shërbimet e përmendura në pikën 1, financohen nga subjekte private, atëherë llogaritja për tarifrat e shërbimeve nuk mund të jenë më të vogla se tarifrat minimale referuese në këtë manual. Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.

Loti 10: Mbikëqyrje punimesh "Kanali ujitës Polis -Tudan", me fond limit 1,164,238 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 6 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 5 dhe është kualifikuar Operatori Ekonomik "S&L S." SHPK, me NUIS L.....D, me ofertë ekonomike 1,116,148 (një milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind dyzetë e tetë) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 48,090 lekë me fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi). *Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.*

Loti 13: Mbikëqyrje punimesh "Mbrojtje nga lumi Shkumbin tek Pularia Elbasan", me fond limit 1,315,406.88 (një milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtë pikë tetëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 11 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 10 dhe është kualifikuar Operatori Ekonomik T." SHPK, me NUIS K.....L, me ofertë ekonomike 1,259,654.14 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pikë katërmëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 55,752.74 lekë me fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Në procesverbalin e datës 05.05.2022 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për përgatitjen e fondit limit, konstatohet që:

e. Vlera minimale e mbikëqyrjes është 1,259,648.97 lekë pa TVSh

f. Vlera maksimale e mbikëqyrjes është 1,371,164.8 lekë pa TVSh

Fondi limit është përlogaritur si vlerë mesatare e këtyre dy vlerave dhe është: 1,315,406.88 lekë pa TVSh.

Rezulton se 9 OE janë s' kualifikuar nga KVO, për ofertë ekonomike të paraqitur me vlerë më të ulët se vlera minimale e fondit limit, sipas nenit 1, pika 2, ku citohet se:

Në rastin kur shërbimet e përmendura në pikën 1, financohen nga subjekte private, atëherë llogaritja për tarifrat e shërbimeve nuk mund të jenë më të vogla se tarifrat minimale referuese në këtë manual.

Ndër operatorët e s' kualifikuar me vlerë më të ulët se vlera minimale konstatohet se 3 operatorë ekonomikë e kanë sjellë ofertën më të madhe se oferta minimale dhe konkretisht:

1- Operatori ekonomik "A. M." SHPK, me NUIS L.....Q, me ofertë ekonomike 1,300,000 (një milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH.

2- BOE "H.-E. C." SHPK, me NUIS M.....F dhe "I." SHPK me NUIS L.....M, me ofertë ekonomike 1,259,648 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzetë e tetë) Lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik "Z.&C." SHPK, me NUIS K6.....D, me ofertë ekonomike 1,275,945 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzetë e pesë) Lekë pa TVSH. *Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.*

Observacion i MBZHR në lidhje me akt-konstatimin nr. 12, datë 26.05.2023 të KLSH-së, për të cilin jemi shprehur dhe reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA, subjekti nuk ka paraqitur observacion.

Loti 14: Mbikëqyrje punimesh "Kanali ujitës Mjedë Kotërr", me fond limit **133,637.5** (njëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 6 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 5 dhe është kualifikuar BOE "B.P." SHPK, me NUIS L.....S dhe "P.C.S.C." me NUIS K.....J, me ofertë ekonomike 128,702 (njëqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme, me një diferencë prej 4935,5lekë me fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07. 2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Në procesverbalin e datës 05.05.2022 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për përgatitjen e fondit limit rezultoi se:

- a. Vlera minimale e mbikëqyrjes është **128,688** lekë pa TVSh
- b. Vlera maksimale e mbikëqyrjes është **138,587** lekë pa TVSh

Fondi limit është përlogaritur si vlerë mesatare e këtyre dy vlerave dhe është: 133,637.5 lekë pa TVSh.

Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.

Loti 15: Mbikëqyrje punimesh "Mbrotjtje nga Lumi Buna Bahçallëk, Shkodër", me fond limit **139,047** (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 6 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 5 dhe është kualifikuar OE "G & L C." SHPK, me NUIS L.....N, me ofertë ekonomike 133,907 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme., me një diferencë prej 5140 lekë më pak se fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.

Loti 16: Mbikëqyrje punimesh "Grykëderdhje e KUL Zadrinë (mbrotjtje me gabione L=0.5 km)", me fond limit **925,083.8** (nëntëqind e njëzet e pesë mijë e tetëdhjetë e tre pikë tetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 9 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 8 dhe është kualifikuar Operatori Ekonomik "M.A.K S." SHPK, me NUIS L....O, me ofertë ekonomike 889,297 (tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë), lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme., me një diferencë prej 35,786.8 lekë më pak se fondin limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.

Loti 17: Mbikëqyrje punimesh "Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgji", me fond limit **1,326,797.12** (një milion e treqind e njëzet e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dymbëdhjetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 11 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 10 dhe është kualifikuar Operatori Ekonomik "A." SHPK, me NUIS K.....A, me ofertë ekonomike 1,270,477.50 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, me një diferencë prej 56,319.62 lekë më pak se fondi limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Nuk u konstatuan shkelje në kualifikimin dhe s' kualifikimin e OE nga KVO.

Loti 18: Mbikëqyrje punimesh "Mbrotjtje nga lumi Kir", me fond limit **267,203.28** (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tre pikë njëzet e tetë) Lekë pa TVSh; morën pjesë 6 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë s' kualifikuar 5 dhe është kualifikuar Operatori Ekonomik "N.-G." SHPK, me NUIS L.....P, me ofertë ekonomike 257,314 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e katërmbëdhjetë), lekë pa TVSH, me një diferencë prej 9889,28 lekë më pak se fondi limit. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2022. Në procesverbalin e datës 05.05.2022 të mbajtur nga grupi i punës i ngritur për përgatitjen e fondit limit me anëtarë:

E. M., T.D. dhe D. M. rezultoi se:

- a. Vlera minimale e mbikëqyrjes është **257,306.87** lekë pa TVSh
- b. Vlera maksimale e mbikëqyrjes është **277.099.7** lekë pa TVSh

Fondi limit është përlllogaritur si vlerë mesatare e këtyre dy vlerave dhe është: 267,203.28 lekë pa TVSh. (Të paraqitura hollësisht në tabelën përkatëse sipas loteve në aneksin bashkëlidhur këtij akt-konstatimi).

Në lidhje me 14 lotet e kryera si procedura nga AK, ku për secilin lot ka një fitues u konstatua se kanë marrë pjesë gjithsej 39 OE nga të cilët në një analizë të përmbledhur nga grupi i auditimit, rezultoi konkretisht se pjesëmarrja dhe fituesit të dhënë në mënyrë të përmbledhur **janë në tabelën bashkëngjitur këtij raporti në aneksin sipas drejtimit 6.**

Për sa i përket, zbatimit të kontratave për secilin lot sikurse është përshkruar në tabelën përmbledhëse lidhja, monitorimi dhe zbatimi i kontratave të mbikëqyrjes është kryer nga Drejtoritë e Ujitje-Kullimit sipas rajoneve përkatëse. Nuk ka gjurmë auditimi apo raportim të këtyre DUK-eve në Institucionin Qendror, MBZHR, për zbatimin në kohë dhe me sukses të këtyre kontratave dhe rrjedhimisht nuk ka informacion nga sektori i prokurimit në MBZHR nëse këto institucione kanë kryer raportimin në APP për çdo fazë të zbatimit të kontratës, veprime në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të MBZHR me nr. 77, datë 21.02.2022, për realizimin e procedurave të prokurimit publik të objekteve në Programin "Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", **DUK janë përgjegjëse për lidhjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe do të jenë përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit me sukses të punimeve nga ana e OE të shpallur fitues sipas procedurave të prokurimit**, si dhe nenin 107 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës pika 1, pika 3, pika 4, pika 7 dhe neni 108 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku citohet se:

Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi.

4. Plani i zbatimit të kontratës përfshin në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.

Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi. Pas çdo modifikimi që mund t'i bëhet kontratës, plani përditësohet brenda 7 (shtatë) ditëve nga hartimi dhe nënshkrimi i modifikimit nga palët.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet raportojë në APP për çdo fazë: për modifikimin/modifikimet e çdo kontrate, ndërprerjen, përfundimin (me sukses apo penalitet) apo shpalljen e pavlefshme të saj, duke pasqyruar në formularin përkatës, arsyet, rrethanat dhe argumentimin përkatës, mbi bazën e dispozitave ligjore që është bërë modifikimi, ndërprerja, përfundimi, apo shpallja e pavlefshme e kontratës.

*7. Personi apo strukturat e ngarkuara nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi, duhet të ndjekin me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi: a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës; b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti; d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj; dh) **Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor** për shkelje të dispozitave kontraktuale; e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë; ë)*

Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës; f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së.

Pra AK, MBZHR nuk ka dijeni nëse fondi prej 19,314,734 lekë është përdorur me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet nga DUK-et përkatëse të cilët janë **përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit të punimeve nga ana e OE.**

Observacion i MBZHR në lidhje me akt-konstatimin nr. 12, datë 26.05.2023 të KLSH-së, ardhur me shkresë nr. 1175/18 datë 05.06.2023, për të cilin jemi shprehur dhe reflektuar në projekt raport. Në fazën e RPA, subjekti nuk ka paraqitur observacion.

III. Auditimi i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike” Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-23746-04-01-2022.

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”.

Sipas Urdhrit të Ministrit të MBZHR-së, me nr. 77, datë 21.02.2022, për realizimin e procedurave të prokurimit publik të objekteve në Programin “Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, është urdhëruar realizimi i këtyre procedurave në mënyrë të përqendruar. MBZHR është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit nga fillimi deri në njoftimin e lidhjes së kontratës. Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit duhet të dërgonin pranë MBZHR dokumentacionin e plotë (në formë shkresore dhe elektronike) si projekt preventivat, temat e referencës, detyrat e projektimit, specifikimet teknike dhe afatet e realizimit të punimeve. **DUK janë përgjegjëse për lidhjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe do të jenë përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit me sukses të punimeve nga ana e OE të shpallur fitues sipas procedurave të prokurimit.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si vijon:

1. Fondi limit: 866,303,595 (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH ose 7,157,168 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH, ndarë në 19 lote si më poshtë:

- Loti 1 "Rehabilitim pjesor në kanalin kryesor ujitës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe ri veshje kanali)", me fond limit 15,497,898 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSh ose 128,039 (njëqind e njëzet e tetë mijë e tridhjetë e nëntë) Euro pa TVSh;
- Loti 2 "Rehabilitim Argjinatura Perlat (Loti II)", me fond limit 9,262,799 (nëntë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSh ose 76 527 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) Euro pa TVSh;
- Loti 3 "Rehabilitimi argjinaturës se Tones, Segmenti Tarin - Perlat", me fond limit 82,278,800 (tetëdhjetë e dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) Lekë pa TVSh ose 679,765 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro pa TVSh;
- Loti 4 "Argjinatura mbrojtëse nga lumi Shkumbin, (Gose-Ballaj ,6km, vijim i projektit)", me fond limit 38,253,706 (tridhjetë e tetë milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtë) Lekë pa TVSh ose 316,042 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyzet e dy) Euro pa TVSh;

- Loti 5 "*Vepra e marrjes së kanalit Ujitës Llakatund, Vlorë*", me fond limit 19,487,340 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet) Lekë pa TVSh ose 160 999 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSh;
- Loti 6 "*Mbrojtja nga Lumi Vjosë në Bishan, krahu i majtë, bashkia Vlorë*", me fond limit 11,670,609 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntë) Lekë pa TVSh ose 96 419 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) Euro pa TVSh;
- Loti 7 "*Mbrojtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier*", me fond limit 93,972,048 (nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyzet e tetë) Lekë pa TVSh ose 776,372 (shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) Euro pa TVSh;
- Loti 8 "*Rikonstruksioni i hidrovorit të Akërnisë, Vlorë*", me fond limit 151,242,491 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) Lekë pa TVSh ose 1,249,525 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) Euro pa TVSh;
- Loti 9 "*Rehabilitim i kanalit ujitës krahu i djathtë rezervuari Gjanç*", me fond limit 74,521,353 (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) Lekë pa TVSh ose 615 675 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) Euro pa TVSh;
- Loti 10 "*Kanali ujitës Polis -Tudan*", me fond limit 47,900,000 (dyzet e shtatë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSh ose 395,737 (treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) Euro pa TVSh;
- Loti 11 "*Mbrojtja nga gërryerja e limit Osum, bregu i majtë i tokës në fshatin Arrëz, bashkia Dimal*", me fond limit 79,516,702 (shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dy) Lekë pa TVSh ose 656 946 (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) Euro pa TVSh;
- Loti 12 "*Mbrojtje nga përmytja nga lumi Devoll në Gegë, Bashkia Kuçovë*", me fond limit 58,077,000 (pesëdhjetë e tetë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSh ose 479,817 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) Euro pa TVSh;
- Loti 13 "*Mbrojtje nga lumi Shkumbin tek Pularia Elbasan*", me fond limit 56,463,713 (pesëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) Lekë pa TVSh ose 466,488 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) Euro pa TVSh;
- Loti 14 "*Kanali ujitës Mjedë Kotërr*", me fond limit 4,949,540 (katër milion e nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e dyzet) Lekë pa TVSh ose 40 892 (dyzet mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) Euro pa TVSh;
- Loti 15 "*Mbrojtje nga Lumi Buna Bahçallëk, Shkodër*", me fond limit 5,149,890 (pesë milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSh ose 42 547 (dyzet e dy mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) Euro pa TVSh;
- Loti 16 "*Grykëderdhje e KUL Zadrimë (mbrojtje me gabione L=0.5 km)*", me fond limit 35 412 347 (tridhjetë e pesë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSh ose 292 567 (dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSh;
- Loti 17 "*Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgj*", me fond limit 57,139,289 (pesëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSh ose 472 069 (katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSh;
- Loti 18 "*Mbrojtje nga lumi Kir*", me fond limit 9,896,418 (nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) Lekë pa TVSh ose 81,762 (tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa TVSh;
- Loti 19 "*Mbrojtje nga përmytja nga lumi Gjolës i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë-Krujë*", me fond limit 15,611,652 (pesëmbëdhjetë milion e

gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) Lekë pa TVSh ose 128,979 (njëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSh.

Nga 19 lote janë anuluar 4 Lote: Loti 1, Loti 6, Loti 14 dhe Loti 19, përkatësisht sipas proces verbaleve mbajtur nga KVO në datën 15.06.2022

Në Lotin 1 "Rehabilitim pjesor në kanalën kryesor ujitës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe ri veshje kanali)", morën pjesë:

1. Operatori Ekonomik "A." ShPK me NUIS J.....K me ofertë ekonomike 15,037,588 (pesëmbëdhjetë milion e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik "B. B" ShPK me NUIS K.....H me ofertë ekonomike 13,923,730 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e njëzetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.
3. BOE "K." ShPK me NUIS K.....C dhe "N." ShPK me NUIS K.....I, me ofertë ekonomike 13,383,540 (trembëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik "M." ShPK me NUIS K.....G me ofertë ekonomike 14,311,644 (katërmëdhjetë milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik "Sh." ShPK me NUIS K.....N me ofertë ekonomike 13,819,922 (trembëdhjetë milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH.

Në Lotin 14 "Kanali ujitës Mjedë Kotërr", nuk ka asnjë operator ekonomik pjesëmarrës.

Në Lotin 19 "Mbrojtje nga përmytja nga lumi Gjolës i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë-Krujë", morën pjesë:

1. Operatori Ekonomik "2N" ShPK me NUIS L.....L me ofertë ekonomike 12,183,241 (dymbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzetë e një) lekë pa TVSH.
2. BOE "2Z K." ShPK me NUIS J.....K dhe "S." ShPK me NUIS K.....Ë, me ofertë ekonomike 12,085,544 (dymbëdhjetë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.
3. BOE "E.-A." ShPK me NUIS K.....H dhe "M." ShPK me NUIS J.....V, me ofertë ekonomike 9,817,784.55 (nëntë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

-Njoftimi i Anulimit për Loti 1 "Rehabilitim pjesor në kanalën kryesor ujitës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe ri veshje kanali)", Nr. 1892/19 prot., datë 16.06.2022 është publikuar në SPE në datën 17.06.2022. Me publikimin e këtij njoftimi, filluan afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenit 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik". Pas përfundimit të afateve ligjore nuk u paraqit asnjë ankesë nga operatorët ekonomikë të s kualifikuar. Për sa më sipër ky lot mbetet i anuluar edhe pas mbarimit të afateve të ankimit, pasi nuk ka asnjë operator ekonomikë të kualifikuar.

Njoftimi i Anulimit për Loti 14 "Kanali ujitës Mjedë Kotërr", Nr. 1892/17 prot., datë 15.06.2022 është publikuar në SPE në datën 16.06.2022. Në këtë procedurë prokurimi nuk ka pasur asnjë ofertues në ditën e hapjes së ofertave dhe si rrjedhojë nuk ka qenë e nevojshme pritja e afateve të ankimit.

Njoftimi i Anulimit për Loti 19 "Mbrojtje nga përmytja nga lumi Gjolës i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë-Krujë", Nr. 1892/20 prot., datë 16.06.2022 është publikuar në SPE në datën 17.06.2022. Me publikimin e këtij njoftimi, filluan afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenit 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik". Pas përfundimit të afateve ligjore nuk u paraqit asnjë ankesë nga operatorët ekonomikë të s kualifikuar. Për sa më sipër ky lot mbetet i anuluar edhe pas

mbarimit të afateve të ankimit, pasi nuk ka asnjë operator ekonomikë të kualifikuar, vlerësuar dhe paraqitur në Raportin Përmbledhës nga KVO.

III. Auditimi i procedurës Loti 7: "Mbrojtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier", me fond limit 93,972,048 (nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyzet e tetë) Lekë pa TVSh.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim" Loti 7 "Mbrojtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier"		
<p>1. Urdhër Prokurimi, me nr. 1892/1 prot datë 29.03.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 13. E. M. Personi përgjegjës 14. E. J. 15. D. M.</p>	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike" REF-25919-04-21-2022</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin, me nr. 1892/9 prot datë 18.05.2022, me përbërje: 1. E.S., kryetar 2. G. H.i, anëtar 3. Ing. M.M., anëtar</p>
<p>4. Fondi Limit (pa TVSh) 93 972 048 (nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyzet e tetë) Lekë pa TVSh,</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratë është 74,398,800 (shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSh.</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 19,573,248 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 26.05.2022 ora 10.00</p>	<p>8. Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2022-2023</p>	<p>9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. O.E "2 T" ShPK me NUIS K.....M me ofertë ekonomike 74,398,800 (shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH. 2. O.E "A.K." ShPK me NUIS J.....R me ofertë ekonomike 82,546,170 (tetëdhjetë e dy milion e pesëqind e dyzetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. 3. O.E "G.P.G. C." ShPK me NUIS J....V me ofertë ekonomike 83,675,340 (tetëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë) lekë pa TVSH. 4. BOE "S." ShPK me NUIS J.....M dhe "A ." ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 82,729,164 (tetëdhjetë e dy milion e shtatëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. 5. BOE "A." ShPK me NUIS K.....P, "A.-2A CO" ShPK me NUIS K.....C dhe "U." ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 49,699,020 (dyzetë e nëntë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëzetë) lekë pa TVSH. 6. BOE "C." ShPK me NUIS K.....M dhe "B. T.I. M. S. VE T. LTD" Dege e shoqërisë së huaj me NUIS M.....L me ofertë ekonomike 84,761,766.60 (tetëdhjetë e katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. 7. O.E "C. R. 2008" ShPK me NUIS K.....V me ofertë ekonomike 43,885,552 (dyzetë e tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH. 8. BOE "E. K." ShPK me NUIS L.....T dhe "N." ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 74,860,015 (shtatëdhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH. 9. BOE "E." ShPK me NUIS J.....L dhe "A.-S." ShPK me NUIS J.....Ë me ofertë ekonomike 85,886,640 (tetëdhjetë e pesë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë pa TVSH. 10. O.E "GJ." ShPK me NUIS J.....H me ofertë ekonomike 84,170,352 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH. 11. O.E "L.T.E C." ShPK me NUIS L.....F me ofertë ekonomike 77,191,380 (shtatëdhjetë e shtatë milion e</p>

		njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH. 12. O.E “PE – V. - KU” ShPK me NUIS K.....M me ofertë ekonomike 88,330,023.60 (tetëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë mijë e njëzetë e tre pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. 13. O.E “SH. 07” ShPK me NUIS K.....Ë me ofertë ekonomike 51,517,830 (pesëdhjetë e një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.
10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit – S’ ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S’ ka	11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit S ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike S ka;	12. Përgjigje Ankesës nga KKP – nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
13. Lidhja e kontratës është bërë pranë D.U.K Fier	14.Zbatimi i Kontratës: Pranë D.U.K Fier	

-Me Urdhër Prokurimi, me nr. 1892/1 prot datë 29.03.2022, titullari i AK ka miratuar Njësine e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT, për Procedurën e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike me 19 lote, me përbërje:

E. M.Personi përgjegjës i njësisë,

E.J. dhe

D. M., anëtarë.

-Me urdhrin, me nr.1892/9 prot datë 18.05.2022, titullari i AK (z. O.M.) ka miratuar Komisionin e Vlerësimit Ofertave, me përbërje:

1. E.S., kryetar

2. G.H., anëtar

3. Ing. M. M., anëtar

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Nga pjesëmarrësit janë s’ kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “A.” ShPK me NUIS K.....P, “A. C” ShPK me NUIS K.....C dhe “U.” ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 49,699,020 (dyzetë e nëntë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëzetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar. Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar pasi OE “U.” ShPK sipas marrëveshjes së bashkëpunimit do të kryej 57,78% të punimeve, nisur nga kjo përqindje dhe sipas kërkesë për paraqitje të punonjës të specializuar, në këtë pikë, ky Operator duhet të deklaronte 9 (nëntë) punëtor të pajisur me Certifikata/Diploma, të lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh, ndërkohë ka deklaruar vetëm 6 (gjashtë) punëtorë.

Nuk plotëson pikën 7 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar pasi OE “U.” ShPK sipas marrëveshjes së bashkëpunimit do të kryej 57.78% të

punimeve, nisur nga kjo përqindje dhe sipas kërkesë në pikë 7 ku kërkohen, ndër të tjera, 4 (katër) kamion me kapacitet mbajtës min 20 ton dhe 4 (katër) kamion vetëshkarkues, OE “U.” ShPK në formularin e Vetë deklaramit nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitet mbajtës min 20 ton dhe vetëm 1 (një) kamion vetëshkarkues.

Nuk plotëson pikën 8 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar

2. BOE “C.” ShPK me NUIS K.....M dhe “B. T. I. M. S. VE T. LTD” Dege e shoqërisë së huaj me NUIS M.....L me ofertë ekonomike 84,761,766.60 (tetëdhjetë e katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

BOE nuk plotëson “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pasi në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit”, Deklarata Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, të dy OE, në pikën 6 kanë zgjedhur opsionin “PO”,

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nuk plotëson pikën 9, germat “a” dhe “c” të “Kapacitetit teknik”, pasi OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për Nyje Inerte dhe Nyje Betoni.

3. Operatori Ekonomik “C. R. 2008” ShPK me NUIS K.....V me ofertë ekonomike 43,885,552 (dyzetë e tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.

Nga OE janë deklaruar punonjësit sipas profesioneve të kërkuar dhe më konkretisht: punonjësi me iniciale B.A me profesion “Karpentier”, punonjësit me iniciale RR.GJ, J.D, A.SH dhe F.D me profesion “Hekurkthyes” dhe punonjësi me iniciale B.K me profesion “Saldator”. Për të gjithë këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “A.” me NUIS L.....K.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për “Formim Profesional”.

Nuk plotëson pikën 9, germa “b” të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet : ”... operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë... si dhe në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar”.

4. BOE “E. K.” ShPK me NUIS L.....T dhe “NDERTIMI” ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 74,860,015 (shtatëdhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar pasi OE “E. K.” ShPK sipas marrëveshjes së bashkëpunimit do të kryejë 90% të punimeve, nisur nga kjo përqindje dhe sipas kërkesës për paraqitje të punonjësve të specializuar, në këtë pikë, ky Operator duhet të deklaronte 14 (katërmëdhjetë) punëtorë të pajisur me Certifikata/Diploma, të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh, ndërkohë ka deklaruar vetëm 2 (dy) punëtorë.

Në mbështetje të nenit 26, pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se : “Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, duke qenë se në vetë deklaram nuk janë plotësuar të dhëna konkrete për punonjësit e specializuar, AK nuk mund të vërtetojë me paraqitjen e dokumenteve provues, se dokumenti është i njëjtë me atë të deklaruar në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

BOE nuk plotëson “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pasi në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit”, DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, të dy OE, në pikën 6 kanë zgjedhur opsionin “PO”, për deklaramtën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaram se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”.

Gjithashtu në pikën 7, të këtij formulari, të dy OE, kanë zgjedhur opsionin “JO”, për deklaramtën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaram se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaram se në dokumentet e bashkëngjitur, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomike ose nën-kontraktimit)”.

5. BOE “E.” ShPK me NUIS J.....L dhe “A.-S.” ShPK me NUIS J.....Ë me ofertë ekonomike 85,886,640 (tetëdhjetë e pesë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.

Nga OE “A.-S.” janë deklaruar punonjësit sipas profesioneve të kërkuar dhe më konkretisht: punonjësit me initiale D.K, D.M dhe Sh. D me profesion “Teknik Ndërtimi”, punonjësit me initiale A.B, A.B, A.K dhe B. Xh me profesion “Hekurkthyes”, punonjësit me initiale F.K, A.F, B.V, D.C dhe F.B me profesion “Karpentier” dhe punonjësit me initiale G.M, K.B dhe L.S me profesion “Saldator”. Për të gjithë këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “A.” me NUIS L.....K.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për “Formim Profesional”.

6. Operatori Ekonomik “GJ.” ShPK me NUIS J.....H me ofertë ekonomike 84,170,352 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 2.1.1, 2.1.2, 2.1.3 të “Kritere të veçanta për kualifikim” në lidhje me certifikata Iso të paraqitura. Pasi verifikimit në faqen zyrtare të lëshuesit të këtyre certifikatave, www.lmscert.com, rezultoi se ISO 9001, 14001 dhe 45001 janë të pezulluara, pra nuk janë të vlefshme.

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”.

Nga OE është deklaruar në formularin e Vetë deklaramit, punonjësit me initiale F.I dhe XH.Q me profesion “Hekurkthyes”, punonjësi me initiale Y.A me profesion “Karpentier”, punonjësi me initiale Sh.S me profesion “Saldator”. Për këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-5883-11-2012 me Titull “Formim

profesional” për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe nga QKB:

7. Operatori Ekonomik “L.T.E C.” ShPK me NUIS L.....F me ofertë ekonomike 77,191,380 (shtatëdhjetë e shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 1 të “Kapacitetit teknik”, pasi në dokumentacioni i paraqitur si kontrata: “Matësit UKT”

“Rikonstruksion rrjeti ujësjellës”

“Ndërtim rrjeti UKT” etj.

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.

Nuk plotëson pikën 9, germat “a”, “b” dhe “c” të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet : ”... operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë... si dhe në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar”, pasi OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për Nyje Inerte, Hekur dhe Nyje Betoni.

7. Operatori Ekonomik “P. – V. – K.” ShPK me NUIS K.....M me ofertë ekonomike 88,330,023.60 (tetëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë mijë e njëzetë e tre pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

-Nuk plotëson “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pasi në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklarimit”, DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, të dy OE, në pikën 6 kanë zgjedhur opsionin “PO”, për deklaratën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”

-Gjithashtu në pikën 7, të këtij formulari, të dy OE, kanë zgjedhur opsionin “JO”, për deklaratën si më poshtë: *“Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit)”*.

Pika 6 dhe 7 në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklarimit”, si më sipër, është pikërisht për rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit, operatorët ekonomikë kanë dorëzuar një ofertë si BOE dhe të dy deklarojnë se e kanë përgatitur ofertën e tyre në mënyrë të pavarur dhe nuk janë konsultuar me asnjë konkurrent tjetër.

-Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.

-Nuk plotëson pikën 9, germat “a”, “b” dhe “c” të “Kapacitetit teknik”, pasi OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për Nyje Inerte, Hekur dhe Nyje Betoni.

8. Operatori Ekonomik “SH.....07” ShPK me NUIS K.....Ë me ofertë ekonomike 51,517,830 (pesëdhjetë e një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.

Nga OE janë deklaruar punonjësit sipas profesioneve të kërkuar dhe më konkretisht: punonjësit me initiale A.A, D.H, E.F, F.Z, V.XH dhe XH.K me profesion “*Hekurkthyes*”, punonjësit me initiale A.H, A.S, D.F, F.I, I.N, N.M, L.H dhe V.SH me profesion “*Karpentier*” dhe punonjësit me initiale K.K dhe M.T me profesion “*Saldator*”. Për të gjithë këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “A.” me NUIS L.....K. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për “*Formim Profesional*”. Nga sa më sipër KVO ka vlerësuar OE “2 T” ShPK me NUIS K.....M, me ofertën e paraqitur me vlerë totale prej 74,398,800 (shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) Lekë pa TVSH, si Oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.06.2022.

Të dhënë në mënyrë tabelore, rezultojnë këta pjesëmarrës në tender me diferencat përkatëse të detajuar në vijim:

Nr.	Operatori Ekonomik	Fondi Limit	Vlera e Ofertës	Diferenca
1	OE: "C.R. 2008"	93,972,048	43,885,552	50,086,496
2	BOE A. & A.-2A-C.& U.	93,972,048	46,699,020	47,273,028
3	OE: Sh. 07	93,972,048	51,517,830	42,454,218
4	2 T	93,972,048	74,398,800	19,573,248
5	BOE: E. K.	93,972,048	74,860,015	19,112,033
6	OE: L. C.	93,972,048	77,191,380	16,780,668
7	A. C.	93,972,048	82,546,170	11,425,878
8	S. & A.	93,972,048	82,729,164	11,242,884
9	G. C.	93,972,048	83,675,340	10,296,708
10	OE: Gj.	93,972,048	84,170,352	9,801,696
11	BOE: C. & B.T. I.M. S. ve T. LTD	93,972,048	84,761,767	9,210,281
12	BOE: E. & A.S.	93,972,048	85,886,640	8,085,408
13	OE: P.-v.-k.	93,972,048	88,330,024	5,642,024

Nga sa më sipër konstatohet se OE: “C. R.2008”, konkretisht:

-“C. R. 2008”, ka dhënë ofertë në vlerën 43,885,552 lekë ose sa 46,7 % e fondit limit.

- OE “2 T”, i cili është shpallur fitues ka dhënë ofertë në vlerën 74,398,800 lekë ose sa 79,17 % e fondit limit.

Nisur nga arsyet e s’ kualifikimit konstatohet se për OE: “C. R. 2008” është s’ kualifikuar pasi nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet që *paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”.*

Nga OE janë deklaruar punonjësit sipas profesioneve të kërkuar dhe më konkretisht: punonjësit me initiale H.P, B.K, P.N dhe P.M me profesion “Teknik Ndërtimi”, punonjësit me initiale P.C, P.C, A.K dhe XH.D me profesion “Karpentier”, dhe punonjësi me initiale R.L me profesion “Saldator”. Për këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-5883-11-2012 me Titull "Formim profesional" për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe nga QKB:

- Me Vendimin nr. 2471 prot., datë 20.11.2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

-Me procesverbal nr. 11467, datë 22.12.2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve.

Në këto dy miratime, rezulton se shoqëria "Agjencia Shqiptare e Punësimit" me NUIS L.....G është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh." për profesionet "Teknik Ndërtimi", "Karpentier" dhe "Saldator".

Konkluzion: Grupi i auditimit e vlerëson këtë kriter përjashtues pasi të gjithë këta operatorë, nga historiku i prokurimeve në MBZHR, të s' kualifikuar për arsyen e sipërcituar nga KVO mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh." për profesionet "Teknik Ndërtimi", "Karpentier" dhe "Saldator", janë fitues në procedura të të njëjtit tip dhe kanë pasur kapacitetet teknike të mjaftueshme dhe të njëjtë për periudhën 2017-2021, ndërkohë në vitin 2022 të njëjtët OE vlerësohen me kapacitete teknike të pamjaftueshme ose e thënë ndryshe me teknikë jo të trajnuar dhe të pajisur me certifikatën tip të cilat sipas KVO duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh."

Nga verifikimet e kryera në lidhje me subjektin "Qendra e trajnimeve të avancuara-QTA" i cili është certifikuar nga MFE me shkresën nr. 17089/2, datë 01.12.2021 me lëndë:" Për ndryshim në Licencën e formimit profesional dhe shtim të listës së kurseve të formimit profesional përkatësisht:

Instalues i sistemeve ngrohëse; Saldator; Hidraulik; Pllaka shtrues; Karpentier; Murator-suvatues etj., rezulton që është vetëm ky subjekt privat i certifikuar nga MFE ose e thënë ndryshe ka "*ekskluzivi tetin*" e dhënies së këtyre certifikatave të cilat janë kurse jo më shumë se 85-90 orë mësimore që "zëvendësojnë" shkollat e arsimit profesional të cilat kanë një kohëzgjatje prej 3-vjet. (Verifikuar në certifikatat e lëshuara të marra nga sistemi elektronik i prokurimeve).

AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Sa më sipër konstatohet:

Duke parë rëndësinë e ofertave ekonomike më të mira ekonomikisht, në lidhje me kurset e specialistëve, nga KVO nuk duhej mbajtur qëndrim "*strikt*", në vlerësimin e ofertave, pasi nuk do të cenohej aspak realizimi i kontratës me sukses. Referuar ligjit mbi prokurimin publik, Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, ***gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.***

MBZHR, nuk ka siguruar të ulë shpenzimet procedurale dhe nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Për sa trajtuar më sipër, konstatohen efekte financiare ekonomike, ku operatori ekonomik "Sh. 07", me Nipt- K.....Ë me ofertë ekonomike 51,517,830 lekë pa TVSH,

ka pasur dhe plotësuar kapacitetet e plota ekonomike dhe teknike për realizimin e kontratës, e cila duhej të kishte parim çmimin më të ulët.

Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mosveprimet të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në dis favor të buxhetit të shtetit, përkatësisht:

- Nga s 'kualifikimi i OE "Sh. 07", me Nipt- K.....Ë, ShPK, veprimet e NJP dhe KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën **22,880,970 lekë pa TVSH = (74,398,800 – 51,517,830)**, si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, **Neni 2, i ligjit nr. 162/2020** ku përcaktohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;* **Neni 87 pika 4 e Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik"**: "*Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

Neni 45 pika 8 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021: "*Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra.*"

Observacion i ish- anëtarëve të KVO-së me nr. prot 1175/23 në lidhje me projekt raportin dërguar nga KLSH me nr. 1175/22. prot, datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën IV.C "Gjetjet dhe rekomandimet", rekomandimi 3.1, 3.2, në faqet 396-397, të propozuara nga GA, vihet re se:

GA, në asnjë rast nuk është shprehur se KVO ka vepruar në shkelje të parashikimeve ligjore të LPP, në s' kualifikimin e OE në fjalë, por vetëm se është treguar e ngurtë dhe strikte gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre në përmbushje të pikës 6 të "Kapacitetit teknik".

GA në asnjë rast nuk ka konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga OE të shpallur fitues.

KVO gjykon se GA duhet të propozojë masa organizative dhe jo masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin e 3E-vetë fondeve publike, duke rekomanduar që KVO duhet të tregohet më fleksibël gjatë fazës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Për sa ju shkruani në observacionin tuaj se KVO nuk ka vepruar në shkelje të parashikimeve ligjore të LPP, ri kujtojmë së në fund të çdo trajtimi GA ka vendosur edhe bazën ligjore për të cilën vlerëson se nuk është zbatuar nga KVO dhe konkretisht: Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021.

Neni 2, i ligjit nr. 162/2020 ku përcaktohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

Neni 87 pika 4 e Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik": "*Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

Neni 45 pika 8 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021: "*Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra.*". Për sa më sipër qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Observacioni juaj pranohet pjesërisht përsa i përket reflektimit nga Masa 3E në kalimin në masa organizative, por në lidhje me konstatimet e kryera qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

IV. Loti 8: Të dhënat e përgjithshme të procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstrukioni i hidrovorit të Akërnisë”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim” Loti 8 “Rikonstrukioni i hidrovorit të Akërnisë”		
1. Urdhër Prokurimi , me nr. 1892/1 prot datë 29.03.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 16. E.M.Personi përgjegjës 17. E. J. 18. D.M.	2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike”.	3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave , i ngritur me urdhrin, me nr.1892/9 prot datë 18.05.2022, me përbërje: 1. E.S. kryetar 2. G. H., anëtar 3. Ing. M. M., anëtar
4.Fondi Limit (pa TVSh) 151 242 491 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) Lekë pa TVSh,	5. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratës është 132,870,369 (njëqind e tridhjetë e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSh.	6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 18,372,122 (tetëmbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH më pak se fondi limit ose sa 87,85 % e fondit limit.
7. Data e hapjes së tenderit Data 26.05.2022 ora 10.00	8.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2022-2023	9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. O.E. “A.-I., G. C.” ShPK me NUIS K.....I me ofertë ekonomike 147,699,646.10 (njëqind e dyzetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë pikë dhjetë) lekë pa TVSh. 2. O.E. “G.P.G C.” ShPK me NUIS J.....V me ofertë ekonomike 132,870,369 (njëqind e tridhjetë e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSh. 3. O.E. “GJ.” ShPK me NUIS J....H me ofertë ekonomike 136,464,989 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSh.
10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S’ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S’ka	11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit S’ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike S’ka;	12. Përgjigje Ankesës nga KKP – nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
13. Lidhja e kontratës është bërë pranë D.U.K Fier.	14. Zbatimi i Kontratës: Pranë D.U.K Fier	

-Me Urdhër Prokurimi, me nr. 1892/1 prot datë 29.03.2022, titullari i AK (z. O. M.) ka miratuar Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT, për Procedurën e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike me 19 lote, me përbërje:

E.M.Personi përgjegjës i njësisë,

E.J.dhe

D.M., anëtarë.

-Me urdhrin, me nr.1892/9 prot datë 18.05.2022, titullari i AK (z. O. M.) ka miratuar Komisionin e Vlerësimit Ofertave, me përbërje:

1. E. S., kryetar

2. G. H., anëtar

3. Ing. M. M., anëtar

Procedura e prokurimit: *“Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike”*, me objekt: *“Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”*, Loti 8 *“Rikonstruksioni i hidrovorit të Akërnisë, Vlorë”*, me fond limit **151,242,491** (njëqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dyzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSh dhe me nr. **REF-25921-04-21-2022**.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto □
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Nga pjesëmarrësit janë s’ kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1-Operatori Ekonomik “A.-I. G.I C.” ShPK me NUIS K.....I me ofertë ekonomike 147,699,646.10 (njëqind e dyzet e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë dhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet:

- Nuk plotëson pikën 10, germa “d” dhe “f” të *“Kapacitetit teknik”*, ku kërkohet: *“... operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë... si dhe në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar”*.

OE ka paraqitur *“Kontratë Furnizimi”* me nr. Rep 2912, nr. Kol. 1347 datë 24.05.2022 lidhur me shoqërinë “B.” ShPK me NUIS K.....C, ku nuk specifikohet roli i kësaj shoqërie dhe nuk është paraqitur asnjë dokument që bën lidhjen e shoqërisë “B.” ShPK me prodhuesin e elektro pompave.

- OE ka paraqitur *“Kontratë Furnizimi”* me datë 12.05.2022 lidhur me shoqërinë “A.” ShPK me NUIS J.....A dhe nuk është paraqitur asnjë dokument që bën lidhjen e shoqërisë “A.” ShPK me prodhuesin/prodhuesit e materialeve elektrike.

- Nuk plotëson pikën 6 të *“Kapacitetit teknik”*, ku kërkohet se: *paraqitja e Certifikatave/diplomave duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”*.

Nga OE është deklaruar në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, se punonjësit me initiale A.M, K.SH dhe K.M me profesion *“Hidraulik”*, SH.P, H.XH dhe S.GJ me profesion *“Elektricitet”* dhe punonjësit me initiale I.I dhe H.Z me profesion *“Suvatues”*, janë të pajisur me certifikatë/diplomë të lëshuar nga “F. E. V.”, gjithashtu OE ka paraqitur Diploma/Certifikata për punonjësit e specializuar në SEP. Në këtë diplomë evidentohet se licenca për formim profesional është ajo me nr. LN-2242-04-2021.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, me licencën me nr. LN-2242-04-2021 me Titull “Formim profesional” rezulton Licencë e lëshuar për subjektin “F. M.” me NUIS L.....C me emër tregtar “F. E.” sipas ekstraktit, për të cilën figuron një miratim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Me shkresën nr. 6344/2 prot., datë 04.05.2021, i është miratuar ofrimi i kurseve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Shoqëria “F. M.” me NUIS L.....C bazuar në miratimin më sipër është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale për disa profesione por nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”* për profesionet *“Hidraulik”*, *“Suvatues”* dhe *“Elektricitet”*.

2-Operatori Ekonomik “GJ.” ShPK me NUIS J.....H me ofertë ekonomike 136,464,989 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, është s’ kualifikuar për mos plotësim kriteresh, si vijon:

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

Nga OE është deklaruar në formularin e Vetë deklarimit, punonjësit me iniciale M.H dhe B.K me profesion “*Elektracist*”, punonjësit me iniciale A.L dhe A.XH me profesion “*Karpentier*”, punonjësi me iniciale A.XH me profesion “*Hidraulik*”. Për këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-5883-11-2012 me Titull “Formim profesional” për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe nga QKB:

- Me Vendimin nr. 2471 prot., datë 20.11.2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

-Me procesverbal nr. 11467, datë 22.12.2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve.

• Në këto dy miratime, rezulton se shoqëria “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionet “*Elektracist*”, “*Karpentier*” dhe “*Hidraulik*”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomik “G.P.G C.” ShPK me NUIS J.....V me ofertë ekonomike 132,870,369 (njëqind e tridhjetë e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.06.2022

Në lidhje me OE fitues u verifikua dosja fizike dhe plotësimi i Kriterëve të Përgjithshme dhe të Veçanta të kualifikimit, nga të cilat nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve të vendosura nga NJP.

V. Loti 9: “Rehabilitim i kanalit ujitës krahu i djathtë rezervuari Gjanç”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim” Loti 9 “Rehabilitim i kanalit ujitës krahu i djathtë rezervuari Gjanç”		
<p>1. Urdhër Prokurimi , me nr. 1892/1 prot datë 29.03.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <p>19. E. M. Personi përgjegjës 20. E.J. 21. D. M.</p>	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike”.</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin, me nr.1892/9 prot datë 18.05.2022, me përbërje:</p> <p>1. E.S., kryetar 2. G. H., anëtar 3. Ing. M. M., anëtar</p>
<p>4.Fondi Limit (pa TVSh) 74 521 353 (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) Lekë pa TVSh,</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratës është 66,465,840 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzetë) lekë pa TVSh.</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 8,055,513 (tetë milion e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH ose sa 89,19 % e fondit limit.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 26.05.2022 ora 10.00</p>	<p>8.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2022-2023</p>	<p>9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës:</p> <p>1. O.E “F.” ShPK me NUIS J.....S me ofertë ekonomike 72,285,202.50 (shtatëdhjetë e dy milion e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSh. 2. O.E. “H.” ShPK me NUIS J.....B me ofertë ekonomike 64,293,759.60 (gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSh. 3. B.O.E. “I.” ShPK me NUIS J.....M dhe “L.T.E C.” me NUIS L.....F me ofertë ekonomike 59,006,705.10 (pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtë mijë e shtatëqind e pesë pikë dhjetë) lekë pa TVSh.</p>

		4. B.O.E “K.” ShPK me NUIS K.....C dhe “N.” ShPK me NUIS K....I, me ofertë ekonomike 63,237,458 (gjashtëdhjetë e tre milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSh 5. O.E. “R.” ShPK me NUIS J.....Q me ofertë ekonomike 57,639,393(pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSh 6. B.O.E “S.” ShPK me NUIS J.....M dhe “A .” me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 66,465,840 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzetë) lekë pa TVSh, fitues 7.O.E. “U.” ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 59,271,450 (pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSh
10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S ka	11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit S ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike S ka;	12. Përgjigje Ankesës nga KKP – nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
13. Lidhja e kontratës është bërë pranë D.U.K Korçë	14.Zbatimi i Kontratës: Pranë D.U.K Korçë	

B.O.E “S,” ShPK me NUIS J.....M dhe “A.” me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 66,465,840 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet) Lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 27.06.2022

E dhënë në tabelë diferenca ndërmjet ofertat të OE pjesëmarrës me fondin limit jepet në vijim:

Nr	Operatori ekonomik	Fondi Limit	Oferta	Diferenca me fondin limit
1	R.	74,521,353	57,639,393	16,881,960
2	BOE “I.& L.T.E C.	74,521,353	59,006,705.10	15,514,648
3	U.	74,521,353	59,271,450	15,249,903
4	BOE “K.” & N.	74,521,353	63,237,458	11,283,895
5	H.	74,521,353	64,293,759.60	10,227,593
6	S.” & “A.	74,521,353	66,465,840	8,055,513
7	F.	74,521,353	72,285,202.50	2,236,151

Nga tabela konstatohet që nuk ka fituar vlera më e ulët por ka fituar një nga ofertat më të larta e renditur e dyta respektivisht sipas vlerës.

Në analizën e KVO, rezultoi se janë s’ kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “H.” ShPK me NUIS J.....B me ofertë ekonomike 64,293,759.60 (gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

OE në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, ka deklaruar punonjësit me iniciale E.C dhe B.K me profesion “Karpentier” dhe punonjësin me iniciale M.K me profesion “Hekurkthyes”, të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria “A. Sh. P.” me NUIS L.....G, është e licencuar me licencën me nr. LN-5883-11-2012, me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime për ofrimin e kurseve profesionale nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe nga QKB:

- Me Vendimin nr. 2471 prot., datë 20.11.2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

-Me procesverbal nr. 11467, datë 22.12.2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve.

Në këto dy miratime rezulton se shoqëria “A. Sh.P.” me NUIS L.....G, është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionet “Karpentier” dhe “Hekurkthyes”.

2. BOE “I.” ShPK me NUIS J.....M dhe “L.T.E C.” me NUIS L.....F me ofertë ekonomike 59,006,705.10 (pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtë mijë e shtatëqind e pesë pikë dhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- BOE nuk plotëson pikën 2.1.1, 2.1.2, 2.1.3 të “Kritere të veçanta për kualifikim” pasi certifikata Iso të paraqitura nga OE “I.”, pas verifikimit në faqen zyrtare të lëshuesit të këtyre certifikatave, https://www.rigcert.org/certification_check, rezultoi se ISO 9001, 14001 dhe 45001 janë të pezulluara, pra nuk janë të vlefshme.

- Nuk plotëson pikën 2.1, germa a të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pasi formularët e vetë deklarimit sipas shtojcës 8, nga të dy operatorët ekonomik, nuk janë plotësuar sipas formatit, ku në faqen e parë përcaktohet:

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatori ekonomik në BOE).

Të dy operatorët ekonomik nuk e kanë deklaruar njëri tjetrin në këtë seksion.

- BOE nuk plotëson “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pasi në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklarimit”, DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura e paraqitur nga OE “I.”, në pikën 6 ka zgjedhur opsionin “PO”, për deklaratën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”.

Gjithashtu në pikën 7, të këtij formulari OE ka zgjedhur opsionin “JO”, për deklaratën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit)”.

Pika 6 dhe 7 në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklarimit”, si më sipër, është pikërisht për rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit, operatorët ekonomikë kanë dorëzuar një ofertë si BOE dhe një nga OE deklaron se e ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur dhe nuk është konsultuar me asnjë konkurrent tjetër.

- BOE nuk plotëson “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pasi në “Formularin Përmbledhës të Vetë deklarimit” të paraqitur nga OE “I.” në seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt

kontrate”, ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet njerëzore të subjektit “K.T.” me NUIS K.....A, por nuk ka paraqitur formular Vetë deklarimi më vete për subjektin në të cilin do të mbështetet. Në shtojcën 8, formularin e Vetë deklarimit, të publikuar në DST, në fund të tij është përcaktuar se:

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetë deklarimit.*
- *Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetë deklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”.*

Në përmbushje të kontratës së bashkëpunimit, OE “I.” do të realizojë 94.06% të punimeve, si rrjedhojë do duhet të deklaronte minimumi 2 hekurkthyes dhe 2 karpentier. Në formularin e Vetë deklarimit ka paraqitur vetëm 1 punonjës me profesion hekurkthyes me inicialet D.SH i pajisur me Certifikate/Diplome të lëshuar nga “HSEM”. Në formularin e Vetë deklarimit nga OE “L.T.E C.” i cili do të realizojë 5.94% të punimeve, janë deklaruar punonjës me profesion hekurkthyes (3 punonjës) dhe karpentier (3 punonjës) të gjithë të pajisur me Certifikate/Diplome të lëshuar nga “HSEM”.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-2754-02-2017 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:

- Me shkresën nr. 1004/2 prot., datë 03.03.2017, i është miratuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

-Me shkresën nr. 1390 prot., datë 23.01.2018, i është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në këto dy miratime evidentohet se shoqëria “H. S. E. M.” me NUIS L.....B, është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.” për profesionet “Karpentier” dhe “Hekurkthyes” dhe nuk përmbushen parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”.

- *Nuk plotëson pikën 7 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet se : Për mjetet e deklaruarat me qira, nëse parashikohet ne ligj, duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi (nëse parashikohet ne ligj); ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë (e vlefshme). Nga OE “I.” janë paraqitur 2 kontrata qiraje për mjetet me qira të lidhura midis tij dhe subjekteve “F.” ShPK dhe “K.T.” ShPK të cilat nuk janë noteriale.*

3. BOE “K.” ShPK me NUIS K.....C dhe “N.” ShPK me NUIS K.....I, me ofertë ekonomike 63,237,458 (gjashtëdhjetë e tre milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- *Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, nuk përmbush parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar pasi OE “K.” ShPK sipas marrëveshjes së bashkëpunimit do të kryej 81.5% të totalit të punimeve, nisur nga kjo përqindje dhe sipas kërkesë për paraqitje të punonjës të specializuar sipas profesioneve, në këtë pikë, ky Operator duhet të deklaronte minimumi 5 (pesë) punëtor të specializuar në profesionet teknik ndërtimi, hekurkthyes dhe karpentier të pajisur me Certifikata/Diploma, të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh, ndërkohë ka*

në tabelën e plotësuar ka deklaruar 1 (një) teknik ndërtimi, 3 (tre) karpentier dhe asnjë hekurkthyes.

Nga OE “K.” në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, ka deklaruar punonjësit me iniciale M.S dhe R.C me profesion “Karpentier” të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria “A. Sh. P.” me NUIS L.....G, është e licencuar me licencën me nr. LN-5883-11-2012, me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime për ofrimin e kurseve profesionale nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe nga QKB:

- Me Vendimin nr. 2471 prot., datë 20.11.2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

-Me procesverbal nr. 11467, datë 22.12.2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve.

Në këto dy miratime rezulton se shoqëria “A. Sh. P.” me NUIS L.....G, është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionin “Karpentier”.

Nga ana e BOE nuk është deklaruar asnjë punonjës me profesion hekurkthyes i pajisur me Certifikata/Diploma, të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.

- Nuk plotëson pikën 9, germa a dhe germa c të “Kapacitetit teknik”, BOE nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi për Nyje inerte dhe Nyje betoni. Sipas përcaktimeve në DST, kjo pikë do të plotësohet me paraqitjen e dokumentacionit në fazën e ofertimit. Nga ana e BOE, nuk është paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të kësaj pike.

4. Operatori Ekonomik “R.” ShPK me NUIS J.....Q me ofertë ekonomike 57,639,393(pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh*

OE në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, ka deklaruar punonjësit me iniciale E.H dhe A.K me profesion “Karpentier”, punonjësit me iniciale N.J dhe J.G me profesion “Hekurkthyes” dhe punonjësit me iniciale N.C dhe E. Xh me profesion “Teknik Ndërtimi” të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “HTM” me NUIS K.....D.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licencë për “Formim Profesional”.

Nga sa me sipër shoqëria “HTM” me NUIS K.....D, nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionet “Teknik Ndërtimi”, “Hekurkthyes” dhe “Karpentier”.

Gjithashtu nga OE është deklaruar po i njëjti punonjës si më sipër me iniciale A.K me profesion “Karpentier” të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga shoqëria “Re/Born” me NUIS L.....P, e cila nga kontrolli i bere në ekstraktin historik ka ndryshuar emrin në datë 06/07/2020 nga “Re/Plus” në “Re/Born”.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria “R./B.” me NUIS L.....P, është e licencuar me licencën me nr. LN-7449-06-2019, me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Financave dhe

Ekonomisë: Me shkresën nr. 10051/2 prot., datë 06.06.2019, i është miratuar ofrimi i kurseve të formimit profesional në: “Sisteme Menaxhimi sipas standardeve ISO 9001; 14001; OHSAS 18001”. Me shkresën nr. 3395/2 prot., datë 16.03.2021, i është miratuar për ndryshim në licencën për formim profesional dhe ofrim të kurseve, përveç ndryshimit të adresës së ushtrimit të aktivitetit dhe shtim i listës ekzistuese të kurseve me kurset: “Përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë”, “Plane emergjencash dhe evakuim nga zjarri dhe “auditor dhe kontrollor HACCP”. Nga sa me sipër shoqëria “R./B.”/R.P. me NUIS L7.....P, nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”, për profesionin “Karpentier”.

Nuk plotëson pikën 9, germa a, germa b dhe germa c të “Kapacitetit teknik”, OE nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi për Nyje inerte, Nyje betoni dhe Hekur. Në formularin e Vetë deklarimit janë deklaruar dy kontrata furnizimi, një për Nyje Inerte Beton dhe një për Hekur, të cilat kanë për referencë të njëjtin numër kontrate (Nr. 1033) dhe po të njëjtën datë (26.05.2022) por me dy subjekte të ndryshme, e para me subjektin “F.” dhe tjetra me subjektin “F.K.”. Sipas përcaktimeve në DST, kjo pikë do të plotësohet me paraqitjen e dokumentacionit në fazën e ofertimit. Nga ana e OE, nuk është paraqitur asnjë dokumentacion në SPE në përmbushje të kësaj pike.

5. Operatori Ekonomik “U.” ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 59,271,450 (pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- OE “U.” nëpërmjet SPE, emalit të deklaruar dhe me shkresë zyrtare me lëndën: “Kërkesë për sqarim” me nr. 3350 prot. datë 20.06.2022, bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 82, pika 2 i janë kërkuar sqarime dhe paraqitja e dokumenteve mbështetëse në lidhje me vetë deklarimin, në lidhje me lëshuesin e Certifikatë/Diplomës për punonjësit e specializuar, sipas profesioneve të kërkuara në pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, pasi pas verifikimeve të bëra në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, nuk ekziston licenca me Nr. Licence 2395 datë.02.12.2008. OE nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë brenda 3 (tre) ditëve si afat i përcaktuar në kërkesë.

KVO dërgoi përsëri kujtesë nëpërmjet adresës së email që OE të deklaruar në formularin e Vetë deklarimit, në datë 23.06.2022 me lëndën “Kërkesë për sqarim (kujtese)” ku ndër të tjera OE iu bë me dije se : “Në rast të mos marrjes së një përgjigjeje, oferta juaj do të refuzohet”.

Nisur nga fakti se OE nuk ka kthyer asnjë përgjigje, oferta e tij refuzohet.

Sa më sipër konstatohet:

Duke parë rëndësinë e ofertave ekonomike më të mirë ekonomikisht, në lidhje me kurset e specialistëve, nga KVO nuk duhej mbajtur qëndrim “strikt”, në vlerësimin e ofertave, pasi nuk do të cenohej aspak realizimi i kontratës me sukses. Referuar ligjit mbi prokurimin publik Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, **gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.**

Për sa trajtuar më sipër, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatohen efekte financiare ekonomike, ku operatori ekonomik “H.” ShPK, “U.” ShPK, kanë pasur dhe plotësuar kapacitetet e plota ekonomike dhe teknike për realizimin e kontratës e cila, *duhej të kishte parim çmimin më të ulët.*

Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mos veprimin të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në dis favor të buxhetit të shtetit, përkatësisht:

1-Nga s ‘kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “H.” ShPK me NUIS J.....B me ofertë ekonomike 64,293,759.60 lekë, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një

pagesë në dis favor në vlerën **172,080 lekë pa TVSH** = (66,465,840 – 64,293,760), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

2-Nga s 'kualifikimi i OE Operatori Ekonomik "U." ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 59,271,450 lekë pa tvsh, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën **7,194,390 lekë pa TVSH** = (66,465,840 – 59,271,450), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021

Neni 2, i ligjit nr. 162/2020 ku përcaktohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;* Neni 87 pika 4 e Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik": "*Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

Neni 45 pika 8 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021: "*Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra.*"

Për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit ka vlerësuar në mënyrë "të ngurtë" pikën 6 të "*Kapacitetit teknik*", ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh*

Gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht mangësive, përpara se të kryente s 'kualifikimin, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e neni 53 pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, sipas të cilit: "*autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*". Në alternativë, sa më sipër KVO-ja, midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë, referuar neni 2 të LPP 162/2020 "Për prokurimin publik", me qëllim rritjen e efizienzës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirë përdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është "*Çmimi më i leverdishëm*", për të bërë të mundur shmangien e përdorimit me pa efektivitet të fondeve publike në vlerën 7,366,470 lekë si diferenca totale midis ofertave të OE në klasifikimin e mësipërm.

Observacion i ish- anëtarëve të KVO-së me nr. prot 1175/23 në lidhje me projekt raportin dërguar nga KLSH me nr. 1175/22. prot, datë 19.06.2023.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën IV.C "Gjetjet dhe rekomandimet", rekomandimi 3.1, 3.2, në faqet 396-397, të propozuara nga GA, vihet re se:

GA, në asnjë rast nuk është shprehur se KVO ka vepruar në shkelje të parashikimeve ligjore të LPP, në s' kualifikimin e OE në fjalë, por vetëm se është treguar e ngurtë dhe strikte gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre në përmbushje të pikës 6 të "Kapacitetit teknik".

GA në asnjë rast nuk ka konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga OE të shpallur fitues.

KVO gjykon se GA duhet të propozojë masa organizative dhe jo masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin e 3E-vetë fondeve publike, duke rekomanduar që KVO duhet të tregohet më fleksibël gjatë fazës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Observacioni juaj pranohet pjesërisht përsa i përket kalimit nga 3E në masa organizative. Për sa ju shkruani në observacionin tuaj se KVO nuk ka vepruar në shkelje të parashikimeve

ligjore të LPP, ri kujtojmë së në fund të çdo trajtimi GA ka vendosur edhe bazën ligjore për të cilën vlerëson se nuk është zbatuar nga KVO dhe konkretisht: Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021,

Neni 2, i ligjit nr. 162/2020 ku përcaktohet se: “Qëllim i këtij ligji është: **a)** të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; **b)** të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; **c)** të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; **ç)** të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

Neni 87 pika 4 e Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese”.

Neni 45 pika 8 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021: "Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehën në shifra".

Për sa më sipër qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm në lidhje me konstatimet e kryera vetëm ndryshon në propozim të masave organizative dhe jo në masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin e 3E.

VI. Auditimi i procedurës së prokurimit: Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirg.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim” Loti 17 “Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirg”		
<p>1. Urdhër Prokurimi , me nr. 1892/1 prot datë 29.03.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën. Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT 22. E.M.Personi përgjegjës 23. E. J. 24. D. M.</p>	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike” REF-25942-04-21-2022</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin, me nr.1892/9 prot datë 18.05.2022, me përbërje: 1. E. S., kryetar 2. G. H., anëtar 3. Ing. M. M., anëtar</p>
<p>4.Fondi Limit (pa TVSh) 57,139,289 (pesëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSh,</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) Vlera e kontratës është 39,800,003 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë e tre) lekë pa TVSH.</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 17,339,286 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 26.05.2022 ora 10.00</p>	<p>8.Burimi Financimit nga Buxheti i Shtetit 2022-2023</p>	<p>9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës: 1. O.E “A. T.” ShPK me NUIS J.....C me ofertë ekonomike 40,117,015 (dyzet milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH. 2. O.E. “A.” ShPK me NUIS J7.....K me ofertë ekonomike 49,814,571 (dyzetë e nëntë milion e tetëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH. 3. O.E. “C.” ShPK me NUIS J.....S me ofertë ekonomike 48,510,240 (dyzetë e tetë milion e pesëqind e dhjetë mijë e dyqind e dyzetë) lekë pa TVSH. 4. O.E “D. G.” ShPK me NUIS J.....U me ofertë ekonomike 54,271,565 (pesëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH 5. B.O.E. “E.-A.” ShPK me NUIS K.....H dhe “M.” ShPK me NUIS J.....V, me ofertë ekonomike 34,949,033 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzetë e nëntë mijë e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH. 6. B.O.E “E. H.SH.P.K. DEGA NE SHQIPERË” me NUIS K.....A dhe “D.-05” ShPK me NUIS K.....B me ofertë ekonomike 37,693,159 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH. 7.O.E. “J.A.” ShPK me NUIS K.....I me ofertë ekonomike 39,800,003 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë e tre) lekë pa TVSH. 8. O.E. “N. 2014” ShPK me NUIS L.....L me ofertë</p>

		<p>ekonomike 56,167,136 (pesëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.</p> <p>9. O.E. "P. – V. – K." ShPK me NUIS K.....M me ofertë ekonomike 48,524,948 (dyzetë e tetë milion e pesëqind e njëzetë e katër mijë e nëntëqind e dyzetë e tetë) lekë pa TVSH.</p> <p>10. O.E. "C. R. 2008" ShPK me NUIS K.....V me ofertë ekonomike 31,133,770.86 (tridhjetë e një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.</p> <p>11. O.E. "SH. I." ShPK me NUIS J.....T me ofertë ekonomike 54,130,373 (pesëdhjetë e katër milion e njëqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.</p> <p>12. O.E. "S.2F" ShPK me NUIS K.....J me ofertë ekonomike 54,275,164 (pesëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.</p> <p>13. B.O.E "S.M.O.U." ShPK me NUIS J.....Q dhe "B." ShPK me NUIS J.....G me ofertë ekonomike 41,566,041 (dyzetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyzetë e një) lekë pa TVSH.</p> <p>14. B.O.E "S. V." ShPK me NUIS L.....J dhe "D.-M." ShPK me NUIS K.....L me ofertë ekonomike 46,164,888 (dyzetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.</p> <p>15. O.E "S." ShPK me NUIS J.....M me ofertë ekonomike 51,303,579 (pesëdhjetë e një milion e treqind e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.</p> <p>16. O.E. "U." ShPK me NUIS K.....Q me ofertë ekonomike 43,040,507 (dyzetë e tre milion e dyzetë mijë e pesëqind e shtatë) lekë pa TVSH.</p> <p>17. O.E. "U." ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 44,414,465 (dyzetë e katër milion e katërqind e katërbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.</p> <p>18. B.O.E "V. E" ShPK me NUIS J.....S dhe "A." ShPK me NUIS J.....I me ofertë ekonomike 48,507,191 (dyzetë e tetë milion e pesëqind e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.</p>
<p>10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S'ka</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike -Ankesë A. me Nr. 1449/2022 prot., datë 06.07.2022 nga operatori ekonomik "C. R.2008"</p>	<p>11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit S'ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike Me shkresën nr. 3590/9 prot., datë 14.07.2022 KSHA ka përcjellë pranë Operatorit Ekonomik "C.R.2008" mos pranimin e ankesës.</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës nga KKP –a Vendimi nr. 745/2022 datë 03.08.2022 i Komisionit të Prokurimit Publik ku është vendosur të mos pranohet ankesa e paraqitur.</p>
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>13. Lidhja e kontratës është bërë pranë D.U.K Lezhë</p>	<p>14 .Zbatimi i Kontratës: Pranë D.U.K Lezhë</p>	

Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike", me objekt: "Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim", **Loti 17 "Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgj"**, me fond limit **57,139,289** (pesëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH, dhe me Nr. **REF-25942-04-21-2022**.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik	Fondi Limit	Oferta	Diferenca me fondin limit
1	"C. R.2008	57,139,289	31,133,770.86	26,005,518
2	E.-A.dhe M.	57,139,289	34,949,033	22,190,256
3	O.E "E. H. SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI" me NUIS K.....A dhe "D.-05" ShPK me NUIS K.....B	57,139,289	37,693,159	19,446,130
4	JUBICA	57,139,289	39,800,003	17,339,286
5	A.T.	57,139,289	40,117,015	17,022,274
6	S.M.O.U. dhe "B.	57,139,289	41,566,041	15,573,248
7	U.	57,139,289	43,040,507	14,098,782
8	U.	57,139,289	44,414,465	12,724,824
9	S.V. dhe D.-M.	57,139,289	46,164,888	10,974,401
10	V. E dhe A.	57,139,289	48,507,191	8,632,098
11	C.	57,139,289	48,510,240	8,629,049
12	P. – V.- K.	57,139,289	48,524,948	8,614,341
13	A.	57,139,289	49,814,571	7,324,718
14	S.	57,139,289	51,303,579	5,835,710
15	SH. I.	57,139,289	54,130,373	3,008,916
16	D. G.	57,139,289	54,271,565	2,867,724
17	S . 2F	57,139,289	54,275,164	2,864,125
18	N. 2014	57,139,289	56,167,136	972,153

Nga pjesëmarrësit KVO ka s' kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik "A. T." ShPK me NUIS J.....C me ofertë ekonomike 40,117,015 (dyzet milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të "Kapacitetit teknik", ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh."*.

OE në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, ka deklaruar punonjësit me iniciale S.T dhe Xh. V me profesion "Karpentier" dhe punonjësit me iniciale F.R dhe Y.D me profesion "Teknik Ndërtimi" të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga "H." me NUIS K.....D.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për "Formim Profesional".

Nga sa me sipër shoqëria "H." me NUIS K.....D, nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh." për profesionet "Teknik Ndërtimi" dhe "Karpentier".

2. Operatori Ekonomik "A." ShPK me NUIS J.....K me ofertë ekonomike 49,814,571 (dyzetë e nëntë milion e tetëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik” ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

Nga OE është deklaruar se punonjësit me iniciale N.H dhe SH.M me profesion “Karpentier” janë të pajisur me certifikate/diplomë të lëshuar nga shoqëria “R./B.” me NUIS L.....P, e cila nga kontrolli i bere në ekstraktin historik ka ndryshuar emrin në datë 06/07/2020 nga “R./P.” në “R./B.”.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër është e licencuar me licencën me nr. LN-7449-06-2019 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Me shkresën nr. 10051/2 prot., datë 06.06.2019, i është miratuar ofrimi i kurseve të formimit profesional në: “Sisteme Menaxhimi sipas standardeve ISO 9001; 14001; OHSAS 18001”.

-Me shkresën nr. 3395/2 prot., datë 16.03.2021, i është miratuar për ndryshim në licencën për formim profesional dhe ofrim të kurseve, përveç ndryshimit të adresës së ushtrimit të aktivitetit dhe shtim i listës ekzistuese të kurseve me kurset: “Përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë”, “Plane emergjencash dhe evakuim nga zjarri dhe “auditor dhe kontrollator HACCP”.

Nga sa me sipër, shoqëria “R./B.”/R.P.me NUIS L.....P nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionin “Karpentier”.

- Nuk plotëson pikën 9, germa c të “Kapacitetit teknik” pasi kontrata nr. Rep.8314, nr. Kol. 3277 datë 14.11.2018 e lidhur me shoqërinë “A-K. B. –A.” për furnizimin me beton, nuk ka të parashikuar afatin e kontratës.

3. Operatori Ekonomik “C.” ShPK me NUIS J.....S me ofertë ekonomike 48,510,240 (dyzetë e tetë milion e pesëqind e dhjetë mijë e dyqind e dyzetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jenë të lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

OE në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, ka deklaruar punonjësit me iniciale Q.S dhe A.B me profesion “Karpentier” të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “T.” me NUIS L.....F.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për “Formim Profesional”.

Nga sa me sipër shoqëria “T.” me NUIS L.....F, nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionin “Karpentier”.

- Nuk plotëson pikën 9, germa a dhe germa b të “Kapacitetit teknik”, OE nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi për Nyje inerte dhe Nyje betoni. Në formularin e Vetë deklarimit janë deklaruar dy kontrata furnizimi, një për Nyje Inerte dhe një për Beton, të cilat kanë për referencë të njëjtën datë (10.09.2021) por me dy subjekte të ndryshme, e para me subjektin “B. & C.” dhe tjetra me subjektin “A.-B.”.

4. Operatori Ekonomik “D.G.” ShPK me NUIS J.....U me ofertë ekonomike 54,271,565 (pesëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 2.1, germa a të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pasi në plotësimin e *Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit*, sipas shtojcës 8, në seksionin:

D. Deklaratë mbi Mos angazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

OE në kolonën “Përgjigje” nuk ka deklaruar as PO as JO lidhur me angazhimin e mjeteve në kontrata të tjera.

- Nuk plotëson pikën 2.1.4, të “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pasi OE nuk ka paraqitur licence me kod III. 2 B siç kërkohet në DST.

5. BOE “E.-A.” ShPK me NUIS K.H dhe “M.” ShPK me NUIS J...V, me ofertë ekonomike 34,949,033 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzetë e nëntë mijë e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 2, të “*Kapacitetit Teknik*”, pasi anëtar i BOE, shoqëria “M.” ShPK me NUIS J....V, nuk ka të përfshirë në Licencën Profesionale e paraqitur “NZ.2200/18”, kategorinë NP-9 (*Punime dhe mbrojtje lumore, sistemi hidraulike dhe bonifikime*). Nuk plotëson pikën 6 të “*Kapacitetit teknik*”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”*.

6. BOE “E. H. SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” me NUIS K.....A dhe “D.-05” ShPK me NUIS K.....B me ofertë ekonomike 37,693,159 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- BOE nuk plotëson pikën 2.1.1, 2.1.2, 2.1.3 të “*Kritere të veçanta për kualifikim*” pasi certifikata Iso të paraqitura nga OE “E. H. SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI”, pas verifikimit në faqen zyrtare të lëshuesit të këtyre certifikatave, <https://www.lmscert.com/check-certificate>, rezultoi se ISO 9001, 14001 dhe 45001 janë të pezulluara, pra nuk janë të vlefshme.

- BOE nuk plotëson “*Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pasi në “*Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit*”, Deklarata Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura e paraqitur nga OE “E. H. SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI”, në pikën 6 ka zgjedhur opsionin “PO”, për deklaratën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”.

Gjithashtu në pikën 7, të këtij formulari OE ka zgjedhur opsionin “JO”, për deklaratën si më poshtë:

“Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit)”.

Pika 6 dhe 7 në “*Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit*”, si më sipër, është pikërisht për rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit, operatorët ekonomikë kanë dorëzuar një ofertë si BOE dhe një nga OE deklaron se e ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur dhe nuk është konsultuar me asnjë konkurrent tjetër.

- Nuk plotëson pikën 6 të “*Kapacitetit teknik*”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”*.

- Nuk plotëson pikën 9, germa a dhe b të “*Kapacitetit teknik*”, BOE nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi për Nyje betoni dhe Nyje inerte. Sipas përcaktimeve në DST kjo pikë do të plotësohet me paraqitjen e dokumentacionit në fazën e ofertimit. Nga ana e BOE nuk është paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të kësaj pike.

7. Operatori Ekonomik “N.” ShPK me NUIS L.....L me ofertë ekonomike 56,167,136 (pesëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “*Kapacitetit teknik*”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te*

licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.

8. Operatori Ekonomik “**P.- V. – K.**” ShPK me NUIS K.....M me ofertë ekonomike 48,524,948 (dyzetë e tetë milion e pesëqind e njëzetë e katër mijë e nëntëqind e dyzetë e tetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

9. Operatori Ekonomik “**C. R. 2008**” ShPK me NUIS K.....V me ofertë ekonomike 31,133,770.86 (tridhjetë e një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

Nga OE janë deklaruar punonjësit sipas profesioneve të kërkuar dhe më konkretisht: punonjësit me iniciale H.P dhe B.K me profesion “*Teknik Ndërtimi*” dhe punonjësit me iniciale P.C dhe P.C me profesion “*Karpentier*”. Për këta punonjës, OE ka deklaruar se janë të pajisur me Diplomë/Certifikate lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NUIS L.....G.

10. Operatori Ekonomik “**SH. I.**” ShPK me NUIS J.....T me ofertë ekonomike 54,130,373 (pesëdhjetë e katër milion e njëqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

OE ka paraqitur punonjësit me iniciale A.Q, A.B dhe M.A me profesion “*Karpentier*” të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “H.” me NUIS L.....G.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licence, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për “*Formim Profesional*”.

Nga sa me sipër shoqëria “H.” me NUIS L.....G, nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.” për profesionin “*Karpentier*”.

11. Operatori Ekonomik “**S.**” ShPK me NUIS K.....J me ofertë ekonomike 54,275,164 (pesëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave, duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*

Nga OE është deklaruar punonjësi me iniciale Z.P me profesion “*Karpentier*”. Për këtë punonjës, OE ka deklaruar se është i pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “A.” me NUIS L.....K.

12. BOE “**S. U.**” ShPK me NUIS J.....Q dhe “**B.**” ShPK me NUIS J.....G me ofertë ekonomike 41,566,041 (dyzetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyzetë e një) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Oferta e paraqitur nga BOE refuzohet pasi sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1 dhe 2 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik*”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1.Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek

ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi”. Në këtë lot ka paraqitur ofertë më vete dhe OE “S. V.” ShPK me NUIS L.....J i cili ka si administrator dhe ortak të vetëm shtetasin me iniciale XH.V i cili është njëkohësisht administrator dhe një nga ortakët e OE “S.U.” me NUIS J.....Q.

Nga sa më sipër KVO refuzoi ofertën e paraqitur pa vazhduar më tej vlerësimin.

13. BOE “S. V.” ShPK me NUIS L.....J dhe “D.-M.” ShPK me NUIS K.....L me ofertë ekonomike 46,164,888 (dyzetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Oferta e paraqitur nga BOE refuzohet pasi sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1 dhe 2 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi. 2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi..”. Në këtë lot ka paraqitur ofertë më vete dhe OE “S.U.” me NUIS J.....Q i cili ka si administrator dhe një nga ortakët shtetasin me iniciale XH.V i cili është njëkohësisht administrator dhe ortak i vetëm i OE “S.V.” ShPK me NUIS L.....J. Nga sa më sipër KVO refuzoi ofertën e paraqitur pa vazhduar më tej vlerësimin.

14. Operatori Ekonomik “U.” ShPK me NUIS K....Q me ofertë ekonomike 43,040,507 (dyzetë e tre milion e dyzetë mijë e pesëqind e shtatë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 9, germa a dhe b të “Kapacitetit teknik”, OE nuk ka paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi për Nyje betoni dhe Nyje inerte. Sipas përcaktimeve në DST kjo pikë do të plotësohet me paraqitjen e dokumentacionit në fazën e ofertimit. Nga ana e OE nuk është paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të kësaj pike.

15. Operatori Ekonomik “U.” ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 44,414,465 (dyzetë e katër milion e katërqind e katërmbydhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- OE “U.” nëpërmjet SPE, email të deklaruar dhe me shkresë zyrtare me lëndën: “Kërkesë për sqarim” me nr. 3350 prot. datë 20.06.2022, bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 82, pika 2 i janë kërkuar sqarime dhe paraqitja e dokumenteve mbështetëse në lidhje me vete deklarimin, në lidhje me lëshuesin e Certifikatë/Diplomës për punonjësit e specializuar, sipas profesioneve të kërkuara në pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, pasi pas verifikimeve të bëra në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, nuk ekziston licenca me Nr. Licencë 2395 Dt.02.12.2008. OE nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë brenda 3 (tre) ditëve si afat i përcaktuar në kërkesë.

KVO dërgoi përsëri kujtesë nëpërmjet adresës së email që OE të deklaruar në formularin e Vetë deklarimit, në datë 23.06.2022 me lëndën “Kërkesë për sqarim (kujtesë)” ku ndër të tjera OE ju bë me dije se : “Në rast të mos marrjes së një përgjigjeje, oferta juaj do të refuzohet”.

Nisur nga fakti se OE nuk ka kthyer asnjë përgjigje, oferta e tij refuzohet.

16. BOE “V. E” ShPK me NUIS J.....S dhe “A.” ShPK me NUIS J.....I me ofertë ekonomike 48,507,191 (dyzet e tetë milion e pesëqind e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

BOE nuk plotëson “Kriteret e Përgjithshme për kualifikim” pasi nuk kanë paraqitur asnjë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim dhe elementët që merr përsipër të realizoj secili prej anëtarëve të bashkimit, sipas përcaktimeve të nenit 88, pika 2 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e

tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë”.

Nuk plotëson pikën 5 të “Kapacitetit teknik”, pasi asnjë nga OE nuk ka deklaruar një punonjës të pajisur me certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe as nuk është paraqitur një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në këtë fushë.

Nuk plotëson pikën 6 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”.

Të dy OE kanë deklaruar në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, secili nga një teknik ndërtimi dhe një karpentier më konkretisht: punonjësit me iniciale E.V dhe A.M me profesion “Teknik Ndërtimi” dhe punonjësit me iniciale Y.M dhe L.T me profesion “Karpentier” të pajisur me Diplomë/Certifikate të lëshuar nga “HTM” me NUIS K.....D.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin Kërko për Licencë, shoqëria si më sipër rezulton se nuk është e pajisur me asnjë lloj licence për “Formim Profesional”.

Nga sa me sipër shoqëria “H.” me NUIS K.....D, nuk është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” për profesionet “Teknik Ndërtimi” dhe “Karpentier”.

Ankesat: Operatori ekonomik “C. R. 2008” ShPK me NUIS K.....V paraqiti ankesë pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik datë 06.07.2022. Komisionit të Prokurimit Publik në datë 03.08.2022 mori vendimin përfundimtar nr. 745/2022, ku iu refuzua ankesa OE.

Nga sa më sipër, OE “J.A.” ShPK me NUIS K.....I me ofertë ekonomike 39,800,003 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë e tre) Lekë pa TVSH, është identifikuar nga KVO, si Oferta e suksesshme.

Në verifikimin e OE fitues “J.”, dhe plotësimin e Kriterëve të përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit” nga dosja fizike nuk u konstatuan mangësi.

VII. Auditimi i procedurës “Procedurë e Hapur, Kontratë për Punë Publike”, me objekt: “Rehabilitimi i veprave të programit ujë-ujë-kullim Loti 1 “Rehabilitim pjesor në kanalin kryesor ujëtës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe ri veshje kanali).”

Të dhënat e përgjithshme të tenderit

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Loti 1 "Rehabilitim pjesor në kanalin kryesor ujëtës Peqin Kavajë, zona Gosë. (Ndërtim ure dhe riveshje kanali)"		
<p>1. Urdhër Prokurimi, me nr. 3705/1 prot datë 07.07.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën.</p> <p>Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT</p> <p>E. M. Personi përgjegjës Ing. E. J. D. M.</p>	<p>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur”, ndarë në lote. REF-36125-07-12-2022</p>	<p>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave, i ngritur me urdhrin, me nr. 3705/5 prot datë 21.07.2022, me përbërje:</p> <p>1 E.S., Kryetar 2. M. M., Anëtar 3. G. H., Anëtar</p>
<p>4.Fondi Limit (pa TVSh) 15,497,898 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH</p>	<p>5. Oferta fituese (pa TVSh) 12,071,013.93 (dymbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e trembëdhjetë pikë nëntëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH</p>	<p>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) Diferenca është 3,426,884.07 (tre milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë) lekë pa TVSH.</p>
<p>7. Data e hapjes së tenderit Data 28.07.2022 ora 10.00</p>	<p>8.Burimi Financimi nga Buxheti i Shtetit 2022</p>	<p>9. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës:</p> <p>6. BOE “A.” ShPK me NUIS K.....P dhe “A.2A C.” ShPK me NUIS K.....C me ofertë</p>

		<p>ekonomike 14,658,857 (katërbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.</p> <p>7. Operatori Ekonomik “B. N.” ShPK me NUIS K.....O me ofertë ekonomike 12,071,013.93 (dymbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e trembëdhjetë pikë nëntëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH.</p> <p>8. Operatori Ekonomik “F.” ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 14,512,597 (katërbëdhjetë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.</p> <p>9. BOE “K.” ShPK me NUIS L.....E dhe “C. M” me NUIS L.....O me ofertë ekonomike 13,150,680 (trembëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.</p> <p>10. Operatori Ekonomik “M. K.& R. E.” ShPK me NUIS K.....A me ofertë ekonomike 14,413,923 (katërbëdhjetë milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e tre) Lekë pa TVSH.</p> <p>11. Operatori Ekonomik “M..” ShPK me NUIS K.....G me ofertë ekonomike 13,426,256 (trembëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.</p> <p>12. Operatori Ekonomik “SH.” ShPK me NUIS K.....N me ofertë ekonomike 15,280,565 (pesëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.</p>
<p>10. Ankimime Pranë AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S’ ka</p> <p>Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S ka</p>	<p>11. Përgjigje Ankesës nga AK: Në lidhje me kriteret e kualifikimit - S’ ka Në lidhje me vlerësimin e ofertave ekonomike - S’ ka</p>	<p>12. Përgjigje - S’ ka</p>
b. Zbatimi i Kontratës Prokurimi		
<p>13. Lidhja e kontratës është bërë pranë Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Durrës</p>	<p>14. Zbatimi i Kontratës: Pranë D.U.K Durrës.</p>	

Sipas Urdhër Prokurimi, me nr. 3705/1 prot datë 07.07.2022, titullari i AK ka miratuar arsyet e përdorimit për procedurën e sipër cituar me Njësinë e prokurimit në cilësinë e administrimit të procedurës dhe të DT, me përbërje:

1. E. M. Personi përgjegjës
2. Ing. E. J.
3. D. M.

Me urdhër nr. 3705/5 prot datë 21.07.2022 të SP, është ngritur Komisioni i Vlerësimit Ofertave, me përbërje:

1. E. S., Kryetar
2. M. M., Anëtar
3. G. H., Anëtar

Nga pjesëmarrësit janë s’ kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “A.” ShPK me NUIS K.....P dhe “A.” ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 14,658,857 (katërbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “*Kapacitetit teknik*”, pasi Operatori Ekonomik “A.” ShPK sipas marrëveshjes së bashkëpunimit do të kryej 54.64% të punimeve, nisur nga kjo përqindje ky operator duhet të dispononte minimalisht 1 (një) “*Hekurkthyes*”, 1 (një) “*Karpenier*” dhe 1 (një) “*Teknik Ndërtimi*”. Në përmbushje të kësaj pike OE ka paraqitur formularin e Vetë

deklarimit si dhe tabelën e punonjësve të specializuar siç kërkohet në këtë pikë, ku ka deklaruar punonjësit me iniciale M.M dhe K.C me profesion “*karpentier*” të pajisur me certifikatë/diplomë të lëshuar nga “H.M.”.

Në këto dy miratime evidentohet se shoqëria “H. S. E. M.” me NUIS L.....B, është e licencuar për ofrimin e kurseve profesionale të ndryshme, por jo për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*” për profesionin “*Karpentier*” dhe nuk përmbushen parashikimet e nenit 88, pika 3 e VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik*”. Gjithashtu OE “A.” ShPK në tabelën e punonjësve të specializuar ka deklaruar punonjësit me iniciale TH.G dhe R.R me profesion “*Hekurkthyes*” të pajisur me certifikatë/diplomë të lëshuar nga “A.”.

2. Operatori Ekonomik “F.” ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 14,512,597 (katërbëdhjetë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë:

- Nuk plotëson pikën 6 të “*Kapacitetit teknik*”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”.*

3. Operatori Ekonomik “M.” ShPK me NUIS K.....G me ofertë ekonomike 13,426,256 (trembëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH, për arsyet si më poshtë: Nuk plotëson pikën 3 të “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pasi në plotësimin e *Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit*, sipas shtojcës 8 mbi seksionin : B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, nuk ka deklaruar sipas përcaktimeve në DST numrin e punonjësve të disponueshëm për periudhën “*Prill 2022- Qershor 2022*” por ka deklaruar numrin e punonjësve mesatarisht për Periudhën “*Dhjetor 2021-Shkurt 2022*”.

- Nuk plotëson pikën 6 të “*Kapacitetit teknik*”, pasi Operatori Ekonomik në formularin e Vetë deklarimit mbi seksionin :

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, nuk ka deklaruar një punëtorë të thjeshtë ndërtimi nga 13 (trembëdhjetë) që kërkohen sipas DST.

- Nuk plotëson pikën 2.1, germa a të “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pasi në plotësimin e *Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit*, sipas shtojcës 8 mbi seksionin :

C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” Makineri e mjete, Po [] Jo []

Nga ana e OE nuk është plotësuar **asnjë e dhënë** për makineri/pajisje/mjeteve në pronësi si p.sh.: targa, nr. leje së qarkullimit, shasia etj. Në mbështetje të nenit 26, pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik*” ,duke qenë se në vetë deklarim nuk është plotësuar asnjë e dhënë konkrete për mjete dhe pajisjet, AK nuk mund të vërtetojë me paraqitjen e dokumenteve provues, se dokumenti është i njëjtë me atë të deklaruar në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

- Nuk plotëson pikën 9, germa a, germa b dhe germa c të “*Kapacitetit teknik*”. Nga ana e OE nuk është paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të kësaj pike.

3. BOE “A.” ShPK me NUIS K.....P dhe “A.” ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 14,658,857 Lekë pa TVSH dhe Operatori Ekonomik “F.” ShPK me NUIS K.....C me ofertë ekonomike 14,512,597 lekë pa TVSh, janë s ‘ kualifikuar për mos plotësim të pikës 6 të “*Kapacitetit teknik*”, ku kërkohet paraqitja e *Certifikatave/diplomave duhet te jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional ne R. Sh.”.*, **kriter i vlerësuar nga ne përjashtues por në rastin konkret nuk ka efekte financiare negative pasi ofertat e paraqitura nga këta OE janë më të larta se oferta fituese.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Operatori Ekonomik “B.” ShPK me NUIS K.....O me ofertë ekonomike 12,071,013.93 (dymbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e trembëdhjetë pikë nëntëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme. Në SPE dhe dosjen fizike u krye verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE fites, dhe nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të Veçanta të vendosura nga NJP.

Në lidhje me zbatimin e kontratave për Punë Publike”, me objekt: “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, për vitin 2022 në 5 lote –procedura të audituara nga grupi i auditimit të KLSH-së, ashtu sikurse e kemi cituar në procedurën “Mbikëqyrje rehabilitim i veprave të program ujitje –kullimit me lote, ndarë në 19 lote”, grupi i auditimit arrin në të njëjtin konkluzion ku ngarkon me përgjegjësi DUK-përkatëse për mos raportim të ecurisë dhe përfundimit me sukses të kontratave në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të MBZHR me nr. 77, datë 21.02.2022, për realizimin e procedurave të prokurimit publik të objekteve në Programin” Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes”, ku DUK janë përgjegjëse për lidhjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe do të jenë përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit me sukses të punimeve nga ana e OE të shpallur fitues sipas procedurave të prokurimit, si dhe veprime në kundërshtim me nenin 107 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës pika 1, pika 3, pika 4, pika 7 dhe neni 108 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 12, datë 26.05.2023.

Titulli i Gjetjes:	Jo eficiencë në zbatimin e kontratave të mbikëqyrjes dhe për punë publike nga Drejtoritë e Ujitje Kullimit në rajone dhe mos raportim i ecurisë dhe përfundimit në lidhje me zbatimin e tyre.
Situata:	<p>Nga auditimi i disa prej procedurave të realizuara nga MBZHR, në cilësinë e AK, respektivisht: për periudhën 2022 dhe konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt Marrëveshje kuadër: “Mbikëqyrje rehabilitim i veprave të program ujitje –kullimit me lote, ndarë në 19 lote”, me fond limit 19,315 mijë lekë. 2. Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike” me Objekt kontrate: “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, ndarë në 19 lote”, nga të cilat u audituan Loti 1, 7,8, 9 dhe 17, me fond limit 376, 874 lekë, u konstatuan se: <p>Për sa i përket zbatimit të kontratave për secilin lot lidhja, monitorimi dhe zbatimi i kontratave të mbikëqyrjes dhe të rehabilitimit të veprave të programit ujitje-kullim është kryer nga Drejtoritë e Ujitje-Kullimit sipas rajoneve përkatëse bazuar në Urdhrin e Ministrit të MBZHR me nr. 77, datë 21.02.2022, për realizimin e procedurave të prokurimit publik të objekteve në Programin” Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” Nuk ka gjurmë auditimi apo raportim të këtyre DUK-eve në Institucionin Qendror, MBZHR, për zbatimin në kohë dhe me sukses të këtyre kontratave dhe rrjedhimisht nuk ka informacion nga sektori i prokurimit në MBZHR, nëse këto institucione (DUK-et) kanë kryer raportimin në APP për çdo fazë të zbatimit të kontratës pasi DUK janë përgjegjëse për lidhjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe do të jenë përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit me sukses të punimeve nga ana e OE të shpallur fitues sipas procedurave të prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 107 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës pika 1, pika 3, pika 4, pika 7 dhe neni 108 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Ligjin nr. 110/2015 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, neni 16, pika 2. Pra AK, MBZHR nuk ka dijeni nëse fondi prej 19,315</p>

	mijë lekë për mbikëqyrje dhe fondi prej 376,874 mijë lekë për kontrata publike të rehabilitimit të kanaleve për ujitje kullim është përdorur me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet nga DUK-et përkatëse, mungesë menaxheriale dhe përgjegjësi e strukturave drejtuese si në MBZHR ashtu edhe në Institucionet e varësisë.
Kriteri:	Ligji 162/2020, “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 107 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës pika 1, pika 3, pika 4, pika 7 dhe neni 108, Ligjin nr. 110/2015 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, neni 16, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim pa ekonomikitet i fondeve publike të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mungese menaxheriale e strukturave drejtuese në MBZHR në ngritjen e sistemeve të deklarimit efikas dhe të përpiktë, duke përfshirë nivelet dhe afatet për deklarimin llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	-Të merren masa nga Titullari i Institucionit për vendosjen e përmeshjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sigurimit të gjurmës së auditimit si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë”.

Titulli Gjetjes:	i Përdorim pa efektivitet i fondeve publike nga AK dhe kriteret përjashtues në procedurat publike ”Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, viti 2022.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike”, (2022), me objekt “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim” me vlerë totale të fondit limit 866,303,595 lekë pa TVSH, është konstatuar vendosja e kriterëve përjashtues të cilat kanë sjellë pasojë përdorimin me efekt negativ të fondeve publike në vlerën 30,247,440 lekë pa TVSh e fondit të prokuruar, respektivisht:</p> <p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit Loti 7, me objekt: “”Mbrojtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier”, me fond limit 93,972,048 lekë pa TVSh u konstatua se në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezultoi se kjo e fundit ka vlerësuar në mënyrë të ngurtë kriterin 6 të “Kapacitetit teknik”, ku nga NJP kërkohet që <i>paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, vetëm sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”.</i></p> <p>AK (grupi i punës, njësi e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Grupi i auditimit e vlerëson këtë kriter përjashtues pasi të gjithë këta</p>

operatorë, nga historiku i prokurimeve në MBZHR, të s' kualifikuar për arsyen e sipërcituar nga KVO mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh." për profesionet "Teknik Ndërtimi", "Karpentier" dhe "Saldator", janë fitues në procedura të të njëjtit tip dhe kanë pasur kapacitetet teknike të mjaftueshme dhe të njëjtë për periudhën 2017-2021, ndërkohë në vitin 2022 të njëjtët OE vlerësohen me kapacitete teknike të pamjaftueshme ose e thënë ndryshe me teknikë jo të trajnuar dhe të pajisur me certifikatën tip të cilat sipas KVO duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh."

Nga verifikimet e kryera në lidhje me subjektin "Qendra e trajnimeve të avancuara-QTA" i cili është certifikuar nga MFE me shkresën nr. 17089/2, datë 01.12.2021 me lëndë:" Për ndryshim në Licencën e formimit profesional dhe shtim të listës së kurseve të formimit profesional përkatësisht:

Instalues i sistemeve ngrohëse; Saldator; Hidraulik; Pllaka shtrues; Karpentier; Murator-suvatues etj., rezulton që është vetëm ky subjekt privat i certifikuar nga MFE ose e thënë ndryshe ka "*ekskluzivitetin*" e dhënies së këtyre certifikatave të cilat janë kurse jo më shumë se 85-90 orë mësimore që "zëvendësojnë" shkollat e arsimit profesional që kanë një kohëzgjatje prej 3-vjet. (Verifikuar në certifikatat e lëshuara të marra nga sistemi elektronik i prokurimeve).

Duke parë rëndësinë e ofertave ekonomike më të mira ekonomikisht, në lidhje me kurset e specialistëve, nga KVO nuk duhej mbajtur qëndrim "*strikt*", në vlerësimin e ofertave, pasi nuk do të cenohej aspak realizimi i kontratës me sukses. Referuar ligjit mbi prokurimin publik, Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, ***gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.***

MBZHR, nuk ka siguruar të ulë shpenzimet procedurale. - Nga s 'kualifikimi i me Nipt- K.....Ë, ShPK, veprimet e NJP dhe KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mosveprimet të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në dis favor të buxhetit të shtetit, përkatësisht: Nga s 'kualifikimi i OE "Sh. 07", ShPK, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën **22,880,970 lekë pa TVSH = (74,398,800 – 51,517,830)**, si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

2- Nga auditimi i procedurës së prokurimit Loti 17, me objekt: "***Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgj***", me fond limit **57,139,289** lekë pa TVSh u konstatua se në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit ka vlerësuar në mnëyrë të ngurtë kriterin 6 të "Kapacitetit teknik", ku nga NJP kërkohet që

	<p><i>paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, vetëm sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”. Gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht mangësive, përpara se të kryente s’ kualifikimin, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e nenit 53 pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, sipas të cilit: “autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”.</i></p> <p>veprimet e KVO-së ndikojnë negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike dhe për pasojë kryerjen e punimeve me një vlerë me të lartë ekonomike. Në alternativë, sa më sipër KVO-ja, midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë, referuar nenit 2 të ligjit nr. 162/2020 prot., “Për prokurimin publik”, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirëpërdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhet të vlerësonte kriterin kryesor që është “Oferta më e ulët” për të bërë të mundur shmangien e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mos veprimet të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në dis favor të buxhetit të shtetit, përkatësisht:</p> <p>1-Nga s’ kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “H.” ShPK me NUIS J.....B me ofertë ekonomike 64,293,759.60 lekë, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën 172,080 lekë pa TVSH = (66,465,840 – 64,293,760), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.</p> <p>2-Nga s’ kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “U.” ShPK me NUIS J.....O me ofertë ekonomike 59,271,450 lekë pa tvsh, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën 7,194,390 lekë pa TVSH = (66,465,840 – 59,271,450), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.</p>
Kriteri:	Ligji 162/2020, “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 2, neni 87, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45, pika 8.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet e fondeve të buxhetit të shtetit.
Shkaku:	Mungese menaxheriale e strukturave drejtuese në MBZHR në ngritjen e sistemeve të deklarimit efikas dhe të përpiktë, duke përfshirë nivelet dhe afatet për deklarimin llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	- AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara se të kryejë një s’ kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën

	një devijim të vogël, i cili nuk ndryshon thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e kualifikuar në këtë rast si ofertë të vlefshme. MBZHR të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike në vlerën totale 30,247,440 lekë , nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
--	--

6.2 ZBATIMI I KONTRATAVE

Kontrata “Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine”

Historiku i zbatimit të punimeve.

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE S. (me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4), të përfaqësuar këta nga OE S. sipas prokurës së posaçme me nr. 5782 rep., 2175 kol., datë 26.09.2020 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK z. E. H. sipas shkresës me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me vlerë 288,523,171.95 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit mes Autoriteti Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK z. E. H. dhe BOE D&C P. (me nr. licence MK.0249/6) & IMES-D (me nr. licence MK.1641/11) sipas shkresës me nr. 6942/6 prot., datë 23.10.2020 me vlerë 2,505,870 lekë me TVSh.

Sipas shkresës me nr. 6085/3 prot., datë 30.11.2022 është ngritur nga ana e ish Titullarit z. O. M. Komisioni për kolaudimin me përbërje të komisionit znj. M. H. dhe z. L.K.

Gjithashtu, në lidhje me zbatimin e punimeve është ngritur Urdhri nr. 532, datë 31.12.2020 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës” me përbërje të grupit A.V., B. C. dhe E. J.

Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë filluar me datë 31.12.2020. Pas kërkesës së sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe miratimit nga ana e grupit të ndjekjes së kontratës, është bërë amendimi i kontratës së sipërmarrjes dhe shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me 40 ditë. Punimet kanë përfunduar me datë 25.11.2022, kjo sipas shkresës së administruar në MBZHR me nr. 6085/1 prot., datë 30.11.2022. Konstatohet se pas kërkesës së sipërmarrësit është dhënë autorizimi i përdorimit të fondit rezervë nga ana e mbikëqyrësit dhe më pas miratimi nga ana e Autoritetit Kontraktor. Kolaudimi i punimeve është kryer sipas procesverbalit përkatës në datë 15.12.2022.

3. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.																						
3.1 Situata:	Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 6,461,698 lekë pa TVSH e argumentuar kjo si më poshtë: Tabela nr. 1																						
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>NR.</th> <th>EMËRTIMI I ZËRIT</th> <th>VLERA (LEKË PA TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Trarë themeli monolit b/a C 25/30</td> <td>284,284</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Vetratë xhami i temperuar</td> <td>841,799</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm</td> <td>1,718,983</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjetë + suva</td> <td>848,914</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Plintuse grez importi, h = 10 cm (ballkonet +korridori)</td> <td>87,238</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Patinim me stuko veneciane</td> <td>2,680,480</td> </tr> </tbody> </table>	NR.	EMËRTIMI I ZËRIT	VLERA (LEKË PA TVSH)	1	Trarë themeli monolit b/a C 25/30	284,284	2	Vetratë xhami i temperuar	841,799	3	Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm	1,718,983	4	Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjetë + suva	848,914	5	Plintuse grez importi, h = 10 cm (ballkonet +korridori)	87,238	6	Patinim me stuko veneciane	2,680,480	
NR.	EMËRTIMI I ZËRIT	VLERA (LEKË PA TVSH)																					
1	Trarë themeli monolit b/a C 25/30	284,284																					
2	Vetratë xhami i temperuar	841,799																					
3	Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm	1,718,983																					
4	Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjetë + suva	848,914																					
5	Plintuse grez importi, h = 10 cm (ballkonet +korridori)	87,238																					
6	Patinim me stuko veneciane	2,680,480																					

	SHUMA	6,461,698
	<p>Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave janë si më poshtë:</p> <p>-Zëri Trarë themeli monolit b/a C 25/30 Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumni prej 117.45 m³. Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar detajeve të projektit të zbatimit si dhe mënyrës se si janë përlllogaritur volumet në librezën e masave, rezulton se në këtë të fundit janë përlllogaritur dy herë volumet e këndeve të themeleve pasi gjatësitë janë marrë për të dy drejtimet përkatësisht 37.2 ml dhe 7 ml, kjo si për lartësinë h=0.4 ashtu edhe për atë h=0.6. Duke bërë korrigjimet rezulton se volumni total i realizuar me beton për themelet është në masën 94.148 m³, ose 23.3 m³ më pak nga sasia e likuiduar. Për rrjedhojë vetëm për këtë zë është përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej 284,284 lekë pa TVSH.</p> <p>-Nga krahasimi i gjendjes ekzistuese dhe punimeve të përfunduara rezulton se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë konsideruar si volume pune të kryera të reja punimet ekzistuese për vetratën në faqen veri – perëndimore të godinës, si dhe ato të fasadës me xham struktural të pathyeshëm për faqen veri – perëndimore dhe atë jug – perëndimore. Duke bërë llogaritjet për këto dy zëra rezulton se është favorizuar BOE S. & P. Nga ana e mbikëqyrësit (njëkohësisht edhe hartues i projekt preventivit të punimeve) dhe grupit të ndjekjes së kontratës përmes mos marrjes së masave për zbritjen e zërave si më sipër. Duke bërë korrigjimet për efekt të volumeve të punimeve ekzistuese rezulton se vetëm për këta zëra janë përfituar tepër nga ana e BOE për zërin Vetratë xhami i temperuar sasia prej 56.27 m², ose vlera prej 841,799 lekë pa TVSH si dhe për zërin Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm sasia prej 203.43 m², ose vlera prej 1,718,983 lekë pa TVSH.</p> <p>-Zëri Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjetë + suva. Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumni prej 1142.55 m². Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezulton se punimet nuk janë realizuar me polisterol jeshil kompakt por janë realizuar me polisterol të thjeshtë, ose sipas zërit Veshje muri me polisterol të thjeshtë t=5cm rrjetë+suva me nr. analize 2.358/c, me çmim njësi 1,947 lekë/m². Duke bërë llogaritjet rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit 848,914.65 lekë pa TVSH si rrjedhojë e diferencës në ((2,690 lekë/m² – 1,947 lekë/m²) x 1142.55 m²).</p> <p>-Zëri Plintuse grez importi, h = 10 cm (ballkonet +korridori) Duke bërë diferencën në çmim mes zërit të ofertuar dhe atij të kryer në fakt, duke korrigjuar çmimin e analizës nga 192 lekë/ml në 153.6 lekë/ml, rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej ((192 lekë/ml – 153.6 lekë/ml) x 2271.83 ml) 87,238 lekë pa TVSH.</p> <p>-Zëri Patinim me stuko veneciane Duke bërë diferencën në çmim mes zërit të ofertuar dhe atij të kryer në fakt, duke korrigjuar çmimin e analizës nga 600 lekë/m² në 248 lekë/m², rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit vlera prej ((600 lekë/m² – 248 lekë/m²) x 7615 m²) 2,680,480 lekë pa TVSH.</p>	
3.2 Situata:	Përveç auditimit të dokumentacionit teknik, u krye edhe një verifikim në terren në prezencë të mbikëqyrësit ku u konstatua se cilësia e disa prej	

zërave të punimeve ishte shumë e ulët çka ka sjellë edhe probleme me lagështinë, funksionalitetin si dhe vet pamjen estetike të objektit. Konkretisht në ambientet e katit përdhe, në zonën jug – lindore të godinës, dhomat rezultuan me lagështi dhe prezencë të theksuar myku duke i bërë këto ambiente të papërdorshme. Nisur nga ky fakt u verifikuan punimet e hidroizolimit, nga ku rezultoi se punimet nuk janë kryer sipas projektit dhe sipas zërave për të cilat është paguar kontraktori. Konkretisht preventivi ka parashikuar të realizohen dy shtresa mapei për hidroizolim kur në fakt hidroizolimi është kryer me vetëm një shtresë karton katrama dhe ajo çka u vërejt nga inspektimi ishte fakti se kthimet në kënde me kartonit katrama nuk ishin të mjaftueshme për mbrojtjen nga uji dhe nuk ishin realizuar me dy shtresa por me një. Pra, përveçse nuk ishin realizuar me dy shtresa ishin realizuar jo në përputhje me kërkesat teknike. Probleme me lagështinë u vërejtën edhe në katin e tretë të godinës.

Fasada e xhamit e cila duhet të ishte e temperuar rezultoi me xham të thyeshëm, pra jo të temperuar çka përbën rrezik serioz për vetë jetën e punonjësve të QTTB. Konkretisht rezultuan dy xhama të thyer, një në fasadën me hark dhe një në fasadën e drejtë në faqen veri – perëndimore.

Një pjesë e materialeve të rezultuara nga rikonstruksioni ndodheshin akoma brenda rrethimit të objektit duke krijuar një ambient të papastër.

Plintuesat e godinës nuk janë ndërtuar me lartësi 10 cm sipas kërkesave të projektit por janë realizuar me lartësi 8 cm.

Sipas deklarimeve të punonjësve aparaturat e vendosura për aspirimin nuk ishin efektive pasi në procese të caktuara, punonjësit duhet të dilnin jashtë zyrave për shkak të ndotjes së papranueshme.

Nga ana e kontraktorit të punimeve janë situacionuar si të kryera patinime me stuko veneziane kur në fakt në disa raste stukimi nuk është kryer fare ose është realizuar me stuko të zakonshme dhe jo veneziane e cila ka dhe një çmim më të lartë nga patinimi i zakonshëm.

Nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë deklaruar si të kryera punime suvatimi në tavanet e mbuluara me kartonxhes. Nga verifikimi i kryer në një pjesë të konsiderueshme në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi se pagesa për këtë zë është kryer padrejtësisht pasi ky proces pune, pra suvatimi i tavaneve në pjesë e mbuluara me kartonxhes, nuk është realizuar.

Për sa i takon fasadës strukturale prej xhami në faqet veri – perëndimore dhe jug – perëndimore rezultoi se është përdorur në pjesën më të madhe fasada ekzistuese duke e situacionuar dhe duke i likuiduar sipërmarrësit edhe atë pjesë të fasadës e cila ka qenë ekzistuese por që është përdorur nga ana e sipërmarrësit për punimet e rikonstruksionit. Për sa i përket fasadës rezultoi se në këtë detaj nuk janë kryer pastrimet e nevojshme të xhamave nga silikonit dhe madje ky i fundit nuk është përdorur në të gjitha rastet me qëllim izolimin e fasadës. Përveç kësaj vet në tërësi punimet për fasadat kishin mangësi për sa i takon anës estetike duke mos përmbushur edhe një ndër qëllimet e saj.

Në disa raste u konstatua se vetratat nuk ishin sipas hapësirave të dritës (ishin më të mëdha) dhe për këtë nuk ishin marrë masa për zëvendësimin e tyre duke u vendosur në gjendjen e tyre jo të përshtatshme.

Lyerja me bojë vaji e konstruksioneve metalike të parkimeve nuk është kryer uniforme dhe në disa raste as nuk është lyer fare duke bërë që konstruksioni të shfaq shenja të dukshme ndryshku. Gjithashtu gjatë

	<p>lyerjes së mureve dhe tavaneve nuk ishte treguar kujdesi i duhur për ruajtjen e elementëve të tjerë të godinës dhe as nuk ishin kryer pastrimet e nevojshme në përfundim të lyerjeve.</p> <p>Për sa i takon punimeve të paneleve kompozite (alukobondet) rezultoi se edhe këto nuk ishin realizuar në mënyrë estetike por me deformime dhe cilësi shumë të ulët të lidhjes së elementëve të nevojshëm.</p> <p>Dyert e parashikuar me dru dhe xham ishin realizuar me material MDF dhe pa xham.</p>
3.3 Situata:	<p>Nga inspektimi në terren i punimeve të realizuara për këtë kontratë por në lidhje me punimet për ndërtimin e stallës së lopëve, rezultoi se ky investim, në 5 mujorin e parë të vitit 2023 është krejtësisht jo efektiv dhe i pa vënë në përdorim nga ana e Ministrisë dhe QTTB, duke mos përmbushur objektivin për të cilin është ndërtuar dhe për pasojë përdorimin pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt në masën prej 67,633,707 lekë me TVSH.</p> <p>Gjithashtu investimi nuk rezultoi të ishte i sigurt nga vjedhjet, tjetërsimi si dhe nga përdorimit i paautorizuar pasi nuk janë siguruar vendqëndrimet dhe rojet përkatëse në të paktën 2 pozicione, këto të domosdoshme nisur edhe nga shtrirja e investimit.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”, neni 12, ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve <p>- Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se: Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”;</p> <p>- Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se: “3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi</p>

	<p>teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</p> <p>Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:</p> <p>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</p> <p>a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.</p> <p>b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.</p> <p>c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.</p> <p>ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.</p> <p>Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.</p> <p>- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 6942/6 prot., datë 23.10.2020;</p> <p>- Urdhri nr. 532, datë 31.12.2020 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës”.</p>
3.1 Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 6,461,698 lekë pa TVSH.
3.2 Ndikimi:	Kryerja e punimeve me cilësi të dobët shkakton amortizim të hershëm të punimeve duke çuar kështu në domosdoshmërinë e kryerjes rishtazi të investimeve për të njëjtat zëra punimesh.
3.3 Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt në masën prej 67,633,707 lekë me TVSH.
Shkaku:	Likuidimi i volumeve të punimeve të pakryera nga ana e sipërmarrësit, mos reflektimi në situacionin përfundimtar i çmimit të zërave të kryer në fakt dhe përdorimi për këto zëra i çmimeve të kontratës si dhe mungesa e ushtrimit të kontroleve të nevojshme nga ana e kolaudatorit, grupit të ndjekjes së kontratës si dhe grupit të marrjes në dorëzim.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 6,461,698 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE S. (me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4) për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me objekt ‘Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine’.
3.2 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të ndjiqen të gjitha procedurat e nevojshme

	administrative për mos kryerjen e pagesës prej 14,426,158.6 lekë si shumë e mbajtur për garanci punimesh ndaj BOE S. & . . për shkak të cilësisë së dobët të punimeve të kryera në fakt në kontratën me objekt ‘Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine’, kjo pasi likuidimi i kësaj shume do të përbënte dëm ekonomik ndaj buxhetit të MBZHR.
3.3 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të merren të gjitha masat e nevojshme për vënien në përdorim të investimit të bërë për pjesën e stallës së lopëve pasi aktualisht mos përdorimi e bën këtë shpenzim të jetë krejtësisht jo efektiv duke shkaktuar kështu edhe një përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet në masën prej 67,633,707 lekë me TVSH. Gjithashtu, MBZHR dhe QTTB të marrin masat e nevojshme për sigurimin nga vjedhjet, tjetërsimin si dhe nga përdorimet e paautorizuara të këtij aseti.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Ing. E. D. përfaqësues i ligjor i D&C P. si dhe njëkohësisht i BOE për mbikëqyrjen e punimeve D&C PARTNERS & IMES-D është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 211/63 prot., datë 21.07.2023, i cili gjen trajtim si më poshtë.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE P. I., si anëtar i BOE S.& P. I. në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 211/63, datë 21.07.2023, i cili në përmbajtje ka të njëjta argumente me ato të paraqitura për aktin e konstatimit nga ana e mbikëqyrësit të punimeve e për rrjedhojë edhe qëndrimi i Audituesve Shtetërorë të KLSH është i njëjtë me atë të sqaruar në Projekt raportin e Auditimit.

Kontrata “Rehabilitimi objektiv dhe mbrojtje lumore, i ndarë me lote”, “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë)” nën objekti “Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”.

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE B. & NG S. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK z. E. H. sipas shkresës me nr. 3273/25 prot., datë 31.08.2020 me vlerë 51,972,606 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK z. E. H. dhe BOE XH & XH M. & N.M. PF sipas shkresës me nr. 3137/18 prot., datë 31.08.2021 me vlerë 1,272,000 lekë me TVSh.

Sipas Urdhrit me nr. 471, datë 16.11.2020 është ngritur nga ana e ish – Titullarit z. E. H. për ngritjen e Komisionit për kolaudimin me përbërje të komisionit znj. M.H. dhe z. L. K.

Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë filluar me datë 28.09.2020 dhe kanë përfunduar me datë 05.12.2020 (administruar në MBZHR me nr. 6800/25 prot., datë 07.12.2020).

4. Titulli i gjetjes:	Punime të kryera jo sipas zërave përkatës të përshkruar në preventiv ofertë dhe në situacionin përfundimtar.
Situata:	Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve jo të kryera sipas zërit përkatës të përshkruar në situacionin përfundimtar. Konkretisht rezulton se, referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje, punimet e gërmimit nuk janë kryer me ekskavator me kapacitet 0.25 m ³ , siç parashikon zëri në

	<p>preventiv por janë kryer me ekskavator me kapacitet kove 1 m³, kapacitet i cili rezulton një çmim më të ulët nga ai i zërit 3.97/b <i>Gërmim dhe me ekskavator zinxhir 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shkarkim në tokë</i>, kjo si rrjedhojë e një rendimenti më të lartë të kësaj kove me të paktën 50 %. Për rrjedhojë, për këtë zë duhet të ishte bërë korrigjimi i zërit në preventiv dhe në situacionin përfundimtar⁴ duke ndryshuar rendimentin nga 0.08 o.p makineri/m³ në 0.06 o.p makineri/m³. Mos kryerja e këtij veprimi ka bërë që të përfitohen tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej 956,402 lekë pa TVSH ((900 lekë/m³ – 199 lekë/m³) x 1364.34 m³).</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”, neni 12, ku përcaktohet se: “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve <p>- Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se: Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasishtë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”;</p> <p>- Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se: “3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, vepohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të</p>

⁴ Siç vepohet në rastet kur gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja për zëra të rinj në preventiv.

	<p>ndërtimit”;</p> <p>Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:</p> <p>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</p> <p>a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.</p> <p>b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.</p> <p>c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.</p> <p>ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.</p> <p>Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.</p> <p>- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 3137/18 prot., datë 31.08.2021;</p> <p>- Urdhri nr. 471, datë 16.11.2020 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës”.</p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 956,402 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Mos reflektimi në situacionin përfundimtar i çmimit të zërave të kryer në fakt dhe përdorimi për këto zëra i çmimeve të kontratës si dhe mungesa e ushtrimit të kontroleve të nevojshme nga ana e kolaudatorit, grupit të ndjekjes së kontratës si dhe grupit të marrjes në dorëzim.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 956,402 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE B- & B & B & NG S. për punime jo sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar të kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3273/25 prot., datë 31.08.2020 me objekt “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë)” nën objekti “Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE N. M. PF dhe XH & M. është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 1175/17 prot., datë 02.06.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE B-93, si anëtari i BOE B. & B. & B.& NG S. në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 211/63 prot., datë 21.07.2023, i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“... Theksojmë që kontrata është zbatuar në afat dhe me cilësi të lartë duke bërë që një nga lumenjtë më të egër të përplasat tek kjo mbrojtje lumore dhe të ndryshojë drejtim duke mbrojtur nga gërryerja toka bujqësore të Fushë – Hekal. Vepra është e bukur dhe e qëndrueshme. Kundërshtojmë me forcë gjetjet e Audituesit të KLSH të cilat janë të pavërteta të pasakta, deri në qesharake. Pretendimi i Audituesit që i referohet një fotoje në dosjen e punimeve pranë AK nuk qëndron. Kjo për arsye se në kantier kanë qenë 3-4 ekskavatorë me

nga 2-3 kova secili dhe që variojnë nga 0.25-1.5 m³ secila. Shtrojmë pyetjet me çfarë e mati madhësinë e kovës Audituesi? Me çfarë shkalle zmadhimi apo zvogëlimi përdori ky auditues për të dalë në konkluzion për madhësinë e kovës? Çfarë ekspertize ka kryer fotos që ka patur në dosje? Së dyti, Audituesi bën llogaritjen që me qenë se punimet janë kryer jo më kovë 0.25 m³ por me kovë 1 m³ është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 956,402.00 lekë. E thënë ndryshe, volumet e punës janë të njëjta në m³/gërmim dhe nuk kemi diferencë në volume ose punime të marra më tepër se sa janë kryer në fakt. Pra dëmi ekonomik është kryer vetëm nga përdorimi i kovës së ekskavatorit. Ky lloj arsytimi është i palogjikshëm dhe i padrejtë duke e penalizuar shoqërinë tonë padrejtësisht aq sa duke sa penalizimi ka qenë i qëllimshëm në vetvete.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja si më sipër nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen në mënyrë konkrete gjetjeve. Së pari sqarojmë se në asnjë pjesë të konstatimeve nuk është cituar fakti se vepra nuk e ka kryer funksionin e saj, nuk është e bukur apo nuk është e qëndrueshme. Së dyti theksojmë se në asnjë pjesë të aktit të konstatimit, në Projektraport dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi nuk është shprehur fakti se diferencë ka ardhur si pasojë e volumeve të likuiduara por të pakryera në terren. Pra nga këto dy argumente faktehet se nga ana juaj ka një devijim nga faktet duke mos ju përmbajtur kështu drejt dhe saktë konstatimeve. Konstatimi qëndron në faktin se nga ana e sipërmarrësit janë situacionuar fiktivisht gërmime me ekskavator me kapacitet kove 0.25 m³ kur në fakt gërmimi nuk është kryer më një kovë me kapacitet të tillë. Vet manualit teknik i çmimeve të punimeve të ndërtimit njih çmime të ndryshme për gërmime me kovë me kapacitet të ndryshëm, një koncept teknik ky shumë i thjeshtë për tu kuptuar. Ju rikujtojmë se referuar Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.205 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I Sipërmarrësi i Punimeve të Ndërtimit, pika 8.3 citohet se:

“Dokumentacioni fotografik apo videoregjistruesi sigurohet nga sipërmarrësi për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve, etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit çdo javë.”

Rasti në fjalë lidhet me një zë i cili siç duket është kthyer në objekt diskutimi. Fakt është që kova e përdorur nga ana Juaj dhe e certifikuar padrejtësisht nga ana e mbikëqyrësit të punimeve nuk është me kapacitet 0.25 m³. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, në materialet fotografike bashkë me observacionet e dërguara për aktet e konstatimit ka rezultuar se kova nuk është e njëjtë me atë të ndodhur në dokumentacionin fotografik të dosjes teknike duke krijuar dyshime të arsyeshme për deklarime të rreme në kthimin e observacioneve. Për sa i takon pyetjeve të bëra nga ana juaj se prej nga rezultoi ky konstatim në lidhje me volumin e kovës, sqarojmë se përgjigjen e merrni nga vrojtimi i dokumentacionit që vet ju keni dorëzuar në AK. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

4. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.
Situata:	Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 172,718 lekë pa TVSH si dhe janë përdorur pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 745,000 lekë pa TVSH të argumentuara këto si më poshtë. Zëri Transport mbetjesh deri 7 km Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 1380 m ³ . Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt,

	<p>referuar analizës së zërit të punës Prishje mure tulle pa pastrim, me nr. analize 2.426, rezulton se ky zë ka të parashikuar edhe volumin e punës për transportin e materialit. Për rrjedhojë rezulton se janë përfiturar tepër volumi prej 285 m³ për transportin e mbetjeve nga prishja e mureve të tullës, ose vlera prej 105,450 lekë pa TVSH.</p> <p>Zëri Shtrese betoni C-12/15.</p> <p>Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 181.6 m³, nga të cilat sasia prej 32.75 m³ për plintat sipas librezës së masave. Në fakt, referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje rezulton se shtresa e betonit nuk është realizuar me shtesa prej 20 cm në çdo krah të plintave, pra nuk është realizuar me të njëjtën gjerësi të shtresës me çakëll por është realizuar me gjerësi sipas asaj të plintit. Për rrjedhojë rezulton se janë përfiturar tepër volumi prej 8.515 m³ (32.75 x 26 %), ose vlera prej 67,268 lekë pa TVSH.</p> <p>Zëri F.V. Punime artistik me metal inoksidabël, rrathë me diametër 5 m dhe figurë 3 m të lartë.</p> <p>Sipas përshkrimit në preventiv ky detaj duhet të ishte realizuar me dimensione 5 m diametri dhe 3 m i lartë figura kur në fakt nga verifikimi në terren i kryer ky zë është realizuar me konfiguracion me dimensione 3.8 m dhe 2.4 m, ose përkatësisht 1.2 m dhe 0.6 m më pak. Pra, vlera prej 745,000 lekë pa TVSH nuk është kryer sipas kërkesave të projektit.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”, neni 12, ku përcaktohet se:</p> <p>“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. <p>- Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:</p> <p>Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”;</p> <p>- Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:</p> <p>“3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e vëllimeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që</p>

	<p>përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</p> <p>Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:</p> <p>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</p> <p>a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.</p> <p>b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.</p> <p>c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.</p> <p>ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.</p> <p>Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.</p> <p>- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve e lidhur sipas aktit me nr. 6477/8 prot., datë 22.11.2021;</p> <p>- Urdhri nr. 653, datë 03.12.2019 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës”.</p> <p>- Urdhri nr. 265/1 prot., datë 13.01.2022 “Për ngritjen e komisionit për kolaudimin e punimeve”.</p>
4.1 Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe MBZHR në shumën 172,718 lekë pa TVSH.
4.2 Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe MBZHR në shumën 745,000 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Mos reflektimi në situacionin përfundimtar i sasive të zërave të kryer në fakt si dhe mungesa e ushtrimit të kontroleve të nevojshme nga ana e mbikëqyrësit, kolaudatorit, grupit të ndjekjes së kontratës si dhe grupit të marrjes në dorëzim.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 172,718 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit BOE R. për punime të likuiduara por të pakryera në fakt në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me objekt “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e MBZHR të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorim/ndjekje kontrate dhe atyre të marrjes në dorëzim me qëllim

	shmangien e rasteve të mospërputhshmërisë mes zërave të preventivave dhe atyre të kryer në fakt, duke shmangur kështu edhe përdorimet pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve si është ai i shumës prej 745,000 lekë pa TVSH i shkaktuar prej mos respektimit të detajeve të projektit.
--	--

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE A. M. është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 1175/16 prot., datë 02.06.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Zëri Transport mbetjesh deri 7 km

Referuar strukturës së kostos së preventivit të punimeve, të hartuar nga projektuesi të gjitha volumet e prishjeve pavarësisht analizës referuese të tyre janë parashikuar të transportohen të gjitha jashtë objektit sipas zërit të punimeve 2.37/b Transport mbetjesh deri në 7 km. Sasia e parashikuar në preventivin e punimeve për transport jashtë objektit=850 m3 përfshin volumet për Prishje mur tulle pa pastrim, Prishje shtresa ekzistuese betoni, Prishje mbulesë me panale betoni, Heqje dyer dritare të jashtme. Referuar gjithashtu relacionit të projektuesit dhe Specifikimeve teknike për kapitullin Prishjet, nënvizohet se të gjitha materialet e dala nga prishjet gërmimet, lëvizjet e dherave etj. do të transportohen jashtë objektit ...”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja si më sipër nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen në mënyrë konkrete gjetjeve. Sqarojmë se nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar si diferencë e cila duhet zbritur vetëm sasia dhe vlera korresponduese e transportit të kryer për zërin Prishje mure tulle pa pastrim me nr. analize 2.426. Për këtë zë, referuar manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit në fuqi në momentin e realizimit të kontratës, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, çmimi njësi për këtë zë ka parashikuar edhe punimet për transportin e materialit të rezultuar nga prishjet (210 lekë/m3). Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit.

Pretendimi i subjektit:

“Zëri F.V. Punime artistik me metal inoksidabël, rrrathë me diametër 5 m dhe figurë 3 m të lartë Në lidhje me këtë zë punimesh në dokumentacionin teknik të hartuar nga ana e Projektuesit nuk ka pasur asnjë të dhënë teknike si në vizatime detaje të veçanta, ashtu edhe në specifikimet teknike për punimet e ndërtimit. Për prodhimin dhe instalimin e këtij instalacioni kontraktori i punimeve në koordinim edhe me mbikëqyrësin e punimeve dhe repartin artistik ku është realizuar instalacioni, janë bazuar në fletën e projektit Imazhe 3D nga ku kanë riprodhuar në dimensione për zbatim konfigurimin e këtij instalacioni. Duke marrë për bazë imazhin 3D në raport me planvendosjen e instalacionit dhe në raport me hapësirat e tjera, dimensionet e përfuara sipas programeve kompjuterike janë ato të zbatuara edhe në vepër me rrrathë me diametër 3.8 m dhe figurë 2.4 m. Po kështu edhe analizat statike për qëndrueshmërinë e instalacionit duke marrë parasysh se instalimi lidhet vetëm në 1 pikë me bazamentin, kanë nxjerrë se një instalacion me përmasa më të mëdha se ato të realizuara në vepër jo vetëm do të prishte raportin e kërkuar në pamjet 3D, por edhe nuk garantonin qëndrueshmërinë e tij pas montimit. Në lidhje me vlerën financiare 745,000 lekë pa TVSH, nënvizojmë se ajo është totalisht e justifikuar pasi volumet e punimeve për bazamentin mbështetës janë realizuar më tepër se ato në preventivat dhe situacionin përfundimtar, si dhe në vlerën përfundimtare nuk janë përfshirë kostot e transportit deri në vepër si dhe makineritë (vinça) për montimin e saj.”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja si më sipër nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen në mënyrë konkrete gjetjeve. Sqarojmë se për sa kohë zëri në preventiv ka parashikuar një instalacion me dimensione 5 m diametri dhe 3 m lartësia e

figurës, një përshkrim i tillë nuk lë vend për të kërkuar informacion shtesë në specifikime teknike apo dokumente të tjera të projektuesit. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë dhe si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit. Grupi i auditimit merr në konsideratë pjesërisht observacionin në lidhje me zërin Shtresë betoni C-12/15 duke bërë edhe korrigjimet përkatëse përgjatë materialit.

Nga ana e grupit të kolaudimit të punimeve Ing. M.H.dhe Ing. B. Ç. është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 1175/14 prot., datë 02.06.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Zëri Transport mbetjesh deri 7 km

Grupi i kolaudimit ka kontrolluar dokumentacionin teknik të paraqitur në dosjen teknike e cila është miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe korrespondon me llogaritjen e miratimit e volumit të realizuar në librezën e masave dhe preventivi i tenderit, preventivin e ripunuar dhe situacionin përfundimtar.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja si më sipër nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen në mënyrë konkrete gjetjeve.

Nga ana e punonjësit A. V. është dërguar observacioni i administruar në KLSH me nr. 1175/11 prot., datë 02.06.2023 i cili gjen trajtim si më poshtë.

Pretendimi i subjektit:

“Sqarojë se unë A.V.nuk kam qenë subjekt përfaqësues i këtij objekti prokurimi” .

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Grupi i Auditimit merr në konsideratë observacionin pasi përfshirja në Aktin e Konstatimit të emrit Andi Vila për këtë praktikë është lapsus.

2.7. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit dhe vlerësimi i auditit të brendshëm.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm
- Rregullore e brendshme Nr.4276, datë 02.062021
- Shkresat për emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues
- Regjistri i riskut
- Kodi Etik i MBZHR

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
- Urdhri i Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR” i ndryshuar;
- Urdhri i Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”;
- Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016,

Auditimit, u fokusua kryesisht në këto çështje:

- ☞ Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit
- ☞ Menaxhimi i riskut
- ☞ Veprimtaritë e kontrollit
- ☞ Informim komunikimi
- ☞ Monitorimi

Nga auditimi:

I. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Referuar legjislacionit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, “Mjedisi i kontrollit” është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Vlerësimi i Mjedisit të kontrollit bazohet në komponentët:

1. Integriteti personal dhe etika profesionale nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike;

Në lidhje me këtë komponent MBZHR ka të miratuar një Kod Etike me urdhër të ministrit Nr.85, datë 17.02.2020 “Për miratimin e rregullores së Etikës” në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016, Kap. III, pika 3.1 ku sanksionohet se:

“Kudri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësive publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje”.

Ky detyrim ligjor gjen përcaktim dhe në Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” si dhe në Rregulloren e Brendshme Nr.4276 prot, datë 02.06.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR” kreu VIII, IX, X, ku trajtohen çështje lidhur me kodin e sjelljes dhe etiken profesionale të punonjësve.

Titulli i gjetjes	Mungesa e strukturës Mbikëqyrëse të Etikës në MBZHR.
Situata	Në Kodin e Etikës, neni 19, është parashikuar detyrimi për ngritjen e Strukturës Mbikëqyrëse të Etikës si më poshtë: “Me autorizim të Sekretarit të Përgjithshëm, përcaktohet Struktura e Mbikëqyrëse së Etikës në përbërje të së cilës, dhe sipas hierarkisë është Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtori i Drejtorisë së Mirë administrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore...” Deri në momentin e auditimit në terren nuk rezulton që nga Sekretari i Përgjithshëm të jetë nxjerrë autorizimi për ngritjen e kësaj strukture, veprim jo në përputhje me nenin 19 të Kodit të Etikës e cila është kompetencë e ish Sekretarit të Përgjithshëm z. O.M.
Kriteri	Kodi e Etikës, neni 19.
Ndikimi/Efekti	Struktura Mbikëqyrëse e Etikës nuk është ngritur si strukturë e parashikuar me akt nënligjor.
Shkaku	Mos zbatimi i Kodit të Etikës, neni 19.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	1.Të merren masa nga Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR për nxjerrjen e aktit administrativ/autorizimit, për ngritjen e Strukturës Mbikëqyrëse të Etikës sipas përcaktimeve ligjore parashikuar në Kodin e Etikës së institucionit, neni 19, duke përshkruar kompetencat e kësaj strukture me përshkrime konkrete të detyrave.
Afati zbatimit:	Deri në fund të shtatorit 2023

Për periudhën objekt auditimi ka pasur 21 raste të largimit nga puna/MBZHR të punonjësve me shërbim civil (pa përfshirë punonjës me kontratë dhe ato me Kod Pune).

Titulli i gjetjes	Mos dorëzimi i detyrës (dokumentacionit dhe materialeve në ngarkim) nga nëpunësit civil me procesverbal.
Situata	Në shumicën e rasteve (15), punonjësit nuk kanë dorëzuar detyrën dhe dokumentacionin e administruar prej tyre me procesverbal, por kanë dorëzuar vetëm materialet në ngarkim me inventar sipas një formati tip,

	<p>ku në 7(shtatë) raste, procesverbalet janë pa datë (lista emërore sipas procesverbaleve në Tabelën nr.7.1 tek seksioni Aneksë), ndërsa për 5 raste dorëzimi i dokumentacionit është bërë komfort legjislacionit për nëpunësin civil. Mos dorëzimi i dokumentacionit nga punonjësit e larguar sjell si pasojë marrje informacioni jo të plotë për detyrën për punonjësit pasardhës, veprim jo në përputhje me Kodin e Etikës dhe legjislacionit për shërbimin civil konkretisht të VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22, pasi në nenin 6 të Kodit të Etikës, paragrafi 1, është sanksionuar detyrimi:</p> <p>“Punonjësit e institucionit të cilët kanë statusin e nëpunësit civil, duhet të zbatojnë me korrektësi të gjitha rregullat e procedurat që rrjedhin nga legjislacioni për nëpunësit civil, si dhe legjislacionin në fuqi...”.</p> <p>Referuar këtij detyrimi ligjor si dhe VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22, për raste të largimit të punonjësve me shërbim civil, përcaktohet qartë se:</p> <p>“19. Nëpunësi që largohet nga detyra duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës, në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil.</p> <p>20. Nëpunësi duhet t'i bëjë pasardhësit dorëzimin e plotë të dokumentacionit,...ose në pamundësi, eprorit drejtpërdrejt apo një nëpunësi tjetër civil, të cilit eprori ia delegon këtë detyrë.</p> <p>21. Dorëzimi i detyrës, dokumentacionit, ..., bëhet, si rregull, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të lirimimit. Në raste të veçanta dhe me urdhër të sekretarit të përgjithshëm ky afat mund të zgjatet edhe deri me 5 ditë të tjera.</p> <p>22. Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 21, të këtij vendimi përbën shkelje të rëndë disiplinore...”, kompetencën e Sektorit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.</p>
Kriteri	-VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22, -Kodi i Etikës së MBZHR, neni 6.
Ndikimi/Efekti	Parregullsi në administrimin e dokumentacionit si pasojë e largimit nga puna të nëpunësve.
Shkaku	Mos dorëzimi i detyrës komfort përcaktimit ligjor për nëpunësin civil.
Rëndësia	I ulët
Rekomandimi	1.Të merren masa nga struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në MBZHR, që në rastet e largimit nga puna për punonjësit me shërbim civil, dorëzimi i dokumentacionit të administruar prej tyre të bëhet me procesverbal, me qëllim eliminimin e vonesave të krijuara në rastet e auditimit të tij nga auditi i jashtëm apo auditi i brendshëm.
Afati zbatimit:	Rast pas rasti

Në lidhje me sa sipër, ndaj Projekt raportit është bërë observacion nga MBZHR dërguar në KLSH me shkresën nr. 211/62, datë 18.07.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: ”Njësia e Burimeve Njerëzore nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të DPESHM ka zbatuar detyrimet në kuptim të nenit 27, 28 dhe 29 të Vendimit nr.124 date 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar. Kjo strukturë ka administruar në çdo

rast “**Procesverbalin për punonjësin që largohet nga detyra**”, i cili nënshkruhet nga vet nëpunësi/punonjësi, si dhe nga:

Eprori direkt në kuptim të nenit 28 të VKM-së lart përmendur;

Spektori i Financës (verifikon që nëpunësi që largohet nga detyra nuk ka asnjë detyrim financiar);

Magazini (verifikon nëse mallrat/pajisjet që ka marrë në dorëzim janë të njëjtat dhe të pa dëmtuara sipas process verbalit, që magazina mban me punonjësin, në momentin që fillon mareëdhëniet e punës).

Zyra e arkiv –protokollit (bën verifikimin, nëse ka shkresa pa kthyer përgjigje apo kur mungojnë praktikatat shoqëruese).

Spektori i Burimeve Njerëzore, (pasi ka verifikuar që janë firmosur sa më sipër dhe nëpunësi/punonjësi nuk ka detyrime, i dorëzon librezën e punës të firmosur dhe të vulosur si dhe dosja personale i kthehet punonjësit që largohet, duke mbajtur një kopje të saj sipas përcaktimeve të vendimit nr.833, datë. 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë: Observacioni **nuk merret në konsideratë**, pasi nuk ka argumentim ligjor. Ritheksohet dhe njëherë se në zbatim të VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 20 për raste të largimit të punonjësve me shërbim civil, përcaktohet qartë: “Nëpunësi duhet t’i bëjë pasardhësit dorëzimin e plotë të **dokumentacionit**,...ose në pamundësi, eprorit drejtpërdrejt apo një nëpunësi tjetër civil, të cilit eprori ia delegon këtë detyrë” si dhe pika 21 “Dorëzimi i detyrës, **dokumentacionit**, ..., bëhet, si rregull, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të lirimimit...”, pra bëhet fjalë për dokumentacionin e prodhuar prej tij dhe jo materialet me vlere ekonomike ne ngarkim të tij.

2) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës;

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9, pika 4, germa “a”, “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:

a)propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi...” si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV, pika, 4.2.10, germa “a”,

Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor nga MBZHR objektivat janë përcaktuar në PBA 2021-2023, ka hartuar plane pune dhe ka kryer analiza vjetore të veprimtarisë.

Në lidhje me këtë komponent në zbatim të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar neni 8, pika 8/b ku përcaktohet se:

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike’, nga MBZHR, në funksion dhe zbatim të këtij detyrimi ligjor çdo vit del urdhri i ministrit për ngritjen e grupit strategjik (GMS).

Respektivisht për vitin 2021, me Urdhër të ministrit Nr.64, datë 15.2.2021 është ngritur GMS, i cili ka funksionuar deri në hyrjen në fuqi të Urdhrit Nr.628, datë 15.12.2021dhe përfshin periudhën Dhjetor 2021-Dhjetor 2022. Gjithashtu me Urdhrin e ministrit Nr.629, datë 15.12.2021 është ngritur ekipi i menaxhimit të programeve buxhetore i cili ka shfuqizuar Urdhrin Nr. 84, datë 15.02.2021.

Për vitin 2022, me Urdhrin Nr.373, datë 15.03.2022 është ngritur GMS që ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Urdhrit Nr.628, datë 15.12.2021, që përfshin periudhën Dhjetor 2022-Dhjetor 2023. Gjithashtu me Urdhrin e ministrit Nr.372, datë 15.08.2022 është ngritur ekipi i menaxhimit të programeve buxhetore i cili ka shfuqizuar Urdhrin Nr. 629, datë 15.02.2021.

Në përbërje të GMS, në respekt të nenit 27 të ligjit bëjnë pjesë: titullari i MBZHR, sekretari i përgjithshëm, dhe zëvendësministri, menaxherë të lartë si dhe drejtor i auditimit të brendshëm por pa të drejtë vendimmarrjeje.

Bazuar në Udhëzimin Nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’ përcaktohet se:

‘GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike’.

Për vitin 2021, në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton që GMS ka marrë 2 vendime në mbledhjet e zhvilluara. Vendimi GMS-së për PBA 2022-2024 faza e parë, strategjike është pa datë dhe pa protokolluar. Numri i mbledhjeve të GMS duhet të jetë të paktën 4 herë në vit sipas Udhëzimit Nr.16, datë 20.07.2016.

Për vitin 2022, vërehet i njëjti fenomen në lidhje me numrin e mbledhjeve për vit, pasi dhe për këtë periudhë GMS ka marrë 2 vendime në mbledhjet e zhvilluara, ku të dy vendimet, janë pa datë dhe pa protokolluar. (PBA 2023-2025 faza e parë, strategjike dhe për PBA 2023-2025 faza e dytë, teknike).

3) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

MBZHR për vitin 2021 dhe 2022, ka funksionuar në zbatim të strukturës organizative, miratuar me urdhrat e Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”; Nr.162, datë 14.12.2020 dhe Nr.88, datë 20.05.2022.

Për periudhën objekt auditimi, MBZHR funksionon në bazë të Rregullores Nr. 4276 prot, datë 02.06.2021. Ndryshimet strukturore që kanë ndodhur në këtë periudhë që auditohet nuk janë reflektuar në përditësimin e Rregullores deri në fund të vitit 2022, e cila ka sjellë si pasojë që ndarja e detyrave, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit të mos jenë të qarta, veprim jo në përputhje me Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 20.

Gjatë fazës së auditimit në terren me Urdhrin e ministrit Nr.185, datë 29.03.2023 është miratuar Rregullorja.

Titulli i gjetjes	Mos plotësimi i vendeve të lira/vakante. Punonjës (20) të emëruar përkohësisht sipas VKM-ve përkatëse për vitin 2021 dhe (25) punonjës për vitin 2022 pa kontrata pune, Mos deklarim pasurie në ILDKPI nga këshilltarët e jashtëm.
Situata	<p>-Struktura organike nuk është plotësuar pasi vazhdon të ketë vende të lira/vakante dhe pse ka plan vjetor për rekrutimin në shërbimin civil si dhe vazhdojnë të kryhen procedura konkurimi nga DAP-i.</p> <p>-Pavarësisht vendeve të lira/vakante, janë kontraktuar punonjës me kontrate të përkohshme pune për vitin 2021 dhe 2022 në zbatim të VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020 dhe VKM Nr.35, datë 19.01.2022, për të cilët nuk janë lidhur kontrata pune por vetëm akte të emërimit.</p> <p>-Në 2 (dy) raste emërimi për vitin 2022, në pozicionin “këshilltar i jashtëm i ministrit”, në zbatim të VKM Nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar, nuk kanë bërë deklarim të pasurisë në zbatim të Ligjit Nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, neni 3, pika 1, germa “gj” ku përcaktohet se: “Mbartin detyrimin për deklarim ne Inspektoratin e Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive:...“zyrtaret qe zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta”.</p>

Kriteri	-Urdhri i Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”; Nr.162, datë 14.12.2020 dhe Nr.88, datë 20.05.2022. - VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020 dhe VKM Nr.35, datë 19.01.2022, -Ligji Nr.9049, date 10.4.2003 -VKM Nr.187, datë 08.03.2017
Ndikimi/Efekti	1.Vende të lira/vakante pa plotësuar. 2.Punonjës (njëzet) pa kontratë pune për vitin 2021 dhe 25 për vitin 2022 3.Mos deklarim pasurie për vitin 2022 nga këshilltarët e jashtëm të ministrit.
Shkaku	Mos zbatim i VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	1.Të merren masa nga titullari i MBZHR në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike për plotësimin e vendeve të lira/vakante në MBZHR, me qëllim minimizimin e tyre. 2.Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, për punonjësit e kontraktuar përkohësisht në zbatim të akteve nënligjore që nxjerr Këshilli i Ministrave (VKM) rast pas rasti për vitin respektiv, të lidhen kontrata pune krahas akteve të emërimit në detyrë. 3.Të merren masa nga titullari/ministri i MBZHR që në bashkëpunim me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të nenit 4 të Ligjit Nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, ILDKPKI t’i propozojë Kuvendit, plotësimin e nenit 3 të Ligji Nr.9049, date 10.4.2003 për detyrimin e deklarimit të pasurisë edhe për këshilltarët e jashtëm të cilët emërohen në përputhje me VKM Nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar.
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe rast pas rasti

Me shkresën Nr.7043/5 prot., datë 27.10.2021 është dërguar në MFE ndryshimi i Nëpunësit Autorizues (NA) të MBZHR duke përcaktuar si të tillë z. O. M. me detyrë ish Sekretar i Përgjithshëm, i cili është konfirmuar nga MFE me e-mail të datës 27.10. 2021.Gjithashtu me shkresën Nr.7456/2, datë 24.11.2021 është konfirmuar në MFE Nëpunësi Zbatues z. A.V., në përputhje me kërkesat të Ligjit Nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar neni 8/2 dhe neni 9, pika 4, germa “ç”.

4) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe veprimet disiplinore, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.

Burimet njerëzore, referuar strukturës së miratuar menaxhohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Aktiv-Protokollit. Sektori mbulon çështjet që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit, emërimit dhe lirimimit nga detyra apo shërbimi civil, procedurat disiplinore, administrimin e dosjeve të personelit, plotësimin e regjistrit qendror të personelit, përgatitjen e përshkrimeve të punës. Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike administron trajnimet dhe kualifikimet e stafit.

5) Aftësitë profesionale të punonjësve.

Aftësitë profesionale të punonjësve janë në dinamikë të vazhdueshme, pasi nga ASPA organizohen trajnime të ndryshme në mënyrë që punonjësit të ngrihen profesionalisht.

Megjithatë nga MBZHR nuk është hartuar plan vjetor trajnimesh në lidhje me ngritjen profesionale të punonjësve në fushat specifike që operon vetë ky subjekt, por është mjaftuar vetëm me trajnimet e planifikuara dhe organizuara nga ASPA.

II. Menaxhimi i riskut.

Në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar neni 21, duhet të identifikohen, vlerësohen dhe kontrollohen ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të MBZHR-së.

MBZHR nuk ka hartuar dhe miratuar një regjistër të konsoliduar të risqeve për institucionin, duke vepruar në përputhje me nenin 8, germa “a” dhe nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, ku përcaktohet se :

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave’.

“Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, (ose duke deleguar këtë detyrë) miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut...”.

III. Veprimtaritë e kontrollit.

Në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika 3.2, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, është hartuar harta e proceseve të punës si dhe gjurmët e auditimit.

Titulli i gjetjes	Funksionimi jo harmonik i sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Situata	Sistemet e kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar në harmoni të plotë me njeri- tjetrin, pasi: -nuk janë kryer procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave duke mos koordinuar sistemet e kontrollit mbi kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga monitorimi i kontratave të qirasë së tokave bujqësore në administrim të MBZHR. Një konstatim i tillë doli nga auditimi i pasqyrave financiare 2021–2022 (llogaria 210) “toka troje” figuron në vlerën 0; -në lidhje me rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore, për periudhën 2021-2022 ka raste të largimit të punonjësve me shërbim civil, të cilët nuk kanë dorëzuar detyrën dhe dokumentacionin e administruar prej tyre me procesverbal, e cila sjell si pasojë thyerjen e Kodit të Etikës dhe veprime jo në përputhje me VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22.
Kriteri	-Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar -VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirimin nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22.
Ndikimi/Efekti	Gjendja jo reale e detyrimeve të pa kontabilizuara që rrjedhin nga keq monitorimi i kontratave të qirasë së tokave bujqësore në administrim të MBZHR.
Shkaku	Mos pasqyrim në pasqyrat financiare
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi	1.Të merren masa nga titullari i MBZHR në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për financën dhe monitorimit të kontratave të qirasë së tokës bujqësore në administrim të MBZHR-së, për kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga monitorimi i kontratave të qirasë së tokave bujqësore në administrim të MBZHR, me qëllim që pasqyrat financiare të viti 2023 të japin gjendjen reale të detyrimeve.
Afati zbatimit:	Menjëherë dhe rast pas rasti

IV. Informim komunikimi

Shkëmbimi i informacionit realizohet ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Në Rregulloren e brendshme dhe Kodin e Etikës janë përshkruar proceset e punës dhe sjellja e etike gjatë punës si dhe marrëdhëniet me njëri tjetrin. Komunikimi i informacionit realizohet përmes shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe përmes postës elektronike/e-mail.

Informacion periodik sigurohet në mënyrë të ndërsjellët, raportimet bëhen rast pas rasti mujore, IV mujore dhe vjetore.

Informacioni dhe komunikimi lidhen edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Rregullat e komunikimit elektronik të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen nga AKSHI.

V. Monitorimi

Referuar përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit “monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur”. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari realizohet nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër, për periudhën e audituar, MBZHR ka përgatitur Deklaratën dhe Raportin vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2021, dërguar në MFE me shkresën nr.172/25 prot., datë 07.03.2022 si dhe Deklaratën dhe Raportin vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2022, dërguar në MFE me shkresën nr.1306/1 dhe nr.21306/2, prot., datë 28.02.2023 komfort Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 18.

Raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2021-2022 është hartuar në bazë të formatit të miratuar në Shtojcën 2 të Udhëzimit të Titullarit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011.

Për të realizuar sa mirë objektivat si dhe për të pasur një proces transparent monitorimi në varësi të titullarit të MBZHR-së është dhe struktura e auditimit të brendshëm. Kjo strukturë për vitin 2022 nuk ka funksionuar me kapacitet të plotë pasi është i lirë vendi për pozicionin “specialist” si dhe “drejtor”, duke sjellë si pasojë që drejtoria të mos jetë efciente plotësisht.

Në MBZHR është ngritur dhe funksionon dhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm i ngritur me Urdhër të ministrit, me mandat dy vjeçar me të drejtë riemërimi, i cili për vitin 2021 rezulton të jetë mbledhur 4 herë dhe për vitin 2022 është mbledhur 4 herë.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm u konstatua:

☞ Mungesa e Strukturës Mbikëqyrëse të Etikës në MBZHR si detyrim që rrjedh nga Kodi i Etikës.

☞ Në 15 raste, punonjësit me shërbim nuk kanë dorëzuar detyrën/dokumentacionin e administruar prej tyre me procesverbal, jo në përputhje me VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirin nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22.

☞ Struktura organike nuk është plotësuar pasi vazhdon të ketë vende të lira/vakante dhe pse ka plan vjetor për rekrutimin në shërbimin civil si dhe nga DAP-i realizohen procedura konkurrimi.

☞ Për vitin 2021 dhe 2022, për punonjësit e kontraktuar në zbatim të VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020 dhe VKM Nr.35, datë 19.01.2022 nuk janë lidhur kontrata por vetëm akte të emërimit.

☞ Nuk janë kryer procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, siç është kontabilizimi i detyrimeve që rrjedhin nga monitorimi i kontratave të qirasë së tokave bujqësore në administrim të MBZHR në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave.

II/7 Vlerësimi i auditit të brendshëm.

Për drejtimin e këtij drejtimi në zbatim të pikës II/7 të programit të auditimit Nr.1175/1 datë 11.01.2023”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Struktura organike, baza e të dhënave/data baza mbi personelin;

-Plani strategjik dhe vjetor 2021 dhe 2022 me ndryshimet përkatëse;

-Deklarata dhe raporti për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshme të MBZHR-së, për vitin 2021 dhe 2022.

-Plani i trajnimit të audituesve nga MFE/DH/AB për vitin 2021 dhe 2022.

-Certifikatat për përfundimin e trajnimeve të vijueshme profesionale në zbatim Ligjit Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

-Dosjet e auditimit.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

-Ligji Nr.152/2013“Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;

-Urdhri i Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR” i ndryshuar;

-Urdhri i Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”;

-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;

-Manuali i “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016.

Auditimi i këtij drejtimi u fokusua kryesisht në këto çështje:

☞ organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit dhe i njësive të varësisë. Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme.

☞ bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori.

☞ realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB.

☞ sigurimi i brendshëm i cilësisë së auditimit.

me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Struktura organike e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Për periudhën objekt auditimi (01.04.2021 deri me datë 30.06.2022) funksionon Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.150, datë 05.11.2020. Për vitin 2021, numri total i punonjësve në strukturë të kësaj drejtorie është 5 (plani) ndërsa numri

në fakt i punonjësve nga 15.4.2021-19.7.2021 është 5 (fakti) dhe nga 19.07.2021 deri me 27.10.2021 ka funksionuar me 3 specialistë dhe 1 drejtues të komanduar deri në 30.11.2021. Nga 30.11.2021 deri me 31.12.2021 ka funksionuar me 3 specialistë dhe 1 drejtor. Në datë 01.07.2022 ka hyrë në fuqi struktura e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR” ku numri i punonjësve të kësaj drejtorie është 5 (plani) konkretisht (1drejtor+4 specialistë), ndërsa në fakt numri i punonjësve/specialistëve është 3 (fakti) dhe 1 drejtor deri në 15.7.2022. Nga Gushti 2022-31.12.2022, drejtorja funksionon me 3 specialistë ku një (1) specialist është i komanduar drejtor.

Titulli i gjetjes	Mos plotësimi i vendit të lirë/vakant në pozicionin ”drejtor” në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.
Situata	Për periudhën Gusht 2022 deri 31.12.2022, Drejtorja e Auditit të Brendshëm ka funksionuar jo me efikasitet dhe efektivitet të plotë, pasi pozicioni-Drejtor, rezulton vend i lirë/vakant për vitin 2022. Nga MBZHR është bërë kërkesë pranë DAP vetëm për plotësimin e vendeve të lira/vakante në pozicionin “specialist” referuar planit të rekrutimeve për vitin 2022 dërguar në DAP dhe jo për pozicionin “drejtor”, veprim ky jo në përputhje me VKM Nr.108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 3, germa “b”, kompetencë e Sektorit të Burimeve Njerëzore.
Kriteri	Urdhri i Kryeministrit Nr.88, datë 20.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”.
Ndikimi/Efekti	Funksionimi i Drejtorisë së AB jo me efikasitet dhe efektivitet të plotë.
Shkaku	Mos plotësimi i vendit të lirë/vakant në pozicionin “drejtor” drejtorie AB.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	1.Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri në bashkëpunim me DAP-in, për plotësimin e vendit vakant/të lirë në pozicionin ”drejtor” drejtorie AB.
Afati zbatimit:	Brenda vitit 2023

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Në zbatim të Ligjit Nr.114/2015, datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:

“Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në gjerat a-c të kësaj pike” është ngritur dhe funksionon Drejtorja e Auditit të Brendshëm (DAB) në varësi funksionale nga Titullari/Ministri i MBZHR. Gjithashtu dhe në strukturat e varësisë së MBZHR-së janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e auditit të brendshëm.

Në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) e cila është strukturë varësie e MBZHR-së megjithëse është ngritur Drejtorja e Auditit të Brendshëm ajo nuk funksionon, pasi nuk është plotësuar me staf. Në Raportin vjetor të veprimtarisë së DAB-it për vitin 2021 dërguar në Ministrinë e Financave Ekonomisë/Drejtorja e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, me qëllim hartimin e “Raportit vjetor të konsoliduar dhe vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, është evidentuar ky fakt i cili vazhdon të jetë edhe gjatë periudhës së ushtrimit të auditimit, dhe pse nga ana e AKVMB, i është bërë kërkesë DAP-it për shpallje të vendeve të lira/vakante pjesë e shërbimit civil, me shkresën nr. 1100/1 prot., datë 19.09.2022. Pas konstatimit të KLSH-së nga titullari/ministri i MBZHR ka dalë Urdhri nr.243, 2411 prot, datë 25.4.2023”Për kryerje auditimi në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Institucionet e Varësisë: Drejtoritë rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë”, duke u ezauruar dhe rekomandimi i KLSH-së.

Në lidhje me sa sipër, është mbajtur nga audituesit shtetërore Akt konstatimi Nr. 2, datë 08.05.2023 ndaj të cilit nga MBZHR është bërë observacion me shkresën Nr.211/17, datë 15.05.2023, protokolluar në KLSH nr. 1179/6, datë 16.05.2023, nga znj. L. Gj. me detyrë drejtor drejtorie AB i komanduar dhe znj. B. K., me detyrë ish Drejtor drejtorisë së AB, ku GA i ka trajtuar dhe është shprehur në projekt raport. Në fazën e RPA, nuk janë paraqitur observacione nga DAB.

DAB/MBZHR në zbatim të Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, neni 20, pika 2, ka në përbërje të saj auditues të cilët janë të gjithë të certifikuar, pasi kanë mbaruar trajnimin e vijueshëm profesional, detyrim ligjor, minimumi 80 orë për 2 vjet.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, funksionimi.

Në zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr.114.2015 i ndryshuar funksionon Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB) i cili është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm. Ai e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

Për periudhën objekt auditimi 01.04.2021 deri 31.12.2022, rezulton të jenë emëruar anëtarët e tij me Urdhër të Ministrit të MBZHR-së Nr.298, datë 08.07.2021 me mandat dy vjeçar me të drejtë riemërimi, ku KAB do mbulojë gjithashtu edhe detyrat e auditimit për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

KAB për vitin 2021 është mbledhur 4 herë ku ka dalë me vendime në lidhje me problematika të ndryshme. Për çdo mbledhje është mbajtur procesverbal i cili bashkëlidhet vendimit respektiv.

KAB bazuar në Ligjin Nr.114/2015 i ndryshuar, neni 13, kreu IV, VKM Nr. 160, datë 2.3.2016 "Për mënyrën e funksionimit , kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike" pika 3, si dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm pika 2.7.3, kap. IV për vitin 2021, ka përgatitur "Raportin vjetor të veprimtarisë së tij", i cili është miratuar me Vendimin e KAB Nr.7, datë 21.02.2022.

Për vitin 2022, KAB është mbledhur 4 herë ku ka dalë me vendime në lidhje me problematika të ndryshme. Për çdo mbledhje është mbajtur procesverbal i cili bashkëlidhet vendimit respektiv.

Bazuar në Ligjin Nr.114/2015 i ndryshuar, neni 13, kreu IV, VKM Nr. 160, datë 2.3.2016 "Për mënyrën e funksionimit , kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike" pika 3, si dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm pika 2.7.3, kap. IV, për vitin 2022 ka përgatitur "Raportin vjetor të veprimtarisë së tij", i cili është miratuar me Vendimin e KAB Nr.26, datë 14.02.2023.

Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

"Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën 10 Tetor të çdo viti. Planet pas dhënies së mendimit të KA-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm....."

Nga të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm rezulton se:

Për vitin 2021, plani vjetor i auditimit është dërguar në MFE-DH/AB brenda afatit ligjor me shkresën nr.7710/1, datë 16.10.2020 i cili është miratuar me Vendim të Komitetit të Auditit të Brendshëm të MBZHR-së Nr.42, datë 09.10.2020 ku ishin planifikuar 16 auditime.

Në planin vjetor të auditimit për këtë periudhë ka pasur ndryshime pasi janë planifikuar dhe 2 subjekte të tjera: (DRVMB dhe zbatimi i rekomandimeve për të gjitha subjektet e audituara). Ndryshimet për të cilat pasi janë marrë mendimet e KA dhe miratuar nga titullari, janë dërguar në MFE-DH/AB me shkresën nr.6097, datë 31.8.2021.

Për vitin 2022, plani vjetor i auditimit është dërguar në MFE-DH/AB brenda afatit ligjor me shkresën nr.6284/5, datë 18.10.2021 miratuar me Vendimin e Komitetit të AB të MBZHR-së (KA) me Nr.3, datë 05.10.2021, ku ishin planifikuar 16 auditime.

Në planin vjetor të auditimit për këtë periudhë ka pasur ndryshime pasi janë audituar 2 subjekte me Urdhër të ministrit të MBZHR (Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Skema e shpërndarjes së naftës për fermerët viti 2021), ndryshim i cili është dërguar në MFE me shkresën nr.6249/6, datë 30.12.2022 megjithëse në rrugë elektronike është dërguar 20.12.2022. Ndryshimet në plan konsiderohen të dërguara me vonesë zyrtarisht dhe pse në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, kapitulli III, pika 3.5 përcaktohet qartë se:

“Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NJAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet)”.

“Të gjithë planet vjetore dhe strategjike të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t’i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra”.

Në detyrimin ligjor të sipërcituar ku parashikohet e drejta e NJAB-ve për të bërë ndryshime në plan, nuk është shprehur qartë dhe nuk është përcaktuar asnjë afat ligjor për pranimin e ndryshimeve në planet vjetore. Në këto kushte dhe ndryshimet në planet vjetore mund të dërgohen në strukturën përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, brenda dhjetorit të çdo viti (15 dhjetor) ose në fund të dhjetorit.

Në pikën 3.3 të kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, përcaktohet: “ ... Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda datës 15 Dhjetor të çdo viti përgatit planin e konsoliduar strategjik dhe vjetor për të gjithë veprimtarinë e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Në kuptimin literal, të këtij detyrimi ligjor, dërgimi i planeve vjetore individuale pas kalimit të afatit ligjor (15 dhjetor) nuk përfshin edhe ndryshimet që mund të ndodhin në planin e konsoliduar, në lidhje me ndryshime e planeve individuale vjetore të njësisë publike. Për pasojë ndryshimet në planet individuale të njësisë të auditit, pas afatit ligjor (15 dhjetor), nuk reflektojnë ndryshimet në planin e konsoliduar, pasi ai (plani) publikohet brenda datës 15 dhjetor të çdo viti dhe sjell konfuzion në vlerësimin e realizimit të planeve.

Shënim: Në lidhje me konstatimin e sipërm, KLSH i ka rekomanduar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm/MFE dërguar me shkresën Nr.19/9 prot., datë 09.09.2022 masë organizative, për përmirësim ligjor në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhër të Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, me qëllim hartimin dhe paraqitjen sa më objektive dhe të saktë të planit strategjik të konsoliduar duke parashikuar afatin për pranimin e ndryshimeve të planeve individuale para mbarimit të afatit ligjor të hartimit të planit të konsoliduar strategjik dhe vjetor.

Në zbatim të Ligjit Nr. 114, datë 22.10.2015 i ndryshuar, neni 14, germa “ç” është dërguar me shkresën Nr.218/1prot., datë 14.02.2022 brenda afatit ligjor (15 shkurt të vitit pasardhës) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) “Raporti i veprimtarisë për vitin 2021”, si pasqyrat përkatëse dhe “Pyetësori i vetëvlerësimit të Auditimit të Brendshëm”.

Gjithashtu për vitin 2022, me shkresën Nr.543/1prot., datë 14.02.2023 është dërguar në MFE “Raporti i veprimtarisë për vitin 2022”.

Për vitin 2021 referuar të dhënave mbi planifikimin dhe ndryshimet përkatëse rezultojnë se janë planifikuar 16 auditime si dhe 2 auditime janë shtuar (me kërkesë të ministrit), realizuar 18 auditime. Të ndara sipas llojit kemi 17 auditime të plota dhe 1 auditim tematik.

Për vitin 2022, janë planifikuar 12 auditime si dhe 2 auditime janë shtuar (me kërkesë të ministrit), realizuar 14 auditime.

Plani dhe realizimi i auditimeve Prill 2021-Dhjetor 2022.

Viti	Planifikuar	Ndryshimet në plan	Auditime plota/kombinuara	Auditime tematike	Realizuar
2021	16	2	17	1	18
2022	12	2	14	-	14

Burimi: Drejtoria e Auditit MBZHR/përpunuar të dhënat nga KLSH

Referuar Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, në nenin 14, germa “ç”, përcaktohet se “Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për:

ç) Përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe përmban të dhënat e mëposhtme, por nuk kufizohet vetëm në to”.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor me shkresën nr. 218/1, datë 14.2.2022 është dërguar në MFE, Raporti vjetor të veprimtarisë së DAB-it për vitin 2021.

Titulli i gjetjes	Gabime materiale në përgatitjen e Raportit vjetor për vitin 2021, mbi funksionimin e AB.
Situata	Në Raportin vjetor për vitin 2021, mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm i cili paraqitet brenda muajit Maj të çdo viti, te Ministri i Financave që bëhet pastaj pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik, komfort Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, neni 24, germa “d”, konstatohen mospërputhje të dhënash të cilat megjithëse nuk janë të përhapura dhe nuk kanë sjellë ndikim në rezultatin final, mund të përhapen në të ardhmen. Në seksionin I, “Përmbledhje ekzekutive”, pika ”Gjetje Kryesore” faqe 3 dhe Pasqyra 3 ”Përmbledhëse e gjetjeve“ bashkëlidhur raportit shprehet se “gjetje me dëm ekonomik nuk ka”, ndërkohë që më Pasqyrën 5 “Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2021”, seksioni IV, “Rekomandime për arkëtime” pika 3 dhe 8, raportohen rekomandimet për arkëtimin e vlerës 107,760 lekë për gjetje “sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve” si dhe pikat 1-2,6,9-10 raportohen rekomandimet për arkëtimin e vlerës 499,869,342 lekë për gjetje “sistemi administrimit të pronës dhe pasurisë “. Paqartësia në të dhënat e raportuara dhe dërguara në MFE, nuk sjell siguri të arsyeshme në hartimin e raportit të konsoliduar të kontrollit të brendshëm në sektorin publik.
Kriteri	Ligji Nr.114/2015, datë 20.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 24.
Ndikimi/Efekti	Paqartësi dhe pasaktësi të dhënash në përgatitjen e Raportit vjetor për 2021 mbi funksionimin AB, pa ndikim në rezultatin final.
Shkaku	Gabime materiale gjatë hartimit të Raportit.
Rëndësia	E ulët
Rekomandimi	1.Të merren masa nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MBZHR-së që para miratimit të Raportit vjetor mbi funksionimin e AB dhe dërgimit të tij në MFE brenda muajit Majit të çdo viti, të rakordohet nga të gjithë anëtarët e grupit për hartimin e tij, për saktësinë e të dhënave të raportuara dhe gabimet materiale, të cilat mund të ndikojnë në rezultatin final si dhe të konfirmohet prej kësaj strukture.
Afati zbatimit:	Rast pas rasti.

Për 248 gjetje janë dhënë 278 rekomandime.

Për vitin 2022, me shkresën Nr.543/1, datë 14.02.2023 është dërguar në MFE, Raporti vjetor të veprimtarisë së DAB-it për vitin 2022.

Nga të dhënat e Raportit gjetjet e rezultuara me dëm ekonomik në total janë në vlerën 15,436,596 lekë, ku ndarë sipas natyrës:

-për mos arkëtim të qirasë vjetore në vlerën 11,302,246 lekë, që rrjedhin nga kontratat për dhënie të tokës me qira dhe kamatëvonesat në likuidim,

-për gjendjen e kiteve dhe reagentëve në magazinë marrë në dorëzim nga institucioni në vlerën 2,074,800 lekë,

-për aktive të pa dorëzuara nga punonjësit e larguar nga institucioni në vlerën 2,059,370 lekë
Gjetjet sipas sistemeve:

☞ sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve: 44 gjetje, në vlerën 2,074,800 lekë

☞ sistemi pagesave: 31 gjetje, në vlerën

☞ sistemi administrimit të pronës dhe pasurisë: 166 gjetje, në vlerën 2,059,370 lekë

☞ sistemi i shitjes, privatizimit, qiradhënies: 7 gjetje, në vlerën 11,302,426 lekë,

☞ sistemi i kreditimit, subvencioneve: 2 gjetje,

☞ sisteme të tjera: 2 gjetje,

Total - 252 gjetje

Për 252 gjetje janë dhënë 261 rekomandime.

Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2022 nga MBZHR për auditimet e kryera në këtë periudhë është planifikuar të bëhet gjatë vitit 2023.

Për periudhën objekt auditimi 01.04.2021 deri me 31.12.2022 nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në MFE nuk është kryer vlerësim i jashtëm i cilësisë së DAB-së në MBZHR, jo në përputhje me Manualin e “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të ministrit të Financave.

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB.

Grupi auditimit duke pasur në fokus gjetjet me dëm ekonomik të konstatuara në subjektet e audituara në vitin 2021 dhe 2022, zgjodhi të auditojë dosjet të cilat janë vlerësuar nga DAB me nivel të lartë risku siç janë:

-dosja e auditimit të kryer në Qendra Transferimit të Teknologjisë Bujqësore Lushnje(QTTB)

-dosja e auditimit të kryer në Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnje (AREB)

-dosja e auditimit të kryer në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)

-dosja e auditimit të kryer në Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, (AREB) Tiranë, Korçë, Shkodër, Lushnjë.

-dosja e auditimit mbi “Zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021”.

1.Dosja e auditimit të subjektit QTTB Lushnje, me objekt “auditim të kombinuar: përputhshmërie, financiar dhe performance, të radhës për periudhën 1.11.2020-31.10.2021”:

☞ mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, megjithëse në fletën e inventarit të dosjes përshkruhet se “nuk ka”, ndërkohë që në dosje duhet të ishte plotësuar Dokumenti përkatës nga MBZHR duke shprehur qëndrimin e QTTB Lushnje.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është vlerësimi i sistemeve:

☞kontrolli i brendshëm: kontrolli i buxhetit, menaxhimi i riskut, i shpenzimeve në kuadër të financimit për përmirësimin e elementeve teknologjike për të siguruar rritje prodhimi dhe ulje të kostos, fuqizimin e kapaciteteve prodhuese të bimëve arvore, të agrumeve, ullishteve, vreshtarisë etj.

☒ menaxhimi financiar: sistemi i kontabilitetit, i pagesave, të ardhurave, i prokurimeve.

☒ menaxhimi i burimeve njerëzore: struktura/organika e miratuar, administrimi i dosjeve personale, regjistri themeltar i punonjësve, hartimi/realizimi i objektivave, vlerësimi i performancës së punonjësve, mbajtja, përpunimi dhe shfrytëzimi i dokumentacionit në arkivë.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga DAB të vlerësuar me risk të lartë sipas sistemeve për:

I. Menaxhimi i burimeve njerëzore, është konsideruar gjetja: “Si shkak i vonesave në procedurat e emërimit të punonjësve në vendet vakante ka ndikime negative në rritjen e ngarkesës së stafit aktual dhe njëkohësisht realizimin e objektivave”.

Rekomandimi i lënë:

“Në bashkëpunim me MBZHR, të ndjekë me përparësi plotësimin në kohë të vendeve vakante në strukturë dhe organikë, me qëllim realizimin e objektivave dhe treguesit e vendosur në fillim të vitit”.

II. Menaxhimi financiar për hartimin dhe realizimin e objektivave, mbajtjen e kontabilitetit është konsideruar gjetja: “Vazhdojnë ende të pazgjidhura gjetjet nga auditimi i mëparshëm, të vlerësuara si në proces zbatimi që kanë të bëjnë me regjistrimin në kontabilitet të aktiveve afatgjata dhe detyrimet kreditore, konkretisht: Llogaria 212 “Ndërtesa e rikonstruksione” nuk përfshin objektet ndërtimore ku ushtron aktivitetin Drejtoria e AREB Lushnjë në vlerë gjithsej 20 661 990 lekë”.

Rekomandimi i lënë:

“Të bashkëpunohet me AREB Lushnjë dhe MBZHR për të saktësuar statusin juridik të objekteve ndërtimore që janë në administrim të QTTB-së dhe në përdorim të AREB me vlerë 20.661.990 lekë për të bërë pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare të dy institucioneve”.

Nga auditimi mbi zbatim e rekomandimeve për hapat e ndjekur nga QTTB Lushnje dhe MBZHR konstatohet se rekomandimet nuk janë zbatuar.

2. Dosja e auditimit të subjektit AREB Lushnje me objekt: ”auditim i kombinuar 23.3.2022 deri 8.4.2022, për periudhën 1.12.2020-30.3.2022, për probleme të veçanta periudha të mëparshme”:

☒ mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, dosja nuk është inventarizuar pasi është në proces (auditimi ka përfunduar në Prill 2022).

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është vlerësimi i sistemeve:

☒ kontrolli i brendshëm për menaxhimin e riskut; zbatimin e ligjshmërisë të treguesve buxhetorë, administrimin e fondeve publike për paga e sigurime shoqërore, investime, blerje e shërbime; kryerjen e prokurimeve; administrimin e aseteve, etj.

☒ menaxhimi financiar për hartimin dhe realizimin e objektivave, mbajtjen e kontabilitetit.

☒ menaxhimi i burimeve njerëzore për respektimin e strukturës organike të miratuar; administrimin e dosjeve personale, regjistrin themeltar të punonjësve; vlerësimin e performancës së punonjësve; mbajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumentacionit në arkivë.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga DAB të vlerësuar me risk të lartë sipas sistemeve për:

I. kontrolli i brendshëm për menaxhimin e riskut; pasqyrimi i gjendjes kontabël për aktivet, debitorët, inventarizimi ekzistencës fizike është konsideruar gjetja: “Nuk ka ndjekje të mëtejshme gjatë vitit 2021 me njoftime të debitorëve dhe hapa të tjera ligjore për arkëtim 1.386.332 lekë të Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” gjendje më datë 31.10.2020 të ndarë:

- 5 kontrata qiraje të tokës bujqësore në vlerë 1.106.007 lek qarku Fier e Gjirokastrë.

-16 ish punonjës të ish-Drejtorisë Bujqësisë Fier për shpenzime telefonike ndaj kompanisë “Albtelekom” në vlerën 226.325 lek “.

Rekomandimi i lënë:

“Të bëhet përlllogaritja e penaliteteve për mos derdhje në kohë të detyrimeve dhe të njoftohen zyrtarisht. Të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i tyre së bashku me detyrimet fillestare 1.386.332 lekë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2021 për 15 kontrata qiramarrje të tokës bujqësore në vlerën 1.106.007 lek në qarkun Vlorë dhe Gjirokastrë dhe për 16 ish punonjës të ish drejtorisë Bujqësisë Fier për shpenzime telefonike ndaj kompanisë “A.” në vlerën 226.325 lekë”.

II. menaxhimin e burimeve njerëzore, është konsideruar gjetja: “Nga 1.12.2020-31.3.2022, nga procesi i emërimeve 13 dhe largimeve 5 janë plotësuar 8 pozicione të shërbimit civil në vitin 2021. Nga 23 pozicione që ishin pa u plotësuar në shërbimin civil, më 31.10.2020 mbeten edhe 13 pozicione të pa plotësuar dhe konkretisht pozicionet e shërbimit civil, pa u plotësuar deri më 31.3.202 janë specialistë në sektorin e ekstensionit Lushnjë, Gjirokastrë, Vlorë”.

Rekomandimi i lënë:

“Në bashkëpunim me MBZHR, të ndiqet në DAP me përparësi plotësimi në kohë i vendeve vakante në strukturë dhe organikë, me qëllim realizimin e objektivave dhe treguesit e vendosur në fillim të vitit”.

III. Problematika/risqe në realizimin e detyrave të SEB Fier Vlorë Gjirokastrë është konsideruar gjetja: “Shërbimi Këshillimor i Ekstensionit në SEB Vlorë, Fier, Gjirokastrë përballet me risqe si të brendshme dhe të jashtme dhe që duhen eliminuar me qëllim arritjen e objektivave. Ato kërkojnë bashkëpunim të strukturave MBZHR, dhe mbështetje burime financiare dhe njerëzore, paraqiten Risqe të jashtme-Mungesa e infrastrukturës së ambienteve të dedikuara për aplikimet e fermerëve për skemën mbështetëse të naftës, ka sjellë vështirësi në menaxhimin e aplikantëve për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë”.

Rekomandimi i lënë:

“Të krijohen sportele për aplikimin e fermerëve duke marrë ambiente me qira dhe pajisje me qëllim përmirësimin e procesit duke e bërë me të aksesueshëm aplikimin dhe lehtësimin e punës nga ana e punonjësve të AREB”.

Nga auditimi mbi zbatim e tyre konstatohet se, rekomandimi për hapat e ndjekur nga AREB Lushnje dhe MBZHR në lidhje me krijimin e sportele për aplikimin e fermerëve është zbatuar, ndërsa rekomandimet e tjera kanë status të pa zbatuar:

3. Dosja e auditimit të subjektit ISUV, me objekt “Vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të risqeve të identifikuar dhe kryerjes së veprimtarisë në funksion të arritjes së objektivave të planifikuara, identifikimi i mangësive dhe ndërmarrje e veprimeve korrigjuese”:

☞ mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se për gjetjet e konstatuara në këtë subjekt nga DAB janë lënë disa masa, ku me nivel të lartë risku është konsideruar gjetja e konstatuar në zbatimin e kontratës/marrjen në dorëzim të mallit për tenderin me objekt “Blerje Reagentë”, me procedurë “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me vlerë kontrate 6,444,840 me TVSH, ku rezulton se “Këto kite gjenden në laborator. Kitet e sjella në ISUV nga paraqitja e jashtme, shpjegimet në kutinë mbështjellëse rezultojnë sipas parametrave, ndërsa në momentin e përdorimit rezultuan se nuk plotësonin specifikimet teknike për të cilat janë blerë”.

Rekomandimi i lënë:

“Drejtori i Institucionit (ISUV) të nxjerrë përgjegjësinë për mospërdorimin e kiteve gjendje në magazinë, të marrë masa për kthimin e tyre në një afat kohor një mujor nga marrja e raportit të auditimit, Operatorit Ekonomik fitues “G.”, pasi ky operator ka lidhur kontratën për furnizim edhe për vitin 2022. Në rastin e moskthimit të kiteve mall në ruajtje në magazinën e ISUV-së të shpallet debitor për shumën 2.074.800 lekë”.

Nga auditimi mbi zbatim e këtij rekomandimi për hapat e ndjekur nga ISUV dhe MBZHR:

☞ Me shkresën Nr.437, datë 16.05.2022 ISUV, në zbatim të rekomandimit të lënë nga DAB-i i është kërkuar subjektit “G.” të kthejë kitet gjendje në magazinë (mall në ruajtje) pasi nuk përmbushin specifikimet teknike, në rast mos kthimi shpalljen debitor të këtij subjekti në vlerën 2.074.800 lekë.

☞ Me Urdhrin Nr. 237, datë 24.05.2022 të Ministrit është liruar nga detyra z. A. R.Drejtor i Përgjithshëm i ISUV, pasi nuk ka marrë masa për përmirësimin e gjendjes.

☞ Subjekti “G.” me shkresën Nr. 437/1, datë 07.06.2022 prot.në ISUV, kthen përgjigje shkresës Nr.437, datë 16.05.2022 të ISUV duke bërë të ditur që “furnizimi me kite është marrë në dorëzim nga laboratorit... Fakti që janë gjendje në magazinë është përgjegjësia e stafit tuaj që nuk i ka përdorur apo reklamuar në kohë...”.

☞ Me shkresën Nr.437/2, datë 13.06.2022 ISUV, i kthen përgjigje subjektit “G.” duke i bërë të qartë për çdo kit mos plotësimin e specifikimeve teknike.

☞ Subjekti “G.” me shkresën Nr. 546, datë 21.06.2022 prot.në ISUV, kthen përgjigje duke këmbëngulur dhe përsëritur edhe njëherë që, furnizimi me kite është marrë në dorëzim nga laboratorit i ISUV-it.

☞ Me shkresën Nr. 5632 prot., datë 03.11.2022 DAB/MBZHR në zbatim të Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, i drejtohet Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), për të raportuar mbi statusin aktual të rekomandimeve të lëna brenda 5 ditëve.

Me shkresën Nr. 5632/1 prot., datë 14.11.2022 (protokoll MBZHR) është kthyer përgjigje nga ISUV mbi nivelin dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve ku, në lidhje me detyrimin për arkëtimin e vlerës 2.074.800 lekë nga subjekti “G.” bëhet me dije se statusi i rekomandimit është në “proces”.

☞ Në Buletinin Nr.4 datë 16.01.2023 të APP, njoftohet se operatori “G.” përjashtohet nga pjesëmarrja në tenderime 12 muaj duke filluar nga data 11.01.2023 deri në datë 11.01.2024.

4.Dosja e auditimit për subjektet/Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB)Tiranë, Korçë, Shkodër, Lushnjë me objekt “Zbatimi i procedurave dhe administrimi i fondit për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë për vitin 2021”:

☞ mungon Dokumenti Standard “Takimi ballafaques/përmbyllës”, jo në përputhje me Manualin e auditimit, Kap. VI, pika 8, megjithëse në fletën e inventarit të dosjes jepet sqarimi për takimin përmbyllës se “nuk kanë kërkuar AREB dhe MBZHR”, ndërkohë që në dosje duhet të ishte plotësuar Dokumenti përkatës nga MBZHR duke shprehur qëndrimin e AREB.

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se sistemet e audituara nga DAB/MBZHR janë:

☞ Zbatimi i ligjshmërisë në aplikimin on-line për përfitimin në skemat e naftës nga fermerët për bujqësinë për vitin 2021.

☞ Programimi dhe zbatimi i buxhetit për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, viti 2021.

☞ Sistemi i Pagesave për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, viti 2021.

Disa nga gjetjet e konstatuara nga DAB të vlerësuar me risk të lartë sipas sistemeve:

I.në sistemin e pagesave për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, vitin 2021, për subjektet AREB Shkodër, Tiranë, Lushnjë, Korçë dhe MBZHR është konsideruar gjetja: “Gjendje në magazina 102 239.68 litra naftë, me vlerë 16 846 021 lekë, e pa likuiduara e cila duhet t’i kthehet subjektit “K.” dhe “K. SHA”.

Rekomandimi i lënë:

“Të shkarkohet nga magazina 102 239.68 litra naftë gjendje, me vlerë 16.846.021 lekë e pa likuiduar, me dokumentacion subjektit kontraktues “K.” dhe “K.SHA”.

II. në aplikimin on-line për përfitimin në skemat e naftës nga fermerët është konsideruar gjetja:

“.. konfirmuar gjithsej 61 subjekte përfituese të gjetura me shkelje nga AZHBR...Nuk ka urdhër Ministri për shpalljen debitorë në kontabilitet, dhe kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës 3 092.96 litra naftë, të përfituar padrejtësisht nga 4 subjektet (A.L.F. A.C., BOVA F.D., A.& O. B. A., E.T.).

Rekomandimi i lënë:

“1. Të vijohet ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të penaliteteve për përjashtimin për 3 vjet të 57 subjekteve nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

2.Të nxirret urdhër Ministri nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar në MBZHR për shpalljen debitorë në kontabilitet, dhe kthimin në buxhetin e shtetit të vlerës 3 092.96 litra naftë, të përfituar padrejtësisht nga 4 subjektet (A.L.F. A. C., BOVA F. D., A. & O. B.A., E. Th.)”.

III. në zbatimin e kontratës “Sistemi për shpërndarjen dhe monitorimin e karburantit për fermerët” është konsideruar gjetja:

“Në dorëzimin e pajisjeve fizike dhe të shërbimeve mungon:

-Dokumentacioni financiar (f.h. dhe f.d) për pajisjet fizike që janë në ambientet e AKSHI-t dhe të dorëzuara AZHBR-së.Testimet e kryera dhe dokumentimi i tyre nuk janë bashkëlidhur urdhër shpenzimit.

-Transferimi i aktiveve në AKSH dhe AZHBR

Nuk është përgatitur dokumentacioni financiar për transferimin e pajisjeve me vlerë 26.160.000 lekë në Institucionet e AKSH-it dhe AZHBR. Fletë hyrja e MBZHR është hartuar për të gjitha pajisjet fizike edhe pse ato nuk janë në ambientet e MBZHR. Transferimi është në proces për dërgim”.

Rekomandimi i lënë:

“MBZHR të hartojë dokumentacionin financiar për transferimin e pajisjeve me vlerë 26.160.000 lekë në Institucionet e AKSH-it dhe AZHBR, referuar Ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM Nr.206, datë 8.5.1995 “Për një shtesë të VKM nr.153, datë 3.4.1993 “Për kalimin kapital të objekteve dhe mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(AKSH-it gjithsej 25.680.000 lekë: Server 3 me vlerë 1.920.000 lekë = 5.760.000 lekë, Pajisje për Backup 1x9.600.000 = 9.600.000, storage 1x8.400.000 lekë=8.400.000 lekë, dhe AZHBR-së, tablet tipi I 50 x 48.000 = 2.400.000 lekë).

Nga auditimi mbi zbatim e këtyre rekomandimeve për hapat e ndjekur nga AREB Shkodër, Tiranë, Lushnjë, Korçë dhe MBZHR:

☞ Me shkresën Nr. 5632 prot., datë 03.11.2022 DAB/MBZHR në zbatim të Ligjit Nr. 114/2015 (ndryshuar), i drejtohet AREB Shkodër, Tiranë, Lushnjë, Korçë dhe MBZHR për të raportuar mbi statusin aktual të rekomandimeve të lëna brenda 5 ditëve, të cilët me shkresë përcjellëse kanë dërguar statusin për rekomandimet e lëna.

☞Në lidhje me Rekomandimin I/1, me shkresën Nr.6705, datë 30.12.2022 nga MBZHR është dërguar subjektit “K.” dhe “K. SHA” akt rakordimi i naftës për fermerët për vitin 2021 për 102,239.46 litra naftë, si dhe janë bashkëlidhur Fletë Daljet për vlerën 12,846,006 lekë. Statusi i rekomandimit në proces

☞ Në lidhje me Rekomandimin II/1, është nxjerrë Urdhër i ministrit Nr.391, datë 12.09.2022 për shpalljen debitor të 4 subjekteve (A.L.F. A. C., BOVA F. D., A. & O. B. A., E. Th.).Statusi i rekomandimit në proces.

☞ Në lidhje me Rekomandimin III/1, kanë dalë Urdhrat e ministrit Nr.323, datë 08.07.2022 dhe 324, datë 08.07.2022 “Për transferim kapital asetesh” pa pagesë nga MBZHR tek AKSHI dhe AZHBR. Në zbatim të këtyre urdhërave kanë dalë dhe Urdhrat Nr. 369, datë 04.08.2022 dhe Nr. 381, datë 25.08.2022 për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim dhe dorëzimin e investimit. Gjithashtu me shkresën Nr. 352/7, datë 25.01.2023 drejtuar AKSHI-t

dhe për dijeni dy subjekteve të varësisë, Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës si dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural mbi njoftim dhe kërkesë mbi dy kontratat e mirëmbajtjes dhe amendimit të tyre. Statusi i rekomandimit në proces.

5. Dosja e auditimit mbi “zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021”.

Nga DAB është kryer auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve për vitin 2021, auditim i kryer me kërkesë të titullarit dhe shtuar si auditim në planin e vitit 2021.

Referuar Raportit të Auditimit rezulton se:

Niveli i zbatimit të rekomandimeve, për periudhën 2021 paraqitet si më poshtë:

Periudha	Të rekomanduara	Të pranuar	Të zbatuara	Të pazbatuara	Në proces
2020	93	93	52	12	29
2021	227	227	137	21	69

Burimi: Drejtoria e Auditit MBZHR/përpunuar të dhënat nga KLSH

Nga të dhënat e tabelës, auditimi për zbatimin e rekomandimeve është kryer për auditimet e realizuara në vitin 2021 gjithsej për 14 subjekte, për të cilat janë rekomanduar 227 masa, si dhe për 6 auditime të kryera gjatë vitit 2020, për të cilat janë rekomanduar 93 masa.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë së auditimit.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në dosjet e auditimit të kryer nga DAB, gjatë punës në terren deri në përfundimin e raportimit tek titullari i subjektit të audituar dhe Ministri janë në përputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është realizuar nga përgjegjësi i grupit të auditimit dhe nga Drejtori i DAB pas përfundimit të punës në terren, pas raportimit tek titullari i subjektit të audituar dhe Ministri, për realizimin e angazhimit të auditimit të brendshëm në subjektin përkatës.

Kontrolli i cilësisë është kryer, duke evidentuar dhe sqaruar gjetjet dhe rekomandimet mbas përgatitjes së raportit përfundimtar të auditimit. Procedura e vlerësimit të cilësisë, mbulon aspekte të veprimitarisë së DAB, duke përfshirë objektivin, vlerësimin e riskut, planifikimin, zbatimin e angazhimeve, raportimin, trajnimin, etj.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi auditin e brendshëm u konstatua:

☞ Për periudhën nga Gushti 2022 deri 31.12.2022, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në pozicionin-Drejtor, rezulton vend i lirë/vakant.

☞ Në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) organ varësie i MBZHR-së struktura e auditit të brendshëm megjithëse është ngritur nuk funksion, pasi nuk është plotësuar me staf.

☞ Në Raportin vjetor për vitin 2021, në të dhënat e raportuara dhe dërguara në MFE mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik, komfort Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, neni 24, germa “d”, ka paqartësi të cilat megjithëse nuk janë të përhapura dhe nuk kanë sjellë ndikim në rezultatin final, mund të përhapen në të ardhmen.

2.8. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Mbi auditimin e ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bazë të programit të auditimit Nr.1175/1, datë 11.01.2023, i mbajtur në datë 08.05.2023 për periudhën nga 01.04.2021-31.12.2022.

Në zbatim të programit të auditimit me *nr. 1175/1, i ndryshuar, datë 11.01.2023*, sipas drejtimit 8. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna, në ambientet e institucionit Ministria Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm dhe u

mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së, Znj. E.Ll. (përgj/grupit), dhe Z. S. K., anëtarë, të cilët janë të autorizuar për trajtimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Verifikimi mbi zbatimin e rekomandimeve iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 shkronja “j” dhe neni 30, pika 2.

-Manuali i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional” miratuar me Vendimin Nr.67, datë 23.06.2020 të **Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Objekti i këtij akt verifikimi është:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 528/7 Prot, datë 04.02.2022 me lëndë “Mbi Raportin përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin me objekt “Auditim përputhshmërie dhe financiar” ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” si dhe Plani me afatet për zbatimin e rekomandimeve, për veprimtarinë nga data **01.01.2019 deri më datën 31.03.2021**, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

I- Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të neni 15, shkronja “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Nga auditimi u konstatua se, MBZHR ka miratuar nga Titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit duke e dërguar në KLSH me shkresën nr. 843/2 Prot, date 28.02.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, shkronja j.

II- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të neni 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se MBZHR ka raportuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr 843/28, datë 30.09.2022, jashtë afateve kohore në respektim të afatit prej 6 muajsh në zbatim të neni 30, pika 2.

Në këtë auditim me shkresën e sipërcituar, KLSH ka rekomanduar

- 1 masë për” Propozime për ndryshime ligjore”
- 15 “Masa Organizative” për zbatim;
- 3 masa për shpërblim dëmi;
- 2 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në mënyrë të përmbledhur statusi i pranimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Propozime për ndryshime ligjore	1	1	0
2	Masa Organizative	15	15	0
3	Masa për shpërblim dëmi	3	3	0

4	Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.	2	2	0
---	--	---	---	---

Nr.	Lloji i rekomandimit	pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Propozime për ndryshime ligjore	1	1	0	0	0
2	Masa Organizative	15	2	2	6	5
3	Masa për shpërblim dëmi	3	0			3
4	Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike	2	2			0

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	21	100
2	Pa pranuar	0	0
3	Pranuar	21	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	- Zbatuar	5	23,8
2	- Zbatuar pjesërisht	2	9,5
3	- Në proces	6	28,57
	- Pa zbatuar	8	38,09

Më hollësisht, ndjekja dhe zbatimi i tyre paraqitet si më poshtë

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Gjetje nga auditimi: Në kontratën nr.2548 prot., me nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015 lidhur midis subjektit “A. M.” dhe ish-Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave sot (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), me objekt për ngritjen e kompleksit blegtoral dhe ndërtimin e fabrikës së përpunimit të qumështit në tokë bujqësore, duke parashikuar **veprimtari blegtorale** si dhe në kontratën nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017 lidhur midis subjektit “P.” dhe MBZHR, me objekt për

dhënien e tokës bujqësore me qira, për kultivimin e bimëve foragjerë për sigurimin dhe **plotësimin e nevojave për ushqim të blegtorisë dhe krijimin e një ferme blegtorale** për mbarështimin e gjedhit për mish. Për kontratat e mësipërme janë parashikuar veprimtari blegtorale, ndonëse në aktin nënligjor të aplikuar të kohës, të VKM nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, nuk parashikon veprimtari blegtorale, në referim të kreu VI “Afatet e dhënies me qira të tokave” pika 1, shprehet se, tokat jepen me qira për veprimtari bujqësore.

Ky fakt juridik është në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore” i ndryshuar, neni 8, mbi të cilin është miratuar VKM nr.460, datë 22.5.2013, i ndryshuar me VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, të cilat në përmbajtjen e tyre kreu IV, pika 8, nën-pika (b, d, dh) dhe kreu VI pika1, nuk janë shprehur për veprimtari për prodhim blegtoral.

Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore” i ndryshuar, neni 8, shprehet se:

- (1). deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore.
- (2). deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtoral**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cungishte).
- (3). deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-67 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si ministri përgjegjëse të marrë masa në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e VKM nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore” i ndryshuar, me qëllim për caktimin e drejtë dhe të saktë, të objekteve të kontratave të qiradhënies së tokës bujqësore, duke garantuar zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në të gjitha dimensionet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Lidhur me këtë rekomandim, MBZHR paraqiti se nëpërmjet Vendimit nr. 487, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, në pikën 6, 6.1, shkronja “v”, parashikohet “Veprimtari për prodhimin blegtoral”. Pra janë kryer përmirësimet ligjore sipas Vendimit nr. 487, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave.

Statusi i rekomandimit: *Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, **Llog. 210** “Toka Troje, Teren” paraqitet në kontabilitet në vlerën 0 lekë. VKM nr. 995, datë 9.12.2015,” VKM nr.45, datë 29.01.2014 si dhe VKM nr.142, datë 24.2.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së

Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është 19,033.95 Ha. Për periudhën objekt auditimi është dhënë me qira sipërfaqja prej 714.35 Ha të cilat nga ana se sektorit të monitorimeve është kryer regjistrimit i tyre në hipotekë. Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar asnjë nga tokat të cilat MBZHR ka në përdorim, apo tokave të cilat MBZHR ka dhënë me qira. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi në llog.210 “Toka, Troje, Terren” duhet të ishte kontabilizuar, pas regjistrimit të tokës bujqësore të dhënë me qira, në hipotekë, i cili bëhet nga vetë punonjësit e sektorit të financës, si dhe duke iu referuar zonës kadastrale dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet vlera e secilës nga tokave të cilat MBZHR ka në përdorim.

-Për periudhën objekt auditimi është kryer regjistrimi i pronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme në inventarin e shtetit sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Është regjistruar pasuria në Zyrën e Kadastrës Shtetërore, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Por nga auditimi u konstatua se sipërfaqet e trojeve në llog nr .210 si dhe vlerat e tyre për periudhën objekt auditimi, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlefën 0 lekë. Sipërfaqja totale e tokës që ka MBZHR në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)”, paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-114 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale “Toka troje terren”, në administrim të institucionit MBZHR. Nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupit i punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të ngrëjë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit. Të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Lidhur me të dy rekomandimet dhe në zbatim të planit të veprimit të MBZHR nga Sektori i Administrimit të Tokës, janë kryer aktivitete lidhur me përditësimin, verifikimin e listës së ngastrave të tokës bujqësore, llogaritjen e kostove financiare për përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor për tokat bujqësore objekt i VKM nr. 45/2014 “Për kalimin në administrim të MBZHRAU të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në

dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave “ për të bërë të mundur regjistrimin e tyre në ASHK. Për të përcaktuar statusin aktual të pronave tokë bujqësore në administrim të MBZHR, për bërë përditësimin e tyre në terren MBZHR ka kërkuar informacion dhe verifikimin në terren të ngastrave tokë bujqësore në administrim të MBZHR nga njësitë e pushtetit vendor, në 43 bashki në vend ku shtrihet toka bujqësore në administrimin të MBZHR. Janë bërë verifikimet nga 42 bashki sipas shkresës së MBZHR, ku ndodhet toka disponibël shtetërore ne administrim të MBZHR. Kanë kthyer përgjigje të gjitha bashkitë, përveç Bashkisë Himarë. Nisur nga problematikat e verifikuara nga grupet e ngritura nga bashkitë në terren, për ngastrat tokë bujqësore në administrim të MBZHR, në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është organizuar në datën 01.04.2022 një takim me drejtorët e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut të 12 qarqeve ku u diskutua për problematikat në vite lidhur me tokat në administrim të MBZHR. Pas takimit të organizuar në ambientet e MBZHR, lidhur me evidentimin dhe përditësimin e listës së ngastrave "tokë bujqësore disponibël shtetërore", objekt i VKM nr. 45/2014, është miratuar Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 175, datë 15.04.2022 “*Për ngritjen e Grupit të Punës për përditësimin e të dhënave të fondit të tokës bujqësore, të kaluar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*”. Referuar informacioneve të ardhura nga grupet e punës në qarqe dhe bashkitë mbi fondin e tokës disponibël shtetërore, pas hedhjes se informacionit nga të dhënat paraprake rezulton se janë përafërsisht 6345 parcela për tu regjistruar për të cilat duhet përgatiten dhe plan vendosjet e tyre sipas sistemit të regjistrimit. Fillimisht janë përcaktuar paraprakisht kostot e regjistrimit dhe kostot për përgatitjen e plan vendosjeve sipas sistemit të regjistrimit, duke mos parashikuar kostot për marrjen e statusit juridik tek ASHK. Duke iu referuar rekomandimeve të KLSH, për bashkërendim me ASHK pas llogaritjeve paraprake të kostos për regjistrimin e ngastrave tokë bujqësore kaluar në administrim të MBZHR me VKM nr 45/2014, pa llogaritur kostot për marrjen e statusit juridik të ngastrave tokë bujqësore nga ASHK, MBZHR i është drejtuar ASHK-së për informacion si dhe bashkëpunim dhe bashkërendim me shkresën nr 843/30, date 13.10.2022 (shkresa bashkëlidhur). Kërkesa referohej tek të dhënat e sistemit të regjistrimit fillestar i cili ka përfunduar në 2787 zona kadastrale nga 3057 zona kadastrale që ka gjithsej vendi, nisur nga fakti që në zonat kadastrale ku është kryer regjistrimi fillestar cdo pasuri ka kartelën e pasurisë dhe HTR. Në shkresën drejtuar ASHK referuar dhe rekomandimit të KLSH për bashkëpunim është cituar nëse është e nevojshme përgatitja e plan rievimeve për ngastrat tokë bujqësore objekt regjistrimi ne zonat ku ka përfunduar regjistrimi fillestar. Ndërkohë nga ASHK janë marrë hapa ligjorë për përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme shtetërore në administrim të institucioneve qendrore dhe bashkive. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në datën 27.01.2023, është miratuar projektvendimi “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, i cili hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare. Me ngritjen e “Strukturës së posaçme”, e cila do të ketë në përbërje dhe një inxhinier topograf, do ribëhen përditësimet, verifikimet në terren të tokave bujqësore në administrim të MBZHR si dhe regjistrimi i tyre. Sa më sipër është ngritur Struktura e posaçme me Urdhrin Nr. 152, datë 20.3.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHR, me përbërje: A. Sh., Kryetare, E.K., Anëtar, M. K., Anëtar, L. K., Anëtar dhe E. Q., Anëtar, të cilët do të realizojnë inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie për çdo pasuri në inventarin apo në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kjo referuar Vendimit Nr. 28, datë 27.1.2023, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër këto rekomandime konsiderohen të **pranuara dhe në proces**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Llog.486 “Shpenzime te periudhave të ardhshme” për vitin 2019 & 2020 është 0 lekë. Për vitin 2019 sektori i financës ka likuiduar ish-punonjësit bazuar në vendimet gjyqësore në vlerën 23,180 mijë lekë dhe për vitin 2020 janë likuiduar në vlerën 13,170 mijë lekë. Ky detyrim edhe pse i njohur prej sektorit të financës, nuk kontabilizohet por planifikohet vetëm në PBA, duke mos pasqyruar kështu në mënyre të saktë dhe të drejt llogarisë përkatëse në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- Llog.423 “Personeli, paradhënie, deficite gjoba” paraqitet në bilanc në vlerën 0 lekë, nga ku u konstatua se nuk janë kontabilizuar gjordat/kamatë vonesat të cilat janë vënë përfituesve të tokave prej mos likuidimit të qirasë fikse mujore në afatin e përcaktuar të cilën kanë detyrim ligjor ta paguajnë çdo muaj sipas kontratës së lidhur midis MBZHR dhe përfituesit. Gjenezat e disa prej këtyre gjordave është që prej vitit 2013.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 44-48 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të marrë masa ku për të gjitha vendimet gjyqësore, të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore zërin e detyrimeve të prapambetur “për vendimet gjyqësore ku konkretisht të debitoje llogarinë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” si dhe të Kreditohet llogaria përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Titullari i Institucionit të marrë të ngrejë një grup pune për saktësimin dhe vërtetimin e të gjithë kamatëvonesave/gjorbave të cilat kanë ardhur si rezultat i mos likuidimeve apo gjorbave të marra nga mosrespektimi i kontratës dypalëshe të lidhur. Pas saktësimit të vlerës, nga sektori i financës të marren masa ku të kryhet kontabilizimi ku konkretisht, të debitohet llog.423 “Personeli, paradhënie, deficite gjoba” si dhe të kreditohet llog. 4341 “Operacione me shtetin” (Detyrime).

Në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Lidhur me kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga ekzekutimi i Vendimeve Gjyqësore, nga MBZHR janë kontabilizuar një pjesë e tyre përkatësisht në llogaritë 486 dhe 467. Ndërsa lidhur me saktësimin dhe vërtetimin e të gjithë kamatëvonesave/gjorbave të cilat kanë ardhur si rezultat i mos likuidimeve apo gjorbave të marra nga mosrespektimi i kontratës dypalëshe për administrimin dhe monitorimin e tokave bujqësore është hartuar urdhri për shpalljen e debitorëve me qëllim kontabilizimin e tyre në llogarinë debitohet llog.423 “Personeli, paradhënie, deficite gjoba” si dhe të kreditohet llog. 4341 “Operacione me shtetin” (Detyrime), për vitin 2023. Janë njoftuar subjektet lidhur me detyrimet ndaj institucionit me shkresat përkatëse (kopje bashkëlidhur).

Statusi i rekomandimit: Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre, si në vendosjen e përgjigjeve respektive “po” ose “jo”, ashtu edhe në zërthimin me analizë të llogarive përkatëse, në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 114-144 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky

seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Sa i përket rekomandimit, nga sektori i financës është reflektuar në përgatitjen e pasqyrave vjetore 2021 dhe në vijim dhe ato të vitit 2022, plotësimi i rubrikës së shënimeve shpjeguese, në zbatim të UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Statusi i rekomandimit: *Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.*

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në MBZHR për periudhën 01.01.2019 deri më 30.03.2021, u konstatua se, aparati i Ministrisë së Bujqësisë ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të:

(1) Urdhrit të Kryeministrit nr.109, datë 31.07.2018 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.168 datë 05.10.2017 të kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR” me numër total të strukturës plan 163 punonjës, ndërsa fakti në fillim të vitit 2019 rezultoi me 136 punonjës, me diferencë prej 27 vende vakante, nga të cilat 16 vende për nëpunës civil dhe 11 vende me kod pune. Deri në fund të vitit 2020 në dhjetor, numri i vakancave ka pësuar ulje në 17 vende vakante nga të cilat 9 vende për nëpunës civil dhe 8 vende me kod pune. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.109, datë 31.07.2018, Ministri i MBZHR, ka miratuar urdhrin me nr.324/1 datë 25.09.2018 “Për miratimin rregullores së strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

(2) Urdhrit të Kryeministrit nr.150, datë 05.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR” numri total i strukturës plan u bë 174 punonjës. Ky ndryshim në strukturë është kërkuar nga Ministri i MBZHR në bazë të Relacionit me shkresë nr. 7892/1, datë 06.10.2020.

(3) Urdhrit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.150 të kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR”, ku nuk ka ndryshim të numrit total të strukturës plan 174 punonjës, por ka vetëm ndryshime në emërtimin e disa sektorëve.

Gjithashtu, sipas Urdhrit nr.39 të Ministrit të MBZHR-së, datë 22.01.2021, në zbatim të urdhrin nr. 150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MBZHR” është miratuar struktura plan e MBZHR-së, me numër total plan 174 punonjës në aparatit të MBZHR-së, ndër kohë që struktura fakt deri në Mars të vitit 2021 ka qenë 142 punonjës, duke rezultuar 32 vende vakante, nga të cilat 26 vende për nëpunësit civil dhe 6 vende me Kod Pune.

Kjo është edhe struktura plan që ka Aparati i MBZHR-së deri më datën 31.03.2021.

Nga sa më sipër, ndonëse kemi rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit të MBZHR, kemi vakanca gati prej 20% të pozicioneve të vendeve të punës, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri.

Vlen të përmendet që nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore të MBZHR-së janë bërë shpallje për plotësimin e vakancave si në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) për të kaluar më pas në sistemin online të rekrutimit, në platformën administrata.al. Por gjithashtu vlen të theksohet se nuk është gjetur një bashkëpunim institucional me Departamentin e Administratës Publike dhe mekanizmat e nevojshëm për zgjidhjen e këtij problemi.

Pra është përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të aparatit të MBZHR-së për gjetjen e mekanizmave të nevojshëm për rekrutimin dhe plotësimin e këtyre vakancave. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 34-53 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: MBZHR të mbajë një korrespondencë të vazhdueshme dhe më të shpeshtë me Departamentin e Administratës Publike si dhe të gjenden mekanizmat e nevojshme me qëllim që të kryhet rekrutimi i personelit dhe si rrjedhojë minimizimi i vakancave për të arritur një kapacitet sa më të plotë në personelin e Aparatit të MBZHR-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga MBZHR, rezultoi se: Në zbatim të nenit 18, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me shkresën nr. 10643/1, datë 18.12.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, është dërguar në Departamentin e Administratës Publike plani i rekrutimeve për vitin 2021 për institucionet në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pasi aparati i MBZHR-së ishte në proces ristrukturimi (i cili përfundoi në 22 janar 2021).

Gjithashtu, me shkresën Nr. 1456, datë 11.2.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm janë dërguar në Departamentin e Administratës Publike pozicionet të cilat do të shpallehin për kandidatë nga jashtë shërbimit civil. Në përfundim të procesit të ristrukturimit, referuar strukturës aktuale të MBZHR-së, në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, është vijuar procedura për publikimin e pozicioneve vakant në Regjistrin Qendror të Personelit (HRMIS) dhe në Platformën “Administrata.al”.

Për periudhën 22 janar 2021 (hyrja në fuqi e strukturës së re të MBZHR-së) deri në 31.03.2022 kanë qenë vakant pozicionet si më poshtë:

1. Këshilltar i Ministrit (staf politik) për periudhën janar, shkurt, mars 2021;
2. Këshilltar i Ministrit (staf politik) për periudhën janar, shkurt 2021;
3. Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (staf politik) për periudhën janar, shkurt, mars 2021;
4. Sekretar i Zëvendësministrit (staf politik) për periudhën shkurt, mars 2021;
5. Përfaqësues për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, në Sekretariatit e Përfaqësisë në Bruksel (Kod pune) për periudhën janar, shkurt, mars 2021;
6. Përfaqësues për Sigurinë Ushqimore, Veterinarinë dhe Fitosanitetin, në Sekretariatit e Përfaqësisë në Bruksel (Kod pune) për periudhën janar, shkurt, mars 2021;
7. Përfaqësues për Peshkimin, në Sekretariatit e Përfaqësisë në Bruksel (Kod pune) për periudhën janar, shkurt, mars 2021;

Vendet vakant pjesë e shërbimit civil

Pozicione Specialist

1. Specialist në Sektorin e Politikave të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Skemave të Cilësisë, për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);
2. Specialist në Sektorin e Prodhimit Organik dhe Standardeve të Tregtimit të Produkteve Bujqësore dhe Blegtorale, për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);
3. Specialist në Sektorin e Këshillimit dhe Informacionit Bujqësor, për periudhën 22.1.2021 – 3 shkurt 2021, datë në të cilën ka filluar z. B.M., student i ekselencës (në zbatim të VKM Nr. 586, datë 30.8.2019);
4. Specialist në Sektorin e Statistikave dhe Analizave Ekonomike për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Përfunduar procedura e rekrutimit (kodi 3546), emëruar në datë 21.6.2021 znj. J. Q.;
5. Specialist në Sektorin e Shëndetit dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 11.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3541, nuk kishte kandidatë për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil;
6. Specialist në Sektorin e Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-

bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Përfunduar procedura e rekrutimit (kodi 3543), emëruar në datë 8.6.2021 z. M. K.;

7. Specialist në Sektorin e Projekteve të Promovimit dhe Marketingut për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3805, procedura e rekrutimit përfundoi pa fitues për lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë shërbimit civil;

8. Specialist në Sektorin e Projekteve IPA dhe Donatorëve të Tjerë për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 11.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3823, procedura e rekrutimit përfundoi pa fitues për pranim nga jashtë shërbimit civil, ndërsa për lëvizje paralele nuk kishte kandidatë;

9. Specialist në Sektorin e Koordinimit dhe Integritimit për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3799, procedura e rekrutimit përfundoi pa fitues për lëvizje paralele dhe pranim nga jashtë shërbimit civil;

10. Specialist në Sektorin e Koordinimit dhe Integritimit për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3799, procedura e rekrutimit përfundoi me fitues nga jashtë shërbimit civil znj. L. Gj. datë 21.2.2022;

11. Specialist në Sektorin e Koordinimit dhe Integritimit për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3799, procedura e rekrutimit përfundoi me fitues nga jashtë shërbimit civil znj. Y. Y. datë 18.2.2022;

12. Specialist në Sektorin e De rregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3544, procedura e rekrutimit përfundoi pa fitues për pranim nga jashtë shërbimit civil, ndërsa për lëvizje paralele nuk kishte kandidatë;

13. Specialist në Sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 24.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3540, procedura e rekrutimit përfundoi pa fitues për pranim nga jashtë shërbimit civil, ndërsa për lëvizje paralele nuk kishte kandidatë;

14. Specialist në Sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 24.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3540, procedura e rekrutimit përfundoi me fitues nga jashtë shërbimit civil z. A.Z. datë 10.6.2021, për lëvizje paralele nuk kishte kandidatë;

15. Specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 11.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3759, procedura e rekrutimit përfundoi me fitues për lëvizje paralele dhe për pranim nga jashtë shërbimit civil;

16. Specialist në Sektorin e Administrimit të Tokës për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP me Kodin 3542, procedura e rekrutimit përfundoi me fitues nga jashtë shërbimit civil znj. A. Sh. datë 23.6.2021, për lëvizje paralele procedura përfundoi pa fitues;

Pozicione Përgjegjës Sektori

1. Përgjegjës në Sektorin e Statistikave dhe Analizave Ekonomike për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);
2. Përgjegjës në Sektorin e Ushqimit me Origjinë Shtazore dhe Ushqimit për Kafshë për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP në dhjetor 2021 me kodin 3838. Procedura përfundoi në shkurt 2022 (ngitje në detyrë) me emërimin e znj. M. Xh., ndërsa për procedurën e lëvizjes paralele nuk kishte kandidatë;
3. Përgjegjës në Sektorin e Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës. Ky pozicion i është ofruar gjyq fituesit z. R. Q., i cili në zbatim të vendimit Nr. 308, datë 12.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe aktit të emërimit nga DAP Nr. 1382/1, datë 9.3.2021, ka filluar marrëdhëniet financiare më datë 18.3.2021.
4. Përgjegjës në Sektorin e Emergjencave Civile për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 9.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);
5. Përgjegjës në Sektorin e Administrimit të Tokës për periudhën për periudhën 22.1.2021 – 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 11.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);

Pozicione Drejtor Drejtorie

1. Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për periudhën për periudhën 22.1.2021– 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi). Pozicioni është shpallur në DAP në dhjetor 2021 me kodin 3837. Procedura përfundoi pa fitues për lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil;
2. Drejtor në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës për periudhën për periudhën 22.1.2021– 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 15.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);
3. Drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Tokës dhe Ujërave për periudhën për periudhën 22.1.2021– 31.3.2021 (publikuar në Platformën “Administrata.al” në datë 10.2.2021-bashkëlidhur materiali i gjeneruar nga sistemi);

Për periudhën 01.04.2021 deri në 31.12.2022 janë shpallur në DAP pozicionet si më poshtë:

1. Specialist në Sektorin e Prokurimeve, shpallur në DAP me kodin 3785. Procedura përfundoi pa fitues për pranim nga jashtë shërbimit civil, ndërsa për lëvizje paralele nuk kishte kandidatë;
2. Specialist në Sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave, shpallur në DAP me kodin 3540. Procedura për pranim nga shërbimi civil përfundoi me fitues z. A.Z.;
3. Specialist në Sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave, shpallur në DAP me kodin 3540. Procedura për pranim nga shërbimi civil përfundoi pa fitues, ndërsa për lëvizje paralele nuk kishte kandidatë. Me shkresën Nr. 1796, datë 25.3.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm është kërkuar në DAP emërim nga lista fituese për këtë pozicion (bashkëlidhur shkresa).
4. Specialist në Sektorin e Shëndetit dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ, shpallur në DAP me kodin 3541. Procedura përfundoi pa fitues, pasi nuk kishte kandidatë për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil.
5. Specialist në Sektorin e Administrimit të Tokës, shpallur në DAP me kodin 3542. Procedura për pranim nga shërbimi civil përfundoi me fitues znj. A. Sh.;
6. Specialist në Sektorin e Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, shpallur në DAP me kodin 3543. Procedura për pranim nga shërbimi civil përfundoi me fitues z. M.K.;

7. Specialist në Sektorin e De rregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, shpallur në DAP me kodin 3544. Procedura përfundoi pa fitues;
8. Specialist në Sektorin e Statistikave dhe Analizave Ekonomike, shpallur në DAP me kodin 3546. Procedura për pranim nga shërbimi civil përfundoi me fitues znj. J. Q.;
9. Drejtor në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve, shpallur në DAP me kodin 3728. Procedura për lëvizje paralele përfundoi me fitues znj. A.Ç.;
10. Drejtor në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Partneriteteve, shpallur në DAP me kodin 3754. Procedura për ngritje në detyrë përfundoi me fitues z. E. S.;
11. Specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, shpallur në DAP me kodin 3759. Procedura përfundoi pa fitues;
12. Specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, shpallur në DAP me kodin 3759. Procedura përfundoi pa fitues;
13. Specialist në Sektorin e Integritit dhe Koordinimit, shpallur në DAP me kodin 3799. Procedura për pranim në shërbimin civil përfundoi me fitues znj. L.Gj.;
14. Specialist në Sektorin e Integritit dhe Koordinimit, shpallur në DAP me kodin 3799. Procedura për pranim në shërbimin civil përfundoi me fitues znj. Y.Y.;
15. Specialist në Sektorin e Integritit dhe Koordinimit, shpallur në DAP me kodin 3799. Procedura përfundoi pa fitues; Në zbatim të VKM nr. 586, datë 30.8.2019, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, në këtë pozicion është emëruar z. A. Z.;
16. Specialist në Sektorin e Projekteve të Promovimit dhe Marketingut, shpallur në DAP me kodin 3805. Procedura përfundoi pa fitues;
17. Specialist në Sektorin e Projekteve IPA dhe Donatorëve të Tjerë, shpallur në DAP me kodin 3823. Procedura përfundoi pa fitues;
18. Specialist në Drejtorinë e Auditimit, shpallur në DAP me kodin 4040. Procedura përfundoi pa fitues;
19. Drejtor i Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, shpallur në DAP me kodin 3837. Procedura përfundoi pa fitues;
20. Përgjegjës i Sektorit të Ushqimit me Origjinë Shtazore dhe Ushqimit për Kafshë, shpallur në DAP me kodin 3838. Procedura për ngritje në detyrë përfundoi me fitues znj. M. Xh.;
21. Përgjegjës i Sektorit të Statistikave dhe Analizave Ekonomike, shpallur në DAP me kodin 3841. Procedura për kandidatë nga jashtë shërbimit civil përfundoi me fitues znj. M.G.;
22. Specialist në Sektorin e Këshillimit dhe Informacionit Bujqësor, shpallur në DAP me kodin 3877. Procedura përfundoi pa fitues. Në zbatim të VKM nr. 586, datë 30.8.2019, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, për periudhë 3.2.2021-3.2.2022 në këtë pozicion ka qenë z. B.M.;
23. Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme, shpallur në DAP me kodin 3933. Procedura e lëvizjes paralele përfundoi me fitues z. G.H.;
24. Specialist në Sektorin e Prokurimeve, shpallur në DAP me kodin 4039. Procedura e lëvizjes paralele përfundoi me fitues z. M. M.;
25. Specialist në Sektorin e Buxhetit, shpallur në DAP me kodin 4049. Procedura e lëvizjes paralele përfundoi me fitues znj. A. B.;
26. Drejtor i Drejtorisë së Integritit Koordinimit Marrëveshjeve dhe Asistencës Teknike, shpallur në DAP me kodin 4256. Procedura e ngritjes në detyrë përfundoi me fitues znj. M. Sh.;
27. Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpallur në DAP me kodin 4257. Procedura përfundoi pa fitues. Në këtë pozicion me transferim të përkohshëm për periudhën 21.10.2022-10.11.2022 ka qenë z. D.K. Gjithashtu, me shkresën Nr. 1494/3, datë 11.11.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm është kërkuar në DAP që ky pozicion të shpallet nga jashtë shërbimit civil. Është shpallur në DAP me kodin 4419.

28. Drejtorisë i Drejtorisë së Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehrave, shpallur në DAP me kodin 4279. Procedura e ngritjes në detyrë përfundoi me fitues znj. V. B.;
29. Drejtor i Drejtorisë së Politikave Veterinare, shpallur në DAP me kodin 4357. Procedura është në proces;
30. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Inovacionit, shpallur në DAP me kodin 4358. Procedura është në proces;
31. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Tokës, shpallur në DAP me kodin 4281. Procedura e ngritjes në detyrë përfundoi me fitues znj. M. Sh.;
32. Përgjegjës i Sektorit të Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, shpallur në DAP me kodin 4282. Procedura e ngritjes në detyrë përfundoi me fitues znj. A.D.;
33. Specialist në Sektorin e Programimit, shpallur në DAP me kodin 4286. Procedura e lëvizjes paralele përfundoi me fitues znj. S. N.;
34. Specialist në Sektorin e Programimit, shpallur në DAP me kodin 4286. Procedura e pranimit në shërbimin civil përfundoi me fitues znj. O. P.;
35. Specialist në Sektorin e Programimit, shpallur në DAP me kodin 4286. Procedura përfundoi pa fitues;
36. Përgjegjës i Sektorit të Asistencës Teknike, shpallur në DAP me kodin 4304. Procedura përfundoi pa fitues, pasi nuk kishte kandidatë;
37. Specialist në Sektorin e Çështjeve Juridike Administrative, shpallur në DAP me kodin 4305. Procedura është në proces;
38. Specialist në Sektorin e Çështjeve Juridike Administrative, shpallur në DAP me kodin 4305. Procedura është në proces;
39. Specialist në Sektorin e Financës, shpallur në DAP me kodin 4240. Procedura është në proces;
40. Specialist në Sektorin e Prokurimeve, shpallur në DAP me kodin 4348. Procedura e pranimit në shërbimin civil përfundoi me fitues znj. B. M.;
41. Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Inovacionit, shpallur në DAP me kodin 4388. Procedura është në proces;
42. Specialist në Drejtorinë e Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Inovacionit, shpallur në DAP me kodin 4388. Procedura është në proces;
43. Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, shpallur në DAP me kodin 4418. Procedura e lëvizjes paralele përfundoi me fitues z. G. H.;
44. Specialist në Drejtorinë e Auditimit, shpallur në DAP me kodin 4378. Procedura është në proces;
45. Specialist në Drejtorinë e Auditimit, shpallur në DAP me kodin 4378. Procedura është në proces;

Meqenëse portali “Administrata.al”, nga muaji korrik 2022 nuk ka funksionuar për shkak të sulmit kibernetik, janë dërguar në DAP shkresat për shpalljen e pozicioneve vakant si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 5097, datë 6.10.2022, është kërkuar shpallja për 2 (dy) pozicione “Drejtor Drejtorie” (bashkëlidhur shkresa);
- Me shkresën Nr. 2263/4, datë 10.10.2022, është kërkuar shpallja për 1 pozicion “Përgjegjës Sektori” (bashkëlidhur shkresa);
- Me shkresën Nr. 5174, datë 11.10.2022, është kërkuar në DAP shpallja për 3 (tre) pozicione “Specialist” (bashkëlidhur shkresa);
- Me shkresën Nr. 5239, datë 14.10.2022, është kërkuar në DAP shpallja për 1 pozicion “Drejtor Drejtorie”, 2 (dy) pozicione “Përgjegjës Sektori”, 4 (katër) pozicione “Specialist” (bashkëlidhur shkresa);
- Me shkresën Nr. 5902, datë 17.11.2022, është kërkuar në DAP shpallja për 2 (dy) pozicione “Drejtor Drejtorie” (bashkëlidhur shkresa);

- Me shkresën Nr. 6026, datë 23.11.2022, është kërkuar në DAP shpallja për 20 (njëzet) pozicione “Specialist” (bashkëlidhur shkresa).

Për periudhën 28.03.2022 deri më 04.07.2022 MBZHR ka qenë në proces ristrukturimi (bashkëlidhur shkresa Nr. 1830 dhe Nr. 1830/1, datë 28.3.2022, Urdhri i Kryeministrit Nr. 88, datë 20.5.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Urdhri i Ministrit Nr. 318, datë 4.7.2022 “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural).

Gjithashtu, sqarojmë se komunikimi me Departamentin e Administratës Publike ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i shpeshtë dhe i vazhdueshëm edhe në rrugë elektronike për plotësimin e pozicioneve vakant të institucionit, me qëllim përfundimin e procedurave të rekrutimit për njësitë respektive. (Shkresat bashkëlidhur).

Pra konstatohet se MBZHR ka vazhduar ri strukturimin dhe numri i vendeve vakant edhe pse korrespondencat me DAP kanë qenë të vazhdueshme është rritur dhe vazhdon të mbetet i lartë duke sjellë mangësi në plotësimin dhe zbatimin e detyrave funksionale dhe në uljen performancës së MBZHR-së.

Statusi i rekomandimit: *Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.*

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Spektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i dërgon Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim. Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve/Spektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, duke penguar:

-Për çështjet që kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, krijimin e provizioneve nga drejtoria e financës dhe buxhetit për vendimet gjyqësore si ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t’u paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme*”, kapitull III pika 34. Pra Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Spektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i dërgon Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim dhe nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore për kryerjen e një planifikimi të shpenzimeve;

-Për vendime të formës së prerë, buxhetimin e saktë dhe të besueshëm për këtë zë shpenzimesh me qëllim shmangien e detyrimeve të akumuluar, por dhe të pagesave të tarifave përmbartimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve, në përputhje me VKM nr.50, datë 05.02.2014 “*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*” dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit.*”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 34-53 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Spektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në çdo rast të mbajë databazën e ecurisë së proceseve gjyqësore e cila gjithashtu duhet t’i vendoset në dispozicion sektorit të financës për qëllime provigjionimi përgjatë hartimit të pasqyrave financiare.

- MBZHR, gjate vitit buxhetor, nëpërmjet sektorëve përkatës të marrë masa për mbajtjen e data basë-s së vendimeve gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve, shuma totale e të cilëve duhet të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Me shkresën nr. 843/1 prot., datë 18.2.2022 "*Për njohje*" Sek/Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i ka përcjellë Drejtorisë së Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar databazën me të dhënat përkatëse deri në shkurt 2022, për proceset gjyqësore që parashikojnë detyrime monetare, për qëllime provigjionimi përgjatë hartimit të pasqyrave financiare. Për ecurinë e proceseve gjyqësore, kjo drejtori do të informohet në vazhdimësi deri sa vendimet të marrin formë të prerë e përfundimtare.

- Me shkresën nr. 377 prot., datë 18.01.2023 "*Për njohje*" Sek/Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i ka përcjellë Drejtorisë së Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar data bazën me të dhënat përkatëse deri në janar 2023 për proceset gjyqësore që parashikojnë detyrime monetare, për qëllime provigjionimi përgjatë hartimit të pasqyrave financiare. Për ecurinë e proceseve gjyqësore, kjo drejtori do të informohet në vazhdimësi deri sa vendimet të marrin formë të prerë e përfundimtare.

- Me njohjen zyrtarisht të vendimit gjyqësor të formës së prerë, do të informohet kreditori për njohjen e vendimit dhe ndërmarrjen e hapave konkrete nga institucioni me qëllim ekzekutimin e tij, duke shmangur në këtë formë kostot shtesë të shërbimit përmbarrimor. Ndiqet në vijimësi.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe *në proces*.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet e udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në disa raste nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit, dhe mungon dokumentacioni justifikues bashkangjitur pavarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm z. Ardian Maci, të cilit i është deleguar kjo e drejtë në bazë të Urdhrave të Ministrit të MBZHR Urdhri nr.570 datë 16.10.2019, me shkresë nr.7975 prot dhe Urdhri nr.7 datë 07.01.2021.

Kështu në bazë të autorizimeve të Drejtorit të Përgjithshëm është shtuar përbërja e grupit të auditimit duke u shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës zj. Brunilda Kelo e cila ka pozicionin e Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm. Ndërkohë Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkt dhe vihet në lëvizje vetëm me urdhër të Ministrit. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm z. A. M. për të shtuar përbërjen e grupeve të auditimit bie në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit me nr. 1984/1 datë 10.10.2019 dhe me Kreun IV, neni 10, pika 2 e Ligjit nr. 114/2015 për Auditin e Brendshëm "*NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësies publike*" si dhe pagesat janë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit*", i ndryshuar, kreu V, pika 2, dhe Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, Kreu III, pika 36. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-60 të Raportit të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Nëpunësi autorizues/i deleguar i MBZHR në bashkëpunim me sektorin e financës të marrë masa që për çdo udhëtim të verifikohet paraprakisht ligjshmëria përpara dhënies së autorizimit të personave përkatës. Gjithashtu pasi të jepet autorizimi, të bashkëlidhen kërkesat e argumentuara nga personi përgjegjës, ku të citohet data e kërkesës, arsyeja e lëvizjeve të kërkuara si dhe ditët e qëndrimit. Sektori i financës të marrë masa që pas plotësimit të dokumenteve justifikuese të cilat argumentojnë në mënyrë shkresore lëvizjet e punonjësve, të kryhet likuidimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Është hartuar Udhëzuesi për udhëtimet brenda vendit nr. 3458/1, date 24.06.2022, i cili pas miratimit, i është bërë njohur të gjithë punonjësve.

Është hartuar Formulari i Autorizimit i cili ka datën e kërkesës, arsyen e lëvizjes së kërkuar, ditët e qëndrimit, Urdhrin e Ministrit që delegon autorizimin për lëvizje tek DP i DPESHM, dokumentacionin që argumenton lëvizjen dhe i bashkëlidhet Autorizimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *zbatuar*.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2020 nuk janë finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos pasuar më tej me procesin e asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nga ana e komisionit të ngarkuar me kryerjen e inventarizimit fizik si dhe vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit, janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, për të cilat është bërë dhe regjistrimi përkatës por jo përfundimtar pasi rezultoi se, nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit, mbi masat që duhen marrë për aktivet të cilat janë vlerësuar për tu nxjerr jashtë përdorimit. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-60 të Raportit të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Institucioni, të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese si dhe referuar urdhrin të ngritur nga titullari të hartojnë dhe miratojnë procesverbalin për dhënien në përdorim/tjetërsimin/asgjësim të aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti, referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Referuar planit të veprimit miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm, me afat deri 31.12.2022, do të vijohet me;

- proceset e ankandit të materialeve rikupero në magazinë.
- ndjekjen e hapave më tej bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për:
- procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese.
- hartimin dhe miratimin e procesverbalit për dhënien në përdorim/tjetërsimin/ asgjësim të aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit.
- përfundimin e procesit të inventarizimit. Për këtë është përgatitur Udhëzimi ‘Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara’ me nr. 4031/1, datë 29.07.2022.

Pra konstatohet se nuk është kryer asnjë veprim konkret për dhënien në përdorim/tjetërsimin/asgjësim të aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i *pranuar* dhe i *pa zbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: Sipërfaqet e tokës bujqësore të dhëna me qira janë siguruar në mbështetje të Vendimeve të Këshillit të Ministrave si vijon:

(i)VKM nr.995, datë 9.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim Komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 4.4.2012, nr.417, datë 8.6.2011 dhe nr.534, datë 1.5.2008” ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 926,55 Ha*.

(ii)VKM nr.45, datë 29.01.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 18,076 Ha*.

(iii)VKM nr.142, datë 24.2.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi të shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër” ka

kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 31,4 Ha, pasuria nr.2/17, Zona Kadastrale 3811.

Gjithashtu nga fondi i disponueshëm i tokave në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, është kaluar sipërfaqja prej 617,68 ha nën administrim të AIDA-s, për zhvillimin e investimeve strategjike të programuara.

Nga auditimi u konstatua se, sipërfaqja e fondit të tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është 19,033.95 ha, ku për periudhën në auditim është dhënë me qira sipërfaqja 714 ha e 3,484m², ndërsa në total për periudhën 2013-2021 është dhënë me qira sipërfaqja 2,519 ha e 7,366 m², e cila është regjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (AKSH), në momentin kur kanë filluar procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR. Sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për t'u dhënë me qira është 15,896 ha e 5, 334 m², duke konstatuar se, gjendja juridike është e pa ri regjistruar pranë AKSH, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta.

Gjithashtu, u konstatua se fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël, i dhënë në bazë të VKM-së nr. 45/2014, nuk është shoqëruar me një kopje të listës së inventarit për pasuritë, të njehsuara me origjinalin, si pjesë e kësaj VKM, ndonëse nga MBZHR me shkresë nr. 7254 prot. datë 24.09.2019, i është kërkuar Këshillit të Ministrave por nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje mbi këtë kërkesë. Në kushtet kur lista e inventarit të ngastrave që do të jepen me qira ka munguar dhe vijon të mungojë, del e paqartë se si strukturat përgjegjëse për administrimin e tokave bujqësore në MBZHR, bëjnë shpalljen publike dhe përditësimin e saj, sikundër dikton VKM nr. 373 datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar.

Kjo situatë është e mbartur në vite në Ministrinë e Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe nga struktura përgjegjëse të saj, nuk është ndërmarrë asnjë masë për regjistrimin e sipërfaqes në pronësi.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-114 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Nga ana e MBZHR të merren masa, për verifikimin dhe hartimin e një regjistri të plotë dhe të saktë, ku të evidentohet gjithë fondi i tokës bujqësore që i ka kaluar në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, konkretisht me Këshillin e Ministrave dhe Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe, për të verifikuar dhe saktësuar sipërfaqet e tokave në administrim të MBZHR-së.

Menjëherë

8.2 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa, për regjistrimin e fondit të tokës bujqësore që është në administrimin të saj, në bazë të bashkëpunimit dhe koordinimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, duke negociuar mbi kostot e vlerave të regjistrimit, dhe duke marrë masa për të planifikuar në buxhetin vjetor të MBZHR-së, fonde të dedikuara për të finalizuar procesin e regjistrimit të tokave bujqësore.

Deri 31 dhjetor 2022

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Për realizimin e 2 rekomandimeve të mësipërme, SP me Urdhrin Nr. 152, datë 20.03.2023 ka ngritur strukturën e posaçme me qëllim inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie për çdo pasuri në inventarin apo në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kjo referuar Vendimit Nr. 28, datë 27.1.2023, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Kreu II “Procedurat e hollësishme, dokumentacioni i përditësimit dhe rregullat për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, pika 3, i cili ka përcaktuar procedurat e përditësimit të plotë apo të pjesshëm të pronave të paluajtshme

shtetërore, të inventarizuara ose jo, në pronësi ose përdorim apo përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore. Kjo strukturë ka për detyrë:

a. Identifikimin e listës/pronës që do t'i nënshtrohet përditësimit dhe grumbullojë dokumentacionin tekniko-ligjor, arkivor, që disponon për të;

b. Evidentimin faktik në terren të pronës, për rastin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të Kreut II, të këtij Vendimi;

c. Administrimin nga ASHK-ja të informacionit për gjendjen juridike të pronës, në përputhje me Ligjin Nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe Vendimin Nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar, përfshirë dhe informacionin për proceset kalimtare të pronësisë, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe harton relacionin përkatës;

ç. Hartimin e planit të rilevimit të pronës sipas modelit dhe në përputhje me standardet teknike të përcaktuara në Vendimin Nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”;

d. Hartimin e listës së përditësuar të pronës/pronave, ku janë saktësuar emërtesa, vendndodhja, komponentët dhe destinacioni i përdorimit;

dh. Paraqitjen për shqyrtim pranë ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, në mënyrë që të procedohet me hartimin e projektvendimit për miratimin e listës përfundimtare të pronave shtetërore nga Këshilli i Ministrave. Lista që paraqitet për shqyrtim shoqërohet nga relacioni i gjendjes juridike dhe plani i rilevimit”.

I gjithë ky proces do të zhvillohet me asistencën e përfaqësuesit të ASHK-së.

Në zbatim të këtyre parashikimeve nga Struktura e Posaçme e ngritur me urdhrin e sipërcituar ka proceduar me kërkesën e informacionit në institucionet e varësisë së MBZHR-së dhe Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarqe, me shkresat si më poshtë:

1. Shkresa me nr. 658/11 prot., datë 30.3.2023, drejtuar ASHK-së për caktimin e përfaqësuesit që do të asistojë strukturën e posaçme në këtë proces deri në regjistrimin e pronave në regjistrin kadastral publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie për çdo pasuri në inventarin apo në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

2. Shkresat me nr. 658/7-10 prot., datë 29.3.2023 drejtuar Institucioneve të varësisë së MBZHR-së për informacion nëse pasuritë në inventar apo në administrim janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si dhe kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentacionit që provon regjistrimin (vërtetim ose certifikatë pronësie, kartelë të pasurisë së paluajtshme dhe fragment të hartës kadastrale), i cili duhet të dërgohet brenda datës 28.4.2023;

3. Shkresa me nr. 658/6 prot., datë 28.3.2023 ku i kërkohet Sektorit të Administrimit të Tokës në MBZHR vënia në dispozicion i gjithë materialit të dorëzuar nga Grupit i Punës, i ngritur më herët nga kjo drejtori (listat e përditësuara me pasuritë në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së dhe pasuritë disponibël me prejardhje nga ish - ndërmarrjet bujqësore, procesverbalet, foto, etj.)

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër këto rekomandime konsiderohen të *pranuara* dhe *në proces*. (2 rekomandime)

9. Gjetje nga auditimi: MBZHR, për periudhën në auditim, në mbështetje të VKM nr.373, datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe të kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, ka lidhur **11 kontrata**, të cilat u audituan në lidhje mbi përcaktimin e kriterëve, mbi përlllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë së tokës bujqësore, mbi përzgjedhjen e subjektit qiramarrës, si dhe ecurinë e monitorimit të kontratës deri më 31.03.2021.

Gjithashtu, për periudhën nga viti 2013 deri në fund të vitit 2018, janë lidhur **40 kontrata** në mbështetje të VKM-së nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” ndryshuar, me VKM

nr.373, datë 20.06.2018, nga të cilat 11 kontrata prej tyre u përzgjedhën për auditim për fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës.

Në bazë të Urdhrave të Kryeministrit nr.168, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” i ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr.39 datë 22.01.2021, ku sipas rregulloreve të brendshme të miratuara nga titullari i MBZHR me urdhrat nr.324/1 datë 25.09.2018 “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” dhe nr.4276 prot. datë 02.06.2021, është Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave me përbërje (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë) pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, përgjegjës për monitorimin dhe mbajtjen e regjistrit të kontratave të qirasë dhe ecurinë e up date të tyre, në përmbushje të detyrave funksionale.

Kjo strukturë nuk ka funksionuar asnjëherë me staf të plotë me burime njerëzore për shkak të mos rekrutimit të punonjësve nga ana e DAP si dhe punonjësit e pakët e këtij sektori, përtej kryerjes së detyrave funksionale, janë përfshirë rast pas rasti nga titullari i MBZHR (Ministri), duke marrë pjesë edhe në:

(1) grupet të vlerësimit në terren, të tokës bujqësore që jepet me qira, me detyrë, verifikimin e gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës bujqësore, verifikimin e gjendjes së infrastrukturës ujëtare dhe kulluese te saj, distancën nga tregjet, nivelin e industrisë agro përpunuese, si dhe shkallën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës;

(2) grupet e përllogaritjes së vlerës së çmimit të qirasë vjetore për tokën që jepet me qira, me detyrë, përcaktimin e shkallës së bonitetit të tokës me qëllim përcaktimin e qirasë fillestare minimale, mbivlerën e të cilës shtohen (në %) dhe komponentë të tjerë⁵.

Kështu, vendosja në grupe të ndryshme të punonjësve të sektorit, për propozimin, miratimin, monitorimin, në të njëjtën kohë, nuk është në përputhshmëri, sipas kërkesave që dikton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Nga auditimi, në lidhje mbi punën e monitorimit të kontratave nga sektori bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se;

- deri në fund të vitit 2019, ka realizuar 8 monitorime, nga 40 kontrata në fuqi (ose monitoruara rreth 20 % të kontratave) ;

-përgjatë vitit 2020, ka realizuar 6 monitorime nga 50 kontrata ne fuqi (ose monitoruara rreth 12% të kontratave);

-përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021, nuk ka realizuar asnjë monitorim nga 51 kontrata.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse, Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën”, i ndryshuar.

Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njerëzore si dhe vendosja e punonjësve të pakët nga ana e titullarit të MBZHR, në disa procese pune në të njëjtën kohë, për vlerësimin e tokës në terren, përllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë vjetore, për hartimin e kontratës së qirasë si dhe monitorimin e tyre, nuk ka bërë të mundur të kemi efektivitet të plotë të monitorimit të ecurisë së kontratave të qirasë të tokave bujqësore, kjo në kundërshtim me detyrimin që parashikon VKM nr.373 datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” kreu VII “Monitorimi i kontratave”, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

⁵1. Gjendja e infrastrukturës ujëtare dhe kulluese te saj.

2. Distanca nga tregjet (pika grumbullimi, tregjeve te zonave urbane)

3. Shkallën e e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës

4. Distanca nga sipërmarrjet agro-përpunuese (të produkteve bujqësore ose blegtorale)

(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-114 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

9.1 Rekomandim: MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike.

-Nga titullari i MBZHR, për realizimin e procedurës së dhënies me qira të tokës bujqësore, të vendosë në grupet e punës persona, në mënyrë të tillë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin, sipas kërkesave që dikton ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Lidhur me këtë rekomandim MBZHR nuk ka kryer asnjë ri shikim apo studim për shtimin e burimeve njerëzore në Sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave duke e lënë në të njëjtat kushte dhe problematika të pa zgjidhura dhe të evidentuara rishtaz në auditimin e rradhës.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandime konsiderohet i **pranuar dhe i pa zbatuar.**

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i miratimit dhe monitorimit të kontratave, të cilat janë dhënë, mbi bazën nënligjore, konkretisht me VKM nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, u konstatua se ka mospërputhje midis vlerës së investimit parashikuar në plan biznes, paraqitur gjatë fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë, duke rezultuar më e ulët. Ky fakt cenon procesin e dhënies me qira, gjatë të cilit është pretenduar nga subjekti, për vlerë më të madhe të investimit si dhe lidhja e këtyre kontratave është në kundërshtim me bazën nënligjore të aplikuar të kohës, më konkretisht si vijon:

1. Subjekti Kantina “Ç.” ShPK dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr.1001 prot, nr.396 rep., nr.369 kol, datë 05.02.2016, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 154,286,259 leke, ndërsa në kontratë ky investim paraqitet 120,900,000 lekë (ose 33,386,259 lekë më e ulët).

2. Shoqëria “A. L. I. A.” ShPK dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 3,155,883 Euro (ose 442,770,385 lekë) ndërsa në kontratë kjo vlerë është 272,303,322 lekë (ose 170,467,063 lekë më ulët).

3. Shoqëria “P. I.” ShPK dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3620/1 prot. datë 06.09.2013, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është me vlerë 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët).

4. Subjekti “A. M.” dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr. 2548 prot, nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 57,638,000 lekë, ndërsa në kontratë vlera është 34,370,000 lekë (ose 23,268,000 lekë më ulët). *(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-114 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupit pune, me qëllim vlerësimin e kontratave të mësipërme dhe të identifikimit të kontratave të tjera nëse kanë, të njëjtën problematikë të mospërputhjes së vlerës së investimit parashikuar në plan biznes, paraqitur gjatë fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë, duke mundësuar më pas, dakordësinë për amendim kontrate midis palëve,

duke vendosur në kontratë si vlerë investimi vlerën e plan biznesit si dhe të rivlerësohet afati i kohës për realizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Lidhur me këtë rekomandim MBZHR nuk ka ngritur asnjë grup pune dhe problematikat e konstatuara në auditimin e mëparshëm janë prezentë edhe në auditimin e radhës në lidhje me monitorimin e kontratave të tokave bujqësore duke rritur numrin e debitorëve dhe të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandime konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar**.

11. Gjetje nga auditimi: Në disa prej kontratave të qirasë të lidhura gjatë viteve 2013 – 2018 të audituara në lidhje mbi ecurinë dhe monitorimin, u konstatua se, një pjesë e sipërfaqeve të dhëna me qira, janë të mbivendosura, mbi varreza publike të zonës, mbi ndërtime të paligjshme si dhe në përdorim të një pale tretë, për pasojë subjektet qiramarrëse nuk kanë mundur të shfrytëzojnë sipërfaqen e plotë dhe të zhvillojnë plotësisht kontratën. Struktura përgjegjëse e monitorimit të kontratave për periudhën në auditim, ka identifikuar dhe verifikuar problematikën e mësipërme, duke njoftuar titullarit e MBZHR. Problematikat, tregojnë mangësinë e mungesës së regjistrimit të plotë dhe të saktë, të fondit të tokës bujqësore në administrim të MBZHR, i cili duhej hartuar në bashkëpunim dhe koordinim midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, më konkretisht si vijon:

1. Subjekti “M.” ShPK ka lidhur me Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kontratën nr. 8136 prot, datë 23.10.2015, për sipërfaqen prej 18.9174 ha tokë bujqësore të ndodhur të ndodhur në Zonën Kadastrale 1582 e përbërë prej ngastrave me numra pasurie 114/19, 114/21, 114/22, Fshati Dushk i Madh, Njësia Administrative Dushk, Rrethi Lushnje, Qarku Fier.

Nga auditimi u konstatua se, sipas verifikimit në terren i strukturës përgjegjëse për monitorim në MBZHR, në datën 14.11.2018 rezultoi se qiramarrësi nuk mund të shfrytëzojë sipërfaqen me numër pasurie 114/22 me sipërfaqe 7000 m² Zona Kadastrale 1582 e cila **është e zënë me varreza** dhe pasurinë me nr. 114/19 Zona Kadastrale 1582 me sipërfaqe 23,843 m² e ndarë sipas ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar, referuar hartës treguese e cila është e zënë nga vreshta.

Për këtë problematikë shoqëria “M.” shpk është drejtuar pranë qiradhënësit me shkresën nr. 849 Prot. datë 24.01.2019 ku informon se ka aplikuar për regjistrimin e Kontratës së Qirasë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje që në datë 28.11.2015, ndërsa certifikata e regjistrimit është lëshuar nga kjo zyrë në datën 29.9.2016.

Regjistrimi i kontratës është bërë vetëm për pasurinë me numër 114/21 me sipërfaqe 158.331 m². Për pasuritë me numër 114/19 me sipërfaqe 23.843 m² dhe 114/22 me sipërfaqe 7.000 m², nuk u bë i mundur regjistrimi nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje, sepse sipas saj pasuria 114/19 rezulton e ndarë sipas ligjit nr. 7501 por me AMTP të paregjistruara deri në atë kohë, ndërsa pasuria 114/22 e përcaktuar si varrezë publike me vendim të Këshillit të Komunës Dushk i Madh, gjithashtu edhe ky vendim i paregjistruar. Për ta zgjidhur këtë administratori i shoqërisë “Mendi” shpk me deklaratën noteriale nr. 1978 rep. nr. 1308/3 kol. datë 8.9.2016 deklaroi se heq dorë nga regjistrimi i kontratës për pasuritë me numër 114/19 dhe 114/22 Zona Kadastrale 1582.

Si përfundim shoqëria shfrytëzon vetëm sipërfaqen me numër pasurie 114/21 me sipërfaqe 158.331 m² Zona Kadastrale 1582, pasuri të cilën e ka regjistruar pranë ZVRPP Lushnje.

Sa më sipër, në Memon e datës 01.02.2019, sektori i bashkëfinancimit për partneritet dhe monitorimit i është drejtuar Ministrit të MBZHR, për problematikën e konstatuar, ku deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nga ZVRR-Lushnjë, nuk është përcjellë informacioni.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 82-87 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

2. Subjekti “B. A.” shpk dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr.7075 prot, nr.6075 rep. nr.2615 kol, datë 7.10.2014, për të cilën, në zbatim të Urdhrit nr.509 datë 30.10.2014 “*Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë “B. A. I.” ShPK*”, është ngritur grupit i punës i cili ka proceduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se: “*Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufijtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtimet pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 7.10.2014 “Për dhënien me qira të tokës bujqësor në pronësi të shtetit”.*

Një pjesë e sipërfaqes së marrë me qira është e zaptuar nga të tretë. Në këto sipërfaqe janë ndërtuar shtëpi banimi. Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m² qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vend ndodhjes së saj. (Trajtuar më hollësisht në faqet 84-86 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

3. Subjekti “D. F.” ShPK dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur Kontratë nr.6097 prot, nr.1861rep, nr.798kol, datë 8.9.2017 sipas VKM Nr.460, datë 22.5.2013 “*Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*” i ndryshuar, me afat për 90 vite. Titullari i MZHBR me Urdhrit nr.497, datë 15.11.2018 “*Për ngritjen e Grupit të Punës për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit “D. – F.” ShPK*, me datë 15.11.2018 nuk ka mundur të kryejë dorëzimin e tokës, për arsye se **pjesa më e madhe e sipërfaqes ishte e punuar dhe e mbjellë nga të tretë**. Për këtë i është kërkuar informacion ZVRPP Fier e cila informon që këto pasuri janë në pronësi shtet, Bashkisë Fier e cila konfirmon se zaptuesit e tokës nuk kanë asnjë dokument të provojë tagrat e tyre për këtë shfrytëzim dhe DAMT Këshilli i Qarkut Fier e cila informon se këto pasuri nuk janë përfshirë në VKM nr.45/2014, “*Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve-kërkimore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave*”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 84-87 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Nga titullari i institucionit, për kontratat e mësipërme të dakortësohet për amendim kontratë midis palëve, duke vendosur në kontratë sipërfaqen e saktë për përdorim si dhe të marrë masa për ngritjen e një grupit pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbivendosje të sipërfaqeve bujqësore me aktivitete jo të zhvillimit bujqësor rural, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

-Për të gjitha rastet në vijim, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qira tokë bujqësore, pa realizuar procesin e identifikimit dhe verifikimit të mos pasjes së mbivendosjeve sipas shkaqeve të sipërpërmendura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Lidhur me këtë rekomandim MBZHR nuk ka ngritur asnjë grup pune dhe problematikat e konstatuara në auditimin e mëparshëm janë prezentë edhe në auditimin e radhës në lidhje me monitorimin e kontratave të tokave bujqësore duke rritur numrin e debitorëve dhe të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar**.

12. Gjetje nga auditimi: Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti rezulton se mbledhjet e kryera nga GMS të jenë sistematike e periodike në kundërshtim me përcaktimet e ligjit.

Në MBZHR bëhen trajnime të vazhdueshme për ngritjen e nivelit profesional nga Shkolla e Administratës Publike por konstatohet se për vitet objekt auditimi nuk ka pasur një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallur nga institucioni. MBZHR ka hartuar regjistër të risqeve për disa drejtori, por procesi i menaxhimit të riskut nuk është i formalizuar në regjistër i konsoliduar i risqeve për institucionin i miratuar. Gjithashtu rezulton se në Ministrinë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk është finalizuar hartimi i matricës dhe strategjisë së menaxhimit të riskut, e cila rezulton në mungesë të monitorimit të risqeve. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se disa prej sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar në harmoni me njeri-tjetrin.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 145-152 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Nga ana e titullarit të MBZHR të merren masa që në institucion të hartohet një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve dhe të formalizohet regjistri i konsoliduar i risqeve për institucionin dhe të miratohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Nga MBZHR konstatohet se nëpërmjet shkresës nr. 546, datë 26.01.2022, “Mbi kalendarin e trajnimeve”, pas rishqyrtimit të planifikimit të nevojave për trajnim për stafin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim rritjen e mundësive për përmirësimin profesional për secilin punonjës, i janë dërguar ASPA-s nevojat institucionale për trajnim për MBZHR-në për vitin 2022. Aparati ka qenë në proces ristrukturimi, prandaj do të ri konceptohen risqet në nivel drejtorish për të vijuar me regjistrin final të riskut.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar**.

13. Gjetje nga auditimi: Struktura e njësisë së auditit të brendshëm në MBZHR, për periudhën 01.01-08.02.2019 ka funksionuar me 3 specialistë dhe me drejtues të komanduar; për periudhën 08.02-31.12.2019 ka funksionuar me 3 specialistë dhe 1 drejtor, pra struktura nuk ka qenë e plotë me 4 specialistë dhe 1 drejtor (për shkak të mos rekrutimit në kohë nga DAP); ndërsa për periudhën 01.01.2020 e në vazhdim ka funksionuar e plotë, duke realizuar për vitin 2019, rreth 83% të auditimeve të planifikuara dhe në vitin 2020, rreth 125% të auditimeve. Kjo njësi nga auditimi i njësive të varësisë së MBZHR, për vitin 2019, ka konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën 19,880 mijë lekë dhe për vitin 2020 janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën 2,982 mijë lekë. Grupit i audituesve të KLSH, konstatoi se, nga NjAB nuk është monitoruar procesi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga njësia. Në dosjet e audituara nuk ka asnjë gjurmë të sigurimit të brendshëm të cilësisë të realizuar nga auditues brenda drejtorisë që nuk kanë qenë pjesë e grupit të auditimit ose nga drejtuesi i NjAB, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm.

Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore i dosjeve të auditimit, u konstatua se të gjitha dosjet e evaduar nuk janë të arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9154 “Për Arkivat”, kreu VI “Dorëzimi i dokumenteve në arkivat shtetërorë”, neni 42 pika 1 dhe me nenin 9 shkronja ç. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 145-152 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara, NjAB duhet të përmbushë detyrimet ligjore për sigurimin e gjurmës së auditit të brendshëm të cilësisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, për MBZHR dhe njësisë të varësisë.

-Nga MBZHR, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Nga Sektori i auditit të brendshëm në MBZHR, janë hartuar Programet për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Drejtorinë e Auditimit MBZHR, Sektorët e Auditimit AZHBR dhe AKU. Miratimi i programeve nga Titullarët (Ministri dhe Drejtorët e Përgjithshëm). pas dhënies së opinionit nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm në MBZHR, do të kryhet pas miratimit të ndryshimeve në ligjin për audimin e brendshëm. (Ligji është hedhur për konsultim publik). Pas miratimit të ligjit, nga Drejtoria e Harmonizimit për AB në MFE, janë përgatitur 3 manuale, një prej të cilëve, për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Dosjet e inventarizuara janë arkivuar, përkatësisht me:

1. Procesverbal Dorëzimi Nr. 3824 prot., datë 14.7.2022 për dosjet e vitit 2019.
2. Procesverbal Dorëzimi Nr. 3824/1 prot., datë 14.7.2022 për dosjet e vitit 2020.
3. Procesverbal Dorëzimi Nr. 3824/2 prot., datë 14.7.2022 për dosjet e vitit 2021.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën në auditim nga MZHBR, janë realizuar 11 procedura dhënie me qira të tokës bujqësore, nga të cilat nga grupit i auditimit u përzgjodhën 7 kontrata, ku në 2 procedura gjatë procesit të realizimit të dhënies me qira, u konstatua që, përlllogaritja e çmimit fillestar të qirasë të tokës bujqësore pas verifikimit në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej **196,776.94 lekë si efekte negative** në Buxhetin e Shtetit, konkretisht:

1. Për Kontratën nr.180 Rep, nr.33/4Kol nr.317 prot. datë 15.01.2020 me subjektin “A.B.-F.” shpk;

2. Për Kontratën nr.305 Rep, nr.613 Kol, nr.748/1 prot. datë 22.09.2020 me subjektin “F.A.”, Kjo në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore” i ndryshuar, sipas VKM nr.373 datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.” (Trajtuar më hollësisht në faqet 70-74 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

1.1 Rekomandim. Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 196,776.94 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, për shkak të llogaritjes më pak të vlerës së qirasë, konkretisht:

-Vlera prej 32,864 lekë për subjektin “A. B.-F.”.

-Vlera prej 163,912.94 lekë për subjektin “F. A”.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Në lidhje me rekomandimin e mësipërm nga MBZHR ka rezultuar:

1. Për subjektin "A. B.F." shpk është lënë rekomandimi që Neni 1 "Objekti, afati dhe vlera e kontratës", pika 3, paragrafi i dytë, të amendohet dhe çmimi fillestar i qirasë duhet të jetë 532,986.00 lekë, për të cilën është dakordësuar me subjektin amendimi i kontratës së qirasë sa i takon vlerës së qirasë vjetore;

2. Për subjektin "F. A." shpk me shkresat Nr. 843/3 prot., datë 2.3.2022 dhe Nr. 843/26 prot., datë 1.9.2022, të MBZHR-së, u njoftua subjekti Qiramarrës mbi gjetjet e konstatuara në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe u ftua në një takim të përbashkët për të vlerësuar situatën dhe mënyrën e zgjidhjes së kësaj pasaktësie të konstatuar.

3. Përfaqësuesja e subjektit "F. A." ShPK, në takimin që u zhvillua më datë 13.09.2022 në ambientet e MBZHR-së, u shpreh se është dakord për të vijuar me amendimin e Kontratës së Qirasë, sa i takon vlerës së qirasë vjetore të përcaktuar në këtë kontratë, e cila nga shuma 3,000,035.53 (tre milion e tridhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e tre) lekë duhet të jetë në shumën 3,163,948.47 (tre milion njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë pikë dyzet e shtatë) lekë, pra për saktësimin e vlerës së qirasë vjetore për shumën 163,912.94 lekë.

Gjithashtu përfaqësuesja e Qiramarrësit u shpreh dakord dhe për pagesën e vlerës 491,738.82 lekë, diferencë e krijuar gjatë pagesës së vlerës së qirasë vjetore për vitet 2020, 2021 dhe 2022, pasqyruar në procesverbalin me nr. 4931 prot., datë 27.9.2022. MBZHR nuk ka proceduar ende me amendimin e kontratës së qirasë.

Pra rezulton që nga MBZHR nuk është arkëtuar vlera e dëmit ekonomik lënë nga grupit i auditimit të KLSH-së, në vlerën 196,776.94 lekë.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i monitorimit të kontratave në lidhje me detyrimin kontraktor të realizimit të investimeve kapitale, në 3 kontrata, të cilat janë dhënë mbi bazën nënligjore të aplikuar të kohës, me VKM nr.460, datë 22.5.2013 "*Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*" i ndryshuar, u konstatua se, qiramarrësit megjithëse kanë kryer investime në terren **nuk** mund t'i mbështesin investimet me dokumente justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë për këto kontrata **nuk** provohet plotësimi i kushteve të kontratës, për realizimin e investimit jo më pak se 20% e vlerës së parashikuar brenda vitit të 3-të pas lidhjes së kontratës si dhe 70% brenda vitit të 5-të, e për pasojë mosplotësimi i detyrimeve kontraktore, në kundërshtim me nenin 6, pika 5/b, me nenin 7, pika 3 të kontratës, duke përllorëgatur penalitetet, më konkretisht:

1. Shoqëria "A.L. I.A." shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë nr. 3819 prot datë 16.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, me objekt të kultivimit të drufrutorë të arrës së bashku me fidanishte dhe të kultivimit të ullinjve, me vlerë qiraje 622,440 lekë në vit. Nga auditimi rezultoi se, MBZHR ka zgjidhur kontratën në mënyrë të njëanshme me shkresë me urdhër të titullarit, nr.227 datë 01.06.2021, për shkak se, subjekti nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, si dhe ky subjekt nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para.

Grupit i auditimit kreu përllorëgatiqet e penaliteteve për investimin e pakryer nga ku rezultoi se: Investimi i parashikuar në planin e biznesit është në vlerën 3,155,883 Euro brenda një afati 5 vjeçar; Investimi i realizuar është në total rreth 126,346 Euro: nga të cilat 13,306,926 leke dhe 31.500 Euro; dhe Investimi i porealizuar rezulton rreth 3,029,536 Euro (ose 425,044,008 lekë⁶)

⁶ Për efekt përllorëgatiqesh kursi i këmbimit Euro/ALL është 140.30, sipas kursit të këmbimit nga BSH më datë 16.09.2013 - data e lidhjes së kontratës

Totali i penaliteteve në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera është **14,672,752.09 lekë** (ose 104,581 Euro).

2. Shoqëria "P. I." ShPK dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë Nr.3620/1 prot. datë 06.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ndryshuar me Shtojcën 5 nr.4307, nr.1228 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017. Nga auditimi konstatua se, për realizimin e investimit me vlerë prej 351,036,645 lekë sipas Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013 në Plan biznesit të vitit 2013, u konstatuan dokumentacion në dosjen fizike sipas faturave të dorëzuara në vlerën prej 44,399,037 lekë, d.m.th. 13% të vlerës së investimit, në mos plotësim të detyrimit kontraktor, sipas neni 6 pika 5/a e për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera është në vlerën 12,265,504.32 lekë.

-Ndërsa për kontratën shtesë nr.4307 Prot, Nr.1225 Rep, Nr.298 Kol, datë 29.05.2017 sipas Plan Biznesit të vitit 2017, nuk u konstatua dokumentacion justifikues në dosjen fizike, për vlerën e investimit të parashikuar në kontratë dhe për këtë arsye investimi konsiderohet në masën 0 %, për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në mos plotësim të detyrimit kontraktor sipas neni 6 pika 5/b penaliteti i parashikuar në masën 2% sipas nenit 7 pika 3, është në vlerën 1,366,272.00 lekë.

Pra në total, penalitetet për mos realizimin e investimeve kapitale sipas Plan biznesi të vitit 2013 dhe vitit 2017 është në vlerën **13,631,776.32 lekë**.

3. Subjekti Kantina "Ç." shpk dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ngritje vreshti për kultivimin rrushi dhe prodhim vere me vlerë qiraje 321,565 lekë në vit. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës), është ngritur grupit i punës "Për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P.Ç." ShPK, ndërsa në procesverbalin nr. 9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupit i dorëzimit, citohet se "qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës", fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin e tokës bujqësore nga qiramarrësi.

Investimi i parashikuar në planin e biznesi për 5 vitet e para është në vlerën 154,286,259 lekë, ndërsa nga auditimi i dosjes fizike nuk u konstatua asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realizimin e investimit të vitit të pestë kryer në masën prej 70%, pra duhet të kishte të provuar vlerën e investimit prej 108,000,381 lekë, penaliteti me vonesë të investimit për 53 ditë është në vlerën prej **448,064 lekë**.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 67-114 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **28,304,528.3 lekë** si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos kryerja e investimeve në kohë, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

-Për subjektin "A. L. I.A.", në vlerën prej 14,672,752.09 lekë (ose 104,581 Euro).

-Për subjektin "P. I." ShPK, në vlerën 13,631,776.32 lekë.

-Për subjekti Kantina "Ç.", në vlerën 448,064 lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: a) Lidhur me rekomandimin e lënë, nga MBZHR janë paraqitur këto argumente:

1. Për subjektin "A. L. I.A." ShPK, sqaron se:

Me Urdhri me Nr. 227, datë 01.06.2021, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirasë Nr. 3819 prot., datë 16.9.2013 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit” me palë Qiramarrëse shoqëria “A.L. I.A.” shpk, bazuar në nenin 6 të Kontratës së Qirasë është zgjidhur në mënyrë të njëanshme kjo kontratë qiraje, për mungesë të aktivitetit tregtar, mos pagesë të vlerës së qirasë vjetore dhe mos realizimit të investimeve të parashikuara në kontratë dhe Planin e Biznesit.

Ky subjekt ka pezulluar aktivitetin (pushim i përkohshëm i aktivitetit) me datë 18.11.2013 pa afat, pezullim vetëm dy muaj pas nënshkrimit të kontratës. Me datë 25.03.2015 ka ndryshuar statusi nga pasiv në aktiv. Me datë 22.04.2015 ky subjekt ka kërkuar përsëri pezullimin e aktivitetit pa afat, pezullim të cilin e ka hequr me datë 05.02.2018 duke marrë statusin aktiv, të cilin e ka pezulluar përsëri me datë 10.02.2020, fakt ky i provuar dhe me Listën e Subjekteve Pasive të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pezullim i cili vazhdon.

Me tonën me Nr. 1559/3 prot., datë 15.6.2021 është dërguar për njoftim urdhri i sipërcituar, si dhe është njoftuar për detyrimet që ky subjekt ka nga mos përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, kamatëvonesa dhe gjobë referuar parashikimeve të nenit 1 “Objekti i kontratës”, pikat 2 e 3 dhe nenit 7 “Sanksione”. Shkresa për njoftim dhe Urdhri për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së qirasë janë kthyer nga shërbimi postar me shënimin “ka ndryshuar adresë”. Shkresat janë dërguar në adresën e deklaruar nga shoqëria “A. L. I. A.” ShPK në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Pjesa e Shtatë “Njoftimi”, Kreu I “Rregullat e përgjithshme të njoftimit”, Neni 151 “Vendi i njoftimit”, pika 1, shkronja “c”, parashikohet se: “Njoftimi bëhet në selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik”.

Kreu II “Mënyrat dhe mjetet e njoftimit”, Seksioni 1 “Njoftimi me postë dhe mjete elektronike”, neni 162 “Njoftimi publik”, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, parashikon se: “Njoftimi publik bëhet në këto raste: b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur”.... pika 2, parashikon se: “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”.... pika 3, parashikon se: “Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara”....pika 4, parashikon se: “Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh”.

Referuar dispozitave si më lart, meqenëse njoftimi për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë me Nr. 3819 prot., datë 16.9.2013 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit” me palë Qiramarrëse shoqëria “A. L. I.A.” shpk nuk ishte i mundur, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston, me shkresën me Nr. 1353/3 prot., datë 28.2.2023 është dërguar urdhri për njoftimin publik të tij, në Bashkinë Tiranë meqenëse në territorin e saj ka pasur selinë Qiramarrësi, dhe me shkresën me Nr. 1354/2 prot., datë 28.2.2023 për njoftim publik në Njësinë Administrative Fushë - Krujë, Bashkia Krujë, në të cilën ndodhet sipërfaqja e dhënë me qira, si dhe është njoftuar në faqen zyrtare dhe këndin e njoftimit të MBZHR-së. Nga Bashkia Tiranë dhe Krujë jemi njoftuar se është bërë shpallja publike e këtij Urdhri.

Pas përfundimit të afatit të njoftimit po procedohet me fillimin e procesit gjyqësor për zgjidhjen e kësaj kontrate si dhe detyrimin e shoqërisë “A. L. I.A.” ShPK të paguajë shumat e sipërcituara.

b) Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin “P. I.” ShPK, sqarojmë se:

Në zbatim të këtij rekomandimi me shkresën me Nr. 4545 prot., datë 2.9.2022 është njoftuar subjekti për pagesën e shumës 4,619,670.12 lekë, vlerë qiraje të papaguar, shumën prej 20,370,857.62 lekë, kamatëvonesa të akumuluar ndë vite dhe vlerën prej 20,447,653.08 lekë si gjobë për mosrealizimin e investimeve të parashikuara në plan biznes për t’u kryer, brenda 90 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Gjithashtu në këtë shkresë është njoftuar se në rast të mos pagesës brenda këtij afati Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të procedojë me zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme për mos përmbushje të detyrimeve të saj. Subjekti nuk ka qenë dakord me këto detyrime dhe i ka kundërshtuar në MBZHR me pretendimin se nuk qëndrojnë. Me shkresën me nr. 4545/2 prot., datë 30.12.2022 i është kthyer përgjigje dhe është njoftuar përsëri për pagesën e këtyre detyrimeve dhe në rast të mos pagimit të këtij detyrimi nga ana tij, MBZHR do të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për vjeljen e tyre si dhe do të procedojë me zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratës së qirasë. Po përgatitet dokumentacioni për vjeljen e detyrimit në rrugë ligjore.

c) Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin P. Ç., Person Fizik (emri tregtar “K. Ç.”), sqarojmë se:

Në zbatim të këtij rekomandimi me shkresën me Nr. 1321 prot., datë 27.2.2023 është njoftuar subjekti të paguajë gjobë në vlerën 15,571,223.45 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e tre pikë dyzet e tetë) lekë si detyrime që rrjedhin nga kontrata e qirasë, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Gjithashtu është njoftuar subjekti që brenda vitit pasardhës duhet të realizojë investimet e parashikuara në kontratë dhe planin e biznesit dhe në rast se nuk i përmbush këto detyrime brenda këtyre afateve, atëherë MBZHR do të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për vjeljen e këtyre detyrimeve si dhe do të vazhdojë me zbatimin e kushteve të parashikuara në Kontratë. Këtë detyrim subjekti ende nuk e ka likuiduar.

SBMP raporton se në Raportin e Auditimit vlera e detyrimit është në shumën 448,064 lekë, por nga llogaritjet e Strukturës Përgjegjëse për monitorimin kjo vlerë ka rezultuar më e madhe.

Pra rezulton që nga MBZHR nuk është arkëtuar vlera e dëmit ekonomik lënë nga grupit i auditimit të KLSH-së, në vlerën **28,304,528.3** lekë.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar.**

3. Gjetje nga auditimi: Në bazë të kontratave tip të mëposhtme, subjektet kanë likuiduar me vonesë pagesat e qirasë vjetore, në kundërshtim me nenin 7, pika 1, sipas të cilit qiramarrësi, paguan kamatë vonesën në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonese në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në kontratën respektive. Penaliteti nuk është përlllogaritur nga struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupit i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qirasë, janë si vijon:

1. Shoqëria "A. L. I.A." shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, me detyrimin prej vlerës **9,682,054** lekë.

2. Shoqëria “P. I.” shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, me detyrimin prej vlerës **15,197,238.15** lekë.

3. Subjekti Kantina “Ç.” ShPK dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr.1001 prot, nr.396 rep, nr.369 kol, datë 05.02.2016, me detyrimin prej vlerës **184,900.73** lekë.

4. Subjekti “A. M.” dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit Të Ujërave kanë lidhur Kontratë Nr. 2548 Prot, nr.115 Rep, nr.68 Kol, datë 24.03.2015, me detyrimin prej vlerës **1,341,629.10**lekë.

5. Subjekti "P." shpk dhe MZHBR kanë lidhur kontratë nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017, me detyrimin prej vlerës **5,895,051.75** lekë.

6. Subjektin "R.-S." dhe MZHBR kanë lidhur kontrata nr.178 rep, nr.32/4 Kol, nr.311 prot datë 15.01, me detyrimin prej vlerës **889,200** lekë.

7. **Subjektin** "F. A." lidhur kontrata nr.305 rep, nr.613 kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020, me detyrimin prej vlerës **18,000.21** lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 67-114 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **33,208,072.75** lekë të krijuara si pasojë e penaliteteve e mos likuidimit në kohë të qirave vjetore, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

-Për subjektin "R.-S.", në vlerën prej 889,200 lekë.

-Për subjektin "F. A.", në vlerën prej 18,000.21 lekë.

-Për Subjektin "A. L.I. A.", në vlerën prej 9,682,054 lekë.

-Për subjektin "P. I.", në vlerën prej 15,197,238.15lekë.

-Për Subjekti Kantina "Ç.", në vlerën prej 184,900.73lekë.

-Për Subjekti "A. M.", në vlerën prej 1,341,629.10lekë.

-Për Subjekti "P.", në vlerën prej 5,895,051.75 lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: a) Lidhur me rekomandimin e lënë, nga MBZHR janë paraqitur këto argumente:

1. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin "R. S." ShPK, i cili duhet të likuideojë vlerën prej 889,200 lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë, është njoftuar për pagesën me shkresën me Nr. 2051 prot., datë 6.4.2022, nuk e ka shlyer ende detyrimin;

2. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin "F. A." ShPK, në vlerën prej 18,000.21 lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë, është njoftuar për pagesën me shkresën me Nr. 843/3 prot., datë 02.03.2022 dhe Nr. 3360 prot., datë 20.6.2022, e ka likuiduar këtë vlerë.

3. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin "A. L. I. A." shpk, në vlerën prej 9,682,054 lekë, i cili duhet të likuideojë vlerën prej 889,200 lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë, është proceduar me njoftimin me shpallje të zgjidhjes së kontratës dhe do të fillojë procesi gjyqësor për zgjidhjen e njëanshme të kontratës dhe pagesën e detyrimeve nga subjekti;

4. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin "P. I." ShPK, në vlerën prej 15,197,238.15lekë, i cili duhet të likuideojë vlerën prej 889,200 lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë, është njoftuar për pagesë me shkresën me Nr. 4545 prot., datë 02.09.2022, nuk e ka shlyer detyrimin.

5. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin Kantina "Ç.", në vlerën prej 184,900.73lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë, është njoftuar për pagesën me shkresën me Nr. 1321 prot., datë 27.2.2023, nuk e ka likuiduar ende;

6. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin A. M., Person Fizik, në vlerën prej 1,341,629.10 lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë: Është njoftuar për pagesën në mënyrë vullnetare me shkresën me Nr. 2728 prot., datë 13.5.2022, në të cilën është përcaktuar afati 20 ditë nga marrja e njoftimit si dhe në rast të mos likuidimit brenda këtij afati nga Ministria do të përmbushet ky detyrim në rrugë gjyqësore. Dhe pse ka kaluar ky afat nga z. M. nuk është likuiduar vlera e penaltetit në shumën 1,341,629.10 lekë për këtë është përgatitur dokumentacioni për të filluar procesin gjyqësor për vjeljen e këtij detyrimi;

7. Lidhur me rekomandimin e lënë për subjektin “P.” ShPK, në vlerën prej 5,895,051.75 lekë, ardhur nga mos përmbushje e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë, është njoftuar për pagesën me shkresën me nr. 1463 prot., datë 7.3.2022 dhe Nr. 1179 prot., datë 20.2.2023, nuk ka shlyer detyrimet.

Pra rezulton që nga MBZHR nuk është arkëtuar vlera e dëmit ekonomik lënë nga grupit i auditimit të KLSH-së, në vlerën **33,208,072.75** lekë.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar.**

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike”.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligj buxheti për vitin 2019, janë planifikuar shpenzime për vendime gjyqësore në vlerën 5,000,000 lekë dhe janë realizuar 23,180,000 lekë (ose 363% më shumë nga sa planifikuar).

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligjin e buxhetit, për vitin 2020 janë planifikuar shpenzime për vendime gjyqësore në vlerën 5,000,000 lekë dhe u realizuan 13,170,000 lekë (ose 163% më shumë nga sa planifikuar).

-Kështu, me gjithë planifikimin, diferencat ndërmjet planifikimit dhe realizimit mbulohen nëpërmjet ri alokimeve nga diferencat e lira në fond pagash që rrjedhin nga vendet vakante.

Për sa i përket detyrimeve të mbartura, u konstatua se këto vendime gjyqësore janë për gjyq fituesit ku vendimi i formës së prerë është për likuidimin e pagës deri në rikthim në vendin e punës. Aktualisht, për gjyq fituesit që nuk janë sistemuar ende në vendin e tyre të punës, pagesa i bëhet mujore apo në çdo dy muaj nga sektori i financës në MBZHR. Pra nga auditimi i kryer u konstatua se në total për periudhën objekt auditimi janë paguar për vendimet gjyqësore të formës së prerë një total prej 37,326,830 lekë. Vlen të theksohet se të gjitha këto pagesa janë kryer gjatë periudhës objekt auditimi edhe pse vendimet e formës së prerë mund të jenë marrë edhe para kësaj periudhe.

Gjithashtu u konstatua se:

Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2019 u konstatua se në 3 praktika, nga 12 praktika të likuiduar gjithsej, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej 526,672 lekë.

Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2020 u konstatua se në 4 praktika, nga 12 praktika të likuiduar gjithsej, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej **1,138,232 lekë.**

Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, vendimet gjyqësore të formës së prerë, për praktikat e sipërpërmendura, **nuk** janë ekzekutuar vullnetarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por në 7 raste janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e MBZHR-së për periudhën objekt auditimi në vlerën 1,664,904 lekë. Referuar udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, pika 9, përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit vetëm, në ato raste kur njësia shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij udhëzimi, çfarë në këtë rast ka ndodhur pasi MBZHR nuk rezulton të ketë paraqitur zyrtarisht nëpërmjet publikimit në faqen on-line, apo në forma të tjera të publikimit, grafikun e shlyerjes sipas radhës, të cilit gjithashtu duhet t'i përmbahet përmbaruesi, në përputhje me pikën 5 të po këtij udhëzimi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 34-53 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të MBZHR-së të marrin masa që shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes të bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të MBZHR, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut, në mënyrë që edhe përmbaruesi t'i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar, duke shmangur kështu kostot e përmbarimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Lidhur me rekomandimin e lënë, nga MBZHR janë reduktuar kostot e përmbaruesve privatë dhe janë pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve të dietave për periudhën objekt auditimi rezulton se pavarësisht se znj, B. K. (Drejtori i NJAB pranë MZHBR) nuk ka qenë pjesë e programeve të auditimeve, është shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës duke u ndryshuar përbërja e grupit të auditimit me autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën 606,430 lekë, në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 26.12.2011 dhe ligjin nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm”.

Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkt dhe vihet në lëvizje vetëm me urdhër të Ministrit, në përputhje me ligjin nr 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm” Kreu IV, neni 10, pika 2. Në urdhër shpenzimet e audituara nuk ka asnjë shkresë të Ministrit të MZHBR-së që të ndryshohet përbërja e grupeve të auditimit duke shtuar drejtorin e NJAB znj. B. K.

Gjithashtu nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se në 3 urdhër shpenzime është përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qendrën e punës (Tiranë) me datë 03.10.2020 dhe 10.10.2020 (e shtunë) dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën 27,500 lekë.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit”, i ndryshuar, kreu V, pika 2. Me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III, pika 36. Me rregulloren e brendshme të institucionit me nr.1984/1 datë 10.10.2019. Me Ligjin nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm” Kruen IV, neni 10, pika 2 “NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike” dhe Neni 14 pika c dhe ii dhe me VKM nr.511 datë 24.10.2002 i ndryshuar “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore” (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-60 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga titullari i MBZHR, të ngrihet një grup pune, për të evidentuar parregullsitë e konstatuara mbi urdhër shpenzimet për vlerën prej 633,930 lekë, e cila është përdorur pa ekonomikitet, efektivitet dhe efijencë.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Sipas rekomandimit është ngritur grupit i punës me urdhër nr. 434, datë 28.09.2022, “Për kryerje inspektimi, referuar rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Ky inspektim është kryer brenda afatit që ishte data 10 nëntor 2022, si dhe është dërguar pranë KLSH rezultatet me shkresë përcjellëse me nr. 5761/prot, datë 10.11.2022.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, **i rekomandohet** Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupit pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

Menjëherë

1.1 Rekomandim: Nëpërmjet një grupit pune, të vlerësojë shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të nis menjëherë procedurat për dhënien e masës disiplinore përkatëse “Vërejtje me shkrim” deri në “Shkarkim nga detyra/zgjidhje e kontratës së punës” për punonjësit të cilët referuar parregullsi të konstatuara rezultojnë me shkelje në kryerjen e veprimtarisë së tyre administrative e ligjore.

Qëndrimi i audituesit të KLSH: Lidhur me rekomandimin e lënë, nga MBZHR **nuk rezulton të jetë** nisur asnjë procedurë për dhënien e masës disiplinore përkatëse “Vërejtje me shkrim” deri në “Shkarkim nga detyra/zgjidhje e kontratës së punës” për punonjësit të cilët referuar parregullsi të konstatuara rezultojnë me shkelje në kryerjen e veprimtarisë së tyre administrative e ligjore.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe i pa zbatuar.

Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi me nr.1, datë 08.05.2023, nga grupi i auditimit, dorëzuar në MBZHR.

Konstatim: Konstatohet nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga MBZHR, edhe pse në planin e punës dhe shkresat dërguar në KLSH, të gjitha rekomandimet janë pranuar nga subjekti. Konkretisht e dhënë në mënyrë tabelore kemi:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	21	100
2	Pa pranuar	0	0
3	Pranuar	21	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	- Zbatuar	5	23,8
2	- Zbatuar pjesërisht	2	9,5
3	- Në proces	6	28,57
	- Pa zbatuar	8	38,09

Titulli i gjetjes:	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve
Situata:	Nga auditimi u konstatua se sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr. 528/7 Prot, datë 04.02.2022, janë lënë 21 rekomandime nga të cilat rezultoi se janë zbatuar 5 prej tyre ose 23,8% e totalit, zbatuar pjesërisht 2 ose 9,5 % e totalit, në proces – 6 rekomandime ose sa 28,57% e totalit dhe të pa zbatuara 8 rekomandime ose niveli i pa zbatueshmerisë është 38,09 %.
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, neni 30.
Efekti/Ndikimi:	Mos përmirësim i performancës së MBZHR në kryerjen e detyrave funksionale.
Shkaku:	Mos zbatim i saktë i Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim

	të nenit 15, shkronja “j”, neni 30.
Rëndësia:	E larte
Rekomandimi:	Të merren masa nga Titullari i institucionit që në të ardhmen të monitorohen me përgjegjësi dhe në kohë niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, për përmirësimin e treguesve dhe menaxhimin me ekonomicitet, efizienzë dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit ashtu edhe të burimeve njerëzore.

2.9 Çështje të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Në zbatim të pikës 9 “*Çështje të tjera të dala gjatë auditimit*” në zbatim të programit të auditimit nr. 1175/1 datë 11.01.2023”, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Shkresa e ardhur në KLSH me nr. 19. Prot, datë 05.01.2023, nga shoqëria “T.” në lidhje me MBZHR, mbi zbatimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë me objekt:

1-Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, për Lagunën e Patokut të datës 26.3.2015, për vlerësimin e bërë në kundërshtim me kriteret ligjore.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nën ligjore në vijim:

- Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar.

-Ligji nr. 103/2016, datë 20.10.2016, “*Për akua kulturën*”, i ndryshuar.

-Ligji nr.64/2012 PËR PESHKIMIN1 (ndryshuar me ligjin nr. 80/2017, datë 4.5.2017, nr. 4/2019, datë 7.2.2019)

- Udhëzimi i ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “*Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore*”.

Auditimit, u fokusua kryesisht në këto çështje:

☞ Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

☞ Menaxhimi i riskut

☞ Veprimtaritë e kontrollit

☞ Informim komunikimi

☞ Monitorimi

Lidhur me shkresën e ardhur në KLSH me nr. 19. Prot, datë 05.01.2023, nga shoqëria “T.” në lidhje me MBZHR, mbi zbatimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë me objekt:

1-Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, për Lagunën e Patokut të datës 26.3.2015, për vlerësimin e bërë në kundërshtim me kriteret ligjore.

2-Shfuqizimin e vendimit të ministrit për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, të datës 16.4.2015, grupi i auditimit të KLSH-së kërkoi informacion nëpërmjet shkresës protokolluar me nr. 211/1, datë 23.01.2023, “*Kërkesë për dokumentacion*”, me anë të së cilës u kërkua informacion mbi zbatimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, lidhur me çështjen me palë:

Paditës: Shoqëria "C." sh.p.k.

I paditur: Ish-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, për Lagunën e Patokut të datës 26.3.2015, për vlerësimin e bërë në kundërshtim me kriteret ligjore. Shfuqizimin e vendimit të ministrit për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, të datës 16.4.2015, ju informojmë si më poshtë:

Në lidhje me sa më sipër MBZHR sipas shkresës me nr 221/4, datë 27.01.2023, informon se:

1-Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me Vendimin nr. 4647, datë **25.09.2015**, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi Shoqëria "C." ShPK.;

- Shfuqizimin e vendimit datë 26.03.2015, të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Kërkesave, në MBZHRAU, për objektin ujqor "Laguna e Patokut, Kurbin";
- Shfuqizimin e vendimit datë 16.04.2015, të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Kërkesave, në MBZHRAU, për objektin ujqor "Laguna e Patokut, Kurbin" si dhe të vendimit të datës 16.04.2015, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për lënien në fuqi të këtij vendimi.

2- Gjykata Administrative e Apelit, me Vendimin Nr. 2860 (627), datë 29.09.2016, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 4647, datë 25.09.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3- Gjykata e Lartë ka vendosur në Dhomë Këshillimi:

- Mos pranimin e rekursit të palës së Paditur MBZHRAU.

Mbi zbatimin e vendimit gjyqësor nr. 682, datë 17.3.2022, konstatohet se MBZHR informohet nga kërkesa e kreditorit "C." ShPK. (praktika me nr. 3056), si dhe nga Studio Ligjore "S." (praktika me Nr. 3056/1), në datë 3.6.2022.

Me Urdhrin Nr. 306, datë 28.6.2022, të Ministrit është ngritur grupi i punës për ndjekjen e procedurës së zbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë Nr. 682, datë 17.3.2022 me përbërje:

- 1-z. R. K.- Kryetar
- 2- z. I. D.– anëtar
- 3- z. A. B.- anëtar
- 4- z. E. P.- anëtar

Në pikën 2 të këtij urdhri përcaktohen detyrat që do të kryejë grupi i punës, si më poshtë:

- a. Administrimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dokumentacionit të
- b. procedurës së konkurrimit për objektin ujqor "L.P.", lloji i aktivitetit "Peshkim Artizanal, Lagunor me Dajlan";
- c. Kryerjen e çdo procedure administrative dhe propozimin e veprimeve administrative që duhen ndjekur si detyrim që rrjedh nga vendimet e gjykatës dhe komunikimet me shoqëritë ose përfaqësuesit e tyre;
- d. ***Vlerësimin e ndikimit që vendimet e gjykatës kanë mbi veprimtarinë administrative të ndjekur dhe propozimin e veprimeve konkrete që duhen kryer;***
- ç. Draftimin e shkresave, akteve administrative dhe veprimeve të tjera administrative që duhet të kryhen me subjektet private ose me institucione të tjera;
- e. Kryerjen e çdo veprimi administrativ dhe sugjerimi për kryerjen e veprimeve administrative dhe inspektuese nga institucionet e varësisë së MBZHR-së.

Me shkresën nr. 3056/2, datë 14.7.2022, MBZHR (ish-MBZHRAU, debitori) ka proceduar me zbatimin e vendimit duke njoftuar Shoqërinë "T." ShPK., për zbatimin e vendimit. Subjektit i është kërkuar në zbatim të Vendimit Nr. 2860 (627), datë 29.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, duhet:

1. Ti dorëzojë Lagunën e Patokut Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
2. Të marrë të gjitha masat për hapjen e menjëhershme të Dajlanit si dhe;
3. Të largojë të gjitha rrjetat, mjetet apo veglat e peshkimit të vendosura prej saj në lagunë.

Me e mailin e datës 23.8.2022, kryetari i grupit të punës ngritur me Urdhrin nr. 306, datë 28.6.2022, zëvendësministri R. K., ka kërkuar nga DSHPA marrjen e masave në zbatim të vendimit gjyqësor.

Me shkresën Nr. 3056/3 prot., datë 22.7.2022 " , MBZHR informon Studion Ligjore "S.", se i është drejtuar Shoqërisë "T.", mbi zbatimin e titullit ekzekutiv.

Nga DSHPA janë kryer verifikimet përkatëse sipas Raport Inspektimit të datës 30.8.2022 ku shprehen se: *Gjatë kontrollit të ushtruar në Lagunën e Patokut, në subjektin Tekni-01, nuk u*

konstatua gjueti me rrjeta, me pinar, si dhe me mjete motorike, dajlanët ishin të hapur për të mos funksionuar. Laguna do të mbahet në monitorim të vazhdueshëm.

Sa i përket informacionit që kërkohet lidhur me shfrytëzimin dhe përdorimin e Lagunës së Patokut për periudhën kohore mars 2022 dhe në vazhdim, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i është drejtuar me shkresën Nr. 212/2 prot., datë 26.1.2023 “Kërkesë për informacion” Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akua kulturës, nga ku në shkresën me nr. 26/1 prot., datë 26.1.2023 “Kthim përgjigje”, DSHPA konfirmon se aktualisht nuk është hapur procedure e re për dhënien në shfrytëzim të kësaj lagune.

Nisur nga kjo ankesë, grupi i auditimit auditoi në mënyrë të përgjithshme veprimtarinë dhe përputhshmërinë e Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR si dhe DSHPA në varësi të saj, nga ku u konstatua se:

Gjatë auditimit nga informacioni i marrë nga sektori i buxhetit në MBZHR u konstatua se MBZHR ka lidhur kontrata për aktivitet peshkimi me 5 subjekte fizike, dhe 8 subjekte juridike që prej vitit 2012 deri me vitin 2020 për një sipërfaqe prej 10,140 ha. Nga këto, deri më 31.12.2022, një kontratë është shfuqizuar dhe një është në proces gjyqësor. Nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit është vënë në dispozicion baza e të dhënave të kontratave të lidhura për peshkim në laguna i cili nuk përputhet me të dhënat e aparatit të MBZHR. Kështu konstatohet se nga MBZHR janë lidhur 21 kontrata për peshkimin artizanal në laguna.

Këto kontrata janë të regjistruara në regjistër të veçantë në administrim nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit njësi varësie e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarisë, mbrojtjes së bimëve dhe peshkimit në MBZHR, por nuk janë pjesë e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR, si kontrata të lidhura me palë MBZHR, duke bërë që këto kontrata të lidhura me palë të tjera të krijojnë risk në mos raportim të problematikave që mund të lidhen me to si detyrë e një drejtorie në varësi të aparatit të MBZHR.

Veprimi i mësipërm cenon përgjegjshmërinë menaxheriale sipas përcaktimit të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Pika 9. “Përgjegjshmëria menaxheriale” është detyrimi i menaxherëve të njësisë, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera. Neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, Pika 4/ ë). Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar. Neni 12, Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, “Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi”.

Për monitorimin e kontratave të lidhura zbatohet Udhëzimi i ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore”. Në zbatim të tij hartohet plani i veprimit të Sektorit të Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA). Për monitorimin e këtyre kontratave në periudhën në auditim është hartuar plani i veprimit me nr. 5933/1, datë

18.11.2022 “Për monitorimin e kontratave për ushtrimin e aktivitetit artizanal në lagunat bregdetare”.

Gjatë auditimit u konstatua se nuk janë hartuar plane veprimi vjetore në lidhje me monitorimin e kontratave të lidhura në laguna si dhe nuk ka një raport vjetor në lidhje me monitorimin e këtij sektori, apo raportim nga DPSHA në MBZHR në lidhje me këtë monitorim. Gjatë auditimit u konstatuan raporte monitorimi të veçanta për monitorimin e vetëm 2 (dy) kontratave nga 21 të lidhura ose 10% të tyre, duke konstatuar jo efikasitet të Sektorit të Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA). Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të funksionimit të MBZHR dhe **qëllimin e Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës**: “koordinimi i punës për hartimin e implementimin e politikave të peshkimit dhe akuakulturës dhe sigurimin e qëndrueshëm të sektorit, *si dhe monitorimin e kryerjes së veprimit nga subjektet private*” dhe detyrën dh) të Sektorit të Monitorimit, përpunimit dhe analizës së të dhënave: “**Ndjekja dhe vëzhgimi i aktivitetit të peshkimit** me qëllim garantimin që legjisllacioni, kushtet hyrjes në burime dhe masat menaxhuese të jenë zbatuar”.

Mungesa e planeve vjetore të monitorimit bie në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës: a). Harton objektivat, strategjitë dhe politikat specifike të peshkimit detar, në ujëra të brendshme dhe akuakulturë dhe ë) harton politika menaxhuese të lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre. Dhe detyrat pika ç) e Sektorit të Monitorimit, përpunimit dhe analizës së të dhënave: “në zbatim të nenit 26, të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar është përgjegjës *për hartimin dhe ndjekjen e planeve të zbatimit të peshkimit dhe akuakulturës*”.

Nga informacionet verbale u konstatua se as DPSHA dhe as MBZHR nuk verifikon numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, sipas plan biznesit të dakordësuar në kontratë, në kundërshtim me Udhëzimin e ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akua kulturën tokësore dhe ujore”, të ndryshuar, Pika 7: “*Struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DPSHA kontrollojnë dhe verifikojnë numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, në përputhje me nivelin e punësimit të deklaruar në plan biznes*”.

Të ardhurat e këtyre kontratave i arkëton DPSHA, njësi varësie e MBZHR. Për vitin 2021 sipas informacionit të marrë nga sektori financës konstatohet se të ardhurat e arkëtuara nga subjektet e bregdetit të cilat monitorohen nga sistemi blue-box kapin vlerën 14,284,000 lekë, ndërsa për vitin 2022 vlerën 14,561,000 lekë.

Nga sa më sipër si rezultat i mungesës së monitorimit periodik të kontratave të lidhura ndërmjet MBZHR-së dhe subjekteve, planeve konkretë të veprimit, kjo Drejtori rezultoi jo efiçiente.

Titulli i gjetjes:	Trajtim i ankesës së subjektit Tenki -01, dhe performanca e Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akua kulturës.
Situata:	Lidhur me shkresën e ardhur në KLSH me nr. 19. Prot, datë 05.01.2023, nga shoqëria “T.” në lidhje me MBZHR, mbi zbatimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë me objekt: 1-Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, për Lagunën e Patokut të datës 26.3.2015, për vlerësimin e bërë në kundërshtim me kriteret ligjore. 2-Shfuqizimin e vendimit të ministrit për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, të datës 16.04.2015, grupi i auditimit të KLSH-së kërkoi informacion nëpërmjet shkresës protokolluar me nr. 211/1, datë 23.01.2023, “ <i>Kërkesë për</i>

	<p><i>dokumentacion</i>”, si dhe auditori veprimtarinë dhe përputhshmërinë e Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR si dhe DSHPA në varësi të saj, nga ku u konstatua se: MBZHR ka lidhur kontrata për aktivitet peshkimi me 5 subjekte fizike, dhe 8 subjekte juridike që prej vitit 2012 deri me vitin 2020 për një sipërfaqe prej 10,140 ha. Nga këto, deri më 31.12.2022, një kontratë është shfuqizuar dhe një është në proces gjyqësor. Nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit është vënë në dispozicion baza e të dhënave të kontratave të lidhura për peshkim në laguna i cili nuk përputhet me të dhënat e aparatit të MBZHR. Kështu konstatohet se nga MBZHR janë lidhur 21 kontrata për peshkimin artizanal në laguna.</p> <p>Këto kontrata janë të regjistruara në regjistër të veçantë në administrim nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit por nuk janë pjesë e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR, si kontrata të lidhura me palë MBZHR, duke bërë që këto kontrata të lidhura me palë të tjera të krijojnë risk në mos raportim të problematikave që mund të lidhen me to si detyrë e një drejtorie në varësi të aparatit të MBZHR.</p> <p>Nuk janë hartuar plane veprimi vjetore në lidhje me monitorimin e kontratave të lidhura në laguna si dhe nuk ka një raport vjetor në lidhje me monitorimin e këtij sektori, apo raportim nga DPSHA në MBZHR në lidhje me këtë monitorim. Gjatë auditimit u konstatuan raporte monitorimi të veçanta për monitorimin e vetëm 2 (dy) kontratave nga 21 të lidhura ose 10% të tyre, duke konstatuar in efencë të Sektorit të Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA). Mungesa e planeve vjetore të monitorimit bie në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës: a). Harton objektivat, strategjitë dhe politikat specifike të peshkimit detar, në ujëra të brendshme dhe akuakulturë dhe ë) harton politika menaxhuese të lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre. Dhe detyrat pika ç) e Sektorit të Monitorimit, përpunimit dhe analizës së të dhënave: “në zbatim të nenit 26, të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e planeve të zbatimit të peshkimit dhe akuakulturës”.</p> <p>Nga informacionet verbale u konstatua se as DPSHA dhe as MBZHR nuk verifikon numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, sipas plan biznesit të dakordësuar në kontratë, në kundërshtim me Udhëzimin e ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akua kulturën tokësore dhe ujore”, të ndryshuar, Pika 7: “Struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DPSHA kontrollojnë dhe verifikojnë numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, në përputhje me nivelin e punësimit të deklaruar në plan biznes”. Nga sa më sipër si rezultat i mungesës së monitorimit periodik të kontratave të lidhura ndërmjet MBZHR-së dhe subjekteve, planeve konkretë të veprimit, kjo Drejtori rezultoi jo eficientë.</p>
Kriteri:	Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe

	kontrollin”, të ndryshuar, Pika 9. "Përgjegjshmëria menaxheriale", Udhëzimin e ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akua kulturën tokësore dhe ujore”, të ndryshuar, Pika 7, të nenit 26, të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar.
Efekti/Ndikimi:	Mos përmirësim i performancës së MBZHR në kryerjen e detyrave funksionale.
Shkaku:	Mos zbatim i detyrave funksionale nga personat përgjegjës dhe mungesë menaxheriale e strukturave drejtuese në përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të merren masa nga Titullari i institucionit që në të ardhmen të monitorohen me përgjegjësi dhe në kohë veprimtaria e kryer nga Institucionet e varësisë si dhe Drejtoritë në MBZHR, konkretisht për Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR, të hartohet regjistri i kontratave si pjesë integrale e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR. 2. Të hartohen plane monitorimi vjetorë dhe mujorë nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA) dhe të miratohen nga Sekretari I Përgjithshëm. 3. Të raportohet në mënyrë periodike mbi shfrytëzimin e lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre, për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të të ardhurave që këto të fundit gjenerojnë në buxhetin e shtetit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua një nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga MBZHR, të lëna nga KLSH sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së me nr. 528/7 Prot, datë 04.02.2022, ku nga 21 rekomandime,(të pranuar nga MBZHR) rezultoi se janë zbatuar 5 prej tyre ose 23,8% e totalit, zbatuar pjesërisht 2 ose 9,5 % e totalit, në proces – 6 rekomandime ose sa 28,57% e totalit dhe të pa zbatuara 8 rekomandime ose niveli i pa zbatueshmërisë është 38,09 %, veprime që sjellin mos përmirësim të performancës së MBZHR në kryerjen e detyrave funksionale dhe janë në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, neni 30. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 316-347 të Raportit të auditimit).*

1.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masa që në të ardhmen të monitorojë me përgjegjësi dhe në kohë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, për përmirësimin e treguesve dhe menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit ashtu edhe të burimeve njerëzore.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi: MBZHR të marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për personat e ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të brendshëm të MBZHR-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se nga auditimi i urdhër shpenzimeve të viteve nën auditim, për vitin 2021 nuk është bërë regjistrimi në ditarin e bankës për 11 nga 62, ose 18% e urdhër shpenzimeve sipas radhës së regjistrimit apo numrit sekuencial të gjeneruar nga SIFQ, për vitin 2022 nuk është ruajtur kjo radhë për 15 nga 54 ose 28% e urdhër shpenzimeve, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE, nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” .

- Gjatë auditimit u konstatua se urdhër shpenzimet e mësipërme nuk ruajnë të njëjtën radhë ekzekutimi, sipas rregullit hyrja e parë dalja e parë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Pika 8.

- Gjatë auditimit u konstatua se kryesisht urdhër shpenzimet pas datës 29 dhjetor janë firmosur elektronikisht nga NA dhe proceduar për pagesë nga dega e thesarit në muajin Janar të vitit pasardhës përveç urdhër shpenzimit me nr. 658/ sekuencial 2101258, datë 31.12.2021 me objekt “Punime, rikonstruksion i godinës së QTTB Fushë Krujë dhe ndërtim godine” me vlerë 9,735,907, i cili sipas printimit konstatohet se është firmosur elektronikisht nga NA dhe nga dega e thesarit më datë 31.12.2021. Sipas specifikave të udhëzimit të MFE me nr. 25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021” Pika 19. (Trajtuar më hollësisht në faqet 147-167, të Raportit të auditimit)

2.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat që në likuidime/ urdhër shpenzime të ruajë të njëjtën radhë kronologjike me numrin elektronik sekuencial të vendosur nga Sistemi Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në funksion të respektimit dhe reflektimit të saktë të tyre në ditarin e bankës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të urdhër shpenzimeve u konstatua se MBZHR është në proces gjyqësor në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër investitorit italian V.I. në lidhje me ndërmarrjen A.-G. ShPK, e krijuar në vitin 1992 midis investitorëve italianë të V. I. dhe ish NB Gosë, Kavajë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MBZHR në lidhje me këtë çështje u konstatua se nga Avokatura e shtetit si përfaqësuese e MBZHR në përputhje me VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës, ka lidhur dy kontrata, me O. S. LLP dërguar nga Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2235/27, datë 7.11.2018 “Kontrata e përfaqësimit e datës 6.11.2018” me detyrim total 750,000 euro, si dhe me HKA G. L. për ofrimin e shërbimeve të konsulencës “Kontrata e nënshkruar me firmën e ekspertëve HKA G. L.”, dërguar me shkresën nr. 1122/14, datë 5.8.2022, në vlerën 385,000 paund.

Prej vitit 2018 të nisjes së procesit gjyqësor ndërkombëtar deri në fund të periudhës së auditimit, MBZHR ka kryer likuidimin total prej 1,179,500 euro, nga të cilat shpenzimet administrative në vlerën €319,500, shpenzimi kundrejt O. S. në vlerën €650,000 , dhe shpenzimi kundrejt HKA G. L. në vlerën €210,000. Ky proces gjyqësor e ka vënë MBZHR në vështirësi financiare për likuidim, pjesërisht prej mos planifikimit të kërkesave buxhetore referuar parashikimeve të kontratës së parë të lidhur prej vitit 2018 dhe pjesërisht prej detyrimit të panjohur e të vënë në dijeni nga Avokatura e Shtetit për sa i përket kostove administrative të procesit dhe kontratës së re të lidhur me ekspertin në vitin 2022.

Për likuidimet e detyrimeve të mësipërme përgjatë vitit 2022 u konstatua përdorimi i fondeve të lira nga programet e tjera buxhetore.

Nga planifikimi buxhetor për vitin 2022-2024 në fazën e dytë është kërkuar rialokim në zërin shpenzime korrente të programit “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në shumën 20 milion lekë, prej programeve të tjera në funksion të likuidimit të detyrimeve gjyqësore.

Megjithëse likuidimi i detyrimeve të mësipërme ka kërkuar respektim të afateve të caktuara nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë mosrespektim të dispozitave ligjore në lidhje me disiplinën buxhetore duke lejuar përdorim të fondeve të lira të programeve të tjera për një produkt të programit, “Planifikim, menaxhim, administrim” në kundërshtim me Ligjin 9936, datë

26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 44 a) dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Pika 73.a).

Përdorimi i fondeve të lira të programeve të tjera në funksion të realizimit të shpenzimit korrent për programin “Planifikim, menaxhim, administrim” megjithëse praktikisht nuk është bërë me ri alokim, pasi janë përdorur në programet respektive, ai faktikisht përfaqëson një ri alokim, pasi përfaqëson përdorim të fondeve të një programi për një program tjetër, duke cenuar “veprimtarinë e programeve buxhetore”, e cila sipas dispozitës bazë ligjore, përfaqëson tërësinë e veprimtarive, që kryhen në kuadër të një programi, për realizimin e një produkti. Realizimi i mësipërm i fondeve ka cenuar produktet përkatëse të secilit program dhe përdorimi i tyre për produkte të tjera të pa miratuara ka lejuar shpenzime të cilat duhet të kryhen vetëm me miratim nga VKM. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 147-167, të Raportit të auditimit)*

3.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masa në planifikimin e duhur buxhetor në lidhje me procesin e arbitrazhit, si dhe të mos përdorë fonde të lira për realizimin e produkteve jashtë programit pa miratimin e duhur ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR është autoriteti përgjegjës për 3 (tre) kontratat koncesionare si në kontratën e koncensionit datë 07.01.2009, miratuar me Ligjin nr. 10082, datë 23.2.2009 “Për miratimin e kontratës së koncensionit të formës “BOT” për kultivimin e ullirit, në një sipërfaqe deri në 1000 ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevindh dhe Gosë, Kavajë, ndërmjet MBZHR si Autoritet Kontraktues dhe “A.” sha, Tiranë; -Në kontratën miratuar me Vendimin Nr. 625, datë 11.9.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Marrëveshjes së Koncesionit të formës “ROT” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “S.” ShPK për Hidrocentralin e Gjançit” dhe -Në kontratën e koncensionit nr. 8618, datë 14.08.2014 caktuar me VKM nr. 775, datë 04.12.2019, MBZHR si Autoritet Kontraktues përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës koncesionare me Shoqërinë “B.E. O.” ShPK (Koncensionari) për përdorimin e ujit të burimit “Sasaj, Bunec” Lukovë, Sarandë. Këto kontrata koncesionare që monitorohen nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave në MBZHR nuk rezultojnë të regjistruara në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 29 e 31/b. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 147-167, të Raportit të auditimit)*

4.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në pasqyrimin në regjistrin e aktiveve të kontratave koncesionare për të cilat është autoriteti përgjegjës për ndjekjen dhe raportimin, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Lidhur me shkresën e ardhur në KLSH me nr. 19. Prot, datë 05.01.2023, nga shoqëria “T.” në lidhje me MBZHR, mbi zbatimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë me objekt:

1- Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, për Lagunen e Patokut të datës 26.03.2015, për vlerësimin e bërë në kundërshtim me kriteret ligjore.

2- Shfuqizimin e vendimit të ministrit për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, të datës 16.04.2015.

Nga auditimi i veprimtarisë dhe përputhshmërisë së Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR si dhe DSHPA në varësi të saj, rezultoi se:

MBZHR ka lidhur kontrata për aktivitet peshkimi me 5 subjekte fizike, dhe 8 subjekte juridike që prej vitit 2012 deri me vitin 2020 për një sipërfaqe prej 10,140 ha. Nga këto, deri më 31.12.2022, një kontratë është shfuqizuar dhe një është në proces gjyqësor. Nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit

është vënë në dispozicion baza e të dhënave të kontratave të lidhura për peshkim në laguna i cili nuk përputhet me të dhënat e aparatit të MBZHR, ku rezultoi se janë lidhur 21 kontrata për peshkimin artizanal në laguna. Këto kontrata janë të regjistruara në regjistrin të veçantë në administrim nga Sektori i Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit por nuk janë pjesë e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR, si kontrata të lidhura me palë MBZHR, duke bërë që këto kontrata të lidhura me palë të tjera të krijojnë risk në mos raportim të problematikave që mund të lidhen me to si detyrë e një drejtorie në varësi të aparatit të MBZHR.

Nuk janë hartuar plane veprimi vjetore në lidhje me monitorimin e kontratave të lidhura në laguna si dhe nuk ka një raport vjetor në lidhje me monitorimin e këtij sektori, apo raportim nga DPSHA në MBZHR në lidhje me këtë monitorim. Gjatë auditimit u konstatuan raporte monitorimi të veçanta për monitorimin e vetëm 2 (dy) kontratave nga 21 të lidhura ose 10% të tyre, duke konstatuar jo efikasitet të Sektorit të Monitorimit, Përpunimit të të dhënave në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Sektorit të Inspektimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA). Mungesa e planeve vjetore të monitorimit është në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës e cila ka detyrë të hartojë objektivat, strategjitë dhe politikat specifike të peshkimit detar, në ujëra të brendshme dhe akuakulturë si dhe politika menaxhuese të lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre por edhe në kundërshtim me nenin 26, të Ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar ku DSHPA është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e planeve të zbatimit të peshkimit dhe akuakulturës”.

U konstatua se as DPSHA dhe as MBZHR nuk verifikon numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, sipas plan biznesit të dakordësuar në kontratë, në kundërshtim me Udhëzimin e ministrit të MBZHR nr. 11, datë 10.09.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akua kulturën tokësore dhe ujore”, të ndryshuar, pika 7 ku është e përcaktuar qartë që struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DPSHA kontrollojnë dhe verifikojnë numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, në përputhje me nivelin e punësimit të deklaruar në plan biznes”. Nga sa më sipër si rezultat i mungesës së monitorimit periodik të kontratave të lidhura ndërmjet MBZHR-së dhe subjekteve, planeve konkretë të veprimit, kjo Drejtori rezultoi jo efiçente. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 347-352, të Raportit të auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i institucionit që në të ardhmen të monitorohen me përgjegjësi dhe të analizohen në kohë veprimtaria e kryer nga Institucionet e varësisë si dhe Drejtoritë në MBZHR, konkretisht për Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akua Kulturës në MBZHR, të hartohet regjistri i kontratave si pjesë integrale e regjistrit të aktiveve të aparatit të MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2 Rekomandimi: Të hartohen plane monitorimi vjetorë dhe mujorë nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DPSHA) dhe të miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm në MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.3 Rekomandimi: Të raportohet në mënyrë periodike dhe vjetore mbi shfrytëzimin e lagunave bregdetare dhe mbrojtjen e ekosistemeve të tyre, për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të të ardhurave që këto të fundit gjenerojnë në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektorit të Bashkëfinancimit, Partneritetit dhe Monitorimit të kontratave rezultoi se MBZHR në zbatim të legjislacionit në fuqi, administron tokat bujqësore ku nëpërmjet qiradhënies së tyre sigurohen të ardhura dytësore në buxhetin e shtetit. Nga kryqëzimi i të dhënave të mësipërme me regjistrin e aktiveve, si dhe librat e kontabilitetit evidentohet se edhe

për periudhën 2021-2022, këto toka bujqësore që MBZHR administron, në sipërfaqe totale 19,033.95 ha, ashtu si në auditimin e mëparshëm, nuk janë të regjistruara në pasqyrat financiare duke cenuar transparencën dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave pasurore në administrim të MBZHR, si dhe në regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR, në kundërshtim me Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Pjesa II, Pika 5 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Neni 26 dhe Neni 31. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në regjistrimin e menjëhershëm të tokave bujqësore në Agjencinë e Kadastrës dhe më tej në pasqyrat financiare dhe regjistrin e aktiveve për të pasqyruar sa më saktë gjendjen e saj pasurore në administrim dhe evidentimin e të ardhurave dytësore që këto qiradhënie gjenerojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit konstatohet se nga 51 kontrata që janë aktualisht të lidhura, 38 prej tyre ose 75% kanë detyrime në pagimin e qerasë në shumën totale 64,679,949 lekë, detyrim i cili për datën 31.12.2020 rezulton me një shumë totale prej 68,903,834 lekësh, ndërsa për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 paraqitet në shumën 29,043,882 lekë (në vitet në auditim janë bërë likuidime të detyrimeve të mbartura të qirasë).

Për mungesë të realizimit të planit të investimit MBZHR deri më 31.12.2022 ka vendosur gjoba në shumën 427,044,994 lekë, kryesisht gjatë auditimit në terren. Nga 51 kontratat ende në zbatim konstatohet se 83% e detyrimit për mos realizim të investimit i korrespondon 3 (tre) shoqërive, “B.A. I. ShPK” me 66% të detyrimit kundrejt detyrimit total, “P.I.” ShPK me 11% të detyrimit dhe shoqëria “F. A.” ShPK me 6% të detyrimit kundrejt detyrimit total që subjektet të cilët përdorin tokat bujqësore kanë ndaj MBZHR.

Nga shumat e mësipërme për mos pagim qiraje dhe penalitet për vonesën në pagim në shumën totale 64,679,949 lekë më datë 31.12.2022, për gjoba të mosrealizimit të investimit në shumën totale 427,044,994 lekë, konstatohet se vlera totale 491,724,943 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve palë të kontratave të tokave bujqësore në përdorim, të cilat nuk janë të kontabilizuara në pasqyrat financiare të aparatit të MBZHR, Llogaria 411 “Klientë e llogari të ndryshme” dhe llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” rezultojnë në vlerën 0 lekë për vitin 2022, dhe krahasuar me vitin paraardhës nuk kanë pësuar ndryshime. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8/ 2018, Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 7/c.

Megjithëse kundrejt MBZHR rezultojnë subjekte debitore me detyrimin për të likuiduar qiranë sipas kontratave të lidhura nga MBZHR në shumën 491,724,943 lekë deri në fund të vitit 2022, këto nuk janë pasqyruar në llogarinë 411/ 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke denaturuar pasqyrat financiare me këtë shumë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të auditimit)*

7.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat e menjëhershme në raportimin e duhur financiar të listës së debitorëve në lidhje me tokat bujqësore, duke bërë regjistrimin në pasqyrat financiare si dhe regjistrin e aktiveve të aparatit të MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e mëparshëm të KLSH sipas programit të Auditimit nr.528/1 prot datë 14.05.2021, i ndryshuar me shkresën nr.528/2 prot datë 25.05.2021, KLSH ka rekomanduar që MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. Ky rekomandim jo vetëm që nuk është realizuar, por konstatohet se ky sektor bazuar në Urdhrin e Kryeministrit

nr.88, datë 20.05.2022 ka ngritur strukturën në MBZHR me shkresën nr. 1830/264, datë 04.07.2022 në të cilën rezulton se Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve, Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave në MBZHR është zvogëluar në numër (një përgjegjës dhe 2 specialistë), duke ndikuar në mos përmirësimin e performancës së punës të këtij sektori me gjithë problematikat e konstatuara ndër vite në monitorimin e tokave bujqësore. Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave rezulton me ngarkesë të lartë, referuar numrit të kontratave për monitorim dhe detyrave të tjera që lidhen me administrimin e tokës bujqësore pronë e MBZHR-së si dhe problematikave të konstatuara nga ky auditim. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse, Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën”, i ndryshuar.

Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njerëzore, ku në të njëjtën kohë për disa procese pune për vlerësimin e tokës në terren, përllogaritjen e vlerës së çmimit të qerasë vjetore, për hartimin e kontratës së qirasë si dhe monitorimin e tyre, janë vetëm 2(dy) punonjës. Kjo ka sjellë efektivitet të ulët të monitorimit të kontratave të qirave të tokave bujqësore, veprime në kundërshtim me VKM nr.373 datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” kreu VII “Monitorimi i kontratave”, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: MBZHR, të vlerësojë me prioritet burimet njerëzore të nevojshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, të analizojë nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. MBZHR të marrë masa mbi shtimin e numrit të punonjësve në sektorin e Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave, në funksion të mbarëvajtjes së punës.

Në vijimësi

8.2 Rekomandimi: Nga titullari i MBZHR, për realizimin e procedurës së dhënies me qira të tokave bujqësore, të vendosen zyrtarët përgjegjës në grupet e punës duke mbajtur parasysh parimet e kontrollit të brendshëm dhe vepruar në mënyrë të tillë, që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin sipas kërkesave që dikton ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR ka në administrim të saj fondin e tokës bujqësore për qiradhënie prej 19,033.95 ha, kaluar me aktet e nënligjore si më poshtë:

- VKM nr. 45, datë 29.01.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 18,076 Ha.

- VKM nr. 995, datë 9.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926,55 Ha.

- VKM nr. 142, datë 24.2.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore” ka

kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 31,4 Ha.

Nga vendimet e mësipërme është konstatuar se fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël, i dhënë në bazë të VKM-së nr. 45/2014, “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” *nuk është shoqëruar me një kopje të listës së inventarit për pasuritë, të njehsuar me origjinalin, si pjesë e kësaj VKM.* Nga MBZHR me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019, i është kërkuar Këshillit të Ministrave, por nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë. Në kushtet kur lista e inventarit të ngastrave që do të jepen me qira ka munguar dhe vijon të mungojë deri në fund të auditimit, del e paqartë se si strukturat përgjegjëse për administrimin e tokave bujqësore në MBZHR, bëjnë shpalljen publike dhe përditësimin e saj. Mungesa e listës së pasurive të VKM nr. 45/2014 konfirmon faktin që MBZHR nuk ka të saktësuar sipërfaqen e tokës që ka në administrim, pasi mungesa e një liste inventari të tokave bujqësore është e mbartur që prej fillimit të dhënies në përdorim të tokave bujqësore deri në fund të periudhës në auditim, në drejtim të së cilës struktura përgjegjëse në MBZHR nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për regjistrimin e sipërfaqes në pronësi. Në vijim MBZHR nuk ka në dispozicion një regjistër të ngastrave të tokës bujqësore të cilat janë në administrim të saj, në kundërshtim të me Kreun II “Objekti i qiradhënies”, të VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, duke krijuar riskun e pasaktësive në lidhjen e kontratave të qirasë.

Nga sipërfaqja e tokës në administrim të MBZHR, për periudhën 2013-2021 është dhënë me qira sipërfaqja prej 2,519 ha e 7,366 m². Për periudhën 2021-2022 është dhënë me qira sipërfaqja prej 107.61 ha. Sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për t’u dhënë me qira është 15,896 ha e 3,488 m², ose 83% e sipërfaqes gjithsej. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa, për përditësimin, inventarizimin, dhe regjistrimin e gjithë fondit të tokës bujqësore që ka në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se MBZHR, për periudhën 2013 -2022 ka lidhur 54 kontrata qiradhënie toke bujqësore, nga të cilat 45 kontrata janë aktive deri në fund të periudhës së auditimit dhe vlerësohen sipas parashikimeve kontraktuale, 3 (tre) kontrata janë zgjidhur, 3 (tre) kontrata janë në proces gjyqësor, për 1 (një) kontratë është kërkuar zgjidhja vullnetare nga subjekti dhe për 2 (dy) kontrata ka përfunduar procesi gjyqësor. Nga kontratat aktive vetëm 1 kontratë është lidhur për periudhën nën auditim, konkretisht në vitin 2021. Në lidhje me këto kontrata megjithëse MBZHR mban një regjistër të tyre formal (ex-cel), i cili nuk është i miratuar si nga forma dhe përmbajtja me udhëzim të Ministrit, në kundërshtim me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, Kreu VII, pika 4;

- Nga 45 kontratat aktive u përzgjedhën për auditim 21 kontrata, ose 47% e tyre. Nga auditimi, në lidhje me monitorimin e kontratave nga Sektori Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se ky sektor ka monitoruar:

- Për vitin 2019, 8 kontrata, nga 40 kontrata në fuqi, ose 20% e kontratave.

- Për vitin 2020, 6 kontrata nga 50 kontrata në fuqi, ose 12% të kontratave.

- Për vitin 2021, 10 kontrata nga 51 kontrata gjithsej, ose 19,6 % të kontratave.

- Për vitin 2022, 14 kontrata nga 51 gjithsej (3 kontrata në proces gjyqësor), ose 27 % e kontratave.

Gjatë auditimit të kontratave të qiradhënies së tokave bujqësore u konstatua se MBZHR nuk disponon një plan vjetor për monitorimin e kontratave, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve, nuk u gjendën raporte për çdo vit për monitorimin e kontratave, kjo në kundërshtim me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, Kreu VII, pika 5. Gjithashtu për monitorimet e kryera nga sektori u konstatua se nuk kishte të dhëna të hollësishme për kontratat e monitoruara në lidhje me gjendjen faktike të investimeve të kryera dhe kulturave të mbjella duke e justifikuar me dokumentet përkatëse, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjeve, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat e nevojshme për miratimin e regjistrit për kontratat e qirasë, në të cilin të mirë përcaktohet forma, përmbajtja si dhe të evidentohet në një kolonë të veçantë monitorimi i secilës kontratë në fund të çdo viti ushtrimor.

Në vijimësi

10.2 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat në hartimin e një plani vjetor në fillim të çdo viti për monitorimin e kontratave. MBZHR të hartojë dhe standardizojë procedurat për ndjekjen dhe monitorimin e kontratave, ku të pasqyrohet dokumentacioni që duhet të plotësohet gjatë monitorimit, për argumentimin e investimeve kapitale të kryera si dhe për shpenzimet për përmirësimin e tokës.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 21 kontratave me objekt për dhënie me qira të tokave bujqësore për periudhën në auditim gjatë procesit të analizimit dhe monitorimit të tyre u konstatua se dosjet e kontratave të dhëna me qira janë të pa protokolluara, pa fletë inventari në të cilin të evidentohet dokumentacioni pjesë e dosjes, duke krijuar riskun e mungesës, humbjes apo ruajtjes së radhës kronologjike të tyre. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 24 dhe 44 i Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: MBZHR të marrë masat për protokollimin e të gjitha procesverbaleve të monitorimit të kontratave të qirasë dhe procesverbalet të nënshkruhen dhe nga ana e qiramarrësit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të kontratave të qirasë u përzgjedhën 21 kontrata kundrejt 51 kontratave në total. Nga auditimi i dosjeve të kontratave të qiradhënies, edhe për periudhën 2021 - 2022 u konstatua një vlerë e ndryshme e investimeve kapitale të parashikuara në Plan Biznes nga vlera e parashikuar në Shtojcën 2 të Kontratës së Qirasë, për 8 (tetë) subjektet më poshtë:

- Shoqëria “P.I.” ShPK; vlera e investimit e përcaktuar në plan biznes është vlera 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët).

- Shoqëria “B.A. I.” ShPK; vlera e investimit sipas plan biznesit të paraqitur në konkurim është 2,863,542,500 lekë, ndërsa sipas shtojcës 2 të kontratës vlera e investimit është 2,128,000,000 lekë, ose 735,542,500 lekë më pak.

- Shoqëria “K. D.” ShPK; vlera e investimit sipas plan biznesit të paraqitur në konkurim është përcaktuar 141,500,000 lekë dhe sipas shtojcës 2 të kontratës 137,100,000 lekë, ose 4,400,000 lekë më pak.

- Shoqëria “B. N. F.” shpk; vlera e investimit sipas shtojcës 2 të kontratës është përcaktuar 33,740,000 lekë por ka mospërputhje dhe paqartësi në plan biznes, (në disa pjesë përshkruhet se vlera e investimit është 887,000 Euro ose 124,650,110 lekë dhe në disa pjesë vlera e investimit rezulton 607,000 Euro ose 85,301,710 lekë).

- Shoqëria “B.P.” ShPK; vlera e investimit është 79,390,000 Lekë sipas planit të biznesit por sipas tabelave përmbledhëse rezulton 49,520,000 lekë (ka mospërputhje të shumta midis zërave të investimit, vlera të investimit dhe afateve të realizimit të investimeve) dhe 35,800,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës.

- Person fizik L. Z.; vlera e investimit në planin e biznesit është përcaktuar 66,340,000 lekë (ka probleme në planin e biznesit ku janë futur shpenzime të tjera që nuk kanë vlerë për llogaritjen e investimeve) dhe 36,640,000 lekë sipas shtojcës 2 të kontratës, ose 29,700,000 lekë më pak.
- Person fizik P.Ç., “Kantina Ç.”; Vlera e investimeve, sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim është 154,286,259 lekë, ndërsa vlera e investimeve sipas shtojcës 2 të kontratës është 120,900,000 lekë dhe (ose 33,386,259 lekë më pak).
- Shoqëria “A. I. G.” ShPK; vlera e investimit sipas planit fillestar të biznesit paraqitur në procedurat e ankandit është 482,178,240 lekë ndërsa sipas shtojcës 2 të kontratës së amenduar është 254,627,468 lekë, ose 227,550,772 lekë më pak.

MBZHR rezulton të mos ketë ngritur në vazhdimësi një grup pune për vlerësimin dhe identifikimin e kontratave që kanë problematikë të mos përputhjes së vlerës së investimit të parashikuar në plan biznes me atë të lidhur në kontratë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8318, dt.01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar; Neni 15, dhe VKM nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, Pikat 8 dhe 9. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e kontratave me problematikë në mospërputhjen e vlerës së investimit në plan biznes krahasuar kjo me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë. Në vijim të mundësohet dakordësia për amendim kontrate midis palëve me qëllim përputhshmërinë e investimit real me atë të parashikuar në kontratë sipas investimeve të kryera në terren dhe përshtatjen e afatit të qiradhënies sipas plan biznesit të ri.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të kontratave të dhënies më qira të tokave bujqësore u konstatua se megjithëse janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit, janë hasur probleme ndër vite me zaptimin e tyre nga palë të tretë pa tagra pronësie dhe për pasojë nuk ka një shfrytëzim të plotë të ngastrave të tokës të dhënë me qira. Kjo problematikë është konstatuar në dosjet e kontratave me subjektet më poshtë:

-Në kontratën nr. 4040 prot, Nr.793 Rep, nr.473 Kol, datë 12.5.2015, shoqëria “B.N.” në të cilën qiramarrësi nuk ka kryer investimet sipas plan biznesit të parashikuara, pasi sipërfaqja prej 5 ha është e zaptuar nga fermerë të ndryshëm dhe nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi. Gjithashtu një pjesë rreth 28,84 ha e sipërfaqes, e cila ndodhet pranë një Reparti Ushtarak nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësi, pasi nuk lejohet nga struktura e repartit me pretendimin se është zonë ushtarake.

-Kontrata e qirasë Nr. 748/1 Prot., Nr. 3051 Rep., Nr. 613 Kol., datë 22.9.2020, lidhur me qiramarrësin subjektin “F. A.” ShPK. Nga ana e qiradhënësit është realizuar dorëzimi i tokës pasqyruar në procesverbalin me nr. 748/4 prot., datë 26.10.2020 i mbajtur për procesin e dorëzimit, në të cilin u dorëzuan pa problematikë të gjitha sipërfaqet e trajtuara me qira, përveç pasurisë nr. 448/1, Vol 5, faqe 41 me sipërfaqe 6,804 m², e cila sipas hartës treguese të regjistrimit lëshuar nga DVASHK Lushnje, ka rezultuar e zaptuar.

-Shoqëria “P. I.” ShPK. Në proces-verbalin e mbajtur në datë 05.06.2014 nga grupi i punës dhe përfaqësuesi i shoqërisë është dorëzuar një pjesë e sipërfaqes së trajtuar me qira tek qiramarrësi (është kryer piketimi) sipërfaqe prej 80 ha dhe pjesa tjetër prej 61.92 ha nuk është dorëzuar për shkak të pretendimeve të banorëve të zonës.

-Shoqëria “B. A.” ShPK. dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave kanë lidhur kontratë nr.7075 prot, nr.6075 rep. nr.2615 kol, datë 7.10.2014. Në zbatim të Urdhrit nr.509 datë 30.10.2014 “Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë “B. A.I.” shpk”, është ngritur grupi i punës i cili ka proceduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se: “Nga verifikimi në

terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufijtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtimet pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 07.10.2014 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit”.

- Subjekti Kantina “Ç.” ShPK me Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër e Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës), është ngritur grupi i punës “Për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P.Ç.” ShPK, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit, citohet se “qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës”, fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi.

-Shoqëria “T. A.” ShPK. në Kontratën nr. 6801/3 prot, Nr. 1719 Rep, Nr. 674 Kol, datë 18.11.2016. Rezulton se subjekti i ka ndërtuar dy stalla dhe në ndërtim ishte stalla e tretë me kapacitet prej 300 krerësh, por këto stalla nuk janë ngritur në sipërfaqen e marrë me qira, me argumentimin se nuk i është dorëzuar sipërfaqja në përdorim nga qiramarrësi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Nga titullari i MBZHR të merren masa për vlerësimin dhe mundësimin e amendimit të kontratave të mësipërme midis palëve, në të cilat të vendoset sipërfaqja e saktë në përdorim. MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbi vendosje të sipërfaqeve bujqësore, me qëllim realizimin me sukses të kontratave. Për të gjitha rastet, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qira tokë bujqësore, pa realizuar procesin e identifikimit dhe verifikimit të mungesës së mbivendosjeve nga palë të treta.

Brenda vitit 2023

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana e subjekteve të mëposhtëm, nuk janë dorëzuar garancitë e kontratave për periudhën objekt auditimi, kjo në kundërshtim me detyrimet kontraktuale sipas nenit 8 “Sigurimi i garancisë së kontratës “pasi sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe duhet të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate “për kontratat e subjekteve si më poshtë:

- “P. I.” ShPK,
- “B. N.F.” ShPK,
- L.Z., person fizik
- P. C., person fizik
- ShBB “M.” ShPK.
- “A. P.” ShPK,
- E.B., person fizik
- “R.S.” ShPK,
- “A. B. .” shp.k,
- “F. A.” shp.k,
- “H. P. V. ” SHPK

(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa të menjëhershme për njoftimin periodik për arkëtimin e garancive vjetore për të gjithë subjektet që nuk kanë mbaruar ende investimin, me qëllim parandalimin e risqeve që lidhen me mos respektimin e detyrimeve kontraktuale në kryerjen e investimeve sipas plan bizneseve të miratuara.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin rezultoi se:

Pozicioni "drejtor" në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, është vend i lirë/vakant. Nga MBZHR dhe pse janë dërguar nevojat për rekrutim/plan në DAP, për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në pozicionin "drejtor" nuk është dërguar planifikimi për rekrutime për vitin 2022. Me ndryshimet në strukturë të ndodhura gjatë vitit 2022 rezulton se, nga Gushti 2022-31.12.2022, drejtoria funksionon me 3 specialistë, pa drejtor, ku 1 (një) specialist është i komanduar drejtor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 54-133, të raportit të Auditimit)*

15.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike për plotësimin e vendit të lirë/vakant në pozicionin "drejtor" në Drejtorinë e AB.

Brenda vitit 2023

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi respektimin e strukturës organike rezultoi se:

-Për vitin 2021, 20 (njëzet) punonjësit të cilët janë emëruar në zbatim të VKM Nr.1151, datë 24.12.2020, i ndryshuar, si dhe për vitin 2022, 25 (njëzetepesë) punonjësit e emëruar në zbatim të VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, nuk kanë kontrata pune. Marrëdhëniet e tyre të punës janë rregulluar nëpërmjet aktit administrative/urdhrit të ministrit për emërimin në detyrë, duke vepruar jo në përputhje me VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar, pika 6 dhe VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar. Nga MBZHR janë ndjekur standarde të ndryshme në lidhje me kontraktimin e përkohshëm të punonjësve, pasi për studentët e ekselencës të emëruar në përputhje me VKM-në nr.586, datë 30.8.2019 "*Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore*" i ndryshuar janë lidhur kontratat e punës.

-Në 1(një) rast akti i emërimit me Urdhrin Nr.79, datë 21.02.2022 të një punonjësi nuk është bërë në përputhje me VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, pasi marrëdhëniet e punës dhe ato financiare i fillojnë me datë 01.01.2022, ndërkohë që akti ka dalë më vonë datë 21.02.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-54, të Raportit të Auditimit)*.

16.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, për punonjësit e kontraktuar përkohësisht në zbatim të akteve nënligjore që nxjerr Këshilli i Ministrave (VKM) rast pas rasti për vitin respektiv, të lidhen kontrata pune me të kontraktuarit krahas akteve të emërimit në detyrë.

Rast pas rasti

16.2 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i institucionit/ministri, që në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore, aktet e emërimit në detyrë të punonjësve të kontraktuar përkohësisht në zbatim të VKM-ve respektive të nxirren në afat, me qëllim që vonesat në nxjerrjen e akteve të mos sjellin pasoja financiare në buxhet nga përfitimi i pagës në kushtet e fuqisë prapavepruese të aktit nënligjor kur një gjë e tillë nuk është shprehur në aktin nënligjor.

Rast pas rasti

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2019-2022, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1, faqe 167-298, të raportit të Auditimit)*.

17.1 Rekomandimi: Të merren masa nga njësia përgjegjëse për prokurimin në MBZHR për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit për vitin 2019-2022 me qëllim sistemimin arkivor të dokumentacionit.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i disa prej procedurave të prokurimit me fonde publike në MBZHR, në cilësinë e AK, respektivisht: për periudhën 2019-2020, dhe konkretisht:

1. Procedura me objekt prokurimi: Organizim aktiviteti me temë "Shqipëria punon tokën"
2. Procedura prokurimit e hapur me objekt "Studim fizibiliteti me objekt "Fuqizimi prognozë-sinjalizimet në bujqësi nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve inovative në kuadër të zhvillimit ekonomik rajonal", me fond limit në vlerën prej 68,000,000 lekë pa TVSh.

3. Procedura e hapur me objekt "Rehabilitim objektsh dhe mbrojtje lumore, e ndarë në 5 lote me fond limit në vlerën prej 986,011,139.4 lekë pa tvsh.

Loti 1 - "Rehabilitim hidrovovesh"

Loti 2 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 1 (qarku Gjirokastër - Tepelenë)"

Loti 3 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Jug 2 (qarku Fier - Vlorë)"

Loti 4 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë - Elbasan – Durrës - Berat)"

Loti 5 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Veri (qarku Lezhë – Shkodër - Dibër)" .

u konstatua se, kanë pasur mangësi, në vendosjen e afateve të realizimit të procedurës, në vendosjen e kriterëve në hartimin e kriterëve kualifikuese/dokumente të tenderit të vendosura sipas llojit, veçorive, natyrën dhe volumin e objektit, të cilat janë ankimuar nga OE dhe evidentuar nga APP, dhe mbas rekomandimeve të saj janë reflektuar nga Njësia e prokurimit. Grupi i auditimit, konstaton se, kriteret e vendosura nga njësia e prokurimit, kanë sjellë vonesa në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, pasi kanë rritur koston në kohë dhe në burime njerëzore, si dhe përbëjnë risk të mundshëm duke i vendosur në pozitë jo të barabartë operatorët ekonomikë që janë të interesuar për të qenë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, pasi vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhu, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nga auditimi procedurave të mësipërme nuk ka pasur ankimime në lidhje mbi kualifikimet dhe s'kualifikimet e operatorëve ekonomikë, por vetëm për vendosjen e kriterëve të cilat janë të asistuar nga APP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1, faqe 167-298, të Raportit të Auditimit)*

18.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (MBZHR), të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. MBZHR (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërish, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Rast pas rasti

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i disa prej procedurave të realizuara nga MBZHR, në cilësinë e AK, respektivisht: për periudhën 2019-2020, dhe konkretisht:

1. Për procedurën "Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë", gusht 2019.

2. Procedura e hapur me objekt "Rehabilitim objektsh dhe mbrojtje lumore, e ndarë në 5 lote me fond limit në vlerën prej 986,011,139.4 lekë pa tvsh,

Loti 4 - "Rehabilitim i veprave hidrike Rajoni Shqipëri e Mesme (qarku Tiranë - Elbasan – Durrës - Berat)",

3. Procedura me objekt "Mbrojtjen e gështenjës nga parazitë grerëza "Galeformuese Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae" me fond limit në vlerën prej 22,050,000 lekë

pa TVSh u konstatua se, operatorët ekonomikë ofertues dhe njëkohësisht të shpallur fitues kanë paraqitur dokumentacion me devijime të vogla, për të cilat KVO në mbështetje të nenit 53/Shqyrtimi i Ofertave” të LPP, pika 1, duhej të kërkonte sqarim për plotësimin e dokumentacionit për të siguruar gjurmë auditimi dhe për të shmangur risqet e mundshme në zbatimin me sukses të kontratave për punë publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1, faqe 167-298, të raportit të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’ kualifikim apo kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Rast pas rasti

20. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i disa prej procedurave të realizuara nga MBZHR, në cilësinë e AK, respektivisht: për periudhën 2022 dhe konkretisht:

1. Procedura e prokurimit të zhvilluar me objekt Marrëveshje kuadër: “Mbikëqyrje rehabilitim i veprave të program ujitje –kullimit me lote, ndarë në 19 lote”, me fond limit 19,315 mijë lekë.
2. Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike” me Objekt kontrate: “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, ndarë në 19 lote”, nga të cilat u audituan Loti 1, 7,8, 9 dhe 17, me fond limit 376, 874 lekë, u konstatuan se:

Për sa i përket zbatimit të kontratave për secilin lot lidhja, monitorimi dhe zbatimi i kontratave të mbikëqyrjes dhe të rehabilitimit të veprave të programit ujitje-kullim është kryer nga Drejtoritë e Ujitje-Kullimit sipas rajoneve përkatëse bazuar në Urdhrin e Ministrit të MBZHR me nr. 77, datë 21.02.2022, për realizimin e procedurave të prokurimit publik të objekteve në Programin” Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” Nuk ka gjurmë auditimi apo raportim të këtyre DUK-eve në Institucionin Qendror, MBZHR, për zbatimin në kohë dhe me sukses të këtyre kontratave dhe rrjedhimisht nuk ka informacion nga sektori i prokurimit në MBZHR, nëse këto institucione (DUK-et) kanë kryer raportimin në APP për çdo fazë të zbatimit të kontratës pasi DUK janë përgjegjëse për lidhjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe do të jenë përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit me sukses të punimeve nga ana e OE të shpallur fitues sipas procedurave të prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 107 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës pika 1, pika 3, pika 4, pika 7 dhe neni 108 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Ligjin nr. 110/2015 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, neni 16, pika 2. Pra AK, MBZHR nuk ka dijeni nëse fondi prej 19,315 mijë lekë për mbikëqyrje dhe fondi prej 376,874 mijë lekë për kontrata publike të rehabilitimit të kanaleve për ujitje kullim është përdorur me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet nga DUK-et përkatëse, mungesë menaxheriale dhe përgjegjësi e strukturave drejtuese si në MBZHR ashtu edhe në Institucionet e varësisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1, faqe 167-298, të Raportit të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Titullari i Institucionit për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njërive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, sigurimit të gjurmës së auditimit si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë”.

Rast pas rasti

21. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rehabilitim dhe mbrojtje lumore (e ndarë në 6 lote)”, REF-19871-04-26-2019, rezulton se disa prej kriterëve të vendosura janë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish. Konkretisht rezulton se nga ana e NJP janë kërkuar staf inxhinierik për të cilët nuk rezulton të ketë një sqarim në lidhje me diferencimin mes atij të kërkuar si pjesë e listës së drejtuesve teknik dhe atij të kërkuar si staf mbështetës. Gjithashtu, janë kërkuar

inxhinierë të profileve të ndryshme pa bërë asnjë lloj analize teknike mbështetur në volume dhe në afate. Gjithashtu në lidhje me Audituesin Mjedisor, rezultoi se kjo kërkesë (*e cila i referohet Certifikatës Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor*) është një dokument i cili lëshohet nga Ministria e linjës (Neni 24 i ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 *‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’*). Ky ekspert, sipas nenit 6 *Përkufizime*, pikës 18 të ligjit si më sipër, është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga Ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor. Në fakt, në nenin 1 *Qëllimi*, ky ligj ka cituar se:

‘Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

Pra, nga sa më sipër rezultoi se procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, është një fazë e cila ezaurohet përpara miratimit të Projektit dhe pasi Projekti është miratuar, marrë në dorëzim dhe nuk duhet të vendoset si kriter për firmat sipërmarrëse që do të marrin pjesë në procedurë. Gjithashtu, për sa i takon mjeteve të kërkuara, rezultoi se nuk ka asnjë sqarim konkret për të argumentuar numrin dhe kapacitetet e tyre por vetëm një përshkrim të përgjithshëm. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, Neni 1, *“Objekti dhe qëllimi”*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, ndryshuar, Neni 26, *“Kontratat për punë publike”*, pika 3 dhe 5 si dhe Neni 61, *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”*, pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 167-298, të Raportit të Auditimit*).

21.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa për argumentimin e kriterëve të vendosura në procedurat e prokurimit si dhe përzgjedhjen e tyre në raport me nevojat e investimeve me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

22. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezultoi se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *“Rikonstruktion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine”*, është shpallur fitues BOE S.(me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4), të përfaqësuar këta nga OE S. sipas prokurës së posaçme me nr. 5782 rep., 2175 kol., datë 26.09.2020 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me vlerë 288,523,171.95 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Përveç auditimit të dokumentacionit teknik, u krye edhe një verifikim në terren në prezencë të mbikëqyrësit ku u konstatua se cilësia e disa prej zërave të punimeve ishte shumë e ulët çka ka sjellë edhe probleme me lagështinë, funksionalitetin si dhe vet pamjen estetike të objektit. Konkretisht në ambientet e katit përdhe, në zonën jug – lindore të godinës, dhomat rezultuan me lagështi dhe prezencë të theksuar myku duke i bërë këto ambiente të papërdorshme. Nisur nga ky fakt u verifikuan punimet e hidroizolimit, nga ku rezultoi se punimet nuk janë kryer sipas projektit dhe sipas zërave për të cilat është paguar kontraktori. Konkretisht preventivi ka parashikuar të realizohen dy shtresa mapei për hidroizolim kur në fakt hidroizolimi është kryer me vetëm një shtresë karton katrama dhe ajo çka u vërejt nga inspektimi ishte fakti se kthimet në kënde me kartonit katrama nuk ishin të mjaftueshme për mbrojtjen nga uji dhe nuk ishin realizuar me dy shtresa por me një. Pra, përveçse nuk ishin realizuar me dy shtresa ishin realizuar jo në përputhje me kërkesat teknike. Probleme me lagështinë u vërejtën edhe në katin e tretë të godinës.

Fasada e xhamit e cila duhet të ishte e temperuar rezultoi me xham të thyeshëm, pra jo të temperuar çka përbën rrezik serioz për vetë jetën e punonjësve të QTTB. Konkretisht rezultuan dy xhama të thyer, një në fasadën me hark dhe një në fasadën e drejtë në faqen veri – perëndimore.

Një pjesë e materialeve të rezultuara nga rikonstrukcioni ndodheshin akoma brenda rrethimit të objektit duke krijuar një ambient të papastër. Plintuesat e godinës nuk janë ndërtuar me lartësi 10 cm sipas kërkesave të projektit por janë realizuar me lartësi 8 cm. Sipas deklarimeve të punonjësve aparaturat e vendosura për aspirimin nuk ishin efektive pasi në procese të caktuara, punonjësit duhet të dilnin jashtë zyrave për shkak të ndotjes së papranueshme.

Nga ana e kontraktorit të punimeve janë situacionuar si të kryera patinime me stuko veneziane kur në fakt në disa raste stukimi nuk është kryer fare ose është realizuar me stuko të zakonshme dhe jo veneziane e cila ka dhe një çmim më të lartë nga patinimi i zakonshëm.

Nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë deklaruar si të kryera punime suvatimi në tavanet e mbuluara me kartonxhes. Nga verifikimi i kryer në një pjesë të konsiderueshme në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi se pagesa për këtë zë është kryer padrejtësisht pasi ky proces pune, pra suvatimi i tavaneve në pjesë e mbuluara me kartonxhes, nuk është realizuar.

Për sa i takon fasadës strukturale prej xhami në faqet veri – perëndimore dhe jug – perëndimore rezultoi se është përdorur në pjesën më të madhe fasada ekzistuese duke e situacionuar dhe duke i likuiduar sipërmarrësit edhe atë pjesë të fasadës e cila ka qenë ekzistuese por që është përdorur nga ana e sipërmarrësit për punimet e rikonstrukcionit. Për sa i përket fasadës rezultoi se në këtë detaj nuk janë kryer pastrimet e nevojshme të xhamave nga silikoni dhe madje ky i fundit nuk është përdorur në të gjitha rastet me qëllim izolimin e fasadës. Përveç kësaj në tërësi punimet për fasadat kishin mangësi për sa i takon anës estetike duke mos përmbushur edhe një ndër qëllimet e saj.

Në disa raste u konstatua se vetratat nuk ishin sipas hapësirave të dritës (ishin më të mëdha) dhe për këtë nuk ishin marrë masa për zëvendësimin e tyre duke u vendosur në gjendjen e tyre jo të përshtatshme.

Lyerja me bojë vaji e konstruksioneve metalike të parkimeve nuk është kryer uniforme dhe në disa raste as nuk është kryer duke bërë që konstruksioni të shfaq shenja të dukshme ndryshku. Gjithashtu gjatë lyerjes së mureve dhe tavaneve nuk ishte treguar kujdesi i duhur për ruajtjen e elementëve të tjerë të godinës dhe as nuk ishin kryer pastrimet e nevojshme në përfundim të lyerjeve.

Për sa i takon punimeve të paneleve kompozite (alukobondet) rezultoi se edhe këto nuk ishin realizuar në mënyrë estetike por me deformime dhe cilësi shumë të ulët të lidhjes së elementëve të nevojshëm.

Dyert e parashikuar me dru dhe xham ishin realizuar me material MDF dhe pa xham.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6942/6 prot., datë 23.10.2020, Urdhrin nr. 532, datë 31.12.2020 “*Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 167-298, të Raportit të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për mos kryerjen e pagesës prej 14,426,158.6 lekë si shumë e mbajtur për garanci punimesh ndaj BOE S.& P.I. për shkak të cilësisë së dobët të punimeve të kryera në fakt në kontratën me objekt ‘*Rikonstrukcion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine*’, kjo pasi likuidimi i kësaj shume do të përbënte dëm ekonomik ndaj buxhetit të MBZHR.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike”, (2022), me objekt “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim” me vlerë totale të fondit limit 866,303,595 lekë pa TVSH,

është konstatuar vendosja e kriterëve të cilat zvogëlojnë konkurrencën duke sjellë menaxhim jo të drejtë të fondeve publike në vlerën 30,247,440 lekë pa TVSh të prokuruar, respektivisht: Nga auditimi i procedurës së prokurimit Loti 7, me objekt: "Mbrotjtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, krahu i djathtë (L=400m) Bashkia Fier", me fond limit 93,972,048 lekë pa TVSh u konstatua se në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezultoi se kjo e fundit ka vlerësuar në mënyrë të ngurtë kriterin 6 të "Kapacitetit teknik", ku nga NJP kërkohet që *paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, vetëm sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh."*

AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentonte teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Grupi i auditimit e vlerëson këtë kriter përjashtues pasi të gjithë këta operatorë, nga historiku i prokurimeve në MBZHR, të s' kualifikuar për arsyen e sipërcituar nga KVO mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh." për profesionet "Teknik Ndërtimi", "Karpentier" dhe "Saldator", janë fitues në procedura të njëjtit tip dhe kanë pasur kapacitetet teknike të mjaftueshme dhe të njëjtë për periudhën 2017-2021, ndërkohë në vitin 2022 të njëjtët OE vlerësohen me kapacitete teknike të pamjaftueshme ose e thënë ndryshe me teknikë jo të trajnuar dhe të pajisur me certifikatën tip të cilat sipas KVO duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh."

Nga verifikimet e kryera në lidhje me subjektin "Qendra e trajnimeve të avancuara-QTA" i cili është certifikuar nga MFE me shkresën nr. 17089/2, datë 01.12.2021 me lëndë: "Për ndryshim në Licencën e formimit profesional dhe shtim të listës së kurseve të formimit profesional përkatësisht:

Instalues i sistemeve ngrohëse; Saldator; Hidraulik; Pllaka shtrues; Karpentier; Murator-suvatues etj., rezultoi që është vetëm ky subjekt privat i certifikuar nga MFE ose e thënë ndryshe ka "*ekskluzivitetin*" e dhënies së këtyre certifikatave të cilat janë kurse jo më shumë se 85-90 orë mësimore që "zëvendësojnë" shkollat e arsimit profesional që kanë një kohëzgjatje prej 3-vjet. (Verifikuar në certifikatat e lëshuara të marra nga sistemi elektronik i prokurimeve).

Duke parë rëndësinë e ofertave ekonomike më të mira ekonomikisht, në lidhje me kurset e specialistëve, nga KVO nuk duhej mbajtur qëndrim "*strikt*", në vlerësimin e ofertave, pasi nuk do të cenohet aspak realizimi i kontratës me sukses. Referuar ligjit mbi prokurimin publik, Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, ***gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.***

MBZHR, nuk ka siguruar të ulë shpenzimet procedurale. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mosveprimet të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes të punimeve me një vlerë ekonomike më të favorshme për buxhetin e shtetit, përkatësisht: Nga s' kualifikimi i OE "Sh. 07", ShPK, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë më tepër në vlerën 22,880,970 lekë pa TVSH = (74,398,800 – 51,517,830), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

2- Nga auditimi i procedurës së prokurimit Loti 17, me objekt: "*Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgj*", me fond limit 57,139,289 lekë pa TVSh u konstatua se në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezultoi se kjo e fundit ka vlerësuar në mënyrë të ngurtë kriterin 6 të "Kapacitetit teknik", ku nga NJP kërkohet që *paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara, për kurset e ofruara, vetëm*

sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh.”. Gjatë vlerësimit, KVO-ja, pavarësisht mangësive, përpara se të kryente s’ kualifikimin, në interes të AK mund të konsideronte aplikimin e nenit 53 pika 4, në përputhje me frymën dhe qëllimin e LPP, sipas të cilit: “autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...”, veprimet e KVO-së ndikojnë negativisht në mirë përdorimin e fondeve publike dhe për pasojë kryerjen e punimeve me një vlerë me të lartë ekonomike. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga NJP dhe mos veprimet të KVO-së nuk është bërë e mundur minimalisht shmangja e kryerjes së punimeve me një vlerë ekonomike në dis favor të buxhetit të shtetit, përkatësisht:

Nga s’ kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “H.” ShPK, me ofertë ekonomike 64,293,759.60 lekë, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në dis favor në vlerën 172,080 lekë pa TVSH = (66,465,840 – 64,293,760), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim.

Nga s’ kualifikimi i OE Operatori Ekonomik “U.” ShPK me ofertë ekonomike 59,271,450 lekë pa tvsh, veprimet e KVO-së i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë në disfavor në vlerën 7,194,390 lekë pa TVSH = (66,465,840 – 59,271,450), si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim. Në alternativë, sa më sipër KVO-ja, midis operatorëve pjesëmarrës në procedurë, referuar nenit 2 të ligjit nr. 162/2020 prot., “Për prokurimin publik”, me qëllim rritjen e efijencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit duke siguruar mirë përdorim e fondeve publike si dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duhej të vlerësonte kriterin kryesor që është “Oferta më e ulët” për të bërë të mundur shmangien e përdorimit me efekt negativ të fondeve publike në vlerën 30,247,440 lekë si diferenca midis ofertave të OE në klasifikim. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 167-298, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

23.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara se të kryejë një s’ kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, i cili nuk ndryshon thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e kualifikuar në këtë rast si ofertë të vlefshme.

Brenda vitit 2023

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se:

Sistemet e kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar në harmoni të plotë me njeri- tjetrin, pasi:

-nuk janë kryer procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke mos koordinuar sistemet e kontrollit mbi kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga monitorimi i kontratave të qirasë së tokave bujqësore në administrim të MBZHR. Një konstatim i tillë doli nga auditimi i pasqyrave financiare 2021–2022 dhe regjistrimit në kontabilitet (llogaria 210) “toka troje” është në vlerën 0;

-në lidhje me rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore, për periudhën 2021-2022 ka raste të largimit të punonjësve me shërbim civil, të cilët nuk kanë dorëzuar detyrën dhe dokumentacionin e administruar prej tyre me procesverbal, e cila sjell si pasojë thyerjen e Kodit të Etikës dhe veprime jo në përputhje me VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirim nga

shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22.(*Më hollësisht trajtuar në pikën II/7.2, faqe 298-316, të raportit të Auditimit*)

24.1 Rekomandimi: Të merren masa nga titullari i MBZHR për ndërtimin e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm publik dhe financiar. Struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të marrë masa që në rastet e largimit nga puna për punonjësit me shërbim civil, dorëzimi i dokumentacionit të administruar prej tyre të bëhet me procesverbal, me qëllim eliminimin e vonesave të krijuara në rastet e auditimit të tij nga auditi i jashtëm apo auditi i brendshëm.

Rast pas rasti

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe organizimin e auditit të brendshëm në MBZHR u konstatua se:

Në Raportin vjetor për vitin 2021, mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm i cili paraqitet brenda muajit Maj të çdo viti, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për integrimin në raportin vjetor të konsoliduar për kontrollin e brendshëm në sektorin publik, komform Ligjit Nr.114/2015 i ndryshuar, neni 24, germa “d”, ka paqartësi të dhënash. Paqartësia në të dhënat e raportuara dhe dërguara në MFE, nuk sjell siguri të arsyeshme në hartimin e raportit të konsoliduar të kontrollit të brendshëm në sektorin publik. (*Më hollësisht trajtuar në pikën II/7.2, faqe 298-316, të raportit të Auditimit*).

25.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të MBZHR-së që para miratimit të Raportit vjetor mbi funksionimin e AB dhe dërgimit të tij në MFE, të rakordohet nga të gjithë anëtarët e grupit për hartimin e tij, për saktësinë e të dhënave të raportuara dhe gabimet materiale, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin cilësor të kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt “*Rikonstruktion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine*”, është shpallur fitues BOE S.(me nr. licence NZ.3091/19) & P. I.(me nr. licence NZ.4352/4), të përfaqësuar këta nga OE S. sipas prokurës së posaçme me nr. 5782 rep., 2175 kol., datë 26.09.2020 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me vlerë 288,523,171.95 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej **6,461,698 lekë pa TVSH** për 6 zëra punimesh.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6942/6 prot., datë 23.10.2020, Urdhrin nr. 532, datë 31.12.2020 “*Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës*”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6.2, faqe nr. 167-298, të Raportit të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **6,461,698 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE S. (me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4) për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6764/5 prot.,

datë 16.10.2020 me objekt *'Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine'*.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *“Rehabilitimi objektesh dhe mbrojtje lumore, i ndarë me lote”, “Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë)”* nën objekti *“Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”*, është shpallur fitues BOE B. & B. & B.& NG S. me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 3273/25 prot, datë 31.08.2020 me vlerë 51,972,606 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve jo të kryera sipas zërit përkatës të përshkruar në situacionin përfundimtar. Konkretisht rezulton se, referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje, punimet e gërmimit nuk janë kryer me ekskavator me kapacitet 0.25 m³, siç parashikon zëri në preventiv por janë kryer me ekskavator me kapacitet kove 1 m³, kapacitet i cili rezulton një çmim më të ulët nga ai i zërit 3.97/b *Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.25 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria III, me shkarkim në tokë*, kjo si rrjedhojë e një rendimenti më të lartë të kësaj kove me të paktën 50 %. Për rrjedhojë, për këtë zë duhet të ishte bërë korrigjimi i zërit në preventiv dhe në situacionin përfundimtar⁷ duke ndryshuar rendimentin nga 0.08 o.p makineri/m³ në 0.06 o.p makineri/m³. Mos kryerja e këtij veprimi ka bërë që të përfitohen tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **956,402 lekë pa TVSH** ((900 lekë/m³ – 199 lekë/m³) x 1364.34 m³).

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3 si dhe Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 3137/18 prot., datë 31.08.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.2, faqe nr. 167-298, të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **956,402 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE B. & B. & B.& NG S. për punime jo sipas preventivit dhe situacionit përfundimtar të kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3273/25 prot., datë 31.08.2020 me objekt *“Loti 3, Rehabilitimi i veprave hidrike Rajoni Jug 2, Qarku Fier-Vlorë)”* nën objekti *“Mbrojtje nga lumi Vjosë, në Hekal Mallakastër”*.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt *“Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE R. (me nr. licence NZ.3091/19) me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me vlerë 186,053,560 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

⁷ Siç vepohet në rastet kur gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja për zëra të rinj në preventiv.

Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezultojnë se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej **172,718 lekë pa TVSH** e argumentuar kjo si më poshtë.

Zëri Transport mbetjesh deri 7 km

Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 1380 m³. Libreza e masave pasqyron të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar analizës së zërit të punës *Prishje mure tulle pa pastrim*, me nr. analize 2.426, rezultojnë se ky zë ka të parashikuar edhe volumin e punës për transportin e materialit. Për rrjedhojë rezultojnë se janë përfituar tepër volumi prej 285 m³ për transportin e mbetjeve nga prishja e mureve të tullës, ose vlera prej **105,450 lekë pa TVSH**.

Zëri Shtrese betoni C-12/15

Sipas situacionit përfundimtar në lidhje me këtë zë është paraqitur volumi prej 181.6 m³ nga të cilat sasia prej 32.75 m³ për plintat sipas librezës së masave. Në fakt, referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosje rezultojnë se shtresa e betonit nuk është realizuar me shtesa prej 20 cm në çdo krah të plintave, pra nuk është realizuar me të njëjtën gjerësi të shtresës me çakëll por është realizuar me gjerësi sipas asaj të plintit. Për rrjedhojë rezultojnë se janë përfituar tepër volumi prej 8.515 m³ (32.75 x 26 %), ose vlera prej **67,268 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6477/8 prot., datë 22.11.2021, Urdhri nr. 653, datë 03.12.2019 “Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës” si dhe Urdhri nr. 265/1 prot., datë 13.01.2022 “Për ngritjen e komisionit për kolaudimin e punimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6.2, faqe nr. 167-298, të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **172,718 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit BOE “R”. për punime të likuiduara por të pakryera në fakt në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me objekt “Rikonstruksioni i merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”.

Menjëherë

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore në lidhje me arkëtimin në kohë të qirasë rezultojnë se në 10 nga 21, ose 48% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë paguar në kohë detyrimin për qiranë duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si dhe shtim të detyrimeve të prapambetura në lidhje me kamatëvonesat e llogaritura në vlerën totale 55,830 mijë lekë, veprime në kundërshtim me VKM Nr.373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; Kontratat e qirasë, si dhe detyrimet kontraktuale sipas çdo kontrate.

Gjatë auditimit u konstatua se 7 subjektet e mëposhtëm nuk kanë likuiduar apo paguar me vonesë qiratë në lidhje me kontratat e tokave bujqësore, si më poshtë:

- Shoqëria “P. I.” ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863) detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave;
- Shoqëria “A. I. G.” ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë detyrim i qirasë dhe kamatëvonesave;
- Shoqëria “B. N. F.” ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesë;
- Shoqëria “R.S.” ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesë;

- Shoqëria “S. G.” ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa;
- E.B., person fizik; Kantina C.; A. B. dhe F.A. dhe Kantina D. kanë në total 462 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 55,830 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos pagesa në afat e detyrimit vjetor të qirave duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

- Shoqëria “P. I.” ShPK. në vlerën 27,483 mijë lekë (4,619 + 22,863)
 - Shoqëria “A.I. G.” ShPK në vlerën 9,007 mijë lekë
 - Shoqëria “B. N.F.” ShPK. në vlerën 14,799 mijë lekë
 - Shoqëria “R. S.” ShPK në vlerën 2,180 mijë lekë për qira të pashlyer dhe kamatëvonesa;
 - Shoqëria “S. G.” ShPK në vlerën 1,899 mijë lekë
 - E. B., person fizik; Kantina C.; A. B. dhe F. A. dhe K. D. kanë në total 462 mijë lekë.
- MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të kontratave të lidhura për tokat bujqësore në lidhje me realizimin e investimeve kapitale rezulton se në 12 nga 21, ose 57% të kontratave të qirasë qiramarrësit nuk kanë kryer investime në terren për të cilat në dosjet e kontratave të audituara nuk ka dokumente justifikuese (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë 57% e kontratave nuk provon realizimin e investimit. Gjatë auditimit u konstatua se në 12 kontratat e qirasë nuk janë kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe nuk kanë kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para, referuar neni 6 pika 5, a dhe b të kontratës ku shprehet se “a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë; b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe.

Gjatë auditimit u konstatua se 11 subjektet e mëposhtëm nuk kanë realizuar investimet e parashikuara në plan biznes për të cilat vlera e gjobës për mosrealizim të investimit paraqiten në vlerën totale 426,029 mijë lekë, si më poshtë:

- Shoqëria “P.I.t” ShPK. në vlerën 45,465 mijë lekë;
- Shoqëria “K. D.” ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë;
- Shoqëria “B. A. I.” ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë
- Shoqëria “K. Ç.” ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë;
- Shoqëria “B. N. F.” ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë;
- Shoqëria “A. I. G.” ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë;
- Shoqëria “B.P.” ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë;
- Person fizik L.Z., në vlerën 5,147 mijë lekë;
- Shoqëria “A. P.” ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë;
- Shoqëria “A.W & CO” ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë;
- Shoqëria “F. A.” ShPK në vlerën 25,650 mijë lekë;
- Shoqëria “M.” ShPK në vlerën 931 mijë lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-133, të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: MBZHR, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 426,029 mijë lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor në mos kryerjen e

investimeve duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:

- Shoqëria “P. I.” ShPK. në vlerën 45,465 mijë lekë;
- Shoqëria “K. D.” ShPK. në vlerën 12,938 mijë lekë;
- Shoqëria “B. A. I.” ShPK në vlerën 281,250 mijë lekë
- Shoqëria “K. Ç.” ShPK në vlerën 15,571 mijë lekë;
- Shoqëria “B. N. F.” ShPK. në vlerën 9,084 mijë lekë;
- Shoqëria “A.I. G.” ShPK në vlerën 6,778 mijë lekë;
- Shoqëria “B.P.” ShPK. në vlerën 4,714 mijë lekë;
- Person fizik L.Z., në vlerën 5,147 mijë lekë;
- Shoqëria “A.P.” ShPK. në vlerën 17,063 mijë lekë;
- Shoqëria “A.W & CO” ShPK. në vlerën 1,438 mijë lekë;
- Shoqëria “F. A.” ShPK në vlerën 25,650 mijë lekë;
- Shoqëria “M.” ShPK në vlerën 931 mijë lekë.

-MBZHR, të marrë masa si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative për zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rast mospagimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine*”, është shpallur fitues BOE S. (me nr. licence NZ.3091/19) & P. I. (me nr. licence NZ.4352/4), të përfaqësuar këta nga OE S. sipas prokurës së posaçme me nr. 5782 rep., 2175 kol., datë 26.09.2020 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK sipas shkresës me nr. 6764/5 prot., datë 16.10.2020 me vlerë 288,523,171.95 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Nga inspektimi në terren i punimeve të realizuara për këtë kontratë por në lidhje me punimet për ndërtimin e stallës së lopëve, rezultoi se ky investim, në 5 mujorin e parë të vitit 2023 është krejtësisht jo efektiv dhe i pa vënë në përdorim nga ana e Ministrisë dhe QTTB, duke mos përmbushur objektivin për të cilin është ndërtuar dhe për pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt në masën prej **67,633,707 lekë me TVSH**. Gjithashtu investimi nuk rezultoi të ishte i sigurt nga vjedhjet, tjetërsimi si dhe nga përdorimit i paautorizuar pasi nuk janë siguruar vendqëndrimet dhe rojet përkatëse në të paktën 2 pozicione, këto të domosdoshme nisur edhe nga shtrirja e investimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1 faqe nr. 167-298, të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren të gjitha masat e nevojshme për vënien në përdorim të investimit të bërë për pjesën e stallës së lopëve pasi aktualisht mos përdorimi e bën këtë shpenzim të jetë krejtësisht jo efektiv duke shkaktuar kështu edhe një përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet në masën prej **67,633,707 lekë me TVSH**. Gjithashtu, MBZHR dhe QTTB të marrin masat e nevojshme për sigurimin nga vjedhjet, tjetërsimin si dhe nga përdorimet e paautorizuara të këtij asemi.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit me objekt “*Rikonstruksioni i*

merkatos së tregtimit të peshkut me shumicë, Vlorë”, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE R. (me nr. licence NZ.3091/19) me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK , sipas shkresës me nr. 6766/10 prot., datë 03.12.2019 me vlerë 186,053,560 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Nga krahasimi i zërave të situacionuar me ato të pasqyruara në librezën e masave rezulton se janë përdorur pa efektivitet eficientë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej **745,000 lekë pa TVSH** e argumentuar kjo si më poshtë.

Zëri F.V. Punime artistik me metal inoksidabël, rrathë me diametër 5 m dhe figurë 3 m të lartë

Sipas përshkrimit në preventiv ky detaj duhet të ishte realizuar me dimensione 5 m diametri dhe 3 m i lartë figura kur në fakt nga verifikimi në terren i kryer ky zë është realizuar me konfiguracion me dimensione 3.8 m dhe 2.4 m, ose përkatësisht 1.2 m dhe 0.6 m më pak. Pra, vlera prej **745,000 lekë pa TVSH** nuk është kryer sipas kërkesave të projektit.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar e konkretisht Kreu II, Pika 3, Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me nr. 6477/8 prot., datë 22.11.2021, Urdhri nr. 653, datë 03.12.2019 “*Për ngritjen e komisionit për ndjekjen e zbatimit të kontratës*” si dhe Urdhri nr. 265/1 prot., datë 13.01.2022 “*Për ngritjen e komisionit për kolaudimin e punimeve*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6.1 faqe nr. 167-298, të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e MBZHR të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorim/ndjekje kontrate dhe atyre të marrjes në dorëzim me qëllim shmangien e rasteve të mospërputhshmërisë mes zërave të preventivave dhe atyre të kryer në fakt, duke shmangur kështu edhe përdorimet pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve si është ai i shumës prej **745,000 lekë pa TVSH** i shkaktuar prej mos respektimit të detajeve të projektit.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT